



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05

**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 16 dhjetor 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar më Tej i Versionit të Korrigjuar të Versionit të Redaktuar  
Publik të Aktgjykimit**

---

**T'i njoftohet:**

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Aleks Uajting

Silvia d'Askoli

Sezari Mihalçuk

Filipo de Miniçis

**Zyrës Administrative:**

Fidelma Donlon

**Mbrojtjes së të akuzuarit:**

Julius von Bone

Betim Shala

**Mbrojtjes së viktimave:**

Ani Pues

Brehtje Vosenberg

I.	HISTORIKU PROCEDURAL.....	2
II.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE.....	6
III.	AKUZAT KUNDËR TË AKUZUARIT.....	6
IV.	ASPEKTE TË PROVAVE.....	8
	A. Presumimi i pafajësisë dhe standardi i vërtetimit.....	8
	B. Provat e administruara prej Trupit Gjykes .....	9
	C. Metodologjia e përdorur nga Trupi Gjykes në lidhje me provat.....	11
	D. Faktet që nuk është e nevojshme të vërtetohen .....	20
	E. Vlerësim i përgjithshëm i dëshmitarëve të ZPS-së.....	20
	F. Vlerësim i përgjithshëm i dëshmitarëve të mbrojtjes.....	54
	G. Komente mbi disa dokumente në të cilat është mbështetur Trupi Gjykes..	91
V.	KONSTANTIME FAKTIKE .....	96
	A. Alibia e paraqitur nga i akuzuari .....	96
	B. Njësiti BIA, roli i të akuzuarit dhe raporti i BIA-s me Komandën e Zonës Operative të Llapit .....	134
	C. Ndalimi arbitrar (Pika 1) .....	141
	D. Trajtimi mizor dhe tortura (Pikat 2 dhe 3).....	206
	E. Vrasja e paligjshme (Pika 4) .....	249
VI.	KONSTATIME LIGJORE.....	274
	A. Ndalimi arbitrar (Pika 1) .....	274
	B. Trajtimi mizor (Pika 2).....	281
	C. Tortura (Pika 3).....	285
	D. Vrasja e paligjshme (Pika 4).....	294
	E. Ekzistenca e konfliktit të armatosur .....	298
	F. Lidhja me konfliktin e armatosur jondërkombëtar .....	306
	G. Dijenia për ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe statusin e viktimave .....	308
	H. Përgjegjësia penale individuale e të akuzuarit .....	310
	I. Përfundim.....	324
VII.	DËNIMI.....	325
	A. Parashtrimet .....	326
	B. Kuadri ligjor .....	330
	C. Konstatime.....	336
VIII.	VENDIM .....	347

TRUPI GJYKUES I ("Trupi Gjykues") në vijim jep vendimin e gjykimit.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") parashtrio aktakuzën kundër z. Salih Mustafa ("z. Mustafa" ose "i akuzuari"), të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ("Aktakuza e Konfirmuar").<sup>1</sup>
2. Më 24 shtator 2020, z. Mustafa u arrestua<sup>2</sup> dhe transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.<sup>3</sup>
3. Më 28 shtator 2020 u mbajt seanca e paraqitjes së parë të të akuzuarit para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>4</sup>
4. Më 28 tetor 2020, i akuzuari u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me akuzat për krimet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00011/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë*, 19 qershor 2020, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 28 shtator 2020, [F00019/A01](#); F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës* ("Vendimi i Konfirmimit"), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u dorëzuan më 5 tetor 2020, përkatësisht, F00008/CONF/RED dhe [F00008/RED](#).

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00013, Administratorja, [Notification of Arrest Pursuant to Rule 55\(4\)](#) (Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)), 24 shtator 2020, publik; F00009/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 24 shtator 2020, [F00009/A01/RED](#).

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F00014, Administratorja, [Notification of Reception in the Detention Facilities of the Specialist Chambers](#) (Njoftim për Pranimin në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara), 24 shtator 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i Shtojcës 1 u dorëzua më 24 nëntor 2020, [F00054/A01](#); F00009/A02, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 24 shtator 2020, [F00009/A02/RED](#).

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-05, F00017, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision Setting the Date for the Initial Appearance of Salih Mustafa](#) (Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Salih Mustafës), 25 shtator 2020, publik; T. 28 shtator 2020, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, F00039, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Order Setting the Date for the Plea Hearing and a Second Status Conference](#) (Urdhër për Caktimin e Datës së Seancës për Vetëdeklarim në lidhje me

5. Më 7 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykses dosjen e çështjes gjyqësore.<sup>6</sup>
6. Gjatë fazës së procedurës paraprake dhe të gjykimit të çështjes, nëntë viktimat u pranuan për të marrë pjesë në proces.<sup>7</sup> [REDAKTUAR],<sup>8</sup> mbetën gjithsej tetë viktimat pjesëmarrëse në proces.
7. Më 7 shtator 2021, Trupi Gjykses bëri konstatim gjyqësor për 52 fakte të shqyrtuara në procese të tjera (“Vendimi mbi Faktet e Shqyrtuara”).<sup>9</sup>
8. Gjykimi filloi më 15 shtator 2021, me deklaratat hyrëse të ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave.<sup>10</sup>
9. Prej 20 shtatorit 2021 deri më 4 shkurt 2022, ZPS-ja paraqiti provat e veta, në kuadër të të cilave 13 dëshmitarë dëshmuan drejtpërdrejt në gjykatë.<sup>11</sup> Deklaratat me

---

Fajësinë ose Pafajësinë dhe të Konferencës së Dytë për Ecurinë e Çështjes), 19 tetor 2020, publik, para. 18, 22(a); T. 28 tetor 2020, publik, f. 60, rreshtat 2-13.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-05, F00119, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision Transmitting the Case File to Trial Panel I](#) (Vendim për Kalimin e Dosjes Gjyqësore Trupit Gjykses I), 7 maj 2021, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

<sup>7</sup> Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesat e pesë viktimave për pjesëmarrje në proces; *shih* KSC-BC-2020-05, F00105, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 30 prill 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00105/RED](#). Më 21 maj 2021, Trupi Gjykses miratoi kërkesat e katër viktimave për pjesëmarrje në proces; *shih* F00126, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 21 maj 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00126/RED](#).

<sup>8</sup> [REDAKTUAR].

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-05, F00191, Trupi Gjykses I, [Decision on judicial notice of adjudicated facts](#) (Vendim për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera”) 7 shtator 2021, publik; *shih* F00144/A01, Prokurori i Specializuar, [Annex 1 to Prosecution’s motion for judicial notice of adjudicated facts](#) (Shtojca 1 e Mocionit të Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera), 30 qershor 2021, publike, për listën e fakteve të shqyrtuara në procese të tjera (“Lista e Fakteve të Shqyrtuara”).

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-05, F00138, Trupi Gjykses I, [Decision setting the date for the commencement of the trial and related matters](#) (Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjykimit dhe Pika të Tjera që lidhen me Të), 18 qershor 2021, publik; T. 15 shtator 2021, publik.

<sup>11</sup> T. 20 shtator 2021, publik; F00308, Prokurori i Specializuar, [Prosecution Notice of the Closing of its Case pursuant to Rule 129](#), (Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 129 për Mbylljen e Paraqitjes së Provave të Saj), 4 shkurt 2022, publik.

shkrim të dy dëshmitarëve të tjerë u paraqitën si prova në vend të dëshmime gojore të tyre.<sup>12</sup>

10. Më 23 shkurt 2022, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin mbi Mocionin e Mbrojtjes sipas Rregullës 130(1) për Rrëzimin e Ndonjë apo të Gjitha Akuzave në Aktakuzën e Konfirmuar, me të cilin hodhi poshtë mocionin e Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave.<sup>13</sup>

11. Më 21 mars 2022, Trupi Gjykses dëgjoi mendimet dhe shqetësimet e një viktime pjesëmarrëse në proces.<sup>14</sup>

12. Më 22 mars 2022, Mbrojtja bëri deklaratën hyrëse.<sup>15</sup>

13. Nga 23 marsi deri më 26 maj 2022, Mbrojtja paraqiti provat e veta, në kuadër të të cilave 15 dëshmitarë dëshmuuan drejtpërdrejt në sallën e gjyqit.<sup>16</sup>

14. Më 1 qershor 2022, ZPS-ja paraqiti kundërprova shtesë,<sup>17</sup> në përputhje me autorizimin e Trupit Gjykses.<sup>18</sup> Mbrojtja vendosi të mos paraqiste kundërprova shtesë.

---

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-05, F00235, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Mëparshme të W04648-ës dhe të Dokumenteve Shoqëruese* ("Vendimi për Pranimin e Deklaratave me Shkrim të W04648-ës"), 15 tetor 2021, konfidencial, para. 16(b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00235/RED](#); F00286, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë në bazë të Rregullës 153 të Rregullores* ("Vendimi për Pranimin e Deklaratave me Shkrim të W04712-shit"), 17 dhjetor 2021, konfidencial, para. 37(b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00286/RED](#).

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-05, F00326, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes sipas Rregullës 103(1) për Rrëzimin e Ndonjë apo të Gjitha Akuzave në Aktakuzë*, 23 shkurt 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00326/RED](#).

<sup>14</sup> T. 21 mars 2022, publik.

<sup>15</sup> T. 22 mars 2022, publik.

<sup>16</sup> T. 23 mars 2022, publik; KSC-BC-2020-05, F00421, Mbrojtësi i Specializuar, *Defence Rule 131 Notice to close the Defence case*, (Njoftim i Mbrojtjes sipas Rregullës 131 për Mbylljen e Paraqitjes së Provave të Mbrojtjes), 26 maj 2022, publik.

<sup>17</sup> T. 1 qershor 2022, publik.

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-05, F00424, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Paraqitje të Kundërprovave*, 27 maj 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00424/RED](#).

15. Më 3 qershor 2022, Trupi Gjykses kërkoi paraqitjen e provave shtesë, në përputhje me rregullën 132 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).<sup>19</sup>
16. Më 20 qershor 2022, Trupi Gjykses mbylli procedurën e paraqitjes së provave, në përputhje me rregullën 134(a) të Rregullores.<sup>20</sup>
17. Më 20 korrik 2022, mbrojtësja e viktimave dorëzoi deklaratën në lidhje me pasojat e krimeve mbi viktimat pjesëmarrëse në proces.<sup>21</sup>
18. Më 21 korrik 2022, palët dorëzuan Dosjet Gjyqësore Përfundimtare të tyre.<sup>22</sup>
19. Nga 13 deri më 15 shtator 2022 u mbajt seanca e deklaratave përmbyllëse<sup>23</sup> dhe më 15 shtator 2022, Kryegjykatësja mbylli gjykimin e çështjes.<sup>24</sup>

<sup>19</sup> KSC-BC-2020-05, F00430, Trupi Gjykses I, *Vendim në bazë të Rregullave 132 dhe 149 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës në lidhje me Prova të Kërkuara nga Trupi Gjykses*, 3 qershor 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00430/RED](#).

<sup>20</sup> KSC-BC-2020-05, F00439, Trupi Gjykses I, *Decision on the closing of the evidentiary proceedings and related matters* (Vendim për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe Çështje në lidhje me To) (“Vendimi mbi Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave”), 20 qershor 2022, publik, para. 25.

<sup>21</sup> KSC-BC-2020-05, F00456, Mbrojtësja e Viktimave, *Deklaratë e Mbrojtëses së Viktimave në lidhje me Pasojat e Krimeve mbi Viktimat Pjesëmarrëse në Proces* (“Deklarata e Mbrojtëses së Viktimave mbi Pasojat e Krimeve”), 20 korrik 2022, rreptësisht konfidenciale.

<sup>22</sup> KSC-BC-2020-05, F00457/COR, Mbrojtësi i Specializuar, *Corrected Version of the Defense Final Trial Brief* (Version i Korrigjuar i Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Mbrojtjes), (“Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes”), 21 korrik 2022, publike, me shtojcën 1, konfidenciale; F00459/COR, Prokurori i Specializuar, *Corrected version of Prosecution Final Trial Brief pursuant to Rule 134(b)* (Version i Korrigjuar i Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Prokurorisë sipas Rregullës 134(b)), (“Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së”), 22 korrik 2022 (versioni i parë u dorëzua më 21 korrik 2022), publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe [Annex 2](#), (Shtojca 2), publike.

<sup>23</sup> *Decision Closing the Evidentiary Proceedings* (Vendim mbi Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave), para. 22; KSC-BC-2020-05, F00468, Trupi Gjykses I, *Vendim për Caktimin e Rendit të Ditës të Seancës mbi Deklaratat Përmbyllëse dhe Çështje në lidhje me To* (“Vendimi mbi Caktimin e Rendit të Ditës për Deklaratat Përmbyllëse”), 31 gusht 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00468/RED](#).

<sup>24</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4859, rreshti 15.



20. Më 6 dhjetor 2022, Trupi Gjykses caktoi mbajtjen e seancës së shqiptimit të Aktgjykimit për të premtën, 16 dhjetor 2022.<sup>25</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

21. Trupi Gjykses bazohet në nenin 31(5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (përkatësisht, “Kushtetuta e Kosovës”), nenet 3(2), 14(1)(c) dhe (2), 16(1)(a), 21, 23(1), 34, 40(5), 43, dhe 44(1), (2) dhe (5) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 23(1), 24(1)-(3), 138, 139, 140, 158, 159(1)-(4) dhe (6), dhe 163(1), (3), (4) dhe (6) të Rregullores.

## III. AKUZAT KUNDËR TË AKUZUARIT

22. I akuzuari u lind më 1 janar 1972 në Prishtinë, Kosovë, dhe është shtetas i Kosovës.<sup>26</sup> ZPS-ja pretendon se gjatë gjithë kohës që lidhet me Aktakuzën e Konfirmuar, i akuzuari ishte komandant i njësitit gueril BIA (“BIA”, ose “njësi BIA”) njësit brenda Zonës Operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), në anglishte, *Kosovo Liberation Army* (“KLA”).<sup>27</sup>

23. Në Aktakuzën e Konfirmuar, ZPS-ja ngre kundër z. Mustafa katër akuza për krime lufte në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit, përkatësisht për: ndalim arbitrar (Pika 1), trajtim mizor (Pika 2), torturë (Pika 3) dhe vrasje të paligjshme (Pika 4).<sup>28</sup> Sipas ZPS-së, krimet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar ndodhën në kontekstin e konfliktit

---

<sup>25</sup> KSC-BC-2020-05, F00491, Trupi Gjykses I, [Scheduling order for the pronouncement of the judgment](#) (Urdhër për Caktimin e Datës për Shqiptimin e Aktgjykimit), 6 dhjetor 2022, publik.

<sup>26</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 1; KSC-BC-2020-05, F00108/A01, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Fakteve për të cilat Palët Pajtohen sipas Rregullës 95(3) (Tabela e Propozuar)*, 30 prill 2021, konfidenciale, f. 2, Faktet 1.1 dhe 1.2. Versioni i redaktuar publik, i korrigjuar, u dorëzua më 17 qershor 2022, [F00108/RED/A01/COR](#).

<sup>27</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 2.

<sup>28</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 35.

të armatosur jondërkombëtar dhe kishin lidhje me këtë konflikt midis UÇK-së, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe grupe të tjera që luftonin në emër të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë (bashkërisht, “forcat serbe”).<sup>29</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendon se i akuzuari ishte në dijeni të rrethanave faktike që vërtetonin ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe e dinte se viktimat ishin persona që nuk merrnin pjesë aktive në luftime.<sup>30</sup>

24. Sipas Aktakuzës së Konfirmuar, të gjitha krimet e paraqitura u kryen kundër personave që u mbajtën në ndalim në një kompleks në Zllash, në Kosovë – më tej në tekst: kompleksi i ndalimit në Zllash – që përdorej nga BIA si vendstrehim i sigurt dhe si qendër ndalimi dhe marrjeje në pyetje.<sup>31</sup> ZPS-ja pretendon se z. Mustafa mban përgjegjësi penale individuale për ndalimin arbitrar, trajtimin mizor dhe torturimin e së paku gjashtë personave në kompleksin e ndalimit në Zllash, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999,<sup>32</sup> dhe për vrasjen e paligjshme të një personi, [REDAKTUAR] (“viktima e vrasjes së paligjshme”), afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999.<sup>33</sup>

25. Sipas ZPS-së, i akuzuari mban përgjegjësi penale individuale në bazë të nenit 16(1)(a) të Ligjit për kryerjen fizike të disa veprimeve mbi të cilat bazohen krimet e përfshira në Pikat 1-3, dhe/ose për kryerjen e disa ose të gjitha veprimeve mbi të cilat bazohen krimet e përfshira në Pikat 1-4, nëpërmjet formës bazë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët (“NKP I”). Si alternativë, ZPS-ja pretendon se i akuzuari mban përgjegjësi penale individuale për kryerjen e krimit të përfshirë në Pikën 4, nëpërmjet

---

<sup>29</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 3-4.

<sup>30</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 6.

<sup>31</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 5.

<sup>32</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 18-30, 35.

<sup>33</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 31-33, 35.



formës së zgjeruar të NKP-së (“NKP III”).<sup>34</sup> Pretendohet gjithashtu se i akuzuari urdhëroi dhe/ose nxiti krimet e përfshira në Pikat 1-3,<sup>35</sup> dhe se ndihmoi dhe inkurajoi krimet e përfshira në Pikat 1-4.<sup>36</sup> Si alternativë, ZPS-ja pretendon se i akuzuari mban përgjegjësi penale individuale si epror, në bazë të nenit 16(1)(c) të Ligjit, për të gjitha krimet për të cilat janë ngritur akuza.<sup>37</sup>

26. Mbrojtja kërkon që i akuzuari të shpallet i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës së Konfirmuar.<sup>38</sup>

#### IV. ASPEKTE TË PROVAVE

##### A. PREZUMIMI I PAFAJËSISË DHE STANDARDI I VËRTETIMIT

27. Sikurse garantohet në nenin 31(5) të Kushtetutës dhe nenin 21(3) të Ligjit, i akuzuari konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij. Në bazë të nenit 21(3) të Ligjit dhe rregullave 140(1) dhe 158(3) të Rregullores, trupi gjykues mund ta shpallë një të akuzuar fajtor në qoftë se fajësia vërtetohet jashtë dyshimit të arsyeshëm. Dyshimi i arsyeshëm duhet të bazohet në arsye dhe nuk mund të konsistojë në një dyshim imagjinar ose të pabazuar, por duhet të ketë lidhje racionale me provat, mungesën e provave ose mospërputhjet në prova.<sup>39</sup> Detyrimin e vërtetimit e ka vetëm ZPS-ja.<sup>40</sup>

<sup>34</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 7-10, 12, 34-35.

<sup>35</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 13, 34-35.

<sup>36</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 11, 34-35.

<sup>37</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 14-17, 34-35.

<sup>38</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, f. 84; T. 15 shtator 2022, publike, f. 4798, rreshtat 17-18.

<sup>39</sup> KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Trupi Gjykues II, [Public Redacted Version of the Trial Judgment](#) (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit; “Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*”), 18 maj 2022, publik, para. 36. *Për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-02/12-271-Corr, Appeals Chamber, [Judgment on the Prosecutor’s appeal against the decision of Trial Chamber II entitled “Judgment pursuant to article 74 of the Statute”](#) (Ngudjolo Chui Appeal Judgment), 7 April 2015, para. 109, citon ICTR, *Rutaganda v. Prosecutor*, ICTR-96-3-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 26 May 2003, para. 488.

<sup>40</sup> *Shih gjithashtu* [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 34.

28. Sikurse përcaktohet në rregullën 140 të Rregullores, standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm zbatohet për faktet që përbëjnë elementet e veprës penale dhe të formës së përgjegjësise së të akuzuarit që përmban aktakuza, si dhe për fakte të tjera ku bazohet vendimi i fajësisë. Çka është e rëndësishme, standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm nuk zbatohet veçazi për secilën provë. Përkundrazi, Trupi Gjykses bën vlerësim dhe peshim të përgjithshëm të të gjitha provave të marra në tërësi, sikurse theksohet në rregullën 139(2) të Rregullores, për të përcaktuar nëse janë vërtetuar ose jo faktet në fjalë.

29. Në lidhje me provat rrethore (që janë prova për fakte dytësore nga të cilat mund të deduktohet në mënyrë të arsyeshme një fakt juridikisht thelbësor),<sup>41</sup> standardi i vërtetimit, sipas rregullës 140(3) të Rregullores, përmbushet vetëm në qoftë se përfundimi që nxirret prej këtyre provave është i vetmi përfundim i arsyeshëm.

#### B. PROVAT E ADMINISTRUARA PREJ TRUPIT GJYKUES

30. Provat që disponon Trupi Gjykses për kuvendimet e veta përfshijnë: (i) dëshmitë gojore të 28 dëshmitarëve të cilët dëshmuar para Trupit Gjykses – 13 prej tyre të thirrur nga ZPS-ja dhe 15 të thirrur nga Mbrojtja – së bashku me pjesë të deklaratave të tyre me shkrim të cilat iu lexuan dëshmitarëve dhe u diskutuan me ta në sallën e gjyqit, të cilat janë pjesë përbërëse e dëshmive të tyre;<sup>42</sup> (ii) deklaratat me shkrim të dy dëshmitarëve që nuk dëshmuar para Trupit Gjykses, të cilat u pranuan në vend të dëshmive gojore të tyre në bazë të rregullave 153 dhe 155 të Rregullores, së

---

<sup>41</sup> [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 42.

<sup>42</sup> T., 4 tetor 2021, publik, f. 852, rreshti 14 deri në f. 854, rreshti 21. Këtu përfshihen pjesë deklaratash me shkrim të marra nga ZPS-ja ose Mbrojtja, deklarata me shkrim të marra nga UNMIK-u, ose transkripte të dëshmive të dhëna në gjykata në Kosovë.

bashku me dokumente të lidhura me to, ose prova materiale shoqëruese;<sup>43</sup> (iii) deklaratat me shkrim të të akuzuarit – i cili nuk dëshmoi dhe nuk bëri deklaratë pa betim para Trupit Gjykses – ku përfshihen: një deklaratë e z. Mustafa si dëshmitar në çështjen gjyqësore *Agron Zeqiri*, dhënë gjykatësit hetues të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 12 mars 2003;<sup>44</sup> dhe një deklaratë dhënë ZPS-së, në cilësinë e të dyshuarit, më 19 dhe 20 nëntor 2019;<sup>45</sup> (iv) prova dokumentare, që përfshijnë, ndër të tjera, fotografi (kryesisht të të akuzuarit dhe të vendit të pretenduar të krimit në Zllash), dokumente të brendshme të UÇK-së, raporte, harta, postime në rrjete sociale, dhe pjesë të nxjerra nga libra; dhe (v) dy aktekspertiza nga *Instituut voor Mensenrechten en Medisch Onderzoek* (“iMMO”; “Instituti për Të Drejtat e Njeriut dhe Vlerësim Mjekësor”), të paraqitura si prova me kërkesë të Trupit Gjykses, ku vlerësohet gjendja fizike, psikologjike dhe psikiatrike e dy dëshmitarëve-viktima në këtë çështje gjyqësore.<sup>46</sup>

<sup>43</sup> [Decision Admitting W04648's Written Statements](#) (Vendim për Pranimin e Deklaratave me Shkrim të W04648-ës) para. 16(b); [Decision Admitting W04712's Written Statements](#) (Vendim për Pranimin e Deklaratave me Shkrim të W04712-shit, para. 37(b).

<sup>44</sup> 7000650-7000660.

<sup>45</sup> 069404-TR-ET Parts (Pjesët) 1-8 (dhe versionet gjegjëse në gjuhën shqipe); 069401-069404. *Shih* KSC-BC-2020-05, F00281, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Pranimin e Provave të Mbledhura para Themelimit të Dhomave të Specializuara dhe Materialeve të Tjera* (“Vendimi mbi Materialet e Nenit 37 dhe Materiale të Tjera”), 13 dhjetor 2021, konfidencial, para. 16, 20-23, me të cilin njëra deklaratë u pranua si provë, ndërsa për tjetrën u vendos që Trupi Gjykses ta kishte në dispozicion gjatë kuvendimeve dhe për aktgjykimin. Versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, [F00281/RED](#).

<sup>46</sup> Mbrojtja nuk paraqiti kundërshtime për kualifikimet e dëshmitarëve ekspertë apo aktekspertizat e tyre; KSC-BC-2020-05, F00430, Trupi Gjykses I, *Vendim në Bazë të Rregullave 132 dhe 149 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Lidhje me Prova të Kërkuara nga Trupi Gjykses*, 3 qershor 2022, konfidencial, para. 8-9, 13(a). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00430/RED](#); F00417/01, Mbrojtësja e Viktimave, *Shtojca 1 e Parashtrimin të Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05 prej Mbrojtësës së Viktimave* (“Aktekspertiza e iMMO-së lidhur me [REDAKTUAR]), 24 maj 2022, rreptësisht konfidenciale (përmban aktekspertizën mjekësore lidhur me [REDAKTUAR]); F00417/02, Mbrojtësja e Viktimave, *Shtojca 2 e Parashtrimin të Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05 prej Mbrojtësës së Viktimave* (“Aktekspertiza e iMMO-së lidhur me [REDAKTUAR]), 24 maj 2022, rreptësisht konfidenciale (përmban aktekspertizën mjekësore lidhur me [REDAKTUAR]); *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00473/A01, Zyra Administrative, *Shtojca A e Memorandumit në Lidhje me Listën e Provave Materiale*, 12 shtator 2022, konfidenciale, që është lista e të

## C. METODOLOGJIA E PËRDORUR NGA TRUPI GJYKUES NË LIDHJE ME PROVAT

31. Në bazë të rregullës 138(1) të Rregullores, gjatë kuvendimeve, Trupi Gjykses shqyrtoi provat në dosjen e çështjes gjyqësore në përputhje me sistemin e paraqitjes dhe pranueshmërisë së provave, të vendosur nga Trupi Gjykses para fillimit të gjykimit.<sup>47</sup> Ky sistem nuk u kundërshtua nga palët dhe as nga mbrojtësja e viktimave.

32. Trupi Gjykses ka për detyrë të nxjerrë përfundime vetëm për ato fakte të cilat janë thelbësore për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së të akuzuarit në lidhje me secilën prej akuzave. Rrjedhimisht, kur bëri konstatimet faktike, Trupi Gjykses i diskutoi provat vetëm atë sa ishte e nevojshme për të përcaktuar nëse është përmbushur ose jo standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm në lidhje me elementet përbërëse të krimeve, format e përgjegjësisë penale dhe fakte të tjera relevante. Po kështu, Trupi Gjykses nuk vlerësoi shprehimisht çdo mospërputhje të mundshme brenda një prove, apo ndërmjet provave të ndryshme, por e bëri këtë *proprio motu* ose mbi bazën e kundërshtimeve të paraqitura, kur e gjykoi të nevojshme të përcaktonte nëse ishte përmbushur standardi i duhur i vërtetimit në lidhje me një element ose fakt të caktuar. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses nënvizon rëndësinë e vlerësimit të mbështetshmërisë, besueshmërisë dhe vlerës provuese të provave duke mbajtur parasysh dokumentacionin e çështjes gjyqësore në tërësi. Trupi Gjykses nuk ka trajtuar shprehimisht çdo argument të ngritur nga palët dhe pjesëmarrësit në proces, as nuk i është referuar shprehimisht asnjë dëshmie konkrete të dëshmitarëve në rastet kur në dokumentacionin e çështjes kishte prova të konsiderueshme për të kundërtën. Kur ishte e nevojshme, Trupi Gjykses ka shpjeguar më në hollësi arsyet dhe faktorët mbi të cilët u bazua për vlerësimin e provave. E gjithë kjo është në

---

gjitha materialeve të pranuar nga Trupi Gjykses, ose në dispozicion të Trupit Gjykses për kuvendimet dhe Aktgjykimin.

<sup>47</sup> KSC-BC-2020-05, F00169, Trupi Gjykses I, [Decision on the submission and the admissibility of evidence](#), (Vendim mbi Parashtrimin dhe Pranueshmërinë e Provave), 25 gusht 2021, publik.

përputhje me parimin e vlerësimit lirisht të provave nga ana e Trupit Gjykses, sikurse mishërohet në rregullën 137(2) të Rregullores.

33. Në vijim, Trupi Gjykses do të shtjellojë më në hollësi parimet kryesore mbi të cilët u bazua gjatë vlerësimit të provave, në përputhje me dispozitat e rregullave 139 dhe 140 të Rregullores.

## 1. Dëshmitë gojore

34. **Dëshmitë gojore të dëshmitarëve të drejtpërdrejtë.** Trupi Gjykses vë në dukje rregullën 139(4) të Rregullores, sipas së cilës, gjatë përcaktimit të rëndësisë që do t'i kushtohet dëshmisë së një dëshmitari, trupi gjykses vlerëson besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në dëshminë e atij dëshmitari. Besueshmëria ka të bëjë me atë nëse një dëshmitar ka dëshmuar me vërtetësi, kurse mbështetshmëria me atë nëse faktet për të cilat ka dëshmuar dëshmitari mund të konfirmohen ose vihen në dyshim nga prova të tjera ose nga rrethana të lidhura me to. Për këtë arsye, edhe kur një dëshmitar është i sinqertë dhe i besueshëm, ndonjëherë nuk është e mundshme të mbështetesh në dëshminë e atij dëshmitari.<sup>48</sup>

35. Trupi Gjykses ka kompetencë të plotë diskrecionale për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre, para se të mbështetet në ato dëshmi.<sup>49</sup> Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Trupi Gjykses ka marrë parasysh një numër faktorësh joshterues,<sup>50</sup> si: (i) hollësitë e dhëna nga dëshmitari, të

---

<sup>48</sup> ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-3121-Red, Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr Thomas Lubanga Dyilo against his conviction](#), 1 December 2014, para. 239.

<sup>49</sup> Shih ICTR, *Kanyarukiga v. Prosecutor*, ICTR-02-78-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Kanyarukiga Appeal Judgement*), 8 May 2012, para. 121, dhe referencat që përmban.

<sup>50</sup> Shih për ngjashmëri ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-1762-Red, Trial Chamber IX, [Trial Judgment](#) (*Ongwen Trial Judgment*), 4 February 2021, para. 260.

cilat tregojnë se dëshmitari i përjetoi ngjarjet personalisht;<sup>51</sup> (ii) lidhjen e brendshme logjike dhe përputhshmërinë e dëshmive të dëshmitarëve, përfshirë përputhshmërinë e dëshmive gojore me deklaratën/deklaratat e tyre me shkrim, dhe shpjegimet e dhëna prej tyre për mospërputhjet që u diskutuan me ta në sallën e gjyqit;<sup>52</sup> (iii) lidhjen e brendshme logjike dhe përputhshmërinë e dëshmive të dëshmitarëve me prova të tjera të administruara prej Trupit Gjykses;<sup>53</sup> (iv) gjasat që dëshmia e dëshmitarit të jetë e vërtetë;<sup>54</sup> (v) orvatjet ose përpjekjet e dëshmitarit për të qenë i saktë (për shembull, pranimi se e ka të vështirë t'i kujtojë disa ngjarje ose hollësi, ose bërja e dallimit midis asaj që ka përjetuar vetë dhe asaj që ka dëgjuar nga të tjerët);<sup>55</sup> (vi) ndikimin e kalimit të kohës dhe të traumës mbi kujtesën e dëshmitarit, që mund të ndikojnë në aftësinë e dëshmitarit për t'i rikujtuar ngjarjet siç ndodhën;<sup>56</sup> (vii) sjelljen e dëshmitarit gjatë

<sup>51</sup> Shih, për ngjashmëri ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 255, 395; shih gjithashtu *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-2359, Trial Chamber VI, [Judgment](#) (*Ntaganda Trial Judgment*), 8 July 2019, para. 78, i referohet saktësisë së informacionit të dhënë.

<sup>52</sup> Shih, për ngjashmëri [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Gucati dhe Haradinaj), para. 44; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 255-256; ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), Vol. I (*Prlić et al. Appeal Judgment*), 29 November 2017, para. 200; ICTR, [Kanyarukiga Appeal Judgment](#), para. 121.

<sup>53</sup> Shih për ngjashmëri [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Gucati dhe Haradinaj), para. 44; ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-2275-Red, Appeals Chamber, [Judgment on the appeals of Mr Bemba et al. against the decision of Trial Chamber VII entitled "Judgment pursuant to Article 74 of the Statute"](#) (*Bemba et al. Appeal Judgment*), 8 March 2018, para. 1084, ku theksohet se konfirmimi nga burime të tjera është një ndër shumë faktorët e mundshëm relevantë për vlerësimin prej trupit gjykses të besueshmërisë së dëshmisë së një dëshmitari dhe mbështetshmërisë në atë dëshmi; [Ngudjolo Chui Appeal Judgment](#), para. 2, 170, ku theksohet se "Trupi Gjykses duhet [...] të vlerësojë besueshmërinë e një dëshmitari pjesërisht duke vlerësuar nëse përmbajtja e dëshmisë së tij konfirmohet nga dëshmi të tjera"; ICTY, [Prlić et al. Appeal Judgment](#), para. 200; ICTR, [Kanyarukiga Appeal Judgment](#), para. 121.

<sup>54</sup> Shih për ngjashmëri [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Gucati dhe Haradinaj), para. 44; ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 78; ICTY, [Prlić et al. Appeal Judgment](#), para. 200; ICTR, [Kanyarukiga Appeal Judgment](#), para. 121.

<sup>55</sup> Shih për ngjashmëri ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-1989-Red, Trial Chamber VII, [Judgment pursuant to Article 74 of the Statute](#) (*Bemba et al. Trial Judgment*), 19 October 2016, para. 203.

<sup>56</sup> Shih për ngjashmëri ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 79; [Bemba et al. Trial Judgment](#), para. 203; *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-3436-tENG, Trial Chamber II, [Judgment pursuant to article 74 of the Statute](#) (*Katanga Trial Judgment*), 7 March 2014, para. 83; *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-2842, Trial Chamber I, [Judgment pursuant to Article 74 of the Statute](#) (*Lubanga Trial Judgment*), 14 March 2012, para. 103.



dhënies së dëshmisë në gjyq, përfshirë gatishmërinë për t'iu përgjigjur pyetjeve si dhe çdo ndryshim në qëndrim gjatë pyetjeve të palës kundërshtare;<sup>57</sup> (viii) marrëdhënien midis dëshmitarit dhe secilës palë ose mbrojtëses së viktimave, përfshirë ekzistencën e lidhjeve, anshmërisë, apo motiveve për ta implikuar ose shfajësuar të akuzuarin, lidhje me BIA-n ose UÇK-në, përfshirje të tyre në ngjarjet nën shqyrtim apo shtysë ose motiv tjetër për të gënjer, trilluar, për të shtrembëruar ose për të mos dhënë informacion;<sup>58</sup> (ix) qëndrimin e njëanshëm kundër Dhomave të Specializuara dhe/ose ZPS-së që mund të ketë pasur ndikim negativ mbi gatishmërinë e dëshmitarit ose ndjenjën e tij të detyrës për t'i dhënë Trupit Gjykses dëshmi që e ndihmon në përcaktimin e së vërtetës; dhe (x) tregues se dëshmitari mund të ketë qenë objekt i frikësimit, kërcënimit, trysnisë ose ndikimit, ose se është marrë vesh me dëshmitarë të tjerë.<sup>59</sup>

36. Trupi Gjykses thekson se ka kompetencë të gjerë diskrecionale gjatë vlerësimit të mospërputhjeve në dëshmi.<sup>60</sup> Në kryerjen e këtij vlerësimi, Trupi Gjykses ka mbajtur parasysh, ndër të tjera, llojin, shkallën dhe peshën e mospërputhjeve, shpjegimet e dëshmitarëve për këto mospërputhje, faktin që dëshmitarët i përjetojnë dhe kujtojnë ngjarjet e kaluara në mënyra të ndryshme,<sup>61</sup> ndikimin e traumës dhe të

<sup>57</sup> *Shih për ngjashmëri [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 44; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 259; ICTY, [Prlić et al. Appeal Judgement](#), para. 200; ICTR, [Kanyarukiga Appeal Judgement](#), para. 121.*

<sup>58</sup> *Shih për ngjashmëri [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 44; ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-2666-Red, Appeals Chamber, [Judgment on the appeals of Mr Bosco Ntaganda and the Prosecutor against the decision of Trial Chamber VI of 8 July 2019 entitled 'Judgment'](#) (Ntaganda Appeal Judgment), 30 March 2021, para. 17; [Ongwen Trial Judgment](#), para. 258; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 77; ICTY, [Prlić et al. Appeal Judgement](#), para. 200; ICTR, [Kanyarukiga Appeal Judgement](#), para. 121.*

<sup>59</sup> *Shih për ngjashmëri ICC, [Katanga Trial Judgment](#), para. 87.*

<sup>60</sup> *Shih gjithashtu ICC, [Ntaganda Appeal Judgment](#), para. 18.*

<sup>61</sup> *Dëshmitarët mund t'iu japin peshë të konsiderueshme hollësive që ishin të rëndësishme për ta dhe më pak peshë hollësive të rëndësisë më të vogël; shih për ngjashmëri ICC, [Bemba et al. Trial Judgment](#), para. 204; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 80.*

kalimit të kohës.<sup>62</sup> Rrjedhimisht, mospërputhjet, kundërthëniet dhe pasaktësitë nuk çojnë automatikisht në mosmbështetje në dëshminë e një dëshmitari.<sup>63</sup>

37. Në bazë të rregullës 139(6) të Rregullores, në disa raste, Trupi Gjykes ka pranuar pjesë të një dëshmie dhe nuk ka pranuar pjesë të tjera të saj, duke qenë i vetëdijshëm se është e mundshme që për disa aspekte dëshmia e një dëshmitari të jetë e saktë dhe mund të mbështetesh në të dhe për aspekte të tjera nuk mund të mbështetesh.<sup>64</sup> Kur kishte rezerva në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarëve, Trupi Gjykes u mbështet në dëshmitë e tyre për aq sa ato konfirmoheshin nga dëshmi të tjera të besueshme dhe të mbështetshme, ose kur faktorët, që përndryshe ndikonin në besueshmërinë e dëshmitarëve, nuk kishin ndikim në aspekte të veçanta të dëshmimeve të tyre. Megjithatë, në disa raste të tjera, Trupi Gjykes konstatoi se besueshmëria dhe/ose mbështetshmëria në dëshmi të dëshmitarëve u vunë aq shumë në dyshim, sa që nuk mund të mbështetej në to edhe kur dukej se prova të tjera konfirmonin pjesë të tyre.<sup>65</sup>

38. Gjatë vlerësimit të dëshmimeve të dëshmitarëve në lidhje me identifikimin e personave ose vendndodhjeve, që ishte një aspekt i rëndësishëm në këtë çështje gjyqësore, Trupi Gjykes mori parasysh faktorë si: rrethanat në të cilat dëshmitari e kishte vëzhguar vendndodhjen ose personin; kohëzgjatjen e vëzhgimit; largësinë midis vendndodhjes apo personit të identifikuar dhe dëshmitarit; pengesat e mundshme gjatë vëzhgimit; faktorë të tjerë që ndikojnë në identifikimin (moti, zhurma e motorëve të ndezur, prania e personave të tjerë, ditë ose natë); kontakte të

---

<sup>62</sup> Kujtimet për hollësitë kryesore të një ngjarjeje traumatike janë shpesh më të sakta dhe më të plota se kujtimet për hollësitë rastësore ose dytësore.

<sup>63</sup> Ngjashëm, [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#), (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 44, ku theksohet se "[n]ë pajtim me rregullën 139(6) të Rregullores, mospërputhjet e vogla midis dëshmimeve të dëshmitarëve të ndryshëm, ose midis dëshmisë së një dëshmitari të caktuar dhe deklaratave të mëparshme me shkrim të tij ose të saj, nuk u konsideruan se i zhvlerësonin këto dëshmi".

<sup>64</sup> *Shih për ngjashmëri ICC, [Ongwen Trial Judgment](#)*, para. 260.

<sup>65</sup> *Shih për ngjashmëri ICC, [Ngudjolo Chui Appeal Judgment](#)*, para. 1, 168.

dëshmitarit me personin e identifikuar; mënyrën e përshkrimit të një vendi ose personi nga dëshmitari; nëse kishte mospërputhje, identifikime të pasakta që më pas u korrigjuan, momente harrese, dhe ndikim të mundshëm nga të tjerët.<sup>66</sup>

39. Gjatë vlerësimit të dëshmimeve në lidhje me identifikimin e të akuzuarit dhe kryesve të tjerë të pretenduar, Trupi Gjykes gjithashtu mori parasysh: pozitën, rolin dhe pushtetin e të akuzuarit në atë kohë; nofkat e përdorura nga kryesit e pretenduar; anëtarësinë e tyre në BIA ose në UÇK; praninë e BIA-s ose UÇK-së në një zonë dhe kontrollin e BIA-s ose UÇK-së mbi atë zonë; uniformat, shenjat, pajimet dhe kapelat që mbanin; automjetet e përdorura; gjuhën e përdorur nga kryesit e pretenduar; sjelljen dhe mënyrën e veprimit të tyre; dhe identifikimin në bazë të karakteristikave fizike dhe/ose fotografive që iu treguan dëshmitarëve në gjyq.<sup>67</sup> Trupi Gjykes ka trajtuar me kujdes rastet kur identifikimi u bë nga një dëshmitar në kushte të vështira, si për shembull, në errësirë, gjatë kohës që po e rrihnin disa persona, gjatë kohës që ishte i sëmurë apo pa vetëdije, ose në një çast kalimtar.<sup>68</sup> Sidoqoftë, këto dëshmi Trupi Gjykes nuk i ka përjashtuar, por i ka vlerësuar duke marrë parasysh të gjithë faktorët e lartpërmendur dhe duke mbajtur parasysh prova të tjera. Së fundi, edhe pse njohja e mëparshme ose shkalla e njohjes së mëparshme të një dëshmitari me të akuzuarin është faktor relevant, fakti që një dëshmitar nuk e njihnte personalisht të akuzuarin para

---

<sup>66</sup> ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 72; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-3343, Trial Chamber III, [Judgment pursuant to Article 74 of the Statute](#) (*Bemba Trial Judgment*), 21 March 2016, para. 242 dhe referencat që përmban.

<sup>67</sup> *Për ngjashmëri*, ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 73; [Bemba Trial Judgment](#), para. 243 dhe referencat që përmban.

<sup>68</sup> ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Popović et al. Appeal Judgement*), 30 January 2015, para. 382; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-A, Dhoma e Apelit, [Judgement](#) (Aktgjykim i Apelit), 19 korrik 2010, para. 152-156; *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-A, Appeals Chamber, [Appeal Judgement](#), 23 October 2001, para. 39-40.

ngjarjeve në fjalë jo domosdoshmërisht cenon mbështetshmërinë në dëshminë identifikuese të tij.<sup>69</sup>

40. **Deklaratat me shkrim.** Trupi Gjykses thekson se i njëjti vlerësim i besueshmërisë dhe mbështetshmërisë vlen *mutatis mutandis* edhe për deklaratat me shkrim të paraqitura në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullave 153 dhe 155 të Rregullores. Megjithatë, Trupi Gjykses i ka kushtuar vëmendjen e duhur faktit që këta dëshmitarë nuk dëshmuuan drejtpërdrejt në sallën e gjyqit dhe se pala që nuk e paraqiti dëshminë – dhe, në fakt, në rastin e një dëshmitari, asnjëra palë – nuk pati mundësinë t’u bënte pyetje dëshmitarëve. Sikurse përcaktohet në rregullën 140(4) të Rregullores, Trupi Gjykses nuk e bazoi vendimin e vet vetëm, apo në masë vendimtare, në dëshmitë e këtyre dëshmitarëve.

41. **Aktekspertizat.** Sa u përket aktekspertizave, Trupi Gjykses mori parasysh faktorë si kompetencën e vërtetuar të ekspertëve në fushën e ekspertizës së tyre, metodologjinë e përdorur, masën në të cilën konstatimet e tyre përputheshin me provat e tjera në këtë çështje gjyqësore, dhe mbështetshmërinë e përgjithshme në dëshmitë e ekspertëve.<sup>70</sup>

## 2. Provat dokumentare

42. Trupi Gjykses vëren se Ligji nuk përcakton një kusht absolut që provat të paraqiten vetëm përmes dëshmitarëve. Gjatë vlerësimit të provave dokumentare që iu paraqitën, Trupi Gjykses mori parasysh treguesit e autenticitetit dhe mbështetshmërisë, kur kishte të tillë, si për shembull, prejardhja, autorësia ose burimi,

<sup>69</sup> *Shih për ngjashmëri* ICTR, *Prosecutor v. Nyiramasuhuko et al.*, ICTR-98-42-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 14 December 2015, para. 1616; *Renzaho v. Prosecutor*, ICTR-97-31-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 1 April 2011, para. 530; *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*, ICTR-95-1-A, Appeals Chamber, [Judgment \(Reasons\)](#), 1 June 2001, para. 327-328.

<sup>70</sup> *Shih për ngjashmëri* ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 54.

kronologjia e mbajtjes në ruajtje, përmendjet konkrete të emrave dhe vendeve, prania e stemave ose shenjave apo simboleve të tjera identifikuese, dhe informacione të tjera relevante.<sup>71</sup> Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh edhe lidhjen e brendshme logjike ose përputhshmërinë e provave dokumentare me prova të tjera në këtë çështje gjyqësore. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që Trupi Gjykses nuk i pranoi provat dokumentare të cilave u mungonin treguesit e mësipërm; ato u pranuan kur përmbajtja e tyre përputhej me provat që kishin lidhje me një aspekt të caktuar, në pajtim me vlerësimin tërësor të provave nga Trupi Gjykses.

### 3. Konfirmimi nga prova të tjera

43. Në përputhje me rregullën 139(3) të Rregullores, Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale të vlerësojë nëse një provë e vetme, apo disa prova të marra së bashku, mjaftojnë për vërtetimin e një fakti specifik.<sup>72</sup>

### 4. Dëshmitë e dorës së dytë

44. Trupi Gjykses rikujton se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk ndalon përdorimin e dëshmimeve të dorës së dytë.<sup>73</sup> Trupi Gjykses gjithashtu vlerëson se dëshmi të tilla jo domosdoshmërisht kanë vlerë më të vogël provuese se dëshmitë e drejtpërdrejta (domethënë dëshmitë e drejtpërdrejta për çfarë panë, përjetuan ose bënë vetë dëshmitarët). Kjo, në fund të fundit, varet nga rrethanat e secilës dëshmi të dorës së dytë.<sup>74</sup> Në përgjithësi, Trupi Gjykses është treguar i kujdesshëm në vlerësimin e dëshmimeve të dorës së dytë, për të minimizuar dëmin që mund t'i

---

<sup>71</sup> *Shih për ngjashmëri ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 57; [Bemba et al. Trial Judgment](#), para. 208.*

<sup>72</sup> *Për ngjashmëri, [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 39.*

<sup>73</sup> *Shih gjithashtu [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 24.*

<sup>74</sup> *Për ngjashmëri, ICC, [Ngudjolo Chui Appeal Judgment](#), para. 226; [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 874; ICTY, [Popović et al. Appeal Judgment](#), para. 1307.*

shkaktohej të akuzuarit nga pamundësia e ballafaqimit me burimin parësor të informacionit.<sup>75</sup>

## 5. Provat rrethanore

45. Në përputhje me rregullën 139(5) të Rregullores, Trupi Gjykses është treguar i kujdesshëm në trajtimin e provave rrethanore, si dhe ka vlerësuar me kujdes përputhshmërinë dhe lidhjen e brendshme logjike të këtyre provave përpara se të mbështetej në to.

## 6. Provat në lidhje me alibinë

46. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se alibia, në kuptimin e vet të mirëfilltë, nuk përbën mbrojtje. I akuzuari thjesht paraqet prova për të mohuar se mund të kryente krimin ose krimet e paraqitura në aktakuzë, duke qenë se fizikisht ishte në një vend tjetër dhe jo ku pretendohet sipas akuzave.<sup>76</sup> Për sa i përket vërtetimit të alibisë, i akuzuari nuk ka detyrimin e vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm, por vetëm duhet të paraqesë prova që me gjasë krijojnë dyshim të arsyeshëm në lidhje me provat e ZPS-së.<sup>77</sup> Kur provat e alibisë *prima facie* kanë të bëjnë me veprimtarinë e të akuzuarit në periudhën kur u krye krimi, ZPS-ja duhet të eliminojë çdo mundësi të arsyeshme që

---

<sup>75</sup> Për ngjashmëri, [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi Guçati dhe Haradinaj), para. 25, 43.

<sup>76</sup> ICTY, [Popović et al. Appeal Judgment](#), para. 343; *Prosecutor v. Mucić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgment](#) (Mucić et al. Appeal Judgment), 20 February 2001, para. 581; ICTR, *Nchamihigo v. Prosecutor*, ICTR-2001-63-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 18 March 2010, para. 92; *Zigiranyirazo v. Prosecutor*, ICTR-01-73-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 16 November 2009, para. 17; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2449.

<sup>77</sup> ICTY, [Popović et al. Appeal Judgment](#), para. 343; ICTR, *Setako v. Prosecutor*, ICTR-04-81-A, Appeals Chamber, [Judgment](#) (Setako Appeal Judgment), 28 September 2011, para. 224; *Prosecutor v. Munyakazi*, ICTR-97-36A-A, Appeals Chamber, [Judgment](#) (Munyakazi Appeal Judgment), 28 September 2011, para. 24.



alibia të jetë e vërtetë dhe duhet të vërtetohet jashtë dyshimit të arsyeshëm se pavarësisht nga alibia, faktet e pretenduara janë të vërteta.<sup>78</sup>

#### D. FAKTET QË NUK ËSHTË E NEVOJSHME TË VËRTETOHEN

47. **Faktet e shqyrtuara në procese të tjera.** Në bazë të rregullës 157(2) të Rregullores, Trupi Gjykes mund të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të Specializuara, ose në procese të përfunduara të gjykatave të tjera në Kosovë, apo në sisteme gjyqësore të tjera. Megjithëse nuk ka nevojë që faktet e shqyrtuara në procese të tjera të vërtetohen në gjykim, një palë gjithsesi mund të paraqesë prova që kundërshtojnë saktësinë e fakteve.<sup>79</sup>

48. Në këtë çështje gjyqësore, me kërkesë të ZPS-së, Trupi Gjykes bëri konstatim gjyqësor në lidhje me 52 fakte të shqyrtuara në procese të përfunduara të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") dhe të gjykatave në Kosovë. Faktet kanë të bëjnë kryesisht me ekzistencën e konfliktit të armatosur midis UÇK-së dhe forcave serbe.<sup>80</sup> Mbrojtja nuk paraqiti prova për të kundërshtuar saktësinë e këtyre fakteve.

#### E. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I DËSHMITARËVE TË ZPS-SË

49. Para se të paraqesë vlerësimin e vet të përgjithshëm për besueshmërinë e dëshmitarëve të ZPS-së dhe mbështetshmërinë në ta, Trupi Gjykes e gjykon të nevojshme të diskutojë atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve që mbizotëron në

<sup>78</sup> ICTY, [Popović et al. Appeal Judgement](#), para. 343; ICTR, [Setako Appeal Judgement](#), para. 224; [Munyakazi Appeal Judgement](#), para. 24; *Nahimana et al. v. Prosecutor*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Nahimana et al. Appeal Judgement*), 28 November 2007, para. 417.

<sup>79</sup> [Decision on Adjudicated Facts](#) (Vendimi mbi Faktet e Shqyrtuara), para. 11, 14.

<sup>80</sup> [Decision on Adjudicated Facts](#) (Vendimi mbi Faktet e Shqyrtuara), para. 12-15; F00144/A01, Specialist Prosecutor, [Annex 1 to Prosecution's motion for judicial notice of adjudicated facts](#) (Shtojca 1 e Mocionit të Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera) 30 qershor 2021, publike, që përmban faktet e shqyrtuara në procese të tjera (Faktet e Shqyrtuara).

Kosovë,<sup>81</sup> e cila ka ndikuar në dëshmitë e disa dëshmitarëve të ZPS-së dhe të cilën Trupi Gjykses e ka mbajtur parasysh gjatë vlerësimit të besueshmërisë dhe mbështetshmërisë në ta.

## 1. Atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë

50. Gjatë gjykimit, Trupi Gjykses dëgjoi dëshmi të besueshme nga një numër dëshmitarësh në lidhje me ekzistencën e atmosferës së frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të Dhomave të Specializuara, familjeve të tyre dhe më gjerësisht kundër personave që japin dëshmi në hetimet ose ndjekjet penale të krimeve që pretendohet të jenë kryer nga ish-anëtarë të UÇK-së. Këto hetime ose ndjekje penale kanë të bëjnë me çështje gjyqësore si kjo, në të cilat ish-anëtarë të UÇK-së ndiqen penalisht për krime që pretendohet të jenë kryer kundër shqiptarëve të Kosovës.

51. [REDAKTUAR] shpjegoi në mënyrë shumë të qartë dhe të hapur se dëshmitarët – ose ata që besohen se janë dëshmitarë – para Dhomave të Specializuara konsiderohen dhe etiketohen si tradhtarë dhe bashkëpunëtorë: “një person të cilit i ke tradhëtu vlerat e lirisë e të luftës”. [REDAKTUAR] dëshmoi se mundësia e një etiketimi të tillë krijon frikë ndër dëshmitarët, të cilën [REDAKTUAR] e ka ndjerë ose vazhdon ta ndjejë, dhe theksoi se “frika e etiketimit dhe kjo frika të shpalljes bashkëpunëtor dhe tradhtar gjithmonë do të ekzistojë dhe gjithmonë do të jetë në mesin tonë që sot jemi dëshmitarë të Gjykatës Speciale”. [REDAKTUAR] shtoi se kjo

---

<sup>81</sup> Shih gjithashtu [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 576-579; KSC-BC-2020-06, PL001/F00008, Paneli i Gjykatës Supreme, [Decision on Kadri Veseli's Request for Protection of Legality](#) (Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Mbrojtjen e Ligjshmërisë), 15 gusht 2022, publik, para. 41; IA022/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Periodic Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit), 22 gusht 2022, publik, para. 28.

bëhet edhe më e theksuar nga fakti që Kosova është një vend i vogël dhe “[n]e njihemi mes veti shumë mirë, shumë lehtë”.<sup>82</sup>

52. Në mënyrë të ngjashme [REDAKTUAR] dëshmoi se [REDAKTUAR] si “tradhtar”, çka i kishte sjellë shumë pasoja, dhe se edhe ai kishte frikë: “Po frika normal ka ekzistuar gjithë, ekziston edhe sot [...] [REDAKTUAR] ... paragjykoheja shumë. [...] [REDAKTUAR]”.<sup>83</sup>

53. Disa dëshmitarë të tjerë dhanë gjithashtu dëshmi konkrete për kërcënime ose paralajmërime që u ishin bërë vetë atyre ose anëtarëve të familjeve të tyre. [REDAKTUAR]<sup>84</sup> – tregoi se [REDAKTUAR] se ish-anëtarët e UÇK-së që pretendohet se kishin kryer krime lufte duhet të arrestoheshin dhe ndiqeshin penalisht, ata i thanë të [REDAKTUAR]. Dëshmitari e kuptoi këtë si kërcënim.<sup>85</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>86</sup> [REDAKTUAR] më tej dëshmoi – njësoj si në deklaratën e tij të mëhershme dhënë ZPS-së – se nuk ndihej i qetë që po tregonte se çfarë i kishte ndodhur në Zllash, sepse ish-anëtarët e UÇK-së kishin përkrahës “kudo” në Kosovë, [REDAKTUAR]: “ata i kanë të gjitha institucionet nën mbikëqyrje të vet”.<sup>87</sup>

54. Në mënyrë të ngjashme, [REDAKTUAR] dëshmoi se [REDAKTUAR] e kishin kërcënuar njëherë dhe i kishin thënë [REDAKTUAR]. Këtë incident dëshmitari e lidhi me përpjekjet e tij për të zbuluar se çfarë i kishte ndodhur [REDAKTUAR].<sup>88</sup> Ai gjithashtu bëri të ditur [REDAKTUAR] se jeton gjithmonë me frikën se “mos po na ndodhë diçka [mu ose familjes]”.<sup>89</sup> Në gjyq, ai deklaroi: “kam stres shumë, s’jam i lirë as në punë me shku, në rrugë, kërkund s’jam i lirë”, “një kerr me e pa mbrapa që vjen

<sup>82</sup> **W04676**: T. 18 nëntor 2021, konfidencial, p. 1712, rreshti 1 deri në f. 1714, rreshti 9.

<sup>83</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 942, rreshtat 11-21.

<sup>84</sup> [REDAKTUAR].

<sup>85</sup> [REDAKTUAR].

<sup>86</sup> [REDAKTUAR].

<sup>87</sup> [REDAKTUAR].

<sup>88</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1783, rreshti 23 deri në f. 1787, rreshti 25.

<sup>89</sup> **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1844, rreshti 22 deri në f. 1845, rreshti 1.

[...] se mos po më ndodhë diçka”.<sup>90</sup> Ai shtoi shprehimisht se ka frikë nga i akuzuari dhe anëtarë të tjerë të mëparshëm të UÇK-së.<sup>91</sup>

55. [REDAKTUAR] dëshmoi në mënyrë të ngjashme se kishte frikë dhe se e kishte të pamundur të fliste në mënyrë të sigurt dhe të hapur [REDAKTUAR]: “gjithmonë tutna që del dikush i atij, a po më njëf apo diçka. Nuk diskutojmë fort gjëra mes veti.”<sup>92</sup>

56. Në një incident edhe më domethënës, [REDAKTUAR] dëshmoi se [REDAKTUAR] i kishte thënë të mos dëshmonte në Dhomat e Specializuara, se përndryshe do të vritej.<sup>93</sup> Dëshmia [REDAKTUAR] përforcohet nga deklarata [REDAKTUAR] dhënë ZPS-së, e cila u paraqit si provë në vend të dëshmisë gojore. [REDAKTUAR] u shpreh qartë: “[...] nëse ata mësojnë se unë jam këtu sot duke dhënë këtë deklaratë [ZPS-së], do të jem i vdekur para mbrëmjes”.<sup>94</sup>

57. Dëshmitë e shtjelluara më lart tregojnë se ekziston një atmosferë e përgjithshme e frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të Dhomave të Specializuara, familjeve të tyre dhe më gjerësisht kundër atyre që japin dëshmi në hetimet ose ndjekjet penale të krimeve që pretendohet se u kryen nga anëtarë të atëhershëm të UÇK-së. Dëshmitarët stigmatizohen si “tradhtarë” ose “bashkëpunëtorë”, nuk mund të flasin lirshëm për ngjarjet që kanë përjetuar, janë objekt i kërcënimeve dhe frikësimeve dhe jetojnë me frikën e vazhdueshme se atyre vetë ose familjeve të tyre, do t’u ndodhë diçka. Kjo atmosferë ka pasur ndikim të dukshëm, ndonëse në masë të ndryshme, tek dëshmitë e disa dëshmitarëve që u paraqitën para Trupit Gjykses. Trupi Gjykses e ka vlerësuar këtë ndikim, nëse ka qenë relevant, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të dëshmitarëve më poshtë.

<sup>90</sup> **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1784, rreshti 8 deri në f. 1785, rreshti 23.

<sup>91</sup> **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1845, rreshtat 2-16.

<sup>92</sup> **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1893, rreshtat 21-22.

<sup>93</sup> **W03593**: T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 531, rreshti 23 deri në f. 532, rreshti 23; T. 22 shtator 2022, konfidencial, f. 619, rreshti 14 deri në f. 621, rreshti 19; f. 657, rreshti 23 deri në f. 658, rreshti 13.

<sup>94</sup> **W04712**: 077816-TR-ET Part (Pjesa) 1 RED1, f. 20, rreshtat 4-7.

## 2. W01679

58. W01679 dëshmoi para Trupit Gjykses më 4 dhe 5 tetor 2021 dhe më 1 qershor 2022,<sup>95</sup> me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.<sup>96</sup>

59. Ai dëshmoi për arrestimin e tij nga ushtarë të UÇK-së, mbajtjen në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe keqtrajtimin që pësoi së bashku me të ndaluarit e tjerë atje.

60. Trupi Gjykses konstaton se W01679 është i besueshëm në lidhje me të gjitha aspektet e dëshmisë së tij. Përgjigjet e W01679-ës ishin tejet të hapura për të gjitha temat për të cilat iu bënë pyetje, çka Trupi Gjykses e konsideroi mbresëlënëse duke pasur parasysh atmosferën e frikës dhe frikësimit të dëshmitarëve të përshkruar më lart. Ai iu përgjigj në mënyrë të qartë, të përmbledhur, koherente dhe përputhëse pyetjeve që iu bënë.

61. Trajtimin që pësuan ai dhe të ndaluarit e tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash, W01679 e përshkroi në mënyrë të gjallë, të hollësishme<sup>97</sup> dhe plot emocion, që tregon se i kishte përjetuar personalisht ngjarjet. Për shembull, ai përshkroi me hollësi se si iu vu rrymë elektrike në trup dhe u dogj.<sup>98</sup> Ai tregoi se i dëgjoi të ndaluarit e tjerë “t’u bërtit, t’u bo si qen, si macja...prej torturës, prej dhimbjeve” dhe tha që edhe ai vetë mund të ketë nxjerrë zëra të tillë gjatë keqtrajtimit.<sup>99</sup> Ai gjithashtu dëshmoi se

---

<sup>95</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 860-930; T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 938-1014; T. 1 qershor 2022, konfidencial, f. 4442-4491.

<sup>96</sup> KSC-BC-2020-05, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse* (“Vendimi i Parë mbi Masat Mbrojtëse”), 20 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 39(c). Versioni i redaktuar konfidencial u lëshua po atë ditë.

<sup>97</sup> *Shih, për shembull*, **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 915, rreshti 14 deri në f. 916, rreshti 5; f. 925, rreshtat 2-6. Gjithashtu, në disa raste dëshmitari dha hollësi të panevojshme, që, për mendimin e Trupit Gjykses, tregon se dëshmia e tij bazohej në atë që kishte përjetuar ai vetë. Për shembull, ai mbante mend se kur u lirua ia kthyen lidhëset e këpucëve dhe rripin (**W01679**: T. 4 tetor 2022, publik, f. 904, rreshti 24 deri në f. 905, rreshti 3).

<sup>98</sup> **W01678**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 883, rreshti 17 deri në f. 884, rreshti 17; T. 5 tetor 2021, publik, f. 985, rreshtat 13-23; f. 986, rreshti 17 deri në f. 987, rreshti 15.

<sup>99</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 890, rreshti 15 deri në f. 891, rreshti 1.

viktima e vrasjes së paligjshme dukej “i deformuar” nga rrahjet, dhe se mishit të trupit të tij i vinte erë nga lëndimet.<sup>100</sup> Ai përshkroi bindshëm se si ndihej gjatë mbajtjes së tij në ndalim: “ke prit veç vdekjen, por kur po të vjen...sot, nesër, kur po të mytin”.<sup>101</sup> Ai dëshmoi se edhe sot e kësaj dite i dëgjon zërat e viktimave dhe të atyre që e keqtrajtuuan dhe se i dalin para syve fytyrat e tyre.<sup>102</sup> Dëshmi tejet bindëse për këtë [REDAKTUAR].<sup>103</sup> W01679 deklaroi: “ai njeri nuk e harroj kurrë, deri në frymën e fundit”, “është në blicin tem”.<sup>104</sup> Dëshmia emocionale e tij për vuajtjen që iu shkaktua [REDAKTUAR], e përforcon vërtetësinë e dëshmisë së tij: “mi hap plagët apert” dhe “sikur në ‘99”, u shpreh W01679.<sup>105</sup> Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses nuk ka dyshim se dëshmia e W01679-ës bazohet në ngjarje që ai vetë i përjetoi dhe të cilat i kanë mbetur të pashlyera në mendje.

62. Krahas kësaj, W01679 bëri përpjekje të dukshme që të jepte dëshmi të saktë, duke bërë të qartë kur nuk i kujtohej ndonjë hollësi e veçantë,<sup>106</sup> duke bërë dallimin midis çfarë kishte parë vetë dhe çfarë kishte dëgjuar nga të tjerët,<sup>107</sup> dhe duke këmbëngulur për korrigjimin e disa aspekteve të deklaratës së tij të mëparshme.<sup>108</sup> Në lidhje me këtë,

<sup>100</sup> W01679: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 906, rreshtat 5-9; f. 907, rreshtat 5-8.

<sup>101</sup> W01679: T. 4 tetor 2021, publik, f. 883, rreshtat 6-12; f. 903, rreshtat 20-24.

<sup>102</sup> W01679: T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 939, rreshti 24 deri në f. 940, rreshti 21; T. 1 qershor 2022, konfidencial, f. 4466, rreshtat 2-20, f. 4472 rreshti 21 deri në f. 4473, rreshti 9.

<sup>103</sup> Shih para. 404; T. 1 qershor 2022, konfidencial, f. 4445, rreshtat 3-5.

<sup>104</sup> W01679: T. 1 qershor 2022, konfidencial, f. 4451, rreshtat 3-21; f. 4466, rreshtat 11-20.

<sup>105</sup> W01679: T. 1 qershor 2022, konfidencial, f. 4446, rreshtat 5-15, f. 4447, rreshtat 14-16.

<sup>106</sup> Shih, për shembull, W01679: T. 4 tetor 2021, publik, f. 885, rreshtat 7-11; f. 908, rreshtat 5-9; T. 5 tetor 2021, publik, f. 982, rreshti 10 deri në f. 983, rreshti 2; T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 991, rreshti 21 deri në f. 992, rreshti 4. Përveç kësaj, dëshmia e tij është plot me fraza që vënë në dukje përpjekjet e tij për të dhënë dëshmi të saktë dhe të vërtetë: “Sa më kujtohet mu”, “sa mbaj mend”, “sa më kujtohet”, “nëse nuk gaboj”; shih, për shembull, W01679: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 877, rreshtat 13-21; f. 887, rreshtat 5-11; f. 904, rreshtat 9-12; T. 4 tetor 2021, publik, f. 882, rreshtat 20-23; f. 885, rreshtat 3-11; f. 902, rreshtat 16-22.

<sup>107</sup> Shih, për shembull, W01679: T. 4 tetor, konfidencial, f. 894, rreshtat 4-9; f. 895, rreshtat 2-5, 22-25.

<sup>108</sup> W01679: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 873, rreshti 19 deri në f. 876, rreshti 20 (në veçanti, f. 876, rreshtat 18-20).



Trupi Gjykses është bindur se ai dha shpjegime të besueshme dhe bindëse për mospërputhjet e dukshme me deklaratën e tij të mëparshme.<sup>109</sup>

63. W01679 ishte gjithashtu i matur dhe i përmbajtur në dëshminë e tij, çka e bën atë edhe më të besueshëm. Për shembull, ai dëshmoi se “komandant Cali” e rrahu vetëm në një rast dhe se, ndonëse ishte i pranishëm në raste të mëpasshme, ai nuk mori pjesë në rrahjet e tjera.<sup>110</sup>

64. Së fundi, Trupi Gjykses thekson se dëshmia e W01679-ës konfirmohet fuqimisht nga prova të tjera të besueshme dhe të mbështetshme, të administruara prej Trupit Gjykses, si prova dokumentare, po ashtu edhe dëshmi gojore, sikurse shtjellohet me hollësi në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

65. Duke mbajtur parasysh të gjitha sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se W01679 është i besueshëm dhe rrjedhimisht u mbështet në dëshminë e tij.

### 3. W03593

66. W03593 dëshmoi para Trupit Gjykses nga 20 deri më 23 shtator 2021,<sup>111</sup> me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.<sup>112</sup>

67. Ai dëshmoi për arrestimin e tij nga ushtarë të UÇK-së, mbajtjen në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe keqtrajtimin që pësoi së bashku me të ndaluarit e tjerë gjatë ndalimit atje.

---

<sup>109</sup> W01679: T. 4 tetor 2021, publik, f. 875, rreshtat 10-16; f. 897, rreshti 8 deri në f. 899, rreshti 6; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 882, rreshtat 3-12.

<sup>110</sup> W01679: T. 5 tetor 2021, publik, f. 1004, rreshti 19 deri në f. 1005, rreshti 6; f. 1013, rreshtat 5-15; *shih gjithashtu* T. 5 tetor 2021, publik, f. 987, rreshtat 16-20.

<sup>111</sup> W03593: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 392-489; T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 509-565; T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 569-669; T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 676-702.

<sup>112</sup> Vendimi i Parë mbi Masat Mbrojtëse, para. 39(c).

68. Trupi Gjykues konstaton se W03593 është i besueshëm në lidhje me të gjitha aspektet e dëshmisë së tij. Dëshmia e tij ishte përputhëse, e pasur në detaje, e gjallë dhe e rrëfyer me emocion, që tregon se bazohej në përjetimet personale të tij. Për shembull, W03593 e kujtoi disa herë se si kur u arrestua, ushtarë të UÇK-së i ofruan çokollatë dhe se filluan ta rrihnin kur deshi ta hante.<sup>113</sup> Kjo është një hollësi dytësore të cilën dëshmitari e përshkroi në mënyrë përputhëse gjatë të gjithë dëshmisë së tij, gjë që, për mendimin e Trupit Gjykues, tregon se po dëshmonte për ngjarje që i kishte përjetuar vetë. Përshkrimet e tij të gjalla të kushteve të ndalimit – si shtrihej në ujë në ahur pas rrahjeve, ose si ai dhe W03594 mbulohehin me të njëjtën batanije kur flinin<sup>114</sup> – vërtetojnë edhe më tej natyrën personale të dëshmisë së tij. E njëjta gjë, për mendimin e Trupit Gjykues, vlen edhe për dëshminë prekëse të tij në lidhje me pasojat afatgjata të keqtrajtimit që pësoi: “ma ka ndryshu gjendjen e familjes”, “ma kanë ndryshu jetën”, theksoi dëshmitari, duke shpjeguar se e la [REDAKTUAR].<sup>115</sup>

69. Gjithashtu, W03593 ishte përgjithësisht i hapur në dhënien e dëshmisë së tij, aspekte kritike të së cilës ishin përputhëse. Duhet theksuar se si palët, ashtu edhe Trupi Gjykues, e pyetën gjerësisht dëshmitarin se si e identifikoi të akuzuarin si njërin nga personat të cilët e morën në pyetje dhe e rrahën. W03593 nuk u përpoq ta inkriminonte të akuzuarin me çdo kusht dhe pranoi menjëherë që nuk e kishte parë

---

<sup>113</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 395, rreshtat 7-21; f. 399, rreshtat 19-24; f. 400, rreshtat 20 deri në f. 401, rreshti 1; *shih gjithashtu* T. 20 shtator 2021, publik, f. 401, rreshti 24 deri në f. 402, rreshti 8 (ku rikujton se ra në gjunjë kur e shtynë në ahurin ku mbahej i ndaluar).

<sup>114</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 411, rreshtat 10-16; T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 453, rreshtat 5-9; *shih gjithashtu* T. 20 shtator 2021, publik, f. 454, rreshtat 7-13 (ku i kujtohet qartë se viktima e vrasjes së paligjshme kishte lëndim djegieje në pjesën e barkut).

<sup>115</sup> **W03593**: T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 542, rreshtat 15-25. Dëshmia e dëshmitarit është plot me shembuj të tjerë prekës dhe të gjallë që theksojnë natyrën personale të dëshmisë së tij; *shih, për shembull*: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 416, rreshtat 8-11 (ku dëshmitari shprehet fuqishëm se pas rrahjeve u ndje “i vdekur”); T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 523, rreshtat 10-19 (ku tregon lëndimet e ndryshme që iu shkaktuan dhe deklaroi se “krejt trupin e kam llom”); T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 540, rreshtat 16-21 (ku tregon vendet në trup ku ishte goditur dhe kishte shenja).

mirë, se nuk e njihje, dhe as sot nuk mund ta njihje.<sup>116</sup> Ai shpjegoi – në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes<sup>117</sup> – se kishte krijuar mendimin që ai person ishte i akuzuari në bazë të kapelës, rolit dhe pushtetit mbi kryesit e tjerë, dhe të nofkës së tij.<sup>118</sup> Kur u pyet në mënyrë të përsëritur në lidhje me këtë, si nga ZPS-ja ashtu edhe nga Mbrojtja, dëshmitari ishte përputhës në përgjigjet e veta dhe nuk u lëkund.

70. Krahas kësaj, ai menjëherë bënte të qartë se çka dinte vetë për ngjarjet dhe pranonte pa mëdyshje kur nuk i dinte ose nuk i kujtoheshin disa aspekte të ngjarjeve.<sup>119</sup> Ai bënte dallim të qartë midis çfarë kishte parë dhe dëgjuar vetë<sup>120</sup> dhe çfarë kishte mësuar nga të tjerët. Në veçanti, ai shpjegoi se kishte marrë vesh nga persona të tjerë që komandant në Zllash ishte i akuzuari.<sup>121</sup>

71. Çka është e rëndësishme, shumë aspekte të dëshmisë së W03593-shit konfirmohen nga prova të tjera të besueshme dhe të mbështetshme të administruara prej Trupit Gjykses, si prova dokumentare ashtu edhe dëshmi gojore, sikurse përshkruhet me hollësi në analizën e provave prej Trupit Gjykses. Duke mbajtur parasysh se dëshmia e tij konfirmohet në hollësi nga prova të tjera, si dhe përshkrimin e gjallë të hollësive të dhëna, Trupi Gjykses gjykon se është tejet e pagjasë që W03593

---

<sup>116</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 412, rreshti 20 deri në f. 414, rreshti 14; f. 420, rreshtat 13-21; T. 22 shtator 2021, publik, f. 583, rreshti 19 deri në f. 585, rreshti 3; T. 23 shtator 2021, publik, f. 695, rreshtat 21-25.

<sup>117</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4712, rreshtat 6-23.

<sup>118</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 412, rreshti 20 deri në f. 414, rreshti 14; f. 420, rreshtat 13-21; f. 429, rreshtat 6-12; T. 22 shtator 2021, publik, f. 583, rreshti 19 deri në f. 586, rreshti 21; T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 651, rreshtat 15 deri në f. 657, rreshti 9.

<sup>119</sup> *Shih, për shembull*, **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 399, rreshtat 10-18; f. 405, rreshtat 6-12; f. 409, rreshtat 8-17; T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 431, rreshtat 11-16; T. 21 shtator 2021, publik, f. 511, rreshti 6 deri në f. 512, rreshti 4; f. 552, rreshti 25 deri në f. 553, rreshti 11; T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 517, rreshtat 3-13; T. 23 shtator 2021, publik, f. 697, rreshti 12 deri në f. 698, rreshti 3.

<sup>120</sup> *Shih, për shembull*, **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 413, rreshti 12 deri në f. 414, rreshti 14; f. 429, rreshtat 6-12 (ku shpjegon se e kishte dëgjuar të akuzuarin duke dhënë urdhër dhe se e kishte parë me kapelë të kuqe në kokë).

<sup>121</sup> **W03593**: T. 22 shtator 2021, publik, f. 584, rreshti 12-20; f. 586, rreshtat 10-21; T. 23 shtator 2021, publik, f. 695, rreshtat 21-25.

ta ketë trilluar dëshminë e tij, ose të jetë marrë vesh me dëshmitarë të tjerë për ta përshtatur dëshminë e tij me të tyren.

72. Megjithëse ka disa mospërputhje midis dëshmisë së dëshmitarit në sallën e gjyqit dhe deklaratës së tij dhënë [REDAKTUAR], të cilat u evidentuan gjatë dëshmisë së tij, Trupi Gjykses nuk gjykon se këto mospërputhje ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarit. Trupi Gjykses i ka trajtuar këto mospërputhje më me hollësi në analizën e provave.<sup>122</sup>

73. Së fundi, Trupi Gjykses vëren se ndonjëherë dëshmitari ngurroi t'i jepte emrat e personave që i kishin dhënë informacion në lidhje me ngjarjet nën shqyrtim.<sup>123</sup> Trupi Gjykses nuk mendon se kjo ndikon në besueshmërinë e W03593-shit. Duke mbajtur parasysh atmosferën e frikës dhe frikësimit të dëshmitarëve që mbizotëron në Kosovë, është e kuptueshme që W03593 nuk donte t'i përmendte emrat e individëve të tjerë për shkak të shqetësimit për sigurinë e tyre. Trupi Gjykses e konsideron domethënës faktin që edhe W01679 – i cili ishte tejet i hapur në dhënien e dëshmisë së tij – në një moment ngurroi të jepte emrin e një individi në praninë e të akuzuarit, dhe tha: “Po mbiemri ndoshta nuk është interesant me thonë. [...] klienti yt, ose diçka edhe mundet me u bo ndonji send. [REDAKTUAR]. Por në qoftë se është nevoja muj me ja thonë Gjykatës ... me emër e mbiemër”.<sup>124</sup> Paneli gjykon se ngurrimi i W03593-shit bazohet në frikë dhe jo në synim për të mos i dhënë informacion Trupit Gjykses.

74. Duke mbajtur parasysh të gjitha sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se W03593 është i besueshëm dhe rrjedhimisht u mbështet në dëshminë e tij.

---

<sup>122</sup> *Shih* para. 553.

<sup>123</sup> **W03593**: T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 586, rreshti 19 deri në f. 589, rreshti 18 (*shih, në veçanti*, f. 587, rreshtat 2-4: “[s]’muna me dhanë emna të huaj këtu. Unë vetë për veti me dhonë dëshmi, jo për kërkënd.”; f. 589, rreshtat 12-14: “as nuk du me ta përmend. S’kam nevojë me m’mor hallk n’ kët mënyrë, këtu me përmend, me i mor vesh personal për vete”).

<sup>124</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 994, rreshtat 11-24.

#### 4. W03594

75. W03594 dëshmoi para Trupit Gjykses nga 12 deri më 14 tetor 2021,<sup>125</sup> me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.<sup>126</sup>

76. Ai dëshmoi për arrestimin e tij nga ushtarë të UÇK-së dhe për periudhën që u mbajt në kompleksin e ndalimit në Zllash.

77. W03594 dha dëshmi përgjithësisht të besueshme për arrestimin e tij nga UÇK-ja, mbajtjen në kompleksin e ndalimit në Zllash, praninë e të ndaluarve të tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash, dhe rrethanat e lirit të tij, që konfirmohet fuqimisht nga dëshmitë e disa dëshmitarëve të tjerë, si dhe nga prova dokumentare. Dëshmia e tij ishte e hollësishme, e gjallë dhe me emocion, që tregon se ai dha dëshmi për ngjarje që i kishte përjetuar vetë. Për shembull, ai kujtoi se si, ditën që u çua në Zllash, [REDAKTUAR].<sup>127</sup> Një shembull tjetër domethënës është përshkrimi me emocion i kujtimeve se si ndihej gjatë kohës që u mbajt i ndaluar – baras me një kafshë, i poshtëruar, e jo më një qenie njerëzore: “ai ka qenë vdekja e dytë e imja”, dëshmoi ai.<sup>128</sup> Në lidhje me temat e lartpërmendura, W03594 ishte i hapur dhe i qartë, dhe pranoi kur nuk i dinte ose nuk i kujtoheshin aspekte të caktuara të ngjarjeve, çka e bën edhe më të besueshëm.<sup>129</sup>

<sup>125</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1032-1092; T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1131-1224; T. 14 tetor 2021, konfidencial, f. 1232-1275.

<sup>126</sup> KSC-BC-2020-05, F00053, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse* (“Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse”), 24 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 51(f). Versioni i redaktuar konfidencial u lëshua po atë ditë.

<sup>127</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1036, rreshti 20 deri në f. 1037, rreshti 14. Një shembull tjetër është përshkrimi i gjallë i tij kur dëshmoi se si në ahurin ku mbahej ndjente erën e jashtëqitjeve të bagëtive; *shih* **W03594**: T. 13 tetor 2021, publik, f. 1176, rreshtat 1-19.

<sup>128</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1040, rreshti 22 deri në f. 1041, rreshti 4; T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1066, rreshti 1 deri në f. 1067, rreshti 7.

<sup>129</sup> *Shih, për shembull*, **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1038, rreshti 17 deri në f. 1039, rreshti 11; f. 1040, rreshtat 16-21; T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1153, rreshti 12 deri në f. 1154, rreshti 3; f. 1200, rreshtat 6-14.

78. Megjithatë, dëshmia e tij për mënyrën se si u trajtuan ai dhe të ndaluarit e tjerë gjatë kohës që u mbajtën në ndalim, mori një ton krejt të ndryshëm. Kur dëshmoi për përjetimet e veta, ai deklaroi se u godit vetëm në një rast, se goditja ishte e lehtë dhe nuk ndjeu dhimbje.<sup>130</sup> Gjithashtu, edhe pse pranoi që një herë u mor dhe u çua në dhomën e marrjes në pyetje, e cila ishte mbi ahurin ku mbahej,<sup>131</sup> ai deklaroi se bëri një bisedë miqësore me ushtarët e UÇK-së që ishin aty.<sup>132</sup> Kur u pyet për gjendjen e të ndaluarve e tjerë, ai dëshmoi se ishin në gjendje fizike shumë të mirë, se, edhe pse e kishin shpinën “pak të skuqur”, asnjëri prej tyre nuk kishte shenja (të tjera) rrahjesh, dhe se askush nuk u mor nga ahuri për t’u keqtrajtuar.<sup>133</sup> Në mënyrë të përsëritur, gjatë gjithë dëshmisë së vet, W03594 falënderoi ushtarët e UÇK-së në kompleksin e ndalimit në Zllash që e kishin trajtuar mirë (“edhe sot i falënderohem...se janë sjellë në mënyrën ma korrekte, ma njerëzore”) dhe deklaroi se nuk i fajësonte dhe se i konsideronte si vëllezër.<sup>134</sup>

79. Për arsyet e shtjelluara më poshtë, Trupi Gjykues nuk e vlerëson të besueshme dëshminë e W03594-ës për trajtimin e tij dhe të ndaluarve të tjerë gjatë kohës që u mbajtën në ndalim. Së pari, dëshmia e W03594-ës përgënjeshtrohet qartësisht nga dëshmitë plotësisht të besueshme dhe të mbështetshme të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës, të cilët dëshmuuan për rrahjet që ata vetë, së bashku me të ndaluarit e tjerë – ndër të cilët edhe W03594 – përjetuan çdo ditë në kompleksin e ndalimit në Zllash.

---

<sup>130</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1067, rreshti 8 deri në f. 1070, rreshti 19; T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1190, rreshti 14 deri në f. 1191, rreshti 3.

<sup>131</sup> *Shih* para. 528 në lidhje me dhomën e marrjes në pyetje.

<sup>132</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1072, rreshti 25 deri në f. 1075, rreshti 25; f. 1080, rreshti 3 deri në f. 1081, rreshti 10; f. 1084, rreshti 10 deri në f. 1089, rreshti 13.

<sup>133</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1049, rreshti 19 deri në f. 1050, rreshti 9; f. 1058, rreshti 19 deri në f. 1065, rreshti 25; f. 1076, rreshti 5 deri në f. 1079, rreshti 25; T. 12 tetor 2021, publik, f. 1053, rreshti 18 deri në f. 1054, rreshti 24; T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1189, rreshtat 2-23.

<sup>134</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1049, rreshtat 19-25; f. 1089, rreshtat 4-13; T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1066, rreshti 1 deri në f. 1067, rreshti 7; f. 1081, rreshtat 4-6; f. 1085, rreshtat 3-6.



80. Së dyti, dëshmia e tij ka mospërputhje të brendshme dhe është e pagjasë, edhe nëse merren parasysh faktet e pranuar nga vetë W03594. Shembujt janë të shumtë por, sa për ilustrim, W03594 pranoi në sallën e gjyqit se gjatë kohës që u mbajt i ndaluar, ai kishte frikë për jetën e vet sepse nuk e dinte se çfarë mund t'i ndodhte: “edhe mendonim a na nxa mëngjesi a jo”.<sup>135</sup> Po kështu, ai konfirmoi se një nga të ndaluarit e tjerë, W03593, kishte aq shumë frikë nga anëtarët e BIA-s sa që kur ndonjëri prej tyre hapte derën e ahurit ku mbaheshin, “më afrohe[j] kaq shumë sa që gati më hynte në gjoks, në kraharor”, duke kërkuar mbrojtje tek ai.<sup>136</sup> Për mendimin e Trupit Gjykues, është krejtësisht e pagjasë që të ndaluarit të kishin kaq shumë frikë kur - sikurse pretendoi W03594 - trajtoheshin mirë.<sup>137</sup>

81. Së treti, kur u ballafaqua me deklaratën që i kishte dhënë ZPS-së, e cila shpesh binte ndesh me dëshminë e tij në gjyq në aspekte kyçe, W03594 nuk dha ndonjë shpjegim bindës dhe thjesht mohoi atë që kishte deklaruar më parë. Për shembull, në deklaratën e mëparshme W03594 kishte shpjeguar se ishte goditur me “shkopin...e trashë prej gome”, se edhe të ndaluarit e tjerë ishin goditur në praninë e tij dhe se kishte parë “vrime” në trupat e tyre. Për një nga të ndaluarit që ishte bashkë me të, [REDAKTUAR], ai deklaroi se e kishin rrahur aq keq në të gjithë trupin sa nuk mund të qëndronte më në këmbë. Kur u ballafaqua me këtë deklaratë në gjyq, W03594 e ndryshoi dëshminë dhe pohoi se nuk u godit me “shkopin...e trashë prej gome”, por

---

<sup>135</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1066, rreshtat 9-12; T. 13 tetor 2021, publik, f. 1136, rreshtat 14-16.

<sup>136</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1079, rreshtat 1-13.

<sup>137</sup> Ndër shembujt të tjerë nga dëshmia e W03594-ës që e bëjnë atë të pagjasë, përfshihen: dëshmia e tij se në ahur hynte dritë natyrore e mjaftueshme, edhe pse dritarja ishte e mbuluar me dërrasa; dhe përgjigjja e tij kur u pyet nëse në ahur hynte ujë: “Jo, fare s’ka hi. Dhe vetëm kur ka ra shi, por edhe kur ka ra shi, nuk ka hi”; **W03594**: T. 13 tetor 2021, publik, f. 1178, rreshtat 10-22; f. 1185, rreshti 24 deri në f. 1186, rreshti 2.

me “shufër të hollë druri”,<sup>138</sup> se të ndaluarit e tjerë nuk i goditën por “i kanë shty”,<sup>139</sup> dhe se ata nuk kishin “vrime” nëpër trup, por “vija të gjata” në shpinë.<sup>140</sup> [REDAKTUAR], W03594 fillimisht thjesht e mohoi deklaratën që i kishte dhënë më parë ZPS-së dhe e konfirmoi vetëm pasi ZPS-ja i bëri pyetje të mëtejshme në lidhje me këtë pikë.<sup>141</sup>

82. Së katërti, është e qartë nga dëshmia e tij, si edhe nga dëshmi të tjera para Trupit Gjykyes, se W03594 kishte frikë të implikonte të akuzuarin ose ish-anëtarë të tjerë të UÇK-së. W03594 deklaroi në gjyq se kishte frikë nga personi që kishte urdhëruar ndalimin e tij sepse “[a]i nuk ma don të mirën edhe sot”.<sup>142</sup> Në deklaratën që i kishte dhënë më parë ZPS-së, W03594 kishte thënë gjithashtu se “më kanë dërgu [fjalë] që të kem kujdes që të mos përmend asnjë emër”, edhe pse kur iu tregua deklarata e mëparshme në sallën e gjyqit, e mohoi që kishte thënë ashtu.<sup>143</sup> Fakti që W03594 kishte frikë u konfirmua [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR].<sup>144</sup> Fakti që W03594 kishte frikë del qartë edhe nga deklaratat që bëri në sallën e gjyqit, kur mohoi dëshminë inkriminuese që i kishte dhënë më parë ZPS-së. Janë domethënëse deklaratat në vijim: ““Edhe një herë e deklaroj publikisht”;<sup>145</sup> “Edhe një herë e deklaroj publikisht, të gjithë

<sup>138</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1067, rreshti 8 deri në f. 1070, rreshti 19, *i referohet* 061016-TR-ET Part (Pjesa) 4 RED1, f. 2, rreshtat 7-25 (theksimi i shtuar).

<sup>139</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1070, rreshti 20 deri në f. 1072, rreshti 19, *i referohet* 061016-TR-ET Part (Pjesa) 4 RED1, f. 6, rreshti 23 deri në f. 7, rreshti 8.

<sup>140</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1062, rreshti 13 deri në f. 1065, rreshti 25, *i referohet* 061016-TR-ET Part (Pjesa) 1 RED1, f. 26, rreshtat 13-14, dhe 061016-TR-ET Part (Pjesa) 3 RED1, f. 7, rreshtat 22-23; T. 14 tetor 2021, publik, f. 1266, rreshti 24 deri në f. 1270, rreshti 1, *i referohet* 061016-TR-ET Part (Pjesa) 1 RED1, f. 26, rreshtat 13-14.

<sup>141</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1051, rreshti 12 deri në f. 1054, rreshti 5, *i referohet* 061016-TR-ET Part (Pjesa) 3 RED1, f. 10, rreshtat 1-23; **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1058, rreshtat 8-18.

<sup>142</sup> **W03594**: T. 14 tetor 2021, publik, f. 1273, rreshtat 8-13.

<sup>143</sup> **W03594**: T. 14 tetor 2021, publik, f. 1273, rreshti 20 deri në f. 1274, rreshti 8, *i referohet* 061016-TR-ET Part (Pjesa) 6 RED1, f. 4, rreshtat 20-21.

<sup>144</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 913, rreshti 18 deri në f. 914, rreshti 14.

<sup>145</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1053, rreshti 18 (theksimi i shtuar). Megjithëse dëshmitari i bëri këto deklarata në seancë private, ajo që ka rëndësi për mendimin e Trupit Gjykyes është fakti se ai u përpoq ta minimizonte keqtrajtimin në praninë e të akuzuarit.

personat që kanë qenë me mua në dhomë, asnjë nuk ka pasur lëndime në fytyrë, nuk ka pas lëndime në kokë, nuk ka pas lëndime në këmbë, nuk ka pas lëndime në gjunjë, përpos që shpinën e kam parë pak të skuqur".<sup>146</sup> Jo më pak e rëndësishme, Trupi Gjykses vëren se i akuzuari e di kush është W03594 [REDAKTUAR].<sup>147</sup>

83. Duke mbajtur parasysh të gjitha sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se W03594 ishte i besueshëm në lidhje me arrestimin e tij nga UÇK-ja, mbajtjen e tij në kompleksin e ndalimit në Zllash, praninë e të ndaluarve të tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe rrethanat e lirimit të tij. Megjithatë, Trupi Gjykses konstaton se W03594 vazhdimisht e minimizoi shkallën e rëndë të trajtimit që iu bë atij dhe të ndaluarve të tjerë, dhe se dëshmia e tij është në kundërshtim të plotë me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë që u mbajtën në kompleksin e ndalimit në Zllash, si dhe me deklaratën që vetë ai i kishte dhënë më parë ZPS-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e tij në lidhje me trajtimin e pësuar gjatë mbajtjes në ndalim ka vlerë të kufizuar dhe është mbështetur në të vetëm në masën që ajo konfirmohet nga dëshmi të tjera, sikurse shtjellohet me hollësi në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

## 5. W04669

84. W04669 dëshmoi para Trupit Gjykses më 10 dhe 11 nëntor 2021,<sup>148</sup> me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.<sup>149</sup>

85. Ai dëshmoi për arrestimin e tij nga ushtarë të UÇK-së, mbajtjen e tij në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe mënyrën si u trajtuan ai dhe të ndaluarit e tjerë gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar.

---

<sup>146</sup> W03594: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1061, rreshtat 13-19 (thexsimi i shtuar).

<sup>147</sup> W03594: T. 13 tetor 2021, publik, f. 1210, rreshtat 13-15; T. 14 tetor 2021, konfidencial, f. 1232, rreshti 25 deri në f. 1233, rreshti 2; f. 1239, rreshti 7 deri në f. 1240, rreshti 8.

<sup>148</sup> W04669: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1389-1498; T. 11 nëntor 2021, konfidencial, f. 1503-1586.

<sup>149</sup> Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse, para. 51(f).

86. Trupi Gjykues konstaton se W04669 është i besueshëm në aspektet kryesore të dëshmisë së tij. Dëshmitari iu përgjigj pyetjeve që iu bënë në mënyrë të hapur, të qartë, të përmbledhur dhe përputhëse. Dëshmia e tij ishte e pasur në detaje, e gjallë dhe e rrëfyer me emocion, që tregon se ai dëshmoi për ngjarje që i kishte përjetuar vetë. Për shembull, ai përshkroi në mënyrë të hollësishme dhe të sinqertë se si u keqtrajtua (në cilat pjesë të trupit u godit, si u godit dhe me çfarë u godit).<sup>150</sup> Ai dha një dëshmi shumë të gjallë se si viktimja e vrasjes së paligjshme ishte “i nxirë në fytyrë” dhe “i ënjtur”, dhe se si ishte “duke gjëmuar”.<sup>151</sup> Një element tjetër që vërtetoi natyrën personale të dëshmisë së tij ishte edhe përshkrimi bindës i ndikimit psikologjik që pati mbi të kur pa viktimën e vrasjes së paligjshme të rrahur aq keq dhe i frikës që i ngjalli se mund të pësonte të njëjtin fat.<sup>152</sup>

87. Krahas kësaj, W04669 bëri përpjekje të dukshme që të jepte një përshkrim të saktë të ngjarjeve, duke bërë të qartë kur nuk i kujtoheshin hollësi konkrete,<sup>153</sup> dhe duke bërë dallimin midis asaj që kishte parë vetë dhe asaj që kishte dëgjuar nga të tjerët.<sup>154</sup> Ai e përfundoi dëshminë para Trupit Gjykues me fjalët: “Mirëpo ka kaluar qe 22 vite edhe më falni nëse unë nuk kam pas mundësi me shtjellue në detaje. Unë kam thënë

<sup>150</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1443, rreshti 11 deri në f. 1446, rreshti 7. *Shih gjithashtu* në lidhje me shembuj të tjerë ku W04669 përshkruan hollësi të cilat vënë në dukje natyrën personale të dëshmisë së tij: **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1425, rreshtat 18-21 (ku W04669 shpjegoi se i kujtohej që marrjet në pyetje ndodhnin në mbrëmje sepse “ka qenë dritë aty, elektrike, poç i lëshuar [gjatë marrjes në pyetje]”); T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1399, rreshti 21 deri në f. 1403, rreshti 22 (ku jep hollësi për stërvitjet e tij dhe të tjerëve në Zllash); T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1411, rreshtat 22-23 (ku përshkruan që ushtarë të UÇK-së ia morën lidhëset e këpucëve kur mbërriti në kompleksin e ndalimit në Zllash, një hollësi që e kujtoi edhe W01679, sikurse u theksua më lart); T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1418, rreshti 15 deri në f. 1419, rreshti 5.

<sup>151</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1432, rreshtat 1-8; T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1434, rreshtat 1-9; *shih gjithashtu* T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1430, rreshtat 4-19.

<sup>152</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1441, rreshtat 1-10; f. 1468, rreshtat 7-16.

<sup>153</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1395, rreshti 24 deri në f. 1396, rreshti 2; f. 1397, rreshtat 1-8; f. 1402, rreshtat 17-20; f. 1449, rreshtat 7-22; f. 1463, rreshti 3 deri në f. 1464, rreshti 20; f. 1455, rreshti 15 deri në f. 1456, rreshti 16; T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1412, rreshtat 19-25; f. 1416, rreshti 14 deri në f. 1417, rreshti 2.

<sup>154</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1417, rreshti 11 deri në f. 1418, rreshti 14.

atë që më kujtohet, ça kam dëgjuar, ça kam parë edhe ça kam majt mend pej asaj kohe”.<sup>155</sup>

88. W04669 ishte i matur dhe i përmbajtur në dëshminë e vet, që e bën atë edhe më të besueshëm. Për shembull, kur u pyet për keqtrajtimin e tij, ai menjëherë tha se u mor në pyetje dhe u rrah vetëm një herë.<sup>156</sup> Me rëndësi është që dëshmia e W04669-ës konfirmohet nga prova të tjera, si prova dokumentare ashtu edhe dëshmi gojore, sikurse shtjellohet në analizën e provave.

89. Trupi Gjykses mban parasysh se ka disa mospërputhje midis dëshmisë së W04669-ës në sallën e gjyqit dhe deklaratës së tij dhënë ZPS-së. Konkretisht, në sallën e gjyqit W04669 deklaroi se në BIA kishte dy persona të njohur si “Cali”, që bie ndesh me deklaratën që i kishte dhënë ZPS-së, për të cilën iu bënë pyetje në sallën e gjyqit.<sup>157</sup> Trupi Gjykses i ka dhënë pak peshë kësaj pjese të dëshmisë së W04669-ës, sepse nuk i janë paraqitur prova të tjera për këtë, dhe dëshmitari nuk dha shpjegim të besueshëm për këtë mospërputhje. Për më tepër, Trupi Gjykses ka marrë prova të besueshme dhe të mbështetshme të cilat tregojnë se i vetmi person me nofkën “Cali” ose “Sali” në BIA ishte i akuzuari, sikurse shtjellohet me hollësi në analizën e provave prej Trupit Gjykses.<sup>158</sup> Këto prova e kanë burimin, ndër të tjera, nga ish-anëtarë të BIA-s/UÇK-së, përfshirë të akuzuarin,<sup>159</sup> të cilët kishin më shumë njohuri për njësitin BIA se W04669. Pavarësisht nga kjo, Trupi Gjykses nuk gjykon se kjo mospërputhje ndikon në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit, duke qenë se ky është një rast i veçantë dhe i shkëputur.

---

<sup>155</sup> W04669 : T. 11 nëntor 2021, f. 1585, rreshtat 14-18.

<sup>156</sup> W04669: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1445, rreshtat 7-16; f. 1449, rreshtat 2-4.

<sup>157</sup> W04669: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1472, rreshti 18 deri në f. 1484, rreshti 14.

<sup>158</sup> *Shih* para. 340, 541, 551-552.

<sup>159</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 8, f. 8, rreshtat 2-7.

90. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se W04669 është i besueshëm dhe rrjedhimisht është mbështetur në dëshminë e tij, duke mbajtur parasysh cilësimin e bërë më sipër.

**6. [REDAKTUAR] W04676, W04391, W04390, W04674, W04712 dhe W04648**

91. [REDAKTUAR]. W04676, W04391, W04390 dhe W04674 dëshmuan para Trupit Gjykues, me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit, përkatësisht më 17-18 nëntor 2021,<sup>160</sup> 22-23 nëntor 2021,<sup>161</sup> 24 nëntor 2021,<sup>162</sup> dhe 13-14 dhjetor 2021.<sup>163,164</sup> Deklarata me shkrim e W04712-shit u paraqit si provë në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullës 153 të Rregullores.<sup>165</sup> Deklaratat me shkrim të W04648-ës u paraqitën si prova në vend të dëshmisë gojore, në bazë të rregullës 155 të Rregullores, për arsye se dëshmitari kishte vdekur.<sup>166</sup>

92. Të gjashtë këta dëshmitarë dëshmuan për rrethanat e arrestimit të viktimës së vrasjes së paligjshme (megjithëse në thelb dëshmi të dorës së dytë), [REDAKTUAR], për kërkimin e kufomës dhe vizitën në kompleksin e ndalimit në Zllash në [REDAKTUAR] 1999, [REDAKTUAR] dhe, së fundi, [REDAKTUAR].<sup>167</sup> Duke qenë se të gjashtë dëshmitarët [REDAKTUAR] dhe dëshmuan për të njëjtat ngjarje, Trupi Gjykues do të vlerësojë besueshmërinë e tyre bashkërisht.

93. Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve ishin kryesisht përputhëse dhe, me gjithë lidhjen e ngushtë midis tyre, Trupi Gjykues nuk vuri re ndonjë shenjë se ata ishin

<sup>160</sup> **W04676**: T. 17 nëntor 2021, konfidencial, f. 1594-1677; T. 18 nëntor 2021, konfidencial, f. 1686-1716.

<sup>161</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1729-1788; T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1794-1847.

<sup>162</sup> **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1859-1915.

<sup>163</sup> **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1929-2004; T. 14 dhjetor 2021, konfidencial, f. 2008-2022.

<sup>164</sup> Vendimi i Parë mbi Masat Mbrojtëse, para. 39(c); Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse, para. 51(f).

<sup>165</sup> [Decision Admitting W04712's Written Statements](#) (Vendimi për Pranimin e Deklaratave me Shkrim të W04712-shit) para. 37(b).

<sup>166</sup> [Decision Admitting W04648's Written Statements](#) (Vendimi për Pranimin e Deklaratave me Shkrim të W04648-ës), para. 16(b).

<sup>167</sup> [REDAKTUAR]; **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1900, rreshtat 7-11; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1935, rreshti 9 deri në f. 1936, rreshti 2; f. 1940, rreshtat 10-25.



marrë vesh mes tyre. Ndonëse dëshmuar për të njëjtat fakte, ata i përshkruan ngjarjet nga këndvështrime të ndryshme, duke dhënë hollësi të ndryshme dhe duke përdorur formulime gjuhësore të ndryshme. Kjo për Trupin Gjykes tregon se dëshmitarët nuk i përshtatën ose mësuan përmendësh dëshmitë e tyre. Trupi Gjykes gjithashtu nuk vuri re ndonjë shtysë ose motiv për të gënjer, fshehur, trilluar ose shtrembëruar informacionin.

94. Dëshmitë e tyre ishin gjithashtu të qarta dhe të natyrshme. Ata dhanë hollësi të shumta (si emra vendesh dhe personash) dhe përshkrime të gjalla, nga të cilat Trupi Gjykes u bind se ata flisnin në bazë të përvojës së tyre personale.<sup>168</sup> Kur dhanë informacion për ngjarjet që nuk i kishin përjetuar vetë, ata bënë dallim të qartë midis tyre dhe ngjarjeve që i kishin përjetuar vetë, shpesh edhe pa iu kërkuar.<sup>169</sup> Dëshmitarët dukshëm u përpoqën të ishin të saktë, duke pranuar menjëherë kur nuk e dinin ose nuk u kujtohej ndonjë hollësi e caktuar,<sup>170</sup> dhe duke ndërhyrë për të dhënë më shumë informacion kur mundeshin.<sup>171</sup>

<sup>168</sup> *Për shembull*, **W04676** dëshmoi se i kujtohej që në zhvarrimin e kufomës, [REDAKTUAR] kishin sjellë një arkivol, një qese të bardhë, doreza dhe një shall; *shih* **W04676**: T. 17 nëntor 2021, konfidencial, f. 1606, rreshti 22 deri në f. 1607, rreshti 3. Ajo gjithashtu dha hollësi për teshat që kishte veshur viktimat e vrasjes së paligjshme kur e zhvarrosën kufomën e tij, [REDAKTUAR]; *shih* **W04676**: f. 1653, rreshti 15 deri në f. 1654, rreshti 6; f. 1661, rreshti 14 deri në f. 1662, rreshti 25. **W04391** dëshmoi se si të ndaluarit [REDAKTUAR], ishin të lodhur, të pistë e të palarë dhe në fytyrë kishin shenja rrahjesh dhe keqtrajtimit; *shih* **W04391**: T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1744, rreshtat 10-19. *Shih gjithashtu* **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1867, rreshti 2 deri në f. 1870, rreshti 20; f. 1872, rreshti 20 deri në f. 1873, rreshti 7; **W04712**: 077816-TR-ET Part (Pjesa) 1 RED1, f. 8, rreshti 17 deri në f. 10, rreshti 2; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1935, rreshti 9 deri në f. 1936, rreshti 2; f. 1940, rreshtat 10-25.

<sup>169</sup> *Shih, për shembull*, **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1735, rreshti 17 deri në f. 1736, rreshti 10; **W04712**: 077816-TR-ET Part (Pjesa) 1 RED1, f. 10, rreshti 3 deri në f. 11, rreshti 2; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1933, rreshtat 5-13; f. 1943, rreshti 16 deri në f. 1944, rreshti 18; f. 1992, rreshti 7 deri në f. 1993, rreshti 9.

<sup>170</sup> *Shih, për shembull*, **W04676**: T. 17 nëntor 2021, konfidencial, f. 1601, rreshti 7 deri në f. 1602, rreshti 4; f. 1646, rreshtat 1-8; f. 1651, rreshti 15 deri në f. 1652, rreshti 5; f. 1664, rreshti 2 deri në f. 1665, rreshti 23; **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1819, rreshti 6 deri në f. 1820, rreshti 3; **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1864, rreshtat 10-13; f. 1873, rreshtat 8-23; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, publik, f. 1994, rreshtat 23-24.

<sup>171</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1744, rreshti 25 deri në f. 1745, rreshti 4.

95. [REDAKTUAR].<sup>172</sup> [REDAKTUAR].<sup>173</sup>

96. Trupi Gjykues vërejtë disa mospërputhje në dëshmitë dhe/ose deklaratat e dëshmitarëve, [REDAKTUAR]. Sidoqoftë, Trupi Gjykues gjykon se këto mospërputhje nuk ndikojnë në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarëve, duke pasur parasysh: (i) kohën që ka kaluar nga ngjarjet; (ii) [REDAKTUAR]; (iii) këndvështrimet e ndryshme të dëshmitarëve;<sup>174</sup> (iv) moshën e tyre në atë kohë;<sup>175</sup> dhe (v) faktin që në disa raste dëshmitë e tyre ishin të dorës së dytë.<sup>176</sup> Në fund, të gjitha dëshmitë dhe deklaratat e dëshmitarëve janë në thelb përputhëse. Trupi Gjykues i ka diskutuar mospërputhjet e lartpërmendura në analizën e provave, për aq sa ka qenë e nevojshme për nxjerrjen e përfundimeve faktike,.

97. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues u ka kushtuar vëmendje të posaçme deklaratave të W04648-ës – ku përfshihen, ndër të tjera, një numër deklaratash [REDAKTUAR] dhe një deklaratë pa datë dhe pa nënshkrim<sup>177</sup> – në të cilat ka mospërputhje të

<sup>172</sup> **W04676**: T. 17 nëntor 2021, konfidencial, f. 1633, rreshti 3 deri në f. 1635, rreshti 15; f. 1641, rreshti 24 deri në f. 1643, rreshti 10; **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1763, rreshti 24 deri në f. 1764, rreshti 12; f. 1786, rreshtat 3-10; **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1882, rreshtat 9-25; f. 1893, rreshti 14 deri në f. 1894, rreshti 11; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1945, rreshtat 10-21; f. 1965, rreshti 21 deri në f. 1969, rreshti 5.

<sup>173</sup> **W04676**: T. 17 nëntor 2021, konfidencial, f. 1667, rreshti 14 deri në f. 1669, rreshti 17; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1977, rreshti 6 deri në f. 1978, rreshti 22.

<sup>174</sup> Për shembull, W04390 shpjegoi se, [REDAKTUAR], ajo nuk ndenji shumë me ta: “Për me nejtë, për me folë, unë ma gjatë s’kam bisedu, [REDAKTUAR]”; shih **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1906, rreshti 17 deri në f. 1907, rreshti 4. Kjo mund të shpjegojë se pse dëshmia e saj për vizitën ndryshon në disa aspekte nga ajo e W04391-shit.

<sup>175</sup> Për shembull, në atë kohë W04390 ishte 21 vjeç [REDAKTUAR]; shih **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1859, rreshti 16; f. 1882, rreshtat 9-23.

<sup>176</sup> Për shembull, W04674 dhe W04712 dhanë dëshmi paksa të ndryshme nga ato të W04390-s dhe W04391-shit në lidhje me takimin me W04600-n [REDAKTUAR]. Megjithatë, në dallim nga W04390 dhe W04391, as W04674, e as W04712, nuk ishin të pranishëm aty dhe për takimin mësuar nga [REDAKTUAR], çka mund të shpjegojë mospërputhjet në dëshmitë e tyre; shih **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1982, rreshtat 11-21; **W04712**: 077816-TR-ET Part 1 RED1, f. 12, rreshti 8 deri në f. 13 rreshtat 15; **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1867, rreshtat 2-25; **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1738, rreshti 6 deri në f. 1739, rreshti 11.

<sup>177</sup> Kjo deklaratë pa datë dhe pa nënshkrim është pjesë e një deklaratë [REDAKTUAR]; shih f. SPOE00128339-00128343 të deklaratës [REDAKTUAR] SPOE00128333-00128343 RED1. E njëjta

dukshme lidhur me datat dhe personat e pranishëm gjatë disa takimeve të caktuara.<sup>178</sup> Trupi Gjykses nuk mendon se këto mospërputhje ndikojnë në besueshmërinë e përgjithshme të W04648-ës, duke pasur parasysh: (i) moshën e thyer në kohën kur i dha deklaratat; (ii) [REDAKTUAR]; (iii) [REDAKTUAR]; (iv) [REDAKTUAR];<sup>179</sup> dhe (v) faktin që kur shkroi njëren nga deklaratat (përkatësisht deklaratën pa datë dhe pa nënshkrim), atë e ndihmoi një person tjetër (W04391), fakt ky që e konfirmoi edhe W04391 në sallën e gjyqit dhe shihet qartë edhe në vetë deklaratën e tij, e cila qartësisht përmban komente të një pale të tretë.<sup>180</sup>

98. Sidoqoftë, Trupi Gjykses nuk u mbështet: (i) në asnjë pjesë të deklaratës pa datë dhe pa nënshkrim të W04648-ës;<sup>181</sup> as (ii) në informacionin në deklaratën e tij [REDAKTUAR] se viktima e vrasjes së paligjshme u “kidnapua dhe vra [...] më [REDAKTUAR]” [REDAKTUAR].<sup>182</sup> Prova të tjera më të besueshme, të përfshira në dokumentacionin e çështjes, demonstrojnë se ky informacion është i pasaktë, sikurse diskutohet gjerësisht nga Trupi Gjykses në analizën e provave. Pasaktësitë e tjera nuk lidhen me aspekte të rëndësishme. Dëshmia e W04648-ës se [REDAKTUAR], është e njëjtë në të gjitha deklaratat e tij dhe është vërtetuar mjaftueshmërisht nga prova e dëshmi të tjera konfirmuese.

---

deklaratë pa datë e pa nënshkrim është gjithashtu në f. SPOE00130686-00130687 të SPOE00130685-00130687 RED1.

<sup>178</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343 RED1; SPOE00128158-00128162 RED1; SPOE00128087-00128091 RED1; SPOE00128061-00128064 RED1; SPOE00128069-00128086 RED1; SPOE00130685-00130687 RED1.

<sup>179</sup> **W04648**: SPOE00128069-00128086, f. SPOE00128074 (ku thuhet: “[REDAKTUAR]”).

<sup>180</sup> **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1808, rreshtat 7-10; f. 1815, rreshtat 14-15 (ku dëshmon se “[k]jo është deklaratë që ka shkru edhe unë edhe baba”); **W04648**: SPOE00128333-00128343 RED1, f. SPOE00128339-00128343; SPOE00130685-00130687 RED1, f. SPOE00130686-00130687.

<sup>181</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk u mbështet në f. SPOE00128339-00128343 të deklaratës së UNMIK-ut SPOE00128333-00128343 RED1, që përmban deklaratën pa datë dhe pa nënshkrim. Trupi Gjykses gjithashtu nuk u mbështet në f. SPOE00130686-00130687 të SPOE00130685-00130687 RED1, që përmban të njëjtën deklaratë.

<sup>182</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343 RED1, f. SPOE00128333.

99. Në përputhje me të gjitha sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se të gjashtë dëshmitarët janë të besueshëm dhe rrjedhimisht është mbështetur në dëshmitë e tyre, sikurse shtjellohet në analizën e provave prej Trupit Gjykses, duke mbajtur parasysh cilësimin e lartpërmendur në lidhje me disa pjesë të dëshmisë së W04648-ës.

## 7. W04600

100. W04600 dëshmoi para Trupit Gjykses më 23, 24 dhe 27 shtator 2021,<sup>183</sup> me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit,<sup>184</sup> si dhe iu dhanë garanci në bazë të rregullës 151(3) të Rregullores në lidhje me vetinkriminimin.<sup>185</sup>

101. W04600 ishte anëtar i UÇK-së dhe, gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës, [REDAKTUAR].<sup>186</sup> W04600 dëshmoi për organizimin e UÇK-së brenda Zonës Operative të Llapit, raportin midis [REDAKTUAR] dhe BIA-s, udhëheqjen e BIA-s dhe bazën e saj në Zllash, dhe çka është me rëndësi, rrethanat e [REDAKTUAR].

102. Trupi Gjykses konstaton se W04600 është përgjithësisht i besueshëm për sa u përket aspekteve thelbësore të dëshmisë së tij. Së pari, dëshmitari ishte përgjithësisht i sinqertë, i hapur dhe i qartë gjatë gjithë kohës që u mor në pyetje nga palët dhe nga mbrojtësja e viktimave. Trupi Gjykses është veçanërisht i vëmendshëm ndaj faktit që dëshmitari pranoi menjëherë se, së bashku me ushtarët e UÇK-së [REDAKTUAR],<sup>187</sup> [REDAKTUAR], një fakt tejet vetinkriminues, gjë për të cilën dëshmitari dukej se ishte shumë i vetëdijshtëm.<sup>188</sup>

---

<sup>183</sup> **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 710-743; T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 747-822; T. 27 shtator 2021, konfidencial, f. 825-850.

<sup>184</sup> Vendimi i Parë mbi Masat Mbrojtëse, para. 39(c).

<sup>185</sup> Urdhër gojor, T. 20 shtator 2021, publik, f. 489, rreshti 14 deri në f. 490, rreshti 11. **W04600**: T. 23 shtator 2021, publik, f. 706, rreshti 10 deri në f. 707, rreshti 13.

<sup>186</sup> **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 712, rreshti 9 deri në f. 713, rreshti 10.

<sup>187</sup> **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 725, rreshtat 8-15.

<sup>188</sup> *Shih* **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 769, rreshti 5 deri në f. 773, rreshti 9 (ku thekson, ndër të tjera, se i tha të akuzuarit: “[REDAKTUAR]”).

103. Së dyti, dëshmia e tij ishte e strukturuar dhe plot me hollësi, që tregon se ai dëshmoi për ngjarje që i kishte përjetuar personalisht. Për shembull, ai i përshkroi rrethanat dhe ngjarjet që ndodhën në lidhje me arrestimin e viktimës së vrasjes së paligjshme në mënyrë kronologjike dhe të hollësishme, si urdhrin që iu dha, veturën që përdori, vendet ku shkoi për ta kërkuar, njerëzit me të cilët foli dhe bisedat që pati, ndër të tjera [REDAKTUAR].<sup>189</sup>

104. Së treti, W04600 bëri menjëherë të qartë sa njohuri kishte dhe pranoi kur nuk dinte ose nuk mbante mend ndonjë hollësi të caktuar.<sup>190</sup> Ai bëri përpjekje të dukshme për të dhënë informacion të saktë dhe dha sqarime pa iu kërkuar.<sup>191</sup>

105. Së katërti, dëshmia e W04600-s konfirmohet nga dëshmia e W04603-shit, dhe, duke mbajtur parasysh cilësimin e mëposhtëm, edhe nga disa anëtarë të familjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.

106. Megjithatë, Trupi Gjykses është bindur se W04600 në disa raste dha dëshmi të pagjasë lidhur me disa takime [REDAKTUAR], që diskutohet me hollësi në analizën e provave prej Trupit Gjykses.<sup>192</sup> Ai gjithashtu u përpoq të minimizonte rrethanat e [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].<sup>193</sup> Trupi Gjykses gjykon se ky version (më i zbutur) i dëshmuar prej tij shpjegohet [REDAKTUAR]. Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, edhe pse iu ofruan garanci kundër vetinkrimimit, ishte e qartë se W04600 ndihej në vështirësi kur dëshmonte për sjelljen e tij në të kaluarën dhe u përpoq të mbronte

---

<sup>189</sup> **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 722, rreshti 24 deri në f. 733, rreshti 16; f. 729, rreshti 4 deri në f. 740, rreshti 24; *shih gjithashtu* vizatimet e bëra nga dëshmitari, REG00-003, REG00-004, REG00-005.

<sup>190</sup> *Shih, për shembull*, **W04600**: T. 23 shtator 2021, publik, f. 715, rreshti 23 deri në f. 716, rreshti 11; f. 719, rreshtat 1-5; f. 721, rreshtat 11-14; T. 24 shtator 2021, publik, f. 750, rreshtat 4-25; f. 763, rreshtat 15-19.

<sup>191</sup> **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 728, rreshtat 6-8 (ku qartëson, pa iu kërkuar, se njëri nga ushtarët që e kishte shoqëruar fillimisht nuk shkoi me të deri në Zllash); T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 766, rreshtat 4-15; f. 768, rreshtat 7-12; f. 793, rreshti 9 deri në f. 794, rreshti 19.

<sup>192</sup> *Shih* para. 597; **W04600**: T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 759, rreshti 9 deri në f. 761, rreshti 25.

<sup>193</sup> *Shih* para. 463; **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 725, rreshtat 1-7 (kur ZPS-ja sugjeroi se W04600 [REDAKTUAR]); f. 727, rreshtat 10-20; T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 803, rreshti 25 deri në f. 804, rreshti 19.

interesat e tij, duke u përpjekur njëkohësisht të përmbushte deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses u mbështet në aspekte të dëshmisë së W04600-s për [REDAKTUAR] vetëm kur ato u konfirmuan [REDAKTUAR], sikurse shtjellohet në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

107. Duke mbajtur parasysh të gjitha sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se W04600 është i besueshëm dhe është mbështetur në dëshminë e tij, në masën e përcaktuar më lart.

## 8. W04603

108. W04603 dëshmoi para Trupit Gjykses më 2 dhe 3 nëntor 2021,<sup>194</sup> me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.<sup>195</sup>

109. W04603 ishte anëtar i UÇK-së dhe gjatë gjithë periudhës që lidhet me akuzat [REDAKTUAR].<sup>196</sup> [REDAKTUAR]. Dëshmia e tij u përqendrua kryesisht në këto ngjarje.

110. Trupi Gjykses konstaton se W04603 është përgjithësisht i besueshëm. Dëshmitari ishte përgjithësisht i hapur dhe pranoi [REDAKTUAR], fakt ky tejet inkriminues për të.<sup>197</sup> Ai shprehu keqardhje [REDAKTUAR]: “jam ndi shumë keq. [...] [REDAKTUAR]”, që e bën edhe më të besueshme dëshminë e tij.<sup>198</sup> Çka është me rëndësi, aspekte kyçe të dëshmisë së tij, ku përfshihen hollësitë [REDAKTUAR], konfirmohen nga dëshmitë [REDAKTUAR], sikurse shtjellohet në analizën e provave prej Trupit Gjykses.

---

<sup>194</sup> **W04603**: T. 2 nëntor 2021, konfidencial, f. 1289-1352; T. 3 nëntor 2021, konfidencial, f. 1358-1377.

<sup>195</sup> Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse, para. 51(f).

<sup>196</sup> **W04603**: T. 2 nëntor 2021, konfidencial, f. 1289, rreshti 24 deri në f. 1291, rreshti 7.

<sup>197</sup> **W04603**: T. 2 nëntor 2021, konfidencial, f. 1296, rreshti 9 deri në f. 1305, rreshti 18.

<sup>198</sup> **W04603**: T. 2 nëntor 2021, publik, f. 1313, rreshti 25 deri në f. 1314, rreshti 15; T. 3 nëntor 2021, konfidencial, f. 1368, rreshti 19 deri në f. 1370, rreshti 18.



111. Trupi Gjykses vëren se [REDAKTUAR] W04603 i minimizoi rrethanat [REDAKTUAR].<sup>199</sup> Trupi Gjykses gjykon se ky version (më i zbutur) i dëshmuar prej tij, shpjegohet [REDAKTUAR]. Trupi Gjykses u mbështet në këtë pjesë të dëshmisë së W04603-shit vetëm për aq sa ajo u konfirmua [REDAKTUAR], sikurse shtjellohet në analizën e provave nga Trupi Gjykses. Megjithatë, Trupi Gjykses nuk gjykon se ky aspekt i dëshmisë së tij ndikon në besueshmërinë e përgjithshme të tij si dëshmitar.

112. Duke marrë parasysh të gjitha sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se W04603 është i besueshëm dhe është mbështetur në dëshminë e tij në masën e përcaktuar më lart.

## 9. Fatmir Sopi (W04485)

113. Fatmir Sopi (z. F. Sopi) dëshmoi para Trupit Gjykses më 18 dhe 19 janar 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>200</sup>

114. Zoti F. Sopi ishte anëtar i UÇK-së para dhe gjatë periudhës që lidhet me akuzat.<sup>201</sup> Ai mori pjesë në krijimin e Brigadës 153 (brenda Zonës Operative të Llapit), që e kishte shtabin në shtëpinë e tij në Zllash afërsisht që nga shkurti 1999 deri në mars 1999.<sup>202</sup> Zoti F. Sopi mbajti disa poste komanduese në Brigadë: fillimisht ishte përgjegjës për mbrojtjen civile dhe më pas zëvendëskomandant i Brigadës.<sup>203</sup> Ai dëshmoi për: strukturën dhe komandën e Brigadës 153; strukturën dhe komandën e njësitit BIA; bazën e BIA-s në Zllash; rolin e të akuzuarit; pushtetin e të akuzuarit mbi bazën e BIA-

---

<sup>199</sup> *Shih* para. 463; **W04603**: T. 2 nëntor 2021, konfidencial, f. 1302, rreshti 17 deri në f. 1303, rreshti 17; T. 3 nëntor 2021, konfidencial, f. 1368, rreshtat 13-18.

<sup>200</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, konfidencial, f. 2031-2123; T. 19 janar 2022, konfidencial, f. 2128-2182.

<sup>201</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2032, rreshti 20 deri në f. 2033, rreshti 4.

<sup>202</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2033, rreshti 8 deri në f. 2035, rreshti 2; f. 2043, rreshti 23 deri në f. 2044, rreshti 3.

<sup>203</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2036, rreshtat 6-25; T. 19 janar 2022, publik, f. 2164, rreshtat 2-6.

s dhe anëtarët e BIA-s; praninë e tij në Zllash; dhe ndalimin dhe/ose keqtrajtimin e mundshëm të personave në Zllash.

115. Trupi Gjykses konstaton se zoti F. Sopi është përgjithësisht i besueshëm, veçanërisht në lidhje me strukturat dhe operacionet e UÇK-së në zonën e Zllashit dhe rolin e të akuzuarit, pushtetin e tij mbi njësitin BIA dhe praninë e tij në Zllash gjatë periudhës përkatëse. Zoti F. Sopi ishte i hapur në përgjigjet e tij për këto tema dhe dha informacion përgjithësisht të qartë dhe realist.<sup>204</sup> Ai dha dëshmi unike dhe të hollësishme, bazuar në njohuritë e tij të dorës së parë si person i brendshëm dhe në përputhje me pozitën e tij si anëtar me rang të lartë në UÇK. Për shembull, ai dëshmoi për një mbledhje që u mbajt në shtëpinë e tij në shkurt 1999, kur Brigada 153 u themelua zyrtarisht, dhe dha hollësi për personat e pranishëm në atë mbledhje dhe emërimet që u bënë atëherë për komandën e Brigadës.<sup>205</sup> Duke pasur parasysh se ai ishte gjithashtu i vendosur në zonën e Zllashit në periudhën në fjalë, Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e tij u bazua në njohuritë dhe përvojën personale të tij.

116. Zoti F. Sopi dha dëshmi përputhëse edhe kur u mor në pyetje nga pala tjetër.<sup>206</sup> Ai nuk u duk të kishte ndonjë shtysë apo motiv për të trilluar informacion apo për ta zbukuruar dëshminë e vet në lidhje me aspektet e lartpërmendura.

117. E rëndësishme është që dëshmia e tij për këto aspekte përputhet dhe konfirmohet nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë – ndër të cilët ish-anëtarë të UÇK-së dhe dëshmitarë të cilët dëshmuuan për krimet – si edhe nga vetë i akuzuari, sikurse

---

<sup>204</sup> *Shih, për shembull, z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2036, rreshtat 24-25; f. 2059, rreshtat 7-16; f. 2074, rreshti 15 deri në f. 2075, rreshti 24; f. 2076, rreshtat 12-13.

<sup>205</sup> *Z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2034, rreshti 9 deri në f. 2036, rreshti 13.

<sup>206</sup> *Shih, për shembull, kur u pyet për anëtarë të BIA-s: z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2077, rreshtat 8-18; T. 19 janar 2022, konfidencial, f. 2133, rreshtat 17-21.

shtjellohet me hollësi në analizën e provave prej Trupit Gjykues, gjë që e bën zotin F. Sopi edhe më të besueshëm.<sup>207</sup>

118. Megjithatë, z. F. Sopi ishte kundërshtues dhe i mjegullt kur iu përgjigj pyetjeve në lidhje me dijeninë e mundshme të tij për ndalimin dhe/ose keqtrajtimin e personave në Zllash. Për shembull, ai dëshmoi se asnjëherë nuk kishte dëgjuar për persona të mbajtur të ndaluar në Zllash dhe tha se “jam i bindur që nuk ka pasur”.<sup>208</sup> Ai deklaroi se asnjëherë nuk kishte diskutuar për “spiunë, bashkëpunëtorë” me të akuzuarin dhe, kur u pyet nëse kishte dëgjuar për ndonjë person të keqtrajtuar në Zllash, ai u përgjigj: “Kjo më bën të qesh sepse është e pamundur dhe është diçka që nuk ka mundur të ndodhë, jo në Zllash, por kurrkund.”<sup>209</sup>

119. Mohimi kategorik nga dëshmitari i ndalimit dhe keqtrajtimin të personave në Zllash kundërshtohet fuqimisht nga dëshmitë reciprokisht konfirmuese të një numri dëshmitarësh, nga provat dokumentare dhe nga vetë i akuzuari, i cili i deklaroi ZPS-së se kishte dijeni për ushtarë, dhe me gjasë edhe civilë, që u mbajtën të ndaluar në bazën e BIA-s në Zllash në prill 1999.<sup>210</sup> Trupi Gjykues e gjykon të pagjasë që zoti F. Sopi të mos ketë dëgjuar ose ditur për persona të cilët së paku u mbajtën të ndaluar, në mos edhe u keqtrajtuat, në bazën e BIA-s, duke marrë parasysh pozitën e lartë dhe praninë e tij në Zllash në atë kohë.

<sup>207</sup> Për shembull, zoti. F. Sopi dëshmoi se BIA përdorte si bazë një shtëpi të fshatit, të cilën një banor i fshatit ia kishte dhënë UÇK-së për përdorim, aspekt ky që konfirmohet nga i akuzuari; *shih z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2048, rreshtat 5-13; f. 2088, rreshti 25 deri në f. 2089, rreshti 19; *z. Mustafa*: 069404-TR-ET, Part 3, f. 20, rreshtat 8-16. Z. F. Sopi gjithashtu dëshmoi se Nazif Musliu (me nofkën Tabuti) ishte anëtar i njësitit BIA, çka përputhet me dëshminë e Sejdi Veselit – gjithashtu anëtar i UÇK-së – dhe me dëshmitë e disa dëshmitarëve që dëshmuan për krimet, të cilët e identifikuan Tabutin si njërin nga ushtarët që i keqtrajtoi; *shih z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2077, rreshtat 16-18; T. 19 janar 2022, konfidencial, f. 2133, rreshtat 17-21; *z. Veseli*: T. 25 janar 2022, publik, f. 2202, rreshtat 10-12; para. 543-544, 555 më poshtë.

<sup>208</sup> *Z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2107, rreshtat 15-19; f. 2114, rreshtat 11-17.

<sup>209</sup> *Z. F. Sopi*: T. 19 janar 2022, publik, f. 2161, rreshtat 14-22; p. 2162, rreshti 23 deri në f. 2163, rreshti 2.

<sup>210</sup> Shih konstatimet faktike të Trupit Gjykues në lidhje me ndalimin arbitrar (Pika 1), trajtimin mizor dhe torturën (Pikat 2 dhe 3); *Z. Mustafa*: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 7, f. 15, rreshtat 7-15.

120. Gjithashtu, Trupi Gjykues e gjykon domethënës faktin se kur u pyet për këtë temë, zoti F. Sopi theksoi se nuk ishte e mundur që dikush të ishte keqtrajtuar nga UÇK-ja ose i akuzuari, për arsye se UÇK-ja po bënte “luftë çlirimtare” dhe se vetë i akuzuari kishte qenë dikur i burgosur politik. Ai gjithashtu theksoi se keqtrajtimet që kishin ndodhur ishin kryer “nga forcat serbe, në qoftë se ka ndodhur në atë periudhë kur ata kanë qëndruar në Zllash”<sup>211</sup> edhe pse më pas ra në kundërshtim me vetveten kur dëshmoi se: “Jo, nuk e di [se çfarë bënë serbët në kompleksin e ndalimit në Zllash] se nuk kemi pas mundësi ta dimë. Vetëm se e dimë se i dogjën të gjitha shtëpitë.”<sup>212</sup>

121. Përmbajtja e përgjigjeve të tij për këtë temë dhe mënyra e dhënies së tyre demonstronë se z. F. Sopi e orientoi në mënyrë strategjike dëshminë e tij për të mbrojtur të akuzuarin, me të cilin kishte pasur kontakte të rregullta gjatë periudhave që kanë lidhje me akuzat.<sup>213</sup> Zoti F. Sopi gjithashtu u orvat ta mbronte njësitin BIA, si dhe UÇK-në në përgjithësi, duke qenë se Brigada 153 – dhe ai vetë – ishin të vendosur në Zllash në atë kohë. Në këtë kontekst, dëshmitari u përpoq të jepte interpretimin e vet të ngjarjeve dhe të hidhte poshtë çdo pretendim për keqtrajtim ose shkelje nga ana e UÇK-së. Kjo e zvogëlon ndjeshëm besimin që ndryshe do të mund t’i jepej dëshmisë së tij për këtë pikë.

122. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykues gjykon se dëshmia e zotit F. Sopi, veçanërisht në lidhje me: strukturat dhe operacionet e UÇK-së në zonën e Zllashit; rolin e të akuzuarit në BIA dhe pushtetin e tij mbi BIA-n; dhe praninë e të akuzuarit në Zllash gjatë periudhës përkatëse, është përgjithësisht e besueshme dhe rrjedhimisht

---

<sup>211</sup> **Z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2162, rreshtat 3-18.

<sup>212</sup> **Z. F. Sopi:** T. 19 janar 2022, publik, f. 2177, rreshtat 4-5.

<sup>213</sup> **Z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2155, rreshtat 15-19 (“Unë e kam parë shumë herë. Kemi qenë bashkëluftëtarë dhe kemi qenë në të njëjtat pozicione, në të njëjtin vend, [...] Kemi pasur takime rutinore të ndryshme”).

është mbështetur në të. Nga ana tjetër, Trupi Gjykses nuk i jep peshë dëshmisë së dëshmitarit lidhur me mbajtjen dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në Zllash.

#### 10. Sejdi Veseli (W04484)

123. Sejdi Veseli ("z. Veseli") dëshmoi para Trupit Gjykses më 25 janar 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>214</sup>

124. Z. Veseli ishte anëtar i UÇK-së para dhe gjatë periudhës që lidhet me akuzat.<sup>215</sup> Ai mbante postin e zëvendëskomandantit të Brigadës 153<sup>216</sup> dhe ishte i vendosur në Zllash, përfshirë edhe në shtëpinë e zotit F. Sopi, e cila shërbeu si shtab i Brigadës 153 afërsisht nga shkurti 1999 deri në mars 1999.<sup>217</sup> Gjithashtu, z. Veseli ishte edhe instruktor në qendrën e rekrutëve të vendosur në shkollën në Zllash.<sup>218</sup> Z. Veseli dëshmoi për: funksionimin e Brigadës 153; raportin midis Brigadës 153 dhe njësitit BIA; bazën e BIA-s në Zllash; njohuritë e tij për operacionet e BIA-s dhe anëtarët e saj; rolin e të akuzuarit në BIA dhe pushtetin e tij mbi BIA-n; praninë e të akuzuarit në Zllash; dhe ndalimin dhe/ose keqtrajtimin e mundshëm të personave në Zllash.

125. Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e z. Veseli është përgjithësisht e besueshme, veçanërisht në lidhje me: strukturat dhe operacionet e UÇK-së në zonën e Zllashit; rolin e të akuzuarit në BIA dhe pushtetin e tij mbi BIA-n; dhe praninë e të akuzuarit në Zllash. Z. Veseli ishte përgjithësisht i hapur në përgjigjet e tij në lidhje me këto aspekte dhe dha informacion të qartë, të hollësishëm dhe realist. Trupi Gjykses vëren se z. Veseli ishte thellësisht i përfshirë në krijimin e UÇK-së, veçanërisht të Brigadës 153, dhe informacioni që dha bazohej në njohuritë e tij të dorës së parë si

---

<sup>214</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, konfidencial, f. 2189-2273.

<sup>215</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2189, rreshti 15 deri në f. 2191, rreshti 1.

<sup>216</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2191, rreshtat 2-14.

<sup>217</sup> Kjo konfirmohet nga vetë z. F. Sopi (z. F. Sopi: T. 18 janar 2022, publik, f. 2034, rreshtat 22-24; f. 2043, rreshti 23 deri në f. 2044, rreshti 3).

<sup>218</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2192, rreshtat 17-24; f. 2195, rreshtat 8-13.

person i brendshëm, dhe në përputhje me pozitën e tij si anëtar me rang të lartë në UÇK dhe rolin e tij në formimin e Brigadës 153. Duke qenë se edhe ai ishte i vendosur në zonën e Zllashit gjatë periudhës që lidhet me akuzat, Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e tij për aspektet e lartpërmendura bazohet në njohuritë dhe përvojën personale të tij.

126. Z. Veseli nuk u duk të kishte ndonjë shtysë apo motiv për të trilluar informacion apo për ta zbukuruar dëshminë e vet në lidhje me këto aspekte. Çka është me rëndësi, dëshmia e tij për këto aspekte përputhet dhe konfirmohet nga dëshmi të dëshmitarëve të tjerë – ndër të cilët ish-anëtarë të UÇK-së dhe dëshmitarë që dëshmuar për krimet – si edhe nga i akuzuari, sikurse shtjellohet me hollësi në analizën e provave prej Trupit Gjykses. Këto rrethana e bëjnë edhe më të besueshme dëshminë e z. Veseli.<sup>219</sup>

127. Megjithatë, z. Veseli i dha Trupit Gjykses edhe dëshmi me të cilën mohoi kategorikisht ekzistencën e një praktike ndalimi ose keqtrajtimi në çfarëdo kohe në Zllash.<sup>220</sup> Kur u pyet për këtë aspekt, z. Veseli theksoi se “s’ka qenë misioni i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me u maltrajtu njerëzit. Edhe nuk besoj që një ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës [...] e ka shkel betimin e vet”.<sup>221</sup> Ai gjithashtu dëshmoi se ishte krenar që kishte qenë anëtar i UÇK-së dhe se “nëse e lyp nevoja prap do të jem”.<sup>222</sup> Kur foli për konfliktin e armatosur, z. Veseli theksoi qartë se parapëlqen ta quajë atë

<sup>219</sup> Për shembull, z. Veseli tha se i akuzuari ishte shpesh në Zllash në prill 1999, që përputhet me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, sikurse diskutohet më me hollësi në konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me alibinë; *shih z. Veseli*: T. 25 janar 2022, publik, f. 2233, rreshtat 1-3. Z. Veseli gjithashtu dëshmoi se i akuzuari (me nofkën Cali) ishte komandant i BIA-s dhe përgjegjës për bazën e BIA-s në Zllash, çka konfirmon dëshminë e vetë të akuzuarit dhe të dëshmitarëve të tjerë; *shih z. Veseli*: T. 25 janar 2022, publik, f. 2195, rreshti 25 deri në f. 2196, rreshti 6; f. 2198, rreshti 1 deri në f. 2199, rreshti 8; *shih* para. 338-340. Ai gjithashtu dëshmoi se baza e BIA-s ishte më lart krahasuar me shkollën e fshatit në Zllash, ku ishte qendra e stërvitjes së rekrutëve, çka përputhet me dëshmi të tjera në dokumentacionin e çështjes; *shih z. Veseli*: T. 25 janar 2022, publik, f. 2195, rreshti 8; f. 2197, rreshtat 17-22; *shih* para. 354.

<sup>220</sup> *Z. Veseli*: T. 25 janar 2022, publik, f. 2223, rreshti 4 deri në f. 2224, rreshti 7.

<sup>221</sup> *Z. Veseli*: T. 25 janar 2022, publik, f. 2224, rreshtat 5-7.

<sup>222</sup> *Z. Veseli*: T. 25 janar 2022, publik, f. 2189, rreshtat 19-21.



“luftë e armatosur çlirimtare. Na u ka imponuar.”<sup>223</sup> Kur foli për të akuzuarin, dëshmitari theksoi se “askush nuk mund me m’bindë që Salih Mustafa ka bërë diçka të tillë. Një njeri që ka kushtu jetën nëpër burgje, është torturu nëpër burgje për të mirën e popullit të vet, edhe për me shkelë mbi atë, nuk ma merr mendja”.<sup>224</sup> Ai gjithashtu dëshmoi se “kam pasë raporte para lufte me [të akuzuarin] të mira” dhe e konsideronte “bashkëluftëtar”.<sup>225</sup> Z. Veseli në fund tha se veprimet e ndalimit dhe keqtrajtimit ishin bërë “përveç [nga] policia serbe, ushtarët jo”.<sup>226</sup>

128. Mohimi kategorik nga z. Veseli i ndalimeve dhe keqtrajttimeve në Zllash kundërshtohet fuqimisht nga dëshmitë reciprokisht konfirmuese të një numri dëshmitarësh, nga provat dokumentare dhe nga vetë i akuzuari, i cili pranoi se në bazën e BIA-s ishin mbajtur të ndaluar persona, ndër të cilët mund të ketë pasur edhe civilë.<sup>227</sup> Trupi Gjykues gjykon se është e pagjasë që z. Veseli të mos ketë dëgjuar ose ditur për persona të cilët së paku u mbajtën të ndaluar, në mos edhe u keqtrajtuat, nga BIA në Zllash, duke pasur parasysh pozitën e lartë dhe praninë fizike të tij në Zllash gjatë periudhës përkatëse. Mohimi prej tij i dijenisë në lidhje me këtë aspekt është gjithashtu i pagjasë, duke pasur parasysh pohimet pranuese të vetë dëshmitarit për disa anëtarë (konkretë) të BIA-s, për të cilët nuk kishte mendim të mirë dhe për të cilët tha: “ata që ngjesin nofka Tabuti, Vdekje e këto, [...] për mue një njeri normal nuk i ngjet vetja emnin Vdekje”,<sup>228</sup> ishin “recidivista”,<sup>229</sup> dhe “pjesë e keqe dhe e pisët e historisë”.<sup>230</sup>

<sup>223</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2189, rreshtat 17-18.

<sup>224</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2224, rreshtat 12-15.

<sup>225</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2202, rreshti 25 deri në f. 2203, rreshti 4.

<sup>226</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2224, rreshti 18.

<sup>227</sup> Shih konstatimet faktike të Trupit Gjykues në lidhje me ndalimin arbitrar (Pika 1), trajtimin mizor dhe torturën (Pikat 2 dhe 3); Z. Mustafa: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 7, f. 15, rreshtat 7-15.

<sup>228</sup> Mr Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2201, rreshtat 20-21.

<sup>229</sup> Mr Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2202, rreshtat 10-16; f. 2206, rreshtat 7-11.

<sup>230</sup> Mr Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2204, rreshti 16 deri në f. 2205, rreshti 9.

129. Përmbajtja e përgjigjeve të z. Veseli dhe mënyra se si iu përgjigj ai pyetjeve për temën e ndalimeve dhe keqtrajttimeve, demonstrojnë se z. Veseli e orientoi në mënyrë strategjike dëshminë e vet për të mbrojtur të akuzuarin dhe në përgjithësi UÇK-në dhe reputacionin e saj. Për mendimin e Trupit Gjykses, z. Veseli motivohet nga respekti i thellë që ka edhe sot e kësaj dite për UÇK-në dhe kauzën e saj dhe respekti që ka për të akuzuarin si “bashkëlufëtari”. Trupi Gjykses vëren se z. Veseli gjithashtu kishte synimin ta distancohte veten nga njësitë BIA dhe anëtarët e tij.<sup>231</sup> Për mendimin e Trupit Gjykses, ndikim të mëtejshëm në gatishmërinë e tij për t’iu përgjigjur pyetjeve specifike me vërtetësi dhe në mënyrë të plotë pati fakti që edhe Brigada 153 ishte e vendosur në Zllash gjatë asaj periudhe, gjë që e zvogëloi ndjeshëm besueshmërinë që ndryshe mund të kishte pasur dëshmia e tij në lidhje me këto aspekte.

130. Duke marrë parasysh të gjitha sa më lart, Trupi Gjykses gjykon se dëshmia e z. Veseli, veçanërisht në lidhje me: strukturat dhe operacionet e UÇK-së në zonën e Zllashit; rolin e të akuzuarit në BIA dhe pushtetin e tij mbi BIA-n; dhe praninë e të akuzuarit në Zllash gjatë periudhës përkatëse, është përgjithësisht e besueshme dhe rrjedhimisht Trupi Gjykses është mbështetur në të. Nga ana tjetër, Trupi Gjykses nuk i jep peshë dëshmisë së dëshmitarit në lidhje me mbajtjen dhe keqtrajtimin e të ndaluarve në Zllash.

---

<sup>231</sup> **Mr Veseli:** T. 25 janar 2022, publik, f. 2200, rreshtat 1-5; f. 2202, rreshtat 12-16.

## 11. Fatmir Humolli (W04849)

131. Fatmir Humolli (“z. Humolli”) dëshmoi para Trupit Gjykses më 1 dhe 2 shkurt 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>232</sup> Z. Humolli fillimisht u propozua si dëshmitar nga Mbrojtja (WDSM1900)<sup>233</sup> dhe ai i dha deklaratë Mbrojtjes më 24 dhe 25 mars 2021.<sup>234</sup>

132. Z. Humolli ishte anëtar i UÇK-së dhe gjatë periudhës që lidhet me akuzat ishte përgjegjës për administratën civile të Zonës Operative të Llapit.<sup>235</sup> Ai u caktua në atë detyrë nga një anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të cilit i raportonte drejtpërdrejt.<sup>236</sup> Z. Humolli dëshmoi për: formimin dhe strukturën e UÇK-së; operacionet e UÇK-së në Zonën Operative të Llapit; gjendjen e personave të zhvendosur në Zllash; të kaluarën e të akuzuarit dhe rolin dhe pozitën e tij si komandant i BIA-s; dhe lëvizjet e të akuzuarit para dhe gjatë periudhës që lidhet me akuzat.

133. Shumë aspekte të dëshmisë së z. Humolli Trupi Gjykses i konstatoi si jo të besueshme. Për shembull, z. Humolli dëshmoi se BIA nuk kishte kompetencë të arrestonte apo ndalonte kënd,<sup>237</sup> që kundërshtohet fuqimisht nga dëshmi të qarta dhe reciprokisht konfirmuese të cilat tregojnë se në bazën e BIA-s në Zllash u mbajtën të ndaluar persona në prill 1999. Për më tepër, sikurse shtjellohet me më shumë hollësi në kontekstin e alibisë së të akuzuarit,<sup>238</sup> z. Humolli e pati mjaft të vështirë të jepte data të sakta, apo qoftë edhe të përafërta, dhe t’u përmbahej atyre në vijimësi gjatë dëshmisë së vet. Kur u ballafaqua me deklaratat që kishte dhënë më herët, të cilat në

---

<sup>232</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2292-2372; T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2384-2455.

<sup>233</sup> KSC-BC-2020-05, F00106/COR/A02, Mbrojtja, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve, dhe Listës së Provave – Lista e Dëshmitarëve në bazë të Rregullës 95(5)(c)*, 30 prill 2021, konfidenciale, f. 2.

<sup>234</sup> DSM00100-00118; DSM00119-00133.

<sup>235</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2292, rreshti 25 deri në f. 2294, rreshti 3.

<sup>236</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2293, rreshti 18 deri në f. 2295, rreshti 2.

<sup>237</sup> **Z. Humolli:** T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2429, rreshtat 14-18.

<sup>238</sup> *Shih* para. 316-318.

disa raste binin ndesh me dëshminë e tij në sallën e gjyqit, z. Humolli nuk dha shpjegim bindës për këto mospërputhje.<sup>239</sup>

134. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se z. Humolli konfirmoi në sallën e gjyqit qëndrimin e tij të njëanshëm kundër Dhomave të Specializuara, e shprehur publikisht prej tij jo më larg se në vitin 2021.<sup>240</sup> Sipas z. Humolli, Dhomat e Specializuara ishin një gjykatë “padrejtë e ndërtume”, “Guantanamo për UÇK-në”, dhe “e padrejtë, në thelb raciste dhe shkelës i të drejtave të njeriut, [çka] fatkeqësisht, kjo është ajo që ka votuar Kuvendi jonë”.<sup>241</sup> Z. Humolli gjithashtu u shpreh se ishte skeptik që Dhomat e Specializuara mund të japin aktgjykime të drejta.<sup>242</sup> Në fund, dëshmitari deklaroi se, meqë gjykatën e themeluan institucionet e Kosovës, ai e respektonte atë “pavarësisht që ka mundësi me pas gabime”.<sup>243</sup>

135. Krahas kësaj, Trupi Gjykues vëren se z. Humolli konfirmoi në sallën e gjyqit se kishte shprehur publikisht përkrahjen për të akuzuarin në rrjetet sociale, ku përfshihej edhe një postim një ditë pas arrestimit të të akuzuarit (25 shtator 2020). Z. Humolli bëri të ditur se e kishte kontaktuar familjen e të akuzuarit për t’u ofruar si dëshmitar i Mbrojtjes.<sup>244</sup> Trupi Gjykues konstaton se lidhjet personale midis z. Humolli dhe të akuzuarit datonin që nga periudha para konfliktit të armatosur kur të dy u takuan më 1996 dhe bashkëpunuan me të tjerë për të formuar atë që më vonë do të quhej UÇK.<sup>245</sup> Për sa i përket periudhës që lidhet me akuzat, z. Humolli dëshmoi se takohej me të akuzuarin për “takime rutine [...] ka mundësi me shku dhjetë ditë mos me u

<sup>239</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2340, rreshti 15 deri në f. 2343, rreshti 14.

<sup>240</sup> 104784-104833, f. 104790, 104793; 104803-104804.

<sup>241</sup> **Z. Humolli:** T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2384, rreshti 11 deri në f. 2393, rreshti 18.

<sup>242</sup> **Z. Humolli:** T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2384, rreshti 11 deri në f. 2393, rreshti 18.

<sup>243</sup> **Z. Humolli:** T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2386, rreshtat 13-15.

<sup>244</sup> **Z. Humolli:** T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2396, rreshti 15 deri në f. 2399, rreshti 13; 104784-104833, f. 104798, 104800.

<sup>245</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2297, rreshti 6 deri në f. 2298, rreshti 22.

takuar".<sup>246</sup> Bazuar në këto kontakte, Trupi Gjykses konstaton se z. Humolli dhe i akuzuari kanë lidhje të ngushta personale që nga koha e themelimit të UÇK-së, të cilat vazhdojnë edhe sot. Kjo konfirmohet gjithashtu edhe nga fotografi të pranuar si prova, ku shihen të dy në takime mes miqsh.<sup>247</sup>

136. Trupi Gjykses gjykon se qëndrimi i njëanshëm kundër procesit gjyqësor para Dhomave të Specializuara, i shprehur fuqimisht dhe publikisht, së bashku me përkrahjen e hapur për të akuzuarin dhe lidhjet personale me të – sikurse u konfirmua në sallën e gjyqit nga vetë z. Humolli – tregojnë tendencën e dëshmitarit për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në. Trupi Gjykses i gjykon njëanshmërinë dhe lidhjet personale të lartpërmendura si faktorë që ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit.

137. Duke mbajtur parasysh të gjitha sa më lart, Trupi Gjykses është treguar tejet i kujdesshëm në vlerësimin e dëshmisë së z. Humolli.

#### F. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I DËSHMITARËVE TË MBROJTJES

138. Në vijim, Trupi Gjykses do të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të dëshmimeve që dhanë në sallën e gjyqit dëshmitarët e Mbrojtjes, përfshirë edhe lidhur me aspektet e besueshmërisë dhe mbështetshmërisë.

#### 1. **Brahim Mehmetaj (WDSM200)**

139. Brahim Mehmetaj ("z. Mehmetaj") dëshmoi para Trupit Gjykses më 23-24 mars 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>248</sup>

---

<sup>246</sup> **Z. Humolli**: T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2355, rreshti 19 deri në f. 2356, rreshti 5.

<sup>247</sup> 104784-104833, f. 104796, 104797, 104802.

<sup>248</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2612-2716; T. 24 mars 2022, publik, f. 2719-2766.

140. Z. Mehmetaj ishte zëvendëskomandant ose ndihmës i të akuzuarit,<sup>249</sup> dhe mernte urdhra përmes të akuzuarit, por edhe nga vetë i akuzuari.<sup>250</sup> Ai gjithashtu konfirmoi se (i) në mars/prill 1999 e thërrisnin “Bimi”;<sup>251</sup> dhe se (ii) ishte në Zllash, në “vendstrehimin që e ka pas guerila BIA” atje në mars/prill 1999.<sup>252</sup> Trupi Gjykses i kushton vëmendjen e duhur faktit se [REDAKTUAR] e identifikoi z. Mehmetaj si personin që ai njihnte si Bimi; se Bimi ishte njëri nga personat [REDAKTUAR] nga kompleksi i ndalimit në Zllash [REDAKTUAR];<sup>253</sup> dhe se në Aktakuzën e Konfirmuar Bimi përmendet si person që pretendohet se mori pjesë në krimet e përfshira në Aktakuzë.<sup>254</sup>

141. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se z. Mehmetaj dëshmoi se e kishte lexuar Aktakuzën e Konfirmuar pas arrestimit dhe transferimit të të akuzuarit në Dhomat e Specializuara.<sup>255</sup> Kjo ndikoi në qëndrimin e mbajtur nga z. Mehmetaj ndaj pyetjeve që iu bënë gjatë dhënies së dëshmisë. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vuri re mungesën e fortë të dëshirës nga z. Mehmetaj për t’iu përgjigjur pyetjeve lidhur me personat që pretendohet se bashkëpunonin kundër UÇK-së dhe me dijeninë e tij për ndalimet në kompleksin e ndalimit në Zllash; ndër to ishin rastet kur dëshmitari u ballafaqua me deklaratat të mëparshme ose kur Kryegjykatësja i kërkoi t’u përgjigjej pyetjeve.<sup>256</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, kjo tregonte synimin e tij të qartë për të distancuar veten dhe të akuzuarin nga çdo problem që kishte lidhje me BIA-n në Zllash, veçanërisht nga veprimet e UÇK-së kundër bashkëpunëtorëve të pretenduar dhe praktikat e

---

<sup>249</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2618, rreshtat 18-20 dhe f. 2666, rreshtat 4-6.

<sup>250</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2665, rreshtat 4-9 dhe f. 2666, rreshtat 7-9, 19-20.

<sup>251</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2662, rreshti 18 deri në f. 2663, rreshti 12.

<sup>252</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2635, rreshtat 9, 11-13, f. 2638, rreshtat 22-23, f. 2640, rreshtat 1-5, f. 2641, rreshtat 23-25 dhe f. 2642, rreshtat 3-25.

<sup>253</sup> [REDAKTUAR].

<sup>254</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 125.

<sup>255</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2700, rreshtat 12-16 dhe f. 2701, rreshti 16 deri në f. 2702, rreshti 3.

<sup>256</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, f. 2677, rreshti 19 deri në f. 2685, rreshti 1.



ndalimit. Një synim i tillë mund të ketë ndikuar gjithashtu edhe në gatishmërinë e tij për t'iu përgjigjur me vërtetësi pyetjeve të caktuara, çka ndikon negativisht në besueshmërinë e përgjithshme të tij si dëshmitar. Për më tepër, deklaratat e z. Mehmetaj nuk përputhen me pranimin që i akuzuari i bëri ZPS-së se kishte dijeni për ushtarë, dhe me gjasë edhe civilë, që u mbajtën të ndaluar në bazën e BIA-s në Zllash.<sup>257</sup>

142. Z. Mehmetaj e konsideron të akuzuarin më shumë se shok.<sup>258</sup> Ai dëshmoi se kishin qenë të afërt me të akuzuarin që nga mosha 18-vjeçare,<sup>259</sup> dhe se së bashku krijuan njësitin BIA më 20 maj 1998, pas liritimit të të akuzuarit nga burgu.<sup>260</sup> Si konfirmim i lidhjes së ngushtë midis tyre, Trupi Gjykses vëren se ndër provat në këtë çështje gjyqësore ka disa fotografi ku z. Mehmetaj dhe i akuzuari shihen bashkë.<sup>261</sup>

143. Dëshmitari gjithashtu konfirmoi se kishte bërë disa postime në *Facebook* në përkrahje të të akuzuarit.<sup>262</sup> Për shembull, kur z. Mustafa u thirr për intervistë nga ZPS-ja, dëshmitari postoi një fotografi në *Facebook* ku ata të dy shihen në aeroportin e Prishtinës, menjëherë para nisjes së z. Mustafa për në Hagë për intervistën e tij me ZPS-në.<sup>263</sup> Në përshkrimin e atij postimi në *Facebook*, z. Mehmetaj shkroi: “paçin turp ata që e kanë ftuar dhe që e kanë gatuar këtë”.<sup>264</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses konstaton se vetëm disa ditë pas arrestimit të të akuzuarit, z. Mehmetaj postoi një fotografi të vetën në *Facebook* i veshur me një bluzë me mëngë të shkurtra, me fytyrën e z. Mustafa në anën e zemrës, në shenjë përkrahjeje, dhe për të shprehur “urrejtjen

---

<sup>257</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 15, rreshtat 7-15.

<sup>258</sup> Z. Mehmetaj: T. 23 mars 2022, publik, f. 2697, rreshtat 14-17.

<sup>259</sup> Z. Mehmetaj: T. 23 mars 2022, publik, f. 2694, rreshti 18.

<sup>260</sup> Z. Mehmetaj: T. 23 mars 2022, f. 2615, rreshtat 7-10.

<sup>261</sup> Z. Mehmetaj: T. 24 mars 2022, publik, f. 2720, rreshti 17 deri në f. 2725, rreshti 11; SPOE00222617-00222617; SPOE00222690-00222690; SPOE00222600-00222600; SPOE00222631-00222631; SPOE00222695-00222695; SPOE00222548-00222548.

<sup>262</sup> Z. Mehmetaj: T. 23 mars 2022, publik, f. 2697, rreshtat 18-20.

<sup>263</sup> Z. Mehmetaj: T. 23 mars 2022, publik, f. 2698, rreshtat 2-22.

<sup>264</sup> Z. Mehmetaj: T. 23 mars 2022, publik, f. 2699, rreshtat 14-16; SPOE00325261-00325261.

ndaj vendorëve që votuan Specialen, duke kryer një shërbim ndaj armikut dhe duke u bërë servilë të disa ndërkombëtarëve”.<sup>265</sup> Po ashtu, një ditë pasi ZPS-ja e thirri edhe atë vetë për intervistë, ai postoi në *Facebook* fletëthirrjen e ZPS-së dhe shkroi: “Do t’i përgjigjem kësaj thirrjeje me krenari edhe pse vazhdoj me mendu që kjo është një gjykatë e padrejtë dhe e njëanshme”.<sup>266</sup> Dëshmitari tha gjithashtu që besonte se ky proces bazohej në deklaratat dhe lajme të rreme<sup>267</sup> dhe se gjykata (duke iu referuar Dhomave të Specializuara) ishte ngritur “kundër shqiptarëve të cilët kanë luftuar për çlirim”.<sup>268</sup> Pas marrjes së fletëthirrjes dhe intervistës me ZPS-në më 23 janar 2020, z. Mehmetaj dëshmoi se bisedoi me të akuzuarin<sup>269</sup> Gjithashtu, z. Mehmetaj konfirmoi se e thirri të akuzuarin në telefon më 22 janar 2020, një ditë para intervistës së tij me ZPS-në.<sup>270</sup> Ata patën edhe një bisedë tjetër telefonike, vetëm pesë minuta pas përfundimit të intervistës së z. Mehmetaj.<sup>271</sup> Trupi Gjykses thekson se dëshmitari tregoi mungesë dëshire që t’u përgjigjej pyetjeve nëse kishte folur me të akuzuarin para dhe/ose pas intervistës së tij me ZPS-në.<sup>272</sup> Dëshmitari u përpoq t’i bënte bisht pyetjes, duke u përgjigjur se kishte qenë gjithmonë i afërt me të akuzuarin.<sup>273</sup>

144. Nga sa më lart, Trupi Gjykses vëren se ekzistojnë lidhje të forta dhe të ngushta midis z. Mehmetaj dhe të akuzuarit, që burojnë nga koha kur ishin bashkë në BIA dhe nga raporti i ngushtë epror-vartës midis tyre. Trupi Gjykses gjykon se këto lidhje

<sup>265</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2702, rreshti 21 deri në f. 2704, rreshti 3; SPOE00325407-00325408, f. 1-2.

<sup>266</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2692, rreshti 16 deri në f. 2693, rreshti 20; SPOE00325248-00325248.

<sup>267</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2698, rreshtat 23-24; f. 2699, rreshti 19 dhe f. 2704, rreshtat 8-10.

<sup>268</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2699, rreshtat 9-10.

<sup>269</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2694, rreshti 15 deri në f. 2695, rreshti 10.

<sup>270</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2696, rreshti 15 deri në f. 2697, rreshti 7; SPOE00325449-00325450.

<sup>271</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2696, rreshti 15 deri në f. 2697, rreshti 7; SPOE00325449-00325450.

<sup>272</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2694, rreshtat 15 deri në f. 2695, rreshti 19. Kryegjykatësja i tërhoqi vërejtje dëshmitarit se duhej t’i përgjigjej pyetjes (f. 2694, rreshti 25 deri në f. 2695, rreshti 1).

<sup>273</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2695, rreshtat 1-19.

vazhdojnë edhe sot, që vërehet qartë në kontaktet e ngushta të z. Mehmetaj me të akuzuarin para dhe pas intervistës së z. Mehmetaj me ZPS-në, si dhe në mosbesimin ndaj proceseve gjyqësore para Dhomave të Specializuara, veçanërisht ndaj procesit kundër të akuzuarit, që z. Mehmetaj e shprehu fuqishëm në rrjetet sociale. Këta faktorë, për mendimin e Trupit Gjyqësor, vënë në dukje një bashkërendim të mundshëm midis tyre për informacionin që do t'i jepej ZPS-së, si dhe tendencën e z. Mehmetaj për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në. Trupi Gjyqësor gjykon se këta faktorë ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Për këtë arsye, vlerësimi i dëshmisë së z. Mehmetaj është bërë me kujdesin më të madh.

## 2. Ahmet Ademi (WDSM300)

145. Ahmet Ademi ("z. Ademi") dëshmoi para Trupit Gjyqësor më 28 mars 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>274</sup>

146. Z. Ademi është i regjistruar në listën e Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së ("Organizata e Veteranëve të Luftës") si kontribues në logjistikën e UÇK-së.<sup>275</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjyqësor vuri re një mungesë të dukshme dëshire nga ana e dëshmitarit për të pranuar anëtarësinë në UÇK dhe në Organizatën e Veteranëve të Luftës, si dhe një synim të qartë për t'u bërë bisht pyetjeve të lidhura me to — në fillim e mohonte një fakt dhe pastaj e pranonte atë pas ballafaqimit me prova që dëshmonin të kundërtën, si për shembull, që emri i tij ishte në listën e Organizatës së Veteranëve të Luftës.<sup>276</sup> Pa iu kërkuar ndonjë informacion për këtë, dëshmitari theksoi se "e kam dash humanizmin", se nuk kishte marrë pjesë në luftë, se nuk përfitonte nga

---

<sup>274</sup> Z. Ademi: T. 28 mars 2022, publik, f. 2776-2860.

<sup>275</sup> Z. Ademi: T. 28 mars 2022, publik, f. 2839, rreshtat 10-15; 105296-105317, f. 105297.

<sup>276</sup> Z. Ademi: T. 28 mars 2022, publik, f. 2841, rreshti 18 deri në f. 2842, rreshti 11; T. 28 mars 2022, publik, f. 2824, rreshtat 11-13; 105296-105296-ET.

Organizata e Veteranëve të Luftës, dhe se nuk kishte qenë në UÇK, por thjesht “u kam shërbyer”.<sup>277</sup> Trupi Gjykses vlerëson se kjo tregon një synim të qartë të dëshmitarit për t’u distancuar nga çdo aspekt që ka lidhje me UÇK-në dhe për të mohuar çfarëdo lidhje me të; kjo qasje në lidhje me UÇK-në mund të ketë ndikuar në gatishmërinë e tij për t’iu përgjigjur me vërtetësi pyetjeve për UÇK-në, gjë që ndikon negativisht në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit.

147. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se z. Ademi ka qenë mjaft aktiv në rrjetet sociale në lidhje me proceset gjyqësore në Dhomat e Specializuara, veçanërisht në lidhje me procesin gjyqësor aktual. Në komentin e tij nën postimin e z. Mehmetaj në *Facebook*, ku shihen z. Mehmetaj dhe i akuzuari në aeroportin e Prishtinës,<sup>278</sup> ai shprehu publikisht përkrahjen e tij për të akuzuarin dhe tha se turpi ishte i atyre që e kishin thirrur për ta marrë në pyetje. Trupi Gjykses vëren se në komentin e z. Ademi nën postimin e z. Mehmetaj thuhej: “respekt komandant Calin”.<sup>279</sup> Z. Ademi bëri koment edhe nën një postim tjetër të z. Mehmetaj në *Facebook*<sup>280</sup> një ditë pasi z. Mehmetaj kishte marrë fletëthirrjen nga ZPS-ja, ku shkruante: “respekt për ju Komandant, me ju Brahim Mehmetaj, Bimi”.<sup>281</sup> Edhe pse për Trupin Gjykses është e qartë - bazuar në këto komente në rrjetet sociale - se z. Ademi e njeh z. Mehmetaj, dëshmitari dëshmoi në sallën e gjyqit se nuk e njohte z. Mehmetaj. Trupi Gjykses konstaton se kjo është qartësisht e pavërtetë dhe një tregues i mëtejshëm i tendencës së dëshmitarit për të

---

<sup>277</sup> **Z. Ademi:** T. 28 mars 2022, publik, f. 2824, rreshtat 11-13; f. 2829, rreshti 15 deri në f. 2830, rreshti 5; f. 2839, rreshtat 2-16; f. 2842, rreshti 12 deri në f. 2843, rreshti 24.

<sup>278</sup> **Z. Ademi:** T. 28 mars 2022, publik, f. 2846, rreshti 17 deri në f. 2847, rreshti 25; SPOE00325261-SPOE00325261.

<sup>279</sup> **Z. Ademi:** T. 28 mars 2022, publik, f. 2849, rreshtat 15-20; SPOE00325274-SPOE00325274 dhe SPOE00325274-SPOE00325274-ET.

<sup>280</sup> SPOE00325284-SPOE00325284-ET. Ky është postimi në *Facebook* ku z. Mehmetaj komentoj për fletëthirrjen që i kishte ardhur për intervistë me ZPS-në.

<sup>281</sup> **Z. Ademi:** T. 28 mars 2022, publik, f. 2850, rreshti 14 deri në f. 2851, rreshti 8; SPOE00325318-SPOE00325318-ET.

fshehur provat në lidhje me UÇK-në dhe më posaçërisht, me BIA-n.<sup>282</sup> Për më tepër, z. Ademi pranoi në sallën e gjyqit që e kishte shpërndarë emblemën e njësitit gueril Skifterat/BIA-s në rrjetet sociale, pasi e kishte postuar z. Mehmetaj.<sup>283</sup> Kjo nxjerr në pah edhe një mospërputhje tjetër me atë që pretendoi dëshmitari gjatë dëshmisë së tij në sallën e gjyqit kur tha: “Çka do me thënë, se unë as kam qenë në ngjarje, as s’e di çka do me thënë. Edhe sot nuk e di çka do me thënë fjala BIA”.<sup>284</sup> Edhe ky element e bën Trupin Gjykses të besojë se z. Ademi kishte synimin që dëshminë e tij para Trupit Gjykses ta përdorte për të fshehur çdo lidhje të mundshme me UÇK-në dhe në veçanti me BIA-n.

148. Trupi Gjykses gjykon se mungesa e dëshirës nga z. Ademi për t’iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me UÇK-në dhe BIA-n, së bashku me përkrahjen aktive që tregoi për z. Mehmetaj dhe të akuzuarin si dy eprorë të BIA-s, tregojnë qartë tendencën e z. Ademi për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në. Trupi Gjykses gjykon se këta faktorë ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Për këtë arsye, vlerësimi i dëshmisë së z. Ademi është bërë me kujdesin më të madh.

### 3. Jakup Ismaili (WDSM400)

149. Jakup Ismaili (“z. Ismaili”) dëshmoi para Trupit Gjykses më 29 mars 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>285</sup>

150. Z. Ismaili deklaroi se kishte qenë ushtar i UÇK-së në njësitin gueril BIA,<sup>286</sup> dhe se është i regjistruar si veteran i luftës në Organizatën e Veteranëve të Luftës.<sup>287</sup>

---

<sup>282</sup> Z. Ademi: T. 28 mars 2022, publik, f. 2844, rreshtat 13-22.

<sup>283</sup> Z. Ademi: T. 28 mars 2022, publik, f. 2852, rreshtat 8-11; 105322-105322.

<sup>284</sup> Z. Ademi: T. 28 mars 2022, publik, f. 2838, rreshtat 3-13.

<sup>285</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2867-2938.

<sup>286</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2906, rreshti 22 deri në f. 2907, rreshti 5.

<sup>287</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2907, rreshtat 15-19, dhe f. 2908, rreshtat 1-2.

151. Dëshmitari takoi për herë të parë të akuzuarin në mars 1999,<sup>288</sup> dhe mbeti në kontakt me të pas luftës.<sup>289</sup> Sipas fjalëve të dëshmitarit, z. Mustafa “është mik”.<sup>290</sup> Për mendimin e Trupit Gjykses, është domethënëse se, kur u ballafaqua me të dhëna të thirrjeve telefonike të nxjerra nga telefoni mobil [REDAKTUAR] të akuzuarit,<sup>291</sup> z. Ismaili konfirmoi se kishte shkëmbyer 138 mesazhe dhe 193 thirrje telefonike me të akuzuarin midis 24 korrikut 2019 dhe 22 shtatorit 2020; nga 15 deri më 23 shtator 2020 ishin bërë gjithsej 27 thirrje telefonike.<sup>292</sup> Gjithashtu, pas arrestimit të të akuzuarit më 25 shtator 2020, dëshmitari pranoi se kishte folur me të çdo javë.<sup>293</sup> Ai dëshmoi se gjatë atyre bisedave kishte shprehur pakënaqësinë e tij për akuzat kundër të akuzuarit.<sup>294</sup> Sipas Trupit Gjykses, kjo tregon për lidhje të forta midis z. Ismaili dhe të akuzuarit, që burojnë nga koha kur ishin në BIA dhe nga raporti epror-vartës midis tyre. Është e qartë që këto lidhje vazhdojnë edhe sot. Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, kjo — së bashku me kontaktet jashtëzakonisht të shumta midis tyre në periudhën para dhe pas arrestimit të të akuzuarit dhe pakënaqësinë e shprehur për akuzat e ngritura kundër të akuzuarit — tregon tendencën e z. Ismaili për të dhënë (vetëm) dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në. Trupi Gjykses gjykon se këta faktorë ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Për këtë arsye, vlerësimi i dëshmisë së z. Ismaili është bërë me kujdesin më të madh.

---

<sup>288</sup> **Z. Ismaili:** T. 29 mars 2022, publik, f. 2888, rreshti 15.

<sup>289</sup> **Z. Ismaili:** T. 29 mars 2022, publik, f. 2923, rreshtat 11-19.

<sup>290</sup> **Z. Ismaili:** T. 29 mars 2022, publik, f. 2923, rreshtat 15-19.

<sup>291</sup> [REDAKTUAR].

<sup>292</sup> **Z. Ismaili:** T. 29 mars 2022, publik, f. 2924, rreshtat 4-25 dhe f. 2925, rreshtat 8-11; SPOE00325590-00325606. Z. Ismaili njohu numrin e vet të telefonit në krye të faqes së parë të raportit të të dhënave telefonike dhe nuk kundërshtoi se numri tjetër i telefonit ishte i të akuzuarit (f. 2924, rreshtat 1-3), i regjistruar në telefon si “Cali”. Sikurse diskutohet dhe konstatohet në pjesë të tjera të Aktgjykimit, “Cali” ishte nofka e të akuzuarit, që edhe vetë i akuzuari e ka pranuar (z. **Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 4, rreshtat 23-25).

<sup>293</sup> **Z. Ismaili:** T. 29 mars 2022, publik, f. 2929, rreshti 24 deri në f. 2930, rreshti 3.

<sup>294</sup> **Z. Ismaili:** T. 29 mars 2022, publik, f. 2930, rreshtat 9-13.

152. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se dëshmitari e theksoi më se një herë se e kishte problem t'i mbante mend datat e sakta pas 23 vjetësh.<sup>295</sup> Si parim i përgjithshëm i zbatueshëm për të gjithë dëshmitarët, Trupi Gjykues merr parasysh se gjërat mund të harrohen me kalimin e kohës. Megjithatë, duke qenë se z. Ismaili u thirr nga Mbrojtja për të dëshmuar veçanërisht për një alibi të mundshme, gjatë vlerësimit të alibisë së të akuzuarit Trupi Gjykues duhet t'i mbajë parasysh vështirësitë sistematike të z. Ismaili për t'i kujtuar datat, sepse ky është një faktor që mund të ndikojë në mbështetshmërinë në dëshminë e dëshmitarit.

#### 4. Hazir Borovci (WDSM500)

153. Hazir Borovci (z. Borovci) dëshmoi para Trupit Gjykues më 30 dhe 31 mars 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>296</sup>

154. Z. Borovci ishte anëtar i UÇK-së në Prishtinë që nga janari 1998, si dhe anëtar i njësitit BIA.<sup>297</sup> Trupi Gjykues vëren se z. Borovci iu përgjigj gjerësisht dhe sinqerisht pyetjeve lidhur me anëtarësinë e tij në UÇK, por mezi e përmendi – vetëm pas pyetjeve këmbëngulëse të ZPS-së – se kishte qenë konkretisht anëtar i njësitit BIA.<sup>298</sup> Një shembull i kësaj mungese dëshire për të folur për BIA-n dhe për lidhjen e tij me të ishte kur z. Borovci, gjatë pyetjeve nga ZPS-ja, u ballafaqua me deklaratën që i kishte dhënë më parë Mbrojtjes, ku kishte deklaruar se nuk kishte “shumë njohuri” për BIA-n.<sup>299</sup> Sidoqoftë, gjatë të njëjtave pyetje nga ZPS-ja, atij iu tregua një fotografi që e kishte

---

<sup>295</sup> **Z. Ismaili:** T. 29 mars 2022, publik, f. 2888, rreshtat 14-18 (“datat e sakta është problem mbas 23 viteve. [...] s’kam shans...është kohë shumë e gjatë edhe kam problem me kujtesën”); f. 2912, rreshtat 9, 19-20 (“kam probleme me kujtesën”); f. 2917, rreshtat 17-18 (“kam probleme shumë me kujtesën”); f. 2923, rreshti 10 (“kam probleme me kujtesën”).

<sup>296</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2950-3047; T. 31 mars 2022, publik, f. 3051-3067.

<sup>297</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2951, rreshtat 20-21; f. 2972, rreshtat 7-10; f. 2973, rreshtat 15-17 dhe f. 2985, rreshti 25 deri në f. 2986, rreshti 18.

<sup>298</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2985, rreshti 25 deri në f. 2986 rreshti 18.

<sup>299</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 3003, rreshti 10 deri në f. 3005, rreshti 7; DSM00570-00570, f. 7-8.



postuar në *Facebook* në vitin 2013, ku shihej z. Borovci me disa shokë, të cilës z. Borovci i kishte bashkëngjitur këtë koment: “gjatë periudhës së luftës në formimin e gueriljes BIA, Skifterët”.<sup>300</sup> Pasi identifikoi në fotografi veten, Gani Sopin (WDSM600) dhe z. Ismaili, z. Borovci mezi pranoi se të gjithë kishin qenë anëtarë të BIA-s, dhe u shpreh konkretisht se “pak para bombardimeve më 24 mars, e kemi kuptuar se do të thotë për gueriljen”; ai në mënyrë të përsëritur theksoi se kishin qenë anëtarë të pjesës së Prishtinës të njësitit gueril BIA.<sup>301</sup> Krahas kësaj, kur iu kërkua të komentonte se kur ishte bërë kjo fotografi, z. Borovci i bëri bisht pyetjes krejtësisht dhe filloi të fliste për disponueshmërinë e uniformave gjatë kohës së luftës, ndërkohë që asnjë nga personat në fotografi nuk ishte me uniformë.<sup>302</sup> Të gjitha këto, për mendimin e Trupit Gjykues, tregojnë mungesën e fortë të dëshirës nga z. Borovci për t’iu përgjigjur me vërtetësi pyetjeve në lidhje me njësitin BIA ose anëtarët e tij, si dhe tendencën e tij për ta distancuar veten nga degët e tjera të BIA-s, me përjashtim të asaj të Prishtinës, çka ndikon në besueshmërinë e dëshmitarit në këtë aspekt.

155. Trupi Gjykues më tej vëren se z. Borovci deklaroi në sallën e gjyqit se është mik i të akuzuarit dhe se të dy i lidhte “puna e përbashkët për lirinë e vendit, na lidhte puna për çlirimin e Kosovës”.<sup>303</sup> Për ta përforcuar këtë frymë shoqërie të shprehur nga dëshmitari në këtë kontekst, në vitin 2013, z. Borovci postoi në *Facebook* një fotografi ku shihet ai me të akuzuarin dhe shokë të tjerë nga UÇK-ja.<sup>304</sup>

156. Gjithashtu, në përgjigje të pyetjes së ZPS-së nëse e konsideron të akuzuarin si mik, dëshmitari dha një përgjigje të zgjeruar – megjithëse nuk iu kërkua – dhe tha:

<sup>300</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2986, rreshti 20 deri në f. 2987, rreshti 18; SPOE00325566-00325566-ET.

<sup>301</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2988, rreshti 2 deri në f. 2992, rreshti 14.

<sup>302</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2993, rreshti 7 deri në f. 2994, rreshti 11.

<sup>303</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 3018 rreshtat 13-18.

<sup>304</sup> SPOE00325564-00325564; **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 3007, rreshti 24 deri në f. 3012, rreshti 17. Në bazë të fotografisë, z. Borovci identifikoi të akuzuarin, Adem Shehun, Fatmir Sopin dhe Jakup Ismailin.

“jam shumë i bindur që [...] Salih Mustafa - ka me u bind edhe gjykata edhe kam besim tek ju – që ka me dalë tërësisht i pafajshëm”.<sup>305</sup> Gjithashtu, z. Borovci konfirmoi se kishte bërë koment nën fotografinë e postuar në *Facebook* nga z. Mehmetaj, ku shihen z. Mehmetaj dhe i akuzuari në aeroportin e Prishtinës para intervistës së të akuzuarit me ZPS-në, në të cilin thuhej: “rrugë të mbarë, i nderuari komandanti Salih Mustafa. Jam i bindur në faqebardhësinë tuaj. Respekt për jetë e mot për të gjithë Çlirimtarët”.<sup>306</sup> Z. Borovci gjithashtu dëshmoi se janë shokë me z. Mehmetaj, pasi janë rritur bashkë dhe janë fqinjë,<sup>307</sup> ndaj edhe takohen shpesh.<sup>308</sup>

157. Po kështu, provat tregojnë për një miqësi dhe marrëdhënie profesionale të ngushtë midis z. Borovci dhe një dëshmitari tjetër të Mbrojtjes, Gani Sopi (“zoti G. Sopi”): të dy njihen me njëri-tjetrin dhe kanë punuar bashkë “prej fëmijërie. Ka mbi 40 vite”.<sup>309</sup> Në lidhje me këtë, sikurse shtjellohet më me hollësi në konstatimet mbi alibinë, Trupi Gjykues vëren se si z. Borovci, ashtu edhe zoti G. Sopi, e ndryshuan - në një mënyrë jashtëzakonisht të ngjashme - datën e nisjes së tyre nga Prishtina për në Butovc, përkatësisht nga 28 marsi 1999 (që kishin deklaruar në deklaratat të mëparshme dhënë Mbrojtjes) në 31 mars 1999 (që e deklaruan para Trupit Gjykues), çka është me rëndësi për vlerësimin e kontaktit të mundshëm të tyre me të akuzuarin në fillim të prillit 1999, nga këndvështrimi i alibisë. Në këtë përshtatje që bëjnë z. Borovci dhe zoti G. Sopi, parë së bashku me ndjenjën e respektit dhe përkrahjes së tyre për të akuzuarin dhe miqësinë e ndërsjellë, Trupi Gjykues vëren gatishmërinë

---

<sup>305</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022, publik, f. 3018 rreshtat 13-24.

<sup>306</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022, publik, f. 3019, rreshti 24 deri në f. 3020, rreshti 23; SPOE00325271-SPOE00325271-ET.

<sup>307</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022, publik, f. 3021, rreshtat 6-10.

<sup>308</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022, publik, f. 3021, rreshti 25 deri në f. 3022, rreshti 2. Z. Borovci konfirmoi se z. Mehmetaj postoi në *Facebook* një fotografi ku shihen të dy bashkë (T. 30 mars 2022, publik, f. 3021, rreshtat 17-22; SPOE00325578-SPOE00325578-ET). Në një postim të z. Mehmetaj është vënë një shënim për z. Borovci, ku thuhet: “Sot u takova me shokun bashkëluftëtarin tim z. Hazir Borovci (SPOE00325578-SPOE00325578-ET)”.

<sup>309</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022, publik, f. 2989, rreshtat 19-24.

e z. Borovci dhe zotit G. Sopi për t'i përshtatur dëshmitë e tyre me dëshmi të dëshmitarëve të tjerë në një mënyrë që është e favorshme për të akuzuarin.

158. Nga sa më lart, Trupi Gjykses dallon respektin e dukshëm që ka z. Borovci për të akuzuarin si komandant i BIA-s dhe, rrjedhimisht, si epror i dëshmitarit gjatë luftës. Trupi Gjykses vëren gjithashtu një ndjenjë të fuqishme miqësie dhe respekti për anëtarët e tjerë të BIA-s, si z. Mehmetaj (zëvendësi i të akuzuarit dhe, rrjedhimisht, edhe epror i z. Borovci gjatë luftës) dhe zoti G. Sopi, të cilët gjithashtu janë dëshmitarë të Mbrojtjes. Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se lidhjet e forta të z. Borovci me të akuzuarin dhe përgjithësisht me anëtarë të BIA-s, të cilat burojnë nga koha e luftës, vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Kjo, nga ana tjetër, është tregues i tendencës së z. Borovci për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në, dhe për ta përshtatur dëshminë e vet me dëshmi të dëshmitarëve të tjerë. Trupi Gjykses i konsideron këta si faktorë që ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Për këtë arsye, vlerësimi i dëshmisë së z. Borovci është bërë me kujdesin më të madh.

## 5. Gani Sopi (WDSM600)

159. Gani Sopi ("zoti G. Sopi") dëshmoi para Trupit Gjykses më 4 prill 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>310</sup>

160. Gjatë gjithë dëshmisë së tij në sallën e gjyqit, dhe ashtu si në rastin e z. Borovci, Trupi Gjykses vërejti mungesën e fortë të dëshirës nga zoti G. Sopi për t'iu përgjigjur pyetjeve për anëtarësinë e pretenduar të tij në njësitë të caktuara të UÇK-së, konkretisht në BIA. Në lidhje me këtë, dëshmitari dëshmoi se kishte qenë ushtar i UÇK-së që nga janari 1998, dhe, pasi fillimisht mohoi se kishte qenë pjesëtar i një

---

<sup>310</sup> Z. G. Sopi: T. 4 prill 2022, publik, f. 3076-3174.

njësiti ose brigade,<sup>311</sup> më pas pranoi se para përfundimit të luftës e kishte “kuptu” se ishte pjesëtar i njësitetit gueril BIA.<sup>312</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, kjo tregon një tendencë të qartë për ta distancuar veten nga çdo gjë që ka lidhje me BIA-n dhe për të mohuar çdo lidhje me të. Trupi Gjykses e konsideron këtë mungesë dëshire si një përpjekje që të mos detyrohej të thoshte se i akuzuari ishte komandanti i tij në kohën kur kishte qenë anëtar i BIA-s.<sup>313</sup>

161. Gjatë pyetjeve të ZPS-së, dëshmitari u ballafaqua me të njëjtën fotografi<sup>314</sup> që iu tregua zotit Borovci në faqen e tij në *Facebook*, ku shihen disa njerëz dhe komenti i z. Borovci: “Gjatë luftës, kur po formohej njësiti gueril i BIA-s, Skifterët”. Zoti G. Sopi e identifikoi veten në fotografi, bashkë me z. Borovci dhe të tjerët.<sup>315</sup> Megjithatë, zoti G. Sopi mohoi fuqimisht se fotografia lidhej me kohën e luftës dhe krijimin e njësitetit BIA, por pranoi se të paktën tre persona<sup>316</sup> ishin të njësitetit BIA, kurse të tjerët “dashamirës që edhe kanë qëlluar në atë rast”.<sup>317</sup>

162. Trupi Gjykses vlerëson se reagimi i zotit G. Sopi ndaj kësaj fotografie konfirmon mungesën e theksuar të dëshirës nga ana e tij për të dhënë informacion të vlefshëm në lidhje me BIA-n dhe anëtarët e saj. Në fakt, nga vlerësimi i dëshmive të z. Borovci dhe z. Sopi së bashku, Trupi Gjykses është bindur se fotografia që iu tregua atyre ka të bëjë qartësisht me njësitetin BIA dhe krijimin e tij gjatë kohës së luftës, bazuar në komentet e z. Borovci për fotografinë e postuar në faqen e tij në *Facebook*, pavarësisht nëse të gjithë personat në atë fotografi ishin anëtarë të BIA-s ose jo. Nga ky

<sup>311</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3136, rreshti 22 deri në f. 3138, rreshti 2.

<sup>312</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3087, rreshtat 7-11; f. 3136, rreshtat 13-15 dhe f. 3139, rreshti 16 deri në f. 3140, rreshti 1.

<sup>313</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3143, rreshti 5 deri në f. 3144, rreshti 8.

<sup>314</sup> SPOE00325566-00325566-ET.

<sup>315</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3149, rreshti 6 deri në f. 3151, rreshti 11; SPOE00325566-00325566-ET.

<sup>316</sup> Vetë z. G. Sopi, Jakup Ismaili dhe Hazir Borovci.

<sup>317</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3151, rreshti 19 deri në f. 3153, rreshti 9.

këndvështrim, dëshmia e zotit G. Sopi se e kuptoi që ishte anëtar i BIA-s vetëm në maj 1999, është krejtësisht e pagjasë.<sup>318</sup> Edhe kjo tregon mungesën e fortë të dëshirës nga zoti G. Sopi për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me njësitin BIA ose anëtarët e tij, çka ndikon negativisht në besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit dhe në dëshminë e tij.

163. Në bazë të provave, Trupi Gjykses gjithashtu kupton se dëshmitari e konsideron z. Mustafa si "bashkëlufëtar" dhe mik, dhe se kanë edhe lidhje familjare, sepse vajza e vëllait të zotit G. Sopi është gruaja e z. Mustafa.<sup>319</sup> Gjithashtu, shtëpia e dëshmitarit nuk është shumë larg nga shtëpia e z. Mustafa.<sup>320</sup> Ata njihen me njëri-tjetrin që nga lirimi i z. Mustafa nga burgu në vitin 1996 ose 1997<sup>321</sup> dhe, sipas dëshmitarit, duke pasur parasysh lidhjet familjare, është e mundur të jenë takuar në festa familjare, si dhe gjatë përvjetorëve dhe kremtimeve të UÇK-së.<sup>322</sup> Trupi Gjykses më tej vëren se kur u pyet nga ZPS-ja nëse ende e ndjen veten të lidhur fort me UÇK-në, zoti G. Sopi deklaroi: "Unë i kam dash të gjithë dhe do t'i dua të gjithë, sa të jem në këtë botë."<sup>323</sup>

164. Sikurse u diskutua më lart në lidhje me z. Borovci, Trupi Gjykses gjykon se përputhshmëria e dëshmimeve të z. Borovci dhe zotit G. Sopi për sa i përket datës së nisjes së tyre nga Prishtina për në Butovc nuk është e rastësishme, por e qëllimshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerëson se kjo tregon gatishmërinë e zotit G. Sopi dhe të z. Borovci për t'i përshtatur dëshmitë e tyre me dëshmi të dëshmitarëve të tjerë në një mënyrë që është e favorshme për të akuzuarin.

165. Në bazë të këtyre faktorëve të marrë së bashku, Trupi Gjykses vëren se zoti G. Sopi qartësisht ka respekt, si personal ashtu edhe profesional, për të akuzuarin si

---

<sup>318</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3140, rreshtat 8-25; f. 3149, rreshti 6 deri në f. 3152, rreshti 20; SPOE00325566-00325566-ET.

<sup>319</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3078, rreshtat 13-16; f. 3128, rreshtat 2-22; f. 3131, rreshtat 4-9.

<sup>320</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3130, rreshtat 4-9.

<sup>321</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3130, rreshtat 10-14.

<sup>322</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3129, rreshtat 7-13.

<sup>323</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3155, rreshtat 4-6.

komandant i BIA-s dhe rrjedhimisht si epror i dëshmitarit, por edhe si i afërm i tij. Gjithashtu, Trupi Gjykses nuk mund të mos e vërë re ndjenjën e fuqishme të miqësisë dhe respektin për anëtarë të tjerë të BIA-s, si z. Borovci, që është gjithashtu dëshmitar i Mbrojtjes. Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se lidhja e fortë e zotit G. Sopi me të akuzuarin dhe me anëtarët e BIA-s në përgjithësi, e krijuar në kohën e konfliktit të armatosur, vazhdon edhe sot. Kjo tregon tendencën e zotit G. Sopi për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në, si dhe për ta përshtatur dëshminë e vet me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Trupi Gjykses vlerëson se këta faktorë ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Për këtë arsye, vlerësimi i dëshmisë së z. Sopi është bërë me kujdesin më të madh.

166. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se dëshmitari konfirmoi deklaratën që i kishte dhënë më parë ZPS-së ku deklaroi se vuante nga harresa për shkak të keqtrajtimit që pretendoi se kishte pësuar kur e rrëmbyen forcat serbe.<sup>324</sup> Gjithashtu, dëshmitari kërkoi që të trajtohej me njëfarë tolerance në lidhje me datat, për shkak të kohës që ka kaluar dhe vështirësive për të mbajtur mend çdo hollësi dhe datë.<sup>325</sup> Trupi Gjykses nënvizon se përgjithësisht pranohet se trauma dhe/ose kalimi i kohës mund të kenë ndikim të madh në saktësinë dhe mbështetshmërinë në kujtesën e një dëshmitari, që, gjithsesi, është në vetvete arsye e mjaftueshme për ta vlerësuar dëshminë e dëshmitarit me kujdesin e duhur. Për sa i përket zotit G. Sopi, Trupi Gjykses vëren se gjatë rimarrjes në pyetje nga Mbrojtja, dëshmitari tha se mbante mend një takim të pretenduar me të akuzuarin nga “fundi i muajit mars i vitit 1999 dhe fillimi i muajit prill të vitit 1999 [...] në Butovc”.<sup>326</sup> Kjo ngjarje do të diskutohet në konstatimet e Trupit Gjykses mbi alibinë e të akuzuarit. Sidoqoftë, meqë zoti G. Sopi u thirr nga Mbrojtja për të dëshmuar në lidhje me alibinë e mundshme, Trupi Gjykses, kur të vlerësojë alibinë e të akuzuarit, duhet të marrë parasysh pranimin e zotit G. Sopi lidhur me

<sup>324</sup> Z. G. Sopi: T. 4 prill 2022, publik, f. 3122, rreshtat 19-24; f. 3124, rreshtat 6-16.

<sup>325</sup> Z. G. Sopi: T. 4 prill 2022, publik, f. 3114, rreshti 23 deri në f. 3115, rreshti 3.

<sup>326</sup> Z. G. Sopi: T. 4 prill 2022, publik, f. 3166, rreshtat 2-11.

harresën dhe vështirësitë për të mbajtur mend datat sepse ky është një faktor që mund të ndikojë në mbështetshmërisë në dëshminë që dëshmitari dha në sallën e gjyqit.

## 6. Bislim Nreci (WDSM700)

167. Bislim Nreci (z. Nreci) dëshmoi para Trupit Gjykses më 5 prill 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>327</sup>

168. Z. Nreci deklaroi hapur se kishte qenë ushtar i UÇK-së dhe se ishte “shumë krenar”.<sup>328</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses vuri re mungesën e dëshirës në përgjithësi nga ana e dëshmitarit për të pranuar lidhjen e tij me BIA-n dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve për këtë temë. Trupi Gjykses rikujton se pyetjes së thjeshtë “a keni qenë pjesëtar i këtij njësitit [BIA]?” që kërkonte përgjigje me “po” ose “jo”, z. Nreci iu përgjigj në një mënyrë të mjegullt dhe të pakuptimtë: “zyrtarisht dhe me dokumentacion, nuk e di”.<sup>329</sup> Trupi Gjykses gjykon se kjo përgjigje është e pagjasë sepse, në qoftë se do të kishte konsultuar me të vërtetë burime dhe dokumente zyrtare, dëshmitari të paktën do ta dinte nëse kishte qenë ose jo anëtar i BIA-s. Në fund, gjatë pyetjeve të Mbrojtjes dhe më pas të ZPS-së, z. Nreci pranoi se kishte qenë pjesëtar i njësitit BIA, edhe pse paralajmëroi se “nuk [...] mund të them kemi qenë ky ose kemi qenë ai, por nuk [e kemi dit] diçka krejt zyrtare[.] [T]ani në fund është që kemi qenë pjesë e gueriljes e kemi dit të gjithë, por e atyre njërive të vogla, e kemi kuptuar mbasi ka mbaruar lufta”.<sup>330</sup> Kjo, për mendimin e Trupit Gjykses, është gjithashtu e pagjasë, sepse dëshmitari duhet ta ketë ditur strukturën së cilës iu bashkua gjatë luftës, personat nga të cilët merrte urdhrat dhe të cilëve u raportonte. Dëshmitari gjithashtu shtoi se, sa i përket domethënies së shkurtesës BIA “e kemi kuptuar fare vonë”.<sup>331</sup>

<sup>327</sup> Z. Nreci: T. 5 prill 2022, publik, f. 3181-3277.

<sup>328</sup> Z. Nreci: T. 5 prill 2022, publik, f. 3182, rreshtat 11-15.

<sup>329</sup> Z. Nreci: T. 5 prill 2022, publik, f. 3219, rreshti 18.

<sup>330</sup> Z. Nreci: T. 5 prill 2022, publik, f. 3219, rreshtat 10-25. *Shih gjithashtu* f. 3247, rreshtat 4-23.

<sup>331</sup> Z. Nreci: T. 5 prill 2022, publik, f. 3247, rreshtat 22-23.



169. Trupi Gjykses vlerëson se ngurrimi i z. Nreci për ta identifikuar veten me BIA-n vë në dukje mungesën e fortë të dëshirës nga ana e tij për t'iu përgjigjur me vërtetësi pyetjeve për njësitin BIA ose anëtarët e tij, çka ndikon në besueshmërinë e dëshmitarit sa i takon kësaj teme. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vëren gjithashtu se dëshmitari ka përcjellë një pjesë të gjyqimit të kësaj çështjeje ku u diskutuan gjerësisht roli dhe aktivitetet e BIA-s, çka mund të ketë ndikuar në qëndrimin e marrë nga z. Nreci gjatë dëshmisë së tij në lidhje me këtë temë.<sup>332</sup> Krahas kësaj, përkrahja që tregoi z. Nreci për të akuzuarin dhe anëtarë të tjerë të BIA-s (edhe ata dëshmitarë të Mbrojtjes), ka pasur gjithashtu ndikim në gatishmërinë e z. Nreci për të pranuar lidhjen me BIA-n dhe për të thënë informacion të vërtetë për të. Në lidhje me këtë pikë, Trupi Gjykses vëren se z. Nreci bëri komentin në vijim nën postimin e z. Mehmetaj në *Facebook*, ku shihet z. Mehmetaj bashkë me të akuzuarin: “respekt i përjetshëm për Çlirimtarët dhe familjet e tyre”.<sup>333</sup> Për më tepër, z. Nreci deklaroi se i kishte ruajtur kontaktet me z. Mustafa, edhe pse nuk ishin takuar pas arrestimit të të akuzuarit.<sup>334</sup>

170. Trupi Gjykses konstaton se marrëdhënia epror-vartës midis z. Nreci dhe të akuzuarit në BIA gjatë luftës, së bashku me dijeninë e tij për dëshmitë e tjera dhe, si rezultat, mungesën e dëshirës nga ana e tij për të pranuar lidhjen me BIA-n apo për të folur për BIA-n, janë tregues të tendencës së z. Nreci për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në, si dhe për ta përshtatur dëshminë e vet me dëshmi të dëshmitarëve të tjerë. Kjo mund të deduktohet nga dëshmia e dëshmitarit të Mbrojtjes Nazmi Vërbovci (WDSM800), i cili dëshmoi në sallën e gjyqit se me z. Nreci “mund që edhe e kena bisedue [çështjen

<sup>332</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3255, rreshti 22 deri në f. 3256, rreshti 6. Në veçanti, dëshmitari përmendi se kishte përcjellë dëshminë e Fatmir Humollit. Trupi Gjykses rikujton se gjatë dëshmisë së z. Humolli, njësitin BIA u përmend afërsisht 20 herë (**z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2292-2372; T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2384-2455).

<sup>333</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3251, rreshti 3 deri në f. 3252, rreshti 9; SPOE00325341-00325341; SPOE00325348-00325348; SPOE00325348-00325348-ET.

<sup>334</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3253, rreshti 12 deri në f. 3254, rreshti 3.

gjqësore të Salih Mustafës], se mund të burgoset një shok i luftës është dhimbje e madhe”.<sup>335</sup> Trupi Gjykues gjykon se këta faktorë ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Për këto arsye, vlerësimi i dëshmisë së e z. Nreci është bërë me kujdesin më të madh.

171. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se, megjithëse dëshmoi se e takoi të akuzuarin dy herë gjatë periudhës mars-prill 1999, z. Nreci tha se nuk mund të ishte i saktë për datat e këtyre takimeve, duke shpjeguar se mund t’i kishte ngatërruar ato sepse “janë mbi 23 vite” dhe se ato data “munden me u ngatërru shumë lehtë”.<sup>336</sup> Duke qenë se z. Nreci u thirr nga Mbrojtja për të dëshmuar për një alibi të mundshme, Trupi Gjykues duhet të marrë parasysh pranimin e tij për harresat dhe vështirësitë në mbajtjen mend të datave, pasi ky është një faktor që mund të ndikojë në mbështetshmërinë në dëshminë e dëshmitarit në sallën e gjyqit.

## 7. Nazmi Vërbovci (WDSM800)

172. Nazmi Vërbovci (z. Vërbovci) dëshmoi para Trupit Gjykues më 6 prill 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>337</sup>

173. Trupi Gjykues vëren se z. Vërbovci dhe z. Nreci njihen me njëri-tjetrin “shumë mirë” që prej fëmijërisë; kanë qenë së bashku në UÇK; ende banojnë në Barilevë;<sup>338</sup> dhe bëjnë “takime të shpeshta miqësore, vëllazërore, si komshi”.<sup>339</sup>

174. Gjatë pyetjeve të ZPS-së, z. Vërbovci pranoi gjithashtu se, pasi i kishte dhënë deklaratën Mbrojtjes, më 21 mars 2021, ai kishte folur me disa ish-anëtarë të UÇK-së, përfshirë z. Nreci, për t’u siguruar se kishte deklaruar datën e saktë (datat e sakta) për

---

<sup>335</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3378, rreshtat 17-22.

<sup>336</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3231, rreshtat 4-5.

<sup>337</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3285-3400.

<sup>338</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3325, rreshtat 5-18.

<sup>339</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3378, rreshti 8.

takimet e pretenduara me të akuzuarin,<sup>340</sup> që ka lidhje me alibinë e të akuzuarit. Konkretisht, në deklaratën e mëparshme dhënë Mbrojtjes, dëshmitari kishte deklaruar se takimi i parë me të akuzuarin në Barilevë kishte ndodhur më 2 ose 3 prill 1999 dhe jo më 1 ose 2 prill 1999 siç deklaroi në sallën e gjyqit para Trupit Gjykues<sup>341</sup> dhe siç iu sugjerua nga personat me të cilët z. Vërbovci foli pasi i kishte dhënë deklaratën Mbrojtjes,<sup>342</sup> të cilët sipas dëshmitarit as nuk ishin të pranishëm në Barilevë atë ditë.<sup>343</sup> Trupi Gjykues vëren se dëshmitari nuk e dha deklaratën e tij në mënyrë të pavarur, por u mor vesh me të tjerë, përfshirë me dëshmitarin e Mbrojtjes, z. Nreci. Kjo e dëmton besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit në sallën e gjyqit dhe përdorimin e saj si provë nga Trupi Gjykues.

175. Dëshmitari shtoi se, me z. Nreci, “mund që edhe e kena bisedue [çështjen e Salih Mustafës], se mund të burgoset një shok i luftës është dhimbje e madhe”.<sup>344</sup> Krahas kësaj, Trupi Gjykues vëren se z. Vërbovci pranoi se kishte përcjellë dëshmitë e “disa” dëshmitarëve, përfshirë të z. Borovci, Bimit (nofka e z. Mehmetaj)<sup>345</sup> dhe z. Humolli.<sup>346</sup> Nga kontaktet e z. Vërbovci me persona të tjerë, përfshirë me z. Nreci (me të cilin dëshmitari deklaroi se ishte shumë i afërt), dhe në bazë të dijenisë së tij për dëshmitë e dhëna nga dëshmitarë të tjerë në këtë çështje gjyqësore, Trupi Gjykues arrin në përfundimin se ka shumë gjasa që një pjesë e madhe e dëshmisë së z. Vërbovci të mos vijë nga kujtimet e atij vetë për ngjarjet. Dëshmitari është përpjekur ta përshtatë dëshminë e tij me atë të dëshmitarëve të tjerë, ose së paku është ndikuar nga persona të tjerë në lidhje me aspekte kyçe të dëshmisë së tij, sidomos për kohën e takimit të pretenduar të tij me të akuzuarin, që ka lidhje me alibinë e paraqitur nga Mbrojtja.

---

<sup>340</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3335, rreshti 16 deri f. 3336, rreshti 21; shih gjithashtu f. 3375, rreshtat 10-23.

<sup>341</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3329, rreshti 22 deri f. 3330, rreshti 11; DSM00076-00089, f. 9.

<sup>342</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3335 rreshti 16 deri f. 3337, rreshti 6; f. 3375, rreshtat 3-7.

<sup>343</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3337, rreshtat 7-23.

<sup>344</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3378, rreshtat 17-22.

<sup>345</sup> **Z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2662, rreshtat 18-21.

<sup>346</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3326, rreshtat 2-19.

Trupi Gjykues gjykon se këta faktorë ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Rrjedhimisht, vlerësimi i dëshmisë së z. Vërbovci është bërë me kujdesin më të madh.

176. Gjithashtu, dhe për të justifikuar se pse u kishte kërkuar këshillë personave të tjerë lidhur me takimin e pretenduar të tij me të akuzuarin, z. Vërbovci shtoi se ai nuk mban “mend shumë, shumë. Mundet njeriu me gabue datat” dhe se “edhe ditët të pshtillen që jo më datat”.<sup>347</sup> Trupi Gjykues është i vetëdijshtë se kujtesa mund të zbehet me kalimin e kohës, por duke qenë se z. Vërbovci u thirr nga Mbrojtja për të dëshmuar për një alibi të mundshme, Trupi Gjykues është i detyruar që, kur të vlerësojë alibinë e të akuzuarit, t’i marrë parasysh vështirësitë e z. Vërbovci në mbajtjen mend të datës (datave) të takimit të pretenduar të tij me të akuzuarin, sepse ky është një faktor që me gjasë dëmton besueshmërinë e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari në sallën e gjyqit.

## 8. Kapllan Parduzi (WDSM900)

177. Kapllan Parduzi (z. Parduzi) dëshmoi para Trupit Gjykues më 11 prill 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>348</sup>

178. Z. Parduzi iu bashkua UÇK-së në maj 1998 dhe e konsideron veten anëtar të UÇK-së “gjer më tani”.<sup>349</sup> Megjithëse dëshmitari u takua rrallë me të akuzuarin pas lufte, ai ka qenë në kontakt me vëllain e të akuzuarit, Arben Mustafën.<sup>350</sup> Z. Parduzi e konsideron Nuredin Ibishin, një tjetër dëshmitar i Mbrojtjes, “ma tepër sesa mik” dhe të dy u takuan 10 deri 14 ditë përpara dëshmisë së z. Parduzi në sallën e gjyqit.<sup>351</sup>

---

<sup>347</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3336, rreshti 22 deri f. 3337, rreshti 2.

<sup>348</sup> **Z. Parduzi:** T. 11 prill 2022, publik, f. 3411-3514.

<sup>349</sup> **Z. Parduzi:** T. 11 prill 2022, publik, f. 3412, rreshtat 19-23.

<sup>350</sup> **Z. Parduzi:** T. 11 prill 2022, publik, f. 3503, rreshti 23 deri f. 3504, rreshti 15.

<sup>351</sup> **Z. Parduzi:** T. 11 prill 2022, publik, f. 3499, rreshtat 4-6, 11-12.

179. Trupi Gjykses vuri re tek z. Parduzi një frymë përgjithësisht armiqësore dhe mungesë dëshire për t'iu përgjigjur pyetjeve të ZPS-së.<sup>352</sup> Z. Parduzi dëshmoi se ai e konsideron arrestimin e të akuzuarit si të “padrejtë” dhe tha se “nuk ka bazë edhe nuk ka fakte. Ne mendojmë që janë të gjitha sajesa edhe me gënjeshtër të dëshmitarëve të rrejshëm dhe të Prokurorisë së Serbisë, që fatkeqësisht ju edhe e keni dekorue. I keni dhënë edhe dekorata atyne bashkëpunëtorëve të tyne. Ata që na kanë vra, na kanë djegë edhe na kanë pjekë. Ju me ta keni bashkëpunue edhe ata i keni dekorue”.<sup>353</sup> Ai tha gjithashtu se ZPS-ja e kishte keqpërdorur gatishmërinë e dëshmitarëve për të bashkëpunuar me Dhomat e Specializuara dhe me ZPS-në.<sup>354</sup>

180. Dëshmitari deklaroi gjithashtu se i kishte ndjekur seancat “pjesërisht”, por bashkëshortja e tij i kishte ndjekur “90 për qind” dhe në mbrëmje diskutonin për dëshmitë e disa dëshmitarëve të Mbrojtjes.<sup>355</sup>

181. Trupi Gjykses mendon se z. Parduzi është tejet i anshëm kundër Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së dhe se deklarata e tij në mbështetje të të akuzuarit së bashku me mungesën e dëshirës për t'iu përgjigjur pyetjeve të ZPS-së (në dallim nga pyetjet

---

<sup>352</sup> *Shih, për shembull, z. Parduzi*: T. 11 prill 2022, publik, f. 3459, rreshtat 13-18 (Kryegjykatësja u detyrua t'i rikujtonte dëshmitarit, i cili deklaroi se nuk e kuptonte se si ZPS-ja po i nxirrte përgjigjet nga konteksti: “të gjithë po përpiqemi të respektojmë njëri-tjetrin. Znj. prokurore po citon nga transkripti ato që keni thënë ju, që zbardhen aty dhe po përpiqet t'i qartësojë.”); f. 3470, rreshtat 4-10 (pyetjes se çfarë plagësh kishte marrë gjatë konfliktit, dëshmitari iu përgjigj me ton sfidues: “Doni me i pa vizualisht, apo veç t'jua përshkruaj?” dhe Kryegjykatësja vërejti se “sigurisht që nuk ju kërkojmë të na i tregoni vizualisht. Thjesht na i përshkruani plagët që kishit marrë”); f. 3473, rreshti 20 deri f. 3474, rreshti 3, (pasi nuk i dha përgjigje një pyetjeje dhe tha se “Unë pyetjen që e bane u përgjigja tash. Nëse keni pyetje tjetër, rrëmo, këtu jam unë”, Kryegjykatësja ndërhyri dhe tha “nuk funksionon kështu [...] Kur bëhet një pyetje, unë ju kërkoj që të jepni përgjigje. Nuk jeni këtu ju për të vendosur se cilës pyetje t'i përgjigjeni apo jo”); f. 3484, rreshtat 18-21 (“Nuk e di sa herë duhet me i shpjegu. A po nëse doni gjithë ditën, unë ta shpjegoj, nuk është problem. Kam tema me fol një javë. Po thjesht unë po përpiqem me qenë sa më shkurt.”).

<sup>353</sup> **Z. Parduzi**: T. 11 prill 2022, publik, f. 3505, rreshtat 3-4; f. 2506, rreshtat 9-13.

<sup>354</sup> **Z. Parduzi**: T. 11 prill 2022, konfidencial, f. 3508, rreshtat 17-24 (dëshmitari u ankua për praktikën e ZPS-së të dërgimit të fletëthirrjeve dhe për mënyrën se si ZPS-ja i trajtonte dëshmitarët, duke thënë se “Nuk jemi njerëz të xhungllës, jemi njerëz që kuptojmë”).

<sup>355</sup> **Z. Parduzi**: T. 11 prill 2022, publik, f. 3505, rreshti 5 deri f. 3506, rreshti 6.

e Mbrojtjes) janë tregues të tendencës së dëshmitarit për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në. Për këtë mund të ketë ndihmuar edhe dijenia e përgjithshme e z. Parduzi për përmbajtjen e dëshmimeve të tjera, sepse ai i ndiqte seancat dhe i diskutonte ato dëshmi me bashkëshorten. Trupi Gjykses i konsideron këta si faktorë që ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Rrjedhimisht, vlerësimi i dëshmisë së z. Parduzi është bërë me kujdesin më të madh.

182. Krahas faktorëve që ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarit, Trupi Gjykses identifikon edhe një problem serioz lidhur me mbështetshmërinë në dëshminë e dhënë nga dëshmitari. Sa i përket dëshmisë për alibinë lidhur me periudhën rreth 10 prillit 1999, z. Parduzi deklaroi se për shkak të plagëve që kishte marrë nga pushkë snajper në të dy shpatullat dhe në kraharor,<sup>356</sup> ai kishte pasur gjakrrjedhje<sup>357</sup> dhe kishte humbur ndjenjat gjatë rrugës për në spitalin e Potokut dhe se iu desh të ndalonin gjatë rrugës, “me pushu edhe me i dhënë ndonjë bar qetësues ose ndonjë infuzionin me e vendosë”.<sup>358</sup> Krahas kësaj, gjatë marrjes në pyetje nga ZPS-ja, z. Parduzi deklaroi se nuk ishte në gjendje të përcaktonte vendin dhe kohën kur, sipas tij, e pa z. Mustafa gjatë transportit mjekësor.<sup>359</sup> Kujtimi i vagullt i dëshmitarit për këtë ngjarje, gjendja e tij shëndetësore, barnat (përfshirë barnat qetësuese) të marra gjatë udhëtimit dhe kushtet e këqija të motit e cenojnë rëndë besueshmërinë e dëshmisë së tij në sallën e gjyqit, gjatë së cilës pretendoi se e kishte parë z. Mustafa rrugës nga Turiqica për Bellopojë apo Rimanishtë. Meqë z. Parduzi u thirr nga Mbrojtja për të dëshmuar për një alibi të mundshme, Trupi Gjykses është i detyruar të mbajë parasysh rrethanat e

---

<sup>356</sup> **Z. Parduzi:** T. 11 prill 2022, publik, f. 3470, rreshtat 10-11.

<sup>357</sup> **Z. Parduzi:** T. 11 prill 2022, publik, f. 3470, rreshtat 13-14.

<sup>358</sup> **Z. Parduzi:** T. 11 prill 2022, publik, f. 3472, rreshtat 17-20.

<sup>359</sup> **Z. Parduzi:** T. 11 prill 2022, publik, f. 3479, rreshtat 11-14; f. 3480, rreshti 6 deri f. 3481, rreshti 13 (pyetjes se kur e kishte parë [të akuzuarin] gjatë atyre ditëve, dëshmitari iu përgjigj: “Prandaj s’ mund të them unë që ka qenë 10, 11 apo 12. Këtë e kam thënë edhe këtë po e them edhe sot. Nuk e di se cila ka qenë data, se s’kam pas kohë të mendoj sa është [...] data”).

transportit mjekësor të këtij dëshmitari, sepse ky është një faktor që me gjasë ndikon ndaj mbështetshmërisë në dëshminë e dhënë nga dëshmitari në sallën e gjyqit.

183. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se pjesa tjetër e dëshmisë së dëshmitarit për alibinë lidhur me fundin e prillit/fillimin e majit 1999 nuk është relevante sepse nuk ka të bëjë me rastet kur pretendohet se i akuzuari ishte i pranishëm në vendin e krimeve, ose thjesht është jashtë kuadrit kohor të akuzave.

## 9. Nuredin Ibishi (WDSM1000)

184. Nuredin Ibishi (z. Ibishi) dëshmoi para Trupit Gjykses më 12 prill 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>360</sup>

185. Trupi Gjykses vërejti një armiqësi të përgjithshme të z. Ibishi në përgjigjet ndaj pyetjeve të ZPS-së dhe një tendencë për t'u bërë bisht përgjigjeve duke shtuar shpjegime jorelevante ose hollësi që nuk iu kërkuan; për këtë u desh që dëshmitarit t'i tërhiqej vëmendja më shumë se një herë.<sup>361</sup>

186. Trupi Gjykses nënvizon gjithashtu se z. Ibishi reagoi me keqardhje për arrestimin e të akzuarit, duke thënë se ishte "i padrejtë" dhe se procesi do të "tregon atë realitetin", dhe shprehu kritika dhe kundërshtimin e tij të fortë ndaj ngritjes së Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së.<sup>362</sup> Qëndrimi i z. Ibishi kundrejt këtij procesi gjyqësor dhe më në përgjithësi kundrejt Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së hedh dyshime të forta mbi gatishmërinë e tij për të dhënë dëshmi që mund ta ndihmojë Trupin Gjykses për përcaktimin e së vërtetës dhe mbi besueshmërinë e dëshmitarit.

---

<sup>360</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3522-3654.

<sup>361</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3581, rreshti 21 deri f. 3582, rreshti 4 (dëshmitari tha se pyetja e ZPS-së ishte "diskriminuese" dhe "ofendim" për të); f. 3602, rreshtat 5-6; f. 3619, rreshti 24 deri f. 3620, rreshti 3 (dëshmitari u orvat t'i shmangej pyetjes së prokurorit duke bërë vetë pyetje, për të treguar që pyetja e bërë ishte e paqartë ose e paplotë).

<sup>362</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3643, rreshti 21 deri f. 3645, rreshti 5.



187. Trupi Gjykues vëren gjithashtu se z. Ibishi i kishte përcjellë seancat e këtij gjykimi, përfshirë dëshmitë e z. Mehmetaj, z. Humolli dhe z. Parduzi (të cilin e konsideron mik).<sup>363</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykues, dijenia për dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e tjerë dhe, rrjedhimisht, për kuadrin e provave kundër të akuzuarit, mund të kenë kontribuar më tej në armiqësinë e përgjithshme të dëshmitarit kundrejt Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, që ai shfaqti gjatë dëshmisë së tij në sallën e gjyqit.

188. Sipas vlerësimit të Trupit Gjykues, armiqësia e dëshmitarit, së bashku me deklarimin e përkrahjes së tij për të akuzuarin dhe kundërshtimin e tij të vendosur ndaj themelimit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, tregojnë se ka gjasë që z. Ibishi kishte tendencën të jepte dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në. Trupi Gjykues i konsideron këta si faktorë që ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Rrjedhimisht, vlerësimi i dëshmisë së z. Ibishi është bërë me kujdesin më të madh.

189. Krahas kësaj, ashtu si z. Parduzi, edhe z. Ibishi ishte plagosur rëndë dhe pas plagosjes iu desh të rrinte i shtrirë në një rimorkio, mbuluar me mushama nën shi.<sup>364</sup> Gjithashtu, z. Ibishi deklaroi se “pjesën jashtë [rimorkios] nuk muj ta shoh”.<sup>365</sup> Kushtet mjekësore dhe të udhëtimit të z. Ibishi, sipas mendimit të Trupit Gjykues, e cenojnë rëndë mbështetshmërinë në kujtesën e z. Ibishi lidhur me këto ngjarje dhe rrjedhimisht ajo duhet marrë me shumë rezervë nga Trupi Gjykues. Nga ana tjetër, z. Ibishi dha të njëjtën dëshmi si në dy deklaratat të mëparshme lidhur me disa aspekte shumë specifike, për shembull, për praninë e Latif Gashit gjatë udhëtimit për në spitalin e

---

<sup>363</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3634, rreshti 2 deri f. 3635, rreshti 13.

<sup>364</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3559, rreshtat 24-25; f. 3582, rreshtat 7-9.

<sup>365</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3562, rreshtat 21-22.

Potokut dhe rolin e tij në mbrojtjen gjatë transportit.<sup>366</sup> Kjo përputhje duhet mbajtur parasysh gjatë vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarit.

## 10. Sheqir Rrahimi (WDSM1100)

190. Sheqir Rrahimi (z. Rrahimi) dëshmoi para Trupit Gjykses më 13 prill 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>367</sup>

191. Dëshmitari ishte anëtar i UÇK-së (Brigada 151).<sup>368</sup>

192. Trupi Gjykses vëren se z. Rrahimi u thirr si dëshmitar i Mbrojtjes në bazë të pjesëmarrjes së pretenduar të tij në transportin mjekësor të z. Parduzi dhe z. Ibishi. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se në dëshminë e tij, z. Rrahimi pretendoi se i akuzuari mund të ketë qenë i pranishëm jo vetëm në një pjesë të kufizuar të udhëtimit (nga Koliqi në Rimanishtë),<sup>369</sup> por edhe në pjesën e fundit të udhëtimit,<sup>370</sup> që ishte pjesa më afër Zllashit. Rrjedhimisht, sipas mendimit të Trupit Gjykses, dëshmia e tij si dëshmitar i drejtpërdrejtë për këtë udhëtim dhe për praninë e pretenduar të të akuzuarit është me rëndësi mjaft të kufizuar sa i takon mbrojtjes së të akuzuarit përmes alibisë.<sup>371</sup> Më tej, kujtesa e z. Rrahimi për numrin e traktorëve në kolonën mjekësore, për vendin dhe kohën kur iu bashkuan dhe u ndanë prej saj, është konfuzë dhe jobindëse. Gjithashtu, edhe kujtesa e z. Rrahimi për “kontaktin” e tij me dikë të quajtur “Cali” është kundërthënëse dhe e vagullt. Për këtë, gjatë pyetjeve të Mbrojtjes, dëshmitari deklaroi se gjatë udhëtimit nga Koliqi në Rimanishtë, kolonës iu bashkuan

---

<sup>366</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3573, rreshti 15 deri f. 3577, rreshti 20. *Shih gjithashtu* DSM00460-00475, f. 8; SPOE00123560-00123574, f. 12.

<sup>367</sup> **Z. Rrahimi:** T. 13 prill 2022, publik, f. 3660-3712.

<sup>368</sup> **Z. Rrahimi:** T. 13 prill 2022, publik, f. 3661, rreshtat 20-23.

<sup>369</sup> **Z. Rrahimi:** T. 13 prill 2022, publik, f. 3666, rreshtat 21-25; f. 3667, rreshtat 15-16.

<sup>370</sup> **Z. Rrahimi:** T. 13 prill 2022, publik, f. 3712, rreshtat 13-19.

<sup>371</sup> Nga harta (DSM00090-00099, f. DSM00099) që u përdor gjatë dëshmisë për të evidentuar fshatrat e ndryshme nëpër të cilat kaloi kolona (Turuçicë, Rakinicë, Bllatë, Kalaticë, Krushevicë, Ballaban, Koliq, Sharban dhe Rimanishtë) kuptohet qartë se pjesa e fundit nga Koliqi në Rimanishtë është më e afërta me Zllashin dhe se distanca është e kufizuar.

dy persona të tjerë dhe dëshmitari dëgjoji njërin prej tyre t'i drejtohej tjetrit me emrin "Cali".<sup>372</sup> Sidoqoftë, z. Rrahimi deklaroi me bindje të plotë se nuk pati asnjë kontakt me këta dy persona<sup>373</sup> dhe se nuk ishte në gjendje ta identifikonte personin e quajtur "Cali" si z. Mustafa.<sup>374</sup> Sidoqoftë, gjatë pyetjeve të ZPS-së, z. Rrahimi e ndryshoi dëshminë dhe deklaroi se personi i quajtur Cali u "ka avitur tu prekolicë" dhe "ka pyetur çka ndodhi".<sup>375</sup> Z. Rrahimi u përpoq ta shpjegonte këtë kundërthënie me kohën që kishte kaluar dhe duke e cilësuar këtë kontakt të pretenduar me personin e quajtur "Cali" si diçka që ai nuk e quante "bisedë".<sup>376</sup> Trupi Gjykses vëren gjithashtu se kushtet në të cilat ndodhi ky kontakt i pretenduar atë ditë, e bënë të vështirë të shihje dhe të dëgjoje, çka bën që përgjithësisht nuk mund të mbështetesh në dëshminë e z. Rrahimi. Konkretisht, në atë kohë po binte shi dhe traktorët i kishin motorët të ndezur,<sup>377</sup> duke e bërë të vështirë, sipas mendimit të Trupit Gjykses, që z. Rrahimi të dëgjonte dhe kuptonte si duhet se çfarë po ndodhte për qark tij. Në përfundim, Trupit Gjykses i duket e pagjasë që z. Rrahimi të ketë qenë në gjendje ta njihje të akuzuarin në ndonjë moment, duke pasur parasysh se edhe vetë dëshmitari tha se në kohën që ka lidhje me akuzat nuk e njihje të akuzuarin me emër apo me nofkën "Cali", e as kishte dëgjuar për të.<sup>378</sup>

193. Trupi Gjykses e konsideron dëshminë e z. Rrahimi kaq të paqartë sa që në thelb është e pamundur të nxirret ndonjë informacion me vlerë prej saj për ta ndihmuar Trupin Gjykses në përcaktimin e së vërtetës. Krahas kësaj, periudha gjatë së cilës pretendohet se z. Rrahimi e pa të akuzuarin dhe kushtet në atë kolonë mjekësore ishin të tilla që e bëjnë mbështetjen në dëshminë e dhënë nga dëshmitari krejt të

---

<sup>372</sup> Z. Rrahimi: T. 13 prill 2022, publik, f. 3667, rreshti 25 deri f. 3668, rreshti 2 dhe f. 3671, rreshtat 3-14.

<sup>373</sup> Z. Rrahimi: T. 13 prill 2022, publik, f. 3667, rreshti 25 deri f. 3668, rreshti 2.

<sup>374</sup> Z. Rrahimi: T. 13 prill 2022, publik, f. 3672, rreshtat 10-15.

<sup>375</sup> Z. Rrahimi: T. 13 prill 2022, publik, f. 3695, rreshti 23 deri f. 3696, rreshti 4.

<sup>376</sup> Z. Rrahimi: T. 13 prill 2022, publik, f. 3697, rreshtat 14-18.

<sup>377</sup> Z. Rrahimi: T. 13 prill 2022, publik, f. 3667, rreshti 4; f. 3694, rreshtat 18-22; f. 3695, rreshtat 2-3.

<sup>378</sup> Z. Rrahimi: T. 13 prill 2022, publik, f. 3676, rreshtat 9-19.

pamundshme. Në këto rrethana, Trupi Gjykses nuk është mbështetur në dëshminë e z. Rrahimi.

## 11. Musli Halimi (WDSM1300)

194. Musli Halimi (z. Halimi) dëshmoi para Trupit Gjykses më 20-21 prill 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>379</sup>

195. Z. Halimi ishte komandant i qendrës stërvitore të rekrutëve të vendosur në shkollën e Zllashit.<sup>380</sup> Për këtë arsye, ai dha informacion lidhur me veprimtaritë dhe programin e stërvitjes, që Trupi Gjykses e konsideron të besueshëm, sepse mund të vinte vetëm nga një person që kishte njohuri të drejtpërdrejtë për qendrën stërvitore. Krahas kësaj, kjo dëshmi konfirmon dëshmitë e W01679-ës, W04669-ës dhe të zotit F. Sopi, dhe mbështet edhe besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve për sa i përket pjesëmarrjes së tyre në stërvitje (W01679 dhe W04669), ose njohurive të tyre për këto stërvitje, në cilësinë e instruktorit të stërvitjes (zoti F. Sopi). Trupi Gjykses ka marrë parasysh një kundërshtim konkret të Mbrojtjes për këtë aspekt, në konstatimin e tij mbi ndalimin arbitrar (Pika 1).<sup>381</sup>

196. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren disa kundërthënje themelore në dëshminë e z. Halimi, që vë në pikëpyetje besueshmërinë e dëshmitarit në lidhje me disa aspekte të stërvitjes që kryhej në atë qendër. Gjatë pyetjeve të Mbrojtjes, z. Halimi deklaroi se askush nuk mund të largohet nga stërvitja, e as nuk mund të merrej, përpara përfundimit të saj, dhe se “çdo rekrut [...] e ka fillu trajnimin e ka mbaru trajnimin”.<sup>382</sup> Z. Halimi e deklaroi këtë me bindje dhe me “plot përgjegjësi”.<sup>383</sup> Megjithatë, z. Halimi

<sup>379</sup> Z. Halimi: T. 20 prill 2022, publik, f. 3719-3822; T. 21 prill 2022, publik, f. 3846-3859.

<sup>380</sup> Z. Halimi: T. 20 prill 2022, publik, f. 3720, rreshti 7; f. 3721, rreshtat 17-19; f. 3727, rreshti 1.

<sup>381</sup> *Shih* para. 380 e në vijim.

<sup>382</sup> Z. Halimi: T. 20 prill 2022, konfidencial, f. 3761, rreshtat 19-20; *shih gjithashtu* f. 3758, rreshtat 4-5.

<sup>383</sup> Z. Halimi: T. 20 prill 2022, konfidencial, f. 3761, rreshti 19.

ra pjesërisht në kundërshtim me veten gjatë pyetjeve të ZPS-së, kur deklaroi se në fakt kishte raste, ndonëse të rralla, kur rekrutët dërgoheshin në shtëpi për shkak të sëmundjes dhe ktheheshin të nesërmen, megjithëse askush nuk u largua nga stërvitja plotësisht.<sup>384</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses, është e pagjasë që të jetë zbatuar një regjim kaq i rreptë për stërvitje që duket se ishte joformale. Krahas kësaj, Trupi Gjykses e konsideron të pagjasë që asnjë rekrut nuk u largua asnjëherë nga stërvitja, duke pasur parasysh kushtet dimërore (përfshirë dëborën) në shkurt dhe mars 1999, lartësinë mbi nivelin e detit të qendrës stërvitore (1200 metra), dhe faktin se nuk ka asnjë informacion nëse rekrutëve u bëhej kontrolli i duhur mjekësor përpara fillimit të stërvitjes.<sup>385</sup> Nga ky këndvështrim, duket se z. Halimi nuk është i besueshëm.

197. Gjithashtu, Trupi Gjykses është i mendimit se z. Halimi nuk ka bazën e duhur të njohurive për të dëshmuar me saktësi për frekuentimin e stërvitjes nga rekrutët në kurset e ndryshme. Në fakt, z. Halimi deklaroi në sallën e gjyqit se e kishte të pamundur t'ua dinte emrin të gjithë rekrutëve<sup>386</sup> dhe se nuk ishte i sigurt “100 për qind” se i raportojë gjithçka.<sup>387</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, kjo është logjike, sepse, siç e pranoi z. Halimi gjatë pyetjeve nga të dy palët, në kurset e ndryshme (që zgjatnin secili nga dy javë) morën pjesë me qindra rekrutë<sup>388</sup> nga fillimi i shkurtit deri në mesin e prillit 1999.<sup>389</sup> Krahas kësaj, fakti se z. Halimi nuk mund të kishte informacion të plotë se kush ishte i pranishëm në stërvitje konfirmohet edhe nga vetë

<sup>384</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3784, rreshtat 16-18.

<sup>385</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3746, rreshtat 16-24; f. 3730, rreshtat 10-14.

<sup>386</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, konfidencial, f. 3756, rreshtat 3-4. Madje gjatë pyetjeve të ZPS-së, dëshmitari deklaroi se i kujtohej vetëm një përqindje e vogël e atyre që vinin për stërvitje dhe nuk i interesonte se kush ishin apo nga vinin ata, por vetëm që të ndiqte planin e tij dhe të kryente detyrat e tij (T. 20 prill 2022, publik, f. 3778, rreshtat 11-15).

<sup>387</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3811, rreshtat 13-16.

<sup>388</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3726, rreshtat 4-5.

<sup>389</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3734, rreshtat 1-2; f. 3741, rreshtat 4-8; f. 3773, rreshti 4 deri f. 3777, rreshti 12. Dëshmitari tha se përveç gjeneratës së parë të pjesëmarrësve në stërvitje — që përbëhej nga rreth 50 persona — grupet e mëpasshme përbëheshin nga rreth 150 rekrutë secili.

dëshmitari, i cili deklaroi se ai merrej vetëm me aspekte që lidheshin me stërvitjen, e asgjë tjetër.<sup>390</sup> Mbi këtë bazë, deklarata e vendosur e z. Halimi “me plot përgjegjësi” se “nuk ka pasë shans dikush të vjen të merr dikënd në qendrën stërvitore”<sup>391</sup> duket e pabazë, sepse ai nuk mund të kishte informacion të plotë për të gjithë rekrutët në stërvitje.

198. Lidhur me një aspekt tjetër, z. Halimi dëshmoi se, gjatë kohës që ishte në Zllash, e takoi të akuzuarin “një herë a dy” “rrugës [për në Zllash]”,<sup>392</sup> por se “s’më ka ra me pyet ose me dit se [i akuzuari] çfarë funksioni ka. Nuk kam qenë një person që [...] kam pas të drejtë të hulumtoj kush është”.<sup>393</sup> Megjithëse e kishte parë të akuzuarin në Zllash, z. Halimi tha se nuk dinte asgjë për njësitin BIA apo se ky njësit kishte një bazë në Zllash<sup>394</sup> dhe shtoi se nuk i interesonte të dinte se “çka ban [i akuzuari atje]”.<sup>395</sup> Sipas Trupit Gjykues është e pagjasë që z. Halimi, si komandant i qendrës stërvitore të Zllashit që qëndroi rreth tre muaj atje, të mos dinte për praninë e BIA-s në Zllash. Trupi Gjykues dallon këtu synimin e qartë të z. Halimi për t’u distancuar nga i akuzuari dhe BIA, si edhe për ta mbrojtur të akuzuarin duke mos dhënë informacion për praninë dhe veprimtarinë e BIA-s në Zllash.

199. Synimi i dëshmitarit për ta distancuar veten nga i akuzuari konfirmohet qartë nga mungesa e dukshme e dëshirës nga ana e tij për të pranuar se i akuzuari kishte numrin e telefonit të tij, e për këtë u desh ndërhyrja e Kryegjykatëses.<sup>396</sup> Në këtë

<sup>390</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3772, rreshtat 12-17.

<sup>391</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3761, rreshtat 17-19.

<sup>392</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3813, rreshtat 1, 19-22.

<sup>393</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3816, rreshtat 3-5.

<sup>394</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3816, rreshtat 11-14.

<sup>395</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3816, rreshti 18.

<sup>396</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3819, rreshti 11 deri f. 3820, rreshti 22 (E përballur me mungesën e dëshirës nga ana e z. Halimi për të evidentuar numrin e telefonit të tij në listën e kontakteve të të akuzuarit që iu tregua në ekran, Kryegjykatësja tha: “a është ky numri juaj i telefonit [...]? [...] E keni të vështirë të thoni që: po, ky është numri im i telefonit? A më kupton?” pas së cilës z. Halimi tha: “Po. Ky është numri im i telefonit.” (f. 3820, rreshtat 14-22)).

aspekt, Trupi Gjykues vëren se kur u pyet për këtë nga ZPS-ja, z. Halimi filloi të justifikohet me forcë dhe u bë shumë armiqësor duke thënë “po e përsëris edhe njëherë, meqë 3-4 herë ma ban të njëjtën pyetje”, dhe shtoi se “edhe me dalë nuk është diçka – është edhe normale. Nuk ka qenë diçka e ndaluar ta kem edhe numrin e tij ose të bisedoj me të”,<sup>397</sup> dhe shumë herë tha se nuk mbante mend.<sup>398</sup>

200. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues mendon se ka gjasë që z. Halimi kishte tendencën të jepte dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në. Trupi Gjykues i konsideron këta si faktorë që ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Rrjedhimisht, vlerësimi i dëshmisë së z. Halimi është bërë me kujdesin më të madh.

## 12. Selatin Krasniqi (WDSM1400)

201. Selatin Krasniqi (z. Krasniqi) dëshmoi para Trupit Gjykues më 21-22 prill 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>399</sup>

202. Z. Krasniqi ishte ushtar i UÇK-së dhe anëtar i BIA-s në periudhën që lidhet me akuzat, mirëpo ai nuk ishte në gjendje të përcaktonte me saktësi se kur ishte bërë anëtar i BIA-s dhe dha një sërë përgjigjesh kundërthënëse, bishtnuese dhe të pagjasa, me gjithë pyetjet e përsëritura të ZPS-së dhe të Trupit Gjykues për këtë aspekt.<sup>400</sup> Lidhur me këtë, Trupi Gjykues vëren mungesën shumë të fortë të dëshirës nga ana e

<sup>397</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3818, rreshtat 13-14; f. 3818, rreshti 24 deri f. 3819, rreshti 1.

<sup>398</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3818, rreshti 24; f. 3819, rreshti 9; f. 3821, rreshtat 2-3.

<sup>399</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3865-4005; T. 22 prill 2022, publik, f. 4011-4049.

<sup>400</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, konfidencial, f. 3953, rreshti 24 deri f. 3957, rreshti 11. Dëshmitari tha, për shembull: “më vonë, po [isha anëtar i BIA-s]” (f. 3953, rreshti 25); “më 17 prill [1999] [...] kam shku me ushtarë të njësisë BIA, kam shku në Viti, në fshatin Marec. Edhe prej atyjit jam mbetë me ta” (f. 3954, rreshtat 2-3); “në dokumenta më shkruajn që në shkurt [1999] jam anëtar i BIA-s” (f. 3954, rreshti 15); “ndoshta dhe kam qenë [anëtar i BIA-s në shkurt 1999]” (f. 3955, rreshti 11).



dëshmitarit për të dhënë ndonjë informacion të njëmendtë për BIA-n, apo për ta lidhur veten me atë njësit.

203. Krahas kësaj, Trupi Gjykses vëren se pyetjes që iu bë në mënyrë të përsëritur nga të dy palët, se kush ishte në krye të bazës së BIA-s në Zllash, z. Krasniqi iu përgjigj duke përmendur shumë emra, por çuditërisht nuk e përmendi asnjëherë emrin e të akuzuarit mes atyre që komandonin.<sup>401</sup> Kur u pyet nga Trupi Gjykses, z. Krasniqi pranoi se i akuzuari ishte komandanti i tij në BIA dhe kishte pushtet mbi anëtarët e BIA-s në Zllash,<sup>402</sup> çka e bën krejt të pabesueshme dhe kundërthënëse mospërmendjen e emrit të të akuzuarit prej tij në fillim. Kjo bie ndesh gjithashtu edhe me dëshminë e vetë të akuzuarit se ai ishte komandant i BIA-s.<sup>403</sup>

204. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se z. Krasniqi kishte lidhje të fortë emocionale me të akuzuarin, siç e ilustron deklarata e tij: “na shokë jemi krejt, deri në vdekje jemi shokë mes vedit”.<sup>404</sup>

205. Ajo që ka rëndësi themelore, sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, është se dëshmitari i përket familjes Krasniqi që e kishte në pronësi objektin<sup>405</sup> ku pretendohet se u kryen krimet për të cilat janë ngritur akuzat dhe supozohet se duhet të ketë dijeni për kompleksin e ndalimit në Zllash dhe për ndërtesat dhe funksionet e ndryshme të tyre, duke pasur parasysh se sa shumë kohë ka qëndruar atje në të kaluarën dhe edhe sot e kësaj dite.<sup>406</sup>

---

<sup>401</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3912, rreshti 21 deri f. 3913, rreshti 2; f. 3988, rreshtat 11-19; f. 3994, rreshti 8 deri f. 3995, rreshti 4.

<sup>402</sup> **Z. Krasniqi:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4047, rreshti 10 deri f. 4048, rreshti 23.

<sup>403</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 31, rreshtat 13-21.

<sup>404</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3974, rreshtat 14-15.

<sup>405</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3866 rreshti 22 deri f. 3867, rreshti 3; f. 3874, rreshtat 5-18; DSM00026.

<sup>406</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3940, rreshtat 17-18 (“Jam shku në pushim tre muj të verës me familje”); T. 22 prill 2022, publik, f. 4022, rreshtat 12-13 (“Unë shkoj atje çdo mëngjes në ora 8.00. [...] Është vendi jem, çdo ditë”); f. 4046, rreshti 6 (“Aty jam rritur. Aty i kaloj pushimet”).

206. Nga një anë, Trupi Gjykses mendon se z. Krasniqi tregoi mungesë të dukshme dëshire për të dhënë dëshmi për BIA-n, veprimtaritë e tij të lidhura me BIA-n, dhe veprimtaritë e BIA-s në kompleksin që ishte pronë e familjes së tij. Nga ky këndvështrim, Trupi Gjykses vëren se z. Krasniqi shkoi edhe më tej dhe deklaroi se pretendimet që kompleksi i shtëpive të familjes ishte përdorur si qendër ndalimi “[neve, si familje] shumë na ka[në] bënë dëm”.<sup>407</sup> Qëndrimi i mbajtur nga dëshmitari në këtë aspekt dhe lidhja e tij e fortë me të akuzuarin e bëjnë Trupin Gjykses të besojë se z. Krasniqi kishte tendencë të theksuar të jepte dëshmi të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në dhe në përgjithësi të mos e implikonte veten në asnjë veprimtari të lidhur me BIA-n.

207. Nga ana tjetër, Trupi Gjykses nuk kishte si të mos vërente dëshminë e hollësishme që dha z. Krasniqi për strukturën e kompleksit që ishte pronë e familjes së tij dhe qëllimin e ndërtesave të ndryshme brenda tij,<sup>408</sup> dhe mospërmendjen prej tij të ndërtesës që ZPS-ja pretendon se ishte vend krimi.<sup>409</sup> Trupi Gjykses dallon një gatishmëri të përgjithshme për ta përshkruar me saktësi pronën e familjes,<sup>410</sup> çka ia rrit besueshmërinë dëshmitarit për disa aspekte të caktuara dëshmisë së tij lidhur me kompleksin e ndërtesave të familjes. Mirëpo, Trupi Gjykses mendon se, në përgjithësi, besueshmëria e dëshmitarit është cenuar rëndë. Rrjedhimisht, vlerësimi i dëshmisë së

<sup>407</sup> **Z. Krasniqi**: T. 21 prill 2022, publik, f. 3912, rreshti 11.

<sup>408</sup> **Z. Krasniqi**: T. 21 prill 2022, publik, f. 3876, rreshti 4 deri f. 3885, rreshti 19.

<sup>409</sup> **Z. Krasniqi**: T. 21 prill 2022, publik, f. 3932, rreshti 23 deri f. 3934, rreshti 18.

<sup>410</sup> Trupi Gjykses vëren gjithashtu se përshkrimi i kompleksit të ndalimit në Zillash përputhet me përshkrimin e bërë nga dëshmitarë të tjerë që kishin qenë atje: **z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2642, rreshtat 11-12 (“Ka qenë një oborr i madh me disa shtëpia kështu përreth”); **z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2048, rreshtat 18-22 (“ka pasë disa shtëpi banimi. [...] ka pasë pleme”). *Shih gjithashtu* REG00-013 — pamje nga Broshura e Fotografive nga Ajri të UNMIK-ut ku shihet kompleksi i shtëpive të familjes, mbi të cilën z. Krasniqi bëri shënime kur shpjegoi kompleksin — që përputhet me pamjen nga Broshura e Fotografive nga Terreni e UNMIK-ut, DSM00028-00028 (shënuar nga dëshmitari me REG00-015) ku tregohet ana e majtë e kompleksit pronë e familjes së tij.

z. Krasniqi është bërë me kujdesin më të madh dhe është kryer vlerësim vetëm i disa aspekteve shumë specifike.

### 13. Muhamet Ajeti (WDSM1500)

208. Muhamet Ajeti (z. Ajeti) dëshmoi para Trupit Gjykses më 22 prill 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>411</sup>

209. Z. Ajeti u bë anëtar i UÇK-së në fund të qershorit/fillim të korrikut 1998, kur ishte 17 vjeç, ndërsa anëtar i BIA-s ishte nga mesi i tetorit 1998 deri në qershor 1999.<sup>412</sup> Gjatë luftës, z. Ajeti thirrej me nofkën “Shyt Mareci”, “Shyt” ose “Shyti”.<sup>413</sup> Ai e njihte të akuzuarin që nga ajo kohë dhe e konsideronte veten “ushtar” të të akuzuarit dhe konfirmoi se i akuzuari ishte vërtet komandant i njësitit BIA.<sup>414</sup> Trupi Gjykses e kupton se z. Ajeti e konsideron të akuzuarin si epror të tij.

210. Dëshmitari dhe i akuzuari janë miq edhe sot.<sup>415</sup> Hera e fundit që u takuan, sipas dëshmitarit, ishte më 28 ose 29 korrik 2020<sup>416</sup> dhe pas kësaj vazhduan të mbanin kontakt çdo javë me *Viber* ose *WhatsApp*.<sup>417</sup> Nga qershori 2019 deri në shtator 2020, ata patën 113 thirrje telefonike me njëri-tjetrin.<sup>418</sup> Dëshmitari dëshmoi se z. Mustafa e quante dëshmitarin “djalë”, ndërsa dëshmitari e quante z. Mustafa “komandant” ose “Babush”, që do të thotë baba.<sup>419</sup>

<sup>411</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4054-4174.

<sup>412</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4056, rreshtat 17-21; f. 4057, rreshti 19; f. 4086, rreshtat 19-20; f. 4096, rreshtat 4-7.

<sup>413</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4087, rreshti 25 deri f. 4088, rreshti 3; f. 4113, rreshti 21 deri f. 4114, rreshti 14; f. 4116, rreshtat 3-7; f. 4118, rreshti 13 deri f. 4119, rreshti 9.

<sup>414</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4086, rreshtat 22-23 dhe f. 4096, rreshti 16.

<sup>415</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4096, rreshti 23 deri f. 4097, rreshti 4.

<sup>416</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4117, rreshtat 19-23.

<sup>417</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4121, rreshtat 3-17.

<sup>418</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4119, rreshtat 10-25; SPOE00325853-00325865, f. 1.

<sup>419</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4122, rreshtat 3-11; SPOE00325865-00325876; SPOE00325865-00325876-ET.

211. Dëshmitari vendosi në profilin e tij në *Facebook* një fotografi të tijën me z. Mustafa në Zllash, në dhjetor 1998.<sup>420</sup> Poshtë fotografisë, komentoi: “Unë ndihem krenar që si 18-vjeçar në luftë kisha një komandat si ti”.<sup>421</sup> Dëshmitari e pranon se me postimin e kësaj fotografie ai dëshironte të tregonte mbështetjen e tij morale për z. Mustafa.<sup>422</sup> Gjatë pyetjeve të ZPS-së, dëshmitari u ballafaqua me fotografi të tjera me z. Mustafa, ndër të cilat një të postuar në *Facebook* ku shihet dëshmitari, z. Mehmetaj, i akuzuari dhe persona të tjerë në një restorant në vitin 2019.<sup>423</sup> Dëshmitari dëshmoi se gjatë luftës e konsideronte z. Mehmetaj shok, megjithëse njiheshin shumë pak, dhe u bënë shokë pas luftës.<sup>424</sup> Rrjedhimisht, për Trupin Gjykses është e qartë se fryma e solidaritetit mes anëtarëve të BIA-s dhe respekti për të akuzuarin si komandant i tyre vazhdon të jetë e fortë, sidomos tek z. Ajeti.

212. Trupi Gjykses vëren se dëshmitari ngurroi t’u përgjigjej pyetjeve nëse njihje anëtarë të caktuar të BIA-s që mbanin poste më të larta më 1999 dhe u orvat t’u bënte bisht pyetjeve të tilla. Vetëm kur, gjatë pyetjeve të ZPS-së, u përball me emrat e anëtarëve të njohur të BIA-s, zëvendëskomandantëve të të akuzuarit — ndër të cilët z. Mehmetaj dhe Bahri Gashi — dëshmitari pranoi se i njihje.<sup>425</sup> Kjo, sipas mendimit të Trupit Gjykses, tregon mungesën e dëshirës nga ana e z. Ajeti për t’iu përgjigjur me vërtetësi pyetjeve për anëtarë të rangut të lartë të njësitit BIA, gjë që ndikon në besueshmërinë e dëshmitarit lidhur me këtë temë.

213. Në bazë të provave të lartpërmendura, Trupi Gjykses mendon se z. Ajeti ka lidhje tejet të ngushta me të akuzuarin, që i kanë rrënjët në raportin e tyre vartës-epror

---

<sup>420</sup> **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4125, rreshtat 10-18; SPOE00325825-00325825-ET.

<sup>421</sup> **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4125, rreshtat 21-22; SPOE00325825-00325825-ET.

<sup>422</sup> **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4126, rreshtat 10-14.

<sup>423</sup> **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4127, rreshti 8 deri f. 4128, rreshti 23; f. 4132, rreshti 23 deri f. 4133, rreshti 13; SPOE00222559-00222559; SPOE00222587-00222587; SPOE0032835-0032835.

<sup>424</sup> **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4101, rreshtat 4-10 deri f. 4102, rreshti 6; SPOE00325827-SPOE00325827-ET.

<sup>425</sup> **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4097, rreshtat 15-23; f. 4098, rreshtat 5-19; f. 4099, rreshti, 9-14; f. 4102, 7-13; f.4104, rreshtat 1-12.

në BIA gjatë kohës së luftës. Është e qartë që këto lidhje vijojnë edhe sot e kësaj dite, siç ilustron nga shkëmbimi i konsiderueshëm i mesazheve mes të dyve dhe fakti se e quajnë njëri-tjetrin “djalë” dhe “babë”, çka tregon qartë për një marrëdhënie thuajse familjare. Të gjitha këto tregojnë, sipas mendimit të Trupit Gjykses, tendencën shumë të fortë të z. Ajeti për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe në mbështetje të BIA-s, dhe të pafavorshme për ZPS-në. Trupi Gjykses i konsideron këta si faktorë që ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitarit. Rrjedhimisht, vlerësimi i dëshmisë së z. Ajeti është bërë me kujdesin më të madh.

#### 14. Teuta Hadri (WDSM1600)

214. Teuta Hadri (znj. Hadri) dëshmoi para Trupit Gjykses më 11-12 maj 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>426</sup>

215. Znj. Hadri nuk ka ndonjë lidhje të veçantë me UÇK-në apo me të akuzuarin. Trupi Gjykses vëren se pretendohet që ajo arriti në Zllash më 16 prill 1999 dhe se qëndroi atje katër ditë, siç tha në përgjigje të pyetjeve të palës thirrëse dhe e konfirmoi gjatë pyetjeve të ZPS-së.<sup>427</sup> Dëshmitarja dëshmoi se qëndroi në kompleksin e ndalimit në Zllash, ku pretendohet se u kryen krimet për të cilët u ngritën akuza.<sup>428</sup> Znj. Hadri dëshmoi gjithashtu se të akuzuarin, të cilin e njohte me pseudonimin “Cali”, e pa për herë të parë një natë para fillimit të ofensivës.<sup>429</sup>

216. Përgjithësisht, Trupi Gjykses vëren se znj. Hadri ka njohuri shumë të kufizuara për zonën e Zllashit dhe për vendin ku qëndroi.<sup>430</sup> Në fakt, gjatë pyetjeve të ZPS-së ajo

<sup>426</sup> Znj. Hadri: T. 11 maj 2022, publik, f. 4181-4283; T. 12 maj 2022, publik, f. 4292-4314.

<sup>427</sup> Znj. Hadri: T. 11 maj 2022, publik, f. 4191, rreshtat 10-20; f. 4255, rreshtat 16-25.

<sup>428</sup> Znj. Hadri: T. 11 maj 2022, publik, f. 4189, rreshtat 7-10; f. 4190, rreshti 7 deri f. 4191, rreshti 3; f. 4195, rreshtat 15 20; DSM00144.

<sup>429</sup> Znj. Hadri: T. 11 maj 2022, publik, f. 4214, rreshtat 9-15.

<sup>430</sup> Znj. Hadri: T. 11 maj 2022, publik, f. 4205, rreshtat 20-25 (pyetjes së Mbrojtjes nëse mund të tregonte më shumë për hapësirën jashtë, dëshmitarja iu përgjigj: “Aty kanë qenë tre-katër shtëpi si ovale dhe nuk mbaj mend diçka tjetër që ka pasë përveç këtyre tre-katër shtëpive”).

pranoi se nuk kishte qenë kurrë atje, nuk kishte dëgjuar kurrë për atë fshat, nuk kishte dalë nga dhoma ku rrinte dhe ishte “[e zënë] me pacienta duke bërë vizita” dhe për rrjedhojë “[nuk kishte] pasë kohë me dalë jashtë me pa”.<sup>431</sup> Në këto rrethana, Trupi Gjykses mendon se znj. Hadri ka njohuri tejet të kufizuara për të dëshmuar për ngjarjet e Zllashit që lidhen me akuzat. Dëshmia e znj. Hadri ku ajo kundërshton<sup>432</sup> pretendimin e ZPS-së se në Zllash mbaheshin të ndaluar individë – që trajtohet në pjesën mbi ndalimin arbitrar (Pika 1) — është marrë parasysh nga Trupi Gjykses, por duke mbajtur parasysh këtë aspekt.

217. Në përgjithësi, Trupi Gjykses e konsideron znj. Hadri përgjithësisht të besueshme, por një pjesë e madhe e dëshmisë së saj në thelb nuk ka lidhje me akuzat ose nuk ka bazën e duhur të njohurive vetjake për t’u përdorur si dëshmi e mbështetshme.

## 15. Ibadete Canolli-Kaçiu (WDSM1700)

218. Ibadete Canolli-Kaçiu (znj. Canolli-Kaçiu) dëshmoi para Trupit Gjykses më 12 maj 2022, pa masa mbrojtëse.<sup>433</sup>

219. Trupi Gjykses vëren se znj. Canolli-Kaçiu dëshmoi se nuk kishte qenë asnjëherë në Zllash para prillit 1999 dhe nuk ishte kthyer më atje që atëherë; ajo nuk ishte në gjendje të bënte një përshkrim real të ndërtesës ku kishte qenë, nuk u kishte kushtuar vëmendje ndërtesave ku kishte qenë, kishte qëndruar më së shumti brenda në dhomë dhe nuk i kishte vizituar ndërtesat e tjera atje, sepse kishte qenë shumë e zënë me

---

<sup>431</sup> **Znj. Hadri:** T. 11 maj 2022, publik, f. 4234, rreshti 19 deri f. 4236, rreshti 2.

<sup>432</sup> *Shih, për shembull, znj. Hadri:* T. 11 maj 2022, publik, f. 4209, rreshtat 12-19.

<sup>433</sup> **Znj. Canolli-Kaçiu:** T. 12 maj 2022, publik, f. 4321-4397.

punë.<sup>434</sup> Në këto kushte, Trupi Gjykues mendon se znj. Canolli-Kaçiu ka njohuri shumë të kufizuara për të dëshmuar për ngjarjet në Zllash që kanë lidhje me akuzat.

220. Trupi Gjykues vëren gjithashtu se znj. Canolli-Kaçiu bënte pjesë në UÇK prej marsit 1998 dhe është e përfshirë në listën e Organizatës së Veteranëve të Luftës.<sup>435</sup> Në fakt, gjatë pyetjeve të ZPS-së, doli se sipas listës së Organizatës së Veteranëve të Luftës ajo ishte anëtare e gueriljes BIA në Prishtinë që prej janarit 1999.<sup>436</sup> Krahas kësaj, ajo ka statusin e veteranes së UÇK-së.<sup>437</sup> Nga janari 1999, ajo kontribuoi dhe ndihmoi në organizim bashkë me z. Mustafa.<sup>438</sup>

221. Sipas vetë fjalëve të saj, dëshmitarja e njëjtte të akuzuarin prej fillimit të vitit 1999 dhe ishte në dijeni se ai kishte post drejtues si komandant i njësitit BIA.<sup>439</sup> Ajo konfirmoi se i akuzuari ishte komandant dhe se ai mund t'i jepte urdhra dhe ajo do t'i zbatonte.<sup>440</sup>

222. Lidhur me fotografinë e postuar nga z. Mehmetaj në *Facebook*, ku shihen z. Mehmetaj dhe i akuzuari në aeroportin e Prishtinës, znj. Canolli-Kaçiu tregoi mbështetjen e saj për z. Mustafa duke vënë figurën e një grushti të shtrënguar si koment në *Facebook*; dëshmitarja shpjegoi se kjo do të thoshte “qëndro i fortë” dhe se dëshironte t'i shprehte mbështetje morale të akuzuarit.<sup>441</sup> Dëshmitarja u ballafaqua edhe me një tjetër fotografi në *Facebook* — e postuar nga z. Mehmetaj — mbi të cilën ajo kishte vënë simbolin e pëlqimit dhe kishte komentuar: “Gjithmonë në shërbim të

<sup>434</sup> Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4324, rreshti 4 deri f. 4326, rreshti 18; f. 4377, rreshtat 7-24; f. 4378, rreshtat 12-15; f. 4379, rreshtat 22-25; f. 4381, rreshtat 2-3, 18-19.

<sup>435</sup> Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4322, rreshti 22 deri f. 4323, rreshti 10; f. 4339, rreshtat 9-17; f. 4340, rreshtat 2-14.

<sup>436</sup> Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4339, rreshtat 9-17 dhe f. 4340, rreshtat 2-11.

<sup>437</sup> Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4340, rreshtat 12-14.

<sup>438</sup> Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4340, rreshtat 18-24.

<sup>439</sup> Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4351, rreshtat 12, 18-20; f. 4354, rreshtat 5-7.

<sup>440</sup> Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4356, rreshtat 2-3.

<sup>441</sup> Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4383, rreshti 3 deri f. 4384, rreshti 7; SPOE00325261-SPOE00325261-ET; SPOE00325266-SPOE00325266.



atdheut, drejtësi për çlirimtarët”; me këtë, dëshmitarja nënkuptonte “përfundimin e këtij procesi gjyqësor në mënyrë sa më të drejtë” dhe dëshironte të përçonte mbështetje morale për të akuzuarin.<sup>442</sup>

223. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjyqësor vlerëson se znj. Canolli-Kaçiu tregoi respekt të qartë dhe të thellë për të akuzuarin si komandant të BIA-s dhe gatishmëri për ta mbështetur atë. Kjo, së bashku me anëtarësinë e saj në BIA, tregon për tendencën e dëshmitares për të dhënë dëshmi përgjithësisht të favorshme për të akuzuarin dhe të pafavorshme për ZPS-në. Trupi Gjyqësor i konsideron këta si faktorë që ndikojnë shumë në besueshmërinë e dëshmitares. Për këtë arsye, vlerësimi i dëshmisë së znj. Canolli-Kaçiu –në pjesët ku nuk është jorelevante apo pa bazën e duhur të njohurive – është bërë me kujdesin më të madh.

G. KOMENTE MBI DISA DOKUMENTE NË TË CILAT ËSHTË MBËSHTETUR TRUPI  
GJYKUES

224. Në këtë çështje gjyqësore përfshihen, mes të tjerash, edhe katër dokumente mbi të cilat Trupi Gjyqësor është mbështetur gjerësisht në të gjithë Aktgjykimin dhe në lidhje me të cilat palëve iu dha mundësia të ngrinin kundërshtime. Megjithatë Trupi Gjyqësor tashmë ka marrë vendim nëse mund të mbështetet në materialin në fjalë për Aktgjykimin, Trupi Gjyqësor e konsideron të përshtatshme të shtjellojë më tej aspekte të veçanta të materialit (si prejardhja, autorësia apo efekti dëmtues), për të plotësuar arsyetimin e tij.

---

<sup>442</sup> Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4384, rreshti 23 deri f. 4385, rreshti 21; 105327-105328-ET; SPOE00325377-SPOE00325377-ET.

## 1. Lista e të Burgosurve (U001-0310-U001-0322-ET)

225. Dokumenti U001-0310-U001-0322-ET (Lista e të Burgosurve), që është pranuar në provat gjyqësore,<sup>443</sup> është një përmbledhje shënimesh me shkrim dore, që përfshihet në një grup më të madh materialesh të marra prej forcave serbe nga baza të ndryshme të UÇK-së në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999, të cilat iu dorëzuan TPNJ-së dhe, më pas, Task Forcës Hetimore Speciale, pararendëses së ZPS-së.<sup>444</sup>

226. Trupi Gjykes vëren fillimisht se në dokument nuk ka nënshkrime, stema apo informacione të tjera të dukshme për autorësinë dhe kohën e tij. Mirëpo, Trupi Gjykes vëren se Lista e të Burgosurve përmban hollësi të shumta që të bëjnë të besosh në autenticitetin dhe mbështetshmërinë në të. Së pari, Trupi Gjykes vëren se Lista e të Burgosurve evidenton saktë të dhënat personale (emër, mbiemër, datëlindje dhe vendlindje) të W01679-ës,<sup>445</sup> W03593-shit,<sup>446</sup> W03594-ës<sup>447</sup> dhe të viktimës së vrasjes së paligjshme,<sup>448</sup> si edhe emrat e plotë të të ndaluarve të tjerë të identifikuar, [REDAKTUAR], përfshirë datën e arrestimit të secilit prej këtyre personave.<sup>449</sup> Në këtë aspekt, Lista e të Burgosurve dhe dëshmitë gojore të dëshmitarëve të lartpërmendur, [REDAKTUAR], janë reciprokisht konfirmuese sa i takon pranisë së secilit prej këtyre

<sup>443</sup> KSC-BC-2020-05, F00369, Trupi Gjykes I, [Decision on items used with witnesses W04484, W04485 and W04849 during their in-court testimony and on evidence collected prior to the establishment of the Specialist Chambers](#) (Vendim mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W04484, W04485 dhe W04849 gjatë Dëshmisë së Tyre në Gjykatë dhe Provat e Mbledhura para Themelimit të Dhomave të Specializuara), 29 mars 2022, publik, me Shtojcën 1, publike, para.21-23, 25(d).

<sup>444</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, poshtëshënimi 547. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00279, Prokurori i Specializuar, [Prosecution notice of disclosure pursuant to Rule 102\(4\)](#) (Njoftim i Prokurorisë për Nxjerrje Materiali sipas Rregullës 102(4)), 7 dhjetor 2021, publik, me shtojcën 1, konfidenciale, para.2-3.

<sup>445</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0310; **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 861, rreshtat 20-25.

<sup>446</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0310; **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 393, rreshtat 21-25.

<sup>447</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0310; **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1032, rreshtat 13-16.

<sup>448</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0310; **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1738, rreshtat 6-7; **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1867, rreshtat 4-6; **W04712**: 077816-TR-ET, Pjesa 1, f. 13, rreshtat 9-13.

<sup>449</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0310; *shih* para. 196.

të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash. Së dyti, në Listën e të Burgosurve janë 19 emra, çka konfirmon dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit, W04669-ës dhe provat e tjera dokumentare, sipas të cilave në prill 1999 në kompleksin e ndalimit në Zllash ndodheshin më shumë se gjashtë të ndaluar.<sup>450</sup> Së treti, Lista e të Burgosurve përmban shënime me shkrim dore që konfirmojnë dëshminë e W03594-ës, sipas të cilit ai u mor në pyetje [REDAKTUAR].<sup>451</sup> Së fundi, Lista e të Burgosurve përmban një shënim “për Calin” që, sikurse ka konstatuar Trupi Gjykses, ishte nofka e të akuzuarit në periudhën që lidhet me akuzat, siç e pranoi edhe vetë z. Mustafa dhe siç është konfirmuar nga burime të shumta.<sup>452</sup>

227. Trupi Gjykses është i mendimit se, pavarësisht nga mungesa e treguesve për autorësinë e Listës së të Burgosurve, shënimet për të dhënat personale të të burgosurve dhe për hollësitë e marrjes në pyetje të tyre mund të jenë bërë vetëm nga persona me dijeni për statusin e këtyre viktimave si të ndaluar. Trupi Gjykses konstaton se Lista e të Burgosurve është dokument i asaj kohe dhe se është tejet e pagjasë që të jetë falsifikuar, apo edhe ndryshuar, pas ngjarjeve. Sipas mendimit të Trupit Gjykses, është po aq e pagjasë që, në këtë kuadër, të ishte rastësi përmendja e nofkës së të akuzuarit (“Cali”).

228. Për këto arsye, Trupi Gjykses është mbështetur në Listën e të Burgosurve.

## 2. Broshurat e Fotografive të UNMIK-ut (SPOE00128386-00128420 dhe SPOE00213459-00213487)

229. Dokumenti SPOE00128386-00128420 (Broshura e Fotografive nga Terreni e UNMIK-ut), që është pranuar në provat gjyqësore,<sup>453</sup> përmban fotografi të bëra nga

---

<sup>450</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0310; *shih* para. 485 e në vijim.

<sup>451</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0313; **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1075, rreshtat 11-12.

<sup>452</sup> *Shih* para. 340; z. **Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 4, rreshtat 23-25.

<sup>453</sup> [Article 37 & Other Material Decision](#) (Vendimi mbi Materialin sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera), para. 26(e).

personeli i UNMIK-ut më [REDAKTUAR] 2006, ku shihen infrastrukturat dhe vendet, ndër të cilat edhe kompleksi i ndalimit në Zllash, sikurse përcaktohet në konstatimet faktike të Trupit Gjykues mbi ndalimin arbitrar (Pika 1).

230. Dokumenti SPOE00213459-00213487 (Broshura e Fotografive nga Ajri e UNMIK-ut), që gjithashtu është pranuar në provat gjyqësore,<sup>454</sup> përmban fotografi ajrore të bëra nga personeli i UNMIK-ut më [REDAKTUAR] 2006, ku duket zona e Zllashit, ndër të tjera edhe kompleksi i ndalimit në Zllash.

231. Të dy dokumentet bëjnë pjesë në dosjen hetimore të UNMIK-ut [REDAKTUAR], lidhur me [REDAKTUAR]. Të dy dokumentet, shqyrtuar së bashku me dëshminë gojore të W04648-ës [REDAKTUAR] janë prova që përforcojnë njëra-tjetrën për këtë pikë të rëndësishme.<sup>455</sup>

232. Trupi Gjykues vëren se Broshura e Fotografive nga Terreni e UNMIK-ut dhe Broshura e Fotografive nga Ajri e UNMIK-ut janë të lidhura me: (i) një memorandum të brendshëm me stemën e UNMIK-ut, emrat e zyrtarëve të përfshirë në hetimin [REDAKTUAR], numrin e çështjes ([REDAKTUAR]) dhe një përmbledhje të fakteve që konfirmojnë dëshmitë e dëshmitarëve [REDAKTUAR];<sup>456</sup> dhe (ii) një kërkesë për mision ajror, me stemën e UNMIK-ut, emrat e të njëjtëve zyrtarë të përfshirë në hetim, koordinatat e zonave për t'u fotografuar, datën dhe fjalët "Kompleks i paraburgimit i UÇK-së në 1999" [REDAKTUAR].<sup>457</sup>

233. Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja nuk kundërshtoi asnjëherë pranueshmërinë as të Broshurës së Fotografive nga Terreni, as të Broshurës së Fotografive nga Ajri të UNMIK-ut, por kundërshtoi përdorimin e Broshurës së Fotografive nga Terreni të

<sup>454</sup> [Article 37 & Other Material Decision](#) (Vendimi mbi Materialin sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera), para. 26(e).

<sup>455</sup> *Shih* **W04648**: SPOE00128333-00128343 (2 shkurt 2002); SPOE00128158-00128162 (4 mars 2003); SPOE00128061-00128064 (18 prill 2006); SPOE00128069-00128086 (29 maj 2006). *Shih gjithashtu* dëshminë konfirmuese të **W04676-ës**: T. 18 nëntor 2021, konfidencial, f. 1708, rreshtat 20-24.

<sup>456</sup> SITF00318201-00318202.

<sup>457</sup> SPOE00128266-00128273 RED3.

UNMIK-ut për identifikim prej dëshmitarëve të ZPS-së në sallën e gjyqit, që do të trajtohet në konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me ndalimin arbitrar (Pika 1).

234. Për këto arsye, Trupi Gjykses është mbështetur në Broshurën e Fotografive nga Ajri të UNMIK-ut dhe në Broshurën e Fotografive nga Terreni të UNMIK-ut.

### 3. Deklarata e të akuzuarit dhënë ZPS-së (069404, Pjesët 1-8)

235. Dokumenti 069404, pjesët 1-8, është deklarata që i akuzuari i ka dhënë ZPS-së, për të cilën Trupi Gjykses ka vendosur ta marrë parasysh në kuadër të kuvendimeve dhe të Aktgjykimit.<sup>458</sup>

236. Trupi Gjykses gjykon se kjo provë është shumë relevante, autentike dhe konfirmuese e provave të tjera, siç do të shpjegohet në konstatimet faktike, në lidhje me: (i) praninë e të akuzuarit në periudhat që kanë lidhje me akuzat në prill 1999 në vendin e krimeve të pretenduara në Zllash; (ii) aftësinë e tij për të shkuar dhe ardhur nga Zllashi, si dhe për të lëvizur nëpër territorin përreth gjatë prillit 1999; (iii) disponueshmërinë e automjeteve të ndryshme, ndër të cilat edhe automjete për terren të vështirë dhe malor; (iv) pronësinë e kompleksit të ndalimit në Zllash ku ishte vendosur baza e BIA-s; dhe (v) pozitën komanduese të të akuzuarit në BIA dhe pushtetin e tij për t'u dhënë urdhra vartësve të tij në BIA, të cilët ata ishin të detyruar t'i zbatonin.

237. Siç e trajton me më shumë hollësi në konstatimet e veta, Trupi Gjykses mendon se në lidhje me pikat e mësipërme i akuzuari ka dhënë vullnetarisht informacione, hollësi dhe shpjegime të konsiderueshme. Megjithëse Trupi Gjykses ka vënë re përpjekje për fshehjen ose minimizimin e dijenisë së tij për shkeljet e mundshme në bazën e BIA-s në Zllash, dëshmia e të akuzuarit mbetet në përgjithësi e besueshme

---

<sup>458</sup> [Article 37 & Other Material Decision](#) (Vendimi mbi Materialin sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera), para.23, 26(f).

dhe e mbështetshme sepse konfirmon një numër të madh dëshmish gojore nga burime të ndryshme (dëshmitarë për krimet dhe dëshmitarë të brendshëm). Trupi Gjykses çmon se është tërësisht e pagjasë që të gjithë këta persona, përfshirë edhe të akuzuarin, të kenë dëshmuar rastësisht në të njëjtën mënyrë.

238. Sa i takon dëmit që mund të shkaktohet nga mbështetja në deklaratën e të akuzuarit dhënë ZPS-së, Trupi Gjykses rikujton se nuk ka konstatuar asnjë shkelje të Ligjit dhe të Rregullores.<sup>459</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses nënvizon se Mbrojtja nuk ka kundërshtuar pranueshmërinë apo përdorimin e kësaj prove. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se nuk vjen asnjë dëm nga përdorimi i deklaratës që i akuzuari i dha ZPS-së në kuadër të aktgjykimit.

239. Për këto arsye, Trupi Gjykses është mbështetur në deklaratën që i akuzuari i dha ZPS-së.

## V. KONSTANTIME FAKTIKE

### A. ALIBIA E PARAQITUR NGA I AKUZUARI

240. Mbrojtja vendosi të paraqiste alibi si pjesë të provave të saj. Në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare, Mbrojtja analizon secilin prej dëshmitarëve të saj dhe dëshmitë e tyre.<sup>460</sup> Në të Mbrojtja argumenton se koha, vendi dhe veprimet e pretenduara të të akuzuarit, të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar, “nuk qëndrojnë”.<sup>461</sup> Disa dëshmitarë, që pretendohet se kishin qenë në vende të tjera dhe jo në Zllash, dëshmuan se e kishin parë ose kishin qenë së bashku me të akuzuarin në kohë të ndryshme nga 1 prilli deri në fund të prillit 1999. Vendet në fjalë janë Butovci,

---

<sup>459</sup> [Article 37 & Other Material Decision](#) (Vendimi mbi Materialin sipas Nenit 37 dhe Materiale të Tjera), para. 22.

<sup>460</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, f. 9.

<sup>461</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, f. 9.

Prishtina, Barileva, Rimanishta dhe Bellopoja. Dëshmitarë të tjerë dhanë dëshmi se gjatë prillit 1999 i akuzuari nuk ishte ose nuk ishte parë në Zllash.

241. Trupi Gjykses rikujton se alibia (kuptimi i drejtpërdrejtë i së cilës është “gjetiu”) është deklarimi i të akuzuarit se ai nuk kishte se si të kryente krimin ose krimet për të cilat akuzohet sepse ishte në një vend tjetër në kohën kur u kryen krimet e pretenduara. Rrjedhimisht, provat e alibisë pritet të tregojnë vendin ose vendet ku ishte i akuzuari, të ndryshme nga vendi i krimit, në kohët përkatëse. Megjithëse është e natyrshme që kalimi i kohës dhe faktorë të tjerë (për shembull, gjendja shëndetësore e dëshmitarëve dhe kushtet e motit apo të udhëtimit në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara) mund të ndikojnë në saktësinë e provave të alibisë, Trupi Gjykses duhet gjithsesi të jetë në gjendje të përcaktojë vendndodhjen e të akuzuarit në një kohë dhe vend të caktuar, në bazë të provave të paraqitura. Me fjalë të tjera, për të përcaktuar nëse provat e alibisë me gjasë mund të krijojnë dyshim të arsyeshëm për provat e paraqitura nga ZPS-ja,<sup>462</sup> Trupi Gjykses nuk mund të lihet të hamendësojë apo të plotësojë zbrazëtitë në prova për të përcaktuar vendndodhjen apo vendndodhjet e mundshme të të akuzuarit në periudhat që lidhen me akuzat.

242. Trupi Gjykses vëren se kur përmendet Zllashi, nënkuptohet kompleksi i ndalimit në Zllash, pra baza e BIA-s ku, sipas ZPS-së, pretendohet se u kryen krimet për të cilat janë ngritur akuzat kundër të akuzuarit.

243. Trupi Gjykses qartëson gjithashtu se alibinë e paraqitur nga i akuzuari do ta shqyrtojë kundrejt pretendimeve të ZPS-së lidhur me praninë e të akuzuarit në vendin e krimit, veçanërisht në dy javët e para të prillit 1999.

244. Trupi Gjykses i ka vlerësuar provat e alibisë në kontekstin e përshkruar më lart. Rrjedhimisht, provat që tregojnë se i akuzuari ishte në një vend tjetër dhe jo në Zllash në çfarëdo kohe tjetër përveç dy javëve të para të prillit 1999, nuk kanë lidhje me

---

<sup>462</sup> *Shih* para. 46.



alibinë dhe Trupi Gjykes nuk i ka diskutuar, ose i ka trajtuar vetëm kalimthi. Po kështu, provat që përgjithësisht sugjerojnë se i akuzuari thjesht nuk ka qenë i pranishëm ose nuk është parë në Zllash në prill 1999 nuk janë prova alibie në kuptimin e ngushtë të fjalës, sepse nuk e ndihmojnë Trupin Gjykes të përcaktojë vendndodhjen e të akuzuarit në periudhat që kanë lidhje me akuzat.

245. Gjatë vlerësimit nëse ekziston mundësi e arsyeshme që alibia e paraqitur nga i akuzuari të jetë e vërtetë,<sup>463</sup> në përputhje me rregullën 139(2) të Rregullores, Trupi Gjykes i ka vlerësuar provat në mënyrë tërësore për sa u përket lëvizjeve të pretenduara të të akuzuarit gjatë kuadrit kohor të Aktakuzës së Konfirmuar. Krahas kësaj, për të vlerësuar alibinë e të akuzuarit, Trupi Gjykes e gjykon të nevojshme t'i vlerësojë dëshmitarët e alibisë në bazë të: (i) deklaratës që i akuzuari i dha ZPS-së gjatë fazës hetimore; dhe (ii) provave lidhur me aftësinë dhe kohën e nevojshme për të lëvizur nëpër territorin përreth Zllashit gjatë prillit 1999.

246. Në deklaratën që i dha ZPS-së, i akuzuari ka dhënë informacion relevant për vendndodhjen/vendndodhjet dhe lëvizjet e tij në kohën e Aktakuzës së Konfirmuar. Trupi Gjykes konsideron se kjo deklaratë është relevante për vlerësimin e përgjithshëm të alibisë.

247. Gjithashtu, siç shtjellohet nga Trupi Gjykes më poshtë, dëshmitarë të ndryshëm dhanë dëshmi që tregonin se njerëzit në përgjithësi, dhe i akuzuari në veçanti, kishin mundësi të lëviznin nëpër atë territor me mjete të ndryshme transporti gjatë periudhës që ka lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar, dhe se distancat midis vendeve të ndryshme që kanë lidhje me këtë çështje gjyqësore ishin relativisht të vogla dhe, rrjedhimisht, mund të përshkoheshin brenda një kohe të arsyeshme. Lidhur me këtë, të gjitha vendet e përmendura nga Mbrojtja, përfshirë Zllashin, janë në Kosovë, pikërisht

---

<sup>463</sup> *Shih për ngjashmëri ICTY, [Popović et al. Appeal Judgement](#), para. 343.*

brenda një zone të kufizuar në verilindje të Prishtinës. Trupi Gjykses është mbështetur në këto prova dhe e ka vlerësuar alibinë nga ky këndvështrim.

## 1. I akuzuari

248. Trupi Gjykses vëren se në deklaratën që i dha ZPS-së, i akuzuari pranoi se përpara se të fillonte ofensiva serbe, më 16 ose 17 prill 1999, ose rreth këtyre datave, gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar, ai ishte në Zllash, konkretisht për 15 deri 20 ditë para asaj kohe “jo standard, por [ka] [...] qenë aty”.<sup>464</sup> I akuzuari më tej deklaroi se “ka mujt që unë në atë objekt [Zllash] kam fjet dy herë, tri herë, nga dy ditë.”<sup>465</sup>

249. I akuzuari pranoi se kur ishte atje, flinte në vendin ku ishte baza, në katin e parë.<sup>466</sup> Në një tjetër pjesë të deklaratës së tij dhënë ZPS-së, i akuzuari deklaroi se në fakt ai u largua nga Zllashi “më 14, ndoshta 13, s’po e di, dy, tre ditë para fillimit të ofensivës”,<sup>467</sup> ose “më 12, 13, [ose] 14.”<sup>468</sup>

250. Në deklaratën e tij dhënë ZPS-së i akuzuari pretendoi se më pas u kthye në Zllash më 20 prill 1999, meqenëse, sipas fjalëve të tij, “më është kërku në radiolidhje me u kthye me i marr të plagosurit dhe me i dërgu në spital.”<sup>469</sup> Sa u takon komunikimeve, Trupi Gjykses vëren se i akuzuari konfirmoi se përdornin edhe telefona satelitorë për të komunikuar informacion.<sup>470</sup> I akuzuari deklaroi se në mëngjesin e 21 prillit 1999, u largua me të plagosurit dhe ushtarët guerilë në drejtim të Zonës Operative të Llapit.<sup>471</sup>

---

<sup>464</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 16, rreshtat 9-15.

<sup>465</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 10, rreshtat 16-21.

<sup>466</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 16, rreshtat 13-15.

<sup>467</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 22, rreshtat 10-11.

<sup>468</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 22, rreshtat 17-18.

<sup>469</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 22, rreshtat 6-8.

<sup>470</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 2, f. 12, rreshtat 13-20; 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 4, f. 6, rreshtat 1-7.

<sup>471</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 23, rreshtat 1-5.

251. Trupi Gjykues gjykon se i akuzuari kishte të gjitha motivet e mundshme për të fshehur ose mohuar praninë e tij në Zllash gjatë prillit 1999, duke qenë se ZPS-ja e pyeti, ndër të tjera, nëse në atë vend ishin mbajtur të ndaluar dhe keqtrajtuar individë. Pavarësisht nga kjo, i akuzuari dha vullnetarisht informacion të konsiderueshëm, sipas të cilit ai ishte i pranishëm në Zllash gjatë një pjese të prillit 1999, një pohim që përputhet me pretendimin e ZPS-së në këtë aspekt. Besueshmëria e të akuzuarit për këtë temë përforcohet më shumë nga fakti se ai aktivisht përmendi disa pika referimi kohore (në veçanti bombardimin e 24 marsit 1999 dhe ofensivën e mëpasshme serbe gjatë gjysmës së dytë të prillit 1999) për të identifikuar më me konkretësi kur ishte dhe nuk ishte në Zllash.

252. Trupi Gjykues nuk gjen asnjë arsye për të vënë në dyshim thelbin e dëshmisë së të akuzuarit lidhur me praninë dhe vajtje-ardhjet e tij në Zllash, që mund të sintetizohet në faktin se ai ishte herë pas here në Zllash gjatë prillit 1999 dhe shkante e vinte nga ai vend në mënyrë të përsëritur. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues është mbështetur në këtë dëshmi.

## **2. Aftësia për të lëvizur nëpër territorin përreth Zllashit**

253. Trupi Gjykues ka marrë prova lidhur me aftësinë e të akuzuarit për të lëvizur në territorin përreth Zllashit gjatë kohës që lidhet me Aktakuzën e Konfirmuar (më 1-19 prill 1999, ose rreth këtyre datave), që, nga ana e tyre, lidhen drejtpërdrejt me vlerësimin e alibisë së të akuzuarit dhe aftësinë e tij për të shkuar në një numër vendesh brenda së njëjtës ditë.

254. Fillimisht, Trupi Gjykues vëren se vetë i akuzuari në deklaratën që i dha ZPS-së, deklaroi se ishte në Zllash gjatë prillit 1999, por jo vazhdimisht, sepse shkante edhe në

Kamenicë, Gjilan dhe Prishtinë,<sup>472</sup> çka nënkupton, sipas mendimit të Trupit Gjykues, se ai mund të shkonte e të vinte në Zllash. I akuzuari deklaroi edhe se mund të kthehej në Zllash kur lindte nevoja, pasi informohej me radiolidhje,<sup>473</sup> çka gjithashtu tregon se i akuzuari kishte mundësinë të shkonte në Zllash brenda një kohe relativisht të shkurtër. Lidhur me këtë, Trupi Gjykues nënvizon se me gjithë afrimin e ofensivës serbe, i akuzuari deklaroi dy herë se më 20 prill 1999 ai u kthye në Zllash për të evakuuar disa të plagosur dhe u largua sërish mëngjesin e 21 prillit 1999 me “xhipa”.<sup>474</sup>

255. Aftësia e të akuzuarit për të shkuar dhe ardhur nga Zllashi gjatë periudhës që ka lidhje me akuzat konfirmohet nga dëshmitarë të tjerë. Z. Nreci dëshmoi para Trupit Gjykues se i akuzuari dhe Jusuf Shalaku kishin në dispozicion një veturë Golf II (të tipit 4x4).<sup>475</sup> Z. Vërbovci konfirmoi në sallën e gjyqit se Jusuf Shalaku kishte vërtet një veturë të tillë.<sup>476</sup> Z. Nreci e përdori atë automjet për t’i çuar të akuzuarin dhe Jusuf Shalakun nga Barileva në Llapashticë.<sup>477</sup> Trupi Gjykues e vlerëson z. Nreci si të besueshëm për këtë temë, në veçanti ngaqë dëshmitari e lidhi këtë ngjarje me ngazëllimin që me sa duket pati se kishte hipur në një Golf të tipit 4x4, çka i kishte dhënë “njëfarë ndjesie” dhe nga kjo “u bënë ushtri e fortë se e kemi këtë automjet”.<sup>478</sup> Z. Nreci dëshmoi gjithashtu, njësoj si në deklaratën e tij të mëparshme, se ishte edhe një tjetër automjet në Radashec, të cilin e përdorte i akuzuari, që ishte më i

---

<sup>472</sup> *Shih, për shembull, z. Mustafa:* 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 10, rreshtat 16-21; f. 12, rreshtat 6-14 (“Unë zakonisht kam lëviz, domethënë, kam qëndru një ditë, dy ditë. Kam shku, për shembull, në Kamenicë, kam shku në Gjilan, jam kthi në Prishtinë. [Në Zllash] s’kam pas qëndrim të përhershëm.”); f. 17, rreshtat 9-12; f. 22, rreshtat 10-18; **z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 12, rreshtat 6-9.

<sup>473</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 22, rreshtat 6-8.

<sup>474</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 22, rreshti 6 deri f. 23, rreshti 6.

<sup>475</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3207, rreshtat 2-4. Në fakt, sipas dëshmitarit, pronari ishte Jusuf Shalaku (f. 3221, rreshtat 6-9).

<sup>476</sup> **Z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3306, rreshti 25 deri f. 3307, rreshti 2.

<sup>477</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3206, rreshti 21 deri f. 3207, rreshti 8; f. 3222, rreshti 24 deri f. 3223, rreshti 3. Llapashtica ndodhet në veri të Barilevës (SPOE00238094).

<sup>478</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3207, rreshti 5; f. 3223, rreshti 3.

përshtatshëm për terrenin nga Radasheci në Zllash.<sup>479</sup> Fakti që i akuzuari kishte mundësi të përdorte dhe përdori automjet, u konfirmua edhe nga z. Humolli.<sup>480</sup> Lidhur me këtë, dëshmitë sipas të cilave i akuzuari ishte rregullisht në lëvizje, u konfirmuan edhe nga dëshmitarë të tjerë.<sup>481</sup>

256. Provat e trajtuara më lart – që tregojnë qartazi se i akuzuari ishte i aftë të lëvizte lirisht nëpër territor – duhen parë gjithashtu në kontekstin e mundësisë që kishin në përgjithësi anëtarët e UÇK-së për të përdorur mjete transporti, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, të distancave relativisht të kufizuara në zonën përreth Zllashit. Për shembull, z. Mehmetaj dëshmoi se anëtarët e njësiteve të ngarkuar me detyrën e marrjes së furnizimeve udhëtonin nga Butovci në Prishtinë me automjetet e tyre, si traktorë apo vetura.<sup>482</sup> Kjo konfirmohet edhe nga dëshmitarë të tjerë, që dëshmuan se njerëzit shkonin në Prishtinë me veturë, traktor, apo edhe në këmbë, për të marrë furnizime.<sup>483</sup> Në lidhje me këtë, z. Krasniqi dëshmoi se gjatë luftës kishte një traktor të cilin e përdorte për të çuar familje nga një vend në tjetrin.<sup>484</sup> Gjatë evakuimit mjekësor të tij, z. Ibishi dëshmoi se nga Rimanishta e tutje ishin transportuar me xhip.<sup>485</sup> Gjithashtu, siç është përcaktuar nga Trupi Gjyqësor në konstatimet faktike mbi ndalimin arbitrar (Pika 1), W04600 transportoi të paktën dy të ndaluar, në dy raste,

<sup>479</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3274, rreshti 13 deri f. 3275, rreshti 6; DSM00056-00067, f. DSM00062.

<sup>480</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2328, rreshti 13.

<sup>481</sup> **Z. Ismaili:** T. 29 mars 2022, publik, f. 2905, rreshtat 16-18 (“më kujtohet kur ka pasë dikun të plagosur, e di që i kanë lëviz. Ka lëviz ku janë të plagosurit. Me pa e kam pa që ka qenë dy-tri herë aty që ka lëviz”); f. 2912, rreshtat 13-18 (dëshmitari dhe i akuzuari shkuan së bashku në Prishtinë për të marrë barna dhe u kthyen në Butovc); **z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2967, rreshtat 22-23; **z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3093, rreshti 9; **z. Vërbovci:** T. 6 prill 2022, publik, f. 3305, rreshtat 5-7, 14-20.

<sup>482</sup> **Z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2629, rreshtat 1-7; T. 24 mars 2022, publik, f. 2742, rreshtat 14-24. **Shih gjithashtu z. Ademi:** T. 28 mars 2022, publik, f. 2789, rreshtat 12-14.

<sup>483</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2971, rreshtat 13-17.

<sup>484</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, konfidencial, f. 3888, rreshtat 16-17.

<sup>485</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3560, rreshtat 1-2, f. 3583, rreshtat 10-17.

[REDAKTUAR].<sup>486</sup> Po kështu, W03593 dhe W03594 u çuan nga [REDAKTUAR] në bazën e BIA-s në Zllash, përkatësisht me një xhip<sup>487</sup> dhe një veturë tip Niva.<sup>488</sup> Gjithashtu edhe W04600 e transportoi [REDAKTUAR] prej fshatit [REDAKTUAR] në bazën e BIA-s në Zllash me një [REDAKTUAR].<sup>489</sup>

257. Me gjithë rreziqet për shkak të pranisë së forcave armike<sup>490</sup> dhe intensifikimin e ofensivës serbe si pasojë e bombardimit nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO),<sup>491</sup> Trupi Gjykues vlerëson se provat në tërësi tregojnë që, gjatë kohës përkatëse, lëvizjet nëpër territorin përreth Zllashit vazhduan, ndër të tjera edhe me automjete të përshtatshme për terrene malore dhe të vështira, si xhipa dhe traktorë.

258. Konstatimi se lëvizjet për në Zllash, prej Zllashit dhe në rrethinë vazhduan gjatë prillit 1999 konfirmohet nga prova të tjera të shumta që tregojnë se distancat midis vendeve të ndryshme në zonën përreth Zllashit ishin të kufizuara, si në kilometra, ashtu edhe në kohë. Trupi Gjykues nuk vë në dyshim besueshmërinë e dëshmitarëve sa u takon distancave dhe kohës së udhëtimit, sepse ata e dhanë këtë informacion në bazë të njohurive vetjake dhe të lëvizjeve të tyre në atë kohë dhe dallimet normale mes dëshmive të tyre janë qartazi rezultat i kujtimeve dhe vlerësimeve të përafërta të secilit dëshmitar.

---

<sup>486</sup> *Shih* para.447, 461.

<sup>487</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 395, rreshti 12; T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 398, rreshtat 6-7.

<sup>488</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1036, rreshtat 11-12.

<sup>489</sup> [REDAKTUAR].

<sup>490</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2629, rreshtat 7-8; **z. Borovci**: T. 30 mars 2022, publik, f. 2970, rreshti 22 deri f. 2971, rreshti 20.

<sup>491</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2093, rreshtat 2-7; **z. Humolli**: T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2423, rreshti 2 deri f. 2424, rreshti 2; f. 2448, rreshtat 1-3; **z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2625, rreshtat 15-18; **z. Ademi**: T. 28 mars 2022, publik, f. 2786, rreshtat 14-16; **z. Ismaili**: T. 29 mars 2022, publik, f. 2874, rreshtat 2-5; **z. G. Sopi**: T. 4 prill 2022, publik, f. 3108, rreshtat 2-12; **z. Ajeti**: T. 22 prill 2022, publik, f. 4055, rreshtat 13-16.

259. Matur në kilometra, për shembull, sipas zotit G. Sopi, distanca midis Butovcit dhe Zllashit është rreth 13 kilometra.<sup>492</sup> Z. Veseli deklaroi se distanca midis Prishtinës dhe fshatit Zllash, që ndodhet në lindje të saj, është “përafërsisht 20 kilometra”,<sup>493</sup> ndërsa distanca midis Zllashit dhe Mramorit (që ndodhet mes Prishtinës dhe Zllashit)<sup>494</sup> është “tre kilometra [...], s’ka ma shumë”.<sup>495</sup> Z. Humolli dëshmoi se distanca midis Prishtinës dhe Barilevës, që ndodhet në veri të saj, “nga rruga e asfaltume është dikun afër 10 kilometra”.<sup>496</sup> Sipas [REDAKTUAR], distanca nga Ugrija deri në bazën e BIA-s në Zllash ishte “nja pesë kilometra, apo dhjetë gati dhe është rruga ka qenë e paasfaltuar”.<sup>497</sup>

260. Për sa i përket kohës, për shembull, z. Krasniqi dëshmoi se shkoi nga Zllashi në Prishtinë vajtje-ardhje brenda ditës, duke u kthyer pasi ra nata.<sup>498</sup> Sipas z. Parduzi, për të shkuar nga Bradashi në Zllash me veturë mund të duhej që nga një orë e gjysmë, deri në njëzet e katër orë, në varësi të “kushteve e rrethanave”.<sup>499</sup> Itinerari Barilevë-Radashec e kthim me traktor merrte një natë.<sup>500</sup> Gjithashtu, sipas z. Ajeti, për të shkuar në këmbë nga Prishtina deri në Zllash duheshin vetëm katër ose pesë orë,<sup>501</sup> që konfirmohet nga W03593, i cili dëshmoi se e bëri më këmbë rrugën nga Zllashi në Prishtinë për “5-6 orë”.<sup>502</sup> Rruga nga Butovci i Poshtëm deri në Prishtinë, sipas zotit G.

<sup>492</sup> Z. G. Sopi: T. 4 prill 2022, publik, f. 3081, rreshti 23 deri f. 3082, rreshti 1.

<sup>493</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2192, rreshti 18.

<sup>494</sup> *Shih, për shembull*, hartën, SPOE00238094.

<sup>495</sup> Z. Veseli: T. 25 janar 2022, publik, f. 2268, rreshti 11. [REDAKTUAR] në përgjithësi konfirmoi distancën e vogël nga Zllashi në Mramor, duke thënë: [REDAKTUAR]. Megjithëse nuk pret që dëshmitarët të japin distancat e sakta, Trupi Gjykues vëren se vlerësimet e përafërta, për shembull, të z. Veseli dhe [REDAKTUAR] nuk dallojnë shumë dhe tregojnë se distanca midis Zllashit dhe Mramorit ishte e kufizuar.

<sup>496</sup> Z. Humolli: T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2311, rreshti 4.

<sup>497</sup> [REDAKTUAR].

<sup>498</sup> Z. Krasniqi: T. 22 prill 2022, publik, f. 4041, rreshtat 4-14.

<sup>499</sup> Z. Parduzi: T. 11 prill 2022, publik, f. 3422, rreshti 4 deri f. 3423, rreshti 10.

<sup>500</sup> Z. Nreci: T. 5 prill 2022, publik, f. 3275, rreshtat 14-18.

<sup>501</sup> Z. Ajeti: T. 22 prill 2022, publik, f. 4058, rreshtat 6-8.

<sup>502</sup> W03593: T. 21 shtator 2021, publik, f. 557, rreshtat 19-20.



Sopi mund të bëhej më këmbë, në kushte normale, edhe për “një orë, një orë e 20 minuta”, por mund të zgjaste më shumë “varësisht prej rrethanave [...] që kanë qenë” për shkak të pozicioneve të armikut.<sup>503</sup> Sipas [REDAKTUAR], u desh rreth “një orë gati, po, gjysmë ore” në rrugë të pashtuar për ta çuar nga [REDAKTUAR]<sup>504</sup> në bazën e BIA-s në Zllash.<sup>505</sup> Z. Halimi dëshmoi se nga 7 deri më 10 prill 1999 kishte shkuar çdo ditë më këmbë nga qendra stërvitore e Zllashit deri në Prapashticë (rreth 10 kilometra larg),<sup>506</sup> çka tregon se as në atë drejtim (në verilindje të Zllashit) nuk kishte pengesa për të lëvizur.

261. Trupi Gjykses vlerëson se është disi e vështirë që të përcaktohen në bazë të dëshmive kohët e sakta të udhëtimit midis vendeve të ndryshme, sepse këto vareshin plotësisht nga rrethanat konkrete në kohën e çdo udhëtimit. Mirëpo, të marra në tërësi, provat vërtetojnë se distancat midis vendeve përkatëse në zonën përreth Zllashit ishin relativisht të vogla dhe se njerëzit në përgjithësi, dhe i akuzuari në veçanti, mund të lëviznin dhe faktikisht lëviznin rregullisht nëpër territor gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se gjatë kohës që ka lidhje me akuzat, i akuzuari kishte aftësinë të shkonte dhe vinte nga Zllashi sa herë të ishte e nevojshme. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vëren gjithashtu se Zllashi dhe fshatrat përreth tij shiheshin si zonë relativisht e sigurt, ku kishte prani të kufizuar të forcave serbe.<sup>507</sup> Rrjedhimisht, lëvizja nëpër zonë nuk ishte shumë e vështirë, sidomos për dikë me njohuritë dhe përvojën e të akuzuarit. Trupi Gjykses vëren edhe se të

<sup>503</sup> Z. G. Sopi: T. 4 prill 2022, publik, f. 3082, rreshtat 6-7. Sipas dëshmitarit, rrethanat vareshin nga pozicionet e armikut përgjatë rrugës. (f. 3082, rreshti 8-10).

<sup>504</sup> [REDAKTUAR].

<sup>505</sup> [REDAKTUAR].

<sup>506</sup> Z. Halimi: T. 20 prill 2022, publik, f. 3803, rreshti 10 deri f. 3805, rreshti 8; *shih gjithashtu hartën SPOE00238094 për të përcaktuar vendndodhjen e Prapashticës në raport me Zllashin.*

<sup>507</sup> Z. Mehmetaj: T. 23 mars 2022, publik, f. 2641, rreshti 23 deri f. 2642, rreshti 9; z. F. Sopi: T. 19 janar 2022, publik, f. 2172, rreshti 13 deri f. 2173, rreshti 4; 069474-TR-ET, Part 2, f. 20, rreshtat 13-16; z. G. Sopi: T. 4 prill 2022, publik, f. 3082, rreshtat 6-10 (dëshmitari përcaktoi se segmenti i vështirë, për shkak të pozicioneve të armikut, ishte ai Prishtinë-Butovc dhe jo Zllashi).

akuzuarit i ishte kërkuar të transportonte njerëz dhe mallra në atë zonë,<sup>508</sup> çka tregon se ishte i aftë të lëvizte me lehtësi në atë rajon, të cilin e njihte shumë mirë.

262. Rrjedhimisht, alibia e paraqitur nga i akuzuari do të vlerësohet duke mbajtur parasysh: (i) aftësinë në përgjithësi, përfshirë aftësinë e të akuzuarit, për të lëvizur nëpër territorin përreth Zllashit; dhe (ii) distancat relativisht të kufizuara ndërmjet vendeve në zonën përreth Zllashit dhe Prishtinës.

### 3. Prania e të akuzuarit në Butovc

#### (a) Z. Mehmetaj

263. Z. Mehmetaj dëshmoi se u takua me të akuzuarin në Butovc, në vendin ku ishin vendosur guerilasit e BIA-s. Gjatë këtij takimi, i akuzuari i kërkoj dëshmitarit të mbante lart moralin e ushtarëve dhe të vrojtonte lëvizjet e forcave serbe.<sup>509</sup> Z. Mehmetaj fillimisht deklaroi se ky takim u bë në “2-3 ditët e para të muajit prill [1999]” kur u kthye nga Prishtina në Butovc,<sup>510</sup> por pastaj sqaroi: “më 31 mars [1999] jam kthyer në Prishtinë, atje kam qëndruar 2-3 ditë. Besoj më datën, mund të ketë qenë 3, 4, 5 deri nga data 7, kam qëndruar në Butovc. Në këtë periudhë kam qëndruar shpesh herë me Calin”.<sup>511</sup> Sipas dëshmitarit, i akuzuari fjeti në Butovc dhe ata ishin aty bashkë për dy net.<sup>512</sup>

<sup>508</sup> **Z. Ismaili:** T. 29 mars 2022, publik, f. 2905, rreshtat 16-18 (“më kujtohet kur ka pasë dikun të plagosur, e di që i kanë lëviz. Ka lëviz ku janë të plagosurit. Me pa e kam pa që ka qenë dy-tri herë aty, që ka lëviz”); f. 2912, rreshtat 13-18 (dëshmitari dhe i akuzuari shkuan së bashku në Prishtinë për të marrë barna dhe u kthyen në Butovc); **z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2967, rreshtat 22-23 (ku flet për rastet kur i akuzuari shkonte “në qytet me marrë ushqim”).

<sup>509</sup> **Z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2631, rreshti 22 deri f. 2632, rreshti 16; f. 2632, rreshti 22 deri f. 2633, rreshti 9.

<sup>510</sup> **Z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2631, rreshtat 22-23; f. 2633, rreshtat 1-3.

<sup>511</sup> **Z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2633, rreshtat 1-3.

<sup>512</sup> **Z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2633, rreshtat 10-12.

(b) Z. Ismaili

264. Z. Ismaili dëshmoi se e kishte takuar të akuzuarin për herë të parë në Butovc, rreth datave 27, 28 ose 29 mars 1999.<sup>513</sup> Megjithatë, dëshmitari shpjegoi se datat mund të mos jenë të sakta pas 23 vjetësh, për shkak të problemeve me kujtesën dhe, në përgjithësi, të vështirësive që ka për t'i kujtuar gjërat.<sup>514</sup> Ky takim i parë i dëshmitarit me të akuzuarin ndodhi, sipas z. Ismaili, në shtëpinë e kushëririt të Sabit Krasniqit, në Butovc.<sup>515</sup> Në atë rast, z. Ismaili deklaroi se nuk pati asnjë kontakt të drejtpërdrejtë me të akuzuarin.<sup>516</sup>

265. Sipas dëshmitarit, një takim i dytë ndodhi "[nga] fillimi i prillit 7, 8 fillimi i prillit [1999]. Që prej takimit që unë [z. Ismaili] s'kam marrë pjesë, në takimin e dytë ka shku shtatë-tetë ditë [...] mbas 7-8 ditëve".<sup>517</sup> Dëshmitari dhe i akuzuari u takuan në një pikë strategjike ku dëshmitari vëzhgonte lëvizjet e forcave serbe.<sup>518</sup> Siç e tha vetë dëshmitari "zyrtarisht aty jam taku [me z. Mustafa]".<sup>519</sup> Z. Ismaili deklaroi se diskutuan për planet strategjike se si ta furnizonin popullatën civile për deri në shtatë orë.<sup>520</sup>

266. Dëshmitari dëshmoi gjithashtu se në ditët në vijim, e pa të akuzuarin në shtëpinë e Mustafë Sopit, dhe ndonjëherë në terren, aty ku ishin vendosur.<sup>521</sup> Z. Ismaili pretendoi se e kishte parë të akuzuarin gjatë afërsisht shtatë a tetë ditëve në Butovc.<sup>522</sup> Në të njëjtën kohë, për shkak të disa të plagosurve, në dy a tri raste ai e pa të akuzuarin kur ishte në lëvizje.<sup>523</sup>

<sup>513</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2879, rreshtat 8-9; f. 2881, rreshtat 18-23.

<sup>514</sup> z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2888, rreshtat 14-18.

<sup>515</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2888, rreshtat 21-22.

<sup>516</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2889, rreshti 1.

<sup>517</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2900, rreshtat 19-25.

<sup>518</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2889, rreshtat 6-23; f. 2890, rreshti 10.

<sup>519</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2891, rreshtat 18-19.

<sup>520</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2892, rreshti 19 deri f. 2893, rreshti 6.

<sup>521</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2897, rreshtat 9-11.

<sup>522</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2905, rreshtat 9-12.

<sup>523</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2905, rreshtat 16-18.

267. Gjatë pyetjeve të ZPS-së, dëshmitari dëshmoi gjithashtu se më 20 prill 1999, ai udhëtoi bashkë me të akuzuarin në Prishtinë për të marrë disa barna.<sup>524</sup> Kur dëshmoi lidhur me këtë, dëshmitari i theksoi sërish problemet që kishte me kujtesën.<sup>525</sup>

(c) Z. Borovci

268. Z. Borovci dëshmoi se e pa të akuzuarin në Butovc më 2 ose 3 prill 1999, në shtëpinë e Mustafë Sopit,<sup>526</sup> ku po festonin Bajramin e Vogël.<sup>527</sup> Dëshmitari shpjegoi se Festa e Bajramit është arsyeja përse i kujtohet data e takimit të parë me të akuzuarin; sipas dëshmitarit “ne myslimanët i kemi dy festa, Bajramin e Madh, Bajramin e Vogël. Bajrami i Vogël zgjat pak ma shumë se bëjmë Bajram ma shumë edhe dy ditë, tri ditë, katër ditë pas Bajramit. Dhe kjo ma kujtoi atë datën, do të thotë, kur bënim Bajram aty, do të thotë, që ka qenë orientimisht java e parë, gjegjësisht 2-3 prilli i vitit 1999.”<sup>528</sup>

269. Krahas këtij takimi të parë, z. Borovci dëshmoi gjithashtu se e pa dhe foli sërish me të akuzuarin “3, 4 apo 5 herë. Nuk jam dot preciz për këtë”, sepse i akuzuari qëndroi në Butovc afërsisht dy javë, deri më 15, 16 ose 17 prill 1999.<sup>529</sup> Sipas dëshmitarit, i akuzuari qëndronte natën në Butovc, me përjashtim të rasteve kur shkonte në Prishtinë për të marrë ushqim.<sup>530</sup> Megjithatë, dëshmitari deklaroi se “... [takimet] nuk i kemi mbajtur çdo ditë, për shkak se unë kam qëndruar te Reçicët. Ai [z. Mustafa] ka qëndruar në familjen e Sopit”.<sup>531</sup>

---

<sup>524</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2912, rreshtat 13-18.

<sup>525</sup> Z. Ismaili: T. 29 mars 2022, publik, f. 2912, rreshtat 9, 19-20.

<sup>526</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022, publik, f. 2963, rreshtat 7-14.

<sup>527</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022, publik, f. 2963, rreshti 20 deri f. 2964, rreshti 1.

<sup>528</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022 publik, f. 2964, rreshtat 5-8.

<sup>529</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022, publik, f. 2964, rreshtat 18-22; f. 2964, rreshti 25 deri f. 2965, rreshti 4; f. 2966, rreshtat 5-7; T. 31 mars 2022, publik, f. 3062, rreshtat 18-23.

<sup>530</sup> Z. Borovci: T. 30 mars 2022, publik, f. 2967, rreshti 20 deri f. 2968, rreshti 6.

<sup>531</sup> Z. Borovci: T. 31 mars 2022, publik, f. 3062, rreshtat 24-25.

## (d) Zoti G. Sopi

270. Zoti G. Sopi dëshmoi se e pa të akuzuarin në Butovc gjatë dy javëve të para të prillit 1999.<sup>532</sup> Sipas dëshmitarit, i akuzuari ishte sidomos i afërt me vëllain e dëshmitarit, Mustafë Sopin, dhe për këtë arsye i shkoi për vizitë në Butovc gjatë Bajramit.<sup>533</sup> Dëshmitari dëshmoi se rreth ditës së tretë, të katërt ose të pestë të Bajramit të Vogël, i akuzuari i shkoi për urim Mustafë Sopit dhe dëshmitarit dhe festoi me ta.<sup>534</sup>

271. Krahas këtij takimi të parë me rastin e Bajramit, dëshmitari pretendoi se e takoi sërish të akuzuarin javën e parë dhe të dytë të prillit 1999, gjatë disa takimeve të të akuzuarit me Mustafë Sopin në të cilat mori pjesë edhe dëshmitari.<sup>535</sup> Gjatë dëshmisë së tij, dëshmitari shpjegoi se këto takime u bënë gjatë ditës dhe gjatë natës.<sup>536</sup> Dëshmitari shtoi se ai, i akuzuari, Mustafë Sopi, dhe bashkëluftëtarë të tjerë, shkonin shpesh së bashku në pika strategjike nga ku vrojtonin pozicionin e armikut.<sup>537</sup>

272. Zoti G. Sopi deklaroi se i akuzuari fillimisht qëndroi në shtëpinë e Mustafë Sopit, që ishte shtëpia e prindërve të dëshmitarit, ku rrinte edhe vetë dëshmitari.<sup>538</sup> Megjithatë, siç tha dëshmitari, “pastaj [z. Mustafa] ka bë lëvizje”.<sup>539</sup>

## (e) Përfundim

273. Sa i takon z. Mehmetaj, Trupi Gjykses rikujton se besueshmëria e dëshmitarit cenohet rëndë nga faktorët e identifikuar në vlerësimin e përgjithshëm të Trupit Gjykses.<sup>540</sup>

---

<sup>532</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3089, rreshtat 20-22.

<sup>533</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3089, rreshti 25 deri f. 3090, rreshti 2.

<sup>534</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3098, rreshtat 22-24; f. 3165, rreshti 24 deri f. 3166, rreshti 1.

<sup>535</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3090, rreshtat 19-24; f. 3091, rreshtat 19-21.

<sup>536</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3091, rreshtat 19-21.

<sup>537</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3091, rreshtat 2-6; f. 3104, rreshtat 14-20.

<sup>538</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3093, rreshtat 8-9, 13, 16-19.

<sup>539</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3093, rreshti 9.

<sup>540</sup> *Shih* para.139-144.

274. Krahas kësaj, Trupi Gjykses gjykon se, edhe duke marrë parasysh se dëshmitari dha një periudhë kohore të përafërt lidhur me praninë e tij në Butovc — që mund të ishte nga 2 prilli 1999<sup>541</sup> deri nga 7 prilli 1999 — Trupi Gjykses nuk është në gjendje të përcaktojë vendndodhjen e të akuzuarit gjatë asaj kohe. Lidhur me këtë, Trupi Gjykses gjykon se, me gjithë kalimin e kohës dhe pasojat që mund të ketë ose mund të mos ketë kjo në kujtesën e njeriut, Trupi Gjykses nuk mund thjesht të konstatojë se dëshmitë me natyrë të përgjithshme për periudha kohore të vagullta lidhur me praninë e të akuzuarit në një vend të caktuar, mund të vërtetojnë *prima facie* se i akuzuari ishte gjetiu dhe jo në Zllash, çka do të krijonte dyshim të arsyeshëm lidhur me argumentet e ZPS-së. Kjo është aq më tepër e vërtetë kur merret parasysh distanca e kufizuar mes Butovcit dhe Zllashit (rreth 13 kilometra), dhe mjetet e transportit që kishte në dispozicion, që e bënin shumë të mundur që ai të ishte brenda së njëjtës ditë në të dy vendet, duke e bërë argumentimin e alibisë krejt të paefektshme.

275. Sa i takon z. Ismaili, Trupi Gjykses rikujton se besueshmëria e dëshmitarit cenohet rëndë nga faktorët e identifikuar në vlerësimin e përgjithshëm të Trupit Gjykses.<sup>542</sup> Krahas kësaj, Trupi Gjykses gjykon se fakti që dëshmitari i theksoi në mënyrë të përsëritur problemet me kujtesën<sup>543</sup> ndikon ndjeshëm në mbështetshmërinë në dëshminë e tij, e cila për rrjedhojë duhet të vlerësohet me kujdes të madh kur bëhet fjalë për mbajtjen mend të datave.

276. Kuadri kohor i alibisë që dha z. Ismaili lidhur me takimin e parë që ai pretendoi se pati me të akuzuarin (27-29 mars 1999) është jashtë kornizës kohore të akuzave dhe rrjedhimisht nuk është relevant, as për alibinë, as për kuadrin e çështjes gjyqësore në përgjithësi. Sa i takon takimit të dytë të pretenduar me të akuzuarin, kuadri kohor i dhënë nga z. Ismaili është kaq i përgjithshëm dhe i vagullt, sa që ky takim mund të

---

<sup>541</sup> Siç e tha dëshmitari fillimisht “2-3 ditët e para të muajit prill” (z. **Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2631, rreshtat 22-23).

<sup>542</sup> *Shih* para.149-152.

<sup>543</sup> *Shih* para. 152.

ketë ndodhur në çfarëdo kohe afërsisht midis 2 prillit dhe 8 prillit 1999. Ndonëse teorikisht, takimi i dytë bie në dy javët e para të prillit 1999, afërsia e këtyre datave, parë në kontekstin e kujtesës së mangët të dëshmitarit, bën që Trupi Gjykses të mos mundet të përcaktojë vendndodhjen e të akuzuarit në atë kohë. Ashtu si në rastin e dëshmisë së z. Mehmetaj, edhe për dëshminë e z. Ismaili, Trupi Gjykses gjykon se nuk mund të konstatojë *prima facie*, në bazë të provave me natyrë të përgjithshme që përfshijnë një periudhë kohore mjaft të gjatë, se i akuzuari ishte vetëm në Butovc dhe, për pasojë, jo në Zllash, çka do të krijonte dyshim të arsyeshëm lidhur me provat e ZPS-së.

277. Sa i takon z. Borovci, besueshmëria e dëshmitarit cenohet rëndë nga faktorët e identifikuar në vlerësimin e përgjithshëm të Trupi Gjykses.<sup>544</sup>

278. Megjithatë, Trupi Gjykses i kushtoi vëmendjen e duhur dëshmisë së z. Borovci, sepse kuadri kohor i alibisë, 2-3 prill 1999 që dha dëshmitari, është paksa më i përcaktuar se ai i dëshmitarëve të tjerë të alibisë. Lidhur me këtë, Trupi Gjykses vëren se gjatë pyetjeve të Mbrojtjes, z. Borovci deklaroi se kishte shkuar në Butovc më 31 mars 1999.<sup>545</sup> Bazuar në këtë, gjatë pyetjeve të Mbrojtjes z. Borovci deklaroi se takimi i pretenduar me të akuzuarin ishte më “2, 3 prill të vitit 1999” duke e lidhur këtë datë me festën e “Bajramit të Vogël”.<sup>546</sup>

279. Gjatë pyetjeve të ZPS-së për këtë temë, z. Borovci u ballafaqua me faktin se pse në deklaratën e mëparshme që i kishte dhënë Mbrojtjes, kishte deklaruar se kishte shkuar nga Prishtina për në Butovc më 28 mars 1999 (dhe jo më 31 mars 1999), të cilit ai iu përgjigj se i kishte ngatërruar këto dy data.<sup>547</sup> Z. Borovci ritheksoi se arsyeja përse e mban mend datën e këtij takimi është lidhja me festën e Bajramit të Vogël, që “nuk

---

<sup>544</sup> *Shih* para.153-158.

<sup>545</sup> **Z. Borovci**: T. 30 mars 2022, publik, f. 2958, rreshtat 9-12.

<sup>546</sup> **Z. Borovci**: T. 30 mars 2022, publik, f. 2963, rreshti 7 deri f. 2964, rreshti 1.

<sup>547</sup> **Z. Borovci**: T. 30 mars 2022, publik, f. 3026, rreshtat 10-21.



ka qenë me 28 [mars 1999] domethënë, por ka qenë me 31 mars [1999]”.<sup>548</sup> Megjithatë, dëshmitari pranoi se nuk i mban mend mirë datat e festave myslimane.<sup>549</sup> Pasi u pyet disa herë nga ZPS-ja për arsyen përse tani ishte i bindur se Bajrami i Vogël kishte qenë më 31 mars 1999, dhe jo më 28 mars 1999 siç kishte kujtuar fillimisht, z. Borovci pranoi se ky ndryshim në dëshminë e tij nuk mbështetej në njohuri vetjake, por se kishte pyetur “hoxhallarët. U thashë: “a dini me m’regu se kur ka qenë?” Thanë, “Ka qenë me 31-shin [ e marsit 1999]”.<sup>550</sup>

280. Në fakt, Trupi Gjykses vëren se është dorëzuar si provë një tabelë me datat e festës së Bajramit të Vogël ndër vite, sipas së cilës në vitin 1999 kjo festë binte më 28 mars — ashtu si e mendonte fillimisht z. Borovci — dhe jo më 31 mars 1999.<sup>551</sup> Trupi Gjykses nuk e vë në dyshim mbështetshmërinë në këtë tabelë, sepse është dokument nga burim i hapur në internet, besueshmëria dhe vërtetësia e të cilit për sa u përket datave të këtyre festave mund të verifikohet me lehtësi. Rrjedhimisht, duke mbajtur parasysh se z. Borovci e lidhi takimin e pretenduar me të akuzuarin me festën e Bajramit të Vogël, Trupi Gjykses është i bindur se ky takim, nëse ka pasur një të tillë, mund të ketë ndodhur nga fundi i marsit 1999 dhe jo më 2-3 prill 1999. Rrjedhimisht, kjo nuk do të binte ndesh me rastet e pretenduara të kryerjes së drejtpërdrejtë nga i akuzuari të krimeve për të cilat janë ngritur akuzat.

281. Lidhur me këtë, Trupi Gjykses vëren se z. Borovci dhe zoti G. Sopi e ndryshuan të dy, në mënyrë tejet të ngjashme, datën e nisjes nga Prishtina për në Butovc, nga 28 marsi 1999 (sipas deklaratave të tyre të mëparshme dhënë Mbrojtjes), më 31 mars 1999 (që e deklaruan në sallën e gjyqit para Trupit Gjykses). Trupi Gjykses rikujton gjithashtu se z. Borovci dhe zoti G. Sopi janë miq të ngushtë prej kohësh.<sup>552</sup> Sipas

---

<sup>548</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 3027, rreshtat 7-11.

<sup>549</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 3027, rreshtat 15-16.

<sup>550</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 3029, rreshti 23 deri f. 3031, rreshti 15.

<sup>551</sup> SPOE00325821-00325821.

<sup>552</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2989, rreshtat 19-24.

mendimit të Trupit Gjykues, duke qenë se z. Borovci pranoi se kishte kërkuar këshilla nga persona të tjerë lidhur me dëshminë e tij, kjo përputhje datash ngre shqetësimin se z. Borovci dhe zoti G. Sopi mund t'i kenë bashkërenduar edhe këto ndryshime, çka e bën Trupin Gjykues ta konsiderojë z. Borovci si jo të besueshëm sa i takon dëshmisë lidhur me alibinë.

282. Sa i takon pjesës së dëshmisë së z. Borovci lidhur me afërsisht dy javët e para të prillit 1999 dhe pretendimin se e pa të akuzuarin tri deri pesë herë në Butovc, Trupi Gjykues e konstaton atë tepër të vagullt dhe të përgjithshme për të vërtetuar alibinë, sepse dëshmitari dëshmoi se nuk e pa të akuzuarin në Butovc çdo ditë dhe se ai ishte në lëvizje.<sup>553</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykues, kjo përputhet plotësisht me aftësinë e të akuzuarit për të lëvizur nëpër atë territor, siç u konstatua nga Trupi Gjykues dhe, rrjedhimisht, me praninë e të akuzuarit në Zllash në kohët përkatëse gjatë dy javëve të para të prillit 1999.

283. Rrjedhimisht, kur dëshmitë e z. Borovci dhe të të akuzuarit shihen së bashku, është plotësisht e mundshme, sipas mendimit të Trupit Gjykues, se i akuzuari mund të ketë udhëtuar midis Butovcit dhe Zllashit gjatë dy javëve të para të prillit 1999. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues mendon se disa pjesë të dëshmisë së z. Borovci në fakt mbështesin provat dhe argumentet e ZPS-së në vend që të ofrojnë alibi për të akuzuarin.

284. Sa i takon zotit G. Sopi, Trupi Gjykues mendon se, duke qenë se ky dëshmitar deklaroi se vuante nga probleme të kujtesës, dëshmia e tij duhet marrë me rezervë kur bëhet fjalë për mbajtjen mend të datave.<sup>554</sup> Krahas kësaj, besueshmëria e dëshmitarit

---

<sup>553</sup> **Z. Borovci:** T. 30 mars 2022, publik, f. 2967, rreshti 20 deri f. 2968, rreshti 6; f. 3039, rreshti 24; f. 3044, rreshtat 9-12, 21-22.

<sup>554</sup> *Shih* para. 166.

cenohet rëndë nga faktorët e identifikuar në vlerësimin e përgjithshëm të Trupit Gjykues.<sup>555</sup>

285. Sa i takon dëshmisë së tij lidhur me alibinë, Trupi Gjykues vëren se ashtu si në rastin e z. Borovci, zoti G. Sopi mori si pikë referimi festën e Bajramit të Vogël për të përcaktuar kohën e takimit të pretenduar me të akuzuarin në Butovc.<sup>556</sup> Sipas zotit G. Sopi, Bajrami i Vogël “i vjen 30, 31 mars [1999]”.<sup>557</sup> Mirëpo Trupi Gjykues ka përcaktuar tashmë se Bajrami i Vogël ishte më 28 mars 1999.<sup>558</sup> Zoti G. Sopi dëshmoi në gjykatë se u takua dhe bisedoi me të akuzuarin në “fillim të prillit [1999], në javët e para të prillit”;<sup>559</sup> më konkretisht “ka qenë java e parë dhe java e dytë e muajit prill [1999]. Na jemi taku. Kemi bisedu”.<sup>560</sup>

286. Megjithatë, Trupi Gjykues vëren se në deklaratat tij të mëparshme dhënë Mbrojtjes dhe ZPS-së, zoti G. Sopi dëshmoi në mënyrë përputhëse se në Butovc kishte arritur më 28 mars 1999, për Bajramin e Vogël.<sup>561</sup> Gjithashtu, në deklaratën e mëparshme për ZPS-në, zoti G. Sopi tha se i akuzuari shkoi në Butovc në një periudhë kohore më të përcaktuar se sa ajo që deklaroi në sallën e gjyqit, pra “drejt fundit të javës së parë të prillit [1999]” dhe se ai qëndroi deri “diku nga fundi i javës së dytë”.<sup>562</sup> Kur z. G. Sopi u pyet nga ZPS-ja për këtë ndryshim midis deklaratave të tij të mëparshme dhe dëshmisë në sallën e gjyqit, qëndrimi që dëshmitari mbajti në fund ishte se nuk i kujtohej mirë pas 23 vjetësh, por se “aty pari ka qenë” (domethënë siç

---

<sup>555</sup> *Shih* para.159-165.

<sup>556</sup> **Z. G. Sopi**: T. 4 prill 2022, publik, f. 3098, rreshti 18 deri f. 3099, rreshti 6.

<sup>557</sup> **Z. G. Sopi**: T. 4 prill 2022, publik, f. 3096, rreshtat 23-24.

<sup>558</sup> SPOE00325821-00325821.

<sup>559</sup> **Z. G. Sopi**: T. 4 prill 2022, publik, f. 3089, rreshtat 20-22.

<sup>560</sup> **Z. G. Sopi**: T. 4 prill 2022, publik, f. 3090, rreshtat 19-20.

<sup>561</sup> **Z. G. Sopi**: T. 4 prill 2022, publik, f. 3110, rreshti 12 deri f. 3118, rreshti 12; DSM00177-00186, f. 2, 4-5, 8; 104551-TR-ET Part 1, f. 31, rreshtat 16-19.

<sup>562</sup> **Z. G. Sopi**: T. 4 prill 2022, publik, f. 3119, rreshtat 11-23; 104551-TR-ET Part 1, f. 31, rreshtat 7-12, 20-24.

kishte dëshmuar në deklaratën që i kishte dhënë më parë ZPS-së).<sup>563</sup> Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë se deklaratat e z. Borovci dhe të zotit G. Sopi kanë ndryshuar në mënyrë tejet të ngjashme sa i takon datës së nisjes së tyre nga Prishtina për në Butovc. Kjo përputhje ngre shqetësimin se z. Borovci dhe zoti G. Sopi mund t'i kenë bashkërenduar këto ndryshime, çka e bën Trupin Gjykses ta konsiderojë zotin G. Sopi si jo të besueshëm sa i takon dëshmisë së tij për alibinë.

287. Krahas kësaj, nga dëshmia e zotit G. Sopi e marrë në tërësi, Trupi Gjykses vëren se dëshmitari kishte vështirësi të konsiderueshme për të përcaktuar me saktësi, sado minimale, kohën e bisedës së pretenduar me të akuzuarin. Në fakt, dëshmia mund të vërtetojë vetëm se zoti G. Sopi mund ta ketë parë dhe të ketë folur me të akuzuarin në Butovc në çfarëdo date midis 28 marsit 1999 dhe fundit të javës së dytë të prillit 1999. Gjithsesi, duke mbajtur parasysh provat e përgjithshme të paraqitura nga Mbrojtja, të cilat mbulojnë një periudhë kohore relativisht të gjatë që pjesërisht bie jashtë kornizës kohore të akuzave të ngritura, Trupi Gjykses nuk mund të arrijë në përfundimin, *prima facie*, se në kohën që lidhet me akuzat i akuzuari ishte në një vend tjetër — Butovc — çka do ngrinte dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e tij në Zllash.

288. Krahas kësaj, Trupi Gjykses vëren se zoti G. Sopi shpjegoi se ai nuk ishte tërë kohën me të akuzuarin gjatë asaj kohe,<sup>564</sup> çka mbështet konstatimin e Trupit Gjykses se i akuzuari mund të shkonte nga një vend në tjetrin, përfshirë edhe në Zllash. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se vetë zoti G. Sopi dëshmoi se i akuzuari lëvizte nga Butovci,<sup>565</sup> çka konfirmon dëshmitë e shumta — përfshirë edhe nga vetë i akuzuari

---

<sup>563</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3114, rreshti 22 deri f. 3115, rreshti 5; f. 3118, rreshtat 2-3; f. 3120, rreshtat 22-25. Edhe gjatë pyetjeve të palës thirrëse, z. G. Sopi mbajti një qëndrim po aq të kujdesshëm lidhur me kujtimin e datave (f. 3090, rreshtat 17-20: “për mos me e marrë me data, se datat mujn me qenë të lëvizshme për shkak të rrethanave edhe të kohës shumë të largët 23 vjet”).

<sup>564</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3121, rreshti 10 deri f. 3122, rreshti 15; 104551-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 34, rreshtat 17-22.

<sup>565</sup> **Z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, konfidencial, f. 3093, rreshti 9.

— që tregojnë se ai lëvizte rregullisht nëpër territorin e Kosovës verilindore në prill 1999.<sup>566</sup>

289. Me rëndësi kritike është se dëshmitari shtoi se distanca midis Butovcit të Poshtëm dhe Zllashit është rreth “13 kilometra”.<sup>567</sup> Trupi Gjykses e konsideron dëshmitarin të besueshëm dhe në të cilin mund të mbështetet për këtë pikë, sepse zoti G. Sopi është lindur në Butovc dhe i përshkroi në mënyrë të hollësishme dhe pa asnjë hezitim veçoritë e zonës - përfshirë lagjet e ndryshme të Butovcit - dhe distancën dhe kohën që duhej për të shkuar në vende të tjera.<sup>568</sup> Duke pasur parasysh distancën kufizuar midis Butovcit dhe Zllashit, Trupi Gjykses është i mendimit se, edhe duke supozuar njëfarë saktësie të zotit G. Sopi në kujtimin e ngjarjeve, i akuzuari mund ta ketë përshkuar atë distancë brenda së njëjtës ditë, madje edhe disa herë po të ishte nevoja. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton si përfundim se, në bazë të dëshmisë në tërësi, kuadri kohor i alibisë së dhënë nga zoti G. Sopi nuk është i papajtueshëm me praninë e të akuzuarit në Zllash në kohët përkatëse gjatë dy javëve të para të prillit 1999.

290. Duke pasur parasysh të gjitha sa më lart dhe në bazë të provave të marra në tërësi,<sup>569</sup> Trupi Gjykses konstaton se alibia e dhënë nga dëshmitarët e mësipërm nuk vërteton *prima facie* praninë e të akuzuarit në Butovc aq sa për të krijuar dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e të akuzuarit në Zllash në kohët përkatëse, gjatë dy javëve të para të prillit 1999.

---

<sup>566</sup> *Shih* para.254-255.

<sup>567</sup> **Z. G. Sopi**: T. 4 prill 2022, publik, f. 3081, rreshti 23 deri f. 3082, rreshti 6.

<sup>568</sup> **Z. G. Sopi**: T. 4 prill 2022, publik, f. 3079, rreshtat 4-16; f. 3081, rreshti 23 deri f. 3082, rreshti 10. Distanca midis vendeve, dëshmitari mundi t'i jepte gjithashtu jo mbi bazën e distancave midis tyre në vijë të drejtë (“në vijë ajrore” siç u shpreh dëshmitari), por në bazë të distancës në terren.

<sup>569</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me praninë e z. Mustafa në kompleksin e ndalimit të Zllash, para.468-473, 541-545, 551-554.

#### 4. Prania e të akuzuarit në Barilevë

##### (a) Z. Vërbovci

291. Z. Vërbovci dëshmoi se në vitin 1999 banonte në Barilevë.<sup>570</sup> Sipas z. Vërbovci, në mars/prill 1999 ushtarët e UÇK-së kalonin nëpër lagjen Vërbovc ku UÇK-ja kishte një njësit të vendosur në shtëpinë e dëshmitarit. Kur kalonte në Barilevë, i akuzuari qëndronte me njësitin në shtëpinë e z. Vërbovci.<sup>571</sup> Ai sqaroi se i akuzuari vinte ndonjëherë mbrëmjeve dhe pushonte aty një a dy orë.<sup>572</sup>

292. Z. Vërbovci dëshmoi se në prill 1999 e pa të akuzuarin dy herë në shtëpinë e tij në Barilevë.<sup>573</sup> Hera e parë ishte më 1 ose 2 prill 1999, kur i akuzuari shkoi në shtëpinë e dëshmitarit, “ka pushue shumë pak. Është përshëndet me Jusuf Shalakun, ka vazhdue” për të shkuar në një vend të panjohur për dëshmitarin.<sup>574</sup> Lidhur me këtë takim të parë, ai dëshmoi se z. Mustafa i shkoi në shtëpi më 1 prill 1999; pastaj u largua dhe u kthye të nesërmen, më 2 prill 1999.<sup>575</sup> I akuzuari qëndroi dy deri tri orë, jo më shumë.<sup>576</sup> Takim i dytë, më 20-21 prill 1999, nuk ka lidhje me alibinë sepse bie jashtë kuadrit kohor të akuzave, ndaj edhe nuk mund të vlerësohet për këtë qëllim.

##### (b) Z. Nreci

293. Sipas z. Nreci, ai u takua me të akuzuarin në Barilevë në një rast, midis afërsisht 12 dhe 22 prillit 1999.<sup>577</sup> Dëshmitari dëshmoi se gjatë kësaj kohe, e çoi të akuzuarin në

<sup>570</sup> Z. Vërbovci: T. 6 prill 2022, publik, f. 3285, rreshti 13.

<sup>571</sup> Z. Vërbovci: T. 6 prill 2022, publik, f. 3289, rreshtat 18-20; f. 3294, rreshti 23 deri f. 3295, rreshtat 1-3; f. 3297, rreshti 23 deri f. 3298, rreshti 1.

<sup>572</sup> Z. Vërbovci: T. 6 prill 2022, publik, f. 3297, rreshti 23 deri f. 3298, rreshti 1.

<sup>573</sup> Z. Vërbovci: T. 6 prill 2022, publik, f. 3304, rreshti 20 deri f. 3305, rreshti 8.

<sup>574</sup> Z. Vërbovci: T. 6 prill 2022, publik, f. 3305, rreshtat 5-7, 14-20.

<sup>575</sup> Z. Vërbovci: T. 6 prill 2022, publik, f. 3351, rreshti 25 deri f. 3352, rreshti 8.

<sup>576</sup> Z. Vërbovci: T. 6 prill 2022, publik, f. 3328, rreshtat 2-3.

<sup>577</sup> Z. Nreci: T. 5 prill 2022, publik, f. 3214, rreshtat 6-10; f. 3215, rreshtat 12-14.

Majac me automjetin tip Golf II 4x4 të Jusuf Shalakit.<sup>578</sup> Dëshmitari deklaroi se më pas atë e çuan në rrugën që përdorej nga popullata civile për të shkuar nga një vend në tjetrin.<sup>579</sup> Prej aty, siç dëshmoi z. Nreci, i akuzuari shkoi në drejtim të Zllashit.<sup>580</sup> Kur u pyet nga Mbrojtja nëse e mbante mend arsyen përse i akuzuari dhe Jusuf Shalaku duhej të shkonin në Zllash, dëshmitari u përgjigj se “ka qenë e pakuptimtë edhe me i pyet, “Pse po shkon e për çka po shkon”. Sepse ata shumicën e kohës andej diku kanë ndejt, jo te neve”.<sup>581</sup> Kur u ballafaqua me deklaratën që i kishte dhënë më parë Mbrojtjes, dëshmitari deklaroi se të akuzuarin e kishin thirrur me telefon (satelitor) dhe i ishte dashur të largohej me ngut për në Zllash sepse kishte shumë të plagosur në atë zonë.<sup>582</sup>

294. Gjatë pyetjeve të palës thirrëse, dëshmitari konfirmoi deklaratën që i kishte dhënë më parë Mbrojtjes dhe deklaroi se ky takim kishte qenë katër a pesë ditë para 22 prillit 1999.<sup>583</sup> Mirëpo, gjatë pyetjeve të ZPS-së, dëshmitari kundërshtoi veten kur dëshmoi se nuk mund të thoshte me saktësi se kur kishte qenë data e takimit të dytë: “[...] me datë që të them 13, 14, ose 19, ose 21, ose 22, nuk mund ta përcaktoj datën [...]”.<sup>584</sup>

295. Gjithashtu, sipas dëshmitarit, i akuzuari shkoi në Barilevë edhe herë të tjera midis 24 marsit 1999 dhe ditës së takimit të tyre të fundit, por dëshmitari nuk ishte në gjendje të jepte hollësi të mëtejshme.<sup>585</sup>

---

<sup>578</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3206, rreshti 21 deri f. 3207, rreshti 8; f. 3216, rreshtat 12-14; f. 3221, rreshtat 6-9.

<sup>579</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3216, rreshtat 12-15.

<sup>580</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3216, rreshtat 19-21.

<sup>581</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3216, rreshtat 22-25.

<sup>582</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3217, rreshti 1 deri f. 3218, rreshti 1; DSM00056-00067, f. DSM00062.

<sup>583</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3218, rreshtat 6-12; DSM00056-00067, f. DSM00061.

<sup>584</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, publik, f. 3236, rreshti 17 deri f. 3237, rreshti 12.

<sup>585</sup> **Z. Nreci:** T. 5 prill 2022, konfidencial, f. 3218, rreshtat 13-24.



## (c) Përfundim

296. Sa i takon z. Vërbovci, Trupi Gjykues rikujton se besueshmëria e dëshmitarit cenohet rëndë nga faktorët e identifikuar nga Trupi Gjykues në vlerësimin e tij të përgjithshëm, dhe se dëshmia e tij nuk mbështetet vetëm në njohuritë apo kujtesën e vetë dëshmitarit për ngjarjet, por u ndikua nga persona të tjerë, ndër të cilët dëshmitari i Mbrojtjes, z. Nreci, sidomos në lidhje me datën e takimit të pretenduar të tij me të akuzuarin.<sup>586</sup>

297. Krahas kësaj, Trupi Gjykues mendon se dëshmia e z. Vërbovci, sipas së cilës i akuzuari i shkoi në shtëpi më 1 ose 2 prill 1999, nuk e përjashton praninë e të akuzuarit në Zllash, sepse z. Vërbovci dëshmoi se i akuzuari qëndroi “shumë pak” dhe pastaj u largua për të shkuar në një vend të panjohur. Diku tjetër, dëshmitari deklaroi se z. Mustafa i shkoi në shtëpi më 1 prill 1999; pastaj u largua dhe u kthye të nesërmen më 2 prill 1999. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues rikujton se ka konstatuar tashmë që i akuzuari, gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar, kishte aftësinë të lëvizte nëpër territor, çka i jepte mundësi të ishte në disa vende brenda së njëjtës ditë. Dëshmia e z. Vërbovci në fakt mbështet këtë konstatim, dhe nuk ofron alibi për të akuzuarin.

298. Sa i takon z. Nreci, Trupi Gjykues rikujton se besueshmëria e dëshmitarit cenohet rëndë nga faktorët e identifikuar nga Trupi Gjykues në vlerësimin e tij të përgjithshëm.<sup>587</sup>

299. Krahas kësaj, dëshmia e z. Nreci është shumë e vagullt për sa u përket referencave kohore lidhur me praninë e mundshme të të akuzuarit në Barilevë. Rrjedhimisht, kjo nuk krijon tek Trupi Gjykues ndonjë dyshim të arsyeshëm që do të ndikonte në konstatimet e tij për praninë e të akuzuarit në vendin e krimit në kohët që

---

<sup>586</sup> *Shih* para.174-175.

<sup>587</sup> *Shih* para.167-170.

kanë lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar. Edhe në qoftë se Trupi Gjykses do të mbështetej në dëshminë e z. Nreci lidhur me takimin e pretenduar të tij me të akuzuarin midis 12 dhe 22 prillit 1999, provat lidhur me aftësinë e të akuzuarit për të shkuar dhe ardhur nga Zllashi dhe për të lëvizur nëpër territor, rrëzojnë çdo alibi të mundshme të dhënë z. Nreci, sepse i akuzuari mund të ketë qenë në Zllash në kohët që kanë lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar.

300. Në lidhje me këtë, vetë dëshmitari dëshmoi se, pasi u ndanë, i akuzuari dhe Jusuf Shalaku shkuan në drejtim të Zllashit. Trupi Gjykses e konsideron z. Nreci veçanërisht të besueshëm për këtë pikë. Në fakt, kur Mbrojtja e pyeti dëshmitarin nëse i kujtohet arsyeja përse i akuzuari dhe Jusuf Shalaku duhej të shkonin në Zllash, z. Nreci u përgjigj se “ka qenë e pakuptimtë edhe me i pyet [për arsyen]sepse ata [i akuzuari dhe Jusuf Shalaku] shumicën e kohës andej diku [në Zllash] kanë ndejt, jo te neve”. Edhe pse më pas ai konfirmoi deklaratën që i kishte dhënë më parë Mbrojtjes se të akuzuarin e thirrën me telefon satelitor që të shkonte në Zllash për shkak se atje kishte shumë të plagosur, kjo gjithsesi konfirmon, sipas mendimit të Trupit Gjykses, se i akuzuari ishte në gjendje të shkonte e vinte nga Zllashi dhe, në fakt, e bëri këtë në mënyrë të përsëritur gjatë prillit 1999, sidomos kur i kërkohet një gjë e tillë. Fakti se i akuzuari kishte në dispozicion një telefon satelitor, siç e konfirmoi vetë z. Mustafa,<sup>588</sup> i jepte gjithashtu mundësi t’i ndryshonte lëvizjet e tij në mbarë rajonin.

301. Mbështetur në sa më lart dhe në bazë të provave të marra në tërësi,<sup>589</sup> Trupi Gjykses konstaton se alibia e dhënë nga dëshmitarët e mësipërm nuk vërteton *prima facie* praninë e të akuzuarit në Barilevë aq sa për të krijuar dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e të akuzuarit në Zllash në kohët përkatëse, gjatë dy javëve të para të prillit 1999.

---

<sup>588</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 2, f. 12, rreshtat 13-20; 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 4, f. 6, rreshtat 1-7.

<sup>589</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me praninë e z. Mustafa në kompleksin e ndalimit në Zllash, para.468-473, 541-545, 551-554.

## 5. Prania e të akuzuarit në Rimanishtë dhe Bellopojë

(a) Z. Parduzi

302. Më 10 prill 1999, z. Parduzi u plagos, u çua fillimisht në Turiqicë dhe më pas në një spital të improvizuar në fshatin Potok.<sup>590</sup> Sipas dëshmitarit, u deshën më shumë se dyzet e tetë orë për të bërë rrugën nga Turiqica për në Potok.<sup>591</sup> Gjatë këtij transporti nga Turiqica në Potok, dëshmitari pretendoi se e kishte parë personalisht të akuzuarin.<sup>592</sup> Sipas z. Parduzi, i akuzuari e shoqëroi dëshmitarin në më shumë se gjysmën e rrugës, deri në Bellopojë ose Rimanishtë, ku i akuzuari u kthye mbrapsht.<sup>593</sup>

303. Z. Parduzi deklaroi gjithashtu se gjatë udhëtimit, i akuzuari iu afrua dy herë rimorkios në të cilën po transportohej dëshmitari dhe e pyeti si ishte.<sup>594</sup> Ai dëshmoi se i akuzuari iu afrua për ta pyetur “kur jemi ndal, qoftë për ndonjë pushim të shkurtër që është dashtë me ma dhënë një infuzion, apo ndonjë injeksion për shkak të dhimbjeve edhe një pushim të shkurtër për me vazhdu”.<sup>595</sup> Z. Parduzi gjithashtu dëshmoi se “ka qenë e mbuluar rimorkio me një llastik se kanë qenë reshjet atmosferike jashtëzakonisht të mëdha”.<sup>596</sup> Ai përsëriti se “kushtet atmosferike kanë qenë jashtëzakonisht të rënda dhe tërë kohën ka ranë shi. Shi pa ndërprerje dhe ka qenë një i ftohtë, mund të them -- nuk e di sa ka qenë minus, apo. Por ka qenë bukur ftohtë.”<sup>597</sup>

---

<sup>590</sup> Z. Parduzi: T. 11 prill 2022, publik, f. 3427, rreshti 15; f. 3428, rreshtat 3-4; f. 3429, rreshtat 16-19.

<sup>591</sup> Z. Parduzi: T. 11 prill 2022, publik, f. 3429, rreshtat 20-23.

<sup>592</sup> Z. Parduzi: T. 11 prill 2022, publik, f. 3430, rreshtat 17-19; f. 3431, rreshtat 4-10.

<sup>593</sup> Z. Parduzi: T. 11 prill 2022, publik, f. 3432, rreshtat 1-7; f. 3443, rreshtat 10-21.

<sup>594</sup> Z. Parduzi: T. 11 prill 2022, publik, f. 3431, rreshtat 9-13.

<sup>595</sup> Z. Parduzi: T. 11 prill 2022, publik, f. 3484, rreshtat 12-14.

<sup>596</sup> Z. Parduzi: T. 11 prill 2022, publik, f. 3484, rreshti 15.

<sup>597</sup> Z. Parduzi: T. 11 prill 2022, publik, f. 3443, rreshtat 5-6.

(b) Z. Ibishi

304. Më 10 prill 1999, z. Ibishi u plagos dhe u evakuua për në spitalin e Potokut së bashku me z. Parduzi.<sup>598</sup> Sipas dëshmitarit, transporti për në Potok filloi rreth orës 19:00 ose 20:00 të 10 prillit 1999 dhe përfundoi brenda 48 orësh.<sup>599</sup> Dëshmitari deklaroi se për shkak të lëndimeve (ai vetë ishte plagosur në stomak) që kishin pësuar ai dhe z. Parduzi, kolona “u deshke edhe pushim [...] [siç] u preferonte nga personeli mjekësor”.<sup>600</sup> Krahas kësaj, z. Ibishi shpjegoi se si ai, edhe z. Parduzi, ishin plagosur në stomak dhe duhej të qëndronin shtrirë gjatë transportit “që dhimbjet të jenë më pak”.<sup>601</sup>

305. Z. Ibishi dëshmoi se, deri në Rimanishtë, rimorkioja me të cilën po transportoheshin të dy ishte e mbuluar “me tendë” për shkak të kushteve të motit dhe për shkak se binte shi gjatë gjithë kohës.<sup>602</sup> Ai shtoi se nga Rimanishta u transportuan me një xhip.<sup>603</sup>

306. Z. Ibishi dëshmoi gjithashtu se brenda në rimorkio ishte një punonjës mjekësor dhe një ndihmësinfermiere dhe se Latif Gashi ishte gjithashtu aty afër dhe ndërmori masa sigurie.<sup>604</sup> Gjatë pyetjeve të ZPS-së, z. Ibishi deklaroi se Latif Gashi ishte përgjegjës që të vrojtonte gjatë udhëtimit nga Turiqica në Potok.<sup>605</sup>

---

<sup>598</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3557, rreshti 14 deri f. 3559, rreshti 1.

<sup>599</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3559, rreshtat 9-12.

<sup>600</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3559, rreshtat 20-22.

<sup>601</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3582, rreshtat 7-9.

<sup>602</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3559, rreshtat 16-25; f. 3563, rreshtat 1-2; f. 3583, rreshtat 10-17. Dëshmia e z. Ibishi lidhur me kushtet e këqija të motit ishte përputhëse si gjatë pyetjeve të Mbrojtjes ashtu edhe atyre të Prokurorisë.

<sup>603</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3560, rreshtat 1-2.

<sup>604</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3562, rreshtat 22-24.

<sup>605</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3576, rreshtat 7-12.

## (c) Përfundim

307. Trupi Gjykses rikujton se besueshmëria e z. Parduzi dhe z. Ibishi cenohet rëndë prej faktorëve të identifikuar në vlerësimin e përgjithshëm të Trupit Gjykses.<sup>606</sup>

308. Sidoqoftë, Trupi Gjykses nuk ka asnjë arsye të mos i besojë dëshmitarët për gjendjen e tyre shëndetësore dhe për kushtet e vështira të motit dhe të udhëtimit gjatë kohës që ishin në rimorkion e mbuluar. Të dy dëshmuan qartë për këto aspekte, theksuan kushtet e vështira që përjetuan dhe dhanë dëshmi mjaft përputhëse me njëri-tjetrin. Bazuar në këtë, Trupi Gjykses është i mendimit se gjendja shëndetësore e z. Parduzi, së bashku me kushtet e motit dhe të udhëtimit gjatë rrugës, e kufizojnë ndjeshëm mundësinë për t'u mbështetur në kujtimet e tij për ngjarjet. Faktikisht, Trupit Gjykses i duket e pagjasë që ky person i plagosur rëndë, i cili po transportohej i shtrirë në një rimorkio të mbuluar, nën shiun e rrëmbyer dhe të vazhdueshëm, të ketë qenë fizikisht dhe mendërisht në gjendje për të vënë re praninë e të akuzuarit gjatë udhëtimit.

309. Fakti që nuk mund të mbështetesh në dëshminë e alibisë së këtij dëshmitari për sa i përket pranisë së të akuzuarit gjatë udhëtimit, konfirmohet edhe nga një mospërputhje e rëndësishme midis dëshmive të z. Parduzi dhe të z. Ibishi. Ndërsa i pari deklaroi se e kishte parë të akuzuarin, i dyti nuk përmendi që i akuzuari ishte i pranishëm në ato rrethana, as se ai ishte përgjegjës për transportin mjekësor. Në vend të kësaj, z. Ibishi përmendi se krahas dy punonjësve mjekësorë, ishte i pranishëm edhe Latif Gashi, i cili ishte përgjegjës për të garantuar sigurinë e transportit.<sup>607</sup> Lidhur me praninë e Latif Gashit dhe detyrën e tij për të siguruar transportin mjekësor, Trupi Gjykses vëren se gjatë dhënies së dëshmisë në sallën e gjyqit, z. Ibishi i qëndroi deklaratës që i kishte dhënë më parë Mbrojtjes dhe një deponimi të mëhershëm të tij

---

<sup>606</sup> *Shih* para.177-182; 184-189.

<sup>607</sup> **Z. Ibishi**: T. 12 prill 2022, publik, f. 3562, rreshtat 22-24.

para një gjykatësi hetues në Kosovë.<sup>608</sup> Trupi Gjykses e konsideron z. Ibishi të besueshëm për këtë pikë dhe, rrjedhimisht, konstaton se z. Parduzi ose gaboi — për shkak të gjendjes shëndetësore dhe kushteve mjedisore — që e identifikoi të akuzuarin si të pranishëm, ose u përpoq të ofronte alibi për të akuzuarin, çka është në përputhje me qëndrimin tejet të njëanshëm kundër Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së si dhe me përkrahjen për të akuzuarin, që ka shprehur dëshmitari.

310. Gjithsesi, nisur nga konstatimi i Trupit Gjykses se i akuzuari mund të lëvizte nëpër territor dhe të shkonte në disa vende brenda së njëjtës ditë, alibia e dhënë nga dëshmitarët e Rimanishtës dhe Bellopojës nuk ka vlerë, edhe sikur Trupi Gjykses t'u jepte vlerën më të lartë provuese dëshmive të tyre. Madje, Trupi Gjykses mendon se distancat midis Rimanishtës, Bellopojës dhe Zllashit ishin kaq të kufizuara saqë, edhe në kushte të vështira udhëtimi, i akuzuari me gjasë mund të ketë qenë në të gjitha këto vende brenda së njëjtës ditë.

311. Mbështetur në sa më lart dhe në provat të marra në tërësi,<sup>609</sup> Trupi Gjykses konstaton se alibia e dhënë nga dëshmitarët e mësipërm nuk vërteton *prima facie* praninë e të akuzuarit në Rimanishtë dhe Bellopojë aq sa për të krijuar dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e të akuzuarit në Zllash në kohët përkatëse gjatë dy javëve të para të prillit 1999.

---

<sup>608</sup> **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3573, rreshti 15 deri f. 3577, rreshti 20. *Shih gjithashtu* DSM00460-00475, f. 8; SPOE00123560-00123574, f. 12.

<sup>609</sup> *Shih gjithashtu* konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me praninë e z. Mustafa në kompleksin e ndalimit në Zllash, para.468-473, 541-545, 551-554.

## 6. Prania e të akuzuarit në Prishtinë

### (a) Z. Ademi

312. Sipas z. Ademi, më 30 mars 1999 ose më 2, 3 ose 4 prill 1999, në shtëpinë e tij në Prishtinë erdhën tre anëtarë të UÇK-së.<sup>610</sup> Dëshmitari dëshmoi se njëri prej tyre ishte i akuzuari.<sup>611</sup> Sipas z. Ademi, i akuzuari erdhi në mbrëmje, qëndroi një natë, fjeti në shtëpinë e axhës së dëshmitarit dhe u largua të nesërmen rreth orës 22:00 ose 23:00.<sup>612</sup>

### (b) Z. Humolli

313. Z. Humolli dëshmoi se ishte me të akuzuarin për një ditë rreth 1 prillit 1999 në Prishtinë.<sup>613</sup> Sipas dëshmitarit, herët në mëngjesin e 1 prillit 1999, ai dhe i akuzuari u larguan nga qyteti në këmbë; ata ndaluan në lagjen e Llumnicve të Barilevës dhe pastaj u ndanë pasdreke.<sup>614</sup>

### (c) Përfundim

314. Sa i takon z. Ademi, Trupi Gjykues rikujton se besueshmëria e dëshmitarit cenohet rëndë nga faktorët e identifikuar në vlerësimin e përgjithshëm të Trupit Gjykues.<sup>615</sup>

315. Gjithashtu, Trupi Gjykues mendon se referenca kohore e dhënë nga z. Ademi (30 mars 1999 ose 2, 3 ose 4 prill 1999 — z. Ademi nuk e mbante mend datën e saktë)<sup>616</sup> ose del pjesërisht jashtë kuadrit kohor të akuzave (dhe, rrjedhimisht nuk ka lidhje me çështjen), ose është tepër e përgjithshme, ndaj edhe nuk çon në një dyshim të

---

<sup>610</sup> **Z. Ademi:** T. 28 mars 2022, publik, f. 2776, rreshtat 24-25; f. 2777, rreshtat 7-17; f. 2795, rreshtat 12-17; f. 2809, rreshtat 7-12; f. 2810, rreshtat 8-15;

<sup>611</sup> **Z. Ademi:** T. 28 mars 2022, publik, f. 2809, rreshtat 15-16;

<sup>612</sup> **Z. Ademi:** T. 28 mars 2022, publik, f. 2809, rreshti 25 deri f. 2810, rreshti 1; f. 2810, rreshti 7; f. 2813, rreshtat 13-14.

<sup>613</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2306, rreshtat 1-21, f. 2307, rreshti 23 deri f. 2308, rreshti 20.

<sup>614</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2307, rreshti 6 deri f. 2310, rreshti 23; f. 2327, rreshtat 1-21.

<sup>615</sup> *Shih* para.145-148.

<sup>616</sup> **Z. Ademi:** T. 28 mars 2022, publik, f. 2860, rreshtat 2-3.



arsyeshëm lidhur me praninë e të akuzuarit në vendin e krimit në kohët përkatëse të Aktakuzës së Konfirmuar. Gjithashtu, në bazë të konstatimit të Trupit Gjykses se i akuzuari mund të lëvizte nëpër territor dhe mund të ishte në disa vende brenda së njëjtës ditë, dëshmia e alibisë së z. Ademi nuk bie ndesh me praninë e të akuzuarit në Zllash në kohët që kanë lidhje me akuzat, në dy javët e para të prillit 1999. Kjo konfirmohet gjithashtu nga fakti se distanca midis Prishtinës dhe Zllashit është jo më shumë se rreth 20 kilometra.<sup>617</sup>

316. Sa i takon z. Humolli — krahas kujdesit të madh që duhet të bëjë Trupi Gjykses në vlerësim për shkak të përkrahjes që ka treguar ai për të akuzuarin dhe anshmërisë së dëshmitarit kundër Dhomave të Specializuara<sup>618</sup> — Trupi Gjykses vëren se z. Humolli nuk ishte i sigurt për asnjë prej datave apo referencave kohore që dha. Konkretisht, z. Humolli tha në sallën e gjyqit se në Prishtinë kishte arritur “në fund të datës 30 ose në fillim të mëngjesit të hershëm të datës 31 mars”.<sup>619</sup> Kur ZPS-ja e ballafaqoi me deklaratën që i kishte dhënë më parë Mbrojtjes — ku kishte deklaruar se në Prishtinë kishte hyrë “rreth 28 marsit 1999”,<sup>620</sup> z. Humolli u përgjigj se ishte “në fund të marsit” dhe se kanë kaluar 20 vjet nga ajo kohë.<sup>621</sup> Më pas, kur u ballafaqua me deklaratën që i kishte dhënë më parë ZPS-së — në të cilën kishte deklaruar për hyrjen e tij në Prishtinë se “datat mund të jenë ose 31 mars ose 1 prill [1999]”<sup>622</sup> — z. Humolli u përgjigj: “për data nuk kam siguri të plotë, por jam i bindur që ka qenë fundi i marsit dhe fillimi i prillit [1999]. [...] unë nuk mundem me të thanë sot për data

---

<sup>617</sup> **Z. Veseli:** T. 25 janar 2022, publik, f. 2192, rreshti 18.

<sup>618</sup> *Shih* para. 134.

<sup>619</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2304, rreshtat 8-9.

<sup>620</sup> DSM00119-00133, f. DSM00123.

<sup>621</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2305, rreshtat 3, 16-17.

<sup>622</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2334, rreshti 6 deri f. 2335, rreshti 2; 100954-TR-ET Part 2, f. 28, rreshtat 9-12.

të sakta”.<sup>623</sup> Kur dëshmoi në lidhje me kohën kur ishte ndarë me të akuzuarin në Barilevë, z. Humolli tha se “duhet të jetë pasdite. Për orë të saktë, nuk e di”.<sup>624</sup>

317. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses merr parasysh se z. Humolli në mënyrë të përsëritur dhe të sigurt e lidhi takimin e pretenduar të tij me të akuzuarin me eksodin e popullatës civile drejt Maqedonisë, përmes Prishtinës, që sipas dëshmitarit ndodhi më 1 prill 1999.<sup>625</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se provat dokumentare të administruara tregojnë se ky eksod filloi më 24 mars 1999, pak pas bombardimit të NATO-s, dhe vazhdoi deri së paku më 6 prill 1999.<sup>626</sup> Trupi Gjykses nuk ka asnjë dyshim mbi mbështetshmërinë në këtë material, sepse ai e ka burimin nga subjekte të njohura ndërkombëtare të cilat vepronin në Kosovë në atë kohë (OSBE, UNHCR), mediat e pranishme në terren, dhe nga një libër përmbajtja e të cilit qartazi bazohet në burime publike dhe në dëshmi të dëshmitarëve okularë. Këto dokumente konfirmojnë njëri-tjetrin lidhur me periudhën e eksodit dhe Trupi Gjykses mbështetet në to. Krahas kësaj, Trupi Gjykses vëren se data e fillimit të eksodit konfirmohet edhe nga dëshmia e zotit F. Sopi, i cili dëshmoi se popullata filloi të largohet në masë nga Prishtina pas fillimit të sulmeve të NATO-s.<sup>627</sup> Po kështu, z. Veseli dëshmoi se “para bombardimeve [të NATO-s] ka pasur prurje shumë të mëdhaja të popullatës, po sidomos mbas bombardimeve ka pasur prurje shumë të madhe”.<sup>628</sup> Rrjedhimisht, sipas mendimit të Trupit Gjykses, provat tregojnë se ky eksod filloi më 24 mars 1999, ose rreth kësaj date, dhe vazhdoi në ditët në vijim.

318. Duke mbajtur parasysh vështirësitë e z. Humolli për të dhënë datat e sakta (apo qoftë edhe të përafërta) dhe për t’iu përmbajtur atyre, si edhe provat që kundërshtojnë

---

<sup>623</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2335, rreshtat 1-10.

<sup>624</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2327, rreshti 18.

<sup>625</sup> **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2306, rreshtat 1-4; f. 2309, rreshtat 13-18; f. 2336, rreshtat 2-4.

<sup>626</sup> SPOE00061256-00061258, f. SPOE00061257; SPOE00061259-00061261, f. SPOE00061260; SPOE00061262-00061265, f. SPOE00061263, SPOE00061264; SPOE00058374-SPOE00058374-ET; 106471-106474; 106465-106470, f. 106465-106466; SPOE00054089-00054655, f. SPOE00054543.

<sup>627</sup> **Z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2093, rreshtat 3-15.

<sup>628</sup> **Z. Veseli:** T. 25 janar 2022, publik, f. 2210, rreshtat 6-16.

dëshminë e z. Humolli për periudhën e eksodit të popullatës, është e arsyeshme të arrihet në përfundimin se edhe data e pretenduar e nisjes nga Prishtina në shoqërinë e z. Mustafa (1 prill 1999) dhe koha kur u ndanë nga njëri-tjetri (pasdreken e po asaj dite) mund të jenë të pasakta dhe rrjedhimisht dëshmi në të cilat nuk mund të mbështetesh. Në fakt, Trupi Gjykses konstaton se takimi i pretenduar i z. Humolli me të akuzuarin mund të ketë ndodhur në çfarëdo kohe që nga data 24 mars 1999 e në vijim.

319. Gjithsesi, edhe nëse supozohet se data e 1 prillit 1999 e dhënë nga z. Humolli është e saktë, Trupi Gjykses vëren se me gjithë largimin nga Prishtina herët në mëngjes dhe ndarjen në Barilevë, është e mundur që i akuzuari të ketë qenë i pranishëm në Zllash po atë ditë. Ky përfundim, siç është thënë në mënyrë të përsëritur, mbështetet nga prova të shumta dhe bindëse që tregojnë se i akuzuari kishte mundësi të përdorte mjete transporti për të udhëtuar nëpër territor, siç edhe veprimi faktikisht gjatë prillit 1999.<sup>629</sup>

320. Mbështetur në të gjitha sa më lart dhe në provat e marra në tërësi,<sup>630</sup> Trupi Gjykses konstaton se alibia e dhënë nga dëshmitarët e mësipërm nuk vërteton *prima facie* praninë e të akuzuarit në Prishtinë aq sa për të krijuar dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e të akuzuarit në Zllash në kohët përkatëse, gjatë dy javëve të para të prillit 1999.

---

<sup>629</sup> *Shih* para.248-252, 254-255.

<sup>630</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me praninë e z. Mustafa në kompleksin e ndalimit në Zllash, para. 468-473, 541-545, 551-554.

## 7. Prania e të akuzuarit në Zllash

### (a) Z. Krasniqi

321. Z. Krasniqi deklaroi se e pa zotin Mustafa në Zllash, në kompleksin e ndalimit në Zllash, në prill 1999 pa specifikuar më tej datën e saktë apo të përafërt.<sup>631</sup> Dëshmitari deklaroi se “[z. Mustafa] disa ditë para ofensivës ka qenë, ka ndejtë një natë dhe ka vazhdu. Po nuk e di bash datën e saktë, se unë në data aso, e nuk e di ka ka shkue”.<sup>632</sup> Sidoqoftë dëshmitari tha se i akuzuari qëndroi në atë vend një natë dhe pas kësaj dëshmitari nuk e pa më gjer më 21 prill 1999.<sup>633</sup>

322. Më 21 prill 1999, dëshmitari dhe i akuzuari u takuan sërish në mbrëmje dhe shkuan bashkë në Koliq për të shoqëruar të plagosurit.<sup>634</sup> Sapo mbërritën në Koliq, u ndanë, sepse dëshmitari vijoi udhëtimin me të plagosurit drejt Majacit.<sup>635</sup>

### (b) Znj. Hadri

323. Znj. Hadri dëshmoi se mbërriti në Zllash më 16 prill 1999.<sup>636</sup> Sipas dëshmitares, ajo qëndroi në vendin ku pretendohet se u kryen krimet për të cilat janë ngritur akuzat.<sup>637</sup> Znj. Hadri dëshmoi se e pa z. Mustafa aty më 17 prill 1999, një natë para se

---

<sup>631</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3905, rreshti 24 deri f. 3906, rreshtat 3; f. 3922, rreshtat 13-16; f. 3922, rreshti 23 deri f. 3923, rreshti 1. *Shih* para.349-351 (ku Trupi Gjykses konstaton se familja e z. Krasniqi ishte pronare e kompleksit të përdorur nga BIA).

<sup>632</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3922, rreshti 25 deri f. 3923, rreshti 2.

<sup>633</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3922, rreshtat 16-18.

<sup>634</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3922, rreshtat 18-21.

<sup>635</sup> **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3922, rreshtat 21-22.

<sup>636</sup> **Znj. Hadri:** T. 11 maj 2022, publik, f. 4191, rreshtat 7-10.

<sup>637</sup> **Znj. Hadri:** T. 11 maj 2022, publik, f. 4206, rreshtat 19-25, f. 4207, rreshtat 1-6. Trupi Gjykses vëren se znj. Hadri identifikoi kompleksin dhe ndërtesat konkrete ku qëndroi në bazë të një fotografie nga Broshura e Fotografive nga Ajri e UNMIK-ut (REG00-020) dhe të një fotografie nga Broshura e Fotografive nga Terreni e UNMIK-ut (DSM00134-00143, f. DSM00144), të cilat janë saktësisht të njëjta me ato që z. Krasniqi i identifikoi si pronë e familjes së tij (REG00-013, REG00-017). Këto janë edhe të njëjtat fotografi që u identifikuan nga disa dëshmitarë që dëshmuan në lidhje me krimet dhe nga anëtarë të UÇK-së. Në konstatimet faktike lidhur me ndalimin arbitrar (Pika 1), Trupi Gjykses ka konstatuar se kjo pronë ishte baza e BIA-s së cilës i referohet Aktakuza e Konfirmuar si vendi i krimit (*shih* para. 348-378).

të niste ofensiva serbe e 18 prillit 1999.<sup>638</sup> Sipas dëshmisë së dëshmitares, ajo atëherë nuk e dinte se z. Mustafa ishte komandant Cali, këtë e mori vesh më vonë, ditën e ofensivës kur pyeti se kush ishte ai djalë i ri: “më 18 kam pyetur kur është bërë ajo lufta, ofensiva e madhe, [...] kam pyet “Kush është ky djalë”? Dhe aty e kam kuptuar se është Cali.”<sup>639</sup> Dëshmitarja tha se më 18 prill 1999 i akuzuari po organizonte tërheqjen e të plagosurve dhe kjo ishte koha kur ajo e mori vesh nga ushtarët e tjerë se ai quhej Cali.<sup>640</sup>

(c) Znj. Canolli-Kaçiu

324. Znj. Canolli-Kaçiu dëshmoi se qëndroi në Zllash, në vendin ku pretendohet se ndodhën krimet e paraqitura në Aktakuzë, midis 16 dhe 21 prillit 1999 për t’u dhënë ndihmë mjekësore civilëve ose anëtarëve të ushtrisë.<sup>641</sup> Dëshmitarja dëshmoi se e takoi të akuzuarin në Zllash më 21 prill 1999, kur filluan evakuimin e të plagosurve drejt Majacit.<sup>642</sup>

(d) Z. Ajeti

325. Megjithëse dëshmoi që nuk e kishte parë z. Mustafa në Zllash në prill 1999,<sup>643</sup> z. Ajeti dëshmoi para Trupit Gjykues se, më 21 ose 22 prill 1999, e takoi të akuzuarin në Koliq, ku ishte me disa të plagosur.<sup>644</sup>

---

<sup>638</sup> **Znj. Hadri:** T. 11 maj 2022, publik, f. 4214, rreshtat 12-16; f. 4223, rreshtat 24-25.

<sup>639</sup> **Znj. Hadri:** T. 11 maj 2022, publik, f. 4214, rreshtat 16-17, 21-24; f. 4223, rreshti 25 deri f. 4224, rreshti 3.

<sup>640</sup> **Znj. Hadri:** T. 11 maj 2022, publik, f. 4224, rreshtat 1-3.

<sup>641</sup> **Znj. Canolli-Kaçiu:** T. 12 maj 2022, publik, f. 4322, rreshtat 1-2; f. 4331, rreshtat 7-9; f. 4331, rreshti 25 deri f. 4332, rreshti 8. Trupi Gjykues vëren se znj. Canolli-Kaçiu nuk e identifikoi në fotografi vendin ku kishte qenë (**znj. Canolli-Kaçiu:** T. 12 maj 2022, publik, f. 4325, rreshti 14 deri f. 4326, rreshti 19; DSM00156, DSM00159). Por, duke qenë se znj. Canolli-Kaçiu u takua dhe foli me znj. Hadri gjatë të njëjtave ditë, Trupi Gjykues arrin në përfundimin se ato ishin në të njëjtin kompleks në Zllash (**znj. Canolli-Kaçiu:** T. 12 maj 2022, publik, f. 4335, rreshtat 1-5).

<sup>642</sup> **Znj. Canolli-Kaçiu:** T. 12 maj 2022, publik, f. 4330, rreshtat 21-22.

<sup>643</sup> **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4083, rreshti 24 deri f. 4084, rreshti 1.

<sup>644</sup> **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4084, rreshtat 11, 13-14.

## (e) Përfundim

326. Trupi Gjykses konstaton se dëshmitarët që dëshmuuan për praninë e të akuzuarit në Zllash nuk dhanë prova të mirëfillta për alibi, sepse dëshmuuan vetëm se e panë të akuzuarin në Zllash në kohë të caktuara gjatë prillit 1999 ose se përgjithësisht nuk e panë atje, çka në vetvete nuk bie ndesh me deklaratën me shkrim që i akuzuari i dha ZPS-së, sepse ai rregullisht shkonte dhe vinte nga ai vend.<sup>645</sup>

327. Për shembull, sa i takon z. Ajeti, Trupi Gjykses gjykon se ai në thelb dëshmoi se nuk e pa të akuzuarin në Zllash në prill 1999,<sup>646</sup> pa dhënë asnjë hollësi se ku mund të ketë qenë faktikisht. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses mendon se dëshmia e z. Ajeti nuk është relevante për alibinë. Z. Ajeti deklaroi gjithashtu se më 21 ose 22 prill 1999, e takoi të akuzuarin në Koliq, ku ishte me disa të plagosur,<sup>647</sup> që gjithashtu nuk është relevante për alibinë, sepse ajo periudhë është jashtë dy javëve të para të prillit 1999, periudhë në të cilën pretendohet se i akuzuari ishte në vendin e krimit.

328. Sa i takon z. Krasniqi, dëshmia e tij në thelb është se e pa z. Mustafa “para ofensivës”; se ai “ka ndejtë një natë”; dhe se nuk e pa më deri më 21 prill 1999,<sup>648</sup> pa dhënë asnjë hollësi tjetër për vendin (vendet) ku mund të ishte z. Mustafa kur nuk ishte në vendin ku pretendohet se u kryen krimet. Në këtë kuptim, dëshmia e dëshmitarit për alibinë është në thelb jorelevante dhe nuk e ndihmon Trupin Gjykses të përcaktojë nëse i akuzuari mund të ketë qenë diku tjetër dhe, rrjedhimisht, mund të mos ketë qenë në Zllash në kohët përkatëse të Aktakuzës së Konfirmuar. Trupi Gjykses është i mendimit se provat që sugjerojnë se i akuzuari ishte i pranishëm në

---

<sup>645</sup> *Shih, për shembull*, dëshminë e të akuzuarit se ai qëndroi në vendstrehimin e sigurt në Zllash për 15 deri në 20 ditë (ndonëse jo vazhdimisht) deri në ofensivën e prillit të forcave serbe: z. **Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 16, rreshtat 9-15; f. 20, rreshtat 13-17. *Shih gjithashtu* 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 3, f. 19, rreshtat 17-19.

<sup>646</sup> **Z. Ajeti**: T. 22 prill 2022, publik, f. 4083, rreshti 24 deri f. 4084, rreshti 1.

<sup>647</sup> **Z. Ajeti**: T. 22 prill 2022, publik, f. 4084, rreshtat 11-14.

<sup>648</sup> **Z. Krasniqi**: T. 21 prill 2022, publik, f. 3922, rreshtat 16-18.

Zllash në një kohë të caktuar nuk përjashtojnë aspak mundësinë që ai të ishte në atë vend edhe në kohë të tjera relevante gjatë prillit 1999.

329. Po kështu, dëshmitë e znj. Hadri dhe znj. Canolli-Kaçiu, sipas të cilave që të dyja e panë të akuzuarin në Zllash, lidhen me data në të cilat nuk pretendohet që i akuzuari të ketë kryer drejtpërdrejt ndonjë prej krimeve për të cilat janë ngritur akuza. Rrjedhimisht, dëshmitë e tyre nuk kanë lidhje me alibinë.

330. Në përgjithësi, Trupi Gjykses vlerëson se dëshmitë e kufizuara për alibi, sipas të cilave i akuzuari nuk ishte në Zllash, kundërshtohen në masë të madhe nga dëshmi të shumta dhe konfirmuese që tregojnë se i akuzuari, në fakt, ishte atje, madje edhe shpesh. Këto dëshmi, të cilat do të diskutohen me hollësi në konstatimet faktike mbi krimet për të cilat janë ngritur akuzat, përfshijnë: (i) dëshmitarë për krimet, si W01679 dhe W03593, të cilët dëshmuuan se u keqtrajtuan nga vetë i akuzuari;<sup>649</sup> (ii) W04600-n, që e pa dhe foli me të akuzuarin në kompleksin e ndalimit në Zllash<sup>650</sup> (iii) z. Veseli, që deklaroi se i akuzuari ishte shpesh në Zllash në prill 1999;<sup>651</sup> dhe (iv) vetë të akuzuarin, që gjithashtu deklaroi se ishte shpesh në Zllash gjatë prillit 1999, siç u konstatua më lart.<sup>652</sup>

331. Mbështetur në të gjitha sa më lart dhe në provat e marra në tërësi,<sup>653</sup> Trupi Gjykses konstaton se alibia e dhënë nga dëshmitarët e lartpërmendur për mospraninë e të akuzuarit në Zllash nuk vërtetojnë *prima facie* praninë e të akuzuarit në vende të tjera të ndryshme nga vendi ku pretendohet se u kryen krimet, aq sa për të krijuar dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e të akuzuarit në Zllash në kohët përkatëse, gjatë dy javëve të para të prillit 1999.

---

<sup>649</sup> *Shih* para.541-545, 551-554.

<sup>650</sup> *Shih* para.468-473.

<sup>651</sup> **Z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2233, rreshtat 1-3.

<sup>652</sup> *Shih* para.248-252.

<sup>653</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me praninë e z. Mustafa në kompleksin e ndalimit në Zllash, para.468-473, 541-545, 551-554.



## 8. Përfundim i përgjithshëm mbi alibinë e të akuzuarit

332. Trupi Gjykues ka konstatuar se i akuzuari në mënyrë të përsëritur shkonte dhe vinte nga Zllashi në kohët që lidhen me Aktakuzën e Konfirmuar, përfshirë edhe sipas nevojës dhe pasi informohej nëpërmjet radiolidhjes apo telefonit satelitor. Trupi Gjykues ka konstatuar gjithashtu se i akuzuari, dhe përgjithësisht anëtarët e UÇK-së, kishin në dispozicion automjete të ndryshme, disa prej të cilave ishin posaçërisht të përshtatshme për terren malor dhe të vështirë (traktorë, automjete 4x4, xhipa), të cilat i përdornin për të lëvizur nëpër territorin përreth Zllashit. Gjithashtu, Trupi Gjykues ka konstatuar se të marra në tërësi, provat për praninë e të akuzuarit në Butovc, Barilevë, Rimanishtë dhe Bellopojë, si dhe në Prishtinë në kohët përkatëse gjatë periudhës kohore të akuzave, nuk rezultojnë në një përfundim të prerë. Konkretisht, Trupi Gjykues nuk bindet që i akuzuari *nuk* ishte i pranishëm në Zllash në kohët që lidhen me akuzat.

333. Mbështetur në sa më lart dhe duke mbajtur parasysh konstatimet e Trupit Gjykues për Pikat 1-4 lidhur me praninë e të akuzuarit në vendin e krimit,<sup>654</sup> alibia e paraqitur nga Mbrojtja nuk mund të krijojë dyshim të arsyeshëm lidhur me praninë e të akuzuarit në vendin e krimit në kohët përkatëse sipas Aktakuzës së Konfirmuar.

---

<sup>654</sup> *Shih* para.468-473, 541-545, 551-554.

B. NJËSITI BIA, ROLI I TË AKUZUARIT DHE RAPORTI I BIA-S ME KOMANDËN E ZONËS OPERATIVE TË LLAPIT

1. Krijimi dhe struktura e BIA-s

334. Sipas dëshmimeve reciprokisht konfirmuese të dëshmitarëve, BIA<sup>655</sup> ishte njësit gueril i UÇK-së në Zonën Operative të Llapit.<sup>656</sup> Zona Operative e Llapit përfshinte zonat e Prishtinës (përfshirë Zllashin) dhe Podujevën.<sup>657</sup> Krahas BIA-s, në Zonën Operative të Llapit vepronin edhe Brigadat 151, 152 dhe 153.<sup>658</sup> Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, shtabi i Zonës Operative të Llapit kishte marrë masa për rekrutimin, stërvitjen dhe caktimin në detyrë të ushtarëve të rinj, si edhe për strukturimin, zgjerimin dhe forcimin e strukturave komanduese në Zonën Operative të Llapit.<sup>659</sup> Zona Operative e Llapit komandohej nga Rrustem Mustafa (me nofkën “Remi”) gjatë gjithë periudhës kohore që ka lidhje me akuzat.<sup>660</sup>

<sup>655</sup> Shkurtesa BIA përfaqëson emrat e tre anëtarëve të UÇK-së që kishin rënë në luftë: Bahri Fazliu, Ilir Konushefci dhe Agron Rrahmani. *Shih z. Mustafa*: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 24, rreshtat 18-21; 7000650-7000660, f. 7000653; **z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2045, rreshtat 7-10; **z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2195, rreshtat 23-24.

<sup>656</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 26, rreshti 11 deri f. 27, rreshti 9; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 13, rreshti 4 deri f. 14, rreshti 19; 069404-TR-ET Part (Pjesa)3, f. 25, rreshtat 15-17; **z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2059, rreshtat 11-16; **z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2656, rreshti 24 deri f. 2657, rreshti 1.

<sup>657</sup> SPOE00238090-00238090; SPOE00238092-00238092. *Shih gjithashtu* SPOE00055705-SPOE00055708-ET, f. 00055708; SPOE00208166-00208166; SPOE00238093-00238093; SPOE00238094-00238094.

<sup>658</sup> Decision on Adjudicated Facts (Vendimi mbi Faktet e Shqyrtuara), para. 14; Adjudicated Facts (Faktet e Shqyrtuara), Faktet 45, 47-48. *Shih gjithashtu, për shembull, z. Mustafa*: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 27, rreshtat 10-12; **z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2113, rreshtat 1-25; 069474-TR-ET Part 1, f. 12, rreshtat 3-10; f. 14, rreshti 25 deri f. 15, rreshti 11.

<sup>659</sup> *Shih* SPOE00055705-SPOE00055708-ET, f. 00055705; SPOE00055799-SPOE00055868-ET, f. 1-10.

<sup>660</sup> Kadri Kastrati (me nofkën Daja) ishte zëvendëskomandanti i Zonës Operative të Llapit, z. Ibishi (me nofkën Leka) shefi i shtabit, dhe Latif Gashi (me nofkën Lata) shefi i zbulimit në shtabin e komandës së Zonës Operative të Llapit; *shih* Decision on Adjudicated Facts (Vendim mbi Faktet e Shqyrtuara), para. 14; Adjudicated Facts (Faktet e Shqyrtuara), Faktet 46-47. *Shih gjithashtu z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2036, rreshtat 24-25; f. 2075, rreshtat 2-9; f. 2076, rreshtat 12-13; 7000669-7000676 RED, f. 7000671; 7000593-7000609 RED, f. 7000596, 7000597; 069474-TR-ET Part 1, f. 14, rreshtat 3-23; **z. Humolli**: T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2417, rreshtat 16-25. *Shih gjithashtu* SPOE00055705-SPOE00055708-ET, f. 00055705.

335. Në bazë të provave, Trupi Gjykses konstaton se BIA, që njihej edhe si “Skifterat” ose “Skifteri”,<sup>661</sup> u krijua më 20 maj 1998 dhe vepronte në zonën e Prishtinës dhe më vonë edhe në Podujevë.<sup>662</sup> Ajo kishte disa qindra anëtarë – në kohë të caktuara midis 500 dhe 600 – dhe numri i tyre ndryshonte gjatë kohës së ekzistencës së saj.<sup>663</sup>

336. Në periudhën përkatëse, disa ushtarë të BIA-s mbanin uniforma të kamufluara ose të zeza me stemën zyrtare të UÇK-së ose të BIA-s dhe ishin të armatosur, ndërsa të tjerët mbanin veshje civile.<sup>664</sup> Të gjithë ushtarët e BIA-s kishin dokument identifikimi dhe një pllakë të varur në qafë me të cilat identifikoheshin si ushtarë guerilë.<sup>665</sup> Simboli i BIA-s ishte një zog gjahtar.<sup>666</sup>

337. Trupi Gjykses nuk ka arsye për të dyshuar në besueshmërinë e këtyre dëshmimeve, sepse ato vijnë kryesisht nga anëtarë të UÇK-së, përfshirë të akuzuarin, të cilët kanë njohuri të hollësishme për UÇK-në në përgjithësi, veprimtaritë dhe strukturat e Zonës Operative të Llapit, si dhe për BIA-n në veçanti. Krahas kësaj, dëshmitarët konfirmuan dëshmitë e njëri-tjetrit.

---

<sup>661</sup> *Shih, për shembull, z. Mustafa*: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 24, rreshti 3 deri f. 25, rreshti 12; *z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2045, rreshtat 4-6; **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 723, rreshti 8.

<sup>662</sup> *Z. Mustafa*: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 26, rreshti 11 deri f. 27, rreshti 9; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 4, rreshtat 17-25; f. 8, rreshtat 23-25; f. 13, rreshtat 7-13; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 12, rreshti 12 deri f. 16, rreshti 13; f. 25, rreshtat 8-17; *z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2059, rreshtat 11-16; *z. Veseli*: T. 25 janar 2022, publik, f. 2197, rreshtat 4-5. *Shih gjithashtu* SPOE00055705-SPOE00055708-ET, f. 00055708.

<sup>663</sup> *Z. Mustafa*: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 27, rreshti 18 deri f. 28, rreshti 5; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 9, rreshtat 21-25; *z. Mehmetaj*: T. 23 mars 2022, publik, f. 2670, rreshtat 9-14.

<sup>664</sup> Për stemën e UÇK-së, *shih Adjudicated Facts* (Faktet e Shqyrtuara), Fakti 52. *Shih gjithashtu W01679*: T. 4 tetor 2021, publik, f. 865, rreshtat 21-25; f. 887, rreshtat 12-21; **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 441, rreshti 23 deri f. 442, rreshti 10; T. 22 shtator 2021, publik f. 576, rreshtat 23-24; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1437, rreshtat 15-19; f. 1441, rreshti 21 deri f. 1442, rreshti 18; **W03594**: T. 13 tetor 2021, publik, f. 1198, rreshtat 11-24; *z. Mustafa*: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 4, f. 2, rreshtat 7-12.

<sup>665</sup> *Z. Mustafa*: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 3, f. 26, rreshtat 2-4.

<sup>666</sup> *Z. Mustafa*: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 26, rreshtat 13-25.

## 2. Roli i të akuzuarit në BIA

338. Trupi Gjykues vëren se i akuzuari dha dëshmi të hollësishme dhe të besueshme mbi rolin e tij në BIA, që u konfirmua edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues është bindur se i akuzuari iu bashkua UÇK-së në fillim të shtatorit 1997.<sup>667</sup> Në maj 1998, ai u emërua nga komandanti i atëhershëm i Zonës Operative të Llapit të UÇK-së, Rrustem Mustafa (me nofkën “Remi”), si komandant i BIA-s së sapokrijuar.<sup>668</sup> Sipas deklaratave të atij vetë, i akuzuari e mbajti këtë post deri afërsisht në mes të qershorit 1999, kur njësitë u shpërbë.<sup>669</sup> Siç deklaroi vetë i akuzuari, “qendra [ka] qenë” vetë ai, pra ai ishte komandanti i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s gjatë të gjithë ekzistencës së BIA-s, përfshirë në prill 1999,<sup>670</sup> dhe ai ishte gjithashtu përgjegjës për mbledhjen e informatave të zbulimit.<sup>671</sup> Posti i tij si komandant konfirmohet nga fakti se deri në shkurt 1999, zëvendës dhe ndihmës i parë i të akuzuarit ishte z. Mehmetaj (me nofkën “Bimi”);<sup>672</sup> ndërsa nga shkurti 1999 deri në 21 prill 1999, ishte Isa Kastrati, pasuar nga Bahri Gashi (me nofkën “Bafta”).<sup>673</sup> Trupi Gjykues vëren gjithashtu se i akuzuari, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së,

<sup>667</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 8, rreshtat 15-16.

<sup>668</sup> **Z. Mustafa:** 7000650-7000660, f. 7000651, 7000656, 7000657; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 24, rreshti 16 deri f. 25, rreshti 2 (mbështetur në pjesën tjetër të deklaratës së z. Mustafa, Trupi Gjykues konsideron se fjala “left” (jam larguar) në f. 24, rreshti 17 të versionit në anglishte është gabim; duhet lexuar si “led” (kam udhëhequr)); f. 32, rreshtat 13-14; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 22, rreshti 15 deri f. 23, rreshti 8. *Shih gjithashtu, për shembull, W04600:* T. 23 shtator 2021, publik, f. 718, rreshtat 22-23.

<sup>669</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 7, f. 30, rreshtat 17-19; f. 24, rreshti 12 deri f. 26, rreshti 15; 7000650-7000660, f. 700653, 700658.

<sup>670</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 29, rreshtat 2-5; f. 31, rreshtat 13-24; f. 32, rreshti 14; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 14, rreshti 17 deri f. 15, rreshti 3. *Shih gjithashtu, për shembull, z. Humolli:* T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2418, rreshtat 1-6; f. 2443, rreshtat 1-6.

<sup>671</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 32, rreshtat 6-14; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 6, f. 13, rreshtat 1-16; **z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2620, rreshti 22 deri f. 2621, rreshti 25; f. 2666, rreshti 21 deri f. 2667, rreshti 3; f. 2668, rreshti 16 deri f. 2670, rreshti 8.

<sup>672</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 4, f. 3, rreshtat 18-20; **z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2618, rreshtat 17-20; f. 2665, rreshtat 21-25.

<sup>673</sup> **Z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2713, rreshti 13 deri f. 2714, rreshti 11.

shkuan te familja Krasniqi<sup>674</sup> në Prishtinë për të kërkuar leje për të përdorur pronën e saj në Zllash, që më pas u bë bazë e BIA-s.<sup>675</sup>

339. BIA, dhe i akuzuari si komandant i BIA-s, i merrnin urdhrat dhe i raportonin drejtpërdrejt Shtabit të Komandës së Zonës Operative të Llapit: Rustem Mustafës, Kadri Kastratit, zotit Ibishi dhe Latif Gashit.<sup>676</sup> Sipas dëshmimeve, i akuzuari kishte kompetencë ekskluzive të bënte emërimet brenda BIA-s, përfshirë për postet e zëvendëskomandantëve dhe ndihmësve të parë të tij.<sup>677</sup> Siç deklaroi vetë i akuzuari dhe siç u konfirmua nga dëshmitarë të tjerë në sallën e gjyqit, ai gjithashtu kishte kompetencën t'u jepte urdhra vartësve të tij, ndër të tjera në lidhje me vëzhgimin e lëvizjeve të forcave serbe, identifikimin e objektivave të mundshme ushtarake dhe dërgimin e furnizimeve mjekësore.<sup>678</sup> Gjithashtu, ai merrte informacion për shkeljet e kryera nga ushtarët e BIA-s dhe kishte kompetencën t'i disiplinonte.<sup>679</sup>

---

<sup>674</sup> [REDAKTUAR].

<sup>675</sup> **Z. Mustafa**, 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 20, rreshtat 15-18; **z. Krasniqi**: T. 21 prill 2022, publik, f. 3957, rreshti 13 deri f. 3958, rreshti 25; T. 22 prill 2022, f. 4039, rreshti 21 deri f. 4040, rreshti 2.

<sup>676</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 23, rreshti 24 deri f. 24, rreshti 8; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 13, rreshtat 7-10; f. 14, rreshtat 17-19; f. 15, rreshti 4 deri f. 16, rreshti 5; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 3, rreshtat 13-21; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 4, f. 12, rreshti 18 deri f. 13, rreshti 15; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 6, f. 13, rreshtat 18-21. *Shih gjithashtu z. Mehmetaj*: T. 23 mars 2022, publik, f. 2656, rreshti 24 deri f. 2657, rreshti 1; f. 2665, rreshtat 4-20; f. 2668, rreshtat 12-21; f. 2670, rreshtat 3-8; **z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2059, rreshtat 11-16; **z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2196, rreshtat 20-21. Lidhur me nofkën e Latif Gashit "Lata", *shih, për shembull, z. Veseli*: 069889-TR-ET Part 1, f. 15, rreshtat 4-5.

<sup>677</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2666, rreshtat 4-6.

<sup>678</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 2, f. 3, rreshti 14 deri f. 4, rreshti 10; f. 8, rreshtat 1-25; **z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2621, rreshtat 20-22; f. 2665, rreshtat 2-9; f. 2666, rreshtat 4-20; f. 2668, rreshtat 12-21; T. 24 mars 2022, publik, f. 2741, rreshtat 17-23; **znj. Canolli-Kaçiu**: T. 12 maj 2022, publik, f. 4355, rreshti 25 deri f. 4356, rreshti 3. Kjo u konfirmua edhe nga W03593-shi që deklaroi: "Unë e bazoj se pa thënë i akuzuari ata s'kanë bërë kurrëgjë. Të tjerët ushtarët që janë konë. I akuzuari a konë [...] kryesori dhe ai ishte -- këtë e di" (**W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 414, rreshtat 7-9).

<sup>679</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 6, f. 2, rreshti 10 deri f. 3, rreshti 22; f. 5, rreshti 24 deri f. 6, rreshti 20; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 5, f. 22, rreshtat 4-18.

340. I akuzuari deklaroi se njihej me nofkën “Cali”<sup>680</sup> dhe se e thërrisnin edhe “komandant Sali”.<sup>681</sup> Dëshmi të shumta dhe reciprokisht konfirmuese nga dëshmitarë ish-anëtarë të UÇK-së (përfshirë anëtarë të BIA-s) konfirmojnë deklaratën e të akuzuarit lidhur me postin e tij si komandant i BIA-s dhe se kishte nofkën “Cali”.<sup>682</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues merr parasysh se shumica e këtyre anëtarëve të UÇK-së kishin poste komanduese të niveleve të ndryshme në UÇK, që sipas vlerësimit të Trupit Gjykues do të thotë se ata kishin njohuri për strukturat operative të UÇK-së. Kjo e bën edhe më të fortë natyrën konfirmuese të këtyre dëshmive, kur konsiderohen së bashku me deklaratat e të akuzuarit. Për më tepër, W01679 dhe W03593 gjithashtu konfirmuan se i akuzuari ishte komandanti i BIA-s dhe se njihej si “Cali”, sepse ata dëgjuan anëtarë të tjerë të BIA-s që e quanin me atë emër.<sup>683</sup>

341. Siç ka pranuar ai vetë dhe është konfirmuar edhe nga dëshmi të tjera, i akuzuari mbante, së paku për një periudhë të caktuar kohe,<sup>684</sup> një kapelë ose beretë të kuqe,<sup>685</sup> e

<sup>680</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 4, rreshtat 23-25. *Shih gjithashtu, për shembull, z. Veseli:* T. 25 janar 2022, publik, f. 2196, rreshtat 3-6; **W04600:** T. 23 shtator 2021, publik, f. 718, rreshtat 22-25.

<sup>681</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 8, f. 7, rreshtat 3-9; f. 8, rreshtat 2-4.

<sup>682</sup> **Z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2060, rreshti 4 deri f. 2061, rreshti 6; **z. Veseli:** T. 25 janar 2022, publik, f. 2195, rreshti 25 deri f. 2196, rreshti 6; **z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2303, rreshtat 19-22; **W04600:** T. 23 shtator 2021, publik, f. 718, rreshtat 22-25; **z. G. Sopi:** T. 4 prill 2022, publik, f. 3143, rreshti 10 deri f. 3144, rreshti 8; **z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3550, rreshtat 23-25; f. 3611, rreshtat 23-25; *shih gjithashtu* para. 89 (ku Trupi Gjykues i jep pak peshë dëshmisë së W04669-ës se kishte dy persona me nofkën Cali).

<sup>683</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, publik, f. 872, rreshti 18 deri f. 873, rreshti 18; f. 877, rreshtat 13-21; f. 882, rreshtat 3-12; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 876, rreshtat 9-13; **W03593:** T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 435, rreshti 8 deri f. 438, rreshti 11; T. 22 shtator 2021, publik, f. 652, rreshti 6 deri f. 654, rreshti 18; f. 656, rreshti 13 deri f. 657, rreshti 9.

<sup>684</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 27, rreshtat 10-12.

<sup>685</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 4, f. 3, rreshtat 1-3; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 8, f. 7, rreshtat 3-9. I akuzuari bëri të ditur se herë pas here mbante edhe një beretë të zezë dhe një kapelë amerikane me strehë: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 27, rreshtat 10-12. *Shih gjithashtu* **W04600:** T. 24 shtator 2021, publik, f. 765, rreshtat 7-14; 082249-082258, f. 082256; *shih gjithashtu* fotografi të shumta të akuzuarit ku mban kapelë të kuqe të cilat janë në dispozicion të Trupit Gjykues si prova dhe disa prej të cilave u diskutuan edhe në sallën e gjyqit: SPOE00222549-00222549; SPOE00222550-00222550; SPOE00222551-00222551; SPOE00222552-00222552; SPOE00222554-00222554; SPOE00222556-00222556; SPOE00222557-00222557; SPOE00222563-00222563; SPOE00222565-00222565; SPOE00222567-00222567; SPOE00222568-00222568; SPOE00222569-00222569; SPOE00222570-00222570; SPOE00222572-00222572;



cila nuk ishte pjesë e uniformës së zakonshme të BIA-s.<sup>686</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka asnjë provë që ndokush tjetër në BIA apo në Zllash të quhej komandant Cali apo të mbante beretë të kuqe.<sup>687</sup> Në fakt, vetë i akuzuari deklaroi: “beretë, besoj, që krejt guerilen ... pos unë [në Zllash] e kam pas një beretë të kuqe”.<sup>688</sup>

### 3. Marrëdhënia midis BIA-s dhe Brigadës 153

342. Trupi Gjykses ka marrë gjithashtu dëshmi reciprokisht konfirmuese që tregojnë se BIA ishte e pavarur nga brigadat e tjera në Zonën Operative të Llapit, përfshirë Brigadën 153.<sup>689</sup> Në bazë të provave, Trupi Gjykses konstaton se nga shkurti 1999 e më pas, Brigada 153<sup>690</sup> e sapoformuar e kishte shtabin në Zllash, por gjithmonë në njëfarë distance nga baza e BIA-s,<sup>691</sup> për vendndodhjen e së cilës Trupi Gjykses bëri

---

SPOE00222582-00222582; SPOE00222585-00222585; SPOE00222589-00222589; SPOE00222600-00222600; SPOE00222602-00222602; SPOE00222619-00222619; SPOE00222639-00222639; SPOE00222682-00222682; SPOE00222688-00222688; SPOE00222695-00222695.

<sup>686</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 4, f. 3, rreshti 3.

<sup>687</sup> *Shih gjithashtu z. Mustafa:* 069404-TR-ET Part (Pjesa) 8, f. 7, rreshtat 3-21; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 4, f. 3, rreshtat 1-3.

<sup>688</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 4, f. 3, rreshtat 1-3; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 8, f. 8, rreshtat 5-7.

<sup>689</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 14, rreshtat 20-21; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 20, rreshti 19 deri f. 24, rreshti 2; **z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2059, rreshtat 7-10; f. 2074, rreshtat 15-17; [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu z. Veseli:* T. 25 janar 2022, publik, f. 2192, rreshtat 13-14; f. 2196, rreshtat 18-25; f. 2198, rreshtat 4-6; f. 2263, rreshtat 22-24; **z. Humolli:** T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2418, rreshtat 1-14.

<sup>690</sup> Urdhra luftimi dhe dokumente të tjera të lëshuara nga komanda e Brigadës tregojnë se Brigada 153 vepronte gjatë periudhës kohore që lidhet me Aktakuzën e Konfirmuar, *shih, për shembull*, U001-0399-U001-0400-ET; U000-9175-U000-9175-ET; U000-4319-U000-4321-ET; U000-4205-U000-4206-ET.

<sup>691</sup> Fillimisht, shtabi i Brigadës 153 ishte në shtëpinë e zotit F. Sopi (dy-tre kilometra nga baza e BIA-s), më vonë në shtëpinë e axhës së zotit F. Sopi, përbri shkollës fillore “Avni Rustemi” të Zllashit (një-dy kilometra nga baza e BIA-s), dhe në fund, pas “ofensivës serbe të 18 prillit 1999”, në shtëpinë e Shaban Gashit; *shih z. F. Sopi:* T. 18 janar 2022, publik, f. 2043, rreshti 3 deri f. 2044, rreshti 23; 069474-TR-ET Part (Pjesa) 1 RED, f. 25, rreshti 19 deri f. 26, rreshti 3; **z. Veseli:** T. 25 janar 2022, publik, f. 2192, rreshtat 15-18; f. 2194, rreshti 23 deri f. 2195, rreshti 5; f. 2198, rreshtat 4-6; f. 2226, rreshtat 10-14; [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu z. Mustafa:* 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 12, rreshtat 1-7; f. 13, rreshti 2 deri f. 14, rreshti 8; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 7, f. 3, rreshtat 1-21. *Shih gjithashtu* SPOE00055870-SPOE00055988-ET, f. 43; **z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2650, rreshti 23 deri f. 2651, rreshti 2.



konstatim në kuadër të konstatimeve faktike lidhur me ndalimin arbitrar (Pika 1).<sup>692</sup> Brigada 153 kishte edhe një qendër stërvitore në shkollën e Zllashit.<sup>693</sup> Brigada 153, dhe në veçanti komandanti i saj, komunikonte drejtpërdrejt me Zonën Operative të Llapit, përkatësisht me komandantin e saj (Rrustem Mustafën) ose zëvendësin e tij (Kadri Kastratin).<sup>694</sup>

343. Trupi Gjykses i konsideron këto dëshmi të besueshme, jo vetëm për shkak se konfirmojnë plotësisht njëra-tjetrën, por edhe sepse vijnë nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët edhe anëtarë me poste të larta, si dhe nga i akuzuari, të cilët i njihnin strukturat e UÇK-së dhe nuk duket se kishin ndonjë motiv për t'i trilluar informacionet për to.

344. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka marrë prova konfirmuese se Adem Shehu, z. Veseli dhe zoti F. Sopi bënë pjesë në komandën e Brigadës 153; konkretisht, Adem Shehu u emërua zyrtarisht komandant i brigadës në shkurt 1999 dhe filloi detyrën në mars 1999.<sup>695</sup> Z. Veseli ishte zëvendësi i tij deri në fund të prillit 1999, kur u zëvendësua nga zoti F. Sopi, që ishte fillimisht ndihmëskomandant për mbrojtjen civile në Brigadë.<sup>696</sup>

---

<sup>692</sup> *Shih* para.354-355.

<sup>693</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2044, rreshtat 10-18; T. 18 janar 2022, konfidencial, f. 2102, rreshti 23 deri f. 2104, rreshti 6; 069474-TR-ET Part (Pjesa) 1 RED, f. 23, rreshtat 11-20; 069474-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 5, rreshtat 11-12; **z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2195, rreshtat 6-13; 069889-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 21, rreshti 22 deri f. 22, rreshti 18; **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 864, rreshtat 7-20; SPOE00128386-00128420 RED2, f. 00128412. *Shih gjithashtu* SPOE00213459-00213487.

<sup>694</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2074, rreshti 18 deri f. 2075, rreshti 24.

<sup>695</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2035, rreshti 22 deri f. 2038, rreshti 3.

<sup>696</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 11, rreshti 4 deri f. 12, rreshti 11; **z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2035, rreshti 22 deri f. 2038, rreshti 21; 069474-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 25, rreshtat 8-18; 069474-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 1, rreshtat 14-23; f. 8, rreshtat 8-14; 7000593-7000609 RED, f. 7000597; **z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2191, rreshti 7 deri f. 2192, rreshti 9; f. 2210, rreshti 23 deri f. 2211, rreshti 3; 069889-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 17, rreshti 2 deri f. 18, rreshti 25; 069889-TR-ET Part (Pjesa) 2, f. 2, rreshtat 10-19. *Shih gjithashtu* SITF00427788-00427788; SITF00427789-00427789; U000-4204-U000-4204-ET; U000-4319-U000-4321-ET; U000-4204-U000-4204-ET; U001-0399-U001-0400-ET; SPOE00055870-SPOE00055988-ET, f. 42.

345. Së fundi, Trupi Gjykses konstaton se ka prova të mjaftueshme konfirmuese se Agron Xhemajli (me nofkën "Agimi") ("z. Xhemajli")<sup>697</sup> ishte anëtar i Brigadës 153.<sup>698</sup> Ai bënte pjesë në shtabin e Brigadës<sup>699</sup> dhe mori detyrën e shefit të shërbimit informativ,<sup>700</sup> që ishte në thelb shërbim zbulimi.<sup>701</sup>

### C. NDALIMI ARBITRAR (PIKA 1)

346. Përpara se të bëjë konstatime faktike lidhur me ndalimin arbitrar (Pika 1), Trupi Gjykses dëshiron të sqarojë si në vijim. Akuzat lidhur me Pikën 1 (si edhe ato lidhur me Pikat 2-4) kanë kuadër gjeografik specifik, konkretisht atë që në Aktakuzën e Konfirmuar quhet kompleksi i ndalimit në Zllash.<sup>702</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykses mund të shqyrtojë pretendime apo rrethana faktike që dalin jashtë kuadrit gjeografik të akuzave, në qoftë se ato kanë lidhje me konstatimet mbi aspekte që përfshihen në kuadrin e akuzave, si për shembull rrethanat në të cilat u arrestuan fillimisht personat të cilët pretendohet se më pas u mbajtën të ndaluar. E njëjta gjë vlen edhe për pretendimet apo rrethanat faktike jashtë kuadrit kohor të akuzave. Për më tepër, Trupi Gjykses mund ta përdorë këtë informacion edhe për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarëve apo për qëllime kontekstualizimi.

---

<sup>697</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343 RED1, f. 00128339; SPOE00130685-00130687 RED1, f. 00130686; [REDAKTUAR].

<sup>698</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2102, rreshtat 9-11; **z. Ajeti**: T. 22 prill 2022, publik, f. 4131, rreshti 23 deri f. 4132, rreshti 1; [REDAKTUAR]. Trupi Gjykses vëren se z. Veseli dëshmoi ndryshe, konkretisht që z. Xhemajli nuk ishte anëtar i Brigadës 153. Mirëpo, sipas mendimit të Trupit Gjykses, ai dëshmoi kështu kryesisht për të theksuar se z. Xhemajli nuk i raportonte komandës së Brigadës 153, por Zonës Operative të Llapit (**z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2214, rreshti 16 deri f. 2215, rreshti 8). Duke mbajtur parasysh dëshmitë konfirmuese të zotit F. Sopi, z. Ajeti [REDAKTUAR], dëshmia e z. Veseli nuk e ndryshon konstatimin e Trupit Gjykses se z. Xhemajli ishte anëtar i Brigadës 153.

<sup>699</sup> SITF00427789-00427789.

<sup>700</sup> [REDAKTUAR].

<sup>701</sup> **Z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2215, rreshtat 2-4. [REDAKTUAR].

<sup>702</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 18-20, 35.

347. Trupi Gjykses më poshtë do të vlerësojë provat dhe do të bëjë konstatime faktike në lidhje me nëse afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, të paktën gjashtë personave<sup>703</sup> - ndër të cilët [REDAKTUAR] (W01679), [REDAKTUAR]<sup>704</sup> (W03593), [REDAKTUAR] (W03594), [REDAKTUAR] (W04669), viktima e vrasjes së paligjshme,<sup>705</sup> një person i njohur si [REDAKTUAR],<sup>706</sup> dhe [REDAKTUAR] – iu hoq arbitrarisht liria pa proces ligjor të rregullt nga i akuzuari dhe disa anëtarë të UÇK-së, konkretisht të njësitit BIA. Ku është e mundur, Trupi Gjykses i analizon provat për secilin të ndaluar më vete, me qëllim që të përcaktojë qartë faktet që lidhen me secilin prej të burgosurve të pretenduar, konkretisht: (i) rrethanat e arrestimit të tyre fillestar, nëse dihen; (ii) vendin e ndalimit; (iii) praninë dhe identifikimin e të ndaluarve të tjerë; (iv) periudhën dhe rrethanat e lirimit të tyre; dhe (v) mungesën e garancive procedurale.

---

<sup>703</sup> Trupi Gjykses përdor në të gjithë Aktgjykimin formulimin “të paktën gjashtë persona” ndonëse evidenton shtatë prej viktimave, sepse i përmbahet formulimit të akuzave nga ZPS-ja në Aktakuzën e Konfirmuar; *shih* [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 18.

<sup>704</sup> W03593 përmendet gjithashtu edhe si [REDAKTUAR] (W01679: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 889, rreshtat 4-13) ose thjesht [REDAKTUAR] (W03594: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1046, rreshtat 18-24). Në deklaratën me shkrim të W03594-ës për ZPS-në, dëshmitari identifikoi [REDAKTUAR], i cili akuzohej për bashkëpunim me serbët (W03594: 061016 TR-ET, Pjesa 1, f. 21, rreshtat 17-21). Në dëshminë para Trupit Gjykses, W03594 konfirmoi identifikimin e W03593-shit, por shtoi se “se kohë pas kohe po i harroj” (W03594: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1047, rreshti 19 deri në f. 1050, rreshti 23). Mbështetur në tërësinë e provave, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se personi i përmendur më lart është W03593.

<sup>705</sup> W03593 i referohet [REDAKTUAR] sepse ky i fundit ishte nga fshati [REDAKTUAR]; kur u pyet, dëshmitari qartësoi se e njëjti [REDAKTUAR] (W03593: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 404, rreshti 1 deri në f. 405, rreshti 1). Më vonë, W03593 tha se [REDAKTUAR] janë i njëjti person (W03593: T. 20 shtator 2021, konfidencial, p. 473, rreshtat 11-15). Gjithashtu, edhe W03594 i referohej [REDAKTUAR] (W03594: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1046, rreshtat 18-24). Në deklaratën me shkrim të W03594-ës për ZPS-në, dëshmitari kishte identifikuar [REDAKTUAR] (W03594: 061016 TR-ET, Part (Pjesa) 1; f. 22, rreshtat 6-10). Në dëshminë para Trupit Gjykses, W03594 konfirmoi identifikimin e [REDAKTUAR], por shtoi se “se kohë pas kohe po i harroj” (W03594: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1047, rreshti 19 deri në f. 1050, rreshti 23). Mbështetur në tërësinë e provave, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se personi që përmendet më lart është [REDAKTUAR].

<sup>706</sup> W03594 iu referua [REDAKTUAR] (W03594: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1187, rreshtat 7-10). Mbështetur në provat në tërësi, Trupi Gjykses gjykon se ky ndryshim i vogël në mënyrën e të shkruarit të emrit nuk ngre asnjë dyshim dhe konstaton se [REDAKTUAR] janë i njëjti person.

## 1. Kompleksi ku u kryen krimet për të cilat janë ngritur akuza

348. Fillimisht, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë nëse vendi i përmendur nga ZPS-ja në Aktakuzën e Konfirmuar është me të vërtetë vendi ku u kryen krimet e pretenduara, të paraqitura në këtë Aktakuzë. Në lidhje me këtë, ZPS-ja pretendon se krimet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar u kryen në kompleksin e ndalimit në Zllash - një kompleks ndërtesash në Zllash që shërbeu si bazë e BIA-s gjatë prillit 1999.<sup>707</sup>

### (a) Prania e një baze të BIA-s në Zllash në prill 1999

349. Në fillim, Trupi Gjykses vë në dukje se vetë i akuzuari, në deklaratën për ZPS-në dhe në deklaratën e mëparshme në çështjen gjyqësore *Agron Zeqiri*, dha dëshmi për praninë e anëtarëve të BIA-s në Zllash gjatë periudhës së akuzave.<sup>708</sup> Në lidhje me këtë pikë, i akuzuari deklaroi se BIA ishte vendosur në një kompleks specifik ndërtesash,<sup>709</sup> me një "bazë të sigurt",<sup>710</sup> dhe se ai ishte pronë e një fshatari vendas të cilit i akuzuari dhe kolegët e tij i morën leje për ta shfrytëzuar.<sup>711</sup> Trupi Gjykses e konsideron veçanërisht të besueshme dëshminë e të akuzuarit në lidhje me këtë pikë, bazuar në pohimin e vetë të akuzuarit se ai ishte komandanti i BIA-s<sup>712</sup> dhe se kishte qëndruar

---

<sup>707</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 5, 35.

<sup>708</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Pjesa 3, f. 18, rreshtat 6-13. Në lidhje me këtë pikë, dëshmia e të akuzuarit ishte në përputhje me deklaratën e tij të mëparshme në çështjen gjyqësore *Agron Zeqiri* (**z. Mustafa:** 7000650-7000660, f. 8).

<sup>709</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 8, f. 1, rreshti 19 deri në f. 4, rreshti 15.

<sup>710</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 3, p. 14, rreshtat 14-15; f. 18, rreshtat 19-22; Part (Pjesa) 7, f. 5, rreshtat 11-12.

<sup>711</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 3, f. 20, rreshtat 8-16; *Shih gjithashtu* para. 338.

<sup>712</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 32, rreshtat 13-14; Part (Pjesa) 3, f. 24, rreshti 22; Part (Pjesa) 7, f. 30, rreshtat 18-19; Part (Pjesa) 8, f. 7, rreshtat 3-9; f. 34, rreshtat 4-6. Trupi Gjykses vëren se dëshmia e të akuzuarit ishte në përputhje me deklaratën e tij të mëparshme në çështjen gjyqësore *Agron Zeqiri* sa i përket rolit të tij si komandant i BIA-s (**z. Mustafa:** 7000650-7000660, f. 7000651). *Shih gjithashtu z. F. Sopi:* T. 18 janar 2022, publik, f. 2060, rreshtat 4-7; **Mr Veseli:** T. 25 janar 2022, publik, f. 2195, rreshti 25 deri në f. 2196, rreshti 2; **Z. Humolli:** T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2303, rreshtat 20-22.

edhe vetë në atë kompleks.<sup>713</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ai kishte njohuri të drejtpërdrejtë për atë vend dhe kjo e bën atë personin më të përshtatshëm për ta përshkruar vendin në mënyrë të saktë dhe të besueshme.

350. Krahas kësaj, Trupi Gjykses vëren se dëshmia e të akuzuarit lidhur me këtë pikë konfirmohet dhe nga dëshmitarë të tjerë. Për shembull, z. Mehmetaj dëshmoi se kishte qenë anëtar i njësitit BIA dhe se ky njësit kishte një bazë të sigurt në Zllash, sepse “nuk ka pasë forca ushtarake” dhe për këtë arsye ishte vend i sigurt ku mund të pushonin ushtarët e UÇK-së para ose pas kryerjes së detyrave të tyre.<sup>714</sup> Zoti F. Sopi konfirmoi dhe qartësoi deklaratën e tij të mëparshme për ZPS-në për këtë pikë dhe dëshmoi se BIA përdorte një vend në “në pikën më të lartë” të Zllashit,<sup>715</sup> ku ushtarët e saj ishin më të sigurt se në Prishtinë, pasi aty nuk mund të arrinin forcat serbe.<sup>716</sup> Sipas zotit F. Sopi, kjo pronë i përkiste në fakt një fshatari vendas, Adem Krasniqi, familja e të cilit u tregua e gatshme t’ia jepte në shfrytëzim UÇK-së.<sup>717</sup> Një anëtar i së njëjtës familje dhe dëshmitar në këtë çështje gjyqësore, z. Krasniqi, konfirmoi se kompleksi ishte pronë e familjes së tij, përfshirë edhe gjatë prillit 1999, dhe se iu vu në dispozicion UÇK-së.<sup>718</sup>

351. Dëshmitë e përmendura më lart janë reciprokisht konfirmuese dhe u dhanë nga persona që e njihnin nga brenda UÇK-në dhe veçanërisht BIA-n, ndër ta edhe i akuzuari dhe z. Mehmetaj. Trupi Gjykses nuk mendon se i akuzuari dhe të gjithë këta

<sup>713</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 3, f. 20, rreshtat 4-5.

<sup>714</sup> **Z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2618, rreshtat 15-16; f. 2641, rreshti 23 to f. 2642, rreshti 9.

<sup>715</sup> **Z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2045, rreshtat 1-15.

<sup>716</sup> **Z. F. Sopi:** T. 19 janar 2022, publik, f. 2172, rreshti 13 to f. 2173, rreshti 15. *Shih gjithashtu z. F. Sopi:* 069474-TR-ET, Part (Pjesa) 2, f. 20, rreshtat 13-16.

<sup>717</sup> **Z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2048, rreshtat 5-13; f. 2088, rreshti 25 deri në f. 2089, rreshti 19.

<sup>718</sup> **Z. Krasniqi:** T. 22 prill 2022, publik, f. 3866, rreshti 22 to f. 3867, rreshti 3; f. 3877, rreshti 13; f. 3879, rreshtat 2-4; f. 3952, rreshtat 8-13. I akuzuari konfirmoi se një nga anëtarët e familjes Krasniqi “ka qenë edhe ushtar i imi” (**Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 3, f. 20, rreshtat 17-18). Nga ana e tij, edhe z. Krasniqi dëshmoi se kishte qenë anëtar i BIA-s (**Z. Krasniqi:** T. 22 prill 2022, publik, f. 3953, rreshti 24 deri në f. 3955, rreshti 11).

dëshmitarë kishin ndonjë arsye për të trilluar këtë informacion kaq përputhës. Për rrjedhojë, këtë dëshmi e konsideron të besueshme dhe mbështetet në të.

352. Sa i përket kontrollit mbi kompleksin, Trupi Gjykses thekson dëshmitë gojore konfirmuese të dhëna nga anëtarë të ndryshëm të UÇK-së, që pohuan se kompleksi ishte nën kontrollin e BIA-s, e cila e përdorte atë si bazë.<sup>719</sup> Gjithashtu, dëshmitarë si z. Veseli dhe W04600 thanë në sallën e gjyqit se i akuzuari ishte përgjegjës për bazën,<sup>720</sup> çka, sipas Trupit Gjykses, është rrjedhojë logjike e pozitës së të akuzuarit si komandant i BIA-s, bazuar në dëshmitë e dhëna nga vetë i akuzuari e të konfirmuara nga anëtarë të tjerë të UÇK-së.<sup>721</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses gjykon se provat që tregojnë se në bazën e BIA-s në Zllash mund të kenë qenë të pranishëm ndonjëherë edhe ushtarë nga njësite të tjera të UÇK-së apo civilë,<sup>722</sup> nuk ndikojnë në konstatimin se baza në fakt ishte nën kontrollin e BIA-s dhe të komandantit të saj, të akuzuarit. Po ashtu, Trupi Gjykses vlerëson se prania e ushtarëve të tjerë të UÇK-së dhe civilëve, përputhet plotësisht me dëshmitë e përmendura më lart, sipas të cilave një nga funksionet e kompleksit ishte që t'u ofronte siguri dhe mbrojtje personave që qëndronin aty përkohësisht, për shkak se nuk kishte forca armike në afërsi.

<sup>719</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2049, rreshtat 20-22; f. 2089, rreshtat 23-25 ("Ai kompleks për shembull, është quajtur baza e "Skifterave" ose baza e gueriljes, BIA [...]); T. 19 janar 2022, publik f. 2172, rreshtat 2-8; **Z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2195, rreshti 18 deri në f. 2197, rreshti 19; **W04600**: T. 23 shtator 2021, publik, f. 718, rreshtat 14-21; T. 24 shtator 2021, publik, f. 811, rreshti 23 deri në f. 812, rreshti 8; f. 814, rreshtat 8-11.

<sup>720</sup> **Z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2198, rreshti 1 deri në f. 2199, rreshti 8; **W04600**: T. 27 shtator 2021, publik, f. 846, rreshtat 14-15.

<sup>721</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET, Pjesa 1, f. 29, rreshtat 2-5; f. 31, rreshtat 19-21; f. 32, rreshtat 13-14; Pjesa 7, f. 30, rreshtat 18-19; Pjesa 8, f. 7, rreshtat 3-9; f. 34, rreshtat 4-6. Trupi Gjykses vëren se i akuzuari dha dëshmi përputhëse me deklaratën e tij të mëparshme në çështjen gjyqësore *Agron Zeqiri* sa i përket rolit të tij si komandant i BIA-s (**Z. Mustafa**: 7000650-7000660, f. 7000651). *Shih gjithashtu Z. F. Sopi*: T. 18 janar 2022, publik, f. 2060, rreshtat 4-7; **Z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2195, rreshti 25 deri në f. 2196, rreshti 2; **Z. Humolli**: T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2303, rreshtat 19-22.

<sup>722</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2642, rreshtat 17-25; **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2089, rreshti 23 deri në f. 2090, rreshti 1; **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET, Pjesa 3, f. 14, rreshtat 12-24.



353. Për rrjedhojë, bazuar në provat në tërësi, Trupi Gjykses është bindur se BIA kishte një bazë në Zllash në periudhën e akuzave, e cila ishte nën kontrollin dhe pushtetin e komandantit të BIA-s, të akuzuarit.

(b) Vendndodhja e bazës së BIA-s në Zllash

354. Provat që ka marrë Trupi Gjykses vërtetojnë pa mëdyshje se baza e BIA-s ishte në një zonë të caktuar në Zllash, në “pikën më të lartë vëzhguese që është vrejt territori shumë”.<sup>723</sup> Baza e BIA-s ishte e ndarë nga strukturat e tjera të UÇK-së që ishin në Zllash, konkretisht një shkollë që përdorej si qendër stërvitore për rekrutët e rinj të UÇK-së, shtabi i Brigadës 153, dhe njësi operativ i Karadakut.<sup>724</sup> Lidhur me këtë pikë, Trupi Gjykses mori dëshmi të qarta dhe konfirmuese. Sipas dëshmive të dëshmitarëve, baza e BIA-s ishte vendosur në lagjen Sfarç të Zllashit,<sup>725</sup> më lart krahasuar me shkollën e fshatit,<sup>726</sup> çka është në përputhje me provat e tjera që tregojnë se baza e BIA-s ishte në një pjesë disi të veçuar dhe më të lartë të Zllashit, për t’u ofruar strehë të sigurt atyre që e kishin bazën atje. Sipas shpjegimit të zotit F. Sopi “por pjesë e Zllashit është pjesa ma e lartë ajo ku ndodhet, ku ishte njësia BIA”, sepse ishte më lart se shkolla dhe më e vështirë për të shkuar deri atje.<sup>727</sup>

<sup>723</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 3, f. 16, rreshtat 3-6.

<sup>724</sup> *Shih, për shembull*, **W04600:** T. 23 shtator 2021, publik, f. 717, rreshtat 2-4; **W04603:** T. 2 nëntor 2021, publik, f. 1292, rreshtat 10-15; **z. Veseli:** T. 25 janar 2022, publik, f. 2195, rreshtat 6-21; **z. Mustafa:** 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 3, f. 14, rreshtat 4-5; **Z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2044, rreshti 12; f. 2053, rreshtat 6-16 (z. F. Sopi identifikoi në fotografinë SPOE00128412 shkollën e Zllashit ku ishte qendra stërvitore); **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3721, rreshtat 17-19; **W04669:** T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1402, rreshtat 3-11.

<sup>725</sup> Sfarç nuk ishte emri i vendit ku ishte baza e BIA-s në Zllash, por emri që përdorej për t’iu referuar familjes që jetonte në atë vend (Krasniqi). *Shih* **W04600:** T. 23 shtator 2021, publik, f. 718, rreshti 14 deri në f. 722, rreshti 5. Z. Krasniqi konfirmoi se kompleksi i përkiste familjes së tij edhe në prill 1999 (**Z. Krasniqi:** T. 22 prill 2022, publik, f. 3867, rreshti 22 deri në f. 3868, rreshti 3; f. 3879, rreshtat 2-4).

<sup>726</sup> Konkretisht, W04600 deklaroi se ishte afërsisht “nji kilometër, nji e gjys” (**W04600:** T. 23 shtator 2021, publik, f. 719, rreshti 20). *Shih gjithashtu* **z. Veseli:** T. 25 janar 2022, publik, f. 2197, rreshtat 17-22; **z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2047, rreshti 1 deri në f. 2048, rreshti 1.

<sup>727</sup> **Z. F. Sopi:** T. 19 janar 2022, publik, f. 2181, rreshtat 16-25.



355. Për rrjedhojë, bazuar në provat në tërësi, Trupi Gjykses është bindur se baza e BIA-s ishte në një pjesë më të lartë të Zllashit, e ndarë nga pjesa tjetër e fshatit dhe nga objektet e tjera të UÇK-së atje.

(c) Identifikimi fotografik i bazës së BIA-s në Zllash

356. Pasi ka përcaktuar pozicionin e bazës së BIA-s në Zllash – veçanërisht në krahasim me shkollën e fshatit dhe strukturat e tjera nën kontrollin e UÇK-së në Zllash – Trupi Gjykses do të trajtojë identifikimin fotografik të bazës së BIA-s nga dëshmitarët që dhanë dëshmi në sallën e gjyqit, përfshirë dëshmitarët që pretendohet se ishin të ndaluar atje.

i. Kundërshtimet e Mbrojtjes lidhur me identifikimin fotografik dhe dëshmitë përshkruese

357. Mbrojtja parashtroi se nuk ka mundësi që W03593,<sup>728</sup> W01679,<sup>729</sup> W03594,<sup>730</sup> dhe W04669<sup>731</sup> të kenë qenë të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, sepse nuk ishin në gjendje t'i përshkruanin me saktësi ndërtesat; ose planimetria e përshkruar prej

---

<sup>728</sup> Sipas Mbrojtjes, W03593 nuk mund ta identifikonte kompleksin e ndalimit në Zllash, pasi kishte një thes në kokë, nuk e njohte vendin, të cilin e përshkroi pjesërisht, dhe nuk përmendi shumë prej nëntë strukturave që duhej të kenë qenë atje (T. 14 shtator 2022, publik, f. 4641, rreshtat 3-22).

<sup>729</sup> Sipas Mbrojtjes, W01679 nuk mund ta identifikonte kompleksin e ndalimit në Zllash, pasi kishte një thes në kokë; përshkrimi i tij ishte i përgjithshëm; dhe, edhe pasi u lirua ai nuk deklaroi asgjë lidhur me vendin e ndalimit (T. 14 shtator 2022, publik, f. 4642, rreshti 18 to f. 4643, rreshti 9).

<sup>730</sup> Sipas Mbrojtjes, W03594, i cili nuk kishte thes në kokë dhe për rrjedhojë mund të shihte përfaqë, nuk mundi ta identifikonte kompleksin e ndalimit në Zllash pasi përshkroi një vend tjetër me më pak ndërtesa sesa ato nëntë nga të cilat përbëhej kompleksi i ndalimit në Zllash (T. 14 shtator 2022, publik, f. 4646, rreshti 25 deri në f. 4647, rreshti 16; f. 4690, rreshti 9 to f. 4692, rreshti 3).

<sup>731</sup> Sipas Mbrojtjes, W04669, i cili nuk kishte thes në kokë dhe, për rrjedhojë mund të shihte përfaqë, identifikoi vetëm tri ndërtesa (nga nëntë që ishin në atë kompleks) dhe deklaroi se ai vend ishte vetëm 200 metra larg shkollës së Zllashit; pra, ai përshkroi një vend tjetër dhe jo kompleksin e ndalimit në Zllash (T. 14 shtator 2022, publik, f. 4649, rreshtat 5-23).

tyre ishte e ndryshme nga ajo që përshkruan dëshmitarët e Mbrojtjes, znj. Hadri, znj. Canolli-Kaçiu, z. Krasniqi dhe z. Ajeti, si dhe dëshmitari i ZPS-së, z. Humolli.<sup>732</sup>

358. Mbrojtja gjithashtu kundërshton mbështetshmërinë dhe vlerën provuese të dëshmimeve identifikuese të W03593-shit dhe W01679-ës, bazuar në faktin se këtyre dëshmitarëve iu tregua vetëm një fotografi, në vend të një numri fotografish me ndërtesa të ngjashme nga të cilat të mund të zgjidhnin.<sup>733</sup> Po ashtu, Mbrojtja kundërshton mbështetshmërinë në dëshminë identifikuese të W04669-ës, pasi përshkrimi që i bëri ai pjesës së jashtme të ndërtesave është tepër i përgjithshëm.<sup>734</sup>

359. ZPS-ja përgjigjet se dëshmitë e viktimave janë të besueshme dhe se ato konfirmuan njëra-tjetrën dhe u konfirmuan nga prova të pavarura, si Lista e të Burgosurve, që nuk do të kishte qenë e mundur në qoftë se dëshmitë e tyre do të kishin qenë të trilluara apo në qoftë se nuk do të kishin qenë të ndaluar në bazën e BIA-s në Zllash.<sup>735</sup> ZPS-ja përgjigjet më tej se çështja e identifikimit me anë të fotografive duhej të ishte trajtuar gjatë gjykimit. Gjithashtu, ZPS-ja shton se ajo u tregoi dëshmitarëve jo

<sup>732</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4670, rreshtat 16-24. Për shembull, Mbrojtja argumenton se disa nga dëshmitarët e ZPS-së thanë se kompleksi i ndalimit në Zllash kishte gardh, ndërsa dëshmitarë të Mbrojtjes e përshkruan si vend të hapur. Po ashtu, Mbrojtja mendon se disa nga dëshmitarët e ZPS-së nuk përshkruan oborrin në mes të kompleksit të ndalimit në Zllash, madje nuk përmendën as nëntë ndërtesat që ndodheshin atje (T. 14 shtator 2022, publik, f. 4650, rreshti 3 to f. 4654, rreshti 10; f. 4654, rreshti 11 deri në f. 4660, rreshti 23).

<sup>733</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4671, rreshtat 2 deri në f. 4675, rreshtat 22; f. 4686, rreshti 10 deri në f. 4690, rreshti 8.

<sup>734</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4692, rreshti 4 deri në f. 4694, rreshti 19. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja po ashtu parashtron se W04669, kur i dha dëshmi ZPS-së, identifikoi një fotografi nga Broshura e Fotografive nga Terreni e UNMIK-ut si vendi i mundshëm i ndalimit (SPOE00128386-00128420, f. 00128407), i cili është i ndryshëm nga vendi që u identifikua në sallën e gjyqit (082020-082023 RED1, f. 082022). Trupi Gjykses thekson se, kur paraqiti këtë argument, Mbrojtja u mbështet në një pjesë nga deklarata e mëparshme e W04669-ës për ZPS-në, të cilën Trupi Gjykses nuk e ka në dispozicion në kuadër të Aktgjykimit, sepse nuk u diskutua me dëshmitarin në gjyq (konkretisht, 082023-TR- ET, Part (Pjesa) 2, f. 29-30). Pavarësisht nga kjo, kur i krahason të dy fotografitë (atë që iu tregua dëshmitarit kur dha dëshminë e mëparshme për ZPS-në me atë që u identifikua në seancë gjyqësore), Trupi Gjykses konstaton se në to shihet saktësisht i njëjti grup ndërtesash, thjesht të marra nga dy kënde të ndryshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka asgjë çorientuese apo të palejueshme në faktin se ZPS-ja në sallën e gjyqit i tregoi W04669-ës një fotografi tjetër (ku shihet i njëjti grup ndërtesash).

<sup>735</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4802, rreshti 15 deri në f. 4803, rreshti 8.

vetëm një fotografi, por disa, dhe se në fakt, identifikimi i atyre ndërtesave u bë në sallën e gjyqit, në prani të Mbrojtjes.<sup>736</sup>

360. Mbrojtësja e viktimave përgjigjet se dëshmitë duhen parë në tërësinë e tyre dhe në këtë prizëm, dëshmitë e dhëna janë të mjaftueshme për të lidhur ngjarjet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar me kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>737</sup>

361. Mbrojtja kundërpërgjigjet se dokumentacioni nuk tregon që dëshmitarëve iu tregua i tërë grupi i fotografive. Mbrojtja shton se, edhe në rast se iu tregua, në Broshurën e Fotografive ka shumë pak ndërtesa dhe ato janë në thelb gjithmonë të njëjtat ndërtesa.<sup>738</sup>

362. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se gjatë gjykimit Mbrojtja nuk ngriti asnjëherë kundërshtime nëse ishte e përshtatshme që dëshmitarëve t'u tregohej vetëm një foto. Mbrojtja mund dhe duhej t'i kishte trajtuar këto aspekte gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve në fjalë.

363. Sa i përket themelësisë së këtyre kundërshtimeve, Trupi Gjykses rikujton se në bazë të rregullës 139(2) të Rregullores, do t'i vlerësojë provat në tërësinë e tyre. Nga kjo rrjedh se Trupi Gjykses nuk duhet të shqyrtojë veças secilin prej kundërshtimeve të paraqitura nga Mbrojtja mbi aspekte dhe/ose dëshmitarë të ndryshëm, por do të vlerësojë edhe nëse këto kundërshtime ndikojnë, dhe si ndikojnë, në vlerësimin e përgjithshëm të të gjitha provave lidhur me një aspekt të caktuar, siç është në këtë rast identifikimi fotografik dhe përshkrimi i bazës së BIA-s nga dëshmitarët e ZPS-së.

364. Duke mbajtur parasysh tërësinë e dëshmive identifikuese, Trupi Gjykses vlerëson se W01679, W03593, dhe W04669 identifikuan në seancë të mbyllur saktësisht

---

<sup>736</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4816, rreshti 21 deri në f. 4818, rreshti 6 (që i referohet 100807-TR-ET, Pjesa 1; 100957-TR-ET, Pjesa 1; 082023-TR-ET, Pjesa 2).

<sup>737</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4826, rreshti 1 deri në f. 4827, rreshti 16. *Shih gjithashtu* T. 15 shtator 2022, publik, f. 4828, rreshtat 13-15 (për referencën ndaj dëshmisë së W01679-ës).

<sup>738</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4838, rreshti 18 deri në f. 4839, rreshti 12.

të njëjtat ndërtesa, bazuar saktësisht në të njëjtat fotografi nga Broshura e Fotografive nga Terreni e UNMIK-ut, si vendin ku mbajtën të burgosur në prill 1999.<sup>739</sup> Trupi Gjykues i vlerëson si shumë të besueshme identifikimet reciprokisht konfirmuese të bëra nga dëshmitarët e lartpërmendur, pasi nuk ka gjasa të jetë rastësi që të gjithë ata identifikuan të njëjtin grup ndërtesash si vendin ku u viktimizuan, bazuar në të njëjtin material fotografik. Gjithashtu, është po aq e pagjasë që, pa i ditur identitetet dhe dëshmitë përkatëse të njëri-tjetrit – për shkak të masave mbrojtëse në fuqi – ata të jenë marrë vesh që t'i përshtatnin dëshmitë identifikuese me njëri-tjetrin. Sipas Trupit Gjykues, nga pikëpamja e metodologjisë, fakti që këta dëshmitarë e bazuan identifikimin e tyre në një fotografi të vetme nuk është i palejueshëm, pasi mund të kishin thënë thjesht që nuk mbanin mend dhe të mos i identifikonin ndërtesat. Trupi Gjykues konstaton se, përkundrazi, këta dëshmitarë bënë përpjekje t'i kujtonin ndërtesat ku u mbajtën të ndaluar. Kjo bëri që W01679, W03593, dhe W04669 të identifikonin që të gjithë saktësisht të njëjtin grup ndërtesash si vendin ku u mbajtën të ndaluar, që qartazi bazohej në njohjen personalisht prej tyre të atij vendi.

365. Me rëndësi kritike është se dëshmitë identifikuese të W01679-ës, W03593-shit, dhe W04669-ës konfirmohen nga W04600,<sup>740</sup> zoti F. Sopi<sup>741</sup> dhe z. Krasniqi,<sup>742</sup> të cilëve iu treguan saktësisht të njëjtat fotografi që iu treguan edhe W01679-ës, W03593-shit, dhe W04669-ës dhe identifikuan të njëjtin grup ndërtesash si bazën e BIA-s në Zillash.

---

<sup>739</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 920, rreshti 1 deri në f. 925, rreshti 25; 100801-100806 RED1, f. 100803; **W03593**: T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 512, rreshti 5 deri në f. 518, rreshti 19; 100966-100969, f. 100968; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1470, rreshti 24 deri në f. 1472, rreshti 6; 082020-082023 RED1, f. 082022 (W04669 identifikoi ndërtesën e parë në të majtë të fotografisë).

<sup>740</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, publik, f. 753, rreshti 14 deri në f. 759, rreshti 4.

<sup>741</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2053, rreshti 22 deri në f. 2054, rreshti 17; SPOE00128386-00128420, f. SPOE00128388.

<sup>742</sup> **Z. Krasniqi**: T. 22 prill 2022, publik, f. 3896, rreshti 9 deri në f. 3898, rreshti 9; DSM00028-00028 (shënuar nga dëshmitari si REG00-015). Z. Krasniqi identifikoi dhe përshkroi bazën e BIA-s mbështetur në Broshurën e Fotografive nga Ajri të UNMIK-ut (**Z. Krasniqi**: T. 22 prill 2022, publik, f. 3874, rreshti 5 deri në f. 3893, rreshti 20; *Shih gjithashtu* DSM00026-00026, që u shënuar nga dëshmitari në seancën gjyqësore për të identifikuar secilën ndërtesë në pronën e familjes (*shih* REG00-013).

Trupi Gjykues vëren se, ndonëse W04600 deklaroi se ishin “të ngjashme ato shtëpi. Jo veç te këta, po në krejt fshatin janë konë të ngjashme shtëpitë”, ai po ashtu konfirmoi në deklaratën e mëparshme për ZPS-në, se një nga ndërtesat që shihej në Broshurën e Fotografive nga Terreni të UNMIK-ut, ishte pronë e “Sfarcëve”,<sup>743</sup> e cila u vërtetua që ishte pronë e Adem Krasniqit që ia kishte dhënë në shfrytëzim UÇK-së për krijimin e bazës së BIA-s në Zllash. Gjithashtu, kur i treguan Broshurën e Fotografive nga Ajri të UNMIK-ut – ku paraqitej e njëjta pronë që dukej në Broshurën e Fotografive nga Terreni të UNMIK-ut, por e marrë nga lart – W04600 identifikoi hyrjen e bazës së BIA-s [REDAKTUAR].<sup>744</sup> Dëshmia identifikuese e W04600-s, veçanërisht e marrë në tërësinë e saj dhe bashkë me prova të tjera, ofron konfirmim të mjaftueshëm për të nxjerrë përfundimin se W04600 identifikoi siç duhet të njëjtin vend si bazën e BIA-s, ashtu si dëshmitarët e tjerë të përmendur.

366. Sipas Trupit Gjykues, konfirmim i mëtëjshëm i dëshmime identifikuese, që i bën ato edhe më të besueshme, është fakti se planimetria e pronës së identifikuar nga këta dëshmitarë, bazuar si në fotografitë nga ajri ashtu edhe nga terreni, është tërësisht në përputhje me përshkrimin e anëtarëve të BIA-s ose UÇK-së që kishin qenë atje.<sup>745</sup>

367. Duke i vlerësuar provat në tërësinë e tyre si dhe shkallën e përputhshmërisë ndërmjet dëshmime të dëshmitarëve, është krejt e pagjasë të supozohet se të gjithë këta dëshmitarë, si anëtarët e UÇK-së, ashtu dhe viktimat e krimeve për të cilat u ngritën akuza, do ta kenë pasur gabim apo mund të jenë marrë vesh njëfarësoj për të

---

<sup>743</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, publik, f. 758, rreshti 12 deri në f. 759, rreshti 4.

<sup>744</sup> **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 723, rreshti 1 deri në f. 729, rreshti 3; T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 750, rreshti 4 deri në f. 752, rreshti 16. Dëshmitari shënoi fotografinë SPOE00213459-00213487 (REG00-006), f. SPOE00213478, që është identike me DSM00026-00026 (REG00-013) që iu tregua z. Krasniqi.

<sup>745</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2642, rreshtat 11-12 (“Ka qenë një oborr i madh me disa shtëpia kështu përreth”); **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2048, rreshtat 18-22 (“ka pasë disa shtëpi banimi. [...] ka pasë pleme”).

identifikuar pikërisht të njëjtën strukturë si bazën e BIA-s dhe si vendin ku u mbajtën të ndaluar.

368. Argumentet e Mbrojtjes sa i përket aftësisë në përgjithësi të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës për të përshkruar (siç duhet) vendin e ndalimit, nuk janë bindëse. Së pari, vetë dëshmitë identifikuese të këtyre dëshmitarëve, si dhe të W04600-s, zotit F. Sopi dhe zotit Krasniqi, tregojnë se duhet t'i kenë parë më parë ndërtesat të cilat më pas i njohën në sallën e gjyqit. Së dyti, ndryshe nga sa pretendon Mbrojtja, dëshmitë nuk sugjerojnë se viktimat i kanë pasur kokat të mbuluara gjatë të gjithë kohës. Më së paku, në momentin e lirimit, viktimat e pretenduara patën mundësi ta shihnin vendin e ndalimit dhe të largoheshin lirisht nga vendi – siç shtjellohet në konstatimet faktike mbi ndalimin arbitrar (Pika 1). Për këtë arsye, është krejt e mundshme që ata t'i kenë parë ndërtesat ku pretendohet se u mbajtën të ndaluar, që ishte edhe baza e njohurisë dhe aftësisë së tyre për të bërë identifikimin fotografik të atyre strukturave fizike në sallën e gjyqit. Në lidhje me këtë pikë, gjatë dhënies së dëshmisë në sallën e gjyqit, W03593 i konfirmoi të gjitha deklaratat e tij të mëparshme [REDAKTUAR] dhe ZPS-në lidhur me identifikimin e ndërtesës ku u mbajt i ndaluar. Kur e pyeti ZPS-ja se si mundi ta njihnte ndërtesën, ai u përgjigj: “Po normal po e di se unë nuk kam kqyr krejt, por kam kqyr pak që me dit ku jom konë” dhe shpjegoi se kishte parë aq sa të ishte në gjendje të njihnte në fotografitë që iu treguan ndërtesën ku u mbajt i ndaluar.<sup>746</sup> Gjithashtu ai vizatoi edhe skica të ndërtesës, të pjesës së poshtme, ku u mbajt, dhe të pjesës së sipërme, ku u mor në pyetje.<sup>747</sup>

369. Si rezultat, çfarëdo dallimesh që mund të ketë në përshkrimet e kompleksit të ndalimit në Zllash nga dëshmitarët e ndryshëm të ZPS-së — përfshirë W03594-ën që nuk bëri identifikim fotografik — faktikisht i bëjnë dëshmitë e tyre më të besueshme,

---

<sup>746</sup> W03593: T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 517, rreshtat 3-13.

<sup>747</sup> W03593: T. 21 shtator 2021, publik, f. 517, rreshti 14 deri në f. 518, rreshti 19, që i referohet 061012-061015, f. 061013.



sepse ato nuk janë përshtatur me njëra-tjetrën aq sistematikisht sa të ngjallin dyshime për besueshmërinë e tyre. Nëse disa dëshmitarë nuk e përshkruan çdonjërin prej ndërtesave në kompleksin e ndalimit në Zllash, kjo faktikisht i bën dëshmitë e tyre më të besueshme dhe më përputhëse me kushtet në të cilat ishin të ndaluarit, të cilët i çonin në dhomën e marrjes në pyetje dhe të keqtrajtimit dhe i kthenin përsëri në ahurin ku mbaheshin të ndaluar dhe rrjedhimisht nuk kishin kohë dhe mundësi të shihnin përqark siç duhet.<sup>748</sup> Përkundër tyre, është e logjikshme që përshkrimet e kompleksit të ndalimit në Zllash nga disa prej dëshmitarëve të Mbrojtjes, si znj. Hadri, znj. Canolli-Kaçiu, z. Krasniqi, z. Ajeti dhe z. Humolli, janë më të plota dhe mbase më të sakta, sepse nuk ka prova për kufizim të lirisë së tyre të lëvizjes apo të vrojtimit. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Trupit Gjykses, dëshmitë përshkruese të viktimave dhe të dëshmitarëve të Mbrojtjes nuk janë kontradiktore por thjesht janë pasqyrim i statusit përkatës të tyre si persona të ndaluar apo të lirë, që rrjedhimisht pati ndikim në mënyrën sesi mund ta vrojtonin mjedisin ku ndodheshin.

370. E njëjta gjë është e vërtetë edhe lidhur me pyetjen nëse kishte apo jo gardh në kompleksin e ndalimit në Zllash. Trupi Gjykses vëren se provat në tërësi tregojnë se mund të ketë pasur një gardh, të paktën në pjesën që mund ta shihnin dëshmitarët. Në fakt, dëshmitë e dhëna nga viktimat dhe nga dëshmitarët e Mbrojtjes as në këtë pikë nuk bien ndesh me njëra-tjetrën, sepse në të njëjtin kompleks mund të ketë pasur pjesë me gardh dhe pa gardh. Sipas Trupit Gjykses, kjo konfirmohet fuqimisht nga Broshura e Fotografive nga Ajri e UNMIK-ut dhe Broshura e Fotografive nga Terreni e UNMIK-ut, ku në një numër fotografish shihen qartë gjurmë të mbetura të një gardhi.<sup>749</sup> Duke mbajtur parasysh se këto fotografi u bënë në vitin 2006, dhe se në to

---

<sup>748</sup> Në fakt, ndërtesat e ndalimit dhe të marrjes në pyetje ishin në njërin anë të kompleksit të ndalimit në Zllash, ndërsa ndërtesat e tjera ishin në anën tjetër të kompleksit, përtej një oborri (të madh) në njëfarë largësie (**W03594**: T. 13 tetor 2021, publik, f. 1145, rreshti 1).

<sup>749</sup> SPOE00128386-0012842, f. SPOE00128389, SPOE00128392, SPOE00128407, SPOE00128410; REG00-013.



gardhi është ende i dukshëm, Trupi Gjykses konstaton se në prill 1999 kompleksi i ndalimit në Zllash kishte të paktën disa pjesë me gardh dhe disa pjesë pa gardh, çka përputhet me dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së dhe të Mbrojtjes lidhur me këtë pikë. Përsëri, në vlerësimin e Trupit Gjykses, dallimet mes dëshmimeve të viktimave dhe të dëshmitarëve të Mbrojtjes në përshkrimet e kompleksit të ndalimit në Zllash, thjesht pasqyrojnë atë që kanë parë personat përkatës gjatë kohës që ishin në atë vend.

371. Rrjedhimisht, kundërshtimet e Mbrojtjes lidhur me dëshmitë identifikuese dhe përshkruese hidhen poshtë.

ii. Konstatime mbi provat e identifikimit fotografik

372. Bazuar në provat dhe arsyetimet më sipër, Trupi Gjykses është bindur se në bazën e BIA-s, ndërtesat në të majtë të kompleksit, të shënuara nga z. Krasniqi me numrat 4, 4A dhe 5 (pamje nga terreni)<sup>750</sup> që përkojnë përkatësisht me ndërtesat 12, 11 dhe 10 (pamje nga ajri),<sup>751</sup> janë ndërtesat që lidhen me akuzat e ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3), dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), të cilat do të shtjellohen me hollësi në pjesët përkatëse. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se, për marrjen e vendimit në lidhje me akuzat, nuk është e rëndësishme të vlerësohet me saktësi absolute se në cilën prej këtyre ndërtesave u mbajt secili prej të ndaluarve, dhe për sa kohë. Trupi Gjykses duhet të bindet — jashtë dyshimit të arsyeshëm dhe bazuar në provat në tërësi— se krimet për të cilat janë ngritur akuzat, u kryen në një ose më shumë prej ndërtesave të cekura më lart, në bazën e BIA-s, afërsisht midis 1 prillit dhe 19 prillit 1999 (ose rreth fundit të prillit 1999, në lidhje me akuzën e vrasjes së paligjshme në Pikën 4) dhe, për rrjedhojë, përfshihen në kuadrin kohor dhe gjeografik të akuzave të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.

---

<sup>750</sup> DSM00028-00028 (shënuar nga dëshmitari si REG00-015).

<sup>751</sup> DSM00026-00026 (shënuar nga dëshmitari si REG00-013).

373. Bazuar në këtë, është i pabazë pretendimi i Mbrojtjes se ZPS-ja e mashtroi sepse e ndryshoi qëndrimin e saj lidhur me ndërtesën/ndërtesat konkrete në kompleksin e ndalimit në Zllash ku pretendohet se u mbajtën të ndaluara viktimat, duke e bërë kështu procesin gjyqësor të padrejtë.<sup>752</sup> Mbrojtja pati mundësinë gjatë të gjithë gjykimit që t'u bënte pyetje dëshmitarëve të ZPS-së dhe të paraqiste prova lidhur me kuadrin gjeografik të akuzave, i cili qartësisht përfshin të gjitha ndërtesat e bazës së BIA-s në Zllash. Për rrjedhojë, pretendimi i Mbrojtjes hidhet poshtë.

(d) Përdorimi i bazës së BIA-s për ndalim

374. Sa i takon faktit nëse baza e BIA-s u përdor apo jo për ndalim — krahas qëllimeve të tjera — Trupi Gjykses vëren se vetë i akuzuari pranoi se në bazën e BIA-s u mbajtën të ndaluar ushtarë.<sup>753</sup> Madje i akuzuari shkoi edhe më tej dhe deklaroi se “asht fol që janë ndalu edhe civilë” dhe se kjo nuk ishte sekret.<sup>754</sup> Ndonëse dëshmia e tij mbi ndalimin e mundshëm të civilëve u paraqit si dëshmi e dorës së dytë, i akuzuari nuk kishte motiv për t'i dhënë vullnetarisht këto informacione, duke pasur parasysh se po merrej në pyetje nga ZPS-ja për rolin e mundshëm ose dijeninë e tij lidhur me ndalimin dhe keqtrajtimin e civilëve, përfshirë edhe në cilësinë si komandant i BIA-s. Edhe vetëm mbi këtë bazë, Trupi Gjykses e vlerëson veçanërisht të besueshme dëshminë e të akuzuarit për këtë aspekt. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se ky informacion konfirmohet edhe nga një anëtar tjetër i BIA-s, z. Mehmetaj, i cili deklaroi njësoj si i akuzuari se kishte dëgjuar për ekzistencën e një dhome brenda bazës së BIA-s ku ishin mbajtur të ndaluar persona.<sup>755</sup> Po ashtu, pa hyrë në rrethanat individuale të secilës

<sup>752</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4771, rreshtat 6-12; f. 4782, rreshti 22 deri në f. 4785, rreshti 2.

<sup>753</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 2, rreshti 11 to f. 8, rreshti 10; Part (Pjesa) 8, f. 1, rreshti 19 deri në f. 4, rreshtat 15; f. 6, rreshtat 14-15 (“gjithë aty që i thonin dhoma e ndalimit”).

<sup>754</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 15, rreshtat 7-15; f. 18, rreshtat 1-16.

<sup>755</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2683, rreshti 15 deri në f. 2684, rreshti 9. Për këtë pikë, Trupi Gjykses e vlerëson z. Mehmetaj si të besueshëm, pasi ai ishte zëvendëskomandant, vartës i të akuzuarit,

viktimë, Trupi Gjykues vë në dukej se W01679 dëshmoi që gjatë periudhës së ndalimit të tij në bazën e BIA-s “[...] Po tani ndërkohë kanë pru edhe tjetër”<sup>756</sup> që qëndronin “dy ditë, tri ditë edhe i kanë largu”.<sup>757</sup> Gjithashtu, W03593 deklaroi se “Po kanë prurë për natë, kanë pru deri në 17 vetë jemi konë në q’atë dhomë”.<sup>758</sup> Po ashtu, W04669 deklaroi se gjatë periudhës relativisht të shkurtër të ndalimit të tij, ai u mbajt aty bashkë me dy persona të tjerë të pidentifikuar,<sup>759</sup> të cilët, sipas dëshmitarit, i kishin sjellë në ahur “para tri-katër ditësh, ashtu” para tij.<sup>760</sup> Trupi Gjykues i vlerëson të besueshme dëshmitë e mësipërme, pasi ato konfirmojnë reciprokisht faktin thelbësor se në kompleksin e ndalimit në Zllash shpesh silleshin ose merreshin të ndaluar. Fakti që çdo dëshmitar dha dëshmi dhe shifra të ndryshme, por që të gjithë e konfirmuan praninë e të ndaluarve, i bën dëshmitë e tyre më realiste, pasi ato pasqyrojnë kujtimet e tyre personale për ngjarjet, që përfshijnë edhe kujtimet se në cilën nga ndërtesat e identifikuar u mbajtën të ndaluar.

375. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues ka marrë dëshmi nga anëtarë të UÇK-së të cilët mohuan kategorikisht ekzistencën e praktikave të ndalimit dhe keqtrajtimit në Zllash,

---

dhe kishte njëfarë dijenie për aktivitetet e BIA-s në bazën e Zllashit. Bazuar në vlerësimin e Trupit Gjykues për besueshmërinë, sipas të cilit z. Mehmetaj shfaqti tendencën të jepte dëshmi në favor të akuzuarit, pranimi i tij, ndonëse pa dëshirë, lidhur me fjalët që qarkullonin për ndalimin e personave në bazën e BIA-s, u vlerësua si i besueshëm dhe me vlerë provuese.

<sup>756</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 889, rreshtat 4-6.

<sup>757</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 889, rreshtat 20-21.

<sup>758</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 419, rreshtat 7-8; T. 20 shtator 2021, konfidencial f. 439, rreshtat 20-24.

<sup>759</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1418, rreshti 20 deri në f. 1419, rreshti 12. Dëshmitari i përshkroi dy të ndaluarit me shumë hollësi: një burrë që ishte 50-60 vjeç, me mustaqe, kishte dy djem që ishin kyçur në UÇK në fshatin Shipol (Mitrovicë), të cilin e kishin ndaluar sepse kishte kërkuar që UÇK-ja t’i kthente automatikun. Tjetri ishte nga Gollaku, 180-190 centimetra i gjatë, 80 kilogram, rreth 5-10 vjet më i vjetër se W04669 asokohe.

<sup>760</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1424, rreshtat 19-20.

në çfarëdo kohe<sup>761</sup> dhe dëshmuar se njësitë BIA nuk kishte mandat të arrestonte dhe mbante të ndaluar askënd.<sup>762</sup>

376. Trupi Gjyqësor vlerëson se këto dëshmi mohuese nuk janë bindëse kur krahasohen me provat e diskutuara më lart dhe me dëshmitë e viktimave lidhur me rrethanat e ndalimit të tyre, që shqyrtohen më poshtë të pjesa e konstatimeve faktike (Pikat 1-3). Së pari, për të gjithë dëshmitarët që mohuan ekzistencën e praktikave të ndalimit dhe keqtrajtimit në Zllash, Trupi Gjyqësor konstatoi se ata shfaqën tendencë të fortë për të dhënë dëshmi në favor të të akuzuarit, BIA-s, ose UÇK-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor është i mendimit se ata të gjithë kishin motive të mundshme për të mohuar praktikën e ndalimit dhe keqtrajtimit në Zllash. Së dyti, dëshmitë mohuese janë qartazi në kundërshtim me dëshminë e të akuzuarit, i cili pranoi shprehimisht se në bazën e BIA-s në Zllash u mbajtën të ndaluar ushtarë (e ndoshta edhe civilë). Siç shtjellohet më lart, Trupi Gjyqësor e vlerëson dëshminë e të akuzuarit lidhur me këtë pikë si të besueshme dhe me autoritet, duke mbajtur parasysh rolin e tij komandues brenda BIA-s, njohurinë e tij të drejtpërdrejtë dhe kontrollin e tij mbi bazën e BIA-s. Për më tepër, dëshmia e të akuzuarit konfirmohet edhe nga dëshmitarë të tjerë, sidomos nga viktimat për të cilët Trupi Gjyqësor nuk ka evidentuar ndonjë faktor të veçantë që vë në dyshim besueshmërinë e tyre. Për këtë pikë, Trupi Gjyqësor thekson se dëshmitë e shtjelluara më lart lidhur me identifikimin fotografik të bazës së BIA-s janë kaq të qarta, përputhëse dhe bindëse, sa që dëshmitë që mohojnë kategorikisht

---

<sup>761</sup> **Z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2107, rreshtat 15-17; f. 2114, rreshtat 2-17; T. 19 janar 2022, publik, f. 2161, rreshti 14 deri në f. 2163, rreshti 2; **Z. Veseli:** T. 25 janar 2022, publik, f. 2223, rreshti 4 deri në f. 2224, rreshti 18; **Z. Ibishi:** T. 12 prill 2022, publik, f. 3621, rreshti 8 deri në f. 3624, rreshti 8 (Z. Ibishi deklaroi se nuk kishte qendër tjetër ndalimi veç asaj në Llapashticë; ai shtoi se ndonjëherë personat mbaheshin edhe në dy vende të tjera, Majac dhe Potok, por, sidoqoftë, vetëm një qendër ndalimi kishte); **Z. Krasniqi:** T. 21 prill 2022, publik, f. 3909, rreshti 19 deri në f. 3911, rreshti 1; f. 3911, rreshti 21 deri në f. 3912, rreshti 11; f. 3950, rreshtat 6-10; **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4076, rreshtat 12-17; f. 4151, rreshtat 13-17.

<sup>762</sup> **Z. Humolli:** T. 2 shkurt 2022, publik, f. 2429, rreshtat 14-18.

praktikat e ndalimit dhe keqtrajtimit në Zllash, nuk mund të zhbëjnë vlerën provuese të tyre.

377. Rrjedhimisht në përgjithësi, Trupi Gjykses konstaton se provat tregojnë se një nga qëllimet e bazës së BIA-s në Zllash ishte që aty të mbaheshin persona të ndaluar. Ky përfundim është në pajtim të plotë edhe me përdorimet e tjera të mundshme të bazës— duke mbajtur parasysh ndërtesat e shumta dhe madhësinë e konsiderueshme të oborrit<sup>763</sup> — qoftë për pushimin dhe çlodhjen e ushtarëve, apo si strehë sigurt për civilët e larguar nga zonat ku kishte luftime.

(e) Përfundim

378. Bazuar në të gjitha provat e vlerësuara më sipër, të marra në tërësi, Trupi Gjykses është bindur se baza e BIA-s në Zllash përkon me kompleksin e ndalimit në Zllash të përmendur në Aktakuzën e Konfirmuar si vendi ku u kryen krimet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses do t'i bëjë konstatimet lidhur akuzat e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme (Pikat 1-4) duke iu referuar kompleksit të ndalimit në Zllash si vendndodhja e vërtetuar e krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari.

## 2. W01679

(a) Arrestimi fillestar

379. Sa u përket rrethanave të arrestimit fillestar, W01679 dëshmoi se gjatë kohës që ishte në shkollën e fshatit në Zllash për t'u stërvitur me UÇK-në<sup>764</sup>, atë e arrestuan katër burra të njësitit special që quhej Skifterat,<sup>765</sup> të cilët ishin të armatosur dhe

---

<sup>763</sup> W03594: T. 13 tetor 2021, publik, f. 1145, rreshti 1.

<sup>764</sup> W01679: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 863, rreshti 25 deri në f. 864, rreshti 11.

<sup>765</sup> Trupi Gjykses vëren se duke specifikuar që burrat që e morën i përkisnin njësitit "Skifteri", W01679 dha një hollësi mjaft të vlefshme që e bën dëshminë e tij shumë të besueshme, pasi "Skifterat" (ose "Skifteri") ishte emri tjetër me të cilën njihet BIA, sikurse u tha nga vetë i akuzuari dhe anëtarë të tjerë

mbanin uniforma të zeza me shenjën e BIA-s.<sup>766</sup> Sipas dëshmitarit, ushtarët që i thanë të shkonte me ta nuk i treguan asnjë dokument.<sup>767</sup>

380. Sa i përket vetë pranisë së dëshmitarit në qendrën stërvitore, Mbrojtja kundërshton vërtetësinë e dëshmisë së W01679-ës, pasi ajo bie ndesh me dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes, z. Halimi,<sup>768</sup> që ishte instruktor në qendrën e rekrutëve.<sup>769</sup> Në thelb, z. Halimi tha se nuk ishte e mundur që rekrutët të merrnin pjesë në kursin stërvitor pa qenë në një listë të posaçme që e jepte shtabi i brigadës, dhe as nuk kishin mundësi t'i bashkoheshin stërvitjes nga gjysma apo të largoheshin pa e përfunduar.<sup>770</sup> Sipas parashtrimeve të Mbrojtjes, kjo ishte në kundërshtim me dëshminë e W01679-ës, i cili tha se shkoi në shkollën e Zllashit dhe praktikisht iu bashkua kursit të stërvitjes së rekrutëve duke u regjistruar në atë moment.<sup>771</sup>

381. Trupi Gjykses vlerëson se dëshmitë e W01679-ës dhe të z. Halimi nuk bien ndesh me njëra-tjetrën, përkundrazi ato janë, në një masë të madhe, përputhëse dhe reciprokisht konfirmuese. Në fakt, W01679 dhe z. Halimi konfirmuan dëshmitë e njëri-tjetrit për aspekte të ndryshme të rëndësishme lidhur me qendrën e stërvitjes në Zllash, çka demonstroi se kanë dijeni personale për atë stërvitje, si rezultat i pranisë së tyre atje.

---

të UÇK-së që kishin dijeni për këto aspekte (**Z. Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 3, f. 24, rreshtat 3-5; Pjesa 8, f. 14, rreshtat 9-19; **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 724, rreshtat 16-17; f. 727, rreshtat 19-21; **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2045, rreshtat 4-6; f. 2089, rreshtat 24-25).

<sup>766</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 864, rreshtat 10-11; f. 865, rreshtat 2-9, 14-25; f. 866, rreshtat 1-9; T. 5 tetor 2021, publik, f. 978, rreshti 11 deri në f. 979, rreshti 11.

<sup>767</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 866, rreshtat 15-21.

<sup>768</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, para. 30. Në deklaratat përmbyllëse, Mbrojtja paraqiti argumente shtesë, duke u mbështetur në dëshminë e Adem Shehut. Megjithatë, Trupi Gjykses rikujton se, dëshmia e Adem Shehut nuk i është dorëzuar Trupit Gjykses si provë dhe, për rrjedhojë, nuk është në dispozicion për t'u shqyrtuar në kontekstin e Aktgjykimit. Për këtë arsye, argumentet e Mbrojtjes në këtë pikë hidhen poshtë (T. 14 shtator 2022, publik, f. 4704, rreshti 10 deri në f. 4705, rreshti 10).

<sup>769</sup> **Z. Halimi**: T. 20 prill 2022, publik, f. 3738, rreshtat 18-20.

<sup>770</sup> **Z. Halimi**: T. 20 prill 2022, publik, f. 3745, rreshtat 5-21; f. 3753, rreshtat 19-21.

<sup>771</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 863, rreshti 15 deri në f. 864, rreshti 3.

382. Për shembull, W01679 deklaroi se kur filloi stërvitjen, i kërkuan të jepte emrin e plotë, datën e lindjes dhe vendin e banimit, çka përputhet me llojin e informacionit që përfshihej në listën e brigadës, të cilën zakonisht e shihte edhe z. Halimi.<sup>772</sup> Veç kësaj, sipas të dy dëshmitarëve, rekrutëve nuk u bënë pyetje lidhur me ndonjë aftësi apo zotësi konkrete, por vetëm u kërkonin të dhënat personale.<sup>773</sup> W01679 deklaroi se ndër instruktorët ishin edhe Emin Borovci (“Triumfi”) dhe Adem Shehu, dëshmi që u konfirmua edhe nga z. Halimi.<sup>774</sup> Gjithashtu, sipas W01679-ës,<sup>775</sup> kursi i stërvitjes përfshinte ushtrime fizike dhe ushtarake, sikurse tha edhe z. Halimi,<sup>776</sup> dhe rekrutët merrnin pjesë në veprime që përfshinin detyrat e rojës, siç u dëshmua nga të dy dëshmitarët.<sup>777</sup>

383. Bazuar në ngjashmëritë e dëshmive të dy dëshmitarëve, Trupi Gjykses konstaton se W01679 dha hollësi kaq konkrete — përputhëse me dëshminë e një personi që ishte instruktor i UÇK-së në atë qendër — sa që do të ishte jorealiste të supozohej se W01679 e trilloi këtë informacion. Qartësia me të cilën W01679 i kujtoi hollësitë e stërvitjes dhe përputhja e tyre me dëshminë e z. Halimi, e forcon besueshmërinë e W01679-ës dhe, sipas Trupit Gjykses, tregon se ai vërtet ishte i pranishëm në Zllash për stërvitje, përpara se t’i hiqej liria.

---

<sup>772</sup> **W01679:** T. 5 tetor 2021, publik, f. 965, rreshtat 6-11; **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3730, rreshti 25 deri në f. 3731, rreshti 2; f. 3756, rreshtat 2-3.

<sup>773</sup> **W01679:** T. 5 tetor 2021, publik, f. 974, rreshtat 17-21; **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3731, rreshtat 3-6.

<sup>774</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, publik, f. 864, rreshti 9 deri në f. 865, rreshti 6; T. 5 tetor 2021, publik, f. 972, rreshtat 19-24; **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3738, rreshtat 21-24; f. 3793, rreshti 7 deri në f. 3797, rreshti 14 (*Shih gjithashtu*, deklarata e mëhershme e z. Halimi për Mbrojtjen, DSM00539-00550, f. 00547, sipas të cilës Adem Shehu “Gjithashtu merrte pjesë në stërvitje. Ai ishte trajneri kryesor”).

<sup>775</sup> **W01679:** T. 5 tetor 2021, publik, f. 969, rreshti 1 deri në f. 970, rreshti 2.

<sup>776</sup> **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3740, rreshtat 3-11; f. 3791, rreshtat 12-14.

<sup>777</sup> **W01679:** T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 975, rreshtat 5-11; **Z. Halimi:** T. 20 prill 2022, publik, f. 3744, rreshtat 13-18.



384. Ngjashmëria ndërmjet dëshmisë së W01679-ës dhe asaj të z. Halimi lidhur me stërvitjen konfirmohet më tej nga W04669<sup>778</sup> dhe zoti F. Sopi,<sup>779</sup> i cili nga ana e tij dha dëshmi që përputhej krejt me atë të W01679-ës dhe të z. Halimi.

385. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton se z. Halimi deklaroi në sallën e gjyqit se ishte e pamundur t'i dinte të gjithë emrat e rekrutëve dhe se as nuk ishte i interesuar të dinte kush ishin e nga vinin.<sup>780</sup> Për më tepër, sipas pohimit të vetë z. Halimi gjatë pyetjeve nga të dyja palët, ishin me qindra rekrutë që morën pjesë në kurset e ndryshme (secili kurs zgjaste dy javë)<sup>781</sup> midis fillimit të shkurtit dhe mesit të prillit 1999.<sup>782</sup> Për rrjedhojë, Trupit Gjykses i duket e pamundur që z. Halimi të ketë pasur ide dhe dijeni të plotë për të gjithë pjesëmarrësit në stërvitje. [REDAKTUAR].<sup>783</sup>

386. Sipas Trupit Gjykses, është tërësisht e mundshme që z. Halimi thjesht mund të mos ketë pasur dijeni që W01679 ishte i pranishëm në qendrën stërvitore apo që atë e morën dikur. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se, sipas W01679-ës, personi që e regjistroi atë për stërvitje ishte zoti F. Sopi.<sup>784</sup> Duke qenë se zoti F. Sopi ishte në atë kohë eprori i z. Halimi,<sup>785</sup> është logjike të supozohet se ai mund të ketë regjistruar persona për stërvitje pa iu përmbajtur praktikave të miratuara, dhe z. Halimi jo domosdoshmërisht kishte dijeni për këtë.

<sup>778</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1400, rreshti 19 to f. 1401, rreshti 9. *Z. Halimi njihej si komandant Llapi*: **Z. Halimi**: T. 20 April 2022, publik, f. 3729, rreshtat 9-15; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1400, rreshtat 16-17. *Z. Halimi kishte përvojë në artet marciale dhe ishte përgjegjës për ushtrimet fizike*: **Z. Halimi**: T. 20 prill 2022, publik, f. 3739, rreshtat 9-24; f. 3792, rreshtat 6-8; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1400, rreshti 16-17; f. 1401, rreshtat 23-25.

<sup>779</sup> *Triumfi ishte një nga instruktorët*: **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2072, rreshtat 11-14; f. 2081, rreshtat 14-16. *Stërvitja përfshinte ushtrime fizike, teori dhe përdorim armësh*: **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2068, rreshtat 2-4.

<sup>780</sup> **Z. Halimi**: T. 20 prill 2022, konfidencial, f. 3756, rreshtat 2-6; f. 3778, rreshtat 10-15.

<sup>781</sup> **Z. Halimi**: T. 20 prill 2022, publik, f. 3726, rreshtat 4-5.

<sup>782</sup> **Z. Halimi**: T. 20 prill 2022, publik, f. 3734, rreshtat 1-2; f. 3741, rreshtat 4-8; f. 3773, rreshti 4 deri në f. 3777, rreshti 12. Dëshmitari deklaroi se me përjashtim të rekrutëve të grupit të parë – që përbëhej nga rreth 50 persona – grupet e mëvonshme që u stërvitën kishin secili nga rreth 150 rekrutë.

<sup>783</sup> **Z. Halimi**: T. 20 prill 2022, konfidencial, f. 3758, rreshti 25 deri në f. 3759, rreshti 17.

<sup>784</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 965, rreshtat 5-11.

<sup>785</sup> **Z. Halimi**: T. 20 prill 2022, publik, f. 3727, rreshtat 7-9.

387. Si përfundim, Trupi Gjykses vlerëson se dëshmia e W01679-ës lidhur me mbajtjen e tij të mëpasshme në ndalim në kompleksin e ndalimit në Zllash, është e hollësishme, e qartë, përputhëse dhe reciprokisht konfirmuese me dëshmitë e të ndaluarve të tjerë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nxjerr përfundimin se përshkrimi i rrethanave të stërvitjes së tij me UÇK-në në Zllash nuk hedh asnjë dyshim mbi besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në dëshminë e tij sa u takon aspekteve me rëndësi për akuzat, veçanërisht sa i takon ndalimit të tij në kompleksin e ndalimit në Zllash.

388. Pasi ka vërtetuar se W01679 ishte në fakt në qendrën e stërvitjes në Zllash përpara se të arrestohej fillimisht, Trupi Gjykses do të trajtojë rrethanat e transferimit të tij në kompleksin e ndalimit në Zllash. Trupi Gjykses vëren se W01679 deklaroi se, kur iu afruan [REDAKTUAR] ushtarët e njësitit “Skifterat”, “s’ke pasë ça me mendu, ti, [REDAKTUAR] vetë të armatosur, ti edhe me të shku menja me mendu diçka s’ke mujt.”<sup>786</sup> Dëshmitari i identifikoi [REDAKTUAR] ushtarët e njësitit “Skifterat [REDAKTUAR].<sup>787</sup> Sipas dëshmitarit, anëtarët e njësitit “Skifterat” i thanë se “Po don komandanti diçka me bisedu me ty”.<sup>788</sup> W01679 dëshmoi se iu deshën 20 minuta për të shkuar në këmbë nga shkolla deri në kompleksin e ndalimit në Zllash,<sup>789</sup> që përputhet me largësinë e kompleksit të ndalimit nga shkolla e Zllashit, sikurse u përcaktua nga Trupi Gjykses.<sup>790</sup> Trupi Gjykses sheh ngjashmëri në përshkrimin e rrethanave të arrestimit të W01679-ës me ato të arrestimit të W04669-ës,<sup>791</sup> W03593-shit dhe W03594-ës,<sup>792</sup> veçanërisht për faktin që nuk iu tregua asnjë dokument dhe se u ndje i detyruar të bënte atë që i thanë, gjë të cilën Trupi Gjykses e vlerëson të

---

<sup>786</sup> W01679: T. 4 tetor 2021, publik, f. 866, rreshtat 13-14.

<sup>787</sup> W01679: T. 5 tetor 2021, publik, f. 1012, rreshtat 20-23.

<sup>788</sup> W01679: T. 4 tetor 2021, publik, f. 866, rreshtat 17-18.

<sup>789</sup> W01679: T. 5 tetor 2021, publik, f. 979, rreshti 25 to f. 980, rreshti 8.

<sup>790</sup> *Shih* para. 354-355.

<sup>791</sup> W04669: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1411, rreshtat 10-15; f. 1456, rreshtat 11-21.

<sup>792</sup> *Shih* para. 411, 442.

besueshme duke pasur parasysh se W01679 kishte përballë burra të armatosur. Sipas Trupit Gjykues, është e pagjasë që W01679 të ketë dhënë dëshmi të pasaktë lidhur me këtë aspekt, apo që ai thjesht rastësisht dha dëshmi të ngjashme me ato të W03593-shit dhe të W03594-ës, duke qenë se këta dëshmitarë u arrestuan në kohë dhe vende të ndryshme dhe nga njësite të ndryshme të UÇK-së.

389. Ndonëse dëshmitari nuk e tha në sallën e gjyqit se kur u arrestua fillimisht, Trupi Gjykues vëren se emri, mbiemri, datëlindja dhe vendlindja e tij janë në Listën e të Burgosurve, sipas së cilës W01679 u arrestua më [REDAKTUAR] prill 1999.<sup>793</sup> Në këtë fazë, Trupi Gjykues sqaron se data e saktë e arrestimit të të ndaluarve nuk është juridikisht thelbësore për vërtetimin e akuzave, me kusht që ajo duhet të jetë brenda kuadrit kohor të Aktakuzës së Konfirmuar, përveç nëse ka ndonjë mospërputhje në data që ngjall dyshime për besueshmërinë e dëshmitarit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues i ka përcaktuar datat kur iu hoq liria disa prej të ndaluarve vetëm me qëllimin për të bërë konstatime sa më të sakta mbi bazën e provave.

390. Duke pasur parasysh provat e marra në tërësi, Trupi Gjykues është bindur se W01679-ës iu hoq liria më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR], pra brenda kuadrit kohor të akuzave.

(b) Vendi i ndalimit

391. Sipas W01679-ës, ai u mbajt në një dhomë që e ai quajti “ahër” ose “stallë të lopëve”.<sup>794</sup> Sipas përshkrimit të W01679-ës, dhoma ishte e ndërtuar prej guri, me dysHEME prej druri, me pak kashtë dhe e lagësht dhe, me sa i kujtohet, pa dritare.<sup>795</sup>

---

<sup>793</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0310.

<sup>794</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 870, rreshtat 6-7; f. 882, rreshtat 18-19. W01679 shtoi se objekti ku e mbajtën ishte qartë një vend ku mbaheshin kafshët sepse “na kena pa dhe ma herët aty ku i mbajnë lopët e këto gjëra” (**W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 919, rreshtat 4-10).

<sup>795</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 882, rreshtat 20-23; T. 5 tetor 2021, publik, f. 982, rreshti 10 deri në f. 983, rreshti 2.

Trupi Gjykues thekson se dëshmia e tij në lidhje me vendin e ndalimit u konfirmua nga dëshmitë që dhanë W03593 dhe W03594.<sup>796</sup> W01679 shtoi më tej se dera e dhomës ku u mbajtën ishte e mbyllur me zinxhirë dhe se jashtë kishte roja, që të mos dilnin të ndaluarit,<sup>797</sup> një hollësi kjo që u konfirmua edhe nga W03594 dhe W03593.<sup>798</sup>

392. Gjatë identifikimit të ndërtesave përkatëse të kompleksit të ndalimit në Zllash në fotografi,<sup>799</sup> W01679 tha: “sa më kujtohet mu, kështu ka qenë. Kjo është. Kjo duhet me qenë”; dhe shtoi: “Po i përngjan shumë asaj pamjes që më ka mbetë mu kur jam liru. [...]edhe është podrumi poshtë edhe është kjo pjesa, që po them, kur na merrshin na çojshin naltë”.<sup>800</sup> Trupi Gjykues është bindur se dëshmia e W01679-ës për dhomën e ndalimit dhe mjedisin përreth është dhënë me vërtetësi, sepse dëshmitari dha dëshmi të qartë mbi këtë pikë. Gjithashtu, dëshmia e tij konfirmohet edhe nga dëshmitë e W03593-ës dhe W04669-ës, të cilët e identifikuan po atë grup ndërtesash brenda kompleksit të ndalimit në Zllash si vendin e ndalimit.<sup>801</sup>

393. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se W01679 u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash.

(c) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

394. Në lidhje me praninë dhe identifikimin e të ndaluarve të tjerë, W01679 tha se kur e çuan tek ahuri, atje gjeti katër persona të cilëve ua mësoi emrat kur bisedoi me ta, gjatë kohës që ishin të ndaluar: “[REDAKTUAR] [W03594], [REDAKTUAR] [W03593],

---

<sup>796</sup> *Shih* para. 415-416, 435-437.

<sup>797</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 919, rreshtat 11-20.

<sup>798</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1044, rreshtat 18-22; **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 403, rreshti 11; f. 405, rreshti 20 to f. 406, rreshti 1; f. 417, rreshtat 20-21; f. 480, rreshtat 6-7.

<sup>799</sup> *Shih* para. 364.

<sup>800</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 920, rreshtat 5-12. Fakti që të ndaluarit i çonin lart konfirmohet edhe nga W03594: “kam dalë në oborr dhe jemi ngjit lart, ku ishim në haur. Majtas kanë qenë shkallët dhe kemi hipur në katin e dytë” (**W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1073, rreshtat 5-8).

<sup>801</sup> *Shih* para. 364.

[REDAKTUAR]”.<sup>802</sup> Trupi Gjykues thekson se prania e këtyre të ndaluarve të tjerë konfirmohet edhe nga Lista e të Burgosurve.<sup>803</sup> Trupi Gjykues vëren më tej se W01679 mundi të identifikonte dy të ndaluar të tjerë, konkretisht “[REDAKTUAR] [W04669] edhe një e thirrshin këta [REDAKTUAR] [...] [REDAKTUAR]”.<sup>804</sup> Meqë sipas Listës së të Burgosurve W03594 u arrestua më [REDAKTUAR] prill 1999, pra nuk ka mundësi që W01679 ta ketë gjetur në ahur kur mbërriti atje, Trupi Gjykues merr parasysh se përshkrimi i ngjarjeve nga W01679 mund të ketë pasaktësi për shkak të kohës që ka kaluar. Në fakt, Trupi Gjykues vlerëson se W01679 dha dëshmi për personat që i mbante mend se ishin të ndaluar bashkë me të në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë prillit 1999, por kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se ata të gjithë kishin qenë të ndaluar aty para se t’i hiqej liria W01679-ës. Kjo pasaktësi nga ana e W01679-ës nuk ndikon në besueshmërinë dhe mbështetshmërinë në dëshminë e tij lidhur me përshkrimin e vendit të ndalimit dhe të të ndaluarve të tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë kuadrit kohor të akuzave, duke mbajtur parasysh se sa të imtësishme ishin hollësitë që dha dëshmitari për veten dhe të ndaluarit e tjerë.

395. Mbrojtja kundërshton dëshminë e W01679-ës, si dhe ato të W03593-shit, W03594-ës dhe W04669-ës, me argumentin se ato bien ndesh me njëra-tjetrën, sepse ata nuk identifikuan të gjithë të njëjtin grup të burgosurish. Për rrjedhojë, Mbrojtja parashtron se dëshmitë e tyre nuk kanë vlerë provuese.<sup>805</sup>

396. Mbrojtësja e viktimave përgjigjet se këto dallime janë të natyrshme, duke pasur parasysh se dëshmitarët dëshmuar për ngjarje traumatike që, për më tepër, ndodhën para më shumë se 20 vjetësh. Të marra së bashku me elementet objektive, si Lista e të Burgosurve, dëshmitë e viktimave krijojnë një dëshmi të qartë dhe autentike.<sup>806</sup>

---

<sup>802</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 889, rreshtat 4-13.

<sup>803</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0310.

<sup>804</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 889, rreshtat 24-25.

<sup>805</sup> T. 14 shtator 2022, konfidencial, f. 4698, rreshti 8 deri në f. 4703, rreshti 16.

<sup>806</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4827, rreshti 17 deri në f. 4828, rreshti 12.

397. Trupi Gjykues është i mendimit se dallime të tilla në identifikimin e të ndaluarve të tjerë– sikurse edhe në përshkrimet e kompleksit të ndalimit në Zllash – janë të natyrshme për shkak të mënyrës se si i kujton çdo dëshmitar ngjarjet traumatike që ka përjetuar. Nga ky këndvështrim, këto dallime nuk e zvogëlojnë, por përkundrazi e përforcojnë besueshmërinë e secilit dëshmitar. Së fundi, Trupi Gjykues vlerëson se dëshmitë identifikuese të dëshmitarëve janë shumë konfirmuese,<sup>807</sup> që përforcohet edhe më tej kur krahasohen me provat dokumentare në dokumentacionin e çështjes gjyqësore, si Lista e të Burgosurve.

398. Në lidhje me W01679-ën, Trupi Gjyqësor vëren se gjatë identifikimit të të ndaluarve të tjerë, dëshmitari u përpoq të jepte informacion të saktë edhe kur nuk ua dinte emrat, si në rastin e [REDAKTUAR], duke e përshkruar atë person ([REDAKTUAR]), gjë që e forcon besueshmërinë e W01679-ës. Trupi Gjykues vëren më tej se, lidhur me personat që i sillnin në ahur dhe më pas i nxirrnin prej tij, dëshmia e dëshmitarit ishte përputhëse me deklaratën që ai i kishte dhënë më parë ZPS-së.<sup>808</sup> Kur u pyet nga Trupi Gjykues, W01679 tregoi se në ahur ishin gjashtë persona, dhe një erdhi më vonë.<sup>809</sup>

399. Trupi Gjykues vlerëson se shkalla e hollësive në informacionin që dha W01679 për të ndaluarit e tjerë ishte e tillë që dëshmitari atë informacion mund ta dinte vetëm përmes bisedave të drejtpërdrejta, ndonëse të shkurtra, me të ndaluarit e tjerë. Trupi Gjykues vëren se W01679 dha edhe hollësi të mëtejshme për të ndaluarit e tjerë, përfshirë për sjelljen e tyre, gjë që e bëri dëshminë e tij më të pasur dhe forcoi përshtypjen e Trupit Gjykues se W01679-ës i kujtoheshin faktet nga përvoja personale. Në lidhje me këtë, W01679 dëshmoi se viktimat e vrasjes së paligjshme ishte i lidhur

---

<sup>807</sup> W03593 identifikoi viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] dhe W03594-ën (*shih* para. 417). W03594 identifikoi W03593-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] (*shih* para. 438). W04669 identifikoi viktimën e vrasjes së paligjshme (*shih* para. 451).

<sup>808</sup> 060698-TR-ET Part 1 Revised (Pjesa 1 e Rishikuar) RED3, f. 11, rreshtat 14-16.

<sup>809</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 1006, rreshtat 10-14.



“të shumtën e kohës” dhe se e kishin ndaluar sepse e konsideronin [REDAKTUAR],<sup>810</sup> që u konfirmua edhe nga dëshmia e W03594-ës.<sup>811</sup> Sipas W01679-ës, W03594 i kishte thënë atij në atë kohë se “[REDAKTUAR]”;<sup>812</sup> kur shkoi tek ushtarët [REDAKTUAR], e arrestuan dhe e akuzuan se “[REDAKTUAR].<sup>813</sup> Në lidhje me [REDAKTUAR], W01679 pranoi se kishte dëgjuar nga W03594 se “ai [REDAKTUAR] kish ardhë [REDAKTUAR]. Kish ardhë me u kyç në luftë. [REDAKTUAR] ja kishin marrë [REDAKTUAR].<sup>814</sup> W01679 po ashtu deklaroi se gjatë kohës së ndalimit [REDAKTUAR] kishte thënë se e konsideronin “spiun”.<sup>815</sup> Gjithashtu, W01679 dëshmoi se gjatë kohës së ndalimit bisedoi me W04669-ën,<sup>816</sup> të cilin e mbajtën “[t]ri a katër ditë”<sup>817</sup> dhe “e akuzojshin si bashkëpunëtor, bashkëpunim me serb”.<sup>818</sup> Konkretisht, sipas W01679-ës, W04669-ës [REDAKTUAR]. Kështu e akuzojshin, një farë akuze si bashkëpunëtor”.<sup>819</sup> W01679 konfirmoi se e kishte marrë informacionin e mësipërm drejtpërdrejt nga W04669 gjatë kohës që ishin të ndaluar bashkë.<sup>820</sup> Së fundi, lidhur me [REDAKTUAR],<sup>821</sup> W01679 deklaroi “ky jo që u tutke prej atynve [UÇK-së], po ky u tutke edhe prej neve. [REDAKTUAR]. Nuk bisedojke me neve kurrë”.<sup>822</sup> Identifikimi i të ndaluarve të tjerë nga W01679 konfirmohet edhe nga dëshmitë e disa

<sup>810</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 892, rreshtat 9-13; f. 892, rreshti 19 deri në f. 893, rreshti 5; T. 5 tetor 2021, publik, f. 990, rreshtat 13-19.

<sup>811</sup> **W03594:** T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1049, rreshtat 3-18.

<sup>812</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 893, rreshtat 23-24. *Shih gjithashtu* T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 992, rreshtat 20-25.

<sup>813</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 894, rreshtat 6-9; T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 992, rreshti 20 deri në f. 993, rreshti 2.

<sup>814</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 894, rreshti 25 deri në f. 895, rreshti 4.

<sup>815</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, publik, f. 895, rreshti 5.

<sup>816</sup> W01679 ia dinte emrin W04669-ës që më parë, dhe mbiemrin ia mësoi gjatë kohës që ishin të ndaluar së bashku (**W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 897, rreshtat 4-5).

<sup>817</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, publik, f. 896, rreshti 22.

<sup>818</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 896, rreshti 23.

<sup>819</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 896, rreshti 24 deri në f. 897, rreshti 1.

<sup>820</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 897, rreshtat 4-7.

<sup>821</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 889, rreshti 24.

<sup>822</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 900, rreshtat 8-17.



prej vetë këtyre të ndaluarve, të cilët konfirmuan se u mbajtën në të njëjtat objekte të kompleksit të ndalimit në Zllash gjatë prillit 1999.<sup>823</sup>

400. Në përgjithësi, sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, W01679 dha dëshmi të qartë dhe me shumë hollësi. Konkretisht, dëshmitari iu përmbajt deklarates së mëparshme – kur iu bënë pyetje për disa pjesë të saj. Dëshmia e tij lidhur me praninë e viktimës së vrasjes së paligjshme, e W03593-shit, W03594-ës dhe [REDAKTUAR], konfirmohet më tej nga Lista e të Burgosurve; ndërsa prania e [REDAKTUAR] konfirmohet edhe nga të ndaluarit e tjerë.<sup>824</sup> Sa i takon pranisë, përshkrimit, dhe arsyeve të pretenduara të mbajtjes së të ndaluarve të tjerë që ishin me të, Trupi Gjykses vëren hollësitë (shumë të veçanta) që jep W01679 dhe përpjekjet e tij për të bërë qartë dallimin mes asaj që dinte personalisht dhe asaj që i kishin treguar të ndaluarit e tjerë. Kjo përforcon përshtypjen e përgjithshme të Trupit Gjykses se dëshmitari synonte të përshkruante me vërtetësi përvojën e tij personale. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses vlerëson se mund të mbështetet në dëshminë e W01679-ës sa i përket pranisë dhe identifikimit të gjashtë të ndaluarve të tjerë.

401. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se W01679 u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash së bashku me të ndaluarit e lartpërmendur.

(d) Rrethanat e lirimit

402. W01679 deklaroi se u mbajt i ndaluar për [REDAKTUAR].<sup>825</sup> Në lidhje me këtë pikë, Mbrojtja kundërshton provat e ZPS-së, me argumentin se nëse përlllogaritjet e W01679-ës do të ishin të sakta – dhe duke marrë parasysh se bazuar në Listën e të

---

<sup>823</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses në “Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë” lidhur me W03593-in, W03594-ën, dhe W04669-ën.

<sup>824</sup> *Shih* para. 417, 438.

<sup>825</sup> [REDAKTUAR].

Burgosurve ai u arrestua më [REDAKTUAR] prill 1999 – atëherë ai duhet të jetë liruar më 20 prill 1999. Në atë periudhë, sipas Mbrojtjes, znj. Hadri dhe znj. Canolli-Kaçiu mjekonin të plagosur në të njëjtën ndërtesë ku W01679 pretendon se u mbajt i ndaluar, duke lënë të nënkuptohet se dëshmitari nuk mund të jetë mbajtur i ndaluar atje.<sup>826</sup>

403. Trupi Gjykues vëren se W01679 shpjegoi se e dinte që u lirua ditën e [REDAKTUAR] të ndalimit sepse shihte “përmes asaj derës së ahurit ajo drita që u hy” dhe, rrjedhimisht, sipas fjalëve të dëshmitarit, e shihte kur ishte ditë dhe “ ato i kam numëru”.<sup>827</sup> Në bazë të datës së arrestimit të shënuar në Listën e të Burgosurve [REDAKTUAR], së bashku me llogaritjen e dëshmitarit se u lirua ditën e [REDAKTUAR], data e lirimit të tij në fakt i bie të jetë 20 prilli 1999, siç parashtrohet nga Mbrojtja. Sidoqoftë, në kuadër të provave të tjera të pakundërshtueshme në dokumentacionin e çështjes gjyqësore, që tregojnë se disa prej të ndaluarve, ku përfshihet dhe vetë W01679, [REDAKTUAR] më 19 prill 1999 ose rreth asaj date,<sup>828</sup> pas lirimit nga kompleksi i ndalimit në Zllash, atëherë 20 prilli 1999 si datë lirimi nuk duket të jetë krejt e saktë. Megjithatë, Trupi Gjykues është i mendimit se kujtimet e W01679-ës lidhur me lirimin e tij dhe shpjegimi se si i numëroi ditët janë të hollësishme, realiste dhe të besueshme. Trupi Gjykues vlerëson më tej se kjo mospërputhje me më pak se 24 orë është minimale dhe e parëndësishme në rrethanat konkrete, duke pasur parasysh dëshminë përndryshe të qartë dhe të hollësishme të

---

<sup>826</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4710, rreshtat 12-24. Mbrojtja kundërshton edhe datën e lirimit që i kujtohet W01679-ës, mbështetur në deklaratën e tij të mëparshme [REDAKTUAR] (7000680-7000686). Megjithatë, meqë Mbrojtja është mbështetur vetëm në një pjesë (f. 7000685) që nuk iu parashtrua dëshmitarit dhe për rrjedhojë nuk është pjesë e provave që do të shqyrtohen në kuadër të aktgjykimit, atëherë ky kundërshtim duhet të hidhet poshtë.

<sup>827</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 1007, rreshtat 16-25.

<sup>828</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 910, rreshtat 7-13 (“[REDAKTUAR]”); **W03593**: T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 613, rreshtat 8-14; **W03594**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1145, rreshtat 11-12; **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333; **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1816, rreshti 24 to f. 1818, rreshti 10; W04390: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1865, rreshti 21 deri në f. 1869, rreshti 20.

W01679-ës, si dhe faktin që kanë kaluar më shumë se 23 vjet nga ngjarjet në fjalë. Veç kësaj, rrethanat e lirimit të W01679-ës konfirmohen edhe nga dëshmitarë të tjerë, si W03593 dhe W03594, të cilët u liruan papritur, në të njëjtën kohë me W01679-ën.<sup>829</sup> Në përfundim, Trupi Gjykses mendon se W01679 u lirua më 19 prill 1999, ose rreth asaj date, që nuk bie ndesh me parashtrimin e Mbrojtjes se znj. Hadri dhe znj. Canolli-Kaçiu mund të kenë qenë duke trajtuar pacientë në të njëjtën ndërtesë ku ishte i ndaluar W01679 më 20 prill 1999.

404. Trupi Gjykses rikujton më tej se W01679 dëshmoi se dy persona, që ai i identifikoi [REDAKTUAR], hapën derën dhe thjesht i lanë W01679-ën dhe dy të ndaluar të tjerë që të dilnin.<sup>830</sup> [REDAKTUAR].<sup>831</sup> W01679 menjëherë deklaroi se ishte “absolutisht pozitiv” që e njohu [REDAKTUAR] për shkak të “tipareve dalluese të [REDAKTUAR], fytyra, forma e trupit dhe gjatësia” dhe shtoi se [REDAKTUAR] “nuk kishte ndryshuar shumë”, [REDAKTUAR].<sup>832</sup> Trupi Gjykses e konsideron W01679-ën tërësisht të besueshëm në lidhje me këtë pikë, pasi dëshmitari nuk mund të ketë trilluar një informacion kaq konkret si nofka e njërit nga kryesit sepse, sipas W01679-ës, ai i njihnte kryesit vetëm me nofkat e tyre, dhe jo me emrat e vërtetë.<sup>833</sup> Reagimi i W01679-ës kur pa [REDAKTUAR] duke dëshmuar në sallën e gjyqit dhe fakti që W01679 menjëherë [REDAKTUAR], mbështesin përfundimin se identifikimi nga W01679 i [REDAKTUAR] – është tejet i besueshëm. [REDAKTUAR].<sup>834</sup> Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se [REDAKTUAR] që liroi W01679-ën.

---

<sup>829</sup> *Shih* para. 419-426, 440-441.

<sup>830</sup> [REDAKTUAR].

<sup>831</sup> **W01679**: 105371-105372 RED, para. 2.

<sup>832</sup> **W01679**: 105371-105372 RED, para. 5; T. 1 qershor 2022, konfidencial, f. 4444, rreshti 7 deri në f. 4445, rreshti 22.

<sup>833</sup> **W01679**: 105371-105372 RED, para. 2.

<sup>834</sup> [REDAKTUAR].

405. Së fundi, kujtimet e W01679-ës për rrethanat e lirimit të tij të papritur, që u konfirmuan edhe nga dëshmitarë të tjerë, janë kaq të detajuara saqë nuk ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarit lidhur me datën e lirimit të tij.

406. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se W01679 u lirua më 19 prill 1999 ose rreth asaj date, së bashku me të ndaluar të tjerë.

(e) Mungesa e garancive procedurale

407. Trupi Gjykses rikujton se heqja e lirisë cilësohet si arbitrare në qoftë se dhe kur nga pala ndaluese mohohet më së paku njëra prej tri garancive bazë që duhet t'u sigurohen të gjithë personave të cilëve u hiqet liria në një konflikt të armatosur. Pala ndaluese ka detyrimin: (i) të informojë personin që i është hequr liria lidhur me arsyet për heqjen e lirisë; (ii) ta sjellë personin që i është hequr liria pa vonesë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent; dhe (iii) t'i japë personit që i është hequr liria mundësinë të kundërshtojë ligjshmërinë e ndalimit të tij.<sup>835</sup>

408. Sa i takon detyrimin për të informuar personin që i është hequr liria për arsyet e heqjes së lirisë, W01679 dëshmoi se kur e arrestuan nuk i treguan asnjë dokument por thjesht i thanë "Hajde se kemi punë pak me ty. Po don komandanti diçka me bisedu me ty".<sup>836</sup> Po ashtu, edhe në lidhje me kohën e lirimit, W01679 deklaroi se nuk i dhanë asnjë vërtetim apo dokument lirimi dhe se kur e pyeti [REDAKTUAR] për arsyet e ndalimit, ai thjesht iu përgjigj [REDAKTUAR].<sup>837</sup> Trupi Gjykses konstaton se W01679 është i besueshëm lidhur me këtë pikë, pasi e identifikoi qartazi [REDAKTUAR] si personin që e kishte liruar dhe me të cilin bisedoi për arsyet e ndalimit të tij. Informacioni i dhënë është kaq specifik dhe personal, saqë Trupi Gjykses arrin në përfundimin se ai e ka burimin tek njohuritë e vetë dëshmitarit. Trupi Gjykses vëren

---

<sup>835</sup> *Shih* para. 648.

<sup>836</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 866, rreshtat 17-18.

<sup>837</sup> [REDAKTUAR].

se W01679-ës – njësoj si W03593-shit, W03594-ës dhe W04669-ës<sup>838</sup> - nuk iu tregua asnjë dokument dhe ai u ndje i detyruar të bënte si i thanë. Sipas Trupit Gjykues, nuk ka gjasa që dëshmitari të ketë dhënë dëshmi të pasaktë apo krejt rastësore lidhur me këtë pikë, sepse të gjithë këta dëshmitarë dhanë dëshmi konfirmuese, pavarësisht se u arrestuan në vende e kohë të ndryshme dhe nga njësite të ndryshme të UÇK-së.

409. Më tej, edhe në lidhje me dëshmitarët e tjerë, Trupi Gjykues ka konstatuar se as ata nuk u nxorën para një gjykatësi apo prokurori dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre.<sup>839</sup> Gjithashtu, edhe lidhur me Pikat 2 dhe 3 në Aktakuzën e Konfirmuar, Trupi Gjykues ka konstatuar se W01679 përjetoi forma të ndryshme keqtrajtimi gjatë kohës së ndalimit në kompleksin e ndalimit në Zllash, me pretendimin se ishte spiun, gënjeshtar dhe hajdut.<sup>840</sup> Duke pasur parasysh se të gjithë të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u mbajtën në kushte ndalimi të ngjashme dhe se W01679 u keqtrajtua rëndë gjatë kohës në ndalim, Trupi Gjykues konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm bazuar në provat në tërësi është se ai nuk u nxor para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent, e as nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

410. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se W01679-ën nuk e informuan për arsyet e heqjes së lirisë, nuk e nxorën pa vonesë para një gjykatësi ose autoriteti tjetër kompetent, dhe nuk i dhanë mundësinë të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

---

<sup>838</sup> *Shih* para. 427, 442, 456.

<sup>839</sup> *Shih* para. 409, 444, dhe 483.

<sup>840</sup> *Shih* para. 534-545.

### 3. W03593

#### (a) Arrestimi fillestar

411. Lidhur me rrethanat e arrestimit të tij fillestar, W03593 dëshmoi se u arrestua në [REDAKTUAR] nga dy persona, të cilët dëshmitari i cilësoi pa hezitim si policë ushtarakë të UÇK-së, sepse ishin me uniforma kamuflimi “si ato që ka mbajtur UÇK-ja” dhe kishin automatikë.<sup>841</sup> Sipas dëshmitarit, ai nuk kishte zgjedhje tjetër veç të shkonte me ta, sepse “mos me shku me ta, më kishin vra q' aty”.<sup>842</sup> Dëshmitari nuk u lëkund dhe këtë hollësi e konfirmoi edhe gjatë pyetjeve të palës kundërshtare.<sup>843</sup> Ndonëse muaji nuk i kujtohej, dëshmitari u përpoq dhe dha një periudhë kohore të përafërt se kur u ndalua, duke thënë “Dikun ka ndodh me 4, e di datën 4 dhe jam kanë i burgosun deri 18, kam qenë aty 18 ditë”.<sup>844</sup>

412. Mbrojtja kundërshton dëshminë e W03593-shit lidhur me arrestimin “në datën 4” pa dhënë hollësi të tjera, mbi bazën se është tepër e përgjithshme dhe nuk mund të mbështetesh në të.<sup>845</sup> Po ashtu, Mbrojtja pretendon se as Lista e të Burgosurve nuk e konfirmon dëshminë e W03593-shit, sepse ai dokument tregon se dëshmitari u arrestua më 2 prill 1999.<sup>846</sup>

413. Trupi Gjykes gjykon se është e përshtatshme të pranohet se mund të ketë pasaktësi dhe mospërputhje lidhur me kohën, vendin apo përshkrimet, në qoftë se këto pasaktësi apo mospërputhje nuk ndikojnë në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit dhe nëse ato balancohen nga

---

<sup>841</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 395, rreshtat 8-10; T. 20 shtator 2021, publik, f. 396, rreshtat 12-21; f. 397, rreshti 6.

<sup>842</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 397, rreshtat 20-22.

<sup>843</sup> **W03593**: T. 21 shtator 2021, publik, f. 556, rreshtat 8-20 (“e kanë pas normal tesha të UÇK-së” mu kanë prezantue “jemi polic ushtarak”).

<sup>844</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 394, rreshtat 24-25.

<sup>845</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4711, rreshtat 8-17.

<sup>846</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4711, rreshti 23 deri në f. 4712, rreshti 6.

vlerësimi tërësor i provave të tjera në dokumentacionin e çështjes gjyqësore. Në rastin konkret, Trupi Gjykses vlerëson se ndonëse referenca kohore e dhënë nga W03593 është disi e pasaktë, kjo mund të jetë për shkak të kohës së konsiderueshme që ka kaluar (23 vjet) që kur ndodhën ngjarjet traumatike, krahas moshës së thyer të dëshmitarit në kohën e dhënies së dëshmisë.<sup>847</sup> Trupi Gjykses është i mendimit se W03593 dha aq referenca kohore sa mund të jepte logjikisht, ndër të cilat datën e përafërt të fillimit, kohëzgjatjen e gjithsejtë dhe datën e lirit. Trupi Gjykses këtë e konsideron si element vërtetësie në dëshminë e W03593-shit, megjithëse qartazi kishte vështirësi të ishte i saktë. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se periudha kohore e arrestimit dhe ndalimit të W03593-shit gjatë prillit 1999 konfirmohet edhe nga W01679 dhe W03594, të cilët e identifikuan atë si një nga personat e ndaluar bashkë me ta gjatë asaj periudhe. Ky fakt konfirmohet më tej edhe nga Lista e të Burgosurve, sipas së cilës W03593 u arrestua më 2 prill 1999.<sup>848</sup> Duke mbajtur këtë parasysh, Trupi Gjykses vlerëson se data e pasaktë që dha W03593 lidhur me heqjen e lirisë nuk ka ndikim në besueshmërinë ose mbështetshmërinë në dëshminë e tij, sepse pavarësisht nga kjo, ai u mbajt i ndaluar brenda kuadrit kohor të akuzave.

414. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se W03593-shit iu hoq liria më 2 prill 1999 ose rreth asaj date, pra brenda kuadrit kohor të akuzave.

#### (b) Vendi i ndalimit

415. Në lidhje me vendin e ndalimit, W03593 sqaroi se [REDAKTUAR], e dinte se ishin nisur në drejtim të Zllashit, pavarësisht se e kishte kokën të mbuluar gjatë gjithë

---

<sup>847</sup> Në lidhje me këtë, W03593 deklaroi se gjatë kohës që qëndroi në Zllash “kam qenë i humbur, kam qenë — s’po di çka po bohet me neve” (W03593: T. 20 shtator 2021, publik, f. 481, rreshtat 4-5). Në kohën e dhënies së dëshmisë, W03593 [REDAKTUAR] (W03593: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 393, rreshtat 23-24).

<sup>848</sup> U001-0310-U001-0322-ET, f. U001-0310. *Shih gjithashtu* W03593: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 393, rreshti 21 to f. 394, rreshti 1.



udhëtimit.<sup>849</sup> Dëshmitari dëshmoi se, gjatë kohës së ndalimit të tij, e kishin mbajtur të kyçur të paktën në dy dhoma të ndryshme brenda të njëjtit vend, të dyja i ngjasonin ahurit të kafshëve.<sup>850</sup> Trupi Gjykses e vlerëson si të besueshëm përshkrimin që i bën dëshmitari vendit të ndalimit, pasi ai konfirmohet edhe nga W01679 dhe W03594, të cilët po ashtu e përshkruan dhomën ku ishin mbajtur si “ahur” ose “stallë lopësh”.<sup>851</sup> Siç është konstatuar tashmë nga Trupi Gjykses, W03593 e identifikoi kompleksin e ndalimit në Zllash si vendin e ndalimit, ashtu si edhe W01679 dhe W04669.<sup>852</sup>

416. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se W03593 u mbajt i ndaluar në të paktën dy ahure në kompleksin e ndalimit në Zllash.

(c) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

417. Sa i përket pranisë dhe identifikimit të të ndaluarve të tjerë, Trupi Gjykses konstaton se W03593 pohoi se në një nga dy ahuret ku e mbajtën ishte dhe një person tjetër të cilin e njohte që më parë, [REDAKTUAR], i cili e njohu W03593-shin dhe e thirri në emër.<sup>853</sup> Trupi Gjykses vlerëson se duke përmendur emrin e një të ndaluarit tjetër, i cili e thirri në emër dëshmitarin, W03593 i shtoi një ndërlikim të panevojshëm dëshmisë së tij, që përputhet me përshkrimin e dikujt që i ka përjetuar personalisht ngjarjet. Gjithashtu, W03593 identifikoi [REDAKTUAR] dhe W03594-ën si dy të ndaluar të tjerë.<sup>854</sup> Sipas Trupit Gjykses, për rrjedhojë, dëshmia W03593-shit konfirmon dëshminë e W01679-ës lidhur me praninë e të ndaluarve të tjerë, të W03594-ës, [REDAKTUAR] dhe viktimës së vrasjes së paligjshme, duke konfirmuar

---

<sup>849</sup> **W03593:** T. 20 shtator 2021, publik, f. 400, rreshtat 24-25; f. 401, rreshtat 2-6, 11-14.

<sup>850</sup> **W03593:** T. 20 shtator 2021, publik, f. 403, rreshtat 17; T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 417, rreshtat 4-13.

<sup>851</sup> *Shih* para. 391, 435.

<sup>852</sup> *Shih* para. 364.

<sup>853</sup> **W03593:** T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 403, rreshti 20 deri në f. 404, rreshti 5.

<sup>854</sup> **W03593:** T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 444, rreshti 17 deri në f. 445, rreshti 20; f. 452, rreshti 19 deri në f. 453, rreshti 16.

se të gjithë u mbajtën të ndaluar në ndërtesat e identifikuar brenda kompleksit të ndalimit në Zllash.<sup>855</sup>

418. Duke marrë parasysh identifikimin që të ndaluarit i bënë njëri-tjetrit, në bazë të tërësisë së dëshmive të W03593-shit, W01679-ës, W03594-ës dhe W04669-ës, Trupi Gjykses është bindur se W03593 u mbajt i ndaluar në Zllash bashkë me të ndaluarit e lartpërmendur.

(d) Rrethanat e lirimit

419. Në lidhje me lirimin, W03593 dëshmoi se qëndroi në Zllash gjithsej 18 ditë.<sup>856</sup> Megjithatë, në të njëjtën kohë Trupi Gjykses vëren se ai deklaroi se u lirua ditën e tetëmbëdhjetë të muajit, duke e lidhur lirimin me ofensivën serbe.<sup>857</sup>

420. Mbrojtja kundërshton vërtetësinë e dëshmisë së W03593-shit me argumentin se sipas përlogaritjes së ditëve të kaluara në ndalim, data e lirimit duhej të ishte 22 prill 1999, ndërkohë që ofensiva filloi më 18 prill 1999.<sup>858</sup>

421. Trupi Gjykses vlerëson se të njëjtët faktorë që u morën parasysh lidhur me periudhën kohore të arrestimit fillestar të W03593-shit, vlejné edhe për rrethanat e lirimit të tij. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses pranon se mund të ketë pasaktësi të tilla, të cilat mund të vijnë si pasojë e kohës që ka kaluar që prej ngjarjeve traumatike, marrë së bashku me moshën e thyer të dëshmitarit në kohën e dhënies së dëshmisë.

422. Sidoqoftë, për shkak të rrethanave konkrete të dëshmisë së tij, Trupi Gjykses vlerëson se heqja e lirisë në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës kohore të

---

<sup>855</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 445, rreshtat 16-20; **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 889, rreshti 24 ([REDAKTUAR]). **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 452, rreshti 19 deri në f. 453, rreshti 16; **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 893, rreshtat 21-24 (për W03594). **W03593**: T. 21 shtator 2021, publik, f. 510, rreshtat 1-8; **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 892, rreshtat 9-13; f. 892, rreshti 19 deri në f. 893, rreshti 5 (për viktimën e vrasjes së paligjshme).

<sup>856</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 418, rreshtat 20-23.

<sup>857</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 418, rreshti 25 deri në f. 419, rreshti 2.

<sup>858</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4713, rreshtat 9-20.

akuzave si dhe koha e lirimit të tij janë mjaftueshmërisht të përcaktuara në kohë, duke marrë parasysh prova të tjera në dokumentacionin e çështjes gjyqësore. Së pari, Trupi Gjykses vëren se kur përshkroi lirimin e tij, W03593 shtoi elemente të mëtejshme se si një burrë me uniformë hapi derën dhe i thirri disa nga të ndaluarit në emër, përfshirë dëshmitarin dhe u tha "Nga doni shkoni, jeni të lirë".<sup>859</sup> Lirimi i papritur i W03593-shit, pa ndonjë procedurë apo shpjegim të veçantë, përputhet edhe me dëshminë e W01679-ës (që u lirua bashkë me W03593-shin më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date), duke konfirmuar kështu dëshmitë e njëri-tjetrit.<sup>860</sup>

423. Së dyti, në lidhje me këtë Trupi Gjykses vëren gjithashtu se për shkak të ofensivës serbe, kompleksi i ndalimit në Zllash u evakuua,<sup>861</sup> çka shpjegon më tej vendimin për lirimin e papritur të të ndaluarve.

424. Së treti, si konfirmim i mëtejshëm i lirimit të papritur të këtyre të ndaluarve më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, Trupi Gjykses thekson se Lista e të Burgosurve, kolona e fundit në të djathtë, përmban të dhënat e sakta për datat e lirimit të të burgosurve. Ndonëse janë shënuar datat e lirimit për të ndaluarit që u liruan më 9, 14, 15 dhe 17 prill, nuk është shënuar datë lirimi për të burgosurit që u liruan pas 17 prillit 1999, ku përfshihen W03593, W03594 dhe W01679. Sipas Trupit Gjykses, kjo tregon se anëtarët e BIA-s që plotësonin Listën e të Burgosurve nuk patën kohë të shënonin datën e lirimit të të ndaluarve si W01679, W03593 dhe W03594, pikërisht sepse vendimi për lirimin e tyre u mor papritur, për shkak të afrimit të ofensivës serbe. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se duke e lidhur lirimin e tij me një ngjarje si ofensiva serbe dhe duke shtuar hollësi të mëtejshme që përputhen me dëshminë e

---

<sup>859</sup> **W03593:** T. 20 shtator 2021, publik, f. 481, rreshti 15 deri në f. 482, rreshti 11.

<sup>860</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 904, rreshti 1 deri në f. 905, rreshti 3.

<sup>861</sup> Lidhur me konstatimet e Trupit Gjykses mbi ofensivën serbe shih para. 625-638.

W01679-ës, W03593 demonstroi aftësinë për t'iu përmbajtur me vërtetësi ngjarjes që, sipas tij, u bë shkas për lirimin e tij.

425. Së katërti, lirimi më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, përputhet edhe me faktin se W03593 [REDAKTUAR],<sup>862</sup> siç u përmend nga vetë dëshmitari gjatë pyetjeve nga të dyja palët në gjykim.<sup>863</sup>

426. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se W03593 u lirua më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, së bashku me të ndaluarit e tjerë.

(e) Mungesa e garancive procedurale

427. Sa i përket detyrimit për ta informuar personin e ndaluar për arsyet e ndalimit, W03593 dëshmoi se kur e ndaluan nuk i treguan asnjë dokument dhe nuk kishte zgjedhje tjetër veçse të shkonte me oficerët e policisë ushtarake, sepse në të kundërt “me kishin vra q' aty”.<sup>864</sup> Në lidhje me këtë pikë, Trupi Gjykses vëren më tej se oficerët që e arrestuan ishin të armatosur,<sup>865</sup> çka tregon, sipas Trupit Gjykses element shtrëngimi dhe kërcënimi të mundshëm fizik të dëshmitarit në rast se nuk bindej. Kjo demonstron më tej nga dëshmia e W03593-shit se gjatë kohës që po vozisnin drejt Zllashit, e goditën me grusht në fytyrë dhe më pas i vunë thes në kokë dhe e shkelmuan.<sup>866</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses merr parasysh se W03593 dëshmoi se kur e liruan nuk i dhanë arsye apo dokument që vërtetonte lirim, por thjesht i thanë që

---

<sup>862</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 910, rreshtat 7-13 (“[REDAKTUAR]”); **W03593**: T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 613, rreshtat 8-14; **W03594**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1145, rreshtat 11-12; **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333; **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1817, rreshti 4 deri në f. 1818, rreshti 10; **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1865, rreshti 21 deri në f. 1869, rreshtat 15-20.

<sup>863</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 486, rreshti 22 deri në f. 487, rreshti 2; dëshmitari gjatë pyetjeve nga Mbrojtja konfirmoi se kishte qenë [REDAKTUAR] (f. 613, rreshtat 8-14).

<sup>864</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 397, rreshtat 13-22

<sup>865</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 397, rreshti 6.

<sup>866</sup> **W03593**: T. 21 shtator 2021, publik, f. 557, rreshtat 7-9; f. 558, rreshtat 7-10, 16-18.

mund të ikte.<sup>867</sup> Trupi Gjykues vëren se W03593-shit, njësoj si W01679-ës, W03594-ës dhe W04669-ës,<sup>868</sup> nuk i treguan asnjë dokument, dhe ai u ndje i detyruar të bënte atë që i thanë. Trupi Gjykues gjykon se nuk ka të ngjarë që W03593 të ketë dhënë dëshmi të pasaktë apo krejt rastësore lidhur me këtë pikë, pasi të gjithë dëshmitarët dhanë dëshmi konfirmuese ndonëse u arrestuan në vende, periudha dhe nga njësite të ndryshme të UÇK-së.

428. Sa i përket detyrimit për ta nxjerrë personin e ndaluar menjëherë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent dhe detyrimit për t'i dhënë personit të cilit i është hequr liria mundësinë të bëjë ankesë lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të tij, Trupi Gjykues vëren se gjatë kohës që u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, W03593-shin nuk e nxorën para një gjykatësi apo prokurori.<sup>869</sup> Ai gjithashtu dëshmoi se nuk pati kontakt me familjen apo me botën e jashtme.<sup>870</sup> Trupi Gjykues dedukton se, në bazë të dëshmisë së W03593-shit, përfshirë kushtet e arrestimit dhe ndalimit të tij dhe mungesën e kontaktit me persona jashtë kompleksit të ndalimit në Zllash, W03593-shit nuk i dhanë mundësi të bënte ankesë lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të tij.

429. Duke marrë parasysh sa më sipër, domethënë se të gjithë të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u mbajtën në kushte të ngjashme ndalimi dhe se W03593 u keqtrajtua egërsisht gjatë mbajtjes në ndalim, Trupi Gjykues është bindur se W03593-shin nuk e informuan për arsyet e heqjes së lirisë; nuk e nxorën menjëherë para gjykatësit apo autoritetit kompetent; dhe nuk i dhanë mundësi të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

---

<sup>867</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 484, rreshtat 14-24.

<sup>868</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykues në “Mungesa e garancive procedurale” në lidhje me W01679-ën, W03594-ën, dhe W04669-ën.

<sup>869</sup> **W03593**: T. 21 shtator 2021, publik, f. 510, rreshtat 9-11.

<sup>870</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 480, rreshti 22 deri në f. 481, rreshti 1.

#### 4. W03594

##### (f) Arrestimi fillestar

430. W03594 deklaroi se më [REDAKTUAR] prill, në [REDAKTUAR], tre anëtarë të UÇK-së me uniforma i thanë “[REDAKTUAR]”,<sup>871</sup> dhe në atë moment W03594 hipi në një makinë Niva bashkë me ta, duke mos e pasur idenë se ku po shkonin.<sup>872</sup> [REDAKTUAR].<sup>873</sup>

431. Mbrojtja parashtron se ZPS-ja e ndryshoi pretendimin e saj sepse në Dosjen Paraprake ZPS-ja pretendoi se W03594 u arrestua, ndërsa në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, ajo pretendoi se W03594 shkoi vullnetarisht me personat që po e kërkonin.<sup>874</sup>

432. Trupi Gjykues rikujton se, në bazë të neneve 38(4) dhe 39(2) të Ligjit, akuzat përfshihen në Aktakuzën e Konfirmuar, siç paraqiten nga ZPS-ja dhe konfirmohen nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Nga ana tjetër, Dosja Paraprake dhe Dosja Gjyqësore Përfundimtare janë dokumente në të cilat palët kanë mundësi të shtjellojnë më tej provat dhe argumentet e tyre, për t’ia paraqitur njëri-tjetrit dhe Trupit Gjykues. Për rrjedhojë, nëse ZPS-ja e ndryshoi pretendimin nga Dosja Paraprake në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare nuk është relevant për vërtetimin e akuzës së ndalimit arbitrar (Pika 1), sipas së cilës të paktën gjashtë personave iu hoq liria në mënyrë arbitrarë në Zllash, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, sikurse dhe përcaktohet në Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>875</sup> Gjithashtu, nuk është juridikisht thelbësore nëse viktimat shkoi vullnetarisht apo jo me anëtarët e UÇK-së, apo nëse u

---

<sup>871</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1035, rreshti 23 deri në f. 1036, rreshti 2.

<sup>872</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1036, rreshtat 11-13.

<sup>873</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1035, rreshtat 3-5; f. 1036, rreshtat 14-17. [REDAKTUAR].

<sup>874</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4713, rreshtat 21-25.

<sup>875</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 18.

arrestua sipas kuptimit të saktë të fjalës, përderisa më pas u mbajt në mënyrë arbitrare në kompleksin e ndalimit në Zllash.

433. Në lidhjen me datën e arrestimit fillestar të W03594-ës, Trupi Gjykses konstaton mospërputhje të vogël prej 24 orësh midis dëshmisë së dëshmitarit në sallën e gjyqit dhe Listës së të Burgosurve, [REDAKTUAR].<sup>876</sup> Trupi Gjykses është i mendimit që kjo mospërputhje e vogël nuk ka ndikim në besueshmërinë e dëshmitarit lidhur me këtë pikë, pasi për shkak të kohës që ka kaluar dëshmitarit mund t'i jetë zbehur kujtesa lidhur me këtë hollësi konkrete. Provat e shumta (konfirmuese) dhe përputhëse gojore dhe dokumentare që tregojnë se W03594-ës iu hoq liria në kompleksin e ndalimit në Zllash, janë aq të mjaftueshme sa e bëjnë këtë mospërputhje të parëndësishme në kuadrin e shqyrtimit tërësor të provave. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses përsërit se duke qenë se është bindur se W03594-ës iu hoq liria brenda periudhës kohore të akuzave, data e saktë kur e çuan në kompleksin e ndalimit në Zllash është e parëndësishme.

434. Duke marrë parasysh provat në tërësi, Trupi Gjykses është bindur se W03594-ës iu hoq liria më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR], pra, brenda kuadrit kohor të akuzave.

(g) Vendi i ndalimit

435. Trupi Gjykses vëren se, sipas dëshmitarit, pas transferimit në Zllash e dorëzuan te dy persona të tjerë me maska, të cilët e çuan dëshmitarin në një ahur kafshësh,<sup>877</sup> dhe kjo dëshmi përputhet me atë të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës. Është e rëndësishme të theksohet se Trupi Gjykses konstaton se prania e W03594-ës në ahur

---

<sup>876</sup> U001-0310-U001-0325, f. U001-0310. *Shih gjithashtu W03594*: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1032, rreshtat 12-16.

<sup>877</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1037, rreshtat 16-23.



konfirmohet edhe nga W01679 dhe W03593.<sup>878</sup> Ashtu siç deklaroi W01679, edhe W03594 dëshmoi se të ndaluarve nuk u lejohej të dilnin jashtë ahurit apo të largoheshin sipas dëshirës.<sup>879</sup>

436. Më pas dëshmitari konfirmoi deklaratën e tij të mëparshme për ZPS-në, sipas së cilës, kur ishte në Zllash e çuan në një zyrë lart ku e morën në pyetje persona të paidentifikuar, [REDAKTUAR].<sup>880</sup> Personat e pranishëm në dhomë, që ishin veshur me uniforma, ia pranuan haptazi dëshmitarit se “Është bërë një gabim, shumë shpejt do të lirohesh”,<sup>881</sup> duke konfirmuar kështu, në vlerësimin e Trupit Gjykues, se në fakt në atë kohë W03594-ës i ishte hequr liria. Duke mbajtur parasysh se heqja e lirisë vërtetohet më tej edhe nga Lista e të Burgosurve dhe se W03594 identifikoi disa të ndaluar të tjerë, Trupi Gjykues konstaton se dëshmitari është i besueshëm në dëshminë e vet kur thotë se anëtarë të UÇK-së e mbajtën të ndaluar në ahur, në kompleksin e ndalimit në Zllash.

437. Duke pasur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykues është bindur se W03594 u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash.

#### (h) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

438. Trupi Gjykues vëren se W03594 deklaroi se e mbajtën në të njëjtën dhomë me katër persona të tjerë,<sup>882</sup> dy prej të cilëve W03594 ua kujton emrin: [REDAKTUAR],<sup>883</sup>

---

<sup>878</sup> *Shih* para. 394, 417.

<sup>879</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1044, rreshtat 18-22.

<sup>880</sup> 061016-TR-ET, Part (Pjesa) 2, f. 8, rreshtat 7-14; **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1082, rreshti 23 deri në f. 1083, rreshti 7.

<sup>881</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1084, rreshtat 14-21.

<sup>882</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1040, rreshtat 3-4.

<sup>883</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1046, rreshtat 18-24; f. 1047, rreshti 19 deri në f. 1050, rreshti 23; 061016-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 21, rreshtat 17-21; f. 22, rreshtat 6-8. Dëshmitari më pas e identifikoi [REDAKTUAR] (W03593) (**W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1048, rreshtat 4-19; *shih gjithashtu* f. 1079, rreshtat 2-13).

dhe një tjetër që dëshmitari e identifikoi si [REDAKTUAR].<sup>884</sup> W03594 shtoi se rreth 7-8 ditë pasi e kishin çuar atje, sollën dhe një person tjetër,<sup>885</sup> dhe u bënë gjashtë persona gjithsej në të njëjtën dhomë.<sup>886</sup> Trupi Gjykses konstaton se identifikimi i këtyre dëshmitarëve nga W03594 është në përputhje me dëshmitë e W01679-ës dhe W03593-shit, e për rrjedhojë konfirmojnë njëra-tjetrën<sup>887</sup> duke i bërë kështu më të besueshme dëshmitë e tyre, pasi nuk do të ishte realiste të dilej në përfundimin se ata të gjithë trilluan dëshmi lidhur me praninë e njëri-tjetrit në të njëjtën dhomë ndalimi dhe në të njëjtën periudhë.

439. Duke pasur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se W03594 u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash së bashku me të ndaluarit e lartpërmendur.

(i) Rrethanat e ndalimit

440. Trupi Gjykses vëren se W03594 deklaroi se e mbajtën në Zllash deri më 19 prill,<sup>888</sup> që përputhet me periudhën kohore të lirimit të W01679-ës dhe W03593-shit. Meqë provat tregojnë se këta të ndaluar u mbajtën së bashku në kompleksin e ndalimit në Zllash, Trupi Gjykses e vlerëson në përgjithësi të besueshëm përshkrimin e W03594-ës lidhur me kohën e lirimit. Gjithashtu, lirimi i W03594-ës më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, konfirmohet [REDAKTUAR].<sup>889</sup>

441. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se W03594 u lirua më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, së bashku me të ndaluarit e tjerë.

---

<sup>884</sup> **W03594:** T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1187, rreshtat 7-10.

<sup>885</sup> **W03594:** T. 12 tetor 2021, publik, f. 1046, rreshtat 10-13.

<sup>886</sup> **W03594:** T. 13 tetor 2021, publik, f. 1186, rreshtat 7-9.

<sup>887</sup> *Shih* para. 394-401, 417-418.

<sup>888</sup> **W03594:** T. 12 tetor 2021, publik, f. 1040, rreshtat 19-21.

<sup>889</sup> [REDAKTUAR].

## (j) Mungesa e garancive procedurale

442. Sa i përket detyrimit për të informuar personin që i hiqet liria mbi arsyet për heqjen e lirisë— në mënyrë përputhëse me dëshmitë e W01679-ës dhe W03593-shit — edhe W03594 deklaroi se nuk i dhanë arsye apo bazë për heqjen e lirisë.<sup>890</sup> Meqë dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, të marra së bashku, vërtetojnë praktikën se të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash nuk iu akorduan garancitë procedurale bazë, atëherë Trupi Gjykses e gjykon dëshminë e W03594-ës të besueshme dhe për rrjedhojë mbështetet në dëshminë e tij.

443. Më tej, në lidhje me të ndaluarit e tjerë Trupi Gjykses ka konstatuar se ata nuk u nxorën para një gjykatësi ose prokurori dhe nuk patën mundësi të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre.<sup>891</sup> Gjithashtu, në lidhje me Pikat 2 dhe 3 të Aktakuzës së Konfirmuar, Trupi Gjykses ka konstatuar se W03594 u keqtrajtua rëndë gjatë kohës që u mbajt i ndaluar në Zllash.<sup>892</sup> Duke mbajtur parasysh se të gjithë të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u mbajtën në kushte të ngjashme ndalimi dhe se W03594 u keqtrajtua rëndë gjatë kohës që u mbajt i ndaluar, Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në provat në tërësi, është se ai nuk u nxor para një gjykatësi apo autoriteti kompetent, as nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

444. Mbështetur në sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se W03594 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë; nuk u nxor menjëherë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent; dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

---

<sup>890</sup> **W03594:** T. 12 tetor 2021, publik, f. 1076, rreshtat 1-4; T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1211, rreshtat 14-21.

<sup>891</sup> *Shih* para. 409, 428 dhe 483.

<sup>892</sup> *Shih* para. 557-566.

## 5. W04669

### (k) Arrestimi fillestar

445. Në lidhje me arrestimin fillestar, W04669 dëshmoi se kur ishte rrugës për në Zllash e ndaluan në fshatin [REDAKTUAR] disa roja në një postbllok.<sup>893</sup> Sipas dëshmitarit, rojat më pas kontaktuan [REDAKTUAR].<sup>894</sup> Gjatë dëshmisë në sallën e gjyqit, W04669 identifikoi [REDAKTUAR].<sup>895</sup> [REDAKTUAR],<sup>896</sup> Trupi Gjykses konstaton se W04669-ën e ndaloi një njësit i UÇK-së. W04669 dëshmoi më tej se [REDAKTUAR] i tha të hipte në makinë, se kishte një kallashnikov në makinë dhe i tha: “tash [...] të tregoj” dhe më pas e çoi në Zllash.<sup>897</sup>

446. Sa i takon datës së arrestimit fillestar, W04669 nuk ishte në gjendje të jepte periudhën e saktë kohore. Sidoqoftë, Trupi Gjykses merr parasysh se W04669 dha pa iu kërkuar edhe hollësi të tjera shpjeguese sa herë që përpiquej të jepte periudhën kohore të heqjes së lirisë. Konkretisht ai dëshmoi: (i) se i hoqën lirinë “më tepër se tri katër ditë, një javë”;<sup>898</sup> (ii) se e morën në pyetje dhe e keqtrajtuat “ditën e [...] dytëntretën [të ndalimit]”;<sup>899</sup> (iii) se dy ose tri ditë më pas e liruan;<sup>900</sup> dhe (iv) se kur ofensiva serbe arriti në fshatin e W04669-ës ([REDAKTUAR]),<sup>901</sup> ai kishte tri a katër ditë që

---

<sup>893</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1410, rreshtat 14-24.

<sup>894</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1410, rreshti 25 deri në f. 1411, rreshti 1.

<sup>895</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1412, rreshti 13. [REDAKTUAR].

<sup>896</sup> [REDAKTUAR].

<sup>897</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1411, rreshtat 10-15.

<sup>898</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1449, rreshtat 8-9. Dëshmitari shtoi “kjo është minimumi edhe maksimumi e thashë sa kena mujt me qëndrue [...] unë personalisht, po flas për veten” (**W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1449, rreshtat 10-12).

<sup>899</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1449, rreshtat 15-19. Dëshmitari shtoi se ishte “Diku ka mesi i ditëve maksimale ka qenë” (**W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1449, rreshtat 19-22).

<sup>900</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1450, rreshtat 8-9. Dëshmitari shpjegoi më tej se “Para meje kanë lirie një person tjetër. Atë që përmenda më herët atë të gjatin që qe. Edhe pas meje ka mbetë ai më i vjetri. Kur e kanë liru atë nuk e di” (**W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1450, rreshtat 10-12).

<sup>901</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1390, rreshti 6.

ishte liruar.<sup>902</sup> Duke marrë parasysh se provat tregojnë se ofensiva serbe kundër fshatrave në zonën e Gollakut ndodhi afërsisht midis 16 prillit dhe 22 prillit 1999,<sup>903</sup> Trupi Gjykses vlerëson se W04669-ës iu hoq liria disa ditë para mesit të prillit 1999.

447. Trupi Gjykses vëren më tej se W04669 dha hollësi konkrete dhe unike për transferimin e tij nga [REDAKTUAR] drejt kompleksit të ndalimit në Zllash. Konkretisht, W04669 dëshmoi se [REDAKTUAR], dhe se mbante uniformë ushtarake dhe kishte kallashnikov.<sup>904</sup> Në atë moment, sipas W04669-ës, [REDAKTUAR] e pyeti dëshmitarin [REDAKTUAR].<sup>905</sup> W04669 shtoi se “edhe [[REDAKTUAR]] më ka dërguar në Zllash. Unë as që e kam menduar që ka ndonjë vendndalim atje”.<sup>906</sup> Trupi Gjykses gjykon se këto hollësi kaq konkrete, të shprehura nga dëshmitari në mënyrë të qartë dhe të saktë, mund të burojnë vetëm nga kujtimet personale të W04669-ës lidhur me ngjarjet, të cilat Trupi Gjykses i vlerëson si të paraqitura me vërtetësi. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se [REDAKTUAR].<sup>907</sup> Në vlerësimin e Trupit Gjykses, kjo hollësi konfirmon se një nga detyrat e [REDAKTUAR] ishte transferimi i personave që u ishte hequr liria për në kompleksin e ndalimit në Zllash, duke konfirmuar kështu që W04669-ën në fakt e çuan atje.

448. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se W04669-ës i hoqën lirinë disa ditë para mesit të prillit 1999, pra brenda kuadrit kohor të akuzave.

---

<sup>902</sup> **W04669:** T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1457, rreshti 21 deri në f. 1458, rreshti 1. Dëshmitari shtoi një sërë hollësish lidhur me ofensivën që po afrohej, që e pa me sytë e tij [REDAKTUAR], përfshirë faktin që dalloj forcat serbe nga shqiponja e bardhë në krah, se e qëlluan me armë zjarri dhe se në shtëpinë e tij kishte pasur një fluks të madh njerëzish që përpiqeshin të shkonin në Prishtinë (**W04669:** T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1458, rreshti 1 deri në f. 1459, rreshti 22).

<sup>903</sup> *Shih* para. 625-628.

<sup>904</sup> **W04669:** T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1411, rreshtat 3-13. [REDAKTUAR].

<sup>905</sup> [REDAKTUAR].

<sup>906</sup> **W04669:** T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1411, rreshtat 15-16.

<sup>907</sup> *Shih* para. 445-447.

## (l) Vendi i ndalimit

449. Dëshmitari deklaroi se kur mbërriti në vendin e ndalimit, e dorëzuan te një roje që e çoi në ahur.<sup>908</sup> Në përputhje me dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W03594-ës, W04669 tha se ahuri ku e mbajtën dukej si stallë me mure të bëra me dru, kashtë e baltë, me disa të çara përmes së cilave mund të shihej jashtë; tha se ishte shumë errësirë brenda dhe mund të kishte pasur një dritare por që ishte mbyllur dhe nuk hynte dritë.<sup>909</sup> W04669 shtoi më tej se stalla ishte e kyçur dhe hyrja ruhej me roje,<sup>910</sup> çka konfirmon dëshminë gojore të W01679-ës dhe W03593-shit si dhe lidhet me dëshminë e W03594-ës, sipas të cilit të ndaluarit nuk mund të dilnin nga ahuri ku ishin burgosur.<sup>911</sup> Në mënyrë përputhëse me dëshminë e W01679-ës dhe W03593-shit, W04669 identifikoi bllokun e ndërtesave në kompleksin e ndalimit në Zllash ku e mbajtën.<sup>912</sup> W04669 përshkroi “Po ishin nja 2 a 3 afër njëra-tjetrës, shumë afër gati të kapura me njëra tjetrën”.<sup>913</sup> Trupi Gjykses përsërit se përcaktimi i ndërtesës konkrete ku u mbajt secili prej të ndaluarve nuk është me rëndësi, duke qenë se Trupi Gjykses është bindur se viktimat u mbajtën në një grup ndërtesash të identifikuara si pjesë e kompleksit të ndalimit në Zllash.

450. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se W04669 u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash.

---

<sup>908</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1411, rreshti 21 deri në f. 1412, rreshti 1.

<sup>909</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1430, rreshtat 4-19; T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1532, rreshtat 13-22.

<sup>910</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1468, rreshtat 17-19.

<sup>911</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1044, rreshtat 18-22.

<sup>912</sup> *Shih* para. 357. **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1470, rreshti 24 deri në f. 1472, rreshti 6; 082020-082023, f. 082022 (W04669 identifikoi ndërtesën e parë në të majtë të fotografisë).

<sup>913</sup> **W04669**: T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1543, rreshtat 1-2.

## (m) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

451. W04669 dëshmoi se pa dy persona të tjerë të panjohur në ahur. [REDAKTUAR].<sup>914</sup> Trupi Gjykses vëren se W04669 në sallën e gjyqit identifikoi qartësisht se viktimën e vrasjes së paligjshme ishte i pranishëm, në dy momente të ndryshme, në të njëjtën stallë me dëshmitarin, ndonëse ai (viktimën e vrasjes së paligjshme) nuk u mbajt atje shumë gjatë.<sup>915</sup> W04669 specifikoi se viktimën e vrasjes së paligjshme i kishte duart të lidhura me tel,<sup>916</sup> që është një hollësi e veçantë e konfirmuar edhe nga W01679 dhe W03593.<sup>917</sup> W04669 gjithashtu deklaroi dy herë në sallën e gjyqit, se viktimën e vrasjes së paligjshme mbahej atje pasi [REDAKTUAR],<sup>918</sup> një tjetër hollësi e veçantë kjo që konfirmohet si nga W01679<sup>919</sup> dhe W04674.<sup>920</sup> Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar më parë se W01679, W03593 dhe W03594 u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash në të njëjtën kohë me viktimën e vrasjes së paligjshme, brenda kuadrit kohor të akuzave dhe se e identifikuan këtë të fundit si një nga të ndaluarit e tjerë.<sup>921</sup> Trupi Gjykses ka konstatuar më tej se edhe W04669 u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash brenda periudhës kohore të akuzave.<sup>922</sup> Duke mbajtur parasysh se edhe W04669 e identifikoi viktimën e vrasjes së paligjshme si një nga të ndaluarit e tjerë - duke përshkruar edhe hollësi të konfirmuara nga dëshmitarë të tjerë - Trupi Gjykses konstaton se W04669 u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash në periudha përkuese me W01679-ën, W03593-shin, W03594-ën dhe viktimën e vrasjes së paligjshme. Nga ky këndvështrim, periudha e

---

<sup>914</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1417, rreshtat 21-22; f. 1418, rreshti 20.

<sup>915</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, f. 1440, rreshtat 3-24.

<sup>916</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1431, rreshti 21 deri në f. 1432, rreshti 3; f. 1441, rreshtat 14-20; T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1434, rreshtat 5-6; f. 1440, rreshtat 1-21;

<sup>917</sup> *Shih* para 399, 569.

<sup>918</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1438, rreshtat 7-17; T. 11 nëntor 2021, konfidencial, f. 1564, rreshtat 19-23.

<sup>919</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 892, rreshti 25 deri në f. 893, rreshti 5.

<sup>920</sup> **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1978, rreshtat 12-20;

<sup>921</sup> *Shih* para. 394, 399, 417, 438.

<sup>922</sup> *Shih* para. 449-450.



pasaktë kohore lidhur me heqjen e lirisë së tij është e parëndësishme, sepse identifikimi i viktimës së vrasjes së paligjshme nga W01679, W03593, W03594 dhe W04669 demonstroi se, edhe W04669 u mbajt i ndaluar në të njëjtin grup ndërtesash të identifikuar në kompleksin e ndalimit në Zllash brenda kuadrit kohor të Aktakuzës së Konfirmuar. Nuk mund të hamendësohet se të gjithë këta dëshmitarë kanë trilluar të njëjtat dëshmi konfirmuese, përfshirë hollësitë për të ndaluarit, ose se kanë dhënë dëshmi krejt rastësore për këto aspekte.

452. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjyqësor është bindur se W04669 u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash sikurse dhe W01679, W03593, W03594, dhe viktima e vrasjes së paligjshme.

(n) Rrethanat e lirimit

453. Trupi Gjyqësor rikujton se ka konstatuar që W04669-ës iu hoq liria disa ditë para mesit të prillit 1999 dhe W04669 dëshmoi në sallën e gjyqit se u lirua disa ditë para se forcat serbe të hynin në fshatin e tij.<sup>923</sup> Duke mbajtur parasysh se dëshmitari dëshmoi që u mbajt nga katër ditë deri në një javë, Trupi Gjyqësor vlerëson se ai u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash afërsisht deri në mes të prillit 1999. Sidoqoftë, Trupi Gjyqësor thekson se data e saktë e lirimit (apo qoftë e arrestimit fillestar) nuk është juridikisht thelbësore për vërtetimin e akuzave, me kusht që Trupi Gjyqësor të jetë bindur se datat përfshihen në kuadrin kohor të Aktakuzës së Konfirmuar, siç edhe është rasti për W04669-en.

454. Trupi Gjyqësor vlerëson se duke përdorur ofensivën serbe kundër fshatit të tij si pikë referimi, dhe duke llogaritur periudhën e mundshme kohore të lirimit të tij bazuar në këtë ngjarje, W04669 demonstroi aftësinë e tij për të përshkruar me vërtetësi rrethanat e lirimit të tij, ndonëse nuk i kujtohej me saktësi periudha kohore.

---

<sup>923</sup> W04669: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1457, rreshti 24.

455. Në lidhje me sa sipër, Trupi Gjykses nuk ka arsye për të vënë në dyshim vërtetësinë e deklaratës së W04669-ës lidhur me lirimin e tij. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses është bindur se W04669 u lirua afërsisht në mes të prillit 1999, brenda kuadrit kohor të akuzave.

(o) Mungesa e garancive procedurale

456. Sa i takon detyrimin për ta informuar personin që i është hequr liria mbi arsyet e heqjes së lirisë, dëshmitari deklaroi se gjatë transferimit për në Zllash, [REDAKTUAR], i cili mbante veshur uniformë ushtarake dhe kallashnikov,<sup>924</sup> nuk i tregoi W04669-ës pse po e merrnin.<sup>925</sup> Ndonëse W04669 dëshmoi se nuk u ndje i kërcënuar në ato momente, Trupi Gjykses vëren se kur mbërriti në Zllash, dëshmitarin e dorëzuan te një rojë.<sup>926</sup> Kjo përputhet me provat e tjera që ka Trupi Gjykses, sipas të cilave të ndaluarit u ndaluan pa iu dhënë ndonjë arsye apo dokument konkret.<sup>927</sup> Po ashtu, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitarit nuk i dhanë asnjë dokument që vërteton se u mbajt i ndaluar, as gjatë kohës në kompleksin e ndalimit në Zllash, as pas lirimit.<sup>928</sup> Kjo përputhet përsëri me mosdhënien e informacionit, shkaqeve dhe arsyeve për heqjen e lirisë që përjetuan W01679, W03593 dhe W03594. Rrjedhimisht, në kuadër të dëshmive konfirmuese që vërtetojnë mosakordimin e garancive procedurale për të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e W04669-ës në lidhje me këtë pikë është e besueshme.

457. Më tej, lidhur me të ndaluarit e tjerë Trupi Gjykses ka konstatuar se nuk u nxorën para një gjykatësi apo prokurori dhe nuk patën mundësi të kundërshtonin

---

<sup>924</sup> *Shih* para. 447.

<sup>925</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1414, rreshti 25 deri në f. 1415, rreshti 15.

<sup>926</sup> *Shih* para. 449.

<sup>927</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses në “Mungesa e garancive procedurale” në lidhje me W01679-ën, W03593-shin, dhe W03594-ën.

<sup>928</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1456, rreshtat 17-25.

ligjshmërinë e ndalimit të tyre.<sup>929</sup> W04669 dëshmoi se nuk pati kontakt me familjen apo me botën e jashtme.<sup>930</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykues vërtetoi në lidhje me Pikat 2 dhe 3 në Aktakuzën e Konfirmuar se, W04669 u keqtrajtua rëndë gjatë kohës që mbahej i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, sepse pretendohet se bashkëpunonte me serbët dhe ishte spiun dhe gënjeshtar.<sup>931</sup> Duke mbajtur parasysh se të gjithë të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u mbajtën në kushte të ngjashme ndalimi, se W04669 nuk pati kontakt me askënd jashtë kompleksit të ndalimit në Zllash dhe se u keqtrajtua rëndë gjatë kohës që u mbajt i ndaluar, Trupi Gjykues konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në provat në tërësi, është se W04669-ën nuk e nxorën para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent, as nuk i dhanë mundësi të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

458. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykues është bindur se W04669 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë; nuk u nxor menjëherë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent; dhe nuk iu dha mundësia të bënte ankesë lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të tij.

## 6. Viktima e vrasjes së paligjshme

### (p) Arrestimi fillestar

459. Trupi Gjykues vëren se [REDAKTUAR] dhanë dëshmi [REDAKTUAR] konfirmuese lidhur me arrestimin dhe transferimin e mëpasshëm të viktimës së vrasjes së paligjshme në kompleksin e ndalimit në Zllash, [REDAKTUAR],<sup>932</sup>

---

<sup>929</sup> *Shih* para. 409, 428, 444, 483.

<sup>930</sup> **W04469**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1467, rreshti 12 deri në f. 1468, rreshti 6.

<sup>931</sup> *Shih* para. 567-568.

<sup>932</sup> [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR],<sup>933</sup> [REDAKTUAR].<sup>934</sup> Kjo dëshmi u konfirmua dhe specifikua, në pjesët përkatëse, [REDAKTUAR],<sup>935</sup> [REDAKTUAR];<sup>936</sup> [REDAKTUAR].<sup>937</sup>

460. W04391 konfirmoi dëshminë [REDAKTUAR] për ekzistencën e një urdhri për arrestimin e viktimës së vrasjes së paligjshme. W04391 dëshmoi se kur takoi [REDAKTUAR] “për ta kërkuar [REDAKTUAR]”, dhe “i kam kërkuar fletë-arrestin”, [REDAKTUAR] iu përgjigj se “ishte urdhër”.<sup>938</sup> [REDAKTUAR],<sup>939</sup> [REDAKTUAR].

461. Më tej, Trupi Gjykes vlerëson se dëshmia e dhënë nga disa [REDAKTUAR] konfirmon rrethanat lidhur me arrestimin fillestar të viktimës së vrasjes së paligjshme, përshkruar [REDAKTUAR]. Po kështu, Trupi Gjykes vëren se W04391 dha dëshmi të drejtpërdrejtë ku identifikoi [REDAKTUAR], duke dhënë hollësi unike — të cilat W04391 i konfirmoi gjatë pyetjeve nga pala tjetër. Më konkretisht, ai tha se [REDAKTUAR].<sup>940</sup> Këto hollësi unike e bëjnë edhe më të besueshme dëshminë e tij. Gjithashtu, W04390 dha dëshmi të dorës së dytë që konfirmon dëshminë e W04391-shit, pasi ajo mësoi rrethanat e arrestimit të viktimës së vrasjes së paligjshme nga [REDAKTUAR].<sup>941</sup>

462. Duke mbajtur parasysh dëshmitë e shumta konfirmuese, [REDAKTUAR], Trupi Gjykes nuk ka dyshim mbi besueshmërinë dhe saktësinë e përshkrimeve të përgjithshme të tyre në lidhje me këtë pikë. Veçanërisht, Trupi Gjykes thekson se [REDAKTUAR] dëshmi të qarta dhe përputhëse me gjithë karakterin tejet inkriminues të këtij informacioni, çka forcon besueshmërinë e tyre.

---

<sup>933</sup> [REDAKTUAR].

<sup>934</sup> [REDAKTUAR].

<sup>935</sup> [REDAKTUAR].

<sup>936</sup> [REDAKTUAR].

<sup>937</sup> [REDAKTUAR].

<sup>938</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1737, rreshtat 10-22.

<sup>939</sup> [REDAKTUAR].

<sup>940</sup> [REDAKTUAR].

<sup>941</sup> **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1861, rreshti 6 deri në f. 1865, rreshti 17.

463. [REDAKTUAR].<sup>942</sup> Sidoqoftë, lidhur me këtë pikë Trupi Gjykses vëren se këto dëshmi bien ndesh me dëshminë e [REDAKTUAR].<sup>943</sup> [REDAKTUAR].<sup>944</sup> Sidoqoftë, rrethanat e përshkruara nga [REDAKTUAR] përputhen kryesisht me praktikën e arrestimeve që përshkruan dëshmitarët e tjerë, të cilët u përballën me anëtarë të armatosur të UÇK-së dhe u ndjenë të detyruar t'u bindeshin.

464. Megjithatë, Trupi Gjykses në fund nuk i jep shumë peshë kësaj mospërputhjeje, sepse ajo nuk ka lidhje me akuzën e ndalimit arbitrar në Pikën 1 të Aktakuzës së Konfirmuar, që ndodhi në kompleksin e ndalimit në Zllash. Më tej, në mënyrë të ngjashme me rrethanat e [REDAKTUAR], fakti që një person mund të mos ketë bërë rezistencë kur e ndaluan, nuk e ndryshon faktin se ai më pas u mbajt i ndaluar në mënyrë arbitrar, duke marrë parasysh kushtet në të cilat u mbajtën të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash, d.m.th të kyçur në ahur, nën rojë, dhe pa disa ose asnjë prej garancive procedurale që duhet të gëzojnë të ndaluarit. Gjithashtu, [REDAKTUAR], nuk ndryshon rrjedhën e ngjarjeve që sollën transferimin e tij të mëpasshëm në kompleksin e ndalimit në Zllash, e cila mbetet e qartë dhe përputhëse në kuadër të tërësisë së dëshmive nga [REDAKTUAR], siç diskutohet më poshtë.

465. Ndonëse Trupi Gjykses merr parasysh se [REDAKTUAR] nuk ishte në gjendje të jepte datën e saktë [REDAKTUAR], ai deklaroi me bindje në sallën e gjyqit se ka qenë prilli 1999,<sup>945</sup> çka u konfirmua [REDAKTUAR].<sup>946</sup> Në lidhje me këtë pikë, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia [REDAKTUAR] përputhet me dëshmitë e të ndaluarve të tjerë, të cilët, kur u burgosën në kompleksin e ndalimit në Zllash në [REDAKTUAR] prillit 1999, e gjetën viktimën e vrasjes së paligjshme që ishte tashmë i ndaluar në atë

---

<sup>942</sup> [REDAKTUAR].

<sup>943</sup> [REDAKTUAR].

<sup>944</sup> [REDAKTUAR].

<sup>945</sup> [REDAKTUAR].

<sup>946</sup> [REDAKTUAR].

vend.<sup>947</sup> Po ashtu këto dëshmi gojore konfirmohen edhe nga Lista e të Burgosurve, ku është shënuar emri, data dhe vendi i lindjes së viktimës së vrasjes së paligjshme dhe se ai u arrestua më [REDAKTUAR] prill 1999.<sup>948</sup> Trupi Gjykues vëren se e njëjta datë ([REDAKTUAR] prill 1999) raportohet edhe në një [REDAKTUAR] lidhur me arrestimin, mbajtjen në ndalim dhe vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme,<sup>949</sup> [REDAKTUAR].

466. Trupi Gjykues vëren se e vetmja dëshmi kundërshtuese është dëshmia e dorës së tretë që dha W04390, që deklaroi se viktimën e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], përpara se ta transferonin në Zllash.<sup>950</sup> Gjithashtu, në një nga deklaratat e tij, W04648 deklaroi se viktimën e vrasjes së paligjshme e morën më [REDAKTUAR] prill 1999.<sup>951</sup> Megjithatë, meqë sipas W04390-s ky informacion iu dha W04648-ës nga persona të tretë të cilët më pas ia përcollën W04390-s, Trupi Gjykues gjykon se vlera provuese e kësaj dëshmie është tepër e ulët, veçanërisht pasi nuk mund të verifikohet me burimet fillestare apo [REDAKTUAR]. Trupi Gjykues vëren se në një deklaratë tjetër, W04648 deklaroi se arrestimi i viktimës së vrasjes së paligjshme u krye më [REDAKTUAR] prill 1999, që përputhet me dëshmitë konfirmuese. Rrjedhimisht, kjo mospërputhje në dëshminë e W04648-ës mund të jetë thjesht një gabim dhe nuk ka ndikim në periudhën kohore të heqjes së lirisë së viktimës së vrasjes së paligjshme, e cila përfshihet në periudhën kohore të akuzave dhe nuk e ndryshon rrjedhën e ngjarjeve dhe faktin që të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash e identifikuan njëri-tjetrin.

---

<sup>947</sup> *Shih* para. 394, 399, 417,438 dhe 451.

<sup>948</sup> U001-0310-U001-0325, f. U001-0310.

<sup>949</sup> SITF00318201-00318202, f. SITF00318201.

<sup>950</sup> **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1888, rreshti 19 deri në f. 1889, rreshti 14.

<sup>951</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

467. Duke pasur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se viktimës së vrasjes së paligjshme iu hoq liria më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR], brenda kuadrit kohor të akuzave.

(q) Vendi i ndalimit

468. Në lidhje me vendin e mbajtjes në ndalim të viktimës së vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR].<sup>952</sup> [REDAKTUAR].<sup>953</sup> [REDAKTUAR].<sup>954</sup>

469. Lidhur me këtë pikë, Mbrojtja ngre kundërshtimin se [REDAKTUAR] nga porta e kompleksit të ndalimit në Zllash, sepse një ndërtesë tjetër – ndërtesa nr. 7 (siç e shënoi dhe z. Krasniqi bazuar në Broshurën e Fotografive nga Ajri të UNMIK-ut) – ishte pa dyshim në mes.<sup>955</sup>

470. ZPS-ja përgjigjet se versioni i paraqitur nga Mbrojtja është hamendësues, shtrembërues dhe i paplotë. ZPS-ja parashtron se [REDAKTUAR] kishte fushëpamje të qartë të [REDAKTUAR]. Dëshmia e tij në lidhje me këtë pikë është e qartë, e besueshme dhe e konfirmuar në masë të konsiderueshme. ZPS-ja shton se Mbrojtja nuk kundërshtoi dëshminë [REDAKTUAR] lidhur me këtë pikë.<sup>956</sup>

471. Mbrojtja kundërpërgjigjet se versioni i paraqitur prej saj nuk është hamendësues, por thjesht pasqyron deklaratat [REDAKTUAR]; dhe nuk është relevante nëse Mbrojtja e kundërshtoi ose nuk e kundërshtoi dëshminë [REDAKTUAR] lidhur me këtë pikë.<sup>957</sup>

472. Trupi Gjykses vëren se [REDAKTUAR].<sup>958</sup> Duke mbajtur parasysh dëshminë [REDAKTUAR], dhe duke krahasuar fotografitë nga Broshura e Fotografive nga Ajri

---

<sup>952</sup> [REDAKTUAR].

<sup>953</sup> [REDAKTUAR].

<sup>954</sup> [REDAKTUAR].

<sup>955</sup> [REDAKTUAR].

<sup>956</sup> [REDAKTUAR].

<sup>957</sup> [REDAKTUAR].

<sup>958</sup> [REDAKTUAR].



me ato të Broshurës së Fotografive nga Terreni të UNMIK-ut, Trupi Gjykues konstaton se [REDAKTUAR] ishte plotësisht në gjendje të kishte fushëpamje të plotë të kompleksit të ndalimit në Zllash dhe të personave që mund të qëndronin në këmbë në cilëndo prej këtyre ndërtesave. Ky përfundim konfirmohet edhe nga përshkrimi që i bën [REDAKTUAR] shtëpisë [REDAKTUAR] më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR], që është shumë i ngjashëm me përshkrimin që i bëri [REDAKTUAR] shtëpisë ku qëndronte në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>959</sup> Trupi Gjykues është i mendimit se përshkrimi [REDAKTUAR] më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR] ishte i besueshëm, sepse ai nuk kishte arsye ta ndërlikonte dëshminë e tij me shpjegimet se [REDAKTUAR] dhe me shënimet që bëri në skica për të sqaruar [REDAKTUAR]. Duke dhënë këto sqarime, [REDAKTUAR] demonstroi se kujtesa e tij për këtë ngjarje konkrete bazohet në njohurinë e tij personale.

473. Rrjedhimisht, kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me këtë pikë hidhet poshtë dhe Trupi Gjykues është bindur se i akuzuari ishte i pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR].

474. Në përgjithësi, Trupi Gjykues e vlerëson të besueshme dëshminë e [REDAKTUAR]. Në fakt, Trupi Gjykues rikujton se [REDAKTUAR] duke parë fotografitë dalloi si hyrjen e kompleksit të ndalimit në Zllash [REDAKTUAR], ashtu edhe bllokun e ndërtesave që ishin atje, të cilat edhe dëshmitarët e tjerë i identifikuan si vendi ku u mbajtën të ndaluar.<sup>960</sup> Vërtetësia e dëshmisë së [REDAKTUAR] lidhur me [REDAKTUAR] konfirmohet nga vetë fakti se, sikurse u vërtetua nga Trupi Gjykues, W01679, W03593, W03594, dhe W04669 u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtin grup ndërtesash të identifikuar, me viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>961</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykues

---

<sup>959</sup> [REDAKTUAR]; *shih* krahasimin me **z. Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 8, f. 3, rreshti 3 deri në f. 4, rreshti 5 dhe [REDAKTUAR] (skica e shtëpisë që bëri [REDAKTUAR]).

<sup>960</sup> *Shih* para. 364.

<sup>961</sup> *Shih* para. 379-458.

vlerëson se vendi i ndalimit të viktimës së vrasjes së paligjshme konfirmohet edhe më tej nga dëshmitë [REDAKTUAR]. Në fakt, W04391, W04648 dhe W04674 dëshmuan se, pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s, ata e gjetën ahurin në Zllash ku besonin se ishte mbajtur viktimë e vrasjes së paligjshme dhe aty gjetën [REDAKTUAR].<sup>962</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se W04391 deklaroi se kati i sipërm i ndërtesës – poshtë të cilit ishte ahuri – ishte shembur.<sup>963</sup> Ky fakt konfirmohet nga fotografitë që u treguan në sallën e gjyqit gjatë dëshmisë së z. Krasniqi, ku ai shpjegoi se konkretisht ajo ndërtesë ishte goditur nga granatimet e tankeve serbe gjatë kohës së ofensivës në gjysmën e dytë të prillit 1999.<sup>964</sup> Bazuar në Broshurën e Fotografive nga Terreni të UNMIK-ut,<sup>965</sup> W04674 identifikoi bllokun e ndërtesave, përfshirë bodrumin, “që kanë ndejtur të burgosurit dhe në katin naltë kanë ndejtur ushtarët”.<sup>966</sup> Trupi Gjykses konstaton se blloku i ndërtesave i identifikuar nga dëshmitari si vendi i ndalimit të viktimës së vrasjes së paligjshme është saktësisht i njëjti vend i identifikuar nga W01679, W03593, dhe W04669 si vendi ku u mbajtën të ndaluar. Kjo përforcon më tej konstatimin e Trupit Gjykses se viktimë e vrasjes së paligjshme u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë prillit 1999.

475. Mbështetur në dëshmitë e pakundërshtueshme dhe konfirmuese nga të ndaluarit e tjerë sa i takon pranisë së viktimës së vrasjes së paligjshme në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999, konfirmuar më tej nga dëshmitë e [REDAKTUAR], W04674-ës, W04391-shit, W04648-ës dhe Lista e të Burgosurve, Trupi Gjykses është bindur se viktimë e vrasjes së paligjshme u mbajt i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë kuadrit kohor të akuzave.

---

<sup>962</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1747, rreshti 1 deri në f. 1748, rreshti 3; T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1833, rreshtat 8-17; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1945, rreshtat 10-15; f. 1948, rreshti 24 deri në f. 1949, rreshti 9; **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

<sup>963</sup> **W04391**: T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1834, rreshti 11.

<sup>964</sup> **Z. Krasniqi**: T. 22 prill 2022, publik, f. 4041, rreshti 25 deri në f. 4045, rreshti 18.

<sup>965</sup> SPOE00128386-00128420, f. SPOE00128388.

<sup>966</sup> **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, publik, f. 1948, rreshtat 14-15.

## (r) Prania dhe identifikimi i të ndaluarve të tjerë

476. Meqë viktimat e vrasjes së paligjshme nuk ishin dëshmitar në këtë çështje gjyqësore, ai nuk dha dëshmi, as lidhur me praninë dhe identifikimin e të ndaluarve të tjerë gjatë ndalimit të tij në kompleksin e ndalimit në Zllash. Sidoqoftë, Trupi Gjyqësor rikujton konstatimin se W01679, W03593, W03594 dhe W04669 u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtin grup ndërtimesh me viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>967</sup>

## (s) Rrethanat e lirimit

477. Trupi Gjyqësor vëren se provat tregojnë se, në ndryshim nga të ndaluarit e tjerë, viktimat e vrasjes së paligjshme nuk u liruan nga kompleksi i ndalimit në Zllash. Edhe sipas dëshmive përputhëse nga W01679, W03593, dhe W03594, kur u liruan më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, viktimat e vrasjes së paligjshme mbeti në ahur [REDAKTUAR].<sup>968</sup>

478. [REDAKTUAR] e vërtetuar [REDAKTUAR] disa nga të ndaluarit e tjerë, pa viktimën e vrasjes së paligjshme,<sup>969</sup> konfirmon fuqimisht konstatimin se në fakt viktimat e vrasjes së paligjshme nuk u liruan nga kompleksi i ndalimit në Zllash. Fakti

---

<sup>967</sup> *Shih* para. 364, 379-458.

<sup>968</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 905, rreshti 15 deri në f. 906, rreshti 4 (W01679 tha se [REDAKTUAR] i tha se viktimat e vrasjes së paligjshme do liron më vonë); **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 484, rreshtat 19-22; Gjatë pyetjeve nga Mbrojtja W03593 konfirmoi se viktimat e vrasjes së paligjshme nuk u liruan (**W03593**: T. 22 shtator 2021, publik, f. 613, rreshtat 4-7); **W03594**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1145, rreshtat 11-12.

<sup>969</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333; **W04391**: T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1817, rreshtat 6-7; **W04674**: SPOE00128189-00128201 RED2, f. SPOE00128189; T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1935, rreshtat 2-15. *Shih gjithashtu* konstatimet e Trupit Gjyqësor sipas të cilave të ndaluarit u liruan nga kompleksi i ndalimit në Zllash më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date (*shih* para. 406, 426, dhe 441).

që kjo [REDAKTUAR] u konfirmua edhe nga disa prej të ndaluarve (W01679, W03594 dhe W03593)<sup>970</sup> krahas [REDAKTUAR].<sup>971</sup>

479. Në lidhje me këtë pikë, Mbrojtja parashtron se të tjerët nuk përmendën W01679-ën si një nga të pranishmit [REDAKTUAR].<sup>972</sup> Së pari, Trupi Gjykses vë në dukje se W03594, kur flet për të burgosurit [REDAKTUAR] “dhe një [REDAKTUAR] që thash ka shit [REDAKTUAR],<sup>973</sup> që sipas Trupit Gjykses i referohet W01679-ës, i cili, para se të ndalohej, [REDAKTUAR].<sup>974</sup> Më tej, Trupi Gjykses merr parasysh se W01679 dëshmoi pa asnjë hezitim se shkoi [REDAKTUAR] pas lirit. Pretendimet e Mbrojtjes nuk i ngjallin asnjë dyshim Trupit Gjykses sa i takon vërtetësisë së dëshmisë së W01679-ës. Fakti që as W03593 dhe as [REDAKTUAR] nuk e përmendën praninë e W01679-ës mund të jetë thjesht ngaqë nuk e kanë vënë re, nuk u kujtohet, ose nuk e njihnin W01679-ën në atë periudhë, ndaj nuk e vunë re praninë e tij. Gjithashtu, në ato rrethana konkrete, Trupi Gjykses pranon se mund të ketë pasaktësi në dëshmitë e [REDAKTUAR]. Për rrjedhojë, argumenti i Mbrojtjes lidhur me praninë e W01679-ës [REDAKTUAR] është i pabazë.

480. Në lidhje me informacionin për vazhdimin e ndalimit të viktimës së vrasjes së paligjshme, W04674 konfirmoi në sallën e gjyqit deklaratën e tij të mëparshme, sipas së cilës të ndaluarit që [REDAKTUAR] “kishin qenë të burgosur të [...] Skifterave dhe se [viktima e vrasjes së paligjshme] kishte qenë me ta dhe që ishte ende atje me një person tjetër”.<sup>975</sup> W04391 e konfirmoi këtë dëshmi dhe dëshmoi se të gjithë të ndaluarit

---

<sup>970</sup> **W03593**: T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 613, rreshtat 8-14; **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 910, rreshtat 7-13 ([REDAKTUAR]); **W03594**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1191, rreshtat 4-17.

<sup>971</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333; **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1817, rreshti 4 deri në f. 1818, rreshti 10; **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1865, rreshti 21 deri në f. 1869, rreshti 20.

<sup>972</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4710, rreshtat 7-11.

<sup>973</sup> **W03594**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1191, rreshtat 15-16.

<sup>974</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 875, rreshtat 4-5.

<sup>975</sup> **W04674**: SPOE00128189-00128201 RED2, f. SPOE00128189; T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1938, rreshtat 13-17.

“[...] kanë dhanë deklaratën e njëjtë” [...] se Latifi ka mbet në burg në Zllash”.<sup>976</sup>  
W04390 po ashtu dëshmoi se të gjithë të ndaluarit dëshmuan se “Neve na lirun por [viktimën e vrasjes së paligjshme] e lamë në ahër”.<sup>977</sup>

481. Duke marrë parasysh dëshmitë konfirmuese nga ish-të ndaluarit dhe anëtarët e familjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, Trupi Gjykses është bindur se viktima e vrasjes së paligjshme nuk u lirua nga kompleksi i ndalimit në Zllash bashkë me të ndaluarit e tjerë, por mbeti në ahur bashkë me një të ndaluar tjetër, [REDAKTUAR].

(t) Mungesa e garancive procedurale

482. Sa i takon detyrimit për të informuar personin që i është hequr liria për arsyet e heqjes së lirisë, Trupi Gjykses konstatoi se [REDAKTUAR]. Më pas, viktima e vrasjes së paligjshme, u mbajt i ndaluar në ahur bashkë me të tjerët. Nga përshkrimi i ngjarjeve që nga momenti i arrestimit fillestar e deri në mbërritjen e tij në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe gjatë kohës së mbajtjes në ndalim atje, Trupi Gjykses nuk konstaton asnjë tregues që viktimës së vrasjes së paligjshme t’i jetë dhënë në ndonjë moment informacion mbi arsyet apo ndonjë dokument me arsyet për heqjen e lirisë, por se ai u keqtrajtua më shumë nga të gjithë të ndaluarit e tjerë, [REDAKTUAR].<sup>978</sup>  
Në lidhje me këtë pikë, W04648 deklaroi se kur e arrestuan viktimën e vrasjes së paligjshme “ata [REDAKTUAR] nuk [i] treguan se çfarë donin nga ai.”<sup>979</sup>

483. Sa i takon detyrimit për ta nxjerrë personin e arrestuar menjëherë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent si dhe detyrimit për t’i dhënë personit të cilit i është hequr liria mundësinë për të bërë ankesë lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të tij, Trupi Gjykses ka konstatuar edhe gjetkë keqtrajtimin e skajshëm që iu bë

<sup>976</sup> W04391: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1817, rreshti 24 deri në f. 1818, rreshti 1; W04390: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1865, rreshti 21 deri në f. 1869, rreshti 14.

<sup>977</sup> W04390: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1869, rreshtat 21-22.

<sup>978</sup> *Shih* para 569-574.

<sup>979</sup> W04648: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

viktimës së vrasjes së paligjshme, i cili më pas vdiq,<sup>980</sup> dhe faktin se, për shembull, sa herë që e kthenin në ahur, ata që e keqtrajtonin urdhëronin të ndaluarit e tjerë të bërtisnin: “Vdekje tradhtarëve, vdekje hajnave edhe lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.<sup>981</sup> Gjithashtu lidhur me Pikat 2 dhe 3 të Aktakuzës së Konfirmuar, Trupi Gjykses arriti në përfundimin se të bashkëndaluarit e tjerë me viktimën e vrasjes së paligjshme pësuan forma të ndryshme keqtrajtimi për shkak se akuzoheshin se ishin, ndër të tjera, hajdutë dhe/ose spiunë.<sup>982</sup> Më tej, në lidhje me të ndaluarit e tjerë Trupi Gjykses konstatoi se ata nuk u nxorën para një gjykatësi ose prokurori dhe nuk patën mundësi të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre.<sup>983</sup> Në këto rrethana, duke mbajtur parasysh se të gjithë të ndaluarit u mbajtën në kushte të ngjashme ndalimi, Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm që del nga dëshmitë është se viktimën e vrasjes së paligjshme nuk e nxorën para ndonjë autoriteti gjyqësor dhe atij nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij.

484. Mbështetur në sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se viktima e vrasjes së paligjshme nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë; nuk u nxor menjëherë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent; dhe atij nuk iu dha mundësia të kundërshtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij, njësoj si të ndaluarit e tjerë.

## 7. Të ndaluarit e tjerë

485. Trupi Gjykses rikujton se, në Aktakuzën e Konfirmuar, ZPS-ja pretendon së afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, i akuzuari dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së u hoqën lirinë të paktën gjashtë personave në kompleksin e ndalimit në Zllash pa proces të rregullt ligjor.<sup>984</sup> Trupi Gjykses ka marrë prova se edhe persona të tjerë veç

---

<sup>980</sup> *Shih* para. 624.

<sup>981</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1434, rreshtat 18-21.

<sup>982</sup> *Shih* para. 579-583.

<sup>983</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses në “Mungesa e garancive procedurale” në lidhje me W01679-ën, W03593-shin, W03594-ën, dhe W04669-ën.

<sup>984</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 18.

W01679-ës, W03593-shit, W0394-ës, W04669-ës dhe viktimës së vrasjes së paligjshme u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës kohore të akuzave, siç shtjellohet më poshtë.

486. Trupi Gjykues konstaton se W01679 dëshmoi se gjatë periudhës që ishte i arrestuar në bazën e BIA-s “[...] kanë pru njerëz aty”<sup>985</sup> të cilët qëndronin “dy ditë, tri ditë, edhe i kanë largu”.<sup>986</sup> Po ashtu, W03593 deklaroi se “Po kanë prurë për natë, kanë pru deri në 17 veti jemi konë në q’atë dhomë. 17 veta”.<sup>987</sup> Të njëjtën deklaroi edhe W04669, se ishte mbajtur i ndaluar me dy persona të tjerë.<sup>988</sup>

487. Sa i takon numrit të të ndaluarve, Mbrojtja parashton se W03593 është i vetmi dëshmitar që dëshmoi se në atë vend u mbajtën 17 të ndaluar, çka sipas Mbrojtjes është e pamundur, duke pasur parasysh hapësirën e kufizuar.<sup>989</sup>

488. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues nuk sheh asgjë problematike në dëshminë e W03593-shit se në një moment të caktuar aty kishte 17 të ndaluar, pasi ajo që kujton W03593 bazohet në përvojën e tij personale si i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, sikurse u konstatua nga Trupi Gjykues. Siç u theksua, disa dallime në hollësitë e kujtimeve të dëshmitarëve lidhur me ndalimin e tyre në kompleksin e ndalimit në Zllash, janë pasqyrim me vërtetësi i përvojës së tyre personale. Me gjithë këto mospërputhje të vogla, dëshmitë e të ndaluarve-dëshmitarë ishin tejet konfirmuese dhe përputhëse në lidhje me elementet thelbësore të akuzave. Mbështetur në faktin se, sipas dëshmimeve, në ahuret që përdorëshin për qëllime ndalimi silleshin e merreshin shumë të ndaluar, është krejt e mundshme, sipas Trupit Gjykues, që në të njëjtën kohë

---

<sup>985</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 889, rreshtat 4-6.

<sup>986</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 889, rreshtat 20-21.

<sup>987</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 419, rreshtat 7-8; T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 439, rreshtat 20-24.

<sup>988</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1418, rreshti 20 deri në f. 1419, rreshti 12; f. 1424, rreshtat 19-20. Dëshmitari i përshkroi dy të ndaluarit me hollësi: [REDAKTUAR].

<sup>989</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4699, rreshtat 20-24.



e në të njëjtin ahur të jenë mbajtur deri në 17 të ndaluar. Për rrjedhojë, kundërshtimi i Mbrojtjes në lidhje me këtë pikë është i pabazë.

489. Krahas dëshmive lidhur me numrin e të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash, Trupi Gjykses konstaton se W01679, W03593 dhe W03594 dhanë dëshmi të qarta dhe reciprokisht konfirmuese lidhur me praninë e një të ndaluarit që njihet si [REDAKTUAR], ku përfshinë hollësi (për shembull, se ishte [REDAKTUAR] dhe kishte [REDAKTUAR] dhe ai, njësoj si ky i fundit, nuk u lirua),<sup>990</sup> që mund të burojnë vetëm nga kujtimet personale të një ndaluarit. Për rrjedhojë, provat e paraqitura lidhur me ndalimin e [REDAKTUAR] janë të besueshme.

490. Gjithashtu, W01679 identifikoi një të ndaluar tjetër, [REDAKTUAR].<sup>991</sup> Dëshmia e W01679-ës për të ndaluarin tjetër përfshinte hollësi unike lidhur me arsyen pse e kishin ndaluar, hollësi këto që mund të burojnë vetëm nga kujtimet personale të W01679-ës për ngjarjet, si dikush që ishte i ndaluar bashkë me të.<sup>992</sup> Trupi Gjykses konstaton se statusi i [REDAKTUAR] si i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash konfirmohet më tej nga fakti se W04391 dhe W04390 e identifikuan atë si një nga të ndaluarit që [REDAKTUAR] më 19 prill 1999, ose rreth kësaj date.<sup>993</sup> Po ashtu, [REDAKTUAR] përmendet në Listën e të Burgosurve, ku bëhet e ditur se ishte ndaluar që prej [REDAKTUAR],<sup>994</sup> që është konfirmim i mëtejshëm se iu hoq liria në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës përkatëse të akuzave.

491. Lista e të Burgosurve konfirmon më tej dëshmitë e dëshmitarëve të mësipërm lidhur me praktikën e gjerë të heqjes së lirisë në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999. Në fakt, ky dokument rendit emrat, datat e lindjes dhe datat e arrestimit (në

---

<sup>990</sup> *Shih* para. 399, 417 dhe 438.

<sup>991</sup> *Shih* para. 394.

<sup>992</sup> *Shih* para. 399.

<sup>993</sup> **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1817, rreshtat 6-13; **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1869, rreshtat 15-20.

<sup>994</sup> U001-0310-U001-0325, f. U001-0310.

prill 1999) të 19 personave, mes të cilëve [REDAKTUAR],<sup>995</sup> çka përputhet me dëshminë e W03593-shit. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses në dukje se ndalimi i [REDAKTUAR] në kompleksin e ndalimit në Zllash konfirmohet më tej edhe nga W04391 dhe W04674, që dëshmuuan se ai ishte ndër personat që, [REDAKTUAR] dhe e informuan se viktima e vrasjes së paligjshme “ka mbet në burg në Zllash”.<sup>996</sup> Në pikëpamjen e Trupit Gjykses, në atë kohë [REDAKTUAR] mund ta dinin që viktima e vrasjes së paligjshme nuk ishte liruar nga kompleksi i ndalimit në Zllash vetëm nga përvoja e tyre personale dhe nga fakti që kishin qenë të ndaluar bashkë me të. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses i vlerëson të besueshme dëshmitë lidhur me ndalimin e tyre në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe [REDAKTUAR] më pas [REDAKTUAR].

492. Është domethënëse – si edhe në përputhje me dëshminë e W01679-ës sipas të cilit disa të ndaluar u mbajtën për periudha të shkurtra – që Lista e të Burgosurve tregon se në fakt pesë të ndaluar u liruan pak pas arrestimit.<sup>997</sup> Sikurse u konstatua në vlerësimin paraprak të provave,<sup>998</sup> Trupi Gjykses është bindur se, duke pasur parasysh përmbajtjen e saj, Lista e të Burgosurve mund të jetë një dokument i hartuar vetëm nga anëtarët e BIA-s për të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999.

493. Mbështetur në të gjitha provat e lartpërmendura të cilat tregojnë për një numër të madh të ndaluarish në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999, Trupi Gjykses është bindur se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në provat në tërësi, është se të

---

<sup>995</sup> U001-0310-U001-0325, f. U001-0310 ([REDAKTUAR] u arrestua më 6 prill 1999, kurse [REDAKTUAR] më 3 prill 1999).

<sup>996</sup> **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1936, rreshtat 5-17; **W04391**: T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1817, rreshti 4 deri në f. 1818, rreshti 10; T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1865, rreshti 21 deri në f. 1869, rreshti 14.

<sup>997</sup> U001-0310-U001-0325, f. U001-0310 dhe U001-0311 (shih rreshtat 4, 12-14 dhe 19).

<sup>998</sup> *Shih* para. 225-228.

paktën gjashtë persona u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë kuadrit kohor të akuzave.

494. Sa i përket arbitraritetit të këtij ndalimi, Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë se W01679-ës, W03593-shit, W03594-ës, W04669-ës, dhe viktimës së vrasjes së paligjshme iu hoq liria në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë prillit 1999 pa iu akorduar asnjë garanci bazë.<sup>999</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses konstatoi në paragrafin më sipër se të paktën gjashtë persona u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës kohore të akuzave. Duke mbajtur parasysh praktikën e mosakordimit të garancive bazë W01679-ës, W03593-shit, W03594-ës, W04669-ës, dhe viktimës së vrasjes së paligjshme, së bashku me format e ndryshme të keqtrajtimit që pësuan gjatë kësaj periudhe,<sup>1000</sup> Trupi Gjykses vlerëson se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në prova, është se të gjithë të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash, përfshirë [REDAKTUAR], u mbajtën në të njëjtat kushte ndalimi dhe iu mohuan garancitë bazë gjatë periudhës së ndalimit. Në lidhje me këtë pikë, Trupi Gjykses konstaton më tej se nuk është paraqitur asnjë provë që tregon ose sugjeron se anëtarët e BIA-s ndërmorën hapa për të mundësuar që të ndaluarit të gëzonin garancitë bazë të parashikuara në të drejtën humanitare ndërkombëtare. Përkundrazi, siç është konstatuar në pjesë të tjera të tekstit, në lidhje me akuzat për trajtim mizor (Pika 2), torturë (Pika 3) dhe vrasje të paligjshme (Pika 4), Trupi Gjykses konstatoi se të ndaluarit u mbajtën në kushte të mjerueshme, u morën në pyetje ashpërsisht, u rrahën dhe pësuan forma të tjera keqtrajtimi dhe se viktima e vrasjes së paligjshme humbi jetën.

## 8. Përfundim

495. Duke mbajtur parasysh provat në tërësi të shtjelluara më sipër, Trupi Gjykses konstaton se të paktën gjashtë personave— mes të cilëve W01679-ës, W03593-shit,

---

<sup>999</sup> *Shih* para. 379-457.

<sup>1000</sup> *Shih* para. 534-578.

W03594-ës, W04669-ës, viktimës së vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR]— iu hoq liria nga anëtarët e BIA-s afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 ose rreth kësaj date, në kompleksin e ndalimit në bazën e BIA-s në Zllash, që ishte nën kontrollin dhe pushtetin e komandantit të BIA-s, të akuzuarit.

496. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se dëshmitarët që u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash dëshmuuan se iu mohuan disa garanci bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, të cilat duhej t'i kishin gjatë kohës që mbaheshin të ndaluar. Trupi Gjykses konstaton se të gjithë personat e lartpërmendur u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash në të njëjtën periudhë dhe në kushte të ngjashme ndalimi— përfshirë kushtet e tmerrshme në dhomat e ndalimit dhe keqtrajtimet, siç shtjellohet në konstatimet e Trupit Gjykses në Pikat 2 dhe 3 të Aktakuzës së Konfirmuar. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në provat në tërësi, është se të ndaluarve nuk iu akordua asnjë prej tri garancive bazë. Provat e administruara prej Trupit Gjykses nuk lënë mundësi për asnjë përfundim tjetër.

#### D. TRAJTIMI MIZOR DHE TORTURA (PIKAT 2 DHE 3)

497. Në vijim, Trupi Gjykses do të vlerësojë provat dhe do të nxjerrë konstatime faktike nëse të ndaluarit e mbajtur në kompleksin e ndalimit në Zllash, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe nëse u keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht nga i akuzuari dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, sikurse pretendohet në Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>1001</sup> Trupi Gjykses do të diskutojë me radhë: (i) kushtet e mbajtjes në ndalim; dhe (ii) keqtrajtimin fizik dhe psikologjik që vuajtën të ndaluarit.

---

<sup>1001</sup> [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar) para. 21-27, 29.

498. Para kësaj, Trupi Gjykses e konsideron të nevojshme të përcaktojë fillimisht nëse personat që krijuan dhe mbajtën kushtet e ndalimit dhe që keqtrajtuuan fizikisht dhe psikologjikisht të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash, ishin anëtarë të UÇK-së. Trupi Gjykses thekson se të ndaluarit nuk ishin gjithmonë në gjendje t'i identifikonin personat prej të cilëve u keqtrajtuuan.<sup>1002</sup> Në ato raste që i identifikuan, Mbrojtja parashtron se nuk ka prova se individët e identifikuar ishin në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë gjithë periudhës që mbulojnë akuzat, dhe nuk ka prova për ndonjë lidhje të tyre me të akuzuarin.<sup>1003</sup> Sipas Trupit Gjykses argumenti i Mbrojtjes do të thotë se individët e identifikuar nga të ndaluarit nuk ishin vartës të të akuzuarit.

499. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vëren, së pari, se W01679 dhe W03593 i identifikuan (disa prej) individëve nga të cilët u keqtrajtuuan, nëpërmjet emrit (nofkës).<sup>1004</sup> Trupi Gjykses është bindur, sikurse shtjellohet më poshtë, se këta individë ishin anëtarë të BIA-s.<sup>1005</sup> Së dyti, W01679 dëshmoi se ata që e keqtrajtuuan u prezantuan si anëtarë të njësitit "Skifterat",<sup>1006</sup> emri tjetër me të cilin njihet BIA, sikurse është konstatuar tashmë prej Trupit Gjykses.<sup>1007</sup> Së treti, W01679 dhe W03593 dëshmuuan se individët që i keqtrajtuuan vepruan nën pushtetin dhe në bazë të urdhrave të të akuzuarit,<sup>1008</sup> i cili ishte komandant i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s gjatë të gjithë periudhës që mbulojnë akuzat.<sup>1009</sup> Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses është bindur se të gjithë këta individë ishin vartës të të akuzuarit dhe, rrjedhimisht, anëtarë

---

<sup>1002</sup> *Shih, për shembull, W03593*: T. 20 shtator 2021, publik, f. 407, rreshti 9 deri në f. 408, rreshti 7; f. 410, rreshtat 9-12; f. 441, rreshtat 16-17.

<sup>1003</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4638, rreshtat 16-22.

<sup>1004</sup> *Shih* para. 543, 555.

<sup>1005</sup> *Shih* para. 544, 555.

<sup>1006</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 865, rreshti 11 deri në f. 866, rreshti 21; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 867, rreshtat 18-21; f. 869, rreshtat 16-20 (ku shpjegohet se ai u arrestua nga katër ushtarë të cilët u prezantuan si anëtarë të "njësitit special Skifterat" dhe se u rrah nga këta katër ushtarë kur arriti në kompleksin e ndalimit në Zllash).

<sup>1007</sup> *Shih* para. 335.

<sup>1008</sup> *Shih* para. 541, 551.

<sup>1009</sup> *Shih* para. 338.

të BIA-s. Së katërti, W01679, W03593, W04669 dhe W03594 dëshmuar se individët të cilët i keqtrajtuar ose i morën në pyetje të ndaluarit, bënë rojë tek ahuret dhe/ose i shoqëronin ata brenda territorit të kompleksit të ndalimit në Zllash, mbanin (pjesërisht) uniforma – disa me emblemën e BIA-s ose të UÇK-së – ishin të armatosur dhe flisnin shqip.<sup>1010</sup> Së pesti, sikurse u konstatua më lart, gjatë periudhës që mbulojnë akuzat, kompleksi i ndalimit në Zllash kontrollohej nga BIA dhe ishte nën kontrollin dhe pushtetin e të akuzuarit.<sup>1011</sup> Së fundi, Trupi Gjykses vëren se, sikurse përshkruhet hollësisht më poshtë, kryesit përdorën të njëjtën mënyrë veprimi në keqtrajtimin e të ndaluarve.<sup>1012</sup>

500. Bazuar në gjithë sa më sipër, Trupi Gjykses konstaton se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në tërësinë e provave, është se individët që krijuan dhe mbajtën kushtet e ndalimit në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe ata që keqtrajtuar të ndaluarit fizikisht dhe psikologjikisht, ishin anëtarë të UÇK-së që bënë pjesë në njësitin BIA.

## 1. Kushtet e ndalimit

501. Sikurse shtjellohet me hollësi më poshtë, provat e administruara prej Trupit Gjykses tregojnë se të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u mbajtën në kushte çnjerëzore gjatë të gjithë kohës që ishin të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash. Trupi Gjykses do të diskutojë: (a) kushtet e jetesës dhe të fjetjes; (b) dhënien e ushqimit dhe të ujit; (c) kushtet higjienike dhe përdorimin e pajisjeve sanitare;

---

<sup>1010</sup> *Shih* para. 543, 555; **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 865, rreshtat 18-25; f. 887, rreshtat 12-21; **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 410, rreshtat 6-8; f. 418, rreshtat 6-14; f. 441, rreshti 16 deri në f. 442, rreshti 10; T. 22 shtator 2021, publik, f. 576, rreshti 23 deri në f. 577, rreshti 1; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1437, rreshtat 15-21; T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1442, rreshtat 11-18; **W03594**: T. 13 tetor 2021, publik, f. 1198, rreshtat 11-24.

<sup>1011</sup> *Shih* para. 349-353.

<sup>1012</sup> *Shih* para. 528, 534-535, 546-547, 567.

(d) disponueshmërinë e ndihmës mjekësore; dhe (e) deri në çfarë mase lejoheshin të ndaluarit të komunikonin dhe të flisnin me njëri-tjetrin gjatë mbajtjes në ndalim.

(a) Kushtet e jetesës dhe të fjetjes

502. Provat e administruara prej Trupit Gjykues, sikurse shtjellohet me hollësi më poshtë, tregojnë se të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u mbajtën në kushte të mjerueshme, të papërshtatshme për qenie njerëzore.

503. Trupi Gjykues rikujton se W01679, W03593, W03594 dhe W04669 përshkruan në mënyrë përputhëse se vendi ku u mbajtën ishte “ahër” ose “stallë” për kafshë.<sup>1013</sup> W01679 dhe W04669 gjithashtu shpjeguan se ahuri ku ata u mbajtën ishte i ndërtuar me gurë, dru dhe baltë dhe kishte kashtë mbi dysheme.<sup>1014</sup>

504. Të katër dëshmitarët dhanë dëshmi tejet të hollësishme, të gjalla dhe përputhëse për kushtet e jetesës dhe të fjetjes në ahur (ahure). W01679 rikujtoi se ata fjetën “në tokë, në dhe, në gurë, në lagështi”.<sup>1015</sup> Ai shtoi se ata kishin vetëm disa batanije të cilat të ndaluarit i përdornin bashkërisht.<sup>1016</sup> W03593 dha dëshmi të ngjashme. Ai dëshmoi se nuk kishte shtretër, por vetëm disa batanije që përdorshin për të mbuluar kuajt, dhe ai përdori një bashkërisht me W03594-ën.<sup>1017</sup> Ai dëshmoi konkretisht se dyshemeja

---

<sup>1013</sup> *Shih* para. 391, 415, 435, 449; *shih më tej W01679*: T. 4 tetor 2021, publik, f. 870, rreshtat 6-7; f. 882, rreshtat 18-23; f. 919, rreshtat 4-10; **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 403, rreshtat 15-17 (ku flet për ahurin e parë në të cilin u mbajt i ndaluar); T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 417, rreshtat 4-11 (ku flet për ahurin e dytë në të cilin u mbajt i ndaluar); **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1037, rreshtat 20-23; T. 12 tetor 2021, publik, f. 1039, rreshtat 17-19; f. 1176, rreshtat 1-10; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1411, rreshti 24 deri në f. 1412, rreshti 1; f. 1415, rreshtat 11-18; T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1545, rreshti 24 deri në f. 1546, rreshti 2.

<sup>1014</sup> *Shih* para. 391, 449; *shih më tej W01679*: T. 4 tetor 2021, publik, f. 882, rreshtat 18-23; T. 5 tetor 2021, publik, f. 982, rreshtat 10-15; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1430, rreshtat 4-16; T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1545, rreshtat 13-16.

<sup>1015</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 902, rreshtat 16-21; *shih gjithashtu* T. 4 tetor 2021, publik, f. 882, rreshtat 20-23.

<sup>1016</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 902, rreshtat 16-21; *shih gjithashtu* T. 4 tetor 2021, publik, f. 882, rreshtat 20-23.

<sup>1017</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 478, rreshtat 22-23; f. 404, rreshtat 17-19; f. 453, rreshtat 1-9; f. 479, rreshtat 19-23.



e ahurit “ka qenë krejt gati ujë” dhe se “në ujë kena flejt”.<sup>1018</sup> W04669 dëshmoi se ai fjeti në grazhdin e bagëtisë dhe dëshmoi se kishin vetëm disa batanije të cilat nuk ishin të mjaftueshme për të gjithë, duke konfirmuar kështu dëshmitë e W01679-ës dhe W03593-shit në lidhje me kushtet e ndalimit në ahuret e ndryshme që përdorshin për atë qëllim në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1019</sup> Edhe W03594 dëshmoi se “kushtet kanë qenë çnjerëzore”, se nuk kishte shtretër dhe se kishte vetëm kashtë dhe disa batanije.<sup>1020</sup>

505. W04669 dhe W03594 dëshmuan më tej në lidhje me kushtet poshtëruese duke rikujtuar se ata nuhatën dhe panë jashtëqitje të bagëtive.<sup>1021</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses, W03594 dha dëshmi domethënëse kur deklaroi se ato kushte e bënë të ndihej si kafshë, jo si qenie njerëzore.<sup>1022</sup>

506. W01679, W03593 dhe W04669 në mënyrë përputhëse dëshmuan se në ahur (ahure) ishte gjithmonë terr. Ata shpjeguan se mund të shihnin dritë natyrore vetëm përmes plasaritjeve në mure ose hapësirave midis dërrasave të derës.<sup>1023</sup>

<sup>1018</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 417, rreshtat 10-11; f. 478, rreshtat 19-23; *shih gjithashtu* **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 411, rreshtat 13-14 (ku i referohet ahurit të parë në të cilin u mbajt i ndaluar); 061012-061015, f. 061013 (skicë e vizatuar nga W03593, ku tregohet se nga muret hynte ujë).

<sup>1019</sup> **W04669**: T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1544, rreshti 14 deri në f. 1545 rreshti 12.

<sup>1020</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1040, rreshti 22-24; f. 1042, rreshtat 4-16.

<sup>1021</sup> **W04669**: T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1545, rreshtat 17-23; **W03594**: T. 13 tetor 2021, publik, f. 1176, rreshtat 1-10.

<sup>1022</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1040, rreshti 22 deri në f. 1041, rreshti 4; f. 1066, rreshtat 3-8; f. 1067, rreshtat 3-7.

<sup>1023</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 982, rreshti 23 deri në f. 983, rreshti 2; f. 1007, rreshtat 22-25; **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 417, rreshtat 12-13; T. 22 shtator 2021, publik, f. 577, rreshtat 9-14; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1430, rreshtat 4-19. Trupi Gjykses vë në dukje se dëshmitë e dëshmitarëve janë të ndryshme sa i takon asaj nëse kishte një dritare që ishte e mbuluar, apo nuk kishte dritare fare; *shih gjithashtu* **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1039, rreshtat 20-24; T. 13 tetor 2021, publik, f. 1178, rreshtat 10-22; Broshura e Fotografive nga Terreni e UNMIK-ut, SPOE00128386-00128420, f. SPOE00128388 (ku në një fotografi të ahureve shihet një dritare). Trupi Gjykses gjykon se këto dallime në dëshmitë e dëshmitarëve janë rezultat i natyrshëm i kohës që ka kaluar dhe pasqyrojnë kujtimet personale të secilit dëshmitar për ngjarjet traumatike të përjetuara. Nga ky këndvështrim, këto dallime e forcojnë besueshmërinë e dëshmitarëve në vend që ta dobësojnë atë. Gjithsesi, këto dallime

507. Duke marrë parasysh cilësimin e mëposhtëm lidhur me dëshminë e W03594-ës, Trupi Gjykses gjykon se niveli i hollësive dhe përputhshmërisë midis dëshmive të katër dëshmitarëve është i lartë dhe mbështet fuqimisht vlerësimin e Trupit Gjykses se ata i treguan ngjarjet mbi bazën e përjetimeve personale.

508. Dëshmia e W03594-ës përputhet me dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës në shumë pika, sikurse u tregua më lart. Sidoqoftë, dëshmia e tij ishte e ndryshme lidhur me disa hollësi të tjera, për shembull, ai dëshmoi se kishin batanije të mjaftueshme, se në ahur nuk hynte ujë, dhe se kishte dritë natyrore të mjaftueshme.<sup>1024</sup> Trupi Gjykses nuk e gjykon të besueshëm W03594-ën në këto pika meqenëse: (i) dëshmia e tij është e pagjasë dhe kundërthënëse, duke marrë parasysh pranimin prej tij lidhur me kushtet e mbajtjes në ndalim;<sup>1025</sup> dhe (ii) dëshmia e tij biesh me dëshmitë përputhëse të W01679-ës dhe W03593-shit, të cilët u mbajtën në të njëjtin ahur me të. Gjithsesi, edhe sikur dëshmia e tij të pranohej, kushtet e jetesës dhe të fjetjes do të ishin përsëri të papërshtatshme, edhe sipas vetë W03594-ës.

509. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses, duke u bazuar në provat e administruara prej tij, konstaton se kushtet e jetesës dhe të fjetjes në kompleksin e ndalimit në Zllash ishin tërësisht të papërshtatshme dhe poshtëruese.

---

nuk ndikojnë në konstatimet e Trupit Gjykses, pasi dëshmitarët dhanë dëshmi përputhëse për faktin se në ahur ishte gjithmonë terr. Nëse kjo ishte për shkak se nuk kishte dritare, apo sepse dritarja ishte e mbuluar, është juridikisht jothelbësore.

<sup>1024</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1042, rreshtat 4-16; T. 13 tetor 2021, publik, f. 1178, rreshtat 10-22; f. 1185, rreshti 24 deri në f. 1186, rreshti 2.

<sup>1025</sup> *Për shembull*, ai dëshmoi se në ahur kishte dritë të mjaftueshme natyrore, por pastaj shpjegoi se dritarja ishte e mbuluar me dërrasa dhe se drita natyrore hynte vetëm përmes hapësirave midis dërrasave. Trupi Gjykses mendon se është e pagjasë që aty të hynte dritë e mjaftueshme natyrore nëse dritarja ishte e mbuluar. Gjithashtu, kur u pyet nga Mbrojtja nëse hynte ujë në ahur, ai u përgjigj në mënyrë kontradiktore: "Jo, fare s'ka hi. Dhe vetëm kur ka ra shi, por edhe kur ka ra shi, nuk ka hi."; *shih W03594*: T. 13 tetor 2021, publik, f. 1178, rreshtat 10-22; f. 1185, rreshti 24 deri në f. 1186, rreshti 2.

## (b) Ushqimi dhe uji i pijshëm

510. Provat e administruara prej Trupit Gjykues tregojnë, sikurse shtjellohet me hollësi më poshtë, se të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash iu dhanë sasi të pamjaftueshme ushqimi dhe uji.

511. Në veçanti, W03593 dhe W01679 dhanë dëshmi përputhëse, të cilat ishin të hollësishme dhe të gjalla. W03593 dëshmoi se ndonjëherë atyre nuk u jepnin asgjë për të ngrënë për 48 orë rresht dhe, edhe kur u jepnin ushqim, ishte një copë bukë bajate, “sa mos me vdek”, siç u shpreh ai.<sup>1026</sup> Fjalët e tij janë domethënëse: “Po atyre harrojsha kur po hamë se ka bo vaki 2 ditë, 3 ditë s’kena hongër hiç”.<sup>1027</sup> Sa i përket ujit, ai shpjegoi se u binin një kanë me ujë që nuk mjaftonte për të gjithë.<sup>1028</sup> W01679 dëshmoi, njësoj si W03593 se atyre u jepnin një copë të vogël buke një herë në dy ose tri ditë.<sup>1029</sup> Sa i përket ujit, dëshmia e tij është domethënëse: “Unë lypa do ujë me na i pru. Edhe erdhën nja dy ushtarë [BIA] të tijna edhe më rrehën edhe më shtrinë përtokë edhe më urinun thanë, ‘Qe uji’”.<sup>1030</sup> Kjo gjë ndodhi jo vetëm një herë, por dy herë, në praninë e të ndaluarve të tjerë.<sup>1031</sup>

512. Dëshmitë e W01679-ës dhe W03593-shit konfirmohen gjithashtu nga disa [REDAKTUAR], konkretisht W04390 dhe W04391, të cilët i panë disa nga të ndaluarit ditën e lirimit të tyre dhe dëshmuan se ata kishin etje dhe uri pasi nuk kishin ngrënë asgjë për dy ditë.<sup>1032</sup>

<sup>1026</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 477, rreshti 19 deri në f. 478, rreshti 9.

<sup>1027</sup> **W03593**: T. 21 shtator 2021, publik, f. 563, rreshtat 15-23.

<sup>1028</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 478, rreshtat 10-18.

<sup>1029</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 902, rreshtat 4-15.

<sup>1030</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 884, rreshti 22 deri në f. 885, rreshti 2; f. 902, rreshtat 12-15.

<sup>1031</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik f. 885, rreshtat 3-12; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 897, rreshti 8 deri në f. 898, rreshti 25.

<sup>1032</sup> **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1869, rreshti 15 deri në f. 1870, rreshti 20; f. 1872, rreshti 20 deri në f. 1873, rreshti 7; f. 1899, rreshtat 11-21 (deklaroi: “Iu dhamë ushqim. S’di si mund të më kujtohet pak si qysh hajshin ushqim, s’di as vetë me ta sqaru”); **W04391**: T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1744, rreshtat 9-17; T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1819, rreshtat 20-24. Gjithashtu, W03593 dëshmoi,

513. Gjithashtu, Trupi Gjykues ka dëgjuar dëshmi nga W04669 dhe W03594, të cilat ndryshojnë nga dëshmitë e W01679-ës dhe W03593-shit në lidhje me sasinë e ushqimit dhe të ujit që iu dha të ndaluarve. W04669 dëshmoi se atyre u jepnin një tas me supë dhe bukë dy herë në ditë dhe ujë të mjaftueshëm.<sup>1033</sup> W03594 në mënyrë të ngjashme dëshmoi se atyre u jepnin ushqim dhe ujë dy herë në ditë.<sup>1034</sup> Trupi Gjykues nuk ka arsye që të dyshojë në përjetimet e W04669-ës dhe W03594-ës në lidhje me këtë pikë, veçanërisht duke pasur parasysh përshkrimin e hollësishëm dhe të gjallë që W04669 bëri në sallën e gjyqit për ushqimin që iu dha.<sup>1035</sup> Sidoqoftë, as dëshmia e tij, as dëshmia e W03594-ës nuk cenojnë dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit, W04390-s dhe W04391-shit. Trupi Gjykues vë në dukje se: (i) W04669 u mbajt i ndaluar në një ahur tjetër nga dëshmitarët e tjerë dhe për një periudhë të shkurtër;<sup>1036</sup> (ii) në një moment të caktuar, sipas vetë W03593-shit, të ndaluarve u dhanë më shumë ushqim;<sup>1037</sup> (iii) dallime të tilla ndërmjet dëshmimeve të dëshmitarëve janë rezultat i natyrshëm i kujtimeve personale të ngjarjeve traumatike që përjetuan dhe perceptimit të tyre për këto ngjarje;<sup>1038</sup> dhe (iv) është shumë e pagjasë që W01679, W03593, W04390 dhe W04391 të kenë dëshmuar në mënyrë të pasaktë – krejt rastësisht – për mungesën e ushqimit dhe të ujit.

---

duke konfirmuar edhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, se ai dhe të ndaluarit e tjerë [REDAKTUAR]. Ai rikujtoi se deri në atë moment, ata nuk kishin ngrënë asgjë për tri ose katër ditë dhe ishin shumë të uritur; *shih* **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 486, rreshti 22 deri në f. 487, rreshti 7; T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 613, rreshti 2 deri në f. 614, rreshti 24.

<sup>1033</sup> **W04669**: T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1543, rreshti 10 deri në f. 1544, rreshti 13.

<sup>1034</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1040, rreshtat 10-15; T. 13 tetor 2021, publik, f. 1154, rreshti 24 deri në f. 1155, rreshti 1.

<sup>1035</sup> **W04669**: T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1543, rreshti 10 deri në f. 1544, rreshti 2 (ai shpjegoi se ushqimin ua jepnin në “një si tas”, rreth 20 centimetra i thellë dhe prej metali që dukej si alumin, dhe se zakonisht ushqimi ishte si përshesh, supë me bukë si përshesh).

<sup>1036</sup> *Shih* para. 449-455.

<sup>1037</sup> **W03593**: T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 570, rreshti 15 deri në f. 572, rreshti 9.

<sup>1038</sup> *Shih, për shembull*, **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1040, rreshtat 10-15; T. 13 tetor 2021, publik, f. 1154, rreshti 24 deri në f. 1155, rreshti 1 (ku ai deklaroi: “Ujë na kanë sjellë sa kemi dashtë edhe ushqimi ka qenë i mjaftueshëm. *Mendoj i mjaftueshëm për kohët e luftës*”; “e thashë edhe dje kemi pasë ushqim të mjaftueshëm aty mrena për mrena. *Për mu ka qenë i mjaftueshëm*”) (theksimi i shtuar).

514. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykues, bazuar në provat e administruara prej tij, konstaton se të paktën për periudha të caktuara kohore të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash iu dha sasi e pamjaftueshme ushqimi dhe uji.

(c) Kushtet higjienike dhe përdorimi i pajisjeve sanitare

515. Sikurse shtjellohet me hollësi më poshtë, provat e administruara prej Trupit Gjykues tregojnë se të ndaluarit lejoheshin t'i përdornin në mënyrë të kufizuar pajisjet sanitare, ose nuk lejoheshin t'i përdornin.

516. Përsëri, dëshmitë e W03593-shit dhe W01679-ës janë shumë të ngjashme dhe përputhëse. Kur u pyet nëse kishte mundësi të lahej, W03593 deklaroi: "Ne s'kena mujt me pi ujë, jo me u la e me u pastru".<sup>1039</sup> Ai gjithashtu dëshmoi se atyre nuk u dhanë tesha për t'u ndërruar, gjë që sipas mendimit të Trupit Gjykues bëhet edhe më e rëndë prej faktit se fjetën në ujë për ditë të tëra, sikurse u konstatua më lart.<sup>1040</sup> Edhe W01679 deklaroi: "ujë me pi s'na kanë dhonë, se le me u la".<sup>1041</sup> Ai gjithashtu dëshmoi se u infektua në ahur nga një lëndim që iu shkaktua prej rrahjes.<sup>1042</sup> [REDAKTUAR] – se plagët, në qoftë se nuk mjekohen siç duhet, mund të infektohen veçanërisht nëse personi i lënduar është në mjedis johigjienik.<sup>1043</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykues rikujton se në ahur (ahure) kishte kudo jashtëqitje të bagëtive.<sup>1044</sup> Bazuar në këto dëshmi, Trupi Gjykues konstaton se infeksioni që mori W01679 u krijua, pjesërisht, si pasojë e kushteve johigjienike në të cilat u mbajt i ndaluar.

---

<sup>1039</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 478, rreshti 24 deri në f. 479, rreshti 7.

<sup>1040</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 479, rreshtat 11-23; *shih* para. 504.

<sup>1041</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 902, rreshti 23 deri në f. 903, rreshti 1.

<sup>1042</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1043</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1044</sup> *Shih* para. 505.

517. Dëshmitë e W03593-shit dhe W01679-ës konfirmohen nga W03594 dhe disa nga [REDAKTUAR]. Edhe pse W03594 e minimizoi ashpërsinë e kushteve të ndalimit, ai pohoi: “Unë isha i parruar. Ishte ba një kohë e gjatë pa pastrim”.<sup>1045</sup> Po ashtu, W04390, W04391 dhe W04674 rikujtuan se kur të ndaluarit [REDAKTUAR], ata ishin të palarë, të parruar, të pakrehur dhe me thonj të gjatë.<sup>1046</sup> “Ishin ba sikur majmunat”, deklaroi W04674.<sup>1047</sup> Konkretisht, W04390 dhe W04674 rikujtuan se të ndaluarve u dhanë prerëse thonjsh për të prerë thonjtë dhe brisqe për t’u rruar.<sup>1048</sup> Trupi Gjykses konstaton se W04390, W04391 dhe W04674 ishin të besueshëm dhe se mund të mbështetet më së miri në dëshmitë e tyre në lidhje me këtë pikë, meqenëse ata i panë të ndaluarit pak pasi ishin liruar dhe dëshmitë e tyre janë të hollësishme, të gjalla dhe reciprokisht konfirmuese deri në imtësi.

518. Në lidhje me pajisjet sanitare, ndonëse dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit, W03594-ës dhe W04669-ës ndryshojnë në disa aspekte, ato konfirmojnë njëra-tjetrën në aspekte kryesore. W01679, W03593 dhe W03594 dëshmuan se ata i kryenin nevojat personale në një kovë brenda në ahur, në prani të njëri-tjetrit.<sup>1049</sup> W03593 dhe W03594 shtuan se ndonjëherë përdornin një banjë jashtë, por – sipas W03593-shit – të shoqëruar nga anëtarë të armatosur të BIA-s.<sup>1050</sup> Dëshmia e W03593-shit përputhet në këtë pikë me dëshminë e W04669-ës, i cili dëshmoi se përdori një banjë jashtë, por ishte

---

<sup>1045</sup> **W03494**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1158, rreshtat 13-23.

<sup>1046</sup> **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1869, rreshtat 21-24; f. 1872, rreshti 20 deri në f. 1873, rreshti 7; f. 1876, rreshti 5 deri në f. 1877, rreshti 7; f. 1899, rreshti 11 deri në f. 1900, rreshti 11; **W04391**: T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1744, rreshti 18-19; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1940, rreshtat 10-25.

<sup>1047</sup> **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1940, rreshtat 10-14.

<sup>1048</sup> **W04390**: T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1872, rreshti 20 deri në f. 1873, rreshti 7; f. 1900, rreshti 7 deri në f. 1901, rreshti 12; f. 1904, rreshti 23 deri në f. 1905, rreshti 3; f. 1906, rreshtat 17-25; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1940, rreshtat 10-25.

<sup>1049</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 903, rreshtat 2-8; **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 479, rreshti 24 deri në f. 480, rreshti 12; **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1042, rreshti 17 deri në f. 1043, rreshti 3.

<sup>1050</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 479, rreshti 24 deri në f. 480, rreshti 12; **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1043, rreshtat 4-14.



i shoqëruar nga një anëtar i armatosur i BIA-s dhe duhej t'i kryente nevojat personale nën tytën e armës.<sup>1051</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash nuk mund të shkonin shpesh në banjë dhe duhej t'i kryenin nevojat personale ose brenda në ahur (ahure) në prani të njëri-tjetrit, ose të përdornin banjën jashtë nën mbikëqyrje.

519. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses, bazuar në provat e administruara prej tij, konstaton se kushtet higjienike dhe sanitare në kompleksin e ndalimit në Zllash ishin krejtësisht të papërshtatshme dhe poshtëuese.

(d) Ndhma mjekësore

520. Provat e administruara prej Trupit Gjykses, sikurse shtjellohet me hollësi më poshtë, tregojnë se të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash nuk iu dha ndihmë mjekësore.

521. Dëshmitë e W03593-shit, W01679-ës dhe W04669-ës, të cilat janë reciprokisht konfirmuese, tregojnë se të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash nuk iu dha ndihmë mjekësore.<sup>1052</sup> Në veçanti, dëshmitë e W03593-shit dhe W01679-ës janë domethënëse. W03593 dëshmoi se “me pas thanë që jam i sëmurë, të kish qit jashtë të kish vra menjëherë”.<sup>1053</sup> Po ashtu, W01679 rikujtoi se ata nuk mund të kërkonin ndihmë mjekësore sepse “çka ke kërku d.m.th. veç e ke pasë, veç ja ke shtu vetit kënd rreh më shumë”.<sup>1054</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses, refuzimi i ndihmës mjekësore bëhet edhe më i rëndë prej faktit se të ndaluarit u keqtrajtuuan fizikisht në mënyrë brutale dhe pësuan lëndime të rënda gjatë mbajtjes në ndalim, sikurse përshkruhet më poshtë.

---

<sup>1051</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1441, rreshti 21 deri në f. 1442, rreshti 5.

<sup>1052</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 480, rreshtat 13-21; **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 903, rreshtat 9-17; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1467, rreshtat 7-11.

<sup>1053</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 480, rreshtat 13-21.

<sup>1054</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 903, rreshtat 9-17.



522. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses, bazuar në provat e administruara prej tij, konstaton se të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash iu refuzua ndihma mjekësore.

(e) Ndalimi i komunikimit me njëri-tjetrin

523. Si W01679 dhe W03593 dëshmuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qartë, se anëtarët e BIA-s nuk i lejonin të ndaluarit të flisnin me njëri-tjetrin duke i kërcënuar me vdekje, dhe dëshmuar se, si pasojë, ata kishin frikë të flisnin me njëri-tjetrin.<sup>1055</sup>

524. Gjithashtu, Trupi Gjykses dëgjoi dëshmi nga W03594 se të ndaluarit kishin kohë të shumtë për të biseduar, mirëpo gjykon se dëshmia e tij nuk bie ndesh me dëshmitë e W01679-ës dhe W03593-shit.<sup>1056</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses, nuk është me rëndësi fakti nëse të ndaluarit kishin kohë të bisedonin me njëri-tjetrin, por nëse mundeshin të bisedonin lirisht.<sup>1057</sup> Dëshmitë e W01679-ës dhe W03593-shit tregojnë se kjo nuk ishte e mundur.

525. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses, bazuar në provat e administruara prej tij, konstaton se të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash nuk ishin në gjendje të komunikonin lirisht me njëri-tjetrin, gjë që shtoi frikën dhe ankthin e tyre.

(f) Komete përfundimtare

526. Mbrojtja ka parashtruar argumentin se kushtet e ndalimit ishin thjesht pasojë e mundësive të pakta në kompleksin e ndalimit në Zllash, ose e mungesës së këtyre mundësive, dhe të gjithë që ishin atje, përfshirë edhe refugjatët, jetuan në të njëjtën

---

<sup>1055</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 889, rreshtat 10-13; **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 404, rreshtat 20-22; f. 406, rreshtat 6-9; f. 416, rreshti 24 deri në f. 417, rreshti 3; f. 417, rreshti 25 deri në f. 418, rreshti 5; f. 455, rreshtat 7-10.

<sup>1056</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1046, rreshtat 5-9.

<sup>1057</sup> W01679 pranoi se ata folën me njëri-tjetrin, por theksoi se kishin frikë kur flisnin; **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 889, rreshtat 10-13.

mënyrë.<sup>1058</sup> Ky argument nuk e bind aspak Trupin Gjykues, sepse nuk shpjegon arsyen e kushteve të tmerrshme të ndalimit: faktin se të ndaluarit u mbajtën në ahure të rrethuar nga jashtëqitjet e bagëtime,<sup>1059</sup> se mbi ta u urinua kur kërkuan ujë;<sup>1060</sup> se shumë rrallë mund të shkonin në një banjë, sado të thjeshtë;<sup>1061</sup> se iu refuzua ndihmë mjekësore;<sup>1062</sup> dhe se e kishin të ndaluar të komunikonin dhe flisnin me njëri-tjetrin nën kërcënimin e vdekjes.<sup>1063</sup>

527. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykues, bazuar në provat e administruara prej tij, konstaton se të ndaluarit u mbajtën në kushte çnjerëzore në kompleksin e ndalimit në Zllash nga anëtarë të BIA-s, nën kontrollin dhe pushtetin e të akuzuarit.

## 2. Keqtrajtimi

528. Sikurse shtjellohet me hollësi më poshtë, provat e administruara prej Trupit Gjykues tregojnë se të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u keqtrajtuuan rregullisht, si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Provat tregojnë se anëtarët e BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash kishin një mënyrë veprimi të caktuar: brenda ahurit (ahureve) të ndaluarit goditeshin me shkelma, grushte dhe shuplaka çdo ditë; krahas kësaj, anëtarë të BIA-s i nxirrnin të ndaluarit nga ahuri (ahuret), një nga një, për marrje në pyetje dhe më të shumtën e kohës i çonin në një dhomë që ishte mbi një nga ahuret (dhoma e marrjes në pyetje), por edhe në vende të tjera në kompleksin e ndalimit në Zllash, ku i rrihnin të ndaluarit brutalisht dhe i keqtrajtonin në forma të

---

<sup>1058</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4730, rreshti 13 deri në f. 4732, rreshti 15.

<sup>1059</sup> *Shih* para. 505.

<sup>1060</sup> *Shih* para. 511.

<sup>1061</sup> *Shih* para. 518.

<sup>1062</sup> *Shih* para. 520-522.

<sup>1063</sup> *Shih* para. 523-525.

tjera.<sup>1064</sup> Trupi Gjykues vë në dukje dëshminë e W01679-ës ku përshkruhet qartësisht kjo mënyrë veprimi: “Aty ke pështu ma lehtë ndoshta poshtë. Nalt u konun shumë ma vshtirë”.<sup>1065</sup> Në vijim, Trupi Gjykues do të diskutojë me radhë: (a) keqtrajtimin fizik dhe/ose psikologjik që u ushtrua ndaj të ndaluarve bashkërisht në ahur (ahure); dhe (b) keqtrajtimin që W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] pësuan individualisht në dhomën e marrjes në pyetje, ose në vende të tjera në kompleksin e ndalimit në Zllash.

(a) Keqtrajtimi i të ndaluarve në ahur (ahure)

529. *Keqtrajtimi fizik.* W01679 dhe W03593 dhanë dëshmi reciprokisht konfirmuese në lidhje me keqtrajtimin fizik që të ndaluarit pësuan çdo ditë në ahurin ku u mbajtën. W01679 dëshmoi se, me përjashtim të [REDAKTUAR], ata të gjithë u goditën me shkelma dhe grushte çdo ditë.<sup>1066</sup> Ai rikujtoi se “kush ka ardhë, kush e ka çel derën, pa ta hy në ndonji shkelm ose ndonji boks ose ndonji diçka, nuk ke pështu”, që tregon sesa i përhapur ishte keqtrajtimi.<sup>1067</sup> W03593 dha dëshmi të ngjashme, duke dëshmuar se çdo natë anëtarë të BIA-s hynin në ahur dhe godisnin me shuplaka e shkelma të gjithë të ndaluarit.<sup>1068</sup>

530. *Keqtrajtimi psikologjik.* Gjithashtu, provat tregojnë se të ndaluarit panë keqtrajtimin brutal që iu bë të ndaluarve të tjerë – i cili përshkruhet me hollësi më

---

<sup>1064</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykues më poshtë; *shih më tej* **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 886, rreshti 22 deri në f. 887, rreshti 1; f. 890, rreshtat 12-14; f. 895, rreshtat 9-10; **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 439, rreshti 25 deri në f. 440, rreshti 8; f. 477, rreshtat 1-9; T. 21 shtator 2021, publik, f. 517, rreshti 14 deri në f. 518, rreshti 19; 061012-061015, f. 061013 (skicë e vizatuar nga W03593, ku dhoma mbi ahur është shënuar si “dhoma e rrahjeve”); **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1425, rreshtat 9-21.

<sup>1065</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 983, rreshtat 11-12.

<sup>1066</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 885, rreshtat 18-25; f. 886, rreshtat 18-21; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 888, rreshti 21 deri në f. 890, rreshti 14; f. 894, rreshti 10 deri në f. 896, rreshti 6; f. 900, rreshti 9 deri në f. 901, rreshti 10; T. 5 tetor 2021, publik, f. 983, rreshtat 8-10.

<sup>1067</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 885, rreshtat 18-22.

<sup>1068</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 441, rreshtat 5-15; f. 442, rreshtat 17-21; T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 575, rreshti 20 deri në f. 577, rreshti 1.

poshtë – dhe si pasojë ata jetonin në frikë të vazhdueshme se mund të ishin në radhë për t’u keqtrajtuar. W03593 rikujtoi se nga ahuri dëgjonte njerëzit kur rriheshin lart në dhomën e marrjes në pyetje dhe britmat e tyre.<sup>1069</sup> Ai shpjegoi se kjo ndodhte pothuajse çdo natë dhe se nuk mund të flinin sepse kishin frikë se – në çdo moment – mund t’u vinte radha.<sup>1070</sup> W01679 dha një përshkrim edhe më të gjallë duke rikujtuar se: “ke ndi zona të njerëzve t’u bërtit [...] t’u bo si qenë, si macja [...] prej torturës, prej dhimbjeve”.<sup>1071</sup> Dëshmia e tij flet qartë për stresin e madh psikologjik të përjetuar prej tyre, sepse siç shpjegoi ai, anëtarë të BIA-s mund ta çonin dikë lart “kur kanë dashtë”: “ke pritun kush po vjen me të rreh ose me të marrë me të çu nalt me të rreh”, ke prit veç vdekjen, por, kur po të vjen [...] as sot, nesër, kur po të mytin”.<sup>1072</sup>

531. Të ndaluarit jo vetëm dëgjuan keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë, ata gjithashtu panë edhe lëndimet e pësuarat prej tyre dhe gjendjen në të cilën ishin kur i kthenin në ahur: të mavijosur, të gjakosur, ose pa ndjenja.<sup>1073</sup> W03593 dëshmoi se, sapo e çuan në kompleksin e ndalimit në Zllash, ai pa viktimën e vrasjes së paligjshme të rrahur, që nuk mund të qëndronte në këmbë dhe mezi fliste. Ai rikujtoi se viktimën e vrasjes së paligjshme i tha: “kanë me t’myt” dhe mënyrën si iu përgjigj ai (W03593), që nuk mund të përshkruhet ndryshe përveçse në gjendje dëshpërimi: “çfarë me i bo”.<sup>1074</sup> W04669 dëshmoi në mënyrë të ngjashme, se kur pa viktimën e vrasjes së paligjshme të keqtrajtuar aq brutalisht, ai pati frikë se e njëjta gjë mund t’i ndodhte atij.<sup>1075</sup> Dëshmia e tij përçoi të njëjtën ndjenjë dëshpërimi si dëshmia e W03593-shit: “Vetëm

<sup>1069</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 476, rreshti 3 deri në f. 477, rreshti 13.

<sup>1070</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 476, rreshtat 3-25.

<sup>1071</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 890, rreshti 15 deri në f. 891, rreshti 1; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 896, rreshtat 7-13.

<sup>1072</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 891, rreshtat 3-8; f. 903, rreshtat 20-24.

<sup>1073</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 440, rreshtat 6-25; T. 22 shtator 2021, publik, f. 576, rreshtat 5-8; **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 891, rreshtat 9-16; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 896, rreshtat 14-19.

<sup>1074</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 404, rreshti 11-19.

<sup>1075</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1441, rreshtat 1-10; f. 1468, rreshtat 7-16. *Shih më tej* Konstatimet e Trupit Gjykoës mbi keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme, para. 569-574.

kem lënë fatin tonë në duar të tyre”.<sup>1076</sup> Dëshmitë reciprokisht konfirmuese të W03593-shit, W01679-ës dhe W04669-ës të cituara më lart janë kaq të gjalla, me emocion dhe të sinqerta në lidhje me këtë pikë saqë Trupi Gjykues nuk ka dyshim se dëshmitarët i treguan ngjarjet bazuar në përjetimet e tyre personale. Gjithashtu, dëshmia e W04669-ës konfirmohet nga [REDAKTUAR] që përcaktoi se W04669 vuan nga simptoma të stresit pastraumatik, konkretisht, makthe dhe fanitje që lidhen me viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>1077</sup>

532. Frika e vazhdueshme u shtua edhe më shumë nga fakti se të ndaluarit nuk u informuan për arsyet e heqjes së lirisë,<sup>1078</sup> atyre ua mbulonin kokën me thasë kur i nxirrnin ose sillnin në ahur (ahure) dhe u thoshin që të mos shihnin rreth e rrotull,<sup>1079</sup> ata u mbajtën në terr,<sup>1080</sup> nuk u lejuan të flisnin me njëri-tjetrin<sup>1081</sup> dhe nuk u lejuan të flinin.<sup>1082</sup>

---

<sup>1076</sup> **W04669**: T. 11 nëntor 2022, publik, f. 1504, rreshtat 16-21.

<sup>1077</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1078</sup> Trupi Gjykues thekson se, përveçse u akuzuan si bashkëpunëtorë të serbëve, apo si spiunë, tradhtarë, hajdutë apo gënjeshtarë, të ndaluarve nuk iu dha asnjë dokument ose arsye zyrtare për heqjen e lirisë dhe, sikurse u dëshmuua nga disa dëshmitarë, ata nuk e kuptonin pse po mbaheshin të ndaluar; *shih* para. 408, 410, 427, 429, 442, 444, 456, 458, 482, 484; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1441, rreshtat 8-10 (“Frikë aty [...] ne nuk dinim arsyen pse jemi aty”); f. 1468, rreshtat 7-10 (“[...] të palogjikshme për neve kanë qenë”); T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1504, rreshtat 11-21 (“frikë të madhe për shkak se ne nuk e dinim se — në realitet se çka – pse po ndodh ajo ashtu”); **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 481, rreshtat 2-5 (“kam qenë i humbur, kam qenë – s’po di çka po bohet me neve”); **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1037, rreshtat 22-23; T. 12 tetor 2021, publik, f. 1066, rreshtat 9-12 (deklaroi se kishte frikë për jetën sepse “Unë s’kam ditë çka — çka më zen mbrëmja ose mëngjesi. Pa kurrfarë sqarimi”).

<sup>1079</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 395, rreshtat 17-19; f. 402, rreshtat 3-4; f. 408, rreshtat 2-12 (“na kanë thënë “kokën poshtë”. Unë nuk kam guxuar me këqyr kush është [...] se na kanë thonë “mos na shiko, kokën mbaje poshtë”); f. 475, rreshti 23 deri në f. 476, rreshti 2; f. 480, rreshtat 6-7; **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 867, rreshtat 4-9; f. 915, rreshtat 14-18; **W04669**: T. 10 nëntor 2022, publik, f. 1425, rreshtat 12-15; T. 11 nëntor 2022, publik, f. 1542, rreshtat 21-23.

<sup>1080</sup> *Shih* para. 506.

<sup>1081</sup> *Shih* para. 523-525.

<sup>1082</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 479, rreshtat 22-23; **W04669**: T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1544, rreshtat 14-17.

533. Trupi Gjykues vëren se dëshmia e W03594-ës ndryshonte dukshëm nga dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur. Ai dëshmoi se, me disa përjashtime, askush nuk u godit gjatë mbajtjes në ahur, askush nuk u nxor nga ahuri dhe se askush nuk kishte shenja keqtrajtimi.<sup>1083</sup> Trupi Gjykues thekson së pari se dëshmia e W03594-ës përgënjeshtrohet qartësisht nga dëshmitë përputhëse të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës.<sup>1084</sup> Së dyti, kur u ballafaqua në sallën e gjyqit me deklaratën që i kishte dhënë më parë ZPS-së – ku W03594 kishte thënë se të ndaluarit kishin shenja lëndimesh dhe vrima në trup dhe se një prej tyre ishte rrahur aq rëndë sa nuk mund të qëndronte në këmbë – W03594 thjesht mohoi të kishte thënë gjëra të tilla dhe nuk dha shpjegim bindës për këtë mospërputhje të dukshme.<sup>1085</sup> Së treti, dëshmia e tij në lidhje me këtë pikë nuk pajtohet as me pranimet e tij në sallën e gjyqit për frikën e vazhdueshme që ndjenë ai dhe të ndaluarit e tjerë në kompleksin e ndalimit në Zllash. W03594 dëshmoi në mënyrë të përsëritur dhe përputhëse me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë se kishte pasur frikë për jetën dhe nuk e dinte nëse të nesërmen do të ishte gjallë apo vdekur.<sup>1086</sup> Ai dëshmoi gjithashtu për të ndaluarit e tjerë se “nga frika se mund të rrahën apet. [...] ne ishim me stresse se mund t’i nxjerrin ose t’i rrahë dikush”.<sup>1087</sup> Në lidhje me W03593-shin, ai dëshmoi konkretisht se çdo herë që anëtarët e BIA-s hynin në ahur “më afrohej kaq shumë sa që gati më hynte në gjoks, në kraharor nga frika që kishte prej tyre”.<sup>1088</sup> Për këto arsye, Trupi Gjykues nuk bindet prej

---

<sup>1083</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1049, rreshti 19 deri në f. 1050, rreshti 9; f. 1051, rreshti 12 deri në f. 1054, rreshti 24; f. 1058, rreshti 8 deri në f. 1065, rreshti 25; f. 1068, rreshti 16 deri në f. 1072, rreshti 19; T. 12 tetor 2021, publik, f. 1076, rreshti 5 deri në f. 1078, rreshti 9; T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1189, rreshtat 2-23; T. 14 tetor 2021, publik, f. 1266, rreshti 24 deri në f. 1270, rreshti 1.

<sup>1084</sup> *Shih* Pjesa V.D.2.

<sup>1085</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1051, rreshti 12 deri në f. 1054, rreshti 24; T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1058, rreshti 8 deri në f. 1065, rreshti 25; T. 14 tetor 2021, publik, f. 1266, rreshti 24 deri në f. 1270, rreshti 1; *i referohet* 061016-TR-ET Part (Pjesa) 1 RED1, f. 26, rreshtat 13-14; 061016-TR-ET Part (Pjesa) 3 RED1, f. 7, rreshtat 5-17, 22-23; f. 10, rreshtat 1-22.

<sup>1086</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1066, rreshtat 9-12, 21-22; f. 1067, rreshtat 3-7; T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1086, rreshti 4 deri në f. 1087, rreshti 3; T. 13 tetor 2021, publik, f. 1136, rreshtat 14-16.

<sup>1087</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1079, rreshtat 20-23.

<sup>1088</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1079, rreshtat 1-13.

dëshmisë së W03594-ës dhe konstaton se ai nuk i përgënjeshton dëshmitë tërësisht autentike dhe të mbështetshme të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës në lidhje me keqtrajtimin fizik dhe psikologjik që vuajtën të ndaluarit.

(b) Keqtrajtimi i ndaluarve në dhomën e marrjes në pyetje ose në vende të tjera në kompleksin e ndalimit në Zllash

i. W01679

534. *Marrja në pyetje dhe keqtrajtimi.* Provat e administruara prej Trupit Gjykses tregojnë se W01679, [REDAKTUAR],<sup>1089</sup> u mor në pyetje dhe u rrah për herë të parë ditën kur e sollën në kompleksin e ndalimit në Zllash. Dëshmitari dëshmoi se me të mbërritur në kompleksin e ndalimit në Zllash, atë e çuan tek i akuzuari në dhomën e marrjes në pyetje sipër ahurit ku më vonë u mbajt i ndaluar.<sup>1090</sup> Atje, i akuzuari e pyeti pse ishte në Zllash dhe e akuzoi si spiun, gënjeshtar dhe hajdut.<sup>1091</sup> Më tej, dëshmitari tregoi se i akuzuari e goditi me shuplakë dhe i urdhëroi ushtarët e tjerë të BIA-s “Mbyteni krejt”.<sup>1092</sup> Ushtarët e BIA-s e goditën me shkelma, me grushte, me një shkop bejsbolli dhe me bishtin e një sakice derisa humbi vetëdijen.<sup>1093</sup> W01679 dëshmoi se më pas e zbritën në ahur të mbuluar në gjak.<sup>1094</sup>

<sup>1089</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 900, rreshti 25 deri në f. 901, rreshti 3; U001-0310-U001-0322-ET.

<sup>1090</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 865, rreshti 11 deri në f. 867, rreshti 16; T. 4 tetor 2021, publik, f. 882, rreshtat 13-19.

<sup>1091</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 867, rreshtat 10-16; f. 868, rreshtat 22-24; f. 869, rreshtat 11-18; f. 874, rreshti 6 deri në f. 876, rreshti 13 (*i referohet* deklaratës së W01679-ës [REDAKTUAR], 7000687-7000691 RED 3, f. 7000687, të cilën dëshmitari e konfirmoi në sallën e gjyqit); T. 5 tetor 2021, publik, f. 981, rreshtat 3-20.

<sup>1092</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 869, rreshtat 11-23; f. 877, rreshtat 13-21; T. 5 tetor 2021, publik, f. 981, rreshtat 10-13.

<sup>1093</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 869, rreshti 16 deri në f. 870, rreshti 7; f. 874, rreshti 6 deri në f. 876, rreshti 13, *i referohet* deklaratës së W01679-ës [REDAKTUAR], 7000687-7000691 RED 3, f. 7000687, të cilën dëshmitari e konfirmoi në sallën e gjyqit.

<sup>1094</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, publik, f. 870, rreshtat 2-7; f. 882, rreshtat 13-19.



535. Gjithashtu, dëshmitari dëshmoi se gjatë mbajtjes në ndalim ai u keqtrajtua thuajse çdo ditë.<sup>1095</sup> Atë e goditën me shufra hekuri dhe bisht sakice;<sup>1096</sup> e dogjën me dyllë të nxehtë qirinsh<sup>1097</sup> me hekur të nxehtë;<sup>1098</sup> dhe i vunë në trup rrymë elektrike.<sup>1099</sup> Ai përshkroi në mënyrë bindëse dhe me hollësi torturën me rrymë elektrike: dy ushtarë të BIA-s – Dardani dhe Afrimi, që ishin “ekspertët” e torturës me rrymë elektrike – ia përveshën pantallonat, i vunë dy tela të lidhur me një “kuti” në pjesët e zbuluara të këmbëve dhe e ndezën “kutinë” dhe në atë moment W01679 goditej me rrymë elektrike.<sup>1100</sup> Dëshmitari më tej dëshmoi se gjatë keqtrajtimit u pyet për arsyet pse ishte në Zllash dhe u akuzua si hajdut.<sup>1101</sup> Ndonëse i akuzuari nuk e rrahu më pas incidentit të parë të përshkruar më lart, sipas asaj që i kujtohej dëshmitarit, ai ishte i pranishëm dhe mbikëqyri (disa nga) rrahjet e tjera.<sup>1102</sup>

536. Dëshmia e W01679-ës ishte tërësisht përputhëse gjatë pyetjeve nga palët dhe nga mbrojtësja e viktimave në lidhje me keqtrajtimin që kishte pësuar. Përshkrimi i tij ishte i qartë, i gjallë dhe aq i hollësishëm sa që Trupi Gjykues nuk ka dyshim se ai i kishte përjetuar vetë ato ngjarje.

537. Lidhur me dëshminë e tij për goditjen me rrymë elektrike, Trupi Gjykues thekson se ka marrë prova me gjasë kundërthënëse në lidhje me ekzistencën e rrymës elektrike në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë prillit 1999. Për shembull, një dëshmitar i Mbrojtjes, z. Krasniqi, dëshmoi se rryma në kompleksin e ndalimit në Zllash u ndërpre nga fundi i janarit 1999.<sup>1103</sup> Një dëshmitare tjetër e Mbrojtjes,

---

<sup>1095</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 885, rreshtat 13-25; T. 5 tetor 2021, publik, f. 983, rreshtat 3-10.

<sup>1096</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 884, rreshtat 2-5.

<sup>1097</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 884, rreshtat 6-11.

<sup>1098</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 984, rreshti 24 deri në f. 986, rreshti 16.

<sup>1099</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 885, rreshtat 13-25.

<sup>1100</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 986, rreshti 17 deri në 987, rreshti 15.

<sup>1101</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 983, rreshti 18 deri në f. 984, rreshti 2.

<sup>1102</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 983, rreshti 18 deri në f. 984, rreshti 8; f. 1004, rreshti 19 deri në f. 1005, rreshti 6.

<sup>1103</sup> **Z. Krasniqi**: T. 21 prill 2022, publik, f. 3890, rreshtat 15-19.

znj. Canolli-Kaçiu, deklaroi se kur nuk kishte rrymë ata përdornin “bateritë e makinave për rrymë”.<sup>1104</sup>

538. Sidoqoftë, W04669 rikujtoi se, kur e morën në pyetje, dhoma e marrjes në pyetje ndriçohet prej një llambe.<sup>1105</sup> Gjithashtu, kur u pyet nga Mbrojtja nëse kishte rrymë në kompleksin e ndalimit në Zllash, W03594 u përgjigj: “lart ishte deri te poçi elektrik”, duke folur për të njëjtën dhomë të marrjes në pyetje.<sup>1106</sup> Dëshmitë e tyre mbështeten nga dëshmia e dëshmitares së Mbrojtjes znj. Hadri (WDSM1600), e cila deklaroi se më 17 prill 1999 ose rreth kësaj date, në kompleksin e ndalimit në Zllash kishte rrymë elektrike, së paku në mëngjes, sepse ajo shikonte televizor atje.<sup>1107</sup>

539. Duke marrë parasysh dëshmitë e lartpërmendura në tërësi dhe në bazë të dëshmisë së hollësishme dhe të besueshme të W01679-ës lidhur me goditjen e tij me rrymë elektrike, Trupi Gjykses konstaton se, gjatë prillit 1999, kishte rrymë elektrike edhe pse jo gjithmonë, përfshirë edhe kur W01679 u godit me rrymë elektrike. Faktikisht, W01679 dëshmoi se kur e goditën me rrymë elektrike “kanë pasë një farë si kuti”,<sup>1108</sup> që përputhet me mundësinë që kryesit të kenë përdorur një bateri makine në qoftë se në atë kohë nuk ka pasur rrymë elektrike. Për konstatimin e Trupit Gjykses në lidhje me W01679-ën është jorelevante nëse më vonë rryma elektrike u ndërpre tërësisht.

540. Së fundi, provat tregojnë se keqtrajtimi i shkaktoi W01679-ës lëndime fizike dhe psikologjike afatgjata. Dëshmitari dëshmoi se pësoi lëndime të shumta në kokë, djegie,

---

<sup>1104</sup> **Znj. Canolli-Kaçiu:** T. 12 maj 2022, publik, f. 4334, rreshtat 3-6.

<sup>1105</sup> **W04669:** T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1425, rreshtat 18-21.

<sup>1106</sup> **W03594:** T. 13 tetor 2021, publik, f.1184, rreshti 25 deri në f. 1185, rreshti 11. Ndonëse dëshmitari nuk tha shprehimisht se drita ishte e ndezur, ai deklaroi qartë se në kompleksin e ndalimit në Zllash kishte rrymë elektrike. Sipas mendimit të Trupit Gjykses, dëshmitari nuk mund ta dinte me kaq siguri se kishte rrymë elektrike në qoftë se drita nuk do të ishte e ndezur.

<sup>1107</sup> **Znj. Hadri:** T. 12 maj 2022, publik, f. 4292, rreshtat 9-19.

<sup>1108</sup> **W01679:** T. 4 tetor 2021, publik, f. 883, rreshti 19.

prerje dhe thyerje dhëmbësh nga rrahjet.<sup>1109</sup> Edhe sot e kësaj dite ai vuan nga dhimbje koke dhe dhimbje në pjesë të tjera të trupit, nuk mund të përdorë plotësisht [REDAKTUAR]<sup>1110</sup> dhe [REDAKTUAR].<sup>1111</sup> Në aspektin psikologjik, W01679 dëshmoi se vuan nga depresioni, ka probleme me gjumin dhe ka makthe, fanitje dhe kujtime tronditëse të pavullnetshme të keqtrajtimet.<sup>1112</sup> Ai shtoi se ka [REDAKTUAR].<sup>1113</sup> Më tej, ai shpjegoi se vuajtjet e pësuar në Zllash patën pasoja [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].<sup>1114</sup> Ai deklaroi: “me vjet s’kam pasë ndjenja”, “qysh 1999 ti je kanë i mbytë prej tyre”, “më ka bërë gjysë”.<sup>1115</sup> Dëshmia e W01679-ës konfirmohet fuqimisht nga [REDAKTUAR], që konstatoi një numër blanchash të cilat përkojnë me dhunën e ushtruar ndaj W01679-ës, dhe si simptoma të stresit pastraumatik (makthe dhe kujtime tronditëse, të pavullnetshme) si rezultat i dhunës së lartpërmendur.<sup>1116</sup>

541. *Identifikimi i të akuzuarit dhe anëtarëve të tjerë të BIA-s.* Megjithëse W01679 nuk e identifikoi të akuzuarin me emër dhe nuk e njihnte në atë kohë, Trupi Gjykses, për arsyet e dhëna më poshtë, është bindur se personi i cili mori fillimisht në pyetje dëshmitarin, e goditi me shuplakë dhe dha urdhër “Mbyte krejt” ishte i akuzuari. Së pari, W01679 dëshmoi se e çuan te komandanti i njësitit *Skifterat*,<sup>1117</sup> i cili thirrrej “komandant Cali”.<sup>1118</sup> Ai shpjegoi se këtë e dinte sepse: (i) ushtarët e UÇK-së të cilët e

<sup>1109</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 929, rreshti 12 deri në f. 930, rreshti 10; f. 944, rreshti 16 deri në f. 945, rreshti 10; T. 1 qershor 2022, konfidencial, f. 4453, rreshtat 3-4.

<sup>1110</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 946, rreshti 6 deri në f. 948, rreshti 11.

<sup>1111</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 942, rreshti 23 deri në f. 944, rreshti 15.

<sup>1112</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 929, rreshti 12 deri në f. 930, rreshti 10; T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 939, rreshti 24 deri në f. 940, rreshti 21; T. 5 tetor 2021, publik, f. 960, rreshtat 8-9; T. 1 qershor 2022, konfidencial, f. 4446, rreshtat 7-15; f. 4447, rreshtat 14-16; f. 4451, rreshtat 20-21; f. 4459, rreshtat 20-24; f. 4466, rreshtat 2-10; f. 4472, rreshti 21 deri në f. 4473, rreshti 13.

<sup>1113</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 941, rreshtat 22-23.

<sup>1114</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 941, rreshtat 11-23.

<sup>1115</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 941, rreshti 23; T. 1 qershor 2022, konfidencial, f. 4472, rreshti 23; f. 4473, rreshtat 7-8.

<sup>1116</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1117</sup> Trupi Gjykses rikujton se *Skifterat* është një emër tjetër me të cilin njihet BIA; *shih* para. 335.

<sup>1118</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 867, rreshtat 10-25.

arrestuan – dhe të cilët u prezantuan si Skifterat dhe mbanin emblemën e BIA-s – i thanë dëshmitarit se po e çonin te komandanti i tyre,<sup>1119</sup> dhe (ii) kur ishin atje, ai dëgjoji ushtarët t'i drejtoheshin atij “komandant” dhe “Cali”.<sup>1120</sup> Së dyti, W01679 rikujtoi se: (i) ai dëgjoji komandantin kur dha urdhrin “Mbyte krejt”, i cili u zbatua menjëherë nga ushtarët e BIA-s;<sup>1121</sup> dhe (ii) ushtarët e BIA-s iu drejtuan atij për udhëzime duke e pyetur: “Çfarë me bo Cal?”.<sup>1122</sup> Kjo dëshmi tregon pozitën e të akuzuarit si komandant i BIA-s. Trupi Gjykses kujton se i akuzuari ishte komandant i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s gjatë kuadrit kohor të akuzave.<sup>1123</sup> Ai vetë pranoi se përdorte nofkën “Cali”, që u konfirmua nga disa ish-anëtarë të UÇK-së.<sup>1124</sup> Së fundi, kur iu treguan fotografitë e të akuzuarit në sallën e gjyqit, W01679 e njohu pa mëdyshje të akuzuarin si “Cali”.<sup>1125</sup>

542. Trupi Gjykses nuk bindet nga argumenti i Mbrojtjes se dëshmia e W01679-ës nuk provon se komandanti i cili e mori në pyetje ishte i akuzuari, meqenëse ai nuk iu prezantua dëshmitarit si “komandant Cali”.<sup>1126</sup> Trupi Gjykses e konsideroi këtë jorelevante, duke marrë parasysh provat e shumta që tregojnë faktin se komandanti

<sup>1119</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 865, rreshti 11 deri në f. 866, rreshti 24; T. 5 tetor 2021, publik, f. 980, rreshtat 15-20.

<sup>1120</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 868, rreshtat 1-10; f. 873, rreshtat 16-18; f. 877, rreshtat 13-21; f. 882, rreshtat 3-12.

<sup>1121</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 869, rreshti 21 deri në f. 870, rreshti 1.

<sup>1122</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 877, rreshtat 13-21; T. 4 tetor 2021, publik, f. 882, rreshtat 9-12; T. 5 tetor 2021, publik, f. 981, rreshtat 10-11.

<sup>1123</sup> *Shih* para. 338; *shih më tej z. Mustafa*: 7000650-7000660, f. 7000651, 7000656; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 29, rreshtat 2-5; f. 31, rreshti 15 deri në f. 32, rreshti 14; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 24, rreshti 3 deri në f. 25, rreshti 12; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 7, f. 30, rreshtat 17-19; **z. F. Sopi**: T. 18 janar 2021, publik, f. 2060, rreshtat 4-7; **W04600**: T. 23 shtator 2021, publik, f. 718, rreshtat 17-23; **z. Veseli**: T. 25 janar 2021, publik, f. 2195, rreshti 25 deri në f. 2196, rreshti 2; **z. Ibishi**: T. 12 prill 2022, publik, f. 3550, rreshti 23 deri në f. 3551, rreshti 4; **z. Humolli**: T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2303, rreshtat 19-22.

<sup>1124</sup> *Shih* para. 340; *shih më tej z. Mustafa*: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, f. 4, rreshtat 19-25; **z. F. Sopi**: T. 18 janar 2021, publik, f. 2061, rreshtat 5-6; **W04600**: T. 23 shtator 2021, publik, f. 718, rreshtat 24-25; **z. Veseli**: T. 25 janar 2021, publik, f. 2196, rreshtat 3-6.

<sup>1125</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 1005, rreshtat 9-24; SPOE00222559 (dhe versioni i shënuar nga dëshmitari në sallën e gjyqit, REG00-008); SPOE00222547.

<sup>1126</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4785, rreshti 11 deri në f. 4787, rreshti 3.

në fjalë ishte i akuzuari. Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, i vetmi përfundim i arsyeshëm i bazuar në tërësinë e provave është se personi i cili e mori në pyetje i pari W01679-ën, e goditi atë me shuplakë dhe dha urdhrin “Mbyte krejt”, ishte i akuzuari.

543. Në lidhje me identitetet e kryesve të tjerë, W01679 identifikoi se personat që e keqtrajtuuan gjatë mbajtjes në ndalim ishin Fatmiri, Bimi, Dardani, Afrimi,<sup>1127</sup> Tabuti (për të cilin dëshmitari mësoi më vonë se quhej Nazif), Ilmi Vela dhe, një herë, edhe dy gra.<sup>1128</sup> W01679 deklaroi se ai i mësoi nofkat e tyre gjatë kohës në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1129</sup> Ai dëshmoi se, ndonëse herë pas here ishin me veshje civile, zakonisht ata mbanin uniforma me emblemën e BIA-s.<sup>1130</sup>

544. Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes,<sup>1131</sup> disa dëshmitarë të ZPS-së dhe të Mbrojtjes, si edhe vetë i akuzuari, konfirmuan se personat e identifikuar nga W01679 ishin anëtarë të BIA-s. Z. Mehmetaj, ish-anëtar i BIA-s,<sup>1132</sup> konfirmoi se në BIA ishte një person që thirrej Dardan<sup>1133</sup> dhe një tjetër Fatmir.<sup>1134</sup> Edhe z. Ajeti, ish-anëtar i BIA-s,<sup>1135</sup> dëshmoi në mënyrë të ngjashme se ai njihnte një person në BIA me nofken

<sup>1127</sup> Sipas asaj që kujtonte dëshmitari, goditjet me rrymë elektrike zakonisht i bënin Dardani dhe Afrimi; **W01679**: T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 987, rreshtat 11-15.

<sup>1128</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 866, rreshtat 18-21; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 867, rreshtat 18-21; f. 869, rreshtat 16-18; f. 886, rreshti 9 deri në f. 888, rreshti 8; T. 5 tetor 2021, publik, f. 984, rreshti 22 deri në f. 987, rreshti 15; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 1012, rreshtat 6-23 (ku shpjegoi se ushtarët që e rrahën ditën e parë ishin [REDAKTUAR] Fatmiri, Bimi, Dardani dhe Afrimi).

<sup>1129</sup> **W01679**: T. 5 tetor 2021, publik, f. 1012, rreshtat 6-19.

<sup>1130</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 887, rreshtat 12-21.

<sup>1131</sup> Mbrojtja parashtron se nuk ka asnjë lidhje ndërmjet të akuzuarit dhe këtyre personave, nuk ka prova se ata ishin në kompleksin e ndalimit në Zllash në atë periudhë dhe se ata nuk u identifikuan dhe intervistuan asnjëherë; *shih* T. 14 shtator 2022, publik, f. 4638, rreshtat 16-22. Faktin që disa nga kryesit u identifikuan vetëm me nofkë dhe jo me emër, Trupi Gjykses e gjykon jorelevant, pasi thelbësore është se ata ishin anëtarë të BIA-s dhe ishin të pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash.

<sup>1132</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2618, rreshtat 15-16.

<sup>1133</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2653, rreshti 25 deri në f. 2654, rreshti 4; f. 2715, rreshtat 1-15.

<sup>1134</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2714, rreshtat 17-23.

<sup>1135</sup> **Z. Ajeti**: T. 22 prill 2022, publik, f. 4056, rreshtat 17-21; f. 4057, rreshti 19; f. 4086, rreshtat 19-20; f. 4096, rreshtat 4-7.

Dardani.<sup>1136</sup> I akuzuari dhe disa dëshmitarë të ZPS-së dhe të Mbrojtjes, të gjithë ish-anëtarë të UÇK-së, konfirmuan se personi me nofkën Tabuti ishte anëtar i BIA-s me emrin Nazif Musliu.<sup>1137</sup> I akuzuari dhe z. Mehmetaj gjithashtu konfirmuan se Ilmi Vela, me nofkën Vdekja, ishte anëtar i BIA-s.<sup>1138</sup> Së fundi, Trupi Gjykses rikujton se Bimi është vetë z. Mehmetaj.<sup>1139</sup> Dëshmitë e mësipërme konfirmojnë njëra-tjetrën dhe vijnë prej personave me njohuri të brendshme për UÇK-në, dhe në veçanti për BIA-n, duke përfshirë edhe të akuzuarin. Trupi Gjykses nuk mund të identifikojë ndonjë arsye pse i akuzuari dhe të gjithë këta dëshmitarë ta trillonin një informacion të tillë përputhës. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i konsideron këto dëshmi të besueshme dhe mbështetet në to.

545. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se, gjatë mbajtjes në ndalim në kompleksin e ndalimit në Zllash, W01679 u mor në pyetje dhe u akuzua si spiun, gënjeshtar dhe hajdut dhe u keqtrajtua rëndë nga anëtarë të BIA-s, ndër të cilët dhe i akuzuari.

ii. W03593

546. *Marrja në pyetje dhe keqtrajtimi.* Provat e administruara prej Trupit Gjykses tregojnë se W03593 u rrah për herë të parë ditën kur e sollën në kompleksin e ndalimit në Zllash. W03593 dëshmoi se, vetëm një orë pasi arriti në kompleksin e ndalimit në Zllash, atë e morën nga ahuri dhe e rrahën disa anëtarë të BIA-s në praninë e të

---

<sup>1136</sup> **Z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4108 deri në f. 4109, rreshti 6.

<sup>1137</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 8, f. 9, rreshti 20 deri në f. 10, rreshti 13; **z. F. Sopi:** T. 18 janar 2022, publik, f. 2077, rreshtat 8-18; T. 19 janar 2022, konfidencial, f. 2133, rreshtat 17-21; **z. Veseli:** T. publik, f. 2202, rreshtat 1-16; **z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2712, rreshti 12 deri në f. 2713, rreshti 8; **z. Ajeti:** T. 22 prill 2022, publik, f. 4107, rreshtat 11-19; **W04600:** T. 24 shtator 2021, publik, f. 764, rreshtat 3-21.

<sup>1138</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 8, f. 10, rreshti 17 deri në f. 12, rreshti 16; **z. Mehmetaj:** T. 23 mars 2022, publik, f. 2705, rreshti 22 deri në f. 2706, rreshti 24.

<sup>1139</sup> [REDAKTUAR].



akuzuarit.<sup>1140</sup> Atë e goditën me shkelma, me një copë druri, dhe e akuzuan se bashkëpunonte me serbët.<sup>1141</sup> Dëshmitari bëri një përshkrim shumë të gjallë të momentit kur i akuzuari ia vuri revolverin në kokë dhe tërhoqi këmbëzën. Ndonëse nuk doli plumb, dëshmitari pati përshtypjen se do ta vrisnin. I akuzuari u tha anëtarëve të tjerë të BIA-s: “Lëshone tha, se paska fat, ta lemë këtë”.<sup>1142</sup> Dëshmitari kujtoi se atë e rrahën për orë të tëra dhe kaq rëndë sa i ra të fikët disa herë.<sup>1143</sup> Ai dëshmoi – në një mënyrë që sipas mendimit të Trupit Gjykses tregon për vuajtjet ekstreme që përjetoi – se në ato momente dëshironte që më mirë ta vrisnin, që të shpëtonte nga vuajtjet.<sup>1144</sup>

547. Në një incident tjetër, më 11-12 prill 1999 ose rreth këtyre datave,<sup>1145</sup> W03593 rikujtoi se ushtarë të BIA-s e morën nga ahuri dhe e çuan në dhomën e marrjes në pyetje lart. Atje, i akuzuari e kërcënoi se do ta vriste dhe e pyeti për identitetet e hajdutëve.<sup>1146</sup> Kur W03593 u përgjigj se nuk i njihnte, i akuzuari filloi ta rrihte duke e goditur vazhdimisht me shkop bejsbolli në të gjithë trupin.<sup>1147</sup> Rrahja zgjati midis

---

<sup>1140</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 401, rreshti 24 deri në f. 402, rreshti 8; f. 407, rreshtat 6-14; f. 408, rreshtat 8-25; f. 414, rreshtat 15-20; f. 431, rreshtat 8-10.

<sup>1141</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 409, rreshti 1 deri në f. 410, rreshti 1.

<sup>1142</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 411, rreshti 17 deri në f. 412, rreshti 19; f. 413, rreshtat 14-19; T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 414, rreshti 25 deri në f. 415, rreshti 6.

<sup>1143</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 409, rreshtat 1-7; f. 411, rreshtat 1-16; f. 413, rreshtat 14-19; f. 414, rreshtat 15-20.

<sup>1144</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 412, rreshtat 18-19.

<sup>1145</sup> W03593 dëshmoi se ky incident ndodhi 7 ose 8 ditë para se të lirohej; *shih* **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 439, rreshtat 2-4. Trupi Gjykses përmend konstatimet e tij të mëparshme se W03593 u lirua më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date; *shih* para. 426.

<sup>1146</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 419, rreshti 15 deri në f. 421, rreshti 2; T. 20 shtator 2021, publik, f. 428, rreshtat 20-23.

<sup>1147</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 419, rreshti 15 deri në f. 420, rreshti 12; f. 425, rreshti 23 deri në f. 426, rreshti 17; T. 20 shtator 2021, publik, f. 428, rreshtat 20-23.



gjysmë ore deri në një orë, pas së cilës i akuzuari urdhëroi dy ushtarë të tjerë të BIA-s ta kthenin dëshmitarin në ahur.<sup>1148</sup>

548. Dëshmia e W03593-shit për keqtrajtimin e pësuar ishte bindëse dhe e gjallë dhe Trupi Gjykues nuk ka dyshim se ajo bazohet në përvojën personale të dëshmitarit. Dëshmia e W03593-shit se e akuzonin se ishte bashkëpunëtor i serbëve u konfirmua nga W03594, i cili dëshmoi se W03593 u akuzua si spiun, gjë që W03594-ës iu duk qesharake.<sup>1149</sup> Në lidhje me incidentin e dytë, Trupi Gjykues mbështetet gjithashtu në dëshminë konfirmuese të W01679-ës, i cili dëshmoi se W03593 u çua në dhomën e marrjes në pyetje lart dhe u rrah.<sup>1150</sup> Ai dëshmoi gjithashtu se W03593 “nuk ka qenë në gjendje të mirë” kur u lirua.<sup>1151</sup> Më tej, W04391 dëshmoi se pa shenja rrahjeje në fytyrë dhe në trup të gjithë të ndaluarit [REDAKTUAR] ditën që u liruan dhe këtu përfshihej edhe W03593.<sup>1152</sup>

549. Trupi Gjykues dëgjoi gjithashtu dëshmi të ndryshme nga W03594, i cili dëshmoi se W03593 ishte mirë dhe nuk kishte lëndime kur u lirua.<sup>1153</sup> Sidoqoftë, dëshmia e W03594-ës përgënjeshtrohet qartë nga dëshmitë tërësisht të besueshme dhe përputhëse të W03593-shit, W01679-ës dhe W04391-shit. Po kështu, dëshmia e tij nuk përputhet me atë që ai vetë e kishte pranuar më parë se W03593-shin e akuzonin se ishte spiun, kur mbahet parasysh praktika e akuzave dhe e keqtrajtimit të të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash që del nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të

---

<sup>1148</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 419, rreshti 15 deri në f. 421, rreshti 2; f. 425, rreshti 23 deri në f. 426, rreshti 17; f. 429, rreshti 25 deri në f. 430, rreshti 1; f. 438, rreshti 12 deri në f. 439, rreshti 7; T. 20 shtator 2021, publik, f. 428, rreshtat 20-23.

<sup>1149</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1048, rreshti 4 deri në f. 1049, rreshti 18.

<sup>1150</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 895, rreshti 16 deri në f. 896, f. 6.

<sup>1151</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 907, rreshti 5.

<sup>1152</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1742, rreshti 18 deri në f. 1743, rreshti 3; f. 1782, rreshtat 3-14; T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1744, rreshtat 9-17; T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1819, rreshtat 6-8.

<sup>1153</sup> **W03594**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1192, rreshtat 1-4.

ndaluar atje. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk i jep peshë këtij aspekti të dëshmisë së W03594-ës.

550. Së fundi, provat tregojnë se keqtrajtimi i shkaktoi W03593-shit lëndime fizike dhe psikologjike afatgjata. Dëshmitari dëshmoi se prej rrahjeve atij [REDAKTUAR]. Këto lëndime cenuan aftësinë e tij për punë [REDAKTUAR] dhe ende i shkaktojnë dhimbje të forta dhe të vazhdueshme edhe sot e kësaj dite.<sup>1154</sup> Ai deklaroi çiltërisht: “Më dhemb krejt trupi, më dhemb. Nuk ka vend që s’më dhemb shumë herë” dhe tregoi se ende nuk është tërësisht i shëruar edhe sot e kësaj dite.<sup>1155</sup> Ai shtoi se, psikologjikisht, u ndje i humbur gjatë mbajtjes në ndalim, sepse nuk e dinte çfarë po ndodhte me të.<sup>1156</sup> Ai gjithashtu u ndje i turpëruar pas lirimit dhe se, edhe sot e kësaj dite, ka vështirësi me gjumin dhe përjeton makthe lidhur me kohën kur u mbajt i ndaluar dhe u keqtrajtua në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1157</sup> Dosja mjekësore e W03593-shit konfirmon dëshminë e tij për lëndimin [REDAKTUAR] dhe vështirësitë në lidhje me gjumin.<sup>1158</sup>

551. *Identifikimi i të akuzuarit dhe anëtarëve të tjerë të BIA-s.* Ndonëse W03593 nuk e identifikoi të akuzuarin me emër, për arsyet e dhëna më poshtë, Trupi Gjykses është

---

<sup>1154</sup> **W03593:** T. 20 shtator 2021, publik, f. 409, rreshtat 1-7; T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 425, rreshti 23 deri në f. 426, rreshti 1; f. 420, rreshtat 2-3; T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 523, rreshti 7 deri në f. 526, rreshti 11; f. 528, rreshti 9 deri në f. 530, rreshti 5; f. 537, rreshti 7 deri në f. 538, rreshti 22; f. 541, rreshtat 5-8; f. 542, rreshtat 15-25; T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 642, rreshti 18 deri në f. 646, rreshti 3.

<sup>1155</sup> **W03593:** T. 21 shtator 2021, publik, f. 526, rreshti 9; T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 541, rreshtat 5-12.

<sup>1156</sup> **W03593:** T. 20 shtator 2021, publik, f. 481, rreshtat 2-5.

<sup>1157</sup> **W03593:** T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 529, rreshti 19 deri në f. 530, rreshti 5; f. 541, rreshtat 9-12; T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 642, rreshti 18 deri në f. 644, rreshti 15.

<sup>1158</sup> SITF00296103-SITF00296121-ET RED3, f. SITF00296103, SITF00296104. Trupi Gjykses vë në dukje se, sipas dosjes mjekësore të W03593-shit, ai e kishte pësuar lëndimin [REDAKTUAR] pasi rrëshqiti në akull. Dëshmitari shpjegoi në sallën e gjyqit se i kishte thënë mjekut se ishte lënduar ashtu sepse kishte turp dhe frikë të thoshte se ishte keqtrajtuar nga UÇK-ja. Trupi Gjykses gjykon se shpjegimi i dëshmitarit është bindës dhe nuk mendon se kjo mospërputhje cenon dëshminë e tij, e cila në aspektet e tjera është autentike dhe në të cilën mund të mbështetet.

bindur se personi i cili i vuri revolverin në kokë gjatë incidentit të parë dhe i cili e rrahu dhe e mori në pyetje gjatë incidentit të dytë është i akuzuari. Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes,<sup>1159</sup> W03593 shpjegoi me hollësi si e identifikoi të akuzuarin. Së pari, W03593 dëshmoi se, ndonëse nuk e njohte të akuzuarin në atë kohë dhe nuk mundi ta shihte si duhej pasi ishte terr,<sup>1160</sup> ai pa se i akuzuari mbante një kapele të kuqe në të dyja herët.<sup>1161</sup> Dëshmitari shpjegoi në mënyrë bindëse se ishte deri diku në gjendje të shihte rreth e rrotull, sepse anëtarët e BIA-s kishin llamba dore dhe atij nuk ia kishin mbuluar kokën me thes kur e rrahën.<sup>1162</sup> Ai deklaroi qartësisht: “Kur m’kanë rrah, kom kqyr njëherë, e kom pa vetëm një person i cili i akuzuari asht që ka pasë kapelën e kuqe” dhe s’kom pa me kapele të kuqe. Vetëm ky” “herën e parë, edhe herën e dytë”.<sup>1163</sup> Së dyti, dëshmitari dëshmoi se personi me kapelë të kuqe “a kon kryesori aty” dhe ushtarët e tjerë “pa thënë i akuzuari ata s’kanë bërë kurrjë”.<sup>1164</sup> Ai gjithashtu deklaroi, në lidhje me të njëjtën gjë, se e dëgjoi duke u dhënë urdhra ushtarëve të tjerë të BIA-s, që ushtarët i zbatuan, dhe dëgjoi se e thërrisnin “komandant”.<sup>1165</sup> Së treti, kur iu lexuan pjesë nga deklarata e tij për ZPS-në për ta

---

<sup>1159</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4695, rreshti 3 deri në f. 4697, rreshti 5; f. 4712, rreshtat 6-23; T. 15 shtator 2022, publik, f. 4787, rreshti 4 deri në f. 4790, rreshti 11.

<sup>1160</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 413, rreshtat 9-11; T. 20 shtator 2021, publik, f. 420, rreshtat 13-16; T. 22 shtator 2021, publik, f. 583, rreshti 19 deri në f. 585, rreshti 3.

<sup>1161</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 413, rreshtat 4-6; T. 20 shtator 2021, publik, f. 420, rreshtat 13-21; f. 421, rreshtat 14-19; f. 432, rreshtat 3-10; T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 428, rreshti 24 deri në f. 429, rreshti 12; T. 23 shtator 2021, publik, f. 695, rreshtat 21-25; f. 697, rreshti 12 deri në f. 698, rreshti 3.

<sup>1162</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 410, rreshtat 15-21; T. 22 shtator 2021, publik, f. 580, rreshtat 10-14.

<sup>1163</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 429, rreshtat 6-12; T. 22 shtator 2021, publik, f. 698, rreshtat 2-3.

<sup>1164</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 413, rreshti 23 deri në f. 414, rreshti 11; T. 22 shtator 2021, publik, f. 583, rreshti 19 deri në f. 585, rreshti 3; f. 586, rreshtat 10-18.

<sup>1165</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 413, rreshtat 14-19; T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 510, rreshti 12 deri në f. 511, rreshti 5; T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 656, rreshti 18 deri në f. 657, rreshti 9. Ndonëse dëshmitari ndonjëherë deklaroi, në mënyrë në dukje kontradiktore, se nuk e kishte dëgjuar të akuzuarin duke dhënë urdhra (*shih* T. 20 shtator 2021, publik, f. 429, rreshti 18 deri në f. 430, rreshti 8), nga dëshmia e tij, e lexuar në tërësi, është e qartë se ai e dëgjoi atë të jepte urdhra në të dy rastet. Kjo mospërputhje në dukje nuk e cenon besueshmërinë e tij dhe mund të jetë shkaktuar nga fakti se dëshmitarit iu bë e njëjta pyetje disa herë, duke e çorientuar.

ndihmuar të rikujtonte ngjarjet, W03593 konfirmoi se dëgjoi ushtarë të tjerë të BIA-s që e thërrisnin “Cali”.<sup>1166</sup> Dëshmia e dëshmitarit ishte përputhëse gjatë pyetjeve (të shumta) nga ZPS-ja dhe Mbrojtja në lidhje me këtë temë, si edhe nga Trupi Gjykses. Ai nuk i ekzagjeroi dhe i bëri të qarta aspektet për të cilat kishte besim se i mbante mend dhe ato që nuk i mbante mend.<sup>1167</sup>

552. Trupi Gjykses rikujton se sipas vetë të akuzuarit, për një kohë ai mbante një beretë të kuqe dhe ishte i vetmi në Zllash që mbante një të tillë.<sup>1168</sup> Kjo u konfirmua edhe nga W04600, i cili deklaroi se në më të shumtën e kohës “komandant Cali” mbante uniformë dhe kapelë të kuqe.<sup>1169</sup> Trupi Gjykses gjithashtu ka parë disa foto të të akuzuarit me beretë të kuqe.<sup>1170</sup> Më tej, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet të mëparshëm se i akuzuari ishte komandanti i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s gjatë periudhës që mbulojnë akuzat dhe kishte nofkën “Cali”.<sup>1171</sup>

<sup>1166</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 432, rreshti 20 deri në f. 438, rreshti 11.

<sup>1167</sup> *Shih, për shembull, W03593*: T. 20 shtator 2021, publik, f. 413, rreshti 23 deri në f. 414, rreshti 11; T. 23 shtator 2021, publik, f. 697, rreshti 12 deri në f. 698, rreshti 3. Megjithëse dëshmitari refuzoi ta shqiptonte emrin e të akuzuarit në sallën e gjyqit (*shih* T. 20 shtator 2021, publik, f. 412, rreshti 20 deri në f. 413, rreshti 1; T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 433, rreshti 19 deri në f. 434, rreshti 6; T. 21 shtator 2021, publik, f. 519, rreshti 18 deri në f. 520, rreshti 4; T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 521, rreshti 25 deri në f. 522, rreshti 10), kjo nuk është juridikisht thelbësore pasi nga dëshmia e tij del qartë se individi për të cilin e kishte fjalën është i akuzuari. Refuzimi i tij për të thënë emrin e të akuzuarit mund të shpjegohet me traumën që pësoi dëshmitari si rezultat i rrahjes prej tij personalisht. Vetë dëshmitari shpjegoi se: “Se po t’ja përmend emrin me dhemb kryt menjëherë” (*shih* T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 522, rreshtat 1-2).

<sup>1168</sup> *Shih* para. 341; **z. Mustafa**: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 3, f. 27, rreshtat 9-12; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 4, f. 3, rreshtat 1-3; 069404-TR-ET Part (Pjesa) 8, f. 8, rreshtat 5-7.

<sup>1169</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, publik, f. 765, rreshtat 7-14.

<sup>1170</sup> 082249-082258, f. 082256; SPOE00222549-00222549; SPOE00222550-00222550; SPOE00222551-00222551; SPOE00222552-00222552; SPOE00222554-00222554; SPOE00222556-00222556; SPOE00222557-00222557; SPOE00222563-00222563; SPOE00222565-00222565; SPOE00222567-00222567; SPOE00222568-00222568; SPOE00222569-00222569; SPOE00222570-00222570; SPOE00222572-00222572; SPOE00222582-00222582; SPOE00222585-00222585; SPOE00222589-00222589; SPOE00222600-00222600; SPOE00222602-00222602; SPOE00222619-00222619; SPOE00222639-00222639; SPOE00222682-00222682; SPOE00222688-00222688; SPOE00222695-00222695; SPOE00222590-00222590.

<sup>1171</sup> *Shih* para. 338-340.

553. Trupi Gjykues mban parasysh se W03593 dha dëshmi paska të ndryshme në deklaratën [REDAKTUAR]. Në atë deklaratë, e cila iu tregua dëshmitarit në sallën e gjyqit, W03593 deklaroi se personi i cili i vuri revolverin në kokë mbante maskë, dhe se ai nuk e dinte kush ishte komandant në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1172</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykues nuk konstaton se kjo e cenon besueshmërinë e dëshmitarit ose mbështetshmërinë në dëshminë e tij. Së pari, Trupi Gjykues thekson se W03593 deklaroi në mënyrë përputhëse, si në sallën e gjyqit po ashtu dhe në deklaratën e tij për ZPS-në, se personat që e rrahën nuk i kishin fytyrat e mbuluara.<sup>1173</sup> Së dyti, fakti nëse i akuzuari mbante ose nuk mbante maskë nuk është i rëndësishëm për konstatimin e Trupit Gjykues, sepse dëshmitari e identifikoi atë jo mbi bazën e tipareve të fytyrës, por duke u bazuar në çfarë mbante në kokë, në rolin dhe pushtetin e tij mbi kryesit e tjerë dhe në nofkën e tij. Së treti, po ashtu nuk është relevante nëse i akuzuari e dinte se kush ishte komandant në kompleksin e ndalimit në Zllash, duke qenë se Trupi Gjykues ka marrë prova të shumta që vërtetojnë në mënyrë të pavarur se ishte i akuzuari.<sup>1174</sup>

554. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykues gjykon se i vetmi përfundim i arsyeshëm, i bazuar në tërësinë e provave, është se personi i cili i vuri revolverin në kokë W03593-shit gjatë incidentit të parë dhe i cili e rrahu dhe e mori në pyetje gjatë incidentit të dytë është i akuzuari.

555. Sa për kryesit e tjerë, edhe pse dëshmitari nuk i përshkroi më tej (të gjithë ata) me (nofkë) emër, pamje ose veshje, për arsyet e dhëna më poshtë, Trupi Gjykues është bindur se ata ishin anëtarë të njësitit BIA. Së pari, W03593 rikujtoi se kishte dëgjuar se

---

<sup>1172</sup> **W03593**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 676, rreshti 20 deri në f. 681, rreshti 15, *i referohet* SPOE00127751-00127769 RED4, në SPOE00127752, SPOE00127756.

<sup>1173</sup> **W03593**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 676, rreshti 23 deri në f. 677, rreshti 23, *i referohet* 061015-TR-ET Part (Pjesa) 2 Revised (Rishikuar) RED3, f. 5, rreshtat 6-7.

<sup>1174</sup> *Shih* para. 338.

njëri prej tyre thirrej "Tabuti" ose "Tabut".<sup>1175</sup> I njëjti person u identifikua edhe nga W01679 si një prej kryesve dhe, sikurse u konstatua më lart, ishte anëtar i BIA-s.<sup>1176</sup> Së dyti, W03593 u keqtrajtua me të njëjtat mjete si W01679 (si për shembull, shkop bejsbolli) dhe, ashtu si W01679, u akuzua si bashkëpunëtor i serbëve – që zbulon një mënyrë veprimi të ngjashme. Së treti, ushtarët të cilët e keqtrajtuan vepruan nën autoritetin e të akuzuarit,<sup>1177</sup> gjë që tregon se ishin vartës të tij dhe rrjedhimisht, anëtarë të BIA-s. Së katërti, në kohën përkatëse, kompleksi i ndalimit në Zllash kontrollohej nga BIA dhe për rrjedhojë, nga i akuzuari.<sup>1178</sup> Së fundi, W03593 dëshmoi se ushtarët flisnin shqip.<sup>1179</sup> Trupi Gjykses mendon se përfundimi i vetëm i arsyeshëm, duke u bazuar në tërësinë e provave, është se personat të cilët rrahën W03593-shin ishin anëtarë të BIA-s.

556. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se gjatë mbajtjes në ndalim në kompleksin e ndalimit në Zllash, W03593 u mor në pyetje, u akuzua si bashkëpunëtor i serbëve, u kërcënua me vdekje dhe u keqtrajtua rëndë nga anëtarë të BIA-s, ndër të cilët edhe i akuzuari.

### iii. W03594

557. W03594 dëshmoi në sallën e gjyqit se nuk u keqtrajtua asnjëherë fizikisht gjatë mbajtjes në ndalim.<sup>1180</sup> Sidoqoftë, provat e administruara prej Trupi Gjykses tregojnë, sikurse shpjegohet më poshtë, se ai u keqtrajtua si në ahur, po ashtu dhe në dhomën e marrjes në pyetje lart.

---

<sup>1175</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 430, rreshti 21 deri në f. 431, rreshti 19; T. 22 shtator 2021, publik, f. 583, rreshtat 5-14.

<sup>1176</sup> *Shih* para. 543-544.

<sup>1177</sup> *Shih* para. 551.

<sup>1178</sup> *Shih* para. 352-353.

<sup>1179</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 410, rreshtat 6-8.

<sup>1180</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1067, rreshtat 8-14; T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1072, rreshti 25 deri në f. 1075, rreshti 7.

558. W03594 – i cili ishte anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)<sup>1181</sup> – pranoi në sallën e gjyqit, pasi iu tregua deklarata e tij për ZPS-në, se një herë e kishin goditur në duar me “një shufër druri, një shufër të hollë”, në ahur. Ai shtoi se nuk kishte qenë e dhimbshme, [REDAKTUAR].<sup>1182</sup> Megjithëse Trupi Gjykses nuk dyshon se W03594 tha të vërtetën kur deklaroi se ishte goditur, sepse nuk kishte arsye për të gënjer në lidhje me këtë, Trupi Gjykses nuk e konsideron dëshminë e tij të besueshme në lidhje me shkallën e keqtrajtimit për arsyet e mëposhtme.

559. Së pari, Trupi Gjykses thekson se në deklaratën e tij për ZPS-në dëshmitari deklaroi se ishte goditur disa herë me një “shkop prej gome të trashë”.<sup>1183</sup> Kur iu tregua kjo deklaratë në sallën e gjyqit, W03594 e ndryshoi dëshminë e tij pa dhënë shpjegim, duke deklaruar se në fakt nuk ishte shkop *i trashë* por *i hollë*. Ai gjithashtu deklaroi se nuk e dinte nëse ishte shkop gome apo “shkop druri”.<sup>1184</sup> Së dyti, Trupi Gjykses e konsideron të pagjasë që pas disa goditjeve dëshmitari nuk ndjeu dhimbje, [REDAKTUAR], sikurse deklaroi vetë dëshmitari. Së fundi, dëshmia e W03594-ës bie ndesh me dëshminë tërësisht të besueshme dhe të mbështetshme të W03593-shit, dhe nuk përputhet me praktikën e keqtrajtimit që del prej dëshmive të të gjithë dëshmitarëve të tjerë të mbajtur në kompleksin e ndalimit në Zllash. W03593 dëshmoi se W03594 u keqtrajtua në ahur njësoj si të gjithë të ndaluarit e tjerë dhe deklaroi: “Shuplakën e ka hongër edhe ai sikur unë njëjtë”, “sa herë na kanë vre t’tanëve ato, jena konë aty krejt mrena, nuk na kanë zgjedh “kush je ti, kush a ai” po rend na kanë

---

<sup>1181</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1032, rreshti 17 deri në f. 1033, rreshti 6.

<sup>1182</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1067, rreshti 15 deri në f. 1070, rreshti 19; T. 14 tetor 2021, publik, f. 1245, rreshti 22 deri në f. 1246, rreshti 2.

<sup>1183</sup> **W03594**: 061016-TR-ET Part (Pjesa) 4 RED1, f. 2, rreshtat 7-25 (theksimi i shtuar).

<sup>1184</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 1070, rreshtat 12-13.



hyrë e na kanë rreh.”<sup>1185</sup> W03593 gjithashtu rikujtoi se W03594 i kishte treguar se kishte dhimbje në krah dhe në këmbë.<sup>1186</sup>

560. Trupi Gjykues mendon se W03594 e minimizoi shkallën e keqtrajtimit që pësoi<sup>1187</sup> dhe, duke u bazuar në tërësinë e provave, konstaton se W03594 u godit së paku një herë në ahur nga anëtarë të BIA-s, që i shkaktuan dhimbje.

561. Në lidhje me keqtrajtimin që pësoi në dhomën e marrjes në pyetje, W03594 deklaroi në sallën e gjyqit se afërsisht një javë pasi u arrestua, e morën nga ahuri dhe e çuan në dhomën e marrjes në pyetje lart, ku një numër ushtarësh të BIA-s i bënë pyetje në lidhje me shpërndarjen e ndihmave. Dëshmitari këmbënguli se kjo ishte bisedë miqësore dhe se ushtarët e BIA-s e trajtuan njerëzisht.<sup>1188</sup> Edhe njëherë, Trupi Gjykues nuk dyshon në vërtetësinë e dëshmisë së W03594-ës në lidhje me faktin e pranuar prej tij se e çuan në dhomën e marrjes në pyetje. Sidoqoftë, për arsyet e mëposhtme, Trupi Gjykues nuk e konsideron të besueshme deklaratën e tij se ai u trajtua njerëzisht.

562. Së pari, dëshmia e W03594-ës bie ndesh me dëshminë tërësisht të besueshme dhe të mbështetshme të W01679-ës, i cili dëshmoi se W03594 u mor nga ahuri dhe u çua në dhomën e marrjes në pyetje lart, ku u keqtrajtua.<sup>1189</sup> Ai rikujtoi se pa shenja (të

---

<sup>1185</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 453, rreshtat 17-21; T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 576, rreshti 9 deri në f. 577, rreshti 1. Trupi Gjykues është i vetëdijshëm se W01679 dëshmoi se, ndryshe nga të ndaluarit e tjerë, W03594 nuk u keqtrajtua asnjëherë në ahur (*shih* **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 894, rreshtat 10-20; f. 896, rreshtat 3-5). Gjithsesi, Trupi Gjykues i jep pak peshë dëshmisë së tij lidhur me këtë pikë, duke marrë parasysh: (i) praktikën e keqtrajtimit në kompleksin e ndalimit në Zllash, e konfirmuar nga dëshmitë e disa dëshmitarëve, përfshirë W01679-ën; (ii) dëshminë e W03593-shit që përmendet më lart, e cila përputhet me këtë praktikë; dhe (iii) faktin që vetë W03594 pranoi që e rrahën një herë. Dëshmia e ndryshme e W01679-ës fare mirë mund të shpjegohet me kohën që ka kaluar.

<sup>1186</sup> **W03593**: T. 22 shtator 2021, publik, f. 577, rreshtat 2-8.

<sup>1187</sup> *Shih gjithashtu* para. 78-83.

<sup>1188</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1044, rreshti 2 deri në f. 1045, rreshti 13; f. 1072, rreshti 25 deri në f. 1075, rreshti 25; f. 1080, rreshti 3 deri në f. 1089, rreshti 13; T. 13 tetor 2021, publik, f. 1198, rreshtat 11-22; f. 1213, rreshtat 18-25.

<sup>1189</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 894, rreshtat 10-20.

dukshme) të keqtrajtimit të W03594-ës kur e kthyen në ahur dhe se ai ishte në “një gjendje shumë, shumë të mjerueshme”.<sup>1190</sup> W01679 gjithashtu rikujtoi se “kur e kanë torturu”, W03594-ën e kishin akuzuar se [REDAKTUAR]. W01679 e dëgjoi këtë nga ahuri poshtë, si edhe nga W03594 kur ishin së bashku në ndalim.<sup>1191</sup>

563. Së dyti, dëshmia e W03594-ës bie ndesh edhe me dëshminë e W04391-shit, i cili dëshmoi se pa shenja të rrahjeve në fytyrën dhe trupin e W03594-ës [REDAKTUAR].<sup>1192</sup>

564. Së treti, dëshmia e W03594-ës nuk përputhet me praktikën e keqtrajtimit që del nga dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve të tjerë të mbajtur në kompleksin e ndalimit në Zllash, të cilët u çuan rregullisht në dhomën e marrjes në pyetje, u morën në pyetje dhe u keqtrajtuan brutalisht. Trupi Gjykues e konsideron tërësisht të pagjasë që W03594 të jetë mbajtur në të njëjtat kushte si të gjithë të ndaluarit e tjerë, të jetë çuar në dhomën e marrjes në pyetje, të jetë akuzuar se ishte [REDAKTUAR] LDK dhe megjithatë, “kemi fol si me shokë” me anëtarët e BIA-s.

---

<sup>1190</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 894, rreshtat 21-24; T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 896, rreshtat 14-19.

<sup>1191</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 893, rreshti 21 deri në f. 894, rreshti 9; T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 992, rreshti 8 deri në f. 993, rreshti 4. Trupi Gjykues është i vetëdijshëm se W03593 dëshmoi se W03594 nuk u mor asnjëherë nga ahuri (*shih* **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 453, rreshtat 22-25; T. 22 shtator 2021, konfidencial, f. 576, rreshti 9 deri në f. 577, rreshti 1). Gjithsesi, Trupi Gjykues nuk i kushton shumë rëndësi dëshmisë së tij në këtë pikë duke marrë parasysh: (i) praktikën e keqtrajtimit në kompleksin e ndalimit në Zllash, e konfirmuar nga dëshmitë e disa dëshmitarëve, përfshirë W03593-shin; (ii) dëshminë e W0169-ës të kujtuar më lart, e cila përputhet me këtë praktikë; dhe (iii) fakti që vetë W03594 pranoi që një herë e çuan në dhomën e marrjes në pyetje sipër ahurit. Trupi Gjykues gjykon se dëshmia devijuese e W03593-shit mund të shpjegohet fare mirë me kohën që ka kaluar.

<sup>1192</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1742, rreshti 18 deri në f. 1743, rreshti 3; T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1744, rreshtat 9-17; T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1819, rreshtat 6-8.

565. Së fundi, dëshmia e W03594-ës nuk përputhet as me pranimin prej tij se ai kishte frikë për jetën gjatë kohës që ishte në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe nuk e dinte nëse e nesërmja do ta gjente të gjallë ose të vdekur.<sup>1193</sup>

566. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses gjykon se i vetmi përfundim i arsyeshëm, bazuar në tërësinë e provave, është se W03594 u keqtrajtua rëndë nga anëtarë të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash kur e çuan në dhomën e marrjes në pyetje, ku u akuzua se ishte [REDAKTUAR].

iv. W04669

567. W04669 – i cili ishte përkrahës i LDK-së<sup>1194</sup> – dëshmoi se gjatë kohës kur ishte i ndaluar, ai u çua një herë në dhomën e marrjes në pyetje.<sup>1195</sup> Dëshmitari tregoi se u mor në pyetje nga dy ushtarë të BIA-s, në praninë e dy deri katër anëtarëve të tjerë të BIA-s, në lidhje me [REDAKTUAR] që mbante, e cila iu gjet dhe konfiskua kur e çuan në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1196</sup> W04669 dëshmoi se u akuzua si spiun, gënjeshtar dhe bashkëpunëtor i serbëve.<sup>1197</sup> Më tej, dy ushtarë të BIA-s i thanë të zhvishej në pjesën e sipërme të trupit dhe e goditën në shpinë 10-12 herë me një shkop gome, duke i shkaktuar mavijosje në krejt shpinën.<sup>1198</sup> W04669 e përshkroi incidentin me hollësi, konkretisht (duke treguar vendet ku ishte goditur në shpinë), në mënyrë koherente dhe pa ekzagjerime. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e konsideron dëshminë e

---

<sup>1193</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, publik, f. 1066, rreshtat 9-12; f. 1066, rreshtat 21-22; f. 1067, rreshtat 3-7; T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1086, rreshti 4 deri në f. 1087, rreshti 3; T. 13 tetor 2021, publik, f. 1136, rreshtat 14-16.

<sup>1194</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1390, rreshtat 15-21.

<sup>1195</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1445, rreshtat 7-16; f. 1449, rreshtat 2-12.

<sup>1196</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1415, rreshti 24 deri në f. 1416, rreshti 4; f. 1443, rreshti 15 deri në f. 1444, rreshti 5; f. 1446, rreshtat 1-7.

<sup>1197</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1443, rreshti 11 deri në f. 1444, rreshti 5.

<sup>1198</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1444, rreshti 6 deri në f. 1448, rreshti 16; f. 1449, rreshti 5 deri në f. 1451, rreshti 3; f. 1468, rreshti 20 deri në f. 1470, rreshti 8; T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1506, rreshtat 11-16.

tij tejet të besueshme.<sup>1199</sup> Dëshmia e W04669-ës konfirmohet nga W01679 në lidhje me akuzuat që iu bënë.<sup>1200</sup> Së fundi, W04669 dëshmoi se mbajtja e tij në ndalim në Zllash ndikoi edhe në [REDAKTUAR] e tij [REDAKTUAR].<sup>1201</sup>

568. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se gjatë mbajtjes në ndalim në kompleksin e ndalimit në Zllash, W04669 u mor në pyetje, u akuzua si spiun, gënjeshtar dhe bashkëpunëtor i serbëve, dhe u keqtrajtua rëndë nga anëtarë të BIA-s.

v. Viktima e vrasjes së paligjshme

569. Provat e administruara prej Trupit Gjykses tregojnë se viktima e vrasjes së paligjshme – së bashku me [REDAKTUAR] – ishin të ndaluarit që u keqtrajtuat më rëndë. W01679 dhe W03593 dëshmuat se viktima e vrasjes së paligjshme u trajtua ndryshe nga të tjerët, ai ka qenë “maltrajtu ma së shumti”, “të dëmtumit ma të mëdhenj”, “në mënyrën ma të keqe të mujtshme”.<sup>1202</sup> W01679 deklaroi: “Ne jena konë krejt të rrehun sende, po [...] “Ai u konë katastrofë, [...] masakër asht ajo”, [ai] a konë tmerr, tmerr asht ajo. Nuk di me përshkru atë”.<sup>1203</sup> W01679, W03593 dhe W04669 (i cili u mbajt në një ahur tjetër, por e pa viktimën e vrasjes së paligjshme dy herë kur e sollën në ahurin ku ishte W04669),<sup>1204</sup> që të gjithë dëshmuat gjithashtu se viktima e

---

<sup>1199</sup> Trupi Gjykses vëren se [REDAKTUAR] përputhet me keqtrajtimin e pësuar gjatë mbajtjes në ndalim. Megjithatë, Trupi Gjykses nuk u mbështet në këtë provë, sepse: (i) [REDAKTUAR] (nëse ishin shkaktuar nga keqtrajtimi gjatë mbajtjes në ndalim, apo diçka tjetër); dhe (ii) dëshmitari deklaroi se ai nuk kishte simptoma fizike ose blana nga keqtrajtimi gjatë mbajtjes në ndalim; *shih* [REDAKTUAR]; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1468, rreshti 20 deri në f. 1470, rreshti 8 (ku përshkruan lëndimet që pësoi nga keqtrajtimi në Zllash, [REDAKTUAR]).

<sup>1200</sup> *Shih gjithashtu W01679*: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 896, rreshti 20 deri në f. 897, rreshti 7.

<sup>1201</sup> **W04669**: T. 11 nëntor 2021, konfidencial, f. 1508, rreshtat 3-6; f. 1509, rreshti 15 deri në f. 1510, rreshti 17.

<sup>1202</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 891, rreshti 22 deri në f. 892, rreshti 8; **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 444, rreshti 23 deri në f. 445, rreshti 14; *shih më tej* T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 470 rreshti 1 deri në f. 473, rreshti 15 ([REDAKTUAR]).

<sup>1203</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 891, rreshti 22 deri në f. 892, rreshti 8, f. 907, rreshtat 3-8.

<sup>1204</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1440, rreshtat 1-7.

vrasjes së paligjshme ishte i vetmi i ndaluar me duar të lidhura.<sup>1205</sup> W03593 dëshmoi se i kujtohej qartë se si e ushqente viktimën e vrasjes së paligjshme, sepse ai nuk mund të hante vetë ngaqë i kishte duart e lidhura.<sup>1206</sup>

570. W01679, W03593 dhe W04669 dhanë dëshmi të hollësishme, të gjalla dhe tejet përputhëse në lidhje me keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme. Ata dëshmuan se ai u rrah derisa nuk mund të qëndronte në këmbë,<sup>1207</sup> u dogj me hekur dhe u shpua me thikë.<sup>1208</sup> W04669 pa në një rast kur viktimja e vrasjes së paligjshme u rrah nga pesë deri në gjashtë ushtarë të BIA-s.<sup>1209</sup> Të tre dëshmitarët rikujtuan se ai e kishte trupin krejt të nxirë dhe fytyrën aq të ënjtur sa mezi mund të hapte sytë.<sup>1210</sup> W01679 dhe W03593 deklaruan se ai ishte “deformum”<sup>1211</sup> dhe “llom”.<sup>1212</sup> Ai u rraskapit prej rrahjeve.<sup>1213</sup> W01679 dhe W04669 dëshmuan se, në një moment, ai vetëm dergjej në dysheme, nuk ishte në gjendje të ecte ose të fliste, vetëm qante prej dhimbjeve.<sup>1214</sup>

571. W01679 dëshmoi se, në kohën kur të ndaluarit e tjerë u liruan, viktimja e vrasjes së paligjshme nuk ishte më në gjendje të qëndronte në këmbë ose të ecte vetë dhe ishte

---

<sup>1205</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 892, rreshtat 9-18; **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 454, rreshti 23 deri në f. 455, rreshti 6; T. 21 shtator 2021, konfidencial, f. 510, rreshtat 1-8; T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 690, rreshtat 20-22; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1432, rreshtat 1-8, f. 1435, rreshtat 13-16; T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1441, rreshtat 11-20.

<sup>1206</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 454, rreshti 23 deri në f. 455, rreshti 6.

<sup>1207</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 403, rreshti 21 deri në f. 405, rreshti 9; **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 906, rreshtat 5-9; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1438, rreshtat 3-6.

<sup>1208</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 892, rreshtat 3-6; **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 454, rreshtat 7-22; T. 20 shtator 2021, publik, f. 473, rreshti 16 deri në f. 474, rreshti 4.

<sup>1209</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1434, rreshti 10 deri në f. 1435, rreshti 18; f. 1437, rreshti 15 deri në f. 1438, rreshti 6.

<sup>1210</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 892, rreshtat 3-6; **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 454, rreshtat 1-22; f. 473, rreshti 16 deri në f. 474, rreshti 4; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, konfidencial, f. 1432, rreshti 1 deri në f. 1433, rreshti 25.

<sup>1211</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 906, rreshtat 5-9.

<sup>1212</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 454, rreshtat 1-6.

<sup>1213</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 906, rreshtat 5-9.

<sup>1214</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 928, rreshtat 1-20; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1434, rreshtat 1-9.

në një gjendje që vështirë se mund të përshkruhet me fjalë: “Trupi i tij, ato dhimbjet e tijna, ajo, atë erën që kena ndi na, atë erën e mishit, ajo a konë tmerr, a konë ajo”, deklaroi W01679.<sup>1215</sup> Sipas W04669-ës, ai ishte “gati vdekur”.<sup>1216</sup> Viktima e vrasjes së paligjshme – [REDAKTUAR] – nuk u lirua me të ndaluarit e tjerë.<sup>1217</sup>

572. W01679, W04669 dhe W03594 dëshmuar se viktima e vrasjes së paligjshme u akuzua si hajdut dhe bashkëpunëtor i serbëve.<sup>1218</sup> W04669 rikujtoi se sa herë që viktimën e vrasjes së paligjshme e sillnin në ahur, të ndaluarit i detyronin të thërrisnin: “Vdekje tradhtarëve, vdekje hajnave edhe lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.<sup>1219</sup> W01679 gjithashtu dëshmoi se, viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR].<sup>1220</sup>

573. Trupi Gjykues gjithashtu dëgjoi dëshminë e W03594-ës se viktima e vrasjes së paligjshme ishte në gjendje të mirë fizike dhe asnjëherë nuk i pati duart e lidhura.<sup>1221</sup> Trupi Gjykues nuk i jep peshë dëshmisë së W03594-ës në lidhje me këtë pikë, sepse ajo përgënjeshtrohet qartësisht nga dëshmitë përputhëse dhe tërësisht të besueshme të W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës në lidhje me keqtrajtimin e tmerrshëm fizik që iu bë viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1222</sup>

<sup>1215</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 906, rreshti 5 deri në f. 907, rreshti 8; f. 928, rreshtat 1-20; *shih gjithashtu* **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1438, rreshtat 3-6.

<sup>1216</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1434, rreshtat 5-9.

<sup>1217</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 484, rreshtat 19-22; T. 21 shtator 2021, publik, f. 606, rreshti 21 deri në f. 607, rreshti 4; **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 905, rreshti 15 deri në f. 906 rreshti 16.

<sup>1218</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 892, rreshti 19 deri në f. 893, rreshti 16; T. 5 tetor 2021, konfidencial, f. 990, rreshti 2 deri në f. 992, rreshti 4; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1438, rreshtat 7-17; **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1049, rreshtat 3-18.

<sup>1219</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1434, rreshtat 18-23.

<sup>1220</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 892, rreshtat 13-16; f. 893, rreshtat 6-20.

<sup>1221</sup> **W03594**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1188, rreshtat 9-15; T. 14 tetor 2021, konfidencial, f. 1265, rreshti 8 deri në f. 1266, rreshti 20.

<sup>1222</sup> Trupi Gjykues vë në dukje se, në një rast, kur W03593 u pyet se në çfarë gjendje ishte viktima e vrasjes së paligjshme kur u lirua ai (W03593), dëshmitari u përgjigj se viktima e vrasjes së paligjshme ishte në gjendje të qëndronte më këmbë dhe të ecte, ishte në gjendje normale; *shih* **W03593**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 690, rreshtat 2-19. Trupi Gjykues i jep pak peshë dëshmisë së W03593-shit në këtë pikë sepse: (i) ajo përgënjeshtrohet nga dëshmitë përputhëse të W01679-ës dhe W04669-ës të përmendura më lart; dhe (ii) është e pagjasë, duke marrë parasysh se gjatë të gjithë pjesës tjetër të



574. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses, bazuar në provat e administruara prej tij, është bindur se gjatë mbajtjes në ndalim në kompleksin e ndalimit në Zllash, viktima e vrasjes së paligjshme u akuzua si hajdut dhe si bashkëpunëtor i serbëve dhe u keqtrajtua shumë rëndë nga anëtarë të BIA-s.

vi. Të ndaluar të tjerë

575. W01679 dëshmoi se e gjeti [REDAKTUAR] në ahur kur mbërriti në kompleksin e ndalimit në Zllash, se ai u rrah si në ahurin poshtë, ashtu dhe në dhomën e marrjes në pyetje lart dhe se u akuzua si spiun.<sup>1223</sup> W01679 deklaroi se rrahjet e rraskapitën [REDAKTUAR] dhe se ai nuk mund të qëndronte në këmbë.<sup>1224</sup> Dëshmia e tij mbështetet nga dëshmia e W04391-shit, i cili deklaroi se pa shenja të rrahjeve në fytyrën dhe trupin e [REDAKTUAR] në ditën kur të ndaluarit u liruan.<sup>1225</sup>

576. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se, gjatë mbajtjes në ndalim në kompleksin e ndalimit në Zllash, [REDAKTUAR] u akuzua si spiun dhe u keqtrajtua rëndë nga anëtarë të BIA-s.

---

dëshmisë së tij ai pranoi se viktimën e vrasjes së paligjshme e kishin keqtrajtuar rëndë. Trupi Gjykses gjykon se kjo mospërputhje shpjegohet me kohën që ka kaluar dhe me faktin se ditën që u lirua, W03593 ishte i shqetësuar vetëm për veten dhe për t'u larguar sa më shpejt që të ishte e mundshme nga kompleksi i ndalimit në Zllash. Rrjedhimisht, në atë moment, nuk e pati mendjen aq shumë te viktima e vrasjes së paligjshme sa e kishte pasur gjatë ditëve që kaloi në ndalim me të; *shih* **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 482, rreshtat 20-23; f. 484, rreshti 25 deri në f. 485, rreshti 5 (“Se me thanë të drejtë unë e kisha problemin tim, me ik sa ma shpejt”); T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 485, rreshti 25 deri në f. 486, rreshti 4 (“S’më ka interesu [REDAKTUAR], as për [viktimën e vrasjes së paligjshme]. Veç më ka interesu me më liru mua e me ik menjëherë”); T. 21 shtator 2021, publik, f. 516, rreshtat 12-15; f. 516, rreshti 25 deri në f. 517, rreshti 2; T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 690, rreshtat 2-8 (i referohen viktimitës së vrasjes së paligjshme, “Tybe me t’thanë t’drejtën se kom kqyr fort se e kom ka rrok tuta jeme [...] unë kom kqyr problemin tem, me ik sa ma shpejt”).

<sup>1223</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 889, rreshtat 1-5; f. 894, rreshti 25 deri në f. 895, rreshti 15.

<sup>1224</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 894, rreshti 25 deri në f. 895, rreshti 15.

<sup>1225</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1742, rreshti 18 deri në f. 1743, rreshti 3; T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1744, rreshtat 9-17; T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1819, rreshtat 6-8.



577. W01679 dhe W03593 dëshmuar se [REDAKTUAR] u rrah në ahur poshtë dhe u çua shpesh lart.<sup>1226</sup> Në lidhje me viktimën e vrasjes së paligjshme dhe [REDAKTUAR], W03593 deklaroi: “Ata të dy kanë maltrajtu ma së shumti, me thonë të drejtën”.<sup>1227</sup> W01679 rikujtoi se [REDAKTUAR] ishte i traumatizuar dhe dridhej, dhe nuk fliste asnjëherë me të ndaluarit e tjerë.<sup>1228</sup> W01679 dhe W03593 gjithashtu dëshmuar se [REDAKTUAR].<sup>1229</sup> Dëshmitë e W01679-ës dhe W03593-shit konfirmohen nga W03594, i cili kur iu tregua deklarata e tij për ZPS-në, pranoi se një herë [REDAKTUAR] e rrahën aq keq, sa nuk mund të ngrihej në këmbë.<sup>1230</sup> [REDAKTUAR] – po ashtu si viktimë e vrasjes së paligjshme – ishte në gjendje të keqe dhe nuk u lirua me të ndaluarit e tjerë.<sup>1231</sup>

578. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se, gjatë mbajtjes në ndalim në kompleksin e ndalimit në Zllash, personi i njohur si [REDAKTUAR] u keqtrajtua rëndë nga anëtarë të BIA-s.

### 3. Qëllimi i shkaktimit të dhimbjeve dhe vuajtjeve

579. Provat e administruara prej Trupit Gjykses, të përshkruara me hollësi më lart, tregojnë se gjatë keqtrajtimit, të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash: (i) u morën në pyetje (për shembull, për arsyet e pranisë së tyre në Zllash, nëse kishin dijeni për identitetin e hajdutëve, ose për [REDAKTUAR] që iu gjetën kur u arrestuan);<sup>1232</sup> (ii) u akuzuan si spiunë, tradhtarë, hajdutë, gënjeshtarë ose bashkëpunëtorë të

---

<sup>1226</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 900, rreshti 9 deri në f. 901, rreshti 10; **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 444 rreshti 23 deri në f. 445, rreshti 14.

<sup>1227</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 445, rreshtat 13-14.

<sup>1228</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 900, rreshtat 13-22.

<sup>1229</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 445, rreshti 20 ([REDAKTUAR]); **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 900, rreshti 23 deri në f. 901, rreshti 3 ([REDAKTUAR]).

<sup>1230</sup> **W03594**: T. 12 tetor 2021, konfidencial, f. 1058, rreshtat 8-18.

<sup>1231</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, konfidencial, f. 905, rreshti 15 deri në f. 907, rreshti 8; **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 484, rreshtat 19-22.

<sup>1232</sup> *Shih* para. 534-535, 545, 547, 556, 567-568.

serbëve;<sup>1233</sup> dhe (iii) iu bënë ekzekutime të simuluar, në rastin e W03593-shit, u kërcënuan me vdekje, ose u detyruan të shihnin keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë.<sup>1234</sup>

580. Gjithashtu, provat e administruara prej Trupit Gjykues tregojnë se keqtrajtimi i të ndaluarve nga anëtarë të BIA-s ishte edhe politikisht i motivuar. W04669 dëshmoi se sa herë që viktimën e vrasjes së paligjshme e sillnin në ahur, të ndaluarit e tjerë u urdhëruan të thërrisnin: “Vdekje tradhtarëve, vdekje hajnave edhe lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.<sup>1235</sup> Më tej, W04669 dhe W03594, të cilët ishin përkrahës ose anëtarë të LDK-së,<sup>1236</sup> shpjeguan se LDK-ja konsiderohej si parti “pacifiste” dhe kundërshtarë e UÇK-së.<sup>1237</sup> W04669 dëshmoi se mendonte se u mor në pyetje dhe keqtrajtua sepse kishte shprehur përkrahje për Ibrahim Rugovën, kryetar i atëhershëm i LDK-së.<sup>1238</sup> Në mënyrë të ngjashme, W03594 dëshmoi se ai mendonte se një nga arsyet e arrestimit të tij ishte anëtarësia e tij në LDK.<sup>1239</sup> Dëshmia e tij përputhet dhe mbështetet nga dëshmia e W01679-ës se “kur e kanë torturu”, W03594 u akuzua [REDAKTUAR].<sup>1240</sup>

581. Trupi Gjykues vë në dukje parashtrimin e Mbrojtjes se dëshmitë e W03594-ës dhe W04669-ës janë të pamjaftueshme për të bërë konstatime mbi arsyet e ndalimit dhe keqtrajtimit të tyre, sepse ato bazohen në mendime dhe analiza personale.<sup>1241</sup> Gjithsesi, Trupi Gjykues thekson se dëshmitë e tyre mbështeten nga, dhe duhen parë së bashku me: (i) dëshminë e W01679-ës të përmendur më lart në lidhje me akuzat e

<sup>1233</sup> *Shih* para. 534-535, 545, 556, 566-568, 572, 574-576.

<sup>1234</sup> *Shih* para. 523-525, 530-532, 546-547, 556.

<sup>1235</sup> *Shih* para. 572; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1434, rreshtat 18-23.

<sup>1236</sup> *Shih* para. 558, 567.

<sup>1237</sup> **W03594**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1169, rreshtat 5-21; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1446, rreshti 8 deri në f. 1448, rreshti 12.

<sup>1238</sup> **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1446, rreshti 8 deri në f. 1448, rreshti 12.

<sup>1239</sup> **W03594**: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1169, rreshtat 5-21; T. 14 tetor 2021, konfidencial, f. 1248, rreshti 7 deri në f. 1250, rreshti 15; **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1446, rreshti 8 deri në f. 1448, rreshti 12.

<sup>1240</sup> *Shih* para. 562.

<sup>1241</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4735, rreshti 17 deri në f. 4738, rreshti 23.

bëra kundër W03594-ës;<sup>1242</sup> (ii) dëshminë e W04669-ës se ai dhe të ndaluarit e tjerë u detyruan të shprehnin përkrahje për UÇK-në;<sup>1243</sup> dhe (iii) dëshmitë në lidhje me akuzat e tjera kundër të ndaluarve (se ata ishin tradhtarë, spiunë ose bashkëpunëtorë të serbëve).<sup>1244</sup>

582. Trupi Gjykses gjithashtu nuk bindet nga parashtrimet e Mbrojtjes se keqtrajtimi u krye pa asnjë qëllim ose objektiv të veçantë.<sup>1245</sup> Provat tregojnë qartësisht se anëtarë të BIA-s, ndër të cilët edhe i akuzuari, synonin: të merrnin informacion prej tyre; t'i detyronin të pranonin se ishin spiunë, gënjeshtarë, hajdutë ose bashkëpunëtorë të serbëve; t'i ndëshkonin për këtë; t'i frikësonin nëpërmjet ekzekutimeve të simuluar ose t'i detyronin të shihnin keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë; dhe/ose t'i diskriminonin për shkak të bindjeve të tyre politike.

583. Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses, bazuar në tërësinë e provave të administruara, është bindur se të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], u keqtrajtuuan nga anëtarë të BIA-s, ndër të cilët i akuzuari, dhe u mbajtën në kushte ndalimi çnjerëzore me qëllim që të merrnin informacion ose deklarata pranuese prej tyre, dhe/ose për t'i ndëshkuar, frikësuar, detyruar dhe/ose diskriminuar për arsye politike.

#### 4. Përfundim

584. Duke u bazuar në të gjitha provat e diskutuara më lart të marra në tërësi, Trupi Gjykses konstaton se, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 ose rreth këtyre datave, të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], u mbajtën në

---

<sup>1242</sup> *Shih* para. 562.

<sup>1243</sup> *Shih* para. 572.

<sup>1244</sup> *Shih* para. 579.

<sup>1245</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4753, rreshti 22 deri në f. 4760, rreshti 25.

kushte ndalimi çnjerëzore dhe poshtëruese dhe rregullisht u keqtrajtuat fizikisht dhe psikologjikisht nga i akuzuari dhe anëtarë të tjerë të BIA-s nën autoritetin e tij në kompleksin e ndalimit në Zllash. Të ndaluarit u mbajtën në ahure të përshtatshme vetëm për mbajtjen e kafshëve. Ata nuk kishin shtretër dhe u detyruan të flinin në grazhdin e ushqimit të kafshëve ose mbi dysheme – në pellgje uji, të rrethuar nga jashtëqitjet e bagëtive. Ata u mbajtën në terr. Atyre nuk iu dha ushqim dhe ujë i mjaftueshëm dhe kur kërkuan ujë, mbi ta u urinua. Ata nuk u lejuan të laheshin ose të ndërronin veshjet dhe u lejuan vetëm në mënyrë të kufizuar të përdornin banjë, duke i detyruar t'i kryenin nevojat personale brenda ahurit në prani të njëri-tjetrit. Të ndaluarve iu refuzua ndihma mjekësore. Gjithashtu, ata nuk u lejuan të kontaktonin dhe të flisnin me njëri-tjetrin duke u kërcënuar me vdekje.

585. Të ndaluarit ishin me frikën e vazhdueshme se mund të keqtrajtoheshin ose madje vriteshin në çdo moment. W03593-shit në momentin e mbërritjes në kompleksin e ndalimit në Zllash iu tha nga viktimat e vrasjes së paligjshme: “kanë me t’myt”, dhe W03593 pa se viktimat e vrasjes së paligjshme ishte keqtrajtuar shumë rëndë.<sup>1246</sup> W03593 gjithashtu ishte objekt i një ekzekutimi të simuluar nga vetë i akuzuari vetëm një orë pasi e sollën në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1247</sup> Po ashtu, të ndaluarit u detyruan të shihnin dhe dëgjonin keqtrajtimin fizik të të ndaluarve të tjerë, ata nuk u lejuan të flinin dhe nuk iu treguan arsyet e heqjes së lirisë.

586. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstaton se të ndaluarit, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktimat e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], rregullisht u keqtrajtuat fizikisht nga i akuzuari dhe anëtarë të tjerë të BIA-s nën autoritetin e tij në kompleksin e ndalimit në Zllash: u rrahën, u dogjën, u goditën me rrymë elektrike, u shpuan me thikë, u goditën me shkelma, me grushte dhe me

---

<sup>1246</sup> *Shih* para. 531.

<sup>1247</sup> *Shih* para. 546.

shuplaka çdo ditë derisa u mbuluan në gjak, humbën vetëdijen, ose nuk ishin në gjendje të qëndronin në këmbë apo të flisnin.

587. Gjatë gjithë kohës së mbajtjes në ndalim, të ndaluarit u morën në pyetje, u akuzuan si spiunë, tradhtarë, hajdutë, gënjeshtarë ose bashkëpunëtorë të serbëve. Ata u kërcënuan me vdekje, u frikësuan dhe u detyruan të shprehnin përkrahje për UÇK-në. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se kushtet çnjerëzore të ndalimit dhe keqtrajtimi fizik dhe psikologjik përkatës i të ndaluarve kishin qëllim marrjen e informacionit ose të deklaratave pranuese prej tyre dhe/ose për t'i ndëshkuar, frikësuar, detyruar dhe/ose diskriminuar për arsye politike.

588. Keqtrajtimi fizik dhe psikologjik si dhe kushtet çnjerëzore të ndalimit u shkaktuan të ndaluarve lëndime afatgjata fizike dhe mendore, si: lëndime në kokë, djegie, krahë, gishta dhe/ose dhëmbë të thyer; dhimbje të madhe të vazhdueshme në trup; dëmtim të shikimit; ndjenjën e turpër; dhe simptoma të stresit pastraumatik (makthe, fanitje të këtyre ngjarjeve dhe kujtime tronditëse të pavullnetshme).

#### E. VRASJA E PALIGJSHME (PIKA 4)

589. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta se viktima e vrasjes së paligjshme u mbajt i ndaluar arbitrarisht në kompleksin e ndalimit në Zllash, në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi, dhe u keqtrajtua shumë rëndë gjatë periudhës që mbulojnë akuzat.<sup>1248</sup> Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se ka konstatuar se në kohën e lirimit të të ndaluarve të tjerë më 19 prill 1999 ose rreth këtyre datave, viktima e vrasjes së paligjshme u mbajt në ahur së bashku me një person tjetër.<sup>1249</sup>

---

<sup>1248</sup> *Shih* para. 459-484, 569-574.

<sup>1249</sup> *Shih* para. 477-481.

590. Duke mbajtur parasysh faktet e konstatuara më lart dhe duke u bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykes do të bëjë konstatime faktike në lidhje me akuzën e vrasjes së paligjshme (Pika 4) në Aktakuzën e Konfirmuar.

### 1. Përpjekjet për të gjetur, vizituar ose liruar viktimën e vrasjes së paligjshme në prill 1999

591. Fillimisht, Trupi Gjykes thekson se, [REDAKTUAR],<sup>1250</sup> [REDAKTUAR].<sup>1251</sup> [REDAKTUAR].<sup>1252</sup>

592. Trupi Gjykes gjithashtu thekson se, në atë rast, [REDAKTUAR]<sup>1253</sup> [REDAKTUAR]. Sikurse u përcaktua prej Trupit Gjykes në konstatimet faktike për ndalimin arbitrar (Pika 1), [REDAKTUAR] viktima e vrasjes së paligjshme u çua në kompleksin e ndalimit në Zllash më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR].<sup>1254</sup>

593. Lidhur me rrethanat pas heqjes së lirisë së viktimës së vrasjes së paligjshme, Trupi Gjykes konstaton se [REDAKTUAR] tentoi të kontaktonte me viktimën e vrasjes së paligjshme deri më 10 prill 1999 ose rreth kësaj date, duke kontaktuar anëtarë të ndryshëm të UÇK-së. Provat tregojnë pa asnjë dyshim se [REDAKTUAR] mori përgjigje dhe reagime çorientuese, dredhuese dhe ndonjëherë të dhunshme nga këta anëtarë të UÇK-së.

---

<sup>1250</sup> **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 723, rreshti 5 deri në f. 726, rreshti 6; [REDAKTUAR].

<sup>1251</sup> **W04600**: T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 724, rreshtat 11-17.

<sup>1252</sup> **W04603**: T. 2 nëntor 2021, konfidencial, f. 1346, rreshtat 21-25; **z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, f. 2102, rreshtat 5-22.

<sup>1253</sup> **W04600**: T. 27 shtator 2021, konfidencial, f. 847, rreshti 12 deri në f. 849, rreshti 7. *Shih gjithashtu W4600*: 072914-TR-ET Revised (Rishikuar) RED3, Part (Pjesa) 3, f. 16, rreshtat 10-19. Trupi Gjykes vëren se W04603 është kushëri i largët i viktimës së vrasjes së paligjshme (**W04603**: T. 2 nëntor 2021, konfidencial, f. 1296, rreshtat 11-14; f. 1309, rreshtat 21-25).

<sup>1254</sup> *Shih* para. 459.

594. Ndër përgjigjet çorientuese dhe dredhuese përfshihen: (i) viktima e vrasjes së paligjshme po merrej në pyetje dhe do të lirohej shpejt;<sup>1255</sup> (ii) ai “[...] ndodhet në Llap [...] Mos u shqetëso”;<sup>1256</sup> (iii) [REDAKTUAR] “[...] e vizitova mbrëmë dhe ai është në gjendje të mirë”;<sup>1257</sup> dhe (iv) “Kurrjë se gjen”.<sup>1258</sup> Gjithashtu, në ditën [REDAKTUAR] iu tha se viktima e vrasjes së paligjshme ishte në zonën e Llapit [REDAKTUAR].<sup>1259</sup>

595. Një herë tjetër, sikurse deklaroi në sallën e gjyqit W04391, [REDAKTUAR].<sup>1260</sup>

596. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se [REDAKTUAR] u përballën me reagime të dhunshme nga anëtarët e UÇK-së [REDAKTUAR]. W04391 konfirmoi faktin se, kur kërkoi [REDAKTUAR], W04600 i tha se viktima e vrasjes së paligjshme ishte në zonën e Llapit të UÇK-së.<sup>1261</sup> Sipas W04391-shit dhe W04390-s, pas kësaj W04600 e kapi

---

<sup>1255</sup> **W04648:** SPOE00128158-00128162, f. SPOE00128158. Deklarata e W04648-ës përputhet me atë të W04391-shit, i cili e konfirmoi këtë bisedë si kur u pyet nga Prokuroria, po ashtu dhe nga Mbrojtja (**W04391:** T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f.1736, rreshtat 19-20; T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1799, rreshtat 11-12).

<sup>1256</sup> **W04712:** 077816-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 12, rreshtat 3-8. *Shih gjithashtu W04391:* T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1809, rreshti 17 deri në f. 1810, rreshti 22.

<sup>1257</sup> **W04391:** T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1809, rreshti 15 deri në f. 1810, rreshti 1. Në kundërshtim me W04391-shin, sipas W04390-s këto fjalë i tha [REDAKTUAR] (**W04390:** T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1869, rreshtat 5-8). Trupi Gjykses e konsideron këtë një mospërputhje të vogël, e cila mund të jetë thjesht gabim ose ngatërrim [REDAKTUAR].

<sup>1258</sup> **W04391:** T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1812, rreshtat 8-16.

<sup>1259</sup> **W04712:** 077816-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 14 rreshtat 12-13, ku W04712 deklaroi se W04600 u përgjigj se viktima e vrasjes së paligjshme ishte në zonën e Llapit dhe nuk mund të shkonte [REDAKTUAR]. **W04648:** SPOE00128061-00128064, f. SPOE00128063 (në këtë deklaratë, W04648 tha se një person i quajtur “[REDAKTUAR]” nuk e lejoi viktimën e vrasjes së paligjshme të shkonte [REDAKTUAR].

<sup>1260</sup> **W04391:** T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1813, rreshtat 3-7 (W04391 deklaroi se W04648 “ [...] ka ardh [REDAKTUAR]. Tha [REDAKTUAR] nuk më kanë lanë [REDAKTUAR]”).

<sup>1261</sup> **W04391:** T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1739, rreshti 5.



W04390-n [REDAKTUAR]<sup>1262</sup> [REDAKTUAR]<sup>1263</sup> [REDAKTUAR].<sup>1264</sup> Pas kësaj, W04600 u tha W04391-shit dhe W04390-s “[REDAKTUAR]”.<sup>1265</sup>

597. Ndryshe nga dëshmitë e anëtarëve të familjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, W04600 dha një version më të zbutur të këtij takimi. W04600 konfirmoi se u takua me W04391-shin dhe W04390-n, [REDAKTUAR].<sup>1266</sup> [REDAKTUAR].<sup>1267</sup> [REDAKTUAR].<sup>1268</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>1269</sup> [REDAKTUAR].<sup>1270</sup> [REDAKTUAR].<sup>1271</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e konsideron dëshminë e W04600-s të besueshme vetëm në lidhje me takimin e [REDAKTUAR] në përgjithësi, që konfirmon dëshmitë e W04390-s dhe W04391-shit.

---

<sup>1262</sup> **W04391:** T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1739, rreshtat 6-8; **W04390:** T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1867, rreshtat 5-7; **W04648:** SPOE00128061-00128064, f. 3. Megjithëse W04648 deklaroi se ishte [REDAKTUAR] që e kapi W04390-n nga flokët, Trupi Gjykses vë në dukje se W04648 nuk ishte i pranishëm në vendngjarje, kurse W04391 dhe W04390 ishin. Duke qenë se këta të dy dëshmuan se atë veprim e kreu W04600, Trupi Gjykses u jep më shumë peshë dëshmime të W04391-shit dhe W04390-s në lidhje me këtë ngjarje.

<sup>1263</sup> **W04390:** T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1867, rreshti 7.

<sup>1264</sup> **W04391:** T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1739, rreshtat 6-8; **W04390:** T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1867, rreshti 9.

<sup>1265</sup> **W04390:** T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1867, rreshtat 11-12; **W04391:** T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1739, rreshtat 8-9. Fjalët e përdorura nga W04600 u konfirmuan nga W04674 dhe W04712 (**W04712:** 077816-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 12 rreshti 12 deri në f. 13, rreshti 15; **W04674:** T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1982, rreshtat 13-17). Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, niveli i përputhshmërisë sa u takon fjalëve që tha W04600 për fatin e viktimës së vrasjes së paligjshme dhe reagimit të W04390-s kur u keqtrajtua, bëjnë që Trupi Gjykses ta konsiderojë të pagjasë që [REDAKTUAR] ta kenë trilluar këtë hollësi, ose të kenë dëshmuar rastësisht në të njëjtën mënyrë. Gjithashtu, vërtetësia e këtij incidenti konfirmohet edhe nga vetë W04390, e cila deklaroi në sallën e gjyqit se [REDAKTUAR] (**W04390:** T. 24 nëntor 2021, konfidencial, f. 1867, rreshtat 10-11; f. 1879, rreshti 24 deri në f. 1880, rreshti 2). *Shih gjithashtu* vlerësimet e përgjithshme të Trupit Gjykses për këta dëshmitarë në para. 91 dhe në vijim të Aktgjykimit.

<sup>1266</sup> **W04600:** T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 761, rreshtat 1-6.

<sup>1267</sup> **W04600:** T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 761, rreshtat 9-11.

<sup>1268</sup> **W04600:** T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 761, rreshtat 13-18 (theksimi i shtuar).

<sup>1269</sup> **W04600:** T. 23 shtator 2021, konfidencial, f. 723, rreshtat 21-24.

<sup>1270</sup> *Shih* para. 459-484. Gjithashtu, Trupi Gjykses vlerëson se dëshmia e dhënë nga W04600 përputhet përgjithësisht me qasjen e tij për të dhënë informacion për rrethanat e mbajtjes në ndalim dhe të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme vetëm deri në një farë mase, pa e kapërcyer kufirin e vënë nga ai vetë lidhur me inkriminimin. [REDAKTUAR].

<sup>1271</sup> **W04600:** T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 773, rreshtat 4-9.

598. Sipas dëshmitave, [REDAKTUAR] bëri një përpjekje të fundit [REDAKTUAR] më 10 prill 1999 ose rreth kësaj date. W04648 në deklaratën e tij tha se në atë datë ose rreth kësaj date,<sup>1272</sup> ai shkoi në Zllash ku një person [REDAKTUAR] i tha: “Ende po e marrim në pyetje [REDAKTUAR] [viktimën e vrasjes së paligjshme]. Nuk kemi mbaruar akoma dhe nuk do ta lëshoj deri sa të mbarojmë me të”.<sup>1273</sup> Sipas W04648-ës, në atë moment [REDAKTUAR] kërcënoi W04648-ën dhe familjen e tij, e shtyu dhe donte ta rrihte sepse ai po pyeste [REDAKTUAR].<sup>1274</sup> Dëshmitari shtoi se pas atij kërcënimi, [REDAKTUAR] kishte frikë për jetën e anëtarëve të familjes së tij.<sup>1275</sup>

599. Trupi Gjykses e konsideron dëshminë në lidhje me përpjekjen e fundit nga W04648 [REDAKTUAR] të besueshme dhe të dhënë me vërtetësi, sidomos sepse ndodhi në kuadër të një praktike më të gjerë dhe gjithnjë e më të dhunshme veprimesh nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët W04600, për ta bërë [REDAKTUAR] të hiqte dorë nga përpjekjet për të marrë informata për viktimën e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR]. Trupi Gjykses mendon se kjo pasqyron synimin e anëtarëve të UÇK-së për ta izoluar viktimën e vrasjes së paligjshme nga kontakti [REDAKTUAR], duke marrë parasysh keqtrajtim e rëndë që kishte pësuar ai në atë kohë në kompleksin e ndalimit në Zllash, që përfundimisht çoi në vdekjen e tij.

600. Pas përpjekjes së tij të fundit të përshkruar më lart, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>1276</sup>

601. Trupi Gjykses më tej vëren se, në kohën që përpiqeshin të kontaktonin [REDAKTUAR] iu tha gjithashtu që të bënin kërkesa me shkrim, të cilat ata i bëjnë, por nuk morën asnjëherë përgjigje.<sup>1277</sup> Trupi Gjykses e konsideron këtë dëshmi të

---

<sup>1272</sup> **W04648:** SPOE00128061-00128064, f. SPOE00128064.

<sup>1273</sup> **W04648:** SPOE00128061-00128064, f. 4.

<sup>1274</sup> **W04648:** SPOE00128061-00128064, f. SPOE00128064 (“[REDAKTUAR]”).

<sup>1275</sup> **W04648:** SPOE00128061-00128064, f. SPOE00128064.

<sup>1276</sup> **W03593:** T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 487, rreshtat 8-13.

<sup>1277</sup> **W04391:** T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1740, rreshti 24 deri në f. 1741, rreshti 18.

besueshme sepse përputhet me kontekstin më të gjerë të përpjekjeve të anëtarëve të UÇK-së që ishin në dijeni të gjendjes dhe vendndodhjes së viktimës së vrasjes së paligjshme, për të çorientuar [REDAKTUAR]. Trupi Gjykses më tej thekson se dëshmitarët e tjerë konfirmojnë faktin se në kompleksin e ndalimit në Zllash nuk lejoheshin vizita te të ndaluarit.<sup>1278</sup>

602. Duke marrë parasysh tërësinë e të gjitha provave në lidhje me përpjekjet e shumta [REDAKTUAR], Trupi Gjykses është bindur se [REDAKTUAR] jo vetëm që u penguan ta shihnin viktimën e vrasjes së paligjshme gjatë kohës që ishte i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, por se ata gjithashtu morën përgjigje të paqarta, çorientuese, verbalisht dhe fizikisht të dhunshme nga anëtarët e UÇK-së, [REDAKTUAR], në lidhje me gjendjen dhe vendndodhjen e viktimës së vrasjes së paligjshme.

## 2. Përpjekjet për gjetjen e kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme

603. Sikurse është konstatuar nga Trupi Gjykses, më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, pasi u liruan nga kompleksi i ndalimit në Zllash, disa nga të ndaluarit [REDAKTUAR] i thanë [REDAKTUAR] se viktimë e vrasjes së paligjshme nuk u lirua, por se duhej të lirohej së shpejti.<sup>1279</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se të nesërmen, për shkak të ofensivës serbe në zonë, [REDAKTUAR].<sup>1280</sup> Pas përfundimit të ofensivës, [REDAKTUAR].<sup>1281</sup>

---

<sup>1278</sup> W03593 deklaroi se anëtarët e familjes së tij nuk mundën ta vizitonin, megjithëse e dinin se ku ishte (W03593: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 481, rreshtat 8-14). W03594 konfirmoi se nuk lejoheshin vizitat në kompleksin e ndalimit në Zllash (W03594: T. 13 tetor 2021, konfidencial, f. 1133, rreshtat 8-11).

<sup>1279</sup> *Shih* para. 477-478.

<sup>1280</sup> W04391: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1745, rreshtat 12-13; W04674: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1934, rreshtat 17-21; f. 1935, rreshtat 12-17 dhe f. 1944, rreshtat 23-25.

<sup>1281</sup> W04648: SPOE00128158-00128162, f. SPOE00128158; SPOE00128061-00128064, f. 1; W04712: 077816-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 22, rreshtat 7-13; W04674: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1946, rreshtat 7-8; W04391: T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1833, rreshti 17.

604. Konkretisht, W04648 deklaroi se rifilloi ta kërkonte viktimën e vrasjes së paligjshme në qershor 1999,<sup>1282</sup> kur UÇK-ja ishte “larguar nga zona”.<sup>1283</sup> Sipas dëshmisë, W04648 shkoi “për çdo ditë” në fshatin Zllash për të kërkuar viktimën e vrasjes së paligjshme,<sup>1284</sup> ku kërkoi në disa shtëpi<sup>1285</sup> derisa, së bashku me W04391-shin, gjetën vendin e saktë ku ishte mbajtur viktimja e vrasjes së paligjshme.<sup>1286</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses, kronologjia e ngjarjeve të përshkruara nga W04648 dhe W04391 është e besueshme, përfshirë faktin se kërkimi për viktimën e vrasjes së paligjshme rifilloi me pakësimin e luftimeve në zonë, si edhe faktin se informacioni relevant u dha nga të ndaluarit me viktimën e vrasjes së paligjshme krahas atij që [REDAKTUAR] e dinte tashmë nga përpjekjet e mëparshme [REDAKTUAR]. Gjithashtu, sa i përket konfirmimit të dëshmive, Trupi Gjykses e gjykon me rëndësi që përskrimi i ndërtesës ku mbaheshin të ndaluarit nga W04391, W04674 dhe W04648 përkon me kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1287</sup> Trupi Gjykses i kushton rëndësi gjithashtu faktit se W04648 dhe W04391 dëshmuuan se ata gjetën brenda disa batanije,<sup>1288</sup> që konfirmon dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës se kishin

<sup>1282</sup> **W04648**: SPOE00128158-00128162, f. SPOE00128158.

<sup>1283</sup> **W04648**: SPOE00128061-00128064, f. SPOE00128061. Trupi Gjykses vë në dukje se W04648 nuk përmendi shprehimisht UÇK-në, por deklaroi se ai rifilloi kërkimin e viktimës së vrasjes së paligjshme “kur më thanë që *ata* ishin larguar nga zona” (theksimi i shtuar). Gjithsesi, duke u bazuar në kontekst Trupi Gjykses është bindur se ai e ka fjalën për UÇK-në.

<sup>1284</sup> **W04648**: SPOE00128158-00128162, f. SPOE00128158. *Shih gjithashtu W04712*: 077816-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 22, rreshtat 7-13; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1946, rreshtat 7-8.

<sup>1285</sup> **W04391**: T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1833, rreshti 17.

<sup>1286</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f.1747, rreshtat 6-7 (“të burgosurit që janë liruar, na kanë thënë përveç [viktimës së vrasjes së paligjshme] asnjë s’u mbetë aty”); **W04648**: SPOE00128158-00128162, f. SPOE00128158 (“Këta dëshmitarë [ish-të ndaluarit] i thanë këtij dëshmitari [W04648] se ku ishte qendra e paraburgimit”); SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333 (“shtatë prej tyre [ish të ndaluarve] u liruan rreth datës 19 prill dhe ata më treguan [W04648] se ku ishte [REDAKTUAR]”).

<sup>1287</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1756, rreshtat 2-4 (i referohet burgut si “ahër”); **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, publik, f. 1945, rreshtat 12-13 “burgun e këqyrëm, e gjetëm në podrum aty në një stallë e kafshëve. Naltë kishin pasë ndejtë ushtarët sigurisht”); **W04648**: SPOE00128158-00128162, f. SPOE00128161 (dëshmitari vizatoi një skicë të vendit të ndalimit, në veçanti një shtëpi me dy kate ku tregoi se në katin përdhes ishin “stallat ku janë mbajtur të burgosurit”).

<sup>1288</sup> **W04391**: T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1834, rreshtat 20-21; **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

pasur batanije që përdoreshin për të mbuluar kuajt.<sup>1289</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykses, fakti që [REDAKTUAR] zbuloi në atë kohë që viktima e vrasjes së paligjshme mbahej i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, konfirmohet nga gjetja në ahur e letërnjoftimit, xhaketës dhe fletëdaljes nga spitali të tij.<sup>1290</sup>

605. Trupi Gjykses ka në vëmendje dëshminë e W04648-ës se, pasi e gjeti kompleksin e ndalimit në Zllash, ai i pyeti [REDAKTUAR] në qoftë se viktima e vrasjes së paligjshme “kishte qenë në atë shtëpi, ai ndoshta mund të jetë i vdekur” [REDAKTUAR],<sup>1291</sup> [REDAKTUAR].<sup>1292</sup> W04674 e konfirmoi këtë aspekt të dëshmisë së W04648-ës kur dëshmoi se ky ishte mesazhi që iu përcoll W04648-ës vetëm një javë pasi rifilloi kërkimin për viktimën e vrasjes së paligjshme në qershor 1999.<sup>1293</sup>

606. Sa i përket gjetjes së kufomës, Trupi Gjykses thekson fjalët e W04674-ës se, në këtë fazë, kërkimi për viktimën e vrasjes së paligjshme u kthye në kërkim “për të vdekur”.<sup>1294</sup> W04648, [REDAKTUAR] në mënyrë përputhëse shpjeguan se sa herë që W04648 shihte një piring dheu të freskët me tri degë sipër, ai gërmonte dheun dhe kërkonte për viktimën e vrasjes së paligjshme.<sup>1295</sup> W04391 konfirmoi informacionin origjinal në deklaratën me shkrim të W04648-ës dhe në skicën e tij, që tregon se

<sup>1289</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 902, rreshtat 16-21; **W03593**: T. 20 shtator 2021, konfidencial, f. 453, rreshtat 1-9; f. 479, rreshtat 19-23; **W04669**: T. 11 nëntor 2021, publik, f. 1545, rreshtat 4-12. Në Broshurën e Fotografive të Terrenit të UNMIK-ut shihen edhe ato që duken si pjesë të mbetura nga batanije të trasha (SPOE00128386-00128420, f. SPOE00128394, SPOE00128401)

<sup>1290</sup> **W04391**: T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1747, rreshti 1 deri në f. 1748, rreshti 3; T. 23 nëntor 2021, konfidencial, f. 1833, rreshtat 8-17; **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1945, rreshtat 10-15; **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

<sup>1291</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1292</sup> [REDAKTUAR] (**W04648**: SPOE00128069-00128086, f. SPOE00128171). Një përshkrim i ngjashëm u bë nga W04674 (**W04674**: T. 14 dhjetor 2021, publik, f. 2016, rreshti 25 deri në f. 2017, rreshti 3).

<sup>1293</sup> **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1945, rreshtat 1-3.

<sup>1294</sup> **W04674**: T. 13 dhjetor 2021, konfidencial, f. 1945, rreshti 10. [REDAKTUAR]; *shih* **W04648**: SPOE00128061-SPOE00128064, f. SPOE00128061.

<sup>1295</sup> [REDAKTUAR]; **W04648**: SPOE00128061-00128064, f. SPOE00128061. *Shih gjithashtu*, **W04648**: SPOE00128061-00128064, f. SPOE00128063 ku W04648 thotë se “gjatë rrugës kontrolloja çdo vrimë”, dhe **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333 ku W04648 deklaroi se ai kërkoi “[REDAKTUAR]”.

kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme më në fund u gjet [REDAKTUAR].<sup>1296</sup> Trupi Gjykues vëren se vlerësimet e bëra nga dëshmitarët, edhe pse nuk kishin instrument matës, janë tejet përputhëse me një kërkesë për një mision ajror të UNMIK-ut, që zbuloi se vendndodhja e varrit të viktimës së vrasjes së paligjshme ishte [REDAKTUAR].<sup>1297</sup> Sipas [REDAKTUAR], varri ku u gjet kufoma ishte në një livadh,<sup>1298</sup> në mes të një pylli,<sup>1299</sup> dhe ishte mjaft i cekët, rreth 20-30 centimetra i thellë.<sup>1300</sup> Trupi Gjykues thekson se thellësia e varrit është gjithashtu e dukshme në një nga fotografitë e bëra nga [REDAKTUAR] gjatë zhvarrosjes, të cilat janë pjesë e provave.<sup>1301</sup> Në këtë kontekst, W04676 shtoi se varri nuk ishte varr “si çdo varr tjetër kur të hapet në rrethana normale”.<sup>1302</sup>

607. Trupi Gjykues vëren se [REDAKTUAR], W04648 [REDAKTUAR], që e panë varrin, dëshmuar në mënyrë përputhëse se aty u gjetën dy kufoma.<sup>1303</sup> [REDAKTUAR] deklaruan se, pasi filluan të gërmonin, në fillim gjetën kufomën e një [REDAKTUAR] të pidentifikuar.<sup>1304</sup> W04648 deklaroi se ai pa “një vrimë hyrëse në

<sup>1296</sup> **W04648:** SPOE00128158-00128162, f. SPOE00128158 dhe SPOE00128161; **W04391:** T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1747 rreshtat 9-18. Në një deklaratë të mëvonshme, W04391 konfirmoi se W04648 e gjeti kufomën [REDAKTUAR], *shih* T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1755, rreshti 25 deri në f. 1756, rreshti 1. *Shih gjithashtu*, **W04674:** T. 13 dhjetor 2021, publik, f. 1948, rreshti 21 deri në f. 1949 rreshti 3 dhe f. 1951, rreshtat 1-2.

<sup>1297</sup> SPOE00128266-00128273 RED3, f. SPOE00128271. Trupi Gjykues rikujton se kërkesa për këtë mision ajror u përgatit [REDAKTUAR] dhe është një nga dokumentet që lidhet me përgatitjen e Broshurës së Fotografive nga Ajri të UNMIK-ut. Trupi Gjykues nuk e kundërshton besueshmërinë e saj dhe është mbështetur në të.

<sup>1298</sup> **W04676:** T. 17 nëntor 2021, publik, f. 1607, rreshtat 3-4.

<sup>1299</sup> **W04676:** T. 17 nëntor 2021, publik, f. 1644, rreshtat 2-3; **W04391:** T. 22 nëntor 2021, publik, f. 1755, rreshti 25; **W04674:** T. 13 dhjetor 2021, publik, f. 1986, rreshtat 12-14.

<sup>1300</sup> **W04676:** T. 17 nëntor 2021, publik, f. 1607, rreshtat 24-25; T. 17 nëntor 2021, konfidencial f. 1615, rreshtat 22-24; **W04391:** T. 22 nëntor 2021, konfidencial, f. 1749, rreshtat 23-25; **W04674:** T. 13 dhjetor 2021, publik, f. 1951, rreshtat 14-16 (W04674 dëshmoi se varri ishte 30 ose 40 centimetra i thellë).

<sup>1301</sup> SPOE00209313-00209320, f. SPOE00209315. Trupi Gjykues nuk kundërshton vërtetësinë e tetë fotografive të zhvarrosjes, duke qenë se vërtetësia e tyre u konfirmua nga W04676 në sallën e gjyqit (**W04676:** T. 17 nëntor 2021, konfidencial, f. 1611, rreshti 20 deri në f. 1612, rreshti 10).

<sup>1302</sup> **W04676:** T. 17 nëntor 2021, publik, f. 1615 rreshti 25 deri në f. 1616 rreshti 2.

<sup>1303</sup> [REDAKTUAR]; **W04648:** SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

<sup>1304</sup> [REDAKTUAR].



kokën e tij, sikur të ishte qëlluar me armë zjarri”.<sup>1305</sup> Sipas dëshmitëve, pasi gërmoi më tej, W04648 gjeti menjëherë një kufomë të dytë të mbuluar me një batanije.<sup>1306</sup>

608. Trupi Gjykses vëren se dëshmitë janë paksa të ndryshme sa i takon datës kur u gjetën këto kufoma, konkretisht 3 korrik 1999,<sup>1307</sup> 4 korrik 1999,<sup>1308</sup> dhe 6 korrik 1999.<sup>1309</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses mendon se këto dallime nuk ndikojnë mbi besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarëve përkatës. Në fakt, Trupi Gjykses gjykon se kronologjia e ngjarjeve relevante në dëshmitë e tyre mbetet e pandryshuar dhe përputhet, për shembull, me datën e zhvarrosjes, që ndodhi më 7 korrik 1999, sikurse përcaktohet më poshtë. Çka është më e rëndësishme, Trupi Gjykses mendon se thelbi i dëshmitëve në këtë pikë, i cili përputhet te të gjithë dëshmitarët, është gjetja e dy kufomave [REDAKTUAR] afërsisht midis 3 korrikut dhe 6 korrikut 1999.

609. Trupi Gjykses thekson se të gjithë dëshmitarët shpjeguan se pasi e panë atë që ata supozuan se ishte kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme (kufoma e dytë që u gjet), ata e mbuluan përsëri varrin dhe e lanë ashtu.<sup>1310</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje dëshminë e W04648-ës se ai bëri një shenjë në varr për të shënuar vendndodhjen e tij.<sup>1311</sup> Fakti që W04648 bëri një vizitë paraprake aty para se të bëhej zhvarrosja u konfirmua nga W04676, që konfirmoi se W04648 e dinte vendndodhjen e kufomës ditën e zhvarrosjes.<sup>1312</sup> Trupi Gjykses i kushton veçanërisht rëndësi faktit se W04648 bëri të ditur se, pasi gjeti atë që supozoi se ishte kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme, ai kontaktoi KFOR-in dhe policinë dhe u tregoi për gjetjen e

---

<sup>1305</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128334.

<sup>1306</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333. Kjo u konfirmua nga W04676, i cili tregoi se viktima e vrasjes së paligjshme ishte mbuluar me një batanije “e kaltërt e mbylltë” [REDAKTUAR].

<sup>1307</sup> **W04648**: SPOE00128158-00128162, f. SPOE00128158.

<sup>1308</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1309</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1310</sup> [REDAKTUAR]; **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

<sup>1311</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

<sup>1312</sup> [REDAKTUAR].



kufomës, por atij iu tha se nuk kishin kohë të mjaftueshme për të hetuar ankesën e tij.<sup>1313</sup>

610. Trupi Gjykses konstaton se [REDAKTUAR] përshkruan gjetjen e dy kufomave në mënyrë bindëse dhe të qartë, tejet të hollësishme dhe përputhëse, çka tregon se kishin dijeni të drejtpërdrejtë për gjetjen. Përpjekja për të përfshirë KFOR-in dhe policinë si autoritete të rendit dhe të ligjit, përpara zhvarrosjes së kufomës, është një tjetër element realist që shton besueshmërinë e dëshmime të tyre.

611. Bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se varri [REDAKTUAR] kishte dy kufoma, të cilat u gjetën përafërsisht midis 3 korrikut dhe 6 korrikut 1999.

### 3. Zhvarrosja dhe identifikimi i kufomës së vrasjes së paligjshme

612. Trupi Gjykses vë në dukje se W04648, [REDAKTUAR] dëshmuar për zhvarrosjen dhe identifikimin e kufomës së vrasjes së paligjshme. Trupi Gjykses dëgjoi dëshmi sipas të cilave një ose disa ditë pas gjetjes së të dy kufomave në varr, [REDAKTUAR] shkuan përsëri te varri për të zhvarrosur kufomën që u supozua se ishte e viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1314</sup> [REDAKTUAR],<sup>1315</sup> një hollësi që Trupi Gjykses e konsideron shumë realiste dhe të dhënë me vërtetësi, e cila mund të vinte vetëm nga kujtimet personale të dëshmitarit. Këta dëshmitarë treguan se gjatë zhvarrosjes, kufoma u nxor nga varri, u vendos në një mbulesë plastike,<sup>1316</sup> dhe brenda në arkivol,<sup>1317</sup> i cili më pas u transportua në fshatin [REDAKTUAR].<sup>1318</sup>

---

<sup>1313</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333. Kjo konfirmohet nga [REDAKTUAR].

<sup>1314</sup> [REDAKTUAR]; **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128340.

<sup>1315</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

<sup>1316</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1317</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1318</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu*, **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

[REDAKTUAR] iu kërkua të ndihmonte në zhvarrosje [REDAKTUAR], të cilat gjenden në provat e administruara prej Trupit Gjykses.<sup>1319</sup>

613. Sa i përket datës së zhvarrosjes, Trupi Gjykses vë në dukje se në një deklaratë të mëparshme W04648 tha se varrimi u bë më 4 korrik 1999.<sup>1320</sup> Megjithatë, [REDAKTUAR] dëshmuar në mënyrë përputhëse se zhvarrosja u bë më 7 korrik 1999, që konfirmohet nga vulat digjitale të fotografive në prova.<sup>1321</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar se gjetja e varrit ndodhi afërsisht midis 3 korrikut dhe 6 korrikut 1999.<sup>1322</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses u jep më shumë peshë dëshmime të [REDAKTUAR], që mbështeten nga fotografitë e përfshira në prova, të cilat përputhen më mirë me kronologjinë e ngjarjeve bazuar në tërësinë e provave. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se zhvarrosja u bë më 7 korrik 1999.

614. Sa i përket identifikimit të kufomës, Trupi Gjykses vë në dukje dëshmitë [REDAKTUAR] se ditën e zhvarrosjes, kufoma ishte në fazën e shpërbërjes,<sup>1323</sup> çka e linte të hapur nëse ishte apo jo viktimia e vrasjes së paligjshme. Gjithsesi, Trupi Gjykses thekson deklaratën e W04648-ës, [REDAKTUAR], i cili konfirmoi [REDAKTUAR] se ishte kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR].<sup>1324</sup> Trupi Gjykses thekson gjithashtu se [REDAKTUAR] konfirmoi në

---

<sup>1319</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu, W04648: SPOE00128158-00128162, f. SPOE00128158, ku W04648 deklaroi se [REDAKTUAR] dhe W04648: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333, ku W04648 në fakt konfirmoi se W04676, [REDAKTUAR].*

<sup>1320</sup> **W04648:** SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333.

<sup>1321</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1322</sup> *Shih* para. 611.

<sup>1323</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1324</sup> **W04648:** SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128333. Në SPOE00128061-00128064, f. 3, ku dëshmitari deklaroi se viktimia e vrasjes së paligjshme kishte [REDAKTUAR], dhe ia njohu [REDAKTUAR] “nga ato hollësi, që ishin të rëndësishme” për të. *Shih gjithashtu, [REDAKTUAR].* Trupi Gjykses vëren një mospërputhje ndërmjet dëshmime të dëshmitarëve, disa prej tyre përmendin [REDAKTUAR] dhe të tjerët [REDAKTUAR]. Megjithatë, Trupi Gjykses i jep peshë faktit se të gjithë dëshmitarët konfirmuan njëri-tjetrin kur dëshmuar se të gjithë mundën ta identifikonin kufomën e viktimës së vrasjes së paligjshme nga [REDAKTUAR], dhe gjykon se, në këtë aspekt, këto mospërputhje nuk e ulin besueshmërinë e dëshmitarëve dhe vlerën provuese të dëshmime të tyre.

sallën e gjyqit se W04648 mundi në fakt ta identifikonte se ishte kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme, sepse W04648-ës [REDAKTUAR].<sup>1325</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se W03593 konfirmoi se të ndaluarit nuk mund [REDAKTUAR] gjatë mbajtjes në ndalim në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1326</sup> Së fundi, [REDAKTUAR] viktimës së vrasjes së paligjshme ndihmoi në identifikimin e kufomës, pasi ishte [REDAKTUAR], sipas [REDAKTUAR].<sup>1327</sup>

615. Sikurse u përmend më lart, kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme ishte mbuluar me një batanije.<sup>1328</sup> Kur iu tregua fotografia e një prej batanijeve të gjetura në kompleksin e ndalimit në Zllash,<sup>1329</sup> [REDAKTUAR] tha menjëherë se dukej e ngjashme me atë që gjetën në varr.<sup>1330</sup> [REDAKTUAR] shtoi se kufoma e viktimës së vrasjes së paligjshme nuk kishte këpucë.<sup>1331</sup> Trupi Gjykses thekson se fotografitë e bëra gjatë zhvarrosjes konfirmojnë se faktikisht kufoma ishte pa këpucë.<sup>1332</sup>

616. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vë në dukje se vdekja e viktimës së vrasjes së paligjshme konfirmohet edhe nga W04600, i cili dëshmoi në sallën e gjyqit se e kishte marrë vesh vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme “pas ofensivës [serbe], muj me kanë 5-6 ditë mbrapa” të 18 prillit 1999.<sup>1333</sup>

617. Trupi Gjykses gjykon se dëshmitë e dëshmitarëve për zhvarrosjen dhe identifikimin e kufomës së viktimës së vrasjes së paligjshme janë shumë të besueshme, bazuar në [REDAKTUAR] në dëshmitë e tyre përputhëse dhe të hollësishme që vërtetojnë se i treguan ngjarjet mbi bazën e përjetimeve personale të tyre.

---

<sup>1325</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1326</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 479, rreshtat 11-23.

<sup>1327</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1328</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1329</sup> **W04648**: SPOE00128386-00128420, f. SPOE00128401.

<sup>1330</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1331</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1332</sup> SPOE00209313-00209320, f. SPOE00209320.

<sup>1333</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 767, rreshtat 4-13.

618. Bazuar në tërësinë e provave, Trupi Gjykses është bindur se kufoma e dytë, e gjetur në varrin [REDAKTUAR] në fillim të korrikut 1999, ishte viktima e vrasjes së paligjshme.

#### 4. Lëndimet e viktimës së vrasjes së paligjshme

##### (a) Krahët dhe këmbët

619. Trupi Gjykses ka marrë prova në lidhje me lëndime të mundshme në krahët dhe këmbët e viktimës së vrasjes së paligjshme. [REDAKTUAR], që mori pjesë në zhvarrosje,<sup>1334</sup> dëshmoi se viktima e vrasjes së paligjshme i kishte krahët dhe këmbët e thyera.<sup>1335</sup> Kur u pyet se si mund ta përcaktonte që gjymtyrët ishin të thyera, ai u përgjigj se “u dukshin” dhe se kur e morën kufomën, ata panë se ishin të thyera.<sup>1336</sup> Kjo dëshmi konfirmohet nga [REDAKTUAR], i cili deklaroi se W04648, [REDAKTUAR] panë “këmbët dhe duart që i ka të thyme”.<sup>1337</sup> Po ashtu, [REDAKTUAR], i cili ishte pak më larg nga varri, dëgjoji dikë që tha se viktima e vrasjes së paligjshme i kishte krahët dhe këmbët e thyera.<sup>1338</sup> Nga ana tjetër, Trupi Gjykses vëren se [REDAKTUAR] deklaroi se ajo nuk dëgjoji nga personat e pranishëm gjatë zhvarrosjes se viktima e vrasjes së paligjshme i kishte krahët dhe këmbët e thyera.<sup>1339</sup> Megjithatë, [REDAKTUAR] dëshmoi gjithashtu se zhvarrosja [REDAKTUAR],<sup>1340</sup> duke e bërë tërësisht të mundshme, sipas mendimit të Trupit Gjykses, që [REDAKTUAR] nuk e dëgjoji apo vuri re këtë hollësi të veçantë gjatë procesit. Ndonëse përcaktimi i lëndimeve të gjymtyrëve të viktimës së vrasjes së paligjshme nuk është thelbësor për akuzën e vrasjes së paligjshme – duke qenë se është

---

<sup>1334</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1335</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1336</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1337</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1338</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1339</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1340</sup> [REDAKTUAR].

vërtetuar se kufoma ishte e viktimës së vrasjes së paligjshme – Trupi Gjykses gjykon se provat, të marra në tërësi, janë përputhëse dhe tregojnë për lëndime të rënda në krahët dhe këmbët e viktimës. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses thekson se lëndime të tilla përputhen me keqtrajtimin e ashpër që pësoi viktimja e vrasjes së paligjshme gjatë mbajtjes në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe faktin se në fund të periudhës së ndalimit ai nuk ishte në gjendje të qëndronte në këmbë ose të ecte.<sup>1341</sup>

(b) Trungu i trupit dhe shkaqet e vdekjes

620. Trupi Gjykses vë në dukje se nuk ka asnjë provë në formën e një autopsie lidhur me shkakun (shkaqet) dhe mënyrën e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.

621. Në lidhje me shkakun e vdekjes, Trupi Gjykses e gjykon të rëndësishme se, kur u pa për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë, viktimja e vrasjes së paligjshme, i cili u keqtrajtua rëndë çdo ditë për gati tri javë, ishte pothuajse i vdekur dhe nuk ishte në gjendje të qëndronte në këmbë ose të ecte.<sup>1342</sup> Gjithashtu, viktimës së vrasjes së paligjshme iu refuzua çdo ndihmë mjekësore që mund t'i kishte shpëtuar jetën në atë kohë. Fakti që të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash iu refuzua ndihma mjekësore konfirmohet nga dëshmitë e W01679-ës, W03593-shit dhe W04669-ës.<sup>1343</sup> Për shembull, sipas W01679-ës askush nuk ia mjekoi plagët pas rrahjeve.<sup>1344</sup> Sikurse dëshmoi W03593, asnjërit prej të ndaluarve nuk iu dha ndihmë mjekësore dhe ishte e pamundur që të ndaluarit të kërkonin ndihmë mjekësore pasi “të kish vra menjëherë”.<sup>1345</sup> Gjithsesi, në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se në Zllash në përgjithësi kishte ndihmë mjekësore<sup>1346</sup> dhe, rrjedhimisht, në kompleksin e ndalimit

---

<sup>1341</sup> *Shih* para. 569-574.

<sup>1342</sup> *Shih* para. 571.

<sup>1343</sup> *Shih* para. 520-522. *Shih gjithashtu* **W04669**: T. 10 nëntor 2021, publik, f. 1467, rreshtat 9-10 (“nuk kam kërkuar, as nuk kam marrë”); **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 903, rreshtat 9-11.

<sup>1344</sup> **W01679**: T. 4 tetor 2021, publik, f. 903, rreshtat 12-13.

<sup>1345</sup> **W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 480, rreshtat 13-21.

<sup>1346</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2115, rreshtat 22-25; f. 2116, rreshtat 16-22; T. 19 janar 2022, publik, f. 2150, rreshti 14 deri në f. 2151, rreshti 16.

në Zllash ekzistonte mundësia për t'ua dhënë atë ndihmë. Në këtë aspekt, bazuar në tërësinë e provave, duke marrë parasysh pozitën e të akuzuarit si komandant i BIA-s dhe kontrollin që kishte mbi kompleksin e ndalimit në Zllash, Trupi Gjykses gjykon se vetëm i akuzuari mund të ketë vendosur për refuzimin e ndihmës mjekësore për të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash.

622. Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje se W04648 deklaroi se në kohën e zhvarrosjes, pa dy vrima hyrëse që ngjanin me plagë nga të shtëna me armë zjarri në anën e djathtë të stomakut të viktimës së vrasjes së paligjshme dhe dy vrima daljeje në anën e majtë të shpinës së tij.<sup>1347</sup> Dëshmia e tij konfirmohet nga [REDAKTUAR], i cili dëshmoi se në shpinën e viktimës së vrasjes së paligjshme, kishte tri ose katër vrima plumbash.<sup>1348</sup> Kur iu kërkua që të shpjegonte se ku ndodheshin vrimat e plumbave, [REDAKTUAR] fillimisht tha se ndodheshin në pjesën e pasme të kokës, duke shtuar se nuk ishte i sigurt nëse i mbante mend mirë,<sup>1349</sup> dhe më vonë sqaroi tri herë se vrimat e plumbave ishin “mbrapa shpinës”,<sup>1350</sup> ku ndodhen mushkëritë.<sup>1351</sup> [REDAKTUAR] përmendi gjithashtu se mundi t'i shihte vrimat e plumbave kur trupin e kthyen nga ana tjetër.<sup>1352</sup> [REDAKTUAR] po kështu dëshmuar për vrimat e plumbave në shpinën e kufomës.<sup>1353</sup> [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], deklaroi se përveç një vrime në anën e majtë të viktimës së vrasjes së paligjshme, nuk vunë re shenja të tjera gjatë zhvarrosjes.<sup>1354</sup> Megjithatë, [REDAKTUAR] saktësoi se u bë vetëm një shikim sipërfaqësor, dhe se pjesët e tjera të kufomës, si kraharori dhe shpina nuk u ekzaminuan në atë kohë.<sup>1355</sup> Gjithashtu, [REDAKTUAR] shpjegoi [REDAKTUAR] se

---

<sup>1347</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128334.

<sup>1348</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1349</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1350</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1351</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1352</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1353</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1354</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1355</sup> [REDAKTUAR].

ishte e pamundur të përcaktohej shkaku i asaj vrime, pasi kufoma kishte filluar të shpërbëhej dhe nuk u krye asnjë ekzaminim mjekoligjor në momentin e zhvarrosjes apo më pas.<sup>1356</sup>

623. Trupi Gjykues thekson se dëshmitë e dëshmitarëve të shqyrtuara më lart konfirmohen nga fotografitë e zhvarrosjes, në të cilat duket të paktën një vrimë në anën e majtë të trungut të trupit të viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1357</sup> Sipas mendimit të Trupit Gjykues, kjo së bashku me provat në lidhje me kufomën tjetër të paidentifikuar të gjetur në të njëjtin varr me “një vrimë hyrëse në kokën e tij, sikur të ishte qëlluar me armë zjarri”,<sup>1358</sup> përputhen me situatën që të dy individët në varr ishin goditur me plumba.

624. Ndonëse provat nuk tregojnë qartësisht numrin dhe vendndodhjen e saktë të vrimave të plumbave, Trupi Gjykues gjykon se provat janë përrputhëse në lidhje me praninë e vrimave në trungun e trupit. Trupi Gjykues gjykon se vrima të tilla mund të ishin shkaktuar vetëm nga plumba, pasi nuk ka prova që tregojnë të kundërtën. Të marra së bashku, keqtrajtimi i konstatuar i viktimës së vrasjes së paligjshme gjatë mbajtjes në kompleksin e ndalimit në Zllash, që i shkaktoi lëndime të rënda trupore dhe refuzimi i ndihmës mjekësore për të, në kontekstin e vendimeve të të akuzuarit për të mos e liruar dhe as evakuuar atë, Trupi Gjykues gjykon se i vetmi përfundim i arsyeshëm, i bazuar në tërësinë e provave, është se viktima e vrasjes së paligjshme vdiq si pasojë e kombinimit të keqtrajtimit të rëndë të shkaktuar nga anëtarët e BIA-s që e ndaluan, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore; refuzimi i ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s; dhe plagët me armë zjarri.

---

<sup>1356</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1357</sup> SPOE00209313-00209320, f. SPOE00209318.

<sup>1358</sup> **W04648**: SPOE00128333-00128343, f. SPOE00128334.



## 5. Ofensiva serbe në zonën e Zllashit

625. Sipas mendimit të Trupit Gjykses dhe bazuar në konstatimet faktike më lart në lidhje me shkaqet e vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme,<sup>1359</sup> është e padiskutueshme që keqtrajtimi që iu bë atij dhe refuzimi i ndihmës mjekësore i atribuohen vetëm veprimeve dhe mosveprimeve të të akuzuarit, në cilësinë e tij si komandant i BIA-s, si edhe veprimeve dhe mosveprimeve të vartësve të tij të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash. Faktikisht, provat tregojnë qartë se vetëm i akuzuari dhe vartësit e tij të BIA-s kishin kontakt me viktimën e vrasjes së paligjshme në kompleksin e ndalimit në Zllash afërsisht midis [REDAKTUAR] prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 ose rreth këtyre datave. Si pasojë, i akuzuari dhe vartësit e tij të BIA-s ishin të vetmit që mund të krijonin rrethanat që çuan në një gjendje në prag të vdekjes të viktimës së vrasjes së paligjshme kur u pa për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë më 19 prill 1999, ose rreth kësaj date.

626. Në këtë pikë, Trupi Gjykses rikujton se sjellja e kryesve, qoftë vepruese apo mosvepruese, ose të dyja, duhet të ketë qenë shkak i qenësishëm i vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1360</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykses është bindur se keqtrajtimi i skajshëm i viktimës së vrasjes së paligjshme – që përfshinte përdorimin e objekteve potencialisht vdekjeprurëse – shoqëruar me mungesën e ndihmës mjekësore për afërsisht [REDAKTUAR] ditë, ishin në fakt shkaqe të qenësishme që ndikuan në vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme. Me fjalë të tjera, nëse i akuzuari dhe vartësit e tij të BIA-s do ta kishin ndaluar një keqtrajtim të tillë të skajshëm, ose do t'i kishin dhënë ndihmë mjekësore viktimës së vrasjes së paligjshme, ai nuk do të kishte vdekur.

---

<sup>1359</sup> *Shih* para. 624.

<sup>1360</sup> *Shih* para. 687.

627. Sidoqoftë, duke marrë parasysh se Trupi Gjykses ka konstatuar edhe një shkak të tretë të vdekjes (plagë plumbi të shkaktuara nga qëllimi i viktimës me armë zjarri),<sup>1361</sup> ai e sheh të përshtatshme të diskutojë nëse vrmat e plumbave të gjetura në kufomën e viktimës së vrasjes së paligjshme mund t'u atribuohen anëtarëve të BIA-s apo forcave serbe.

628. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses ka marrë prova lidhur me ofensivën serbe në zonën e Zllashit në gjysmën e dytë të prillit 1999. Dokumente ushtarake nga Komanda e Përbashkët Serbe për Kosovën dhe Metohinë tregojnë se forcat serbe e planifikuan ofensivën në atë zonë më 18 prill 1999.<sup>1362</sup> Kjo konfirmohet nga deklaratat e të akuzuarit dhe dëshmitë e dëshmitarëve, të cilët dëshmuar, bazuar në dijeninë e drejtpërdrejtë të tyre, se ofensiva në zonën e Zllashit ndodhi afërsisht midis 16 prillit 1999 dhe 22 prillit 1999.<sup>1363</sup>

629. Sidoqoftë, provat nëse kjo ofensivë arriti ose jo deri në kompleksin e ndalimit në Zllash janë kundërthënëse. Nga njëra anë ato duket se vërtetojnë se trupat serbe arritën në *fshatin* Zllash dhe shkaktuan dëme në infrastrukturë.<sup>1364</sup> Nga provat nuk mund të nxirret një përfundim i qartë se për sa kohë qëndruan trupat serbe në fshatin

<sup>1361</sup> *Shih* para. 624.

<sup>1362</sup> IT-05-87.1 P01384.E, f. 3-4 ("Të bëhet beteja në dy faza mbi një periudhë 3-5 ditore"). Në raportet serbe mbi luftimet të datave 19 prill dhe 20 prill 1999 thuhet, ndër të tjera, se ofensiva në sektorin e Zllashit vazhdon (IT-05-87.1 D00633.E, f. 0062; IT-05-87.1 D00634.E, f. 0097).

<sup>1363</sup> I akuzuari deklaroi se ofensiva "ka filluar" më 16 prill 1999 (z. **Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 18, rreshtat 21-23). Ndërsa z. Krasniqi tregoi se ofensiva "ka fillu" më 17 prill 1999 në Zllash, ndërkohë që në Prapashticë dhe në fshatra të tjerë filloi më herët (z. **Krasniqi**: T. 21 prill 2022, publik, f. 3869, rreshtat 6-9). W04600, ndonëse nuk ishte i sigurt për datën, tha se ofensiva ndodhi rreth 18-22 prillit 1999, duke vënë në dukje se zgjati për shtatë ose tetë ditë (**W04600**: T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 767, rreshtat 10-11). Z. F. Sopi dhe znj. Hadri deklaruan në mënyrë përputhëse se ofensiva ndodhi më 18 prill 1999 (**W03593**: T. 20 shtator 2021, publik, f. 418, rreshti 25 deri në f.419, rreshti 2. *Shih gjithashtu*, f. 419, rreshtat 21-22 dhe T. 21 shtator 2021, publik, f. 552, rreshtat 13-24. Z. F. **Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2036, rreshtat 21-22, f. 2043, rreshtat 20-21, f. 2078, rreshtat 11-12. **Znj. Hadri**: T. 11 maj 2022, publik, f. 4209, rreshti 22 dhe f. 4210, rreshtat 1-2).

<sup>1364</sup> Z. F. **Sopi**: T. 19 janar 2022, publik, f. 2175, rreshtat 21-22; f. 2176, rreshtat 17-18 (trupat serbe "i dogjën së pari të gjitha shtëpitë dhe shkuan pothuajse në çdo shtëpi në Zllash").

Zllash. Sipas provave në lidhje me këtë aspekt, trupat serbe mund të jenë vendosur atje për një kohë shumë të shkurtër, ndoshta edhe për më pak se një ditë, edhe për faktin se forcat e UÇK-së nuk u tërhoqën plotësisht nga Zllashi.<sup>1365</sup>

630. Në anën tjetër, Trupi Gjykses nuk është në gjendje të përcaktojë në mënyrë përfundimtare nëse trupat serbe hynë në kompleksin e ndalimit në Zllash, i cili, siç është konstatuar nga Trupi Gjykses, ishte në një pozicion më të lartë, larg fshatit Zllash.<sup>1366</sup> Në këtë aspekt, Trupi Gjykses mund të konstatojë se, në kohën e lirimit të papritur të të ndaluarve, më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, ata mundën të shkonin në këmbë drejt Prishtinës apo vendeve të tjera, relativisht të pashqetësuar.<sup>1367</sup> Kjo tregon se në atë moment, trupat serbe nuk ishin askund afër kompleksit të ndalimit në Zllash.

631. Sidoqoftë, z. Krasniqi, dëshmoi dhe shpjegoi në detaje – në bazë të dy fotografive të kompleksit të ndalimit në Zllash<sup>1368</sup> — se trupat serbe, në një moment të pacaktuar kohe gjatë ofensivës së tyre, granatuan kompleksin e ndalimit në Zllash nga largësia, që shkaktoi shkatërrimin e pjeshëm të disa ndërtesave, por jo rrënimin e tyre nga tanket.<sup>1369</sup> Në bazë të dy fotografive të kompleksit të ndalimit në Zllash që iu treguan z. Krasniqi, Trupi Gjykses mund të konstatojë se ndërtesat që u dëmtuan nga granatimet (por që nuk u shkatërruan apo rrënuan plotësisht) ndodhen në anën e majtë të kompleksit të ndalimit në Zllash dhe në fakt janë ndërtesat ku u mbajtën dhe

---

<sup>1365</sup> **Z. Humolli**: T. 1 shkurt 2022, publik, f. 2450, rreshti 16 deri f. 2451, rreshti 2 (trupat serbe u larguan brenda ditës, “menjëherë”); f. 2359, rreshtat 18-20; **z. Veseli**: T. 25 janar 2022, publik, f. 2271, rreshtat 13-21 (“nuk jemi [UÇK-ja] tërheq prej Zllashit, por jemi tërheq ma në brendësi të malit rreth Zllashit [...] se regjionin e Zllashit nuk e kemi lëshu. Se i tillë ka qenë konfiguracioni i terrenit që kemi mund me organizu në mbrojtje”).

<sup>1366</sup> *Shih* para. 354-355.

<sup>1367</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me disa të ndaluar [REDAKTUAR] pas lirimit të tyre (*shih* para. 403, 425, 440). Në lidhje me këtë, W03593 dëshmoi se në ditën e lirimit të tij, ai nuk pa forca armike duke ardhur në Zllash (W03593: T. 21 shtator 2021, publik, f. 553, rreshtat 9-11).

<sup>1368</sup> DSM00030 dhe DSM00032.

<sup>1369</sup> **Z. Krasniqi**: T. 22 prill 2022, publik, f. 4042, rreshti 24 deri në f. 4045, rreshti 18.

u keqtrajtuat viktimat e vrasjes së paligjshme dhe të ndaluarit e tjerë.<sup>1370</sup> Sipas vlerësimit të Trupit Gjykues, nga ato fotografi duket qartë se pjesa e sipërme e objektit ku silleshin të ndaluarit për t'u marrë në pyetje dhe keqtrajtuar rëndë, është e dëmtuar pjesërisht nga granatimet. Përkundrazi, bodrumi (apo ahuri) nën të, dhe ahuri (ahuret) e tjera ku mbaheshin të ndaluarit, nuk u shkatërruan.<sup>1371</sup> Kjo konfirmohet nga dëshmia e W04674-ës, i cili raportoi se kur hyri në kompleksin e ndalimit në Zllash për të kërkuar trupin e viktimës së vrasjes së paligjshme, vuri re se hambari<sup>1372</sup> prej druri kishte vrime plumbash, të cilat sipas dëshmitarit ishin shkaktuar nga forcat serbe.<sup>1373</sup>

632. Trupi Gjykues mban gjithashtu parasysh dëshminë e z. F. Sopi për këtë temë. Së pari, ai dëshmoi se serbët arritën të shkonin deri te kompleksi i ndalimit në Zllash.<sup>1374</sup> Diku tjetër gjatë dëshmisë së tij, z. Sopi dha këtë përgjigje: "Jo, nuk e di [se çfarë bënë serbët në qendrën e ndalimit në Zllash], se nuk kemi pasë mundësi ta dimë. Vetëm se e dimë se i dogjën të gjitha shtëpitë".<sup>1375</sup> Kur u ballafaqua nga Trupi Gjykues me faktin se fotografitë e Broshurës së Fotografive nga Terreni të UNMIK-ut – në bazë të të cilave ai identifikoi kompleksin e ndalimit në Zllash<sup>1376</sup> – nuk tregonin ndonjë shenjë

<sup>1370</sup> Fotografia DSM00030 është një nga fotografitë e Broshurës së Fotografive nga Terreni të UNMIK-ut dhe paraqet të njëjtën ndërtesë të identifikuar nga viktimat si një nga vendet ku u mbajtën të ndaluar (në bodrumin poshtë) dhe dhomën e marrjes në pyetje ku u kryen keqtrajtimet e rënda dhe marrjet në pyetje (lart). Fotografia DSM00032 paraqet të njëjtën ndërtesë, por e parë nga jashtë kompleksit të ndalimit në Zllash (z. **Krasniqi**: T. 22 prill 2022, publik, f. 4045, rreshtat 2-6).

<sup>1371</sup> **W04391**: T. 23 nëntor 2021, publik, f. 1834, rreshtat 2-21.

<sup>1372</sup> Bazuar në Broshurën e Fotografive nga Ajri të UNMIK-ut, me shënime nga z. Krasniqi, është e mundur të përcaktohet vendndodhja e hambarit në anën e majtë të kompleksit të ndalimit në Zllash (evidentuar si ndërtesa nr. 13), gjë që konfirmon se ajo anë e kompleksit të ndalimit në Zllash mund të jetë goditur nga forcat serbe (shih REG00-013 dhe z. **Krasniqi**: Transkripti i seancës, 22 prill 2022, publik, f. 4023, rreshti 21 deri në f. 4024, rreshti 5).

<sup>1373</sup> **W04674**: Transkripti i seancës, 14 dhjetor 2021, konfidencial, f. 2013, rreshti 3 deri në f. 2014, rreshti 15.

<sup>1374</sup> **Z. F. Sopi**: T. 19 janar 2022, publik, f. 2176, rreshti 23 deri në f. 2177, rreshti 1.

<sup>1375</sup> **Z. F. Sopi**: T. 19 janar 2022, publik, f. 2177, rreshtat 4-5.

<sup>1376</sup> **Z. F. Sopi**: T. 18 janar 2022, publik, f. 2053, rreshti 22 deri në f. 2054, rreshti 17; SPOE00128386-00128420, f. SPOE00128388.

djegjeje, z. F. Sopi deklaroi: “Ajo pjesë nuk është djegur, nuk ishte djegur, ndërsa pjesa e shtëpive në anën tjetër tërësisht kanë qenë të djegura”.<sup>1377</sup>

633. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses vlerëson se dëshmitë krijojnë një bazë, edhe pse jopërfundimtare, se forcat serbe e granatuan dhe qëlluan me armë zjarri kompleksin e ndalimit në Zllash, më së paku nga distanca, duke shkaktuar dëmtim të infrastrukturës së tij.

634. Megjithatë, Trupi Gjykses konstaton se ka një boshllëk kohor në prova. Ky boshllëk fillon nga koha e lirit të të ndaluarve, më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, e deri në momentin kur disa anëtarë të BIA-s, ndër ta dhe i akuzuari, u kthyen në Zllash, më 20-21 prill 1999 ose rreth këtyre datave, për të evakuuar të plagosurit nga ajo zonë.<sup>1378</sup> Sidoqoftë, provat e administruara nuk hedhin dritë mbi aspektin nëse i akuzuari dhe anëtarët e tjerë të BIA-s u kthyen në kompleksin e ndalimit në Zllash apo shkuan diku tjetër në Zllash për të ndihmuar personat e plagosur. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk mund të përjashtojë se, për shkak të granatimeve nga forcat serbe dhe dëmit që iu shkaktua kompleksit të ndalimit në Zllash, në fund forcat serbe u afruan ose hynë në mjediset e vendndodhjes së krimeve më 20-21 prill 1999 ose rreth këtyre datave dhe, për rrjedhojë, është e mundshme që të kenë shkuar te viktima e vrasjes së paligjshme dhe i ndaluarit tjetër që nuk ishte liruar. Trupi Gjykses gjithashtu nuk është në gjendje të përcaktojë nëse, pasi u pa për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë në momentin kur ata u liruan, viktima e vrasjes së paligjshme u zhvendos diku tjetër nga ahuri ku mbahej i ndaluar, duke u bërë kështu potencialisht objektiv i plumbave (qorrë) të serbëve, nga një distancë e largët apo e afërt. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses nuk është në gjendje të përcaktojë, të paktën me njëfarë përafërsie, se

---

<sup>1377</sup> Z. F. Sopi: T. 18 janar 2022, publik, f. 2177, rreshtat 14-15.

<sup>1378</sup> Z. Mustafa: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f. 22, rreshti 6 deri në f. 23, rreshti 5. Znj. Canolli-Kaçiu: T. 12 maj 2022, publik, f. 4330, rreshtat 21-22.

kur vdiq viktima e vrasjes së paligjshme, gjatë periudhës së boshllëkut kohor të përmendur më lart, apo më pas.

635. Sidoqoftë, Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar se viktimës së vrasjes së paligjshme iu hoq liria me urdhër të një zyrtari të lartë të UÇK-së, [REDAKTUAR].<sup>1379</sup> Më pas, për rreth [REDAKTUAR] ditë viktima u vu në shënjestër dhe u keqtrajtua në mënyrë të skajshme nga vartësit e të akuzuarit në njësitin BIA, përfshirë edhe me anë të përdorimit të objekteve që mund të shkaktonin vdekjen.<sup>1380</sup> Ky keqtrajtim dhe, paralelisht me të, refuzimi i ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s nën autoritetin e të akuzuarit, e çuan viktimën e vrasjes së paligjshme në një gjendje në prag të vdekjes, që nuk mund të qëndronte në këmbë dhe të ecte.<sup>1381</sup>

636. Siç është konstatuar, të ndaluarit u liruan papritmas nga kompleksi i ndalimit në Zllash, pa iu dhënë shpjegime apo dokumentacion, më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, për shkak të afrimit të ofensivës serbe në zonën e Zllashit.<sup>1382</sup> Megjithatë, viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] nuk u liruan me të ndaluarit e tjerë.<sup>1383</sup> Në bazë të tërësisë së provave, Trupi Gjykses konstaton se vendimi për të mos liruar viktimën e vrasjes së paligjshme mund të merrej vetëm nga i akuzuari, si komandant i përgjithshëm i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash. Si konfirmim se vendimi për të mos liruar viktimën e vrasjes së paligjshme mund të merrej vetëm nga i akuzuari si komandant i BIA-s, Trupi Gjykses nënvizon se lirimi i të ndaluarve të tjerë u zbatua nga vartësit e të akuzuarit në BIA, ndër të cilët edhe zëvendësi i tij, z. Mehmetaj (me pseudonimin Bimi).<sup>1384</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se viktima e vrasjes së paligjshme nuk u evakuua nga Zllashi, një vendim ky që gjithashtu duhet të jetë marrë

---

<sup>1379</sup> *Shih* para. 459.

<sup>1380</sup> *Shih* para. 570.

<sup>1381</sup> *Shih* para. 571.

<sup>1382</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses në "Rrethanat e lirit" në lidhje me W01679-ën, W03593-shin, W03594-ën.

<sup>1383</sup> *Shih* para. 477.

<sup>1384</sup> [REDAKTUAR].

nga i akuzuari, pasi ai ishte përgjegjës për evakuimin e të plagosurve nga Zllashi. Këto vendime të të akuzuarit (për të mos e liruar ose evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme) në fakt ishin barabar me vendimin për ta vrarë atë, duke pasur parasysh se të ndaluarit e tjerë u larguan nga kompleksi i ndalimit në Zllash për në zona më të sigurta, ndërsa viktimë e vrasjes së paligjshme mbeti i ndaluar aty, në një gjendje në prag të vdekjes, ndërkohë që ofensiva serbe po i afrohej zonës. Nga tërësia e provave, i vetmi përfundim i arsyeshëm është se i akuzuari qëllimisht dhe faktikisht i hoqi viktimës së vrasjes së paligjshme çdo mundësi për të mbetur gjallë.

637. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykes konstaton se ndonëse përfundimi më i mundshëm që mund të nxirret është se anëtarët e BIA-s e qëlluan me plumba viktimën e vrasjes së paligjshme para se të largoheshin nga kompleksi i ndalimit në Zllash, ky nuk është i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirret bazuar në tërësinë e provave. Ekziston në fakt dyshim i arsyeshëm nëse vrmat e plumbave të gjetura në trupin e viktimës së vrasjes së paligjshme mund t'u atribuohen anëtarëve të BIA-s apo trupave serbe. Trupi Gjykes gjykon se ky dyshim nuk është imagjinar. Përkundrazi, ai ka lidhje racionale me provat që tregojnë se forcat serbe qëlluan me armë kundër kompleksit të ndalimit në Zllash, me mungesën e provave nëse viktimë e vrasjes së paligjshme u zhvendos apo nuk u zhvendos nga ahuri ku mbahej i ndaluar pasi u pa për herë të fundit nga të ndaluarit e tjerë, dhe nëse u zhvendos, kur u zhvendos, si dhe me mungesën e provave mbi kohën e vdekjes.

638. Gjithsesi, edhe nëse të shtënat me armë do t'u atribuoheshin vetëm forcave serbe, Trupi Gjykes gjykon se kjo nuk do ta lironte të akuzuarin nga përgjegjësia, pasi, si komandant i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash, ai kishte kompetenca të plota vendimmarrëse në lidhje me: (i) keqtrajtimin e rëndë të shkaktuar viktimës së vrasjes së paligjshme nga vartësit e tij të BIA-s; (ii) refuzimin e ndihmës mjekësore për viktimën; dhe (iii) refuzimin për ta liruar atë bashkë me të ndaluarit e tjerë ose për ta evakuuar atë me të plagosurit për shkak të afrimit të



ofensivës serbe. Nga ky këndvështrim, qëllimi i drejtpërdrejtë i viktimës së vrasjes së paligjshme me armë zjarri ose lënia e tij në një situatë që mund të qëllohej nga forcat serbe që po afroreshin — duke e braktisur pa mbrojtje në një gjendje në prag të vdekjes në kompleksin e ndalimit në Zllash — të çon saktësisht në të njëjtin përfundim, pra që lidhja shkakore që kërkohet ndërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të të akuzuarit dhe vdekjes së viktimës, mbetet e pandryshuar. Kjo për shkak se keqtrajtimi i skajshëm që iu bë viktimës së vrasjes së paligjshme, së bashku me refuzimin e ndihmës mjekësore, në kontekstin e vendimeve të të akuzuarit për të mos e liruar apo evakuuar atë, përbëjnë shkaqe të qenësishme për vdekjen e viktimës, pavarësisht nëse viktima u qëllua nga një apo më shumë plumba të serbëve. Si pasojë, i akuzuari mban përgjegjësi për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme.

## 6. Përfundim

639. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykes është bindur se viktima e vrasjes së paligjshme u vra afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të të akuzuarit dhe vartësve të tij të BIA-s, me gjithë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm nëse plagët e shkaktuara nga armët e zjarrit të evidentuara në trupin e viktimës u shkaktuan nga anëtarët e BIA-s apo nga trupat serbe.

## VI. KONSTATIME LIGJORE

### A. NDALIMI ARBITRAR (PIKA 1)

#### 1. Kriteret ligjore

##### (u) Baza ligjore

640. Mbrojtja parashtrohet se ndalimi arbitrar si krim lufte në një konflikt të armatosur jondërkombëtar nuk ka bazë ligjore në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara. Konkretisht, Mbrojtja argumenton se ndalimi arbitrar nuk përfshihet në nenin 14(1)(c) të Ligjit, pasi nuk përmendet në këtë dispozitë, e as në nenin 3 të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 (përkatesisht, neni i përbashkët 3 dhe Konventat e Gjenevës), veçanërisht pasi individët që pretendohet se janë mbajtur të ndaluar nuk ishin persona të mbrojtur brenda kuptimit të Konventave të Gjenevës.<sup>1385</sup>

641. ZPS-ja dhe mbrojtësja e viktimave nuk pajtohen me Mbrojtjen, duke parashtuar, në veçanti, se Gjykata e Apelit tashmë ka konfirmuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara ndaj ndalimit arbitrar si krim lufte në një konflikt të armatosur jondërkombëtar në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit.<sup>1386</sup>

---

<sup>1385</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4721, rreshti 16 deri në f. 4725, rreshti 10; T. 15 shtator 2022, publik, f. 4840, rreshti 19 deri në f. 4841, rreshti 5. *Shih gjithashtu* T. 15 shtator 2022, publik, f. 4794, rreshtat 8-17.

<sup>1386</sup> **ZPS**: T. 15 shtator 2022, publik, f. 4811, rreshti 13 deri në f. 4812, rreshti 2 (*që i referohet* KSC-BC-2020-04, IA002-F00010, Gjykata e Apelit, [Decision on Pjetër Shala's Appeal Against Decision on Motion Challenging the Establishment and Jurisdiction of the Specialist Chambers](#) (Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 04), 11 shkurt 2022, publik, para. 47; KSC-BC-2020-06, IA009-F00030, Gjykata e Apelit, [Decision on Appeals Against "Decision on Motions Challenging the Jurisdiction of the Specialist Chambers"](#) (Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), 23 dhjetor 2021, publik, para. 86-89, 94-102, 106-111); **Mbrojtësja e viktimave**: T. 15 shtator 2022, publik, f. 4821, rreshti 24 deri në f. 4822, rreshti 1. Lidhur me argumentet e tjera të mbrojtësës së viktimave *shih* T. 15 shtator 2022, publik, f. 4822, rreshti 2 deri në f. 4823, rreshti 6.

642. Fillimisht, Trupi Gjykues thekson se, ndonëse ndalimi arbitrar nuk përmendet shprehimisht në listën e veprave penale të renditura në nenin 14(1)(c) të Ligjit, shprehja “duke përfshirë veprat në vijim” nënkupton se lista nuk është shteruese dhe se, për rrjedhojë, juridiksioni i Dhomave të Specializuara nuk kufizohet në veprat e renditura shprehimisht në nenin 14(1)(c) të Ligjit.<sup>1387</sup> Trupi Gjykues gjithashtu rikujton se Gjykata e Apelit konfirmoi se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi ndalimin arbitrar si krim lufte i kryer në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, nëse një krim i tillë ekzistonte në të drejtën zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara dhe nëse ai përbën shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3.<sup>1388</sup>

643. Sa i përket aspektit nëse ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3, Trupi Gjykues rikujton konstatimin e Gjykatës së Apelit se pavarësisht se ndalimi mund të ketë qenë i ligjshëm (në fillim), ai bëhet arbitrar dhe përbën shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3 kur shkelet parimi i trajtimit njerëzor.<sup>1389</sup> Gjykata e Apelit konfirmoi se mosdhënia e garancive procedurale bazë personave të cilëve u është hequr liria, e bën arbitrare këtë heqje lirie.<sup>1390</sup>

644. Sa i përket faktit nëse ky krim ekzistonte në të drejtën zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara, Trupi Gjykues rikujton konstatimin e Gjykatës së Apelit se edhe para vitit 1998, ndalimi arbitrar apo i

---

<sup>1387</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 87; [Case 04 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 04), para. 44. *Shih gjithashtu Confirmation Decision* (Vendimi i Konfirmimit), para. 23.

<sup>1388</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 89. *Shih gjithashtu Case 04 Jurisdictional Appeal* (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 04), para. 44.

<sup>1389</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 97, 99, me referenca të mëtejshme; [Case 04 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 45.

<sup>1390</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 102, ku Gjykata e Apelit konfirmoi konstatimet e Gjykatës të Procedurës Paraprake në KSC-BC-2020-06, F00412, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Decision on Motions Challenging the Jurisdiction of the Specialist Chambers*, (Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara), 22 korrik 2021 (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), publik, para. 155-156.

paligjshëm dënohej gjerësisht dhe njëhej si shkelje e rëndë e të drejtës humanitare ndërkombëtare, përfshirë edhe në konflikte të armatosura jondërkombëtare, dhe se një shkelje e tillë mund të shkaktojë pasoja në aspektin e përgjegjësisë penale. Më konkretisht, Gjykata e Apelit konfirmoi se që në vitin 1998 kishte një rregull në të drejtën zakonore ndërkombëtare që penalizonte ndalimin arbitrar si krim lufte në konfliktet e armatosura jondërkombëtare.<sup>1391</sup>

645. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se ndalimi arbitrar i kryer në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, përbën krim lufte në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit.

(v) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

646. Krimi i luftës i ndalimit arbitrar, brenda kuptimit të nenit 14(1)(c) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi apo mosveprimi që sjell si pasojë heqjen e lirisë së një personi që nuk merr pjesë në luftime, pa bazë ligjore dhe pa përmbushur garancitë procedurale bazë.

647. Heqja e lirisë është pa bazë ligjore nëse nuk përlligjet as prej procesit penal dhe as prej arsyeve për të besuar se heqja e lirisë është absolutisht e domosdoshme për arsye sigurie.<sup>1392</sup>

648. Garancitë procedurale bazë përfshijnë, në veçanti: (i) detyrimin për të informuar çdo person të cilit i është hequr liria për arsyet pse i është hequr liria; (ii) detyrimin për të nxjerrë menjëherë çdo person të cilit i është hequr liria para një gjykatësi apo

<sup>1391</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 106-111. *Shih gjithashtu Case 04 Jurisdictional Appeal* (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 04), para. 46.

<sup>1392</sup> [Confirmation Decision](#), (Vendimi i Konfirmimit), para. 50; [Mucić et al. Appeal Judgement](#), paras 320-322; *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14-A/2-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (Kordić and Čerkez Appeal Judgement), 17 December 2004, paras 72-73; ECCC, *Co-Prosecutors v. Kaing*, 001/18-07-2007/ECCC/TC, Trial Chamber, [Judgement](#), 26 July 2010 (*Duch Trial Judgment*), para. 465.

një autoriteti tjetër kompetent; dhe (iii) detyrimin për t'i dhënë çdo personi të cilit i është hequr liria mundësinë për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.<sup>1393</sup>

649. Arsyeja e dhënies së garancive procedurale bazë qëndron në faktin se, në atë moment, personi të cilit i është hequr liria është jashtë luftimeve dhe, rrjedhimisht, duke qenë se është i ndaluar, nuk paraqet asnjë kërcënim për autoritetet që e kanë ndaluar.

650. Në kryerjen e vlerësimit nëse janë përmbushur garancitë procedurale bazë, nuk ka rëndësi nëse: (i) heqja e lirisë ishte fillimisht e përligjur;<sup>1394</sup> ose (ii) kryesi është personalisht përgjegjës për mosrespektimin e të drejtave të të ndaluarit.<sup>1395</sup>

(w) Elementet mendore (synimi kriminal)

651. Sjellja e kryesit duhet të ketë qenë e qëllimshme. Ekzistenca e synimit për kryerjen e krimit mund të deduktohet nga dijenia e të akuzuarit se po kryhen krime dhe nga pjesëmarrja e tij në vetë kryerjen e këtyre krimeve.<sup>1396</sup> Gjithashtu, nuk duhet të ekzistojnë arsye që kryesi të besojë se ndalimi është absolutisht i domosdoshëm për shkak të shqetësimeve të palëve në konflikt për sigurinë, ose kryesi duhet të dijë se të ndaluarve nuk u janë akorduar garancitë e duhura procedurale, ose të tregojë neglizhencë të qëllimshme nëse këto garanci janë akorduar apo jo.<sup>1397</sup>

<sup>1393</sup> *Shih* [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 99; [Case 06 Jurisdictional Decision](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 150. *Shih gjithashtu* nenin 5(4) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>1394</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 52; ICTY, [Mucić et al. Appeal Judgement](#), para. 322. *Shih gjithashtu*, ICTY, [Kordić and Čerkez Appeal Judgement](#), para. 73; ECCC, [Duch Trial Judgment](#), para. 465.

<sup>1395</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit) para. 52; ICTY, [Mucić et al. Appeal Judgement](#), para. 379.

<sup>1396</sup> ICTR, *Karemera and Ngirumpatse v. Prosecutor*, ICTR-98-44-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Karemera and Ngirumpatse Appeal Judgement*), 29 September 2014, para. 632; ICTY, *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Kvočka et al. Appeal Judgement*), 28 February 2005, paras 109-110.

<sup>1397</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit) para. 53; ICTY, [Mucić et al. Appeal Judgement](#) para. 378.

## 2. Konstatime

### (x) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

652. Trupi Gjykses ka konstatuar se të paktën gjashtë personave, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], iu hoq liria në kompleksin e ndalimit në Zllash afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999.<sup>1398</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se është përmbushur elementi i parë material i ndalimit arbitrar si krim lufte.

653. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka konstatuar se gjatë ndalimit të tyre, të ndaluarve në asnjë moment nuk iu akorduan garancitë bazë, të cilat sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare duhet t'i jepen çdo personi të cilit i hiqet liria.<sup>1399</sup> Konkretisht, të ndaluarit nuk u informuan për arsyet e heqjes së lirisë së tyre; nuk u nxorën menjëherë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent; dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre. Përkundrazi, viktimat u mbajtën të ndaluar, u keqtrajtuuan nga anëtarët e BIA-s, dhe madje njëri prej tyre u vra.<sup>1400</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se është përmbushur elementi i dytë material i ndalimit arbitrar si krim lufte.

### (y) Elementet mendore (synimi kriminal)

654. Trupi Gjykses ka konstatuar se gjatë gjithë periudhës kohore të akuzave, i akuzuari ishte komandant i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s dhe se BIA kontrollonte kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1401</sup> Trupi Gjykses ka konstatuar gjithashtu se i akuzuari ishte i pranishëm në shumë raste në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë prillit 1999, përfshirë dhe në momentet kritike: (i) më [REDAKTUAR] prill 1999 ose

---

<sup>1398</sup> *Shih* para. 495-496.

<sup>1399</sup> *Shih* para. 495-496.

<sup>1400</sup> *Shih* konstatimet faktike të Trupit Gjykses në Pjesën V për Pikat 1-4.

<sup>1401</sup> *Shih* para. 338-341, 349-353.

rreth [REDAKTUAR], kur viktima e vrasjes së paligjshme iu dorëzua [REDAKTUAR] një anëtarë të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash; dhe (ii) në dy javët e para të prillit 1999, konkretisht kur i akuzuari keqtrajtoi personalisht ose ishte dëshmitar i keqtrajtimit të W01679-ës dhe W03593-shit<sup>1402</sup> nga vartësit e tij të BIA-s. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka konstatuar se vendimi për lirim të disa të ndaluarve dhe për mbajtjen e të tjerëve në ndalim, me gjithë afrimin e ofensivës serbe, mund të merrej vetëm nga i akuzuari, si komandant i BIA-s.<sup>1403</sup> Së fundi, vetë i akuzuari, në deklaratën e tij për ZPS-në, deklaroi se ishte në dijeni ose së paku kishte dëgjuar se në kompleksin e ndalimit në Zllash po mbaheshin të ndaluar disa persona (ndër të cilët mund të kishte dhe civilë).<sup>1404</sup>

655. Po ashtu, anëtarët e BIA-s ishin të pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë kohës që përfshijnë akuzat dhe i mbanin viktimat të kyçura në ahuret e ndalimit, nxirrnin disa prej tyre nga ahuret për t'i marrë në pyetje ashpërsisht, i keqtrajtonin ata në mënyra të ndryshme dhe në vijim i kthenin në ahuret ku mbaheshin të ndaluar.<sup>1405</sup> Anëtarë të BIA-s, ndër të cilët zëvendësi i të akuzuarit, gjithashtu liruan personalisht disa nga të ndaluarit më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date ([REDAKTUAR]), ndërsa të tjerët i mbajtën në ndalim (viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR]).<sup>1406</sup>

656. Edhe vetëm mbi këtë bazë faktike, Trupi Gjykses gjykon se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se i akuzuari dhe vartësit e tij të BIA-s, i panë të ndaluarit dhe e dinin se ata u mbajtën në kompleksin e ndalimit në Zllash afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, dhe u hoqën atyre qëllimisht lirinë gjatë kësaj kohe. Në lidhje me të akuzuarin në veçanti, Trupi Gjykses rikujton se ai pa të paktën një të ndaluar kur mbërriti në kompleksin e ndalimit në Zllash, keqtrajtoi personalisht dy të ndaluar në

---

<sup>1402</sup> *Shih* para. 473, 541-545, 551-556.

<sup>1403</sup> *Shih* para. 636.

<sup>1404</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET Part (Pjesa) 7, f. 15, rreshtat 7-15.

<sup>1405</sup> *Shih, për shembull*, para. 534, 546, 547, 561, 567, dhe 572.

<sup>1406</sup> [REDAKTUAR].



kompleksin e ndalimit në Zllash, dhe pasi e rrahu W03593-shin, urdhëroi vartësit e tij të BIA-s që ta kthenin në ahurin ku mbahej i ndaluar.<sup>1407</sup> Sa më sipër tregon se, i akuzuari jo vetëm që e dinte se në kompleksin e ndalimit në Zllash po mbaheshin viktima, por ai kishte edhe synimin që t'i mbante ata të ndaluar.

657. Rrethana të tjera konfirmojnë qartësisht dijeninë e të akuzuarit se në kompleksin e ndalimit në Zllash të ndaluarit u mbajtën pa garanci bazë, dhe se ai i mbajti ata qëllimisht të burgosur pa garanci të tilla. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses e konsideron të një rëndësie të veçantë pozitën e të akuzuarit si komandant i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s.<sup>1408</sup> Për shkak të kësaj pozite, në kompleksin e ndalimit në Zllash i akuzuari ishte personi i cili kishte përgjegjësinë të siguronte që të ndaluarve t'u jepeshin garancitë bazë. Konkretisht, kur W01679 u arrestua fillimisht, anëtarët e BIA-s i thanë se “po don komandanti diçka me bisedu me ty” dhe e çuan atë drejtpërdrejt te i akuzuari pas mbërritjes në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1409</sup> Në një rast tjetër, pasi i akuzuari mori në pyetje dhe rrahu personalisht W03593-shin, ai urdhëroi dy anëtarë të BIA-s që ta kthenin dëshmitarin sërish në ahur.<sup>1410</sup>

658. Po ashtu, Trupi Gjykses gjykon se i akuzuari, si komandant i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s, ishte i vetmi person në kompleksin e ndalimit në Zllash që kishte kompetencë të lironte të ndaluarit. I akuzuari në fakt e ushtroi kompetencën e tij në këtë aspekt, por vetëm pasi disa të ndaluar ishin mbajtur dhe keqtrajtuar për gati tri javë. I akuzuari e bëri këtë *vetëm* për shkak të një ndryshimi kritik të rrethanave — ofensivës serbe — e cila i detyroi ushtarët e BIA-s nën komandën e tij, ndër të cilët edhe zëvendësi i tij z. Mehmetaj (me pseudonimin Bimi), që të lironin të ndaluarit dhe të evakuonin kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1411</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses ka

---

<sup>1407</sup> *Shih* para. 473, 541-545, 551-556.

<sup>1408</sup> *Shih* para. 338.

<sup>1409</sup> *Shih* para. 388.

<sup>1410</sup> *Shih* para. 547.

<sup>1411</sup> [REDAKTUAR]. *Shih* gjithashtu para. 636.

konstatuar se, me gjithë lirimin e papritur të të ndaluarve dhe evakuimin e kompleksit të ndalimit në Zllash, viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] - dy të ndaluarit më të keqtrajtuar - nuk u liruan.<sup>1412</sup> Mbi bazën e provave Trupi Gjykses ka konstatuar se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se këto dy vendime (lirimi i disa prej të ndaluarve duke i thirrur me emra, dhe mbajtja në ndalim e të tjerëve) — shqyrtuar në të njëjtin kontekst — mund të merreshin vetëm nga i akuzuari, si komandant i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1413</sup>

659. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se pjesëmarrja personale e të akuzuarit në keqtrajtimin e dy të ndaluarve, së bashku me dijeninë e tij se në kompleksin e ndalimit në Zllash mbaheshin persona të ndaluar, tregojnë se i akuzuari u hoqi qëllimisht lirinë këtyre personave dhe e dinte se atyre nuk u ishin dhënë garanci bazë gjatë gjithë kohës sa zgjati mbajtja e tyre në ndalim. E njëjta gjë vlen edhe për anëtarët e BIA-s që ishin të pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë kohës që mbulojnë akuzat. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se janë vërtetuar elementet mendore të ndalimit arbitrar si krim lufte.

## B. TRAJTIMI MIZOR (PIKA 2)

### 1. Kriteret ligjore

#### (z) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

660. Krimi i trajtimit mizor si krim lufte, brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet përmes një veprimi ose mosveprimi që shkakton vuajtje ose lëndim të rëndë mendor ose fizik, ose që përbën një cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor.<sup>1414</sup>

---

<sup>1412</sup> *Shih* para. 477.

<sup>1413</sup> *Shih* para. 636.

<sup>1414</sup> ICTY, *Mucić et al. Appeal Judgement*, para. 424. *Shih gjithashtu* TPNJ, Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve, IT-04-84-A, Appeals Chamber, *Judgement*, 19 July 2010, paras 93-94; *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-A, Appeals Chamber, *Judgement*, 29 July 2004, para. 595.

661. Shkalla e rëndësisë së dëmit ose lëndimit duhet vlerësuar rast pas rasti, duke marrë parasysh faktorë si: (i) ashpërsia e sjelljes së pretenduar; (ii) lloji i veprimit ose mosveprimit; (iii) konteksti në të cilin ka ndodhur sjellja; (iv) kohëzgjatja dhe/ose përsëritja e sjelljes; (v) ndikimi fizik dhe mendor i sjelljes mbi viktimën; dhe (vi) rrethanat personale të viktimës, ndër të cilat mosha, gjinia dhe gjendja shëndetësore.<sup>1415</sup>

662. Vuajtja e shkaktuar nga veprimi ose mosveprimi mbi viktimën nuk është e nevojshme të jetë afatgjatë, me kusht që të jetë reale dhe e rëndë.<sup>1416</sup>

(aa) Elementet mendore (synimi kriminal)

663. Kryesi duhet të ketë vepruar në mënyrë të qëllimshme ose me dijeninë se vuajtja apo lëndimi i rëndë mendor ose fizik, ose cenimi i rëndë i dinjitetit njerëzor, ishte pasojë e mundshme e veprimit ose mosveprimit.<sup>1417</sup>

## 2. Lidhja ndërmjet trajtimit mizor dhe torturës

664. Për hir të drejtësisë ndaj të akuzuarit, vetëm krime të veçanta mund të përlligjin verdikte fajësie të shumëfishtë.<sup>1418</sup> Trupi Gjykues gjykon se, kur dy vepra penale dispozitat për të cilat mbrojnë të njëjtën vlerë (vlera) apo interes (interesa) shoqërore,

<sup>1415</sup> ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber II, [Judgement](#), Vol. I (*Popović et al. Trial Judgement*), 10 June 2010, fn. 3249; [Kvočka et al. Appeal Judgement](#), paras 584-585; *Prosecutor v. Mrkšić et al.*, IT-95-13/1-T, Trial Chamber II, [Judgement](#) (*Mrkšić et al. Trial Judgement*), 27 September 2007, paras 516, 525, 537; *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25-T, Trial Chamber II, [Judgment](#) (*Krnojelac Trial Judgment*), 15 March 2002, para. 131.

<sup>1416</sup> ICTY, [Krnojelac Trial Judgment](#), para. 131.

<sup>1417</sup> ICTY, [Popović et al. Trial Judgement](#) para. 974; [Mrkšić et al. Trial Judgement](#), para. 516; *Prokurori kundër Limajt dhe të tjerëve*. IT-03-66-T, Dhoma Gjyqësore II, [Judgement](#) (Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*) 30 nëntor 2005, para. 231; *Prosecutor v. Strugar*, IT-01-42-T, Trial Chamber II, [judgement](#), 31 January 2005, para. 261.

<sup>1418</sup> *Shih gjithashtu* ICTY, [Mucić et al. Appeal Judgement](#), para. 412; *Prosecutor v. Kunarac et al.*, IT-96-23 & IT-96-23/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Kunarac et al. Appeal Judgement*), 12 June 2002, para. 169.

verdiktet për fajësi të shumëfishtë për të dyja veprat bazuar në të njëjtën sjellje, në parim nuk janë të lejueshme.<sup>1419</sup> Nëse e njëjta sjellje përmbush kushtet e dy dispozitave të ndryshme ligjore, të cilat të dyja mbrojnë të njëjtën vlerë (vlera) apo interes (interesa), mbizotëron dispozita më specifike.<sup>1420</sup> Nëse njëra dhe vetëm njëra dispozitë kërkon një element shtesë që nuk kërkohet nga tjetra, dispozita e parë zakonisht do të ishte ajo më specifike dhe do të mbizotëronte,<sup>1421</sup> pasi në raste të tilla nuk është e mundur të kryhet vepra më specifike pa kryer gjithashtu (dhe njëkohësisht) veprën më pak specifike.<sup>1422</sup> Me fjalë të tjera, vepra penale më specifike përfshin ose mbulon plotësisht veprën më pak specifike.<sup>1423</sup>

665. Neni 14(1)(c) i Ligjit që trajton torturën dhe trajtimin mizor mbron të njëjtën vlerë (vlera) ose interes (interesa) shoqërore, në veçanti, integritetin fizik dhe mendor dhe dinjitetin njerëzor të personave që nuk marrin pjesë aktivisht në luftime.<sup>1424</sup> Gjithashtu,

---

<sup>1419</sup> Në lidhje me “standardin e vlerës”, shih gjithashtu ICTY, *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (*Kupreškić et al. Trial Judgement*), 14 January 2000, paras 692-695; *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-T, Trial Chamber, [Decision on Defence Challenges to Form of the Indictment](#), 15 May 1998, para. 6 (lidhur me atë nëse Prokurori mund të paraqesë akuza të shumëfishta ose jo); ICTR, *Prosecutor v. Akayesu*, ICTR-96-4-T, Trial Chamber I, [Judgement](#) (*Akayesu Trial Judgment*), 2 September 1998, para. 468; Stuckenberg, C., “Multiplicity of Offences: Concursum Delictorum”, in Fischer H., Kress C. and Lüder S. (eds), *International and National Prosecution of Crimes Under International Law*, Berlin Verlag 2001, in particular pp. 582, 586.

<sup>1420</sup> Shih gjithashtu ICTY, [Kupreškić et al. Trial Judgement](#), para. 683-685.

<sup>1421</sup> Në mënyrë të ngjashme edhe, për shembull, ICTY [Mucić et al. Appeal Judgement](#), para. 413; [Kordić and Čerkez Appeal Judgement](#), para. 1032; [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 168; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2792; [Bemba et al. Trial Judgment](#), para. 951; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 1202; [Katanga Trial Judgment](#), para. 1695; [Bemba Trial Judgment](#), paras 747-748; [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 750. Dispozita të qarta të legjislacionit vendor në lidhje me këtë aspekt mund të gjenden, për shembull në [Article 55\(2\) of the Dutch Criminal Code](#) dhe [Article 15 of the Italian Criminal Code](#).

<sup>1422</sup> Në mënyrë të ngjashme, për shembull, ICTY, [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 170; *Prosecutor v. Krstić*, IT-98-33-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 19 April 2004, para. 218.

<sup>1423</sup> Shih ICTY, [Kupreškić et al. Trial Judgement](#), paras 662, 665, 680-692, 707; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2796; [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 751. Nga legjislacionet vendore, një dispozitë e qartë dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me këtë aspekt mund të gjendet, për shembull, në [Article 8\(3\) of the Spanish Criminal Code](#).

<sup>1424</sup> Shih para. 660-663, 668-673; 2016 ICRC Commentary lidhur me nenin 3, para. 590; ICTY, *Prosecutor v. Aleksovski*, IT-95-14/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#), 25 June 1999, para. 49; ICTY, *Prosecutor v. Mucić et al.*, IT-96-21-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (*Mucić et al. Trial Judgement*), 16 November 1998, para. 551.

siç konstatohet më poshtë, për torturën nevojitet një element shtesë, konkretisht që kryesi duhet ta ketë shkaktuar dhimbjen ose vuajtjen jo vetëm qëllimisht, por edhe me synime të tilla si marrja e informatave ose e një deklaratë pranuese, ose ndëshkimi, frikësimi, shtrëngimi ose diskriminimi, për çfarëdo arsyeje, i viktimës ose një personi të tretë.<sup>1425</sup> Siç u konstatua më lart, ky element mendor shtesë nuk kërkohet për krimin e trajtimit mizor – për trajtimin mizor, në krahasim me torturën, nuk nevojitet një element shtesë.<sup>1426</sup> Me fjalë të tjera, elementet ligjore të trajtimit mizor mbulohen tërësisht nga elementet ligjore të torturës.<sup>1427</sup>

666. Trupi Gjykes thekson se faktet në të cilat bazohet akuza për trajtim mizor (Pika 2) dhe faktet në të cilat bazohet akuza për torturë (Pika 3) janë të njëjta.<sup>1428</sup> Në vlerësimin e peshës ose shkallës së dëmit ose vuajtjes që u është shkaktuar të ndaluarve, Trupi Gjykes ka marrë parasysh në tërësi të gjitha veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve të BIA-s (ndër të cilët dhe i akuzuari), përfshirë kushtet e ndalimit, keqtrajtimin psikologjik të pësuar nga të ndaluarit dhe keqtrajtimin fizik që iu bë atyre në ahur (ahure), në dhomën e marrjes në pyetje apo diku tjetër në kompleksin e ndalimit në Zllash.

667. Rrjedhimisht, meqenëse kriteret e trajtimit mizor dhe torturës si krime lufte përmbushen mbi bazën e së njëjtës sjellje, dhe tortura është vepra penale më specifike, akuza për trajtim mizor nuk do të shqyrtohet më tej në kuadër të përcaktimit të dënimit.<sup>1429</sup> Akuza e trajtimit mizor mbulohet plotësisht nga akuza e torturës dhe

<sup>1425</sup> *Shih* para. 672-673, me referenca të mëtejshme.

<sup>1426</sup> *Shih* para. 660-663, me referenca të mëtejshme. *Shih, në veçanti, edhe* TPNJ, Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve, IT-04-84-T, Dhoma Gjyqësore I, [Judgement](#) (Aktgjykimi *Haradinaj*), 3 prill 2008, para. 480; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2835.

<sup>1427</sup> *Shih gjithashtu* ICTY, [Kupreškić et al. Trial Judgment](#), paras 679, 690-692 (që përmban referenca nga ECtHR, *Aksoy v. Turkey*, no. 21987/93, [Judgment](#), 18 December 1996, para. 64); [Mucić et al. Trial Judgment](#), para. 442.

<sup>1428</sup> *Shih* [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 21-30; Pjesa V.C.

<sup>1429</sup> *Shih gjithashtu* ICTY, [Kupreškić et al. Trial Judgment](#) para. 719; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Dorđević*/Prokurori k. Gjorgjeviqit, IT-05-87/1-A, Dhoma e Apelit, [Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*), 27 janar 2014, para. 839 (me referenca të mëtejshme në poshtëshënimin 2447).

përgjegjësia penale individuale e të akuzuarit pasqyrohet plotësisht në një verdikt fajësie për torturën.

## C. TORTURA (PIKA 3)

### 1. Kriteret ligjore

#### (bb) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

668. Krimi i torturës si krim lufte brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që shkakton dhimbje ose vuajtje të rëndë, qoftë fizike apo mendore,<sup>1430</sup> mbi një person tjetër.<sup>1431</sup> Duhet të shqyrtohet rast pas rasti nëse veprimi apo mosveprimi i përmbush kriteret e aktit të torturës,<sup>1432</sup> duke marrë parasysh, për shembull (i) llojin dhe rrethanat e shkakimit të dhimbjes; (ii) paramendimin dhe institucionalizimin e keqtrajtimit; (iii) gjendjen fizike të viktimës; (iv) moshën, gjininë dhe gjendjen shëndetësore të viktimës; (v) mënyrën dhe metodat e përdorura; (vi) pozitën inferiore të viktimës; (vii) shkallën e keqtrajtimit të individit për një periudhë të zgjatur kohe; dhe (viii) nëse viktima është bërë objekt i formave të përsëritura ose të ndryshme të keqtrajtimit të cilat janë të ndërlidhura,

<sup>1430</sup> ICTY, *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (*Kvočka et al. Trial Judgement*), 2 November 2001, para. 149, ku konstatohet se dëmi mendor është në fakt një formë e përhapur e torturës.

<sup>1431</sup> ICTY/TPNJ, [Haradinaj Appeal Judgment](#) (Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj*), para. 290; [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 142. *Shih gjithashtu*, ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2700; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-424, Pre-Trial Chamber II, [Decision Pursuant to Article 61\(7\)\(a\) and \(b\) of the Rome Statute on the Charges of the Prosecutor Against Jean-Pierre Gombo](#), 15 June 2009, para. 292; ECCC, [Duch Trial Judgment](#), para. 354.

<sup>1432</sup> ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2701; ICTY, *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Brđanin Appeal Judgment*), 3 April 2007, para. 251; *Prosecutor v. Naletilić and Martinović*, IT-98-34-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Naletilić and Martinović Appeal Judgment*), 3 May 2006, para. 299; [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 149.



kryhen sipas një praktike të caktuar sjelljeje, ose bëhen për arritjen e të njëjtit qëllim të ndaluar, rast në të cilin pesha e veprimeve duhet të vlerësohet në tërësi.<sup>1433</sup>

669. Kushtet e imponuara gjatë ndalimit si rrahjet, dhuna seksuale, pamundësimi për një kohë të gjatë i gjumit, ushqimit, higjienës dhe ndihmës mjekësore, si dhe kërcënimet me torturë, përdhunim ose vrasje të të afërmeve, janë vlerësuar mjaftueshëm të rënda sa të përbëjnë torturë.<sup>1434</sup> Më konkretisht, ekspozimi i dikujt ndaj frikës së vdekjes, ekzekutimit, torturës apo vuajtjes, ose kërcënimi i tij ose i saj me to, ose në përgjithësi ngjallja e frikës për shkak të kushteve të ndalimit, mund të shkaktojë ankth të rëndë mendor ose vuajtje dhe/ose trauma psikologjike.<sup>1435</sup> Në veçanti, dhimbja ose vuajtja e rëndë mendore mund të shkaktohet kur të ndaluarit detyrohen të jetojnë në një atmosferë të vazhdueshme frike dhe ankthi se mund të bëhen objekt i keqtrajtimit fizik apo edhe të vriten. Kjo ndodh sidomos kur të ndaluarit: (i) janë dëshmitarë, shohin ose dëgjojnë të tjerët duke u rrahur ose keqtrajtuar; (ii) shohin personat e tjerë kur merren për qëllime të tilla – që mund të shoqërohet me një përzgjedhje (në dukje) arbitrare të të ndaluarve për keqtrajtim; dhe/ose (iii) shohin më

<sup>1433</sup> ICTY, *Prosecutor v. Simić et al.*, IT-95-9-T, Trial Chamber II, [Judgment](#) (*Simić et al. Trial Judgment*), 17 October 2003, para. 80, që i referohet [Krnjelac Trial Judgment](#), para. 182; [Mrkšić et al. Trial Judgment](#), para. 514, që i referohet [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 143. *Shih gjithashtu* ECCC, [Duch Trial Judgment](#), para. 355.

<sup>1434</sup> ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-461-Corr-Red, Pre-Trial Chamber I, [Rectificatif à la Décision relative à la confirmation des charges portées contre Al Hassan Ag Abdoul Aziz Ag Mohamed Ag Mahmoud](#), 13 November 2019 (date of original: 30 September 2019), para. 231; ECCC, [Duch Trial Judgment](#) para. 355, që i referohet ICTY, [Mucić et al. Trial Judgment](#), para. 467; [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 151.

<sup>1435</sup> ECtHR, *Soering v. the United Kingdom*, Plenary, Application no. 14038/88, [Judgment](#), 7 July 1989, para. 68, 81, 105, 111; *Ilaşcu and others v. Moldova and Russia*, Chamber, Application no. 48787/99, [Judgment](#) (*Ilaşcu et al. v. Moldova and Russia*), 8 July 2004, para. 240-253; *Tyrer v. the United Kingdom*, Chamber, Application no. 5856/72, [Judgment](#), 25 April 1978, para. 9-10, 33; *Campbell and Cosans v. the United Kingdom*, Chamber, Application no. 7511/76; 7743/76, [Judgment](#), 25 February 1982, para. 26 (ku specifikohet se kërcënimi duhet të jetë mjaftueshmërisht real dhe i drejtpërdrejtë); *Hristovi v. Bulgaria*, Fourth Section, Application no. 42697/05, [Judgment](#), 11 October 2011, para. 80; *Gutsanovi v. Bulgaria*, Fourth Section, Application no. 34529/10, [Judgment](#), 15 October 2013, para. 125.



pas lëndimet e shkaktuara.<sup>1436</sup> Veprime të tilla mund të përbëjnë torturë,<sup>1437</sup> me kusht që të vërtetohet elementi i nevojshëm mendor.

670. Në mënyrë të ngjashme, *detyrimi* i dikujt për të parë ose dëgjuar keqtrajtimin e personave të tjerë, qoftë vrasje, ekzekutim, rrahje, torturim apo përdhunim i tyre, mund të shkaktojë dhimbje, vuajtje dhe/ose keqtrajtim psikologjik të rëndë,<sup>1438</sup> dhe mund të përbëjë torturë, me kusht që të përmbushet elementi i nevojshëm mendor.<sup>1439</sup>

671. Nuk është e nevojshme që pasojat e veprimit ose mosveprimit të jenë të dukshme te viktimat që të përbëjnë torturë dhe as nuk është kusht që lëndimi të jetë i përhershëm.<sup>1440</sup> Gjithashtu, nuk është kusht që kryesi të ketë vepruar në cilësinë e një zyrtari publik apo të një personi me pozitë eprore.<sup>1441</sup>

(cc) Elementet mendore (synimi kriminal)

672. Kryesi duhet ta ketë shkaktuar dhimbjen dhe vuajtjen në mënyrë të qëllimshme dhe për qëllime të tilla si marrja e informatave ose e një deklaratë pranuese, ose ndëshkimi, frikësimi, shtrëngimi ose diskriminimi, për çfarëdo arsyeje, i viktimës ose

<sup>1436</sup> ICTY/TPNJ, [Limaj et al. Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*), para. 293-294.

<sup>1437</sup> ICTY, [Simić et al. Trial Judgement](#), para. 772.

<sup>1438</sup> ICTY/TPNJ, [Limaj et al. Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*), para. 290-293; *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-T, Trial Chamber II, [Judgement](#) (*Brđanin Trial Judgement*), 1 September 2004, paras 508-511; [Simić et al. Trial Judgement](#), paras 695, 771; *Prosecutor v. Furundžija*, IT-95-17/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#) (*Furundžija Trial Judgement*), 10 December 1998, para. 267(ii); [Krnojelac Trial Judgment](#), paras 143-144; ICTR, *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*, ICTR-95-1-T, Trial Chamber II, [Judgement](#) (*Kayishema and Ruzindana Trial Judgement*), 21 May 1999, para. 153; SCSL, *Prosecutor v. Fofana et al.*, SCSL-04-14-T, Trial Chamber I, [Judgement](#), 2 August 2007, para. 153; ICC, *Prosecutor v. Ali Kushayb*, ICC-02/05-01/20-433-Corr, Pre-Trial Chamber II, [Corrected version of 'Decision on the confirmation of charges against Ali Muhhammad Ali Abd-Al-Rahman \('Ali Kushayb'\)](#), 23 November 2021 (date of original: 9 July 2021), paras 44-45; *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-422-Red, Pre-Trial Chamber II, [Decision on the confirmation of charges against Dominic Ongwen](#), 23 March 2016, paras 111-112; *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-717, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the confirmation of charges](#), 30 September 2008, paras 361, 363.

<sup>1439</sup> ICTY, [Brđanin Trial Judgement](#), para. 524; [Kvočka et al. Trial Judgement](#), paras 149, 151; [Furundžija Trial Judgement](#), para. 268.

<sup>1440</sup> ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2701; ECCC, [Duch Trial Judgment](#), para. 355.

<sup>1441</sup> ICTY, [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 148; [Kvočka et al. Appeal Judgement](#), para. 284.

një personi të tretë.<sup>1442</sup> Sidoqoftë, kjo listë qëllimesh nuk është shteruese.<sup>1443</sup> Mjafton që një prej qëllimeve të ndaluara të jetë pjesë e motivimit për sjelljen; nuk është e nevojshme që të jetë “qëllimi mbizotërues ose i vetëm” në shkaktimin e dhimbjes apo vuajtjes së rëndë.<sup>1444</sup> Në qoftë se sjellja përmbush një qëllim të ndaluar, nuk është juridikisht thelbësor fakti që ajo sjellje synonte të arrinte edhe një qëllim tjetër.<sup>1445</sup>

673. Qëllimi i frikësimit, për shembull, mund të përmbushet në qoftë se një person detyrohet të shohë ekzekutimin e personave të tjerë.<sup>1446</sup> Qëllimi i frikësimit mund të përmbushet edhe në qoftë se, për shembull, në mjediset e një kampi burgimi një person i armatosur ushtron dhunë ndaj një të ndaluarit dhe të ndaluarit e tjerë e dinë se po ushtrohet një dhunë e tillë, pasi kjo gjë mund të krijojë një atmosferë frike dhe pafuqie mes të ndaluarve.<sup>1447</sup> Gjithashtu, simulimi i ekzekutimit të një personi mund të jetë tregues i qëllimit të frikësimit dhe mund të përbëjë torturë, pasi rrit në përgjithësi ankthin që ndjen viktimja gjatë kohës së ndalimit të tij ose të saj në lidhje me mundësinë e ekzekutimit të tij ose të saj.<sup>1448</sup>

---

<sup>1442</sup> ICTY, [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 153 (ku gjithashtu trajtohet dallimi midis synimit dhe motivimit); [Limaj et al. Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*), para. 235, 239; ECCC, [Duch Trial Judgement](#), para. 356.

<sup>1443</sup> *Shih*, për shembull, , ICTY, [Mucić et al. Trial Judgement](#), para. 470; [Brđanin Trial Judgement](#), para. 487; [Mrkšić et al. Trial Judgement](#), para. 515; [Kvočka et al. Trial Judgement](#), para. 140; [Furundžija Trial Judgement](#), para. 162 (ku është shtuar poshtërimi).

<sup>1444</sup> ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2706; ICTY, [Simić et al. Trial Judgement](#), para. 81; [Kvočka et al. Trial Judgement](#), para. 153; [Mucić et al. Trial Judgement](#), para. 470; ECCC, [Duch Trial Judgment](#), para. 356.

<sup>1445</sup> ICTY, [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 155; *Prosecutor v. Kunarac et al.*, IT-96-23 & IT-96-23/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#), 22 February 2001, paras 486, 654.

<sup>1446</sup> *Shih* ICTY, [Brđanin Trial Judgement](#), paras. 503-507.

<sup>1447</sup> ICTY, [Mucić et al. Trial Judgement](#), para. 941; [Kvočka et al. Trial Judgement](#), para. 154.

<sup>1448</sup> ECtHR, [Ilaşcu et al. v. Moldova and Russia](#), para. 435, 442.

## 2. Konstatime

(dd) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

674. Trupi Gjykues ka konstatuar se të paktën gjashtë persona, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktimat e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR], rregullisht u keqtrajtuan fizikisht nga i akuzuari dhe nga anëtarë të tjerë të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1449</sup> Të ndaluarit u rrahën me mjete të ndryshme si shkopinj bejsbolli, bishta sakice, shufra hekuri ose shkopinj druri/gome; u dogjën me një hekur ose dyllë të nxehtë qirinsh; iu vunë rrymë elektrike në trup; u shpuan me thikë; u shkelmuan, u goditën me grushte dhe shuplaka çdo ditë.<sup>1450</sup> Shpesh të ndaluarit u keqtrajtuan nga disa anëtarë të BIA-s njëherësh dhe disa prej tyre u rrahën për orë të tëra.<sup>1451</sup> Keqtrajtimi u shkaktoi atyre mavijosje, ënjtje, gjakosje, rraskapitje, humbje të vetëdijes, dhe pafuqi për të qëndruar në këmbë, për të ecur apo për të folur.<sup>1452</sup> Viktima e vrasjes së paligjshme u keqtrajtua aq rëndë, sa në kohën kur u liruan të ndaluarit e tjerë, ai ishte pothuajse i vdekur.<sup>1453</sup> Disa nga të ndaluarit në atë kohë ishin veçanërisht [REDAKTUAR]: [REDAKTUAR].<sup>1454</sup>

675. Trupi Gjykues gjithashtu ka konstatuar se të ndaluarit rregullisht u keqtrajtuan psikologjikisht nga i akuzuari dhe anëtarë të tjerë të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash. Ata jetonin me frikën e vazhdueshme se mund të bëheshin në çdo moment objekt i keqtrajtimit fizik, apo edhe të vriteshin.<sup>1455</sup> Në një rast, i akuzuari bëri sikur do ta ekzekutonte një prej të ndaluarve, W03593-shin.<sup>1456</sup> Të ndaluarit gjithashtu u

---

<sup>1449</sup> *Shih* para. 584, 586.

<sup>1450</sup> *Shih* para. 529, 534, 535, 546, 547, 560, 567, 570.

<sup>1451</sup> *Shih* para. 534, 535, 546, 567, 570.

<sup>1452</sup> *Shih* para. 534, 546, 567, 569-571, 575, 577.

<sup>1453</sup> *Shih* para. 571.

<sup>1454</sup> *Shih* para. 534, 577.

<sup>1455</sup> *Shih* para. 530-531, 585.

<sup>1456</sup> *Shih* para. 546, 585.

detyruan të shihnin keqtrajtimin fizik të ushtruar ndaj të ndaluarve të tjerë: ata i panë ata kur i rrihnin, panë lëndimet në trupat e tyre dhe/ose dëgjuan britmat e tyre teksa keqtrajtoheshin.<sup>1457</sup> Kjo atmosferë e frikës së vazhdueshme u ushqye edhe nga fakti se të ndaluarit nuk u informuan për arsyet e heqjes së lirisë, atyre ua mbulonin kokën me thes kur i çonin në ahur (ahure) ose kur i merrnin prej ahurit (ahureve), u thuhej të mos shikonin përreth, mbaheshin në errësirë, nuk lejoheshin të flisnin me njëri-tjetrin dhe nuk lejoheshin të flinin.<sup>1458</sup>

676. Gjithashtu, Trupi Gjykues ka konstatuar se anëtarët e BIA-s krijuan dhe mbajtën kushte çnjerëzore në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1459</sup> Të ndaluarit mbaheshin në ahure për kafshë.<sup>1460</sup> Ata nuk kishin shtretër dhe flinin në grazhdin e ushqimit të kafshëve ose në tokë, në pellgje uji, me jashtëqitjet e bagëtive përreth tyre dhe me vetëm pak kashtë e disa batanije si shtroja dhe mbuloja.<sup>1461</sup> Ata mbaheshin në errësirë dhe nuk lejoheshin të flisnin me njëri-tjetrin, duke u kërcënuar me vdekje.<sup>1462</sup> Atyre u jepej sasi e pamjaftueshme ushqimi dhe uji.<sup>1463</sup> Kur W01679 kërkoi ujë, mbi të u urinua.<sup>1464</sup> Të ndaluarve nuk u lejohej të laheshin apo të ndërronin teshat.<sup>1465</sup> Ata lejoheshin të shkonin në banjë shumë rrallë dhe detyroheshin t'i kryenin nevojat personale në ahur, në një kovë, në prani të njëri-tjetrit.<sup>1466</sup> Çka është më e rëndësishme, atyre iu refuzua ndihma mjekësore, me gjithë lëndimet e rënda që pësuan si pasojë e keqtrajtimit.<sup>1467</sup>

---

<sup>1457</sup> *Shih* para. 530-531, 585.

<sup>1458</sup> *Shih* para. 532, 585.

<sup>1459</sup> *Shih* para. 527, 584.

<sup>1460</sup> *Shih* para. 503, 584.

<sup>1461</sup> *Shih* para. 503-505, 509, 584.

<sup>1462</sup> *Shih* para. 506, 523-525, 584.

<sup>1463</sup> *Shih* para. 510-514, 584.

<sup>1464</sup> *Shih* para. 511.

<sup>1465</sup> *Shih* para. 516-517, 584.

<sup>1466</sup> *Shih* para. 518, 584.

<sup>1467</sup> *Shih* para. 520-522, 584.

677. Keqtrajtimi fizik dhe psikologjik, bashkë me kushtet çnjerëzore të ndalimit, u shkaktuan të ndaluarve lëndime afatgjata fizike dhe psikologjike, ndër të cilat: lëndime në kokë, lëndime nga djegiet, thyerje të krahëve, gishtave dhe/ose dhëmbëve, çka bëri që ata t'i përdornin në mënyrë të kufizuar duart; dhimbje të vazhdueshme dhe të forta në të gjithë trupin; dëmtim të shikimit; ndjenjë turpi; dhe simptoma të çrregullimeve të stresit pastraumatik (makthe, fanitje të ngjarjeve traumatike dhe kujtime tronditëse të pavullnetshme).<sup>1468</sup>

678. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykes konstaton se i akuzuari dhe anëtarë të tjerë të BIA-s u shkaktuan dhimbje dhe vuajtje të rënda fizike dhe mendore të paktën gjashtë personave të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes konstaton se janë përmbushur elementet materiale të torturës si krim lufte.

(ee) Elementet mendore (synimi kriminal)

679. Trupi Gjykes ka konstatuar se i akuzuari: (i) personalisht goditi me shuplakë W01679-ën dhe urdhëroi anëtarë të tjerë të BIA-s që ta rrihnin derisa ai humbi ndjenjat;<sup>1469</sup> (ii) në një rast, bëri sikur do ta ekzekutonte W03593-shin, teksa anëtarë të tjerë të BIA-s po e rrihnin dhe e akuzonin se kishte bashkëpunuar me serbët; dhe (iii) në një rast tjetër, e rrahu personalisht W03593-shin me një shkop bejsbolli në të gjithë trupin, duke e kërcënuar se do ta vriste.<sup>1470</sup>

680. Trupi Gjykes gjithashtu ka konstatuar se anëtarë të tjerë të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash, ndër të cilët Nazif Musliu (me pseudonimin Tabuti), Ilmi Vela, z. Mehmetaj (me pseudonimin Bimi), Dardani, Afrimi dhe Fatmiri: (i) i keqtrajtuat vazhdimisht të ndaluarit në mënyra të ndryshme: duke i shkelmuar dhe goditur me

---

<sup>1468</sup> *Shih* para. 531, 540, 550.

<sup>1469</sup> *Shih* para. 534, 541-542.

<sup>1470</sup> *Shih* para. 546-547, 551-554.

shufra hekuri ose shkopinj druri/gome dhe me bishta sakice, duke i djegur, duke u vënë rrymë elektrike në trup dhe duke i shpuar me thikë, duke iu shkaktuar mavijosje në të gjithë trupin, gjakosje, pafuqi për të qëndruar në këmbë apo për të ecur, humbje ndjenjash dhe – në rastin e viktimës së vrasjes së paligjshme – duke e lënë atë pothuajse të vdekur;<sup>1471</sup> (ii) kishin një mënyrë veprimi të përcaktuar që tregon se keqtrajtimi ishte i institucionalizuar;<sup>1472</sup> (iii) i kërcënuan të ndaluarit me vdekje;<sup>1473</sup> (iv) nuk u dhanë atyre sasi të mjaftueshme ushqimi dhe uji, dhe urinuan mbi një prej tyre (W01679) para të ndaluarve të tjerë, kur ai kërkoi ujë;<sup>1474</sup> (v) u refuzuan ndihmën mjekësore dhe përdorimin e objekteve sanitare;<sup>1475</sup> (vi) panë kushtet e ndalimit kur i sillnin të ndaluarit në ahur (ahure) dhe kur hynin në ahur (ahure) për t'i keqtrajtuar ata;<sup>1476</sup> dhe (vii) panë gjendjen në të cilën ndodheshin të ndaluarit dhe lëndimet e tyre pas marrjes në pyetje dhe keqtrajtimin kur të ndaluarit ktheheshin në ahur (ahure).<sup>1477</sup>

681. Për këto arsye, Trupi Gjykes konstaton se, bazuar në provat në tërësi, i vetmi përfundim i arsyeshëm është se i akuzuari dhe anëtarët e tjerë të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999, u shkaktuan qëllimisht dhimbje dhe vuajtje të rënda të ndaluarve, duke përfshirë mbajtjen e tyre në kushte çnjerëzore ndalimi.

682. Gjithashtu, Trupi Gjykes ka konstatuar se i akuzuari: (i) mori në pyetje personalisht W01679-ën dhe e akuzoi si spiun, gënjeshtar dhe hajdut; dhe (ii) mori në pyetje personalisht W03593-shin dhe e kërcënoi me vdekje.<sup>1478</sup>

683. Trupi Gjykes gjithashtu ka konstatuar se anëtarë të tjerë të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash, ndër të cilët Nazif Musliu (me nofkën Tabuti), Ilmi Vela,

---

<sup>1471</sup> *Shih* para. 498-500, 534-535, 543-544, 546, 555, 560, 566, 567, 569-571, 575-578.

<sup>1472</sup> *Shih* para. 528, 534-535, 546-547, 567.

<sup>1473</sup> *Shih* para. 523-525, 530-532.

<sup>1474</sup> *Shih* para. 510-514.

<sup>1475</sup> *Shih* para. 515-522.

<sup>1476</sup> *Shih, për shembull*, para. 529, 534, 546-547.

<sup>1477</sup> *Shih, për shembull*, para. 534, 546-547.

<sup>1478</sup> *Shih* para. 534, 541-542, 547, 551-554.

z. Mehmetaj (me nofkën Bimi), Dardani, Afrimi dhe Fatmiri: (i) morën në pyetje të ndaluarit dhe i akuzuan si bashkëpunëtorë të serbëve, ose si spiunë, tradhtarë, hajdutë ose gënjeshtarë;<sup>1479</sup> (ii) urdhëruan të ndaluarit të thërrisnin: “vdekje tradhtarëve, vdekje hajnave edhe lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”;<sup>1480</sup> (iii) mbajtën të ndaluar disa nga viktimat për faktin, të paktën pjesërisht, se ishin anëtarë ose përkrahës të partive politike që konsideroheshin si kundërshtarë të UÇK-së;<sup>1481</sup> (iv) i kërcënuan me vdekje të ndaluarit;<sup>1482</sup> (v) i detyruan të shihnin keqtrajtimin fizik të të ndaluarve të tjerë;<sup>1483</sup> dhe (vi) i detyruan të jetonin në frikë të vazhdueshme se mund të bëheshin në çdo moment objekt i keqtrajtimit fizik apo edhe të vriteshin.<sup>1484</sup>

684. Për këto arsye, Trupi Gjykes konstaton se, bazuar në provat në tërësi, i vetmi përfundim i arsyeshëm është se i akuzuari dhe anëtarët e tjerë të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999, u shkaktuan dhimbje dhe vuajtje të ndaluarve me synim marrjen e informatave ose deklaratave pranuese, duke i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar dhe/ose duke i diskriminuar ata për arsye politike.

685. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykes konstaton se bazuar në provat në tërësi, janë përmbushur elementet mendore të torturës si krim lufte, konkretisht se kryesit shkaktuan qëllimisht dhimbje ose vuajtje me synim marrjen e informatave ose deklaratave pranuese, duke i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar ose duke i diskriminuar të ndaluarit.

---

<sup>1479</sup> *Shih* para. 498-500, 535, 543-546, 555-556, 566-568, 572, 574-576, 579.

<sup>1480</sup> *Shih* para. 572

<sup>1481</sup> *Shih* para. 580-581.

<sup>1482</sup> *Shih* para. 523-525, 579.

<sup>1483</sup> *Shih* para. 530-531, 579.

<sup>1484</sup> *Shih* para. 530-532.



## D. VRASJA E PALIGJSHME (PIKA 4)

## 1. Kriteret ligjore

## (ff) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

686. Krimi i vrasjes së paligjshme si krim lufte, brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që çon në vdekjen e një personi, duke përfshirë, për shembull, shkaktimin e një dëmtimi të rëndë fizik ose mosdhënien/refuzimin e ndihmës mjekësore një të ndaluarit.<sup>1485</sup>

687. Nuk është e nevojshme që sjellja e kryesit të jetë shkak i vetëm i vdekjes së viktimës, por ajo së paku duhet të ketë kontribuar në mënyrë të qenësishme për të.<sup>1486</sup>

## (gg) Elementet mendore (synimi kriminal)

688. Kryesi duhet ta ketë vrarë personin në mënyrë të qëllimshme ose t'i ketë shkaktuar qëllimisht dëmtim të rëndë fizik ose qëllimisht të mos t'i ketë dhënë ose t'i ketë refuzuar ndihmën mjekësore një të ndaluarit, çka kryesi logjikisht duhet ta kishte ditur se mund të çonte në vdekje.<sup>1487</sup>

<sup>1485</sup> ICTY, [Kvočka et al. Appeal Judgement](#), paras 259-261, 270-271; [Krnojelac Trial Judgment](#), paras 326-327.

<sup>1486</sup> ICTY, *Prosecutor v. Orić*, IT-03-68-T, Trial Chamber II, [Judgement](#) (*Orić Trial Judgment*), 30 June 2006, para. 347; [Kupreškić et al. Trial Judgment](#), paras 560-561; ICTR, [Akayesu Trial Judgment](#), para. 589. *Shih* gjithashtu, ICRC Commentary to GC I (2016), neni 50, para. 2952. Në lidhje me kriterin e "shkakut të qenësishëm", shih [Mucić et al. Trial Judgment](#), para. 424 dhe poshtëshënimin 435, që i referohen jurisprudencave vendore, ku shkak që ka një kontribut "të qenësishëm" ose "të konsiderueshëm" konsiderohet i mjaftueshëm në Angli dhe Australi, ndërsa në Kanada kërkohet një shkak kontribues që është më i madh se *de minimus*.

<sup>1487</sup> ICTY, *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92-T, Trial Chamber I, [Judgment](#), Vol III (*Mladić Trial Judgment*), 22 November 2017, para. 3050; [Kvočka et al. Appeal Judgement](#), paras 261, 270-271; ICTR, [Setako Appeal Judgment](#), para. 257; ECCC, [Duch Trial Judgment](#), para. 333.

## 2. Konstatime

### (hh) Elementet materiale (veprimi i fajshëm)

689. Në konstatimet e veta faktike në lidhje me Pikën 4, Trupi Gjykses konstatoi se i vetmi përfundim i arsyeshëm sa i përket vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme është se ai u vra afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, si pasojë e kombinimit të: (i) keqtrajtimit të rëndë të shkaktuar nga anëtarët e BIA-s, të cilët e mbajtën të ndaluar, duke i shkaktuar dëmtime të rënda fizike; (ii) refuzimit të ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s; dhe (iii) plagëve me armë zjarri të shkaktuara nga plumbat, në lidhje me të cilat Trupi Gjykses ka konstatuar se ekziston dyshim i arsyeshëm nëse ato mund t'u atribuohen anëtarëve të BIA-s, apo forcave serbe. Gjithashtu, në konstatimet e veta faktike Trupi Gjykses ka përcaktuar se shkaqet e vdekjes të përmendura në pikat (i) dhe (ii) më lart përbëjnë shkaqe të qenësishme për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme dhe i atribuohen të akuzuarit, në kontekstin e vendimeve të tij për të mos liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme, pavarësisht nëse viktima e vrasjes së paligjshme u godit nga një ose më shumë plumba serbë.<sup>1488</sup>

690. Rrjedhimisht, bazuar në këto shkaqe të vdekjes, Trupi Gjykses konstaton se janë përmbushur elementet materiale të vrasjes së paligjshme si krim lufte.

### (ii) Elementet mendore (synimi kriminal)

691. Trupi Gjykses rikujton se i akuzuari e dinte se më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR] ia dorëzoi viktimën e vrasjes së paligjshme një anëtar të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1489</sup> Trupi Gjykses gjithashtu ka konstatuar se i akuzuari kishte synimin të kryente krimin e ndalimit arbitrar dhe të torturës ndaj

---

<sup>1488</sup> *Shih* para. 638.

<sup>1489</sup> *Shih* para. 468-473.

viktimave, ndër të cilët edhe viktima e vrasjes së paligjshme.<sup>1490</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses merr parasysh faktin se i akuzuari përdori një armë zjarri gjatë marrjes në pyetje dhe keqtrajtimit të W03593-shit, dhe urdhëroi vartësit e tij me fjalët “mbyteni krejt” W01679-ën.<sup>1491</sup> Këta faktorë, ndonëse nuk lidhen drejtpërdrejt me viktimën e vrasjes së paligjshme, tregojnë se i akuzuari pranoi se disa nga të ndaluarit që ai mbante aty mund të vdisnin si pasojë e keqtrajtimit.

692. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton se më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, kur të ndaluarit u liruan papritur nga anëtarët e BIA-s për shkak të afrimit të ofensivës serbe, viktima e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR] nuk u liruan. Sipas mendimit të Trupit Gjykses, këta dy të ndaluar jo rastësisht ishin dy të burgosurit më të keqtrajtuar.<sup>1492</sup> Ndonëse Trupi Gjykses ka konstatuar se i akuzuari duhet të ketë ushtruar kompetencën e tij si komandant për lirimin e disa të ndaluarve dhe për evakuimin e kompleksit të ndalimit në Zllash, ai ushtroi qartësisht të njëjtën kompetencë për të mbajtur të ndaluar viktimën e vrasjes së paligjshme, pas keqtrajtimit shumë më të rëndë që iu bë atij sesa çdo të ndaluar tjetër. Në lidhje me këtë, në konstatimet faktike mbi Pikën 4, Trupi Gjykses ka përcaktuar se në bazë të provave të marra në tërësi, i vetmi përfundim i arsyeshëm është se: (i) vendimet për të mos liruuar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme mund të merreshin vetëm nga i akuzuari, si komandant i përgjithshëm i BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash; dhe (ii) vendimi i të akuzuarit për të mos e liruuar viktimën, i zbatuar nga vartësit e tij të BIA-s, së bashku me vendimin për të mos e evakuuar, ishin faktikisht barabar me një vendim për ta vrarë viktimën e vrasjes së paligjshme, duke pasur parasysh se të ndaluarit e tjerë u larguan nga kompleksi i ndalimit të Zllash, ndërsa viktima e vrasjes

---

<sup>1490</sup> *Shih* para. 659, 685.

<sup>1491</sup> *Shih* para. 546, 541.

<sup>1492</sup> *Shih* para. 569-574, 577.

së paligjshme vazhdoi të mbahej i ndaluar dhe iu mohua mundësia e fundit për t'u shpëtuar.<sup>1493</sup>

693. Synimi për të vrarë konfirmohet edhe nga një rrethanë tjetër e rëndësishme, konkretisht nga fakti se viktimja e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR].<sup>1494</sup> [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se i akuzuari, si dhe vartësit e tij të BIA-s që e keqtrajtojnë viktimën, nuk mund të lejonin që viktimja të mbetet i gjallë pas gjithë kësaj, [REDAKTUAR].

694. Gjithashtu, [REDAKTUAR]<sup>1495</sup> [REDAKTUAR].<sup>1496</sup> [REDAKTUAR].<sup>1497</sup> Në lidhje me këtë pikë, Trupi Gjykses konstaton se [REDAKTUAR] është i besueshëm, pasi detajet që kujton ai nga këto biseda janë aq të veçanta, sa që është e papërfytyrueshme që ato mund të jenë sajuar ose të jenë zbuluar. Trupi Gjykses gjykon se një bisedë e tillë është plotësisht e besueshme, pasi përputhet me tablonë që krijojnë provat sipas së cilës i akuzuari synonte të vraste viktimën e vrasjes së paligjshme dhe më pas të shmangte çfarëdo procesi gjyqësor të nisur në lidhje me vdekjen e tij.

695. Të gjitha këto rrethana të marra së bashku, e bëjnë Trupin Gjykses të besojë se i vetmi përfundim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova është se përmes veprimeve dhe mosveprimeve që u atribuohen të akuzuarit dhe vartësve të tij në BIA, ata synonin të vrisnin viktimën e vrasjes së paligjshme, çka rrjedhimisht vërteton ekzistencën e elementit të nevojshëm mendor për vrasjen si krim lufte.

---

<sup>1493</sup> *Shih* para. 636.

<sup>1494</sup> *Shih* para. 572.

<sup>1495</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 770, rreshti 10.

<sup>1496</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 772, rreshtat 14-15.

<sup>1497</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 772, rreshti 22 deri në f. 773, rreshti 2.

## E. EKZISTENCA E KONFLIKTIT TË ARMATOSUR

## 1. Kriteret ligjore

696. Neni 14(2) i Ligjit përcakton se konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar ndodhin në territorin e një shteti kur ekziston një konflikt i armatosur i zgjatur midis organeve të pushtetit dhe grupeve të armatosura të organizuara, ose midis grupeve të tilla.<sup>1498</sup> Konfliktet e armatosura karakterizohen nga shpërthimi i luftimeve që ndodhin në territorin e një shteti.

697. Në lidhje me palët në luftime, neni 14(2) i Ligjit përmend dy kategori të palëve të mundshme në konflikt të armatosur që duhet të interpretohen në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare. “Organet shtetërore” përfshijnë autoritetet qeveritare, si forcat e rregullta të armatosura, njësitë e policisë, gardat kombëtare ose autoritete të tjera të një natyre të ngjashme,<sup>1499</sup> ndër të cilët edhe grupet e armatosura dhe forca të mbrojtjes territoriale të përfshira në forcat e armatosura.<sup>1500</sup> Termi “grupe të armatosura të organizuara” nënkupton një shkallë organizimi, por ato “jo domosdoshmërisht duhet të jenë po aq të organizuara sa forcat e armatosura të një shteti”.<sup>1501</sup> Nuk është e nevojshme që ato të kryejnë operacione ushtarake të vazhdueshme dhe të bashkërenduara, por duhet të jenë mjaftueshmërisht të

<sup>1498</sup> ICTY, *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-AR72, Appeals Chamber, [Decision on the Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction](#), 2 October 1995 (*Tadić* Decision on Jurisdiction), para. 70; Prokurori kundër Boshkoskit dhe Tarçulovskit, IT-04-82-A, Dhoma e Apelit, [Judgement](#), (Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçulovski*), 19 maj 2010, para. 21. *Shih gjithashtu* ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2683; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 701; [Lubanga Trial Judgment](#), para. 533.

<sup>1499</sup> TPNJ, Prokurori kundër Boshkoskit dhe Tarçulovskit, IT-04-82-T, Dhoma Gjyqësore, [Judgement](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), 10 korrik 2008, para. 178, 195.

<sup>1500</sup> Neni 43(3) i Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe në Lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare (Protokollit I), i 8 qershorit 1977.

<sup>1501</sup> ICTY/TPNJ, [Bošković and Tarčulovski Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), para. 195, 197; [Orić Trial Judgment](#), para. 254; [Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Haradinaj*), para. 60; [Limaj et al. Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*), para. 89.

organizuara për t'u përballur me njëra-tjetrën me mjete ushtarake.<sup>1502</sup> Në përcaktimin nëse një entitet joshtetëror mund të kryejë dhunë të armatosur për një kohë të zgjatur, mund të merren parasysh faktorët tregues të mëposhtëm: (i) ekzistenca e një strukture komanduese, ku përfshihen ekzistenca e një selie të shtabit, e një shtabi të përgjithshëm ose komande të lartë, e gradave dhe posteve të identifikueshme, dhe e një rregulloreje të brendshme; (ii) lëshimi i deklaratave politike ose komunikatave dhe përdorimi i zëdhënësve; (iii) kapaciteti operativ dhe aftësia për kryerjen e operacioneve ushtarake; (iv) kapaciteti logjistik që përfshin disponueshmërinë e armëve dhe pajisjeve dhe kapaciteti për të lëvizur trupat dhe për të rekrutuar dhe stërvitur personelin; (v) kontrolli territorial që përfshin ndarjen në zona të përgjegjësive; (vi) sistemi i brendshëm disiplinor që përfshin zbatimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare në radhët e grupit të armatosur; (vii) aftësia për të folur me një zë të vetëm në emër të grupit të armatosur, për shembull në negociata politike apo marrëveshje armëpushimi.<sup>1503</sup>

698. Në lidhje me nivelin e intensitetit të konfliktit, neni 14(2) i Ligjit kërkon që luftimet ndërmjet palëve duhet të arrijnë një shkallë të caktuar intensiteti që shkon përtej prishjes së rendit dhe tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, veprimet e izoluara apo sporadike të dhunës apo veprime të tjera të një natyre të ngjashme. Në këtë kontekst, nocioni i “dhunës së armatosur të zgjatur” shërben për përkufizimin e standardit të intensitetit sepse i referohet “më tepër intensitetit të dhunës së armatosur

<sup>1502</sup> ICTY/TPNJ, [Boškoski and Tarčulovski Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), para. 197-198.

<sup>1503</sup> *Shih gjithashtu* Neni 1(1) i Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jondërkombëtare (Protokolli Shtesë II) i 8 qershorit 1977. *Shih gjithashtu* ICTY/TPNJ, [Boškoski and Tarčulovski Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), para. 194-203. Megjithatë, shkalla e organizimit të një grupi të armatosur në një konflikt për të cilin është i zbatueshëm neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës, nuk është e nevojshme të jetë në nivelin e organizimit që kërkohet për palët në konfliktet e armatosura për të cilat është i zbatueshëm Protokolli Shtesë II, *shih* ICTY/TPNJ, [Boškoski and Tarčulovski Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), para. 197.

se sa kohëzgjatjes së saj".<sup>1504</sup> Intensiteti mund të deduktohet, për shembull nga (i) ashpërsia dhe shpeshësia e sulmeve; (ii) përhapja e tyre në hapësirën territoriale dhe gjatë një periudhe kohe, dhe nëse janë lëshuar urdhra armëpushimi; (iii) shtimi dhe numri i forcave të dislokuara; (iv) mobilizimi dhe shpërndarja e armëve ndër palët në konflikt; (v) lloji i armëve të përdorura, në veçanti përdorimi i artilerisë së rëndë; (vi) përdorimi i mjeteve luftarake, në veçanti përdorimi i tankeve; (vii) nëse situata ka tërhequr vëmendjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave të tjera ndërkombëtare; (viii) ndikimet në popullatën civile, shkalla e shkatërrimit dhe numri i personave të vrarë ose të zhvendosur; dhe (ix) mënyra në të cilën është trajtuar grupi i armatosur nga të tjerët dhe cilat janë ligjet sipas të cilave pretendon se ka vepruar.<sup>1505</sup>

699. Trupi Gjykues rikujton se një konflikt i armatosur jondërkombëtar mund të ekzistojë krahas një konflikti të armatosur ndërkombëtar.<sup>1506</sup> Një konflikt i armatosur jondërkombëtar mund të shndërrohet në një konflikt të armatosur ndërkombëtar nëse një grup i armatosur i organizuar është nën kontrollin e përgjithshëm të një shteti të tretë.<sup>1507</sup>

---

<sup>1504</sup> ICTY/TPNJ, [Haradinaj Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Haradinaj*), para. 49. Shih gjithashtu [Kordić and Čerkez Appeal Judgement](#), para. 341; *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-T, Trial Chamber, [Opinion and Judgment](#), 7 May 1997, para. 562.

<sup>1505</sup> ICTY/TPNJ, [Boškoski and Tarčulovski Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçulovski*), para. 177, konfirmuar nga [Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçulovski*), para. 22, 24; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2684; [Ntaganda Trial Judgment](#), paras 703-704, 716; [Bemba Trial Judgment](#), para. 137; [Lubanga Trial Judgment](#), para. 538; [Katanga Trial Judgment](#), paras 1186-1187.

<sup>1506</sup> ICTY/TPNJ, [Đorđević Appeal Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*), para. 521; *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-A, Appeals Chamber, [Judgment \(Tadić Appeal Judgement\)](#), 15 July 1999, para. 84 Shih gjithashtu, ICRC, *Commentary on the First Geneva Convention: Convention (I) for the Amelioration of the Condition of the Wounded and Sick in Armed Forces in the Field*, 2<sup>nd</sup> edition, 2016 (2016 ICRC Commentary), lidhur me nenin 3, para. 404, 405, 413.

<sup>1507</sup> Shih, në veçanti, ICTY, [Tadić Appeal Judgement](#), para. 120, 137; ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#) para. 727. Shih gjithashtu, 2016 ICRC Commentary lidhur me nenin 3, para. 406-410.



700. Së fundi, kuadri kohor dhe gjeografik i konflikteve të armatosura me karakter jondërkombëtar i kapërcen kufijtë e kohës dhe vendit të saktë të luftimeve; rregullat e zbatueshme veprojnë edhe pas pushimit të luftimeve deri në arritjen e një zgjidhjeje paqësore.<sup>1508</sup> Rrjedhimisht, normat e së drejtës humanitare ndërkombëtare janë të zbatueshme pavarësisht nëse faktikisht po ndodhin apo nuk po ndodhin veprimtari luftarake në një vendndodhje të caktuar.<sup>1509</sup> Në rastin e personave të cilëve u është kufizuar liria, e drejta humanitare ndërkombëtare vazhdon të zbatohet deri në momentin kur përfundon heqja apo kufizimi i lirisë.<sup>1510</sup>

## 2. Konstatime

701. Trupi Gjykses rikujton Vendimin mbi Faktet e Shqyrtuara, sipas të cilit ka bërë konstatimin gjyqësor të ekzistencës së një konflikti të armatosur, edhe gjatë periudhës që mbulojnë akuzat, ndërmjet UÇK-së nga njëra anë dhe forcave serbe nga ana tjetër.<sup>1511</sup> Duke bërë këtë konstatim gjyqësor të një fakti të shqyrtuar, Trupi Gjykses ka përcaktuar një prezumim të bazuar mirë për saktësinë e këtij fakti, i cili, për rrjedhojë, nuk është e nevojshme të provohet sërish në gjykim.<sup>1512</sup>

702. Trupi Gjykses rikujton se Mbrojtja nuk e kundërshtoi listën e ZPS-së të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera dhe kërkesën përkatëse drejtuar Trupit Gjykses për të bërë konstatim gjyqësor në lidhje me to.<sup>1513</sup> Gjatë gjykimit, Mbrojtja nuk paraqiti as dëshmi gojore, as prova dokumentare për të kundërshtuar saktësinë e konstatimit për ekzistencën e një konflikti të armatosur ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe në kohën

---

<sup>1508</sup> ICTY, [Tadić Decision on Jurisdiction](#), para. 67-70; [Limaj et al. Trial Judgement](#) (Aktgjykimi Limaj dhe të tjerë), para. 84; *Prosecutor v. Vasiljević*, IT-98-32-T, Trial Chamber II, [Judgment](#), 29 November 2002, para. 25; [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 57.

<sup>1509</sup> ICTY, [Orić Trial Judgement](#), para. 255; [Tadić Decision on Jurisdiction](#), para. 70.

<sup>1510</sup> *Shih gjithashtu ICRC, Commentary on the Additional Protocols to the Geneva Conventions, 1987*, lidhur me nenin 2(2) të Protokollit Shtesë II, para. 4491-4496.

<sup>1511</sup> [Decision on Adjudicated Facts](#) (Vendim mbi Faktet e Shqyrtuara), para. 12.

<sup>1512</sup> [Decision on Adjudicated Facts](#) (Vendim mbi Faktet e Shqyrtuara), para. 11.

<sup>1513</sup> [Decision on Adjudicated Facts](#), (Vendim mbi Faktet e Shqyrtuara), para. 5.

e kryerjes së krimeve për të cilat janë ngritur akuzat. Megjithatë, gjatë deklaratave përmyllëse, Mbrojtja kundërshtoi cilësimin e konfliktit të armatosur, duke argumentuar se në fillim konflikti i armatosur në Kosovë kishte karakter jondërkombëtar dhe pas ndërhyrjes së NATO-s më 24 mars 1999, u kthye në një konflikt të armatosur ndërkombëtar. Rrjedhimisht, sipas Mbrojtjes, neni 14(1)(c) i Ligjit, që trajton krimet e luftës të kryera gjatë një konflikti të armatosur jondërkombëtar, nuk është i zbatueshëm në rastin konkret.<sup>1514</sup>

703. ZPS-ja e kundërshton këtë parashtrim të Mbrojtjes.<sup>1515</sup> Ajo përgjigjet se argumentimi prej ZPS-së i ekzistencës së konfliktit të armatosur jondërkombëtar ishte që në fillim i qartë, pasi të gjitha akuzat u ngritën në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit. Çdo kundërshtim ndaj cilësimit të konfliktit të armatosur ose ndaj akuzave është kundërshtim i juridiksionit dhe duhej të ishte paraqitur me anë të një mocioni paraprak sipas rregullës 97 të Rregullores.<sup>1516</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtron se të gjitha krimet e pretenduara përbëjnë shkelje të rënda të nenit të përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës, i cili zbatohet sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare si për situatat e konfliktit të armatosur ndërkombëtar, ashtu edhe ato të konfliktit të armatosur jondërkombëtar, pa përjashtime apo kufizime, dhe se të gjitha krimet për të cilat janë ngritur akuzat janë përcaktuar gjegjësisht në nenin 14(1)(a) të Ligjit. Për rrjedhojë, pavarësisht nga cilësimi që i bëhet konfliktit, krimet për të cilat janë ngritur akuzat përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.<sup>1517</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtron se: (i) ka provuar ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar;

---

<sup>1514</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4725, rreshti 11 deri në f. 4728, rreshti 15 (*që i referohen ICTY/TPNJ, Prosecutor v. Đorđević* (Prokurori k. Gjorgjeviqit), IT-05-87/1-T, Dhoma Gjyqësore II, [Public Judgement with Confidential Annex](#), Vol II, (Aktgjykimi Gjorgjeviq), 23 shkurt 2011, para. 1580-1581). *Shih gjithashtu* T. 14 shtator 2022, publik, f. 4728, rreshti 24 deri në f. 4729, rreshti 3; T. 15 shtator 2022, publik, f. 4749, rreshtat 13-16.

<sup>1515</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4812, rreshti 3 deri në f. 4815, rreshti 5.

<sup>1516</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4812, rreshtat 5-15.

<sup>1517</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4812, rreshti 16 deri në f. 4813, rreshti 15.

dhe (ii) edhe pse nga 24 marsi 1999 ekzistonte konflikt i armatosur ndërkombëtar ndërmjet forcave të NATO-s dhe forcave serbe, ai konflikt i armatosur ekzistonte krahas konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe.<sup>1518</sup>

704. Mbrojtësja e viktimave pajtohet me parashtrimet e ZPS-së.<sup>1519</sup>

705. Mbrojtja kundërpërgjigjet se karakterizimi i konfliktit nuk ka të bëjë me juridiksionin por me cilësimin e krimit sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, mbi bazën e të cilit ZPS-ja ngriti akuzat ndaj z. Mustafa, dhe në të cilin nuk renditet vepra penale e ndalimit arbitrar.<sup>1520</sup> Lidhur me bashkekzistencën e konfliktit të armatosur ndërkombëtar dhe jondërkombëtar, Mbrojtja përsërit qëndrimin e saj se i gjithë konflikti mori karakter ndërkombëtar nga data 24 mars 1999 dhe argumenton se jurisprudenca e TPNJ-së, duke përfshirë dhe çështjen gjyqësore *Gjorgjeviq*, nuk ka të bëjë me konfliktin e prillit 1999.<sup>1521</sup>

706. Trupi Gjykues fillimisht rikujton se ndonëse saktësia e fakteve të shqyrtuara në procese të tjera mund të kundërshtohet nga Mbrojtja, kjo e fundit duhet ta bëjë këtë duke paraqitur prova në gjykim dhe jo thjesht pretendime apo argumente të paraqitura me vonesë gjatë fazës së deklaratave përmbyllëse.<sup>1522</sup>

707. Sidoqoftë, Trupi Gjykues gjykon se sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare është përcaktuar se një konflikt i armatosur jondërkombëtar mund të ekzistojë krahas

---

<sup>1518</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4813, rreshti 16 deri në f. 4815, rreshti 5 (*që i referohen* Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të ZPS-së, para. 261-278; ICTY/TPNJ, *Dorđević Appeal Judgement* (Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*), para. 521; ICRC/KNKK Commentary on the First Geneva Convention, 2016, lidhur me nenin 3, para. 402-405; Gjykata Supreme e Kosovës, *Prosecutor v. Latif Gashi et al/Prokurori k. Latif Gashit dhe të tjerëve*, AP-KZ-139/2004, *Decision of 21 July 2005* (Vendim i 21 korrikut 2005), f. 10; Gjykata Supreme e Kosovës, *Prosecutor v. Kolasinac/Prokurori k. Kolashinacit*, AP-KZ-230/2003, *Decision of 5 August 2004* (Vendim i 5 gushtit 2004), f. 21).

<sup>1519</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4821, rreshtat 17-23.

<sup>1520</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4836, rreshtat 4-24.

<sup>1521</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4836, rreshti 25 deri në f. 4837, rreshti 18.

<sup>1522</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICTY, *Prosecutor v. Lukić & Lukić*, IT-98-32/1-A, Appeals Chamber, *Appeal Judgement*, 4 December 2012, para. 261, dhe referencat që përmbahen aty. *Shih gjithashtu* udhëzimet e Trupit Gjykues në *Decision on Adjudicated Facts* (Vendim mbi Faktet e Shqyrtuara), para. 11.

një konflikti të armatosur ndërkombëtar.<sup>1523</sup> Trupi Gjykses gjithashtu thekson se TPNJ-ja ka konstatuar se duke filluar nga fundi i majit 1998 dhe së paku deri në qershor 1999, në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur ndërmjet forcave serbe dhe UÇK-së, i cili u cilësua jondërkombëtar.<sup>1524</sup>

708. Sa u përket argumenteve të Mbrojtjes lidhur me intensitetin e luftimeve dhe nivelin e organizimit të palëve ndërluftuese,<sup>1525</sup> Trupi Gjykses i mbështet dhe u përmbahet konstatimeve të hollësishme të Dhomës Gjyqësore të TPNJ-së në çështjen gjyqësore *Gjorgjeviq*,<sup>1526</sup> në veçanti se: (i) nga fundi i majit 1998, konflikti në Kosovë ndërmjet forcave serbe (që përbënin autoritetet qeveritare) dhe UÇK-së, kishte nivelin e duhur të intensitetit për t'u konsideruar si konflikt i armatosur;<sup>1527</sup> dhe (ii) nga maji 1998, UÇK-ja kishte karakteristika të mjaftueshme të një grupi të armatosur të organizuar, që ishte në gjendje të përfshihej në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.<sup>1528</sup>

709. Nga ana tjetër, Trupi Gjykses gjykon se konflikti ndërmjet forcave serbe dhe forcave të NATO-s, i cili mund të ketë ekzistuar nga 24 marsi 1999 deri në përfundim

<sup>1523</sup> ICTY/TPNJ, [Dorđević Appeal Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*), para. 521; [Tadić Appeal Judgement](#), para. 84; ICC, [Lubanga Trial Judgment](#), para. 540. *Shih gjithashtu* ICRC Commentary on the First Geneva Convention, 2016, lidhur me nenin 3, para. 404, 405, 413.

<sup>1524</sup> ICTY/TPNJ, [Dorđević Appeal Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*), para. 521; [Dorđević Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Gjorgjeviq*), para. 1578-1580. Trupi Gjykses vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-06, shkoi edhe më tej se kaq; ai konstatoi se konflikti i armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe vazhdoi deri më 16 shtator 1999, kur u arrit një mungesë afatgjatë e konfrontimeve të armatosura dhe gjendja u stabilizua mjaftueshëm për të qenë e barabartë me një zgjidhje paqësore, *shih* KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on the Confirmation of the Indictment Against Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi and Jakup Krasniqi](#)/Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 26 tetor 2020, publik, para. 89, 136-137.

<sup>1525</sup> *Shih* T. 14 shtator 2022, publik, f. 4727, rreshti 7 deri në f. 4728, rreshti 11.

<sup>1526</sup> [Dorđević Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Gjorgjeviq*), para. 1532-1578.

<sup>1527</sup> [Dorđević Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Gjorgjeviq*), para. 1536.

<sup>1528</sup> [Dorđević Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Gjorgjeviq*), para. 1578.

të luftimeve në qershor 1999, u cilësua si ndërkombëtar.<sup>1529</sup> Ndonëse në kushte të caktuara konflikti i armatosur jondërkombëtar në Kosovë mund të ishte kthyer në një konflikt të armatosur ndërkombëtar — konkretisht nëse UÇK-ja do të kishte vepruar nën kontrollin e përgjithshëm të një ose më shumë prej shteteve të NATO-s që merrnin pjesë në konfliktin e armatosur ndërkombëtar<sup>1530</sup> — Trupi Gjykses gjykon se nuk janë paraqitur prova që të çojnë në këtë përfundim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se nuk ka arsye për ta diskutuar më tej karakterizimin e konfliktit të armatosur në kohën që mbulojnë akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.

710. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses rrëzon kundërshtimin e Mbrojtjes lidhur me karakterizimin e konfliktit të armatosur dhe konfirmon konstatimet e tij të mëhershme, bazuar në Vendimin mbi Faktet e Shqyrtuara, sipas të cilave në kohën që mbulojnë akuzat ekzistonte një konflikt i armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe.

711. Gjithashtu, në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash nuk ishin “persona të mbrojtur” brenda kuptimit të Konventave të Gjenevës,<sup>1531</sup> Trupi Gjykses, së pari, rikujton se Mbrojtja iu referua gabimisht nenit 14 të Konventës së Katërt të Gjenevës (KGJIV)<sup>1532</sup> (që trajton statusin e spitaleve, zonave dhe vendeve të sigurisë), ndërkohë që baza e saktë ligjore për argumentin e saj është neni 4 i KGJIV-ës, që jep përkufizimin e personave të mbrojtur. Sido që të jetë, në bazë të nenit 4 të KGJIV-ës, nocioni i personave të mbrojtur zbatohet vetëm për konfliktet

<sup>1529</sup> [Dorđević Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Gjorgjeviq*), para. 1580; [Dorđević Appeal Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*), para. 521.

<sup>1530</sup> *Shih* [Tadić Appeal Judgement](#) para. 120, 137. *Shih gjithashtu* ICRC Commentary on the First Geneva Convention 2016, lidhur me nenin 3, para. 406-410.

<sup>1531</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4721, rreshti 16 deri në f. 4725, rreshti 10. *Shih gjithashtu* T. 15 shtator 2022, publik, f. 4794, rreshti 9 deri në f. 4795, rreshti 24. *Shih më tej* T. 14 shtator 2022, publik, f. 4729, rreshtat 4-9 (argument i ngjashëm në lidhje me Pikën 2); T. 15 shtator 2022, publik, f. 4749, rreshtat 13-22 (argument i ngjashëm në lidhje me Pikën 3).

<sup>1532</sup> T. 14 shtator 2022, publik, f. 4723, rreshti 7.

e armatosura ndërkombëtare, dhe jo për konfliktet e armatosura jondërkombëtare, siç është ky që po trajtohet nga Trupi Gjykses. Në këtë aspekt, sipas pjesës së përgjithshme të nenit 14(1)(c) të Ligjit, (që i referohet nenit të përbashkët 3) përfundimi nëse një person mbrohet ose jo sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare, bazohet në veprimtarinë e jo në statusin e atij personi. Veçanërisht, Trupi Gjykses duhet të vlerësojë nëse viktima merrte pjesë aktive në luftime në kohën e kryerjes së veprës penale.<sup>1533</sup> Rrjedhimisht, rrëzohet kundërshtimi i Mbrojtjes.

## F. LIDHJA ME KONFLIKTIN E ARMATOSUR JONDËRKOMBËTAR

### 1. Kriteret ligjore

712. Krimet e pretenduara duhet të kenë lidhje të mjaftueshme me konfliktin e armatosur. Nuk është e nevojshme që konflikti i armatosur të ketë shkaktuar kryerjen e krimit për të cilin është ngritur akuzë, por ai duhet të ketë luajtur më së paku një rol të konsiderueshëm në aftësinë e kryesit për kryerjen e krimit, vendimin e tij apo të saj për ta kryer atë, mënyrën se si u krye krimi, ose qëllimin për të cilin u krye ai.<sup>1534</sup> Në përcaktimin e ekzistencës së lidhjes duhet t'i kushtohet vëmendje: (i) statusit të kryesit dhe të viktimës; (ii) nëse akti i shërben qëllimit përfundimtar të fushatës ushtarake;

<sup>1533</sup> Në lidhje me dallimin midis nocionit të personave të mbrojtur sipas Konventave të Gjenevës dhe personave që nuk marrin pjesë aktive në luftime në kuptim të nenit të përbashkët 3, shih, në mënyrë të ngjashme ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-1962, Appeals Chamber, [Judgment on the appeal of Mr Ntaganda against the "Second decision on the Defence's challenge to the jurisdiction of the Court in respect of Counts 6 and 9"](#), 15 June 2017, paras 46-51; ICTY, [Tadić Decision on Jurisdiction](#), para. 81.

<sup>1534</sup> ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 731; ICTY, [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 58; *Prosecutor v. Stakić*, IT-97-24-A, Appeals Chamber, [Judgement \(Stakić Appeal Judgement\)](#), 22 March 2006, para. 342; [Tadić Decision on Jurisdiction](#), para. 70; ICTR, [Setako Appeal Judgement](#), para. 249; *Rutaganda v. Prosecutor*, ICTR-96-3-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 26 May 2003, paras 569-570.



ose (iii) nëse akti u krye si pjesë e detyrave zyrtare të kryesit apo në kontekstin e tyre.<sup>1535</sup>

## 2. Konstatime

713. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta se BIA ishte pjesë e UÇK-së dhe ishte e përfshirë në një konflikt të armatosur jondërkombëtar me forcat serbe në kohën që mbulojnë akuzat.<sup>1536</sup>

714. Trupi Gjykses konstaton se, kur kryen ndalimin arbitrar dhe torturimin e viktimave dhe vrasjen e viktimës së vrasjes së paligjshme, anëtarët e BIA-s, ndër ta dhe i akuzuari, vepruan në kontekstin e detyrave zyrtare të tyre brenda UÇK-së. Ata shfrytëzuan statusin e tyre si anëtarë të BIA-s, sepse u mbështetën në bazën e BIA-s në Zllash për të kryer krimet për të cilat akuzohen. Ata përfituan edhe nga statusi i tyre si anëtarë të UÇK-së, pasi shfrytëzuan rrjetin e tyre më të gjerë të UÇK-së për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me këto krime. Më konkretisht, ata i arrestuan viktimat dhe i dërguan në kompleksin e ndalimit në Zllash me ndihmën e [REDAKTUAR] anëtarëve të tjerë të UÇK-së, ku ata u mbajtën të ndaluar në mënyrë arbitrare, u keqtrajtuat dhe u vranë (në rastin e viktimës së vrasjes së paligjshme).

715. Siç është konstatuar, krahas mbajtjes në ndalim të personave, kompleksi i ndalimit në Zllash u përdor edhe për qëllime të tjera që kishin lidhje me konfliktin e armatosur, si vend pushimi dhe rikuperimi për ushtarët e UÇK-së, si vendstrehim i sigurt për civilët e zhvendosur, si dhe si objekt për mjekimin e personave të plagosur.<sup>1537</sup> Trupi Gjykses konstaton se anëtarët e BIA-s, ndër ta dhe i akuzuari, zgjodhën kompleksin e ndalimit në Zllash për të kryer krimet sepse ai ishte në një

---

<sup>1535</sup> ICTY, [Kunarac et al. Appeal Judgement](#), para. 59; ICC, [Bemba Trial Judgment](#), para. 143; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2689; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 732

<sup>1536</sup> *Shih* para. 334, 710.

<sup>1537</sup> *Shih* para. 350-352.



zonë malore të izoluar, larg luftimeve, dhe kjo garantonte që ata t'i kryenin krimet pa u shqetësuar.

716. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstaton se konflikti i armatosur jondërkombëtar që po zhvillohej luajti rol të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve për të cilat u ngritën akuzat, pasi të ndaluarit u mbajtën, u morën në pyetje, u keqtrajtuat dhe u vranë (në rastin e viktimës së vrasjes së paligjshme) mbi bazën, ndër të tjera, të akuzave se ishin spiunë, bashkëpunëtorë të serbëve, tradhtarë ose mbështetës të partive politike që konsideroheshin si kundërshtarë të UÇK-së.

717. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se është përmbushur kriteri i lidhjes me konfliktin për krimet e përfshira në Pikat 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës së Konfirmuar.

## G. DIJENIA PËR EKZISTENCËN E KONFLIKTIT TË ARMATOSUR JONDËRKOMBËTAR

### DHE STATUSIN E VIKTIMAVE

#### 1. Kriteret ligjore

718. Kryesi duhet të ketë dijeni për rrethanat faktike që vërtetojnë konfliktin e armatosur me karakter jondërkombëtar.<sup>1538</sup> Nuk është e nevojshme që kryesi të ketë njohuri për klasifikimin e saktë ligjor të konfliktit të armatosur.<sup>1539</sup>

719. Gjithashtu, të gjitha krimet e luftës duhet të kryhen kundër personave të mbrojtur. Pjesa e përgjithshme e nenit 14(1)(c) të Ligjit që përmend nenin e përbashkët 3(1), kërkon që viktima të mos ketë qenë duke marrë pjesë aktivisht në

---

<sup>1538</sup> ICTY, [Naletilić and Martinović Appeal Judgement](#), para. 118-121; [Bošković and Tarčulovski Trial Judgement](#) (Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski), para. 295. Shih gjithashtu ICC, [Ongwen Trial Judgment](#) para. 2692; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 698, 733.

<sup>1539</sup> ICC, [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 733; ICTY, [Naletilić and Martinović Appeal Judgement](#), para. 119; [Kordić and Čerkez Appeal Judgement](#), para. 311.

luftime në kohën e kryerjes së veprës penale.<sup>1540</sup> Pjesëmarrje aktive në luftime do të thotë kryerje - në kuadrin e luftimeve – të akteve, lloji dhe qëllimi i të cilave synon t'i shkaktojë dëmtim faktik personelit ose pajisjeve të palës kundërshtare.<sup>1541</sup> Personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, ndër të cilët edhe anëtarë të forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata që janë jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit, apo çfarëdo shkakut tjetër, janë të mbrojtur sipas nenit të përbashkët 3. Kryesi duhet të dijë ose duhet të ketë ditur për statusin e viktimave si persona që nuk marrin pjesë aktive në luftime.<sup>1542</sup>

## 2. Konstatime

720. Trupi Gjykes rikujton se në detyrat e BIA-s përfshiheshin: mbledhja e informatave dhe të dhënave të zbulimit lidhur me, ndër të tjera, personat që besohet se ndihmonin forcat serbe;<sup>1543</sup> dhe ndërgjegjësimi se “lufta është e vetmja zgjidhje” dhe se ajo ishte një “luftë e drejtë”.<sup>1544</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykes rikujton se i akuzuari u dha urdhra të tillë vartësve të tij në BIA, të cilët qartazi kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur. Këta urdhra përfshinin, për shembull, vëzhgimin e lëvizjeve të forcave serbe, identifikimin e objektivave të mundshme ushtarake dhe dërgimin e

<sup>1540</sup> ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-AR73.9, Appeals Chamber, [Decision on Appeal from Denial of Judgement of Acquittal for Hostage-Taking](#) (Karadžić Decision 11 December 2012), 11 December 2012, paras 8, 21; IT-95-5/18-AR72.5, Appeals Chamber, [Decision on Appeal of Trial Chamber's Decision on Preliminary Motion to Dismiss Count 11 of the Indictment](#), 9 July 2009, paras 22-26; [Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit Boshkoski dhe Tarçulovski), para. 66; *Prosecutor v. Strugar*, IT-01-42-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (Strugar Appeal Judgement), 17 July 2008, paras 172, 178; [Mucić et al. Appeal Judgement](#), paras 420, 424.

<sup>1541</sup> ICTY, [Strugar Appeal Judgement](#), para. 178; ICC, [Katanga Trial Judgment](#), para. 789-790. *Shih gjithashtu* nenin 13(3) të Protokollit Shtesë II.

<sup>1542</sup> ICTY, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3017; [Karadžić Decision 11 December 2012](#), para. 22; [Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit Boshkoski dhe Tarçulovski), para. 66.

<sup>1543</sup> *Shih* para. 338; **z. Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 1, f. 28, rreshtat 17-18; f. 32, rreshtat 3-14. Sipas vetë të akzuarit mbledhja e informacioneve të zbulimit “ka qenë misioni i parë i punës tonë [BIA-s]”.

<sup>1544</sup> **Z. Mehmetaj**: T. 23 mars 2022, publik, f. 2622, rreshtat 3-10.

furnizimeve mjekësore.<sup>1545</sup> Anëtarët e BIA-s gjithashtu morën pjesë në veprime luftarake për t'iu kundërvënë ofensivës serbe dhe ndihmuan në evakuimin e të plagosurve nga Zllashi, nën udhëheqjen e të akuzuarit.<sup>1546</sup> Trupi Gjykses ka konstatuar se i akuzuari shkonte e vinte rregullisht në Zllash gjatë prillit 1999, edhe gjatë kohës kur po afrohej ofensiva serbe.<sup>1547</sup>

721. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se i akuzuari dhe anëtarët e BIA-s që ishin të pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999, kishin dijeni për ekzistencën e konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, pasi lëvizjet, vendimet dhe veprimet e tyre gjatë kuadrit kohor të akuzave u diktuan kryesisht nga konflikti i armatosur.

722. Lidhur me statusin e mbrojtur të viktimave, Trupi Gjykses konstaton se të ndaluarit nuk merrnin pjesë aktive në luftime për shkak se mbaheshin të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe, si rezultat, ishin të mbrojtur nga neni i përbashkët 3. Në këtë aspekt, i akuzuari dhe vartësit e tij të BIA-s kishin njohuri për statusin e mbrojtur të viktimave, duke pasur parasysh dijeninë e tyre për praninë e të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe pjesëmarrjen personale të tyre në ndalimin dhe keqtrajtimin e zgjatur të viktimave (që çoi në vdekjen e një prej tyre – viktimës së vrasjes së paligjshme).

#### H. PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE E TË AKUZUARIT

723. ZPS-ja argumenton këto forma të përgjegjësisë penale: kryerje e drejtpërdrejtë, kryerje në bazë të një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët NKP I ose NKP III (kjo e

---

<sup>1545</sup> *Shih* para. 339; z. **Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 2, f. 3, rreshti 14 deri në f. 4, rreshti 10; f. 8, rreshtat 1-25.

<sup>1546</sup> **Z. Mustafa**: 069404-TR-ET, Part (Pjesa) 7, f.14, rreshtat 3-12.

<sup>1547</sup> *Shih* para. 248-262.

fundit vetëm për Pikën 4), si edhe urdhërim, nxitje, ndihmë dhe inkurajim, dhe përgjegjësi si epror.<sup>1548</sup>

724. Trupi Gjykues thekson se në këtë çështje: (i) përgjegjësia penale për urdhërim, nxitje, ndihmë dhe inkurajim paraqitet si alternativë ndaj formave të përgjegjesisë për kryerjen e krimeve;<sup>1549</sup> (ii) përgjegjësia penale si epror paraqitet si alternativë ndaj formave të përgjegjesisë sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit;<sup>1550</sup> dhe (iii) përgjegjësia penale për NKP III paraqitet si alternativë ndaj asaj për NKP I për Pikën 4.<sup>1551</sup>

725. Bazuar në konstatimet e tij mbi provat,<sup>1552</sup> Trupi Gjykues e gjykon të përshtatshme të përcaktojë kriteret ligjore të formës (formave) të përgjegjesisë penale që pasqyron (pasqyrojnë) më së miri kuadrin e plotë të përgjegjesisë penale individuale të të akuzuarit, në rast të shpalljes fajtor.<sup>1553</sup> Trupi Gjykues është i mendimit se në qoftë se përgjegjësia penale individuale e të akuzuarit mbulohet plotësisht në një formë të përgjegjesisë penale<sup>1554</sup> atëherë nuk ka nevojë të analizohet

<sup>1548</sup> *Shih* para. 25.

<sup>1549</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 142, 145.

<sup>1550</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 5, 146, 151; [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 14. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues gjithashtu thekson se, sipas jurisprudencës së TPNJ-së, do të ishte e papranueshme që një i akuzuar të shpallej fajtor si për një formë të përgjegjesisë penale sipas nenit 7(1) të Statutit të TPNJ-së, ashtu edhe për përgjegjësinë si epror sipas nenit 7(3) të TPNJ-së, për të njëjtën vepër penale; *shih, për shembull*, ICTY, *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-T, Trial Chamber, [Judgement](#), 3 March 2000, para. 337; *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14/2-T, Trial Chamber, [Judgement](#), 26 February 2001, para. 371; *Prosecutor v. Krstić*, IT-98-33-T, Trial Chamber, [Judgement](#), para. 605; [Orić Trial Judgement](#), para. 343 (ku, megjithatë, thuhet se “sjellja e paligjshme shtesë, që lidhet me moszbatimin nga ana e një të akuzuari të detyrave të tij si epror në kuptim të nenit 7(3) të Statutit [të TPNJ-së], duhet të merret parasysh si faktor rëndues në dhënien e dënimit”); ICTR, [Kayishema and Ruzindana Trial Judgement](#), para. 223.

<sup>1551</sup> [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 130-131, 133, dhe poshtëshënimi 15; [Confirmed Indictment](#) (Aktakuza e Konfirmuar), para. 8.

<sup>1552</sup> *Shih* Pjesa V.

<sup>1553</sup> *Shih, për shembull*, ICTY, *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-T, Trial Chamber I, [Judgement](#), 27 September 2006, para. 877; ICC, [Ongwen Trial Judgment](#), para. 2780; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 1200; *Prosecutor v. Al Mahdi*, ICC-01/12-01/15-171, Trial Chamber VIII, [Judgment and Sentence \(Al Mahdi Trial Judgment\)](#), 27 September 2016, para. 60.

<sup>1554</sup> *Shih, për shembull*, ICTY/TPNJ, [Dorđević Appeal Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit Gjorgjeviq), para. 832; ICTR, [Karemera and Ngirumpatse Appeal Judgement](#), para. 720; [Munyakazi Appeal Judgement](#)

përgjegjësia e tij sipas formave të tjera të përgjegjësive penale, të paraqitura. Në çështjen konkrete, nëse dënimi për kryerje të veprës penale (përfshirë edhe në bazë të NKP-së)<sup>1555</sup> mbulon plotësisht përgjegjësinë penale të të akuzuarit, nuk ka nevojë të shqyrtohet më tej përgjegjësia e të akuzuarit për ndihmë dhe inkurajim, urdhërim ose nxitje, ose përgjegjësia si epror sipas nenit 16(1)(c) të Ligjit, për të njëjtën veprë penale.<sup>1556</sup>

726. Elementet objektive dhe subjektive të këtyre formave të përgjegjësive penale parashtrihen në vijim.

## 1. Kryerja e drejtpërdrejtë

### (jj) Kriteret ligjore

#### i. Elementet objektive

727. Në kryerjen e drejtpërdrejtë kryesi kryen fizikisht elementet objektive të krimit ose nuk ndërmerr veprim kur sipas ligjit i kërkohet të veprojë.<sup>1557</sup>

---

para. 160; *Kamuhanda v. Prosecutor*, ICTR-99-54A-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 19 September 2005, para. 77; ICC, [Al Mahdi Trial Judgment](#), para. 61.

<sup>1555</sup> *Shih, për shembull*, ICTY, [Tadić Appeal Judgment](#), para. 188; *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 17 September 2003, paras 28-32, 73; ICTR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), 28 November 2007, para. 478; *Prosecutor v. Ntakirutimana and Ntakirutimana*, ICTR-96-10-A and ICTR-96-17-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (*Ntakirutimana Appeal Judgment*), 13 December 2004, para. 462; *Prosecutor v. Simba*, ICTR-01-76-T, Trial Chamber I, [Judgement and Sentence](#), 13 December 2005, para. 385.

<sup>1556</sup> *Shih, për shembull*, ICTY, *Prosecutor v. Stakić*, IT-97-24-T, Trial Chamber II, [Judgement](#) (*Stakić Trial Judgment*), 31 July 2003, paras 446, 468, 712, 914; [Blaškić Trial Judgment](#), para. 278; ICTR, [Akayesu Trial Judgment](#), para. 468; *Prosecutor v. Semanza*, ICTR-97-20-T, Trial Chamber III, [Judgement and Sentence](#), 15 May 2003, para. 397. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses ka një qasje të ndryshme nga ajo e ZPS-së, e cila, me përjashtimet e përmendura në paragrafin 723 më lart, ngriti akuza të shumëfishta për disa forma të përgjegjësive penale (*shih, në veçanti, Confirmed Indictment* (Aktakuza e Konfirmuar), para. 34).

<sup>1557</sup> ICTY, [Tadić Appeal Judgment](#), para. 188; *Prosecutor v. Blagojević and Jokić*, IT-02-60-T, Trial Chamber I, [Judgement](#), 17 January 2005, para. 694; *Prosecutor v. Lukić and Lukić*, IT-98-32/1-T, Trial Chamber III, [Judgement](#) (*Lukić Trial Judgment*), 20 July 2009, para. 897; ICTR, [Nahimana et al.](#)

## ii. Elementet subjektive

728. Kryesi duhet të ketë synimin ta kryejë krimin ose duhet të veprojë i vetëdijshëm për gjasën e konsiderueshme se, si pasojë e sjelljes së tij ose të saj do të ndodhë krim.<sup>1558</sup>

## (kk) Konstatime

## i. Elementet objektive

729. Në lidhje me W01679-ën, Trupi Gjykes ka konstatuar se i akuzuari e mori në pyetje personalisht W01679-ën, e akuzoi si spiun, gënjeshtar dhe hajdut, dhe e goditi me shuplakë.<sup>1559</sup>

730. Në lidhje me W03593-shin, Trupi Gjykes ka konstatuar se – teksa po rrihej nga disa anëtarë të BIA-s nën akuzën se bashkëpunonte me serbët — i akuzuari bëri sikur do ta ekzekutonte W03593-shin.<sup>1560</sup> Një herë tjetër, teksa po e merrte në pyetje për të mësuar se çfarë dinte për hajdutët, i akuzuari e rrahu W03593-shin dhe e kërcënoi se do ta vriste.<sup>1561</sup>

731. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes konstaton se i akuzuari ka kryer fizikisht elementet objektive të torturës si krim lufte (Pika 3).

## ii. Elementet subjektive

732. Trupi Gjykes ka konstatuar se i akuzuari kishte synimin kriminal të nevojshëm për krimin e luftës të torturës (Pika 3), pasi ai mori pjesë drejtpërdrejt dhe personalisht në keqtrajtimin e W01679-ës dhe W03593-shit, e bëri këtë në mënyrë të përsëritur në

---

[Appeal Judgement](#), para. 478; *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*, ICTR-95-1-A, Appeals Chamber, [Judgment \(Reasons\)](#) (*Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment*), 1 June 2001, para. 187.

<sup>1558</sup> ICTY, [Lukić Trial Judgment](#), para. 900; ICTR, [Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment](#), para. 187..

<sup>1559</sup> *Shih* para. 541-545.

<sup>1560</sup> *Shih* para. 551-554.

<sup>1561</sup> *Shih* para. 551-554.

rastin e këtij të fundit, ishte dëshmitar i keqtrajtimit të këtyre dy të ndaluarve nga vartësit e tij të BIA-s dhe lëshoi urdhra që janë tregues të qartë të synimit të tij për kryerjen e këtyre krimeve.<sup>1562</sup> Gjithashtu, veprimet që ndërmori i akuzuari ndaj W01679-ës dhe W03593-shit, përfshirë përdorimin e revolverit dhe goditjet me shuplaka, të para në kontekstin e mënyrës së ashpër të marrjes në pyetje, me akuza se ishin spiunë, bashkëpunonin me serbët ose kishin njohuri për hajdutët, tregojnë se i akuzuari synonte të merrte pjesë në ato veprime për të realizuar qëllimin e nevojshëm të torturës si krim lufte.

733. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se i akuzuari u shkaktoi qëllimisht dhimbje ose vuajtje të rënda W01679-ës dhe W03593-shit, me synimin e marrjes së informatave ose deklaratave pranuese, duke i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar ose diskriminuar ata, çka rrjedhimisht përmbush elementin subjektiv të kryerjes së drejtpërdrejtë sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit.

## 2. Ndërmarrja kriminale e përbashkët

### (II) Kriteret ligjore

734. Ndërmarrja kriminale e përbashkët ("NKP") si formë e përgjegjesisë penale përfshin tri forma ose kategori (bazë, sistimore dhe e zgjeruar). Në formën bazë ("NKP I") disa kryes veprojnë mbi bazën e një qëllimi të përbashkët. Në formën sistimore ("NKP II"), që është një variant i formës së parë, krimet kryhen brenda një sistemi të organizuar keqtrajtimi nga anëtarë të forcave ushtarake ose njësi administrative, si në kampet e përqendrimit ose të ndalimit. Në formën e zgjeruar ("NKP III"), vërtetohet përgjegjësia penale për aktet e një bashkëkryesi që dalin jashtë

---

<sup>1562</sup> *Shih* para. 534-556.



kuadrit të planit të përbashkët, por që ishin pasojë e parashikueshme e realizimit të planit.<sup>1563</sup>

735. Gjykata e Apelit konstatoi se mungesa e përmendjes së qartë të NKP-së në Ligj ose Rregullore nuk duhet të interpretohet si qëllim i hartuesve të Ligjit për të përjashtuar NKP-në nga format e zbatueshme të përgjegjesisë penale në Dhomat e Specializuara.<sup>1564</sup> Përkundrazi, sipas nenit 3(3) të Ligjit, gjykatësit mund të orientohen nga jurisprudenca e gjykatave *ad hoc*,<sup>1565</sup> si dhe nga e drejta zakonore ndërkombëtare. Gjykatat *ad hoc* kanë zbatuar doktrinën e NKP-së për krimet themelore nën juridiksionin e këtyre gjykatave si një formë kryerjeje në bazë të së drejtës zakonore ndërkombëtare.<sup>1566</sup> Rrjedhimisht, duke pasur parasysh se neni 16(1) i Ligjit pasqyron thujtë fjalë për fjalë formulimin e nenit 7(1) të Statutit të TPNJ-së dhe të nenit 6(1) të Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën lidhur me përgjegjësinë penale individuale, Trupi Gjykes konstaton se neni 16(1) i Ligjit, duke përfshirë termin “kryerje”, duhet të interpretohet në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare që zbatohet në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara.<sup>1567</sup> Së fundi, hartuesit e Ligjit nuk do të kishin vepruar në mënyrë përputhëse në qoftë se do të kishin përjashtuar qëllimisht nga juridiksioni i Dhomave të Specializuara një nga arsyet për të cilat u krijua gjykata, konkretisht për të mundësuar ndjekjen penale të personave që veprojnë së bashku me persona të tjerë.<sup>1568</sup>

736. Në pajtim me parimin e përcaktuar në paragrafin 725 më lart, Trupi Gjykes do të trajtojë vetëm përgjegjësinë penale individuale të të akuzuarit në bazë të NKP I dhe

---

<sup>1563</sup> ICTY, [Kvočka et al. Appeal Judgement](#), paras 82-83; *Prosecutor v. Vasiljević*, IT-98-32-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 25 February 2004, para. 98; [Tadić Appeal Judgement](#), paras 196, 202-203, 228; ICTR, [Ntakirutimana Appeal Judgement](#), para. 464.

<sup>1564</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 136.

<sup>1565</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 136.

<sup>1566</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 138.

<sup>1567</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 138.

<sup>1568</sup> [Case 06 Jurisdictional Appeal](#) (Apeli i Juridiksionit në Çështjen 06), para. 139, me referenca të mëtejshme.

jo në bazë të NKP III, për arsye se e para pasqyron më së miri përgjegjësinë penale të të akuzuarit si anëtar i NKP-së.

i. Elementet objektive

737. Për të gjitha format e NKP-së kërkohet ekzistenca e elementeve objektive në vijim: (i) një shumësi personash që veprojnë në bazë të një qëllimi të përbashkët; (ii) një qëllim i përbashkët i cili përbën kryerje të një krimi ose përfshin kryerjen e një krimi të përcaktuar në Ligj; dhe (iii) pjesëmarrja e kryesit në realizimin e projektit ose qëllimit të përbashkët.<sup>1569</sup>

738. *Shumësi personash.* NKP-ja ekziston kur një shumësi personash merr pjesë në realizimin e një objektivi kriminal të përbashkët.<sup>1570</sup> Nuk është e nevojshme që personat pjesëmarrës në ndërmarrjen kriminale të jenë të organizuar në një strukturë ushtarake, politike ose administrative.<sup>1571</sup> Megjithatë, ata duhet të identifikohen konkretisht, për shembull, përmes emrit ose kategorive ose grupeve të personave.<sup>1572</sup>

739. *Qëllimi i përbashkët që përbën kryerje të një krimi ose përfshin kryerjen e një krimi.* Nuk është e nevojshme që ky plan, projekt, ose qëllim të jetë organizuar ose formuluar më herët. Plani ose qëllimi i përbashkët mund të materializohet spontanisht dhe

<sup>1569</sup> ICTY, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3561; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Public Redacted Version of Judgment Issued on 24 March 2016](#), para. 561, që i referohet [Tadić Appeal Judgment](#), para. 227; [Stakić Appeal Judgment](#), para. 64. Shih gjithashtu ICTR, [Karemera and Ngirumpatse Appeal Judgment](#), para. 110; [Ntakirutimana Appeal Judgment](#), paras 461-468; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/I/AC/R176bis, Appeals Chamber, [Interlocutory Decision on the Applicable Law: Terrorism, Conspiracy, Homicide, Perpetration, Cumulative Charging](#), 16 February 2011, paras 236-249.

<sup>1570</sup> ICTY/TPNJ, [Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Haradinaj*), para. 138; [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 307.

<sup>1571</sup> ICTY, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3561; [Tadić Appeal Judgment](#), para. 227

<sup>1572</sup> KSC-BC-2020-06, IA012-F00015, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim në lidhje me Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 72 (me referenca të mëtejshme); versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë, [IA012-F00015/RED](#). Shih gjithashtu ICTY, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3561; *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-A, Appeals Chamber, [Judgment \(Krajišnik Appeal Judgment\)](#), 17 March 2009, paras 156-157; [Brđanin Appeal Judgment](#), para. 430.

deduktohet nga fakti se një shumësi personash veprojnë së bashku për të realizuar një ndërmarrje kriminale të përbashkët.<sup>1573</sup> Qëllimi i përbashkët nuk presupozon planifikim përgatitor ose marrëveshje të shprehur ndërmjet pjesëmarrësve në NKP, ose ndërmjet pjesëmarrësve në NKP dhe personave të tretë.<sup>1574</sup> Për më tepër, NKP-ja mund të ekzistojë edhe nëse asnjë, ose vetëm disa, prej kryesve fizikë të krimeve janë anëtarë të NKP-së, por përdoren nga një ose më shumë anëtarë të NKP-së për të kryer krimet sipas qëllimit të përbashkët.<sup>1575</sup>

740. *Kontributi*. Kryesi duhet të ketë marrë pjesë në realizimin e qëllimit të përbashkët mbi të cilin bazohet NKP-ja duke ndihmuar ose duke kontribuar për zbatimin e planit ose qëllimit të përbashkët, por nuk është e nevojshme të ketë kryer ndonjë pjesë të veprimit të fajshëm të krimit për të cilin akuzohet.<sup>1576</sup> Ligjërish nuk është e nevojshme që kontributi i kryesit në NKP të jetë i domosdoshëm ose i konsiderueshëm, por duhet të jetë më së paku kontribut i qenësishëm në krimet për të cilat ai ose ajo konstatohet se është përgjegjës.<sup>1577</sup> Nuk është e nevojshme që kontributi në vetvete të jetë kriminal.<sup>1578</sup>

## ii. Elementet subjektive

741. Sa i përket NKP I, kryesi duhet të ketë të njëjtin synim me pjesëmarrësit e tjerë për kryerjen e krimeve që janë pjesë e qëllimit të përbashkët, duke përfshirë edhe synimin konkret.<sup>1579</sup>

---

<sup>1573</sup> ICTY, [Tadić Appeal Judgement](#), para. 227; *Prosecutor v. Furundžija*, IT-95-17/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 21 July 2000, para. 119.

<sup>1574</sup> ICTY/TPNJ, [Haradinaj Trial Judgement](#) (Aktgjykimi *Haradinaj*), para. 138; [Brdanin Appeal Judgement](#), para. 418; [Kvočka et al. Appeal Judgement](#), paras 117-119.

<sup>1575</sup> ICTY, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3561; [Krajišnik Appeal Judgement](#), paras 225-226, 235-236; [Brdanin Appeal Judgement](#), paras 410, 413.

<sup>1576</sup> ICTY, [Krajišnik Appeal Judgement](#), paras 215, 218, 695; [Tadić Appeal Judgement](#), para. 227.

<sup>1577</sup> ICTY, [Mladić Trial Judgment](#), para. 3561; [Krajišnik Appeal Judgement](#), paras 215, 662, 675, 695-696; [Brdanin Appeal Judgement](#), para. 430; [Kvočka et al. Appeal Judgement](#), paras 97-98.

<sup>1578</sup> ICTY, [Krajišnik Appeal Judgement](#), para. 695.

<sup>1579</sup> ICTY/TPNJ, [Dorđević Appeal Judgement](#) (Aktgjykimi i Apelit *Gjorgjeviq*), para. 468.

(mm) Konstatime

i. Elementet objektive

742. *Shumësi personash.* Trupi Gjykses konstatoi se anëtarë të BIA-s, anëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët vetë i akuzuari, Nazif Musliu (me pseudonimin Tabuti), Ilmi Vela, z. Mehmetaj (me pseudonimin Bimi), Dardani, Afrimi dhe Fatmiri: (i) arrestuan, mbajtën të ndaluar arbitrarisht dhe torturuan në kompleksin e ndalimit në Zllash të paktën gjashtë persona afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR]; dhe (ii) vranë viktimën e vrasjes së paligjshme afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe rreth fundit të prillit 1999.<sup>1580</sup>

743. Trupi Gjykses gjykon se të gjithë këta individë janë identifikuar me konkretësi të mjaftueshme nga provat, ose me emër, pseudonim, dhe/ose sipas funksioneve dhe përkatësisë së tyre në njësitin BIA dhe, më përgjithësisht, në UÇK. Në fakt, mbi bazën e provave, Trupi Gjykses gjykon se individët e lartpërmendur ishin të gjithë të lidhur me njëri-tjetrin për faktin se qendra e veprimtarive të tyre ishte kompleksi i ndalimit në Zllash, ose sepse ata ishin të vendosur atje, ose sepse shkuan atje për të transportuar të ndaluarit të anëtarët e BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash, ose sepse u urdhëruan t'ua dorëzonin të ndaluarit anëtarëve të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash.

744. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ekzistonte një shumësi personash brenda kuptimit të NKP I, çka përmbush elementin e parë objektiv të kësaj forme të përgjegjësisë penale.

745. *Qëllimi i përbashkët që përbën kryerje të një krimi ose përfshin kryerjen e një krimi.* Trupi Gjykses dedukton ekzistencën e veprimeve për realizimin e qëllimit të përbashkët nga

---

<sup>1580</sup> *Shih* konstatimet faktike dhe ligjore të Trupit Gjykses në Pjesët V.7 deri në V.E, dhe VI.A deri në VI.D.

fakti se kryerja e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat u realizua përmes së njëjtës praktikë, përmes ndalimit dhe keqtrajtimit të institucionalizuar gjatë periudhës kohore që përfshijnë akuzat. Çka është më e rëndësishme, Trupi Gjykses ka konstatuar se të paktën gjashtë persona, ndër ta W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] u ndaluan, u morën ashpërsisht në pyetje dhe/ose u torturuan në mënyrë sistematike, përfshirë edhe përmes mbajtjes së tyre në kushte të tmerrshme ndalimi, afërsisht midis [REDAKTUAR] prillit 1999 dhe 19 prillit 1999.<sup>1581</sup> Trupi Gjykses rikujton se viktimat u mbajtën të ndaluara dhe u torturuan me pretendimin se bashkëpunonin me serbët, se ishin spiunë, tradhtarë, hajdutë, gënjeshtarë ose anëtarë apo mbështetës të partive politike, të cilat konsideroheshin kundërshtarë të UÇK-së.<sup>1582</sup> Trupi Gjykses gjithashtu ka konstatuar se anëtarë të identifikuar të BIA-s, ndër të cilët dhe vetë i akuzuari, i torturuan të ndaluarit e lartpërmendur në mënyra të ndryshme, duke i goditur me shkelma, grushte, shuplaka, duke përdorur mjete të shumta si shkopinj bejsbolli, bishta sakice, shufër hekuri, shkop druri/gome, thika, një bateri dhe një hekur të nxehtë, dhe këtë e bënë shpesh në grup.<sup>1583</sup>

746. Është me rëndësi të përmendet se Trupi Gjykses ka konstatuar se ndalimi dhe rrjedhimisht, torturimi i të ndaluarve, u ndërpre vetëm për shkak të lirimit të tyre të papritur (me përjashtim të viktimës së vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], të cilët nuk u liruan), që ndodhi për shkak të një ndryshimi të jashtëzakonshëm të rrethanave, konkretisht afrimit të ofensivës serbe.<sup>1584</sup> Në të njëjtën kohë, Trupi Gjykses ka konstatuar se viktima e vrasjes së paligjshme ishte i ndaluar që u torturoa më së shumti ([REDAKTUAR]), iu refuzua ndihma mjekësore dhe për herë të fundit u pa

---

<sup>1581</sup> *Shih* konstatimet faktike të Trupit Gjykses në Pjesën V në lidhje me Pikat 1-3.

<sup>1582</sup> *Shih* para. 579-583.

<sup>1583</sup> *Shih* para. 497-588.

<sup>1584</sup> *Shih* para. 636. *Shih gjithashtu* konstatimet e Trupit Gjykses në "Rrethanat e lirimit" në lidhje me W01679-ën, W03593-shin dhe W03594-ën.

kur u liruan të ndaluarit e tjerë, në një gjendje në prag të vdekjes, që nuk ishte në gjendje të ecte apo të qëndronte në këmbë.<sup>1585</sup> Ai as u lirua, as u evakuua dhe kufoma e tij u gjet në një varr të cekët [REDAKTUAR].<sup>1586</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se qëllimi i përbashkët i NKP-së përfshinte vrasjen e viktimës së vrasjes së paligjshme.

747. Bazuar në veprimet dhe mosveprimet e tyre të përbashkëta, Trupi Gjykses gjykon se shumësia e personave të identifikuar më lart, ndër ta dhe i akuzuari, vepruan në bashkëpunim, në kuadër të funksioneve të tyre përkatëse, me qëllimin e përbashkët për të ndaluar dhe torturuar të ndaluarit për shkak të dyshimeve të pretenduara ndaj tyre, si dhe për të ndaluar, torturuar dhe përfundimisht për të vlarë viktimën e vrasjes së paligjshme për të njëjtat arsye. Trupi Gjykses konstaton se kjo ndodhi pavarësisht nëse këta individë kryen apo jo edhe detyra të tjera – që nuk kishin të bënin me kryerjen e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat — si mjekimi apo evakuimi i personave të plagosur, ose sigurimi i strehimit për personat e zhvendosur ose për anëtarë të tjerë të UÇK-së. Këto të fundit nuk zbehin faktin se anëtarët e NKP-së kishin qëllimin e përbashkët të kryerjes së krimeve për të cilat janë ngritur akuzat.

748. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se anëtarët e NKP-së kishin një qëllim të përbashkët, që përbënte kryerje të krimeve ose përfshinte kryerjen e krimeve për të cilat janë ngritur akuzat sipas Pikave 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës së Konfirmuar, gjë që rrjedhimisht përmbush elementin e dytë objektiv të NKP I.

749. *Kontributi i të akuzuarit.* Ndonëse për kontributin nuk kërkohet që i akuzuari të ketë kryer ndonjë nga elementet objektive të krimeve për të cilat janë ngritur akuzat, por kërkohet vetëm që kontributi të jetë “i qenësishëm”, Trupi Gjykses konstaton se

---

<sup>1585</sup> *Shih* para. 569-574, 577 dhe 621.

<sup>1586</sup> *Shih* para. 612-618.

kontributi i të akuzuarit, si anëtar i NKP-së, tejkaloi ndjeshëm kriterin për përmbushjen e këtij elementi.

750. Trupi Gjykses rikujton se i akuzuari, si komandant i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s, që kishte kontroll të plotë mbi kompleksin e ndalimit në Zllash: (i) torturoi personalisht W01679-ën dhe W03593-shin (dy herë), duke u dhënë kështu shembull ose nxitje vartësve të tij në BIA që të kryenin veprime të ngjashme kundër të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash; (ii) urdhëroi vartësit e tij të BIA-s që t'i torturonin të ndaluarit dhe t'i mbanin ata në ndalim gjatë prillit 1999;<sup>1587</sup> (iii) nuk u ofroi ndihmë mjekësore të ndaluarve, me gjithë keqtrajtimin dhe lëndimet e tyre; (iv) nuk i liroi të ndaluarit, duke lejuar kështu që vartësit e tij të BIA-s t'i keqtrajtonin deri kur ndodhi një ndryshim i jashtëzakonshëm i rrethanave, konkretisht ofensiva serbe; dhe (v) as i liroi dhe as i evakuo i viktimën e vrasjes së paligjshme [REDAKTUAR], të cilët vazhduan të ishin në ndalim, ndërkohë që i akuzuari dhe vartësit e tij të BIA-s u larguan nga kompleksi i ndalimit në Zllash për shkak të afrimit të ofensivës serbe.<sup>1588</sup>

751. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se i akuzuari dha kontribut të qenësishëm në realizimin e qëllimit të përbashkët, çka rrjedhimisht përmbush elementin e tretë objektiv të NKP I.

## ii. Elementet subjektive

752. *Synimi i kryerjes së krimeve si pjesë e qëllimit të përbashkët.* Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta sipas të cilave i akuzuari kishte synimin kriminal të nevojshëm për kryerjen e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4).<sup>1589</sup>

---

<sup>1587</sup> Trupi Gjykses konstatoi se i akuzuari urdhëroi vartësit e tij të BIA-s që t'i torturonin disa të ndaluar ose t'i kthenin në ahuret ku mbaheshin; ose ishte dëshmitar i torturimit të të ndaluarve nga vartësit e tij (*shih* para. 534, 535, 546 dhe 547).

<sup>1588</sup> *Shih* para. 621-636.

<sup>1589</sup> *Shih* para. 654-659, 679-685, 691-695.



753. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses konstaton se i akuzuari kishte qartazi synimin për të kryer ndalim arbitrar (Pika 1) dhe torturë (Pika 3) me anëtarët e tjerë të NKP-së të identifikuar më lart, pasi ata të gjithë kontribuan, në kuadër të funksioneve të tyre përkatëse, në arrestimin, transferimin, ndalimin dhe torturimin e të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar se disa anëtarë të UÇK-së dhe/ose BIA-s urdhëruan arrestimin e viktimës së vrasjes së paligjshme dhe e transportuan atë, si dhe W03593-shin, W03594-ën, W01679-ën dhe W04669-ën, në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1590</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses ka konstatuar se në kompleksin e ndalimit në Zllash, anëtarët e BIA-s i mbyllnin me kyç dhe i ruanin me roja ahuret ku mbaheshin viktimat; i sillnin të ndaluarit në dhomën e marrjes në pyetje dhe i kthenin në ahure pasi i torturonin, nganjëherë me urdhër të vetë të akzuarit; ata i torturonin të ndaluarit, shpesh në grup, nën vëzhgimin e të akzuarit ose bashkë me të.<sup>1591</sup> Gjithashtu, i akuzuari urdhëroi anëtarët e tjerë të BIA-s që ta rrihnin një të ndaluar (W01679-ën) derisa ai humbi ndjenjat dhe nuk ushtroi kompetencat e tij si komandant për t'u dhënë të ndaluarve garanci bazë ose për t'i liruar ata, me përjashtim të datës 19 prill 1999 ose rreth saj, për shkak të afrimit të ofensivës serbe.<sup>1592</sup> Të gjitha këto veprime, të marra së bashku, tregojnë se anëtarët e NKP-së, ndër ta dhe i akuzuari, kishin qëllimin e përbashkët të kryerjes së krimeve të përfshira në Pikat 1 dhe 3 të Aktakuzës së Konfirmuar.

754. E njëjta gjë vlen edhe në lidhje me akuzën për vrasje të paligjshme sipas Pikës 4. Gjatë kohës që ishte i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, shkalla e keqtrajtimit të ushtruar ndaj viktimës së vrasjes së paligjshme ([REDAKTUAR]) ishte

---

<sup>1590</sup> *Shih* konstatimet e Trupit Gjykses në "Arrestimi fillestar" në lidhje me W01679-ën, W03593-shin, W03594-ën, W04669-ën dhe viktimën e vrasjes së paligjshme.

<sup>1591</sup> *Shih, për shembull*, para. 391, 415, 449, 534-535, 546, 547, 561, 567 dhe 572.

<sup>1592</sup> *Shih* para. 534, 636.

shumë më e rëndë se sa ndaj çdo të ndaluar tjetër, duke e lënë atë në një gjendje në prag të vdekjes.<sup>1593</sup> Trupi Gjykses gjykon se i akuzuari, së bashku me anëtarët e tjerë të BIA-s që morën pjesë në torturë, synonin ta kryenin këtë trajtim vdekjeprurës. Anëtarët e BIA-s përdorën ndaj viktimës së vrasjes së paligjshme mjete ose metoda keqtrajtimi që me gjasë mund të shkaktonin vdekjen. Gjithashtu, i akuzuari ishte në dijeni se viktima kishte mbërritur në kompleksin e ndalimit në Zllash më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR], dhe kishte synimin që torturimi i tij të vazhdonte për rreth [REDAKTUAR] ditë, pa i ofruar kujdes mjekësor, garanci bazë dhe pa e liruar atë, veprime këto që ai kishte kompetencë t'i bënte si komandant i BIA-s. Kjo vazhdoi deri kur i akuzuari, në funksionin e tij si komandant i BIA-s, vendosi të mos e lironte viktimën e vrasjes së paligjshme — çka faktikisht ishte barabar me një vendim për vrasjen e tij. Siç është konstatuar nga Trupi Gjykses, viktima në fund vdiq si rezultat i kombinimit të keqtrajtimit të rëndë të shkaktuar nga anëtarët e BIA-s të cilët e mbajtën në ndalim, duke i shkaktuar dëmtim të rëndë fizik, dhe refuzimit të ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s.<sup>1594</sup>

755. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se [REDAKTUAR].<sup>1595</sup> [REDAKTUAR].<sup>1596</sup> [REDAKTUAR].<sup>1597</sup>

756. Në vlerësimin e Trupit Gjykses, provat në lidhje me: (i) urdhrin fillestar për arrestimin e viktimës së vrasjes së paligjshme; (ii) torturimin që i akuzuari synonte t'i bënte atij, që e la atë në një gjendje në prag të vdekjes; (iii) pengimin e dhunshëm [REDAKTUAR]; (iv) refuzimin e ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s; (v) vendimet e marra nga i akuzuari më 19 prill 1999 ose rreth kësaj date, për lirimin

---

<sup>1593</sup> *Shih* para. 569-574 dhe 577.

<sup>1594</sup> *Shih* para. 620-624 dhe 637-639.

<sup>1595</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 769, rreshtat 21-25; f. 770, rreshti 20 deri në f. 771, rreshti 7.

<sup>1596</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 772, rreshtat 23-24.

<sup>1597</sup> **W04600**: T. 24 shtator 2021, konfidencial, f. 773, rreshtat 1-2.

e disa të ndaluarve, por jo të të tjerëve (ndër ta dhe viktima e vrasjes së paligjshme, çka faktikisht ishte barabar me një vendim për ta vrarë atë), të cilat u zbatuan nga vartësit e tij të BIA-s; dhe (vi) përpjekjet e të akuzuarit dhe të të tjerëve për të penguar çdo hetim dhe ndjekje penale në lidhje me ato ngjarje,<sup>1598</sup> të marra së bashku, provojnë se anëtarët e NKP-së kishin synimin e përbashkët të vrasjes së viktimës së vrasjes së paligjshme dhe, rrjedhimisht, të kryerjes së vrasjes së paligjshme të përfshirë në Pikën 4 të Aktakuzës së Konfirmuar.

757. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se i akuzuari, bashkë me anëtarët e tjerë të NKP-së, kishte synimin e përbashkët për kryerjen e krimeve të përfshira në Pikat 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës së Konfirmuar, çka rrjedhimisht përmbush elementin subjektiv të NKP I.

#### I. PËRFUNDIM

758. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton jashtë dyshimit të arsyeshëm se — në kontekstin e konfliktit jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, duke qenë në dijeni të rrethanave që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe të statusit të viktimave — i akuzuari është fajtor për Pikën 3 të Aktakuzës së Konfirmuar, për kryerjen e drejtpërdrejtë, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit, të veprës së mëposhtme penale afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 në kompleksin e ndalimit në Zllash: torturë si krim luftime, sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kundër W01679-ës dhe W03593-shit, siç është konstatuar nga Trupi Gjykses në paragrafët 729-733 më lart (Pika 3).

759. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton jashtë dyshimit të arsyeshëm se — në kontekstin e konfliktit jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, duke qenë në dijeni të rrethanave që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe të

---

<sup>1598</sup> *Shih* para. 459-460, 591-602, 621, 636, 679-685, 694.

statusit të viktimave — i akuzuari është fajtor për Pikat 1 dhe 3 të Aktakuzës së Konfirmuar, për kryerjen e veprave penale të mëposhtme, si pjesë e NKP I, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 në kompleksin e ndalimit në Zllash: (i) ndalim arbitrar si krim lufte, sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, kundër së paku gjashtë personave, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] (Pika 1); (ii) torturë si krim lufte, sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kundër së paku gjashtë personave, ndër të cilët W01679, W03593, W03594, W04669, viktima e vrasjes së paligjshme, [REDAKTUAR] (Pika 3), siç është konstatuar nga Trupi Gjykses në paragrafët 742-757 më lart dhe me përjashtim të incidenteve për të cilat i akuzuari është penalisht përgjegjës si kryes i drejtpërdrejtë.

760. Së fundi, Trupi Gjykses konstaton jashtë dyshimit të arsyeshëm se — në kontekstin e konfliktit jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, duke qenë në dijeni të rrethanave që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe të statusit të viktimave — i akuzuari është fajtor për Pikën 4 të Aktakuzës së Konfirmuar, për kryerjen, si pjesë e NKP I, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit, të veprës penale të vrasjes së paligjshme si krim lufte, sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kundër viktimit të vrasjes së paligjshme, afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash (Pika 4).

## VII. DËNIMI

761. Pasi ka vërtetuar se z. Mustafa është fajtor për Pikat 1, 3 dhe 4, tani Trupi Gjykses do të përcaktojë dënimin e duhur.

762. Kjo pjesë e Aktgjykimit trajton vetëm përcaktimin e dënimit sipas nenit 44(1) të Ligjit. Trupi Gjykses do të nxjerrë në kohën e duhur një Urdhër për Zhdëmtim sipas

neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit dhe ruan juridiksionin e nevojshëm në lidhje me këtë.<sup>1599</sup>

## A. PARASHTRIMET

### 1. ZPS-ja

763. ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale të gjerë në përcaktimin e dënimit të duhur dhe mund të japë një dënim deri me burgim të përjetshëm sipas nenit 44(1) të Ligjit.<sup>1600</sup>

764. ZPS-ja më tej parashtron se, në bazë të nenit 44(2) të Ligjit, dënimet në legjislacionin e Kosovës në kohën e kryerjes së krimeve nuk kanë fuqi detyruese mbi Trupin Gjykses, por ky ka thjesht detyrimin ta marrë parasysh atë legjislacion.<sup>1601</sup> Sipas ZPS-së, legjislacioni përkatës në fuqi në Kosovë në atë kohë ishte Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ).<sup>1602</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtron se ligjet përkatëse të miratuara më vonë në Kosovë kanë përcaktuar dënime të njëjta ose më të rënda, deri me burgim të përjetshëm.<sup>1603</sup>

---

<sup>1599</sup> Shih KSC-BC-2020-05, F00310, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në këtë Çështje dhe ku Kërkohet Informacion*, 4 shkurt 2022, konfidencial, para. 50(b). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, [F00310/RED](#).

<sup>1600</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 346, 355. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-05, F00471, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në bazë të Vendimit F00468 për Caktimin e Rendit të Ditës të Seancës së Deklaratave Përmbyllëse dhe Çështje në lidhje me To* (Parashtrimet e ZPS-së mbi Deklaratat Përmbyllëse), 8 shtator 2022, konfidenciale, para. 21, 18. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 9 shtator 2022, F00471/RED.

<sup>1601</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 352; Parashtrimet e ZPS-së mbi Deklaratat Përmbyllëse, para. 11-13.

<sup>1602</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 349. Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, 1 korrik 1976.

<sup>1603</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 350.

765. Lidhur me faktorët që duhen marrë parasysh në përcaktimin e dënimit, ZPS-ja parashtron se dënimi duhet të pasqyrojë:<sup>1604</sup> (i) peshën e krimeve të kryera nga i akuzuari, të cilat, në këtë rast, ishin qartësisht brutale;<sup>1605</sup> pasojat e rënda të krimeve mbi viktimat;<sup>1606</sup> (ii) rolin e të akuzuarit në kryerjen e krimeve, që përfshin si udhëzimin e të tjerëve për të kryer krimet, ashtu dhe pjesëmarrjen e tij personale në to, duke shfaqur para vartësve të tij një shpërfillje të plotë për dinjitetin njerëzor dhe duke siguruar kështu që ata vetë të përfshihen në dhunë të skajshme;<sup>1607</sup> (iii) rëndësinë e parandalimit të përgjithshëm, i cili në çështje si kjo në fjalë, dëshmon se vështirësitë lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale nuk do t'i pengojnë Dhomat e Specializuara që të vendosin para përgjegjësisë kryesit për krimet e tyre;<sup>1608</sup> dhe (iv) praninë e faktorëve të shumtë rëndues,<sup>1609</sup> e mungesën e faktorëve lehtësues.<sup>1610</sup>

766. Sa i përket dënimit të zbatueshëm për secilën akuzë të Aktakuzës së Konfirmuar, ZPS-ja kërkon që Trupi Gjykes të japë dënimet e mëposhtme me burgim për të akuzuarin: (i) ndalim arbitrar (Pika 1): 10 vjet; (ii) trajtim mizor (Pika 2): 20 vjet; (iii) torturë (Pika 3): 25 vjet; dhe (iv) vrasje e paligjshme (Pika 4): 33 vjet.<sup>1611</sup> ZPS-ja

---

<sup>1604</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 344, 356-383. *Shih gjithashtu* T. 13 shtator 2022, publik, f. 4590, rreshtat 17-21.

<sup>1605</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 356-359. *Shih gjithashtu* T. 13 shtator 2022, publik, f. 4591, rreshti 12 deri në f. 4595, rreshti 11.

<sup>1606</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 360-364. *Shih gjithashtu* T. 13 shtator 2022, publik, f. 4595, rreshtat 12-16.

<sup>1607</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 365-368. *Shih gjithashtu* T. 13 shtator 2022, publik, f. 4595, rreshti 23 deri në f. 4596, rreshti 16.

<sup>1608</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 369-370. *Shih gjithashtu* T. 13 shtator 2022, publik, f. 4590, rreshtat 21-22.

<sup>1609</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 360, 372-378. *Shih gjithashtu* T. 13 shtator 2022, publik, f. 4596, rreshti 17 deri në f. 4599, rreshti 8.

<sup>1610</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 380-383. *Shih gjithashtu* T. 13 shtator 2022, publik, f. 4599, rreshtat 12-25.

<sup>1611</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 384. *Shih gjithashtu* T. 13 shtator 2022, publik, f. 4600, rreshtat 12-18.

kërkon që të akuzuarit t'i jepet një dënim i njësuar me 35 vjet burgim, që pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale të tij.<sup>1612</sup>

767. Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses duhet të urdhërojë të akuzuarin që të dëmshpërblejë ose të kompensojë viktimat në këtë çështje gjyqësore.<sup>1613</sup>

## 2. Mbrojtësja e viktimave

768. Mbrojtësja e viktimave parashtron se dënimi duhet të pasqyrojë peshën e brendaqenësishme të krimeve për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, si natyrën veçanërisht mizore të kriminit të torturës, të rënduar edhe më shumë nga kushtet çnjerëzore të mbajtjes në ndalim të viktimave.<sup>1614</sup>

769. Sa i përket kontributit të të akuzuarit në krime, mbrojtësja e viktimave thekson se dy viktima e identifikuan të akuzuarin si individ që mori pjesë drejtpërdrejt në keqtrajtimin e tyre dhe që udhëzoi të tjerët të bënin të njëjtën gjë.<sup>1615</sup> Në lidhje me faktorët rëndues, mbrojtësja e viktimave parashtron se pozita me përgjegjësi e z. Mustafa si komandant i njësitit BIA, i cili mori pjesë drejtpërdrejt në keqtrajtimin e viktimave, përlligj një dënim më të rëndë.<sup>1616</sup>

## 3. Mbrojtja

770. Mbrojtja parashtron<sup>1617</sup> se shprehja “e marrin parasysh” në nenin 44(2) të Ligjit nënkupton një kriter detyrues dhe, për rrjedhojë, Trupi Gjykses është i detyruar të

---

<sup>1612</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 386, 388. *Shih gjithashtu* T. 13 shtator 2022, publik, f. 4600, rreshti 25 deri në f. 4601, rreshtat 1-2.

<sup>1613</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 345.

<sup>1614</sup> Deklaratë e Mbrojtëses së Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 71-72.

<sup>1615</sup> Deklaratë e Mbrojtëses së Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 73-75.

<sup>1616</sup> Deklaratë e Mbrojtëses së Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 76-78.

<sup>1617</sup> Mbrojtja iu përgjigj në seancë të hapur pyetjeve të Trupit Gjykses, *shih* [Decision Setting Agenda for Closing Statements](#) (Vendim për Caktimin e Rendit të Ditës së Seancës për Deklaratat Përmbyllëse), para. 11-14.



japë dënimin më të butë për krimin e parashikuar në legjislacionin e Kosovës.<sup>1618</sup> Gjithashtu, Mbrojtja parashtron se për krimet e kryera gjatë periudhës së Aktakuzës së Konfirmuar zbatohet Kodi Penal i RSFJ-së.<sup>1619</sup> Në këtë aspekt, sa i përket krimit të ndalimit arbitrar që ka të bëjë me shqiptarët kosovarë, Mbrojtja parashtron se ky krim në atë kohë nuk ekzistonte dhe nuk parashikohej në Kodin Penal të RSFJ-së, dhe, rrjedhimisht, për të nuk mund të jepet dënim.<sup>1620</sup>

771. Mbrojtja gjithashtu parashtron se në përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh edhe parimet e përcaktuara në nenin 44(2)(a)-(c) të Ligjit.<sup>1621</sup> Në këtë kontekst, Mbrojtja thekson se Trupi Gjykses është gjithashtu i detyruar të zbatojë parimet e përcaktuara në nenet 38 (Burgim), 41 (Parime të përgjithshme për caktimin e dënimit), 42 (Ulja e dënimit), 43 (Mënyra e uljes së dënimeve) dhe 48 (Kombinimi i veprave penale) të Kodit Penal të RSFJ-së.<sup>1622</sup>

---

<sup>1618</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4792, rreshtat 15-22.

<sup>1619</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4793, rreshtat 16-23.

<sup>1620</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4794, rreshtat 8-14, *shih gjithashtu* rreshtat 15-17. Mbrojtja gjithashtu pretendon se termi popullatë civile, siç parashikohet në nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së (që titullohet “Krime lufte kundër popullatës civile” dhe përfshin veprën penale të arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm) mund t’i referohet “popullatës civile të armikut”. Mbrojtja argumenton se në këtë rast “fuqia pushtuese” ishte Serbia dhe asnjë nga të ndaluarit nuk ishte serb. Rrjedhimisht, sipas Mbrojtjes, si shtetas të RSFJ-së, shqiptarët kosovarë të ndaluar ishin të pambrojtur (T. 15 shtator 2022, publik, f. 4794, rreshti 18 deri në f. 4795, rreshti 18). Mbrojtja gjithashtu parashtron se dy prej të ndaluarve kishin qenë në stërvitje dhe, për rrjedhojë, ata nuk ishin të mbrojtur nga neni 3 i nenit të përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës (T. 15 shtator 2022, publik, f. 4795, rreshtat 19-24).

<sup>1621</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4796, rreshti 6 deri në f. 4597, rreshti 23.

<sup>1622</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4797, rreshti 25 deri në f. 4798, rreshti 13.

## B. KUADRI LIGJOR

### 1. Qëllimi i dënimit

772. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se qëllimet kryesore të dënimit të individëve sipas nenit 14 të Ligjit janë ndëshkimi, parandalimi (i veçantë dhe i përgjithshëm) dhe – në një masë më të vogël – rehabilitimi i kryesit.<sup>1623</sup>

773. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se me themelimin e Dhomave të Specializuara është njohur rëndësia e nxjerrjes para drejtësisë të kryesve të krimeve të rënda që përbëjnë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare në tërësi, për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë – edhe dekada pas ngjarjeve në fjalë dhe pavarësisht nga ekzistenca prej kohësh e atmosferës mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë.<sup>1624</sup>

774. Dënimi duhet gjithashtu të pasqyrojë thirrjen për drejtësi nga personat që kanë qenë – drejtpërdrejt ose tërthorazi – viktimat të krimeve. Një qëllim tjetër i rëndësishëm i dënimit është njohja e dëmit dhe vuajtjeve që u janë shkaktuar atyre dhe shoqërisë.<sup>1625</sup>

775. Duke pasur parasysh se në këtë çështje gjyqësore krimet u kryen vetëm kundër shqiptarëve kosovarë, Trupi Gjykses është gjithashtu i mendimit se zbulimi i së vërtetës si rezultat i këtij aktgjykimi mund të kontribuojë më tej në pajtimin ndërmjet grupeve të prekura në Kosovë, për të kontribuar në rivendosjen dhe ruajtjen e paqes.

776. Gjithashtu, qëllimi i dënimit të dhënë nga Trupi Gjykses është që të bëjë më se të qartë se rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare duhet të respektohen në të gjitha rrethanat dhe në të gjitha vendet.

---

<sup>1623</sup> *Shih* Neni 38 i Kodit Penal të Kosovës, 14 janar 2019, Kodi nr. 06/L074 (KPK).

<sup>1624</sup> *Shih* para. 57. *Shih gjithashtu* [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 577-578.

<sup>1625</sup> *Shih* Neni 38(1)(1.3) i KPK-së që përcakton se një nga qëllimet e dënimit është “të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale”.

777. Së fundi, Trupi Gjykues gjykon se një qëllim tjetër i dënimit në çështjen në fjalë është zbatimi i parimit të barazisë para ligjit.<sup>1626</sup>

## 2. Përcaktimi i dënimit

778. Për përcaktimin e dënimit, në bazë të nenit 3(2)(b)-(c) dhe (4) të Ligjit, Trupi Gjykues zbaton dispozitat e neneve 44(1), (2) dhe (5) të Ligjit dhe rregullat 159(6) dhe 163(1), (3), (4) dhe (6) të Rregullores.

779. Në bazë të nenit 44(1) të Ligjit, Trupi Gjykues mund të shqiptojë kundër personit të shpallur fajtor dënim maksimal me burgim të përjetshëm.

780. Trupi Gjykues e interpreton shprehjen “e marrin parasysh” në nenin 44(2) të Ligjit si një kriter që Trupi Gjykues, në përcaktimin e dënimit, të marrë parasysh dënimet e përcaktuara për ato vepra penale në ligjin që ishte në fuqi në Kosovë në kohën e kryerjes së krimeve të shqyrtuara, dhe, në veçanti, çdo dënim më të butë të mëvonshëm.<sup>1627</sup> Gjithsesi, në kundërshtim me çka parashtron Mbrojtja, aspekte të tilla nuk kanë fuqi detyruese mbi Trupin Gjykues.<sup>1628</sup>

781. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues konstaton se në kohën e kryerjes së veprave penale të shqyrtuara, në Kosovë zbatoheshin dispozitat ligjore përkatëse të Kodit Penal të RSFJ-së. Ai vë në dukje se neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së i titulluar “Krime lufte kundër popullatës civile” parashikonte ose “burgim me jo më pak se pesë vjet ose [...] dënim me vdekje” dhe se neni 38 i Kodit Penal të RFSJ-së i titulluar “Burgim” parashikonte se “dënimi me burgim nuk mund të jetë më i gjatë se 15 vjet” por [mund

---

<sup>1626</sup> Në mënyrë të ngjashme, [Stakić Trial Judgement](#), para. 901; *Prosecutor v. Nikolić*, IT-94-2-S, Trial Chamber II, [Sentencing Judgement](#), 18 December 2003, para. 124.

<sup>1627</sup> Nga ana tjetër, neni 44(4) i Ligjit përcakton se dënimet për “krimet sipas nenit 15(2) janë në përputhje me dënimet për krimet e përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012, Ligji nr. 04/L-082” (theksimi i shtuar), që nënkupton se ky është një kriter i detyrueshëm. Shih gjithashtu [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 941.

<sup>1628</sup> Shih para. 770-771.

të jepej] “një dënim me 20 vjet burg për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi me vdekje”.<sup>1629</sup> Sipas Trupit Gjykses, dënimet sipas Kodit Penal të RSFJ-së, tregojnë se për krimet më të rënda, siç janë krimet e luftës, jepeshin dënime më të rënda.

### 3. Faktorë relevantë në përcaktimin e dënimit

782. Trupi Gjykses së pari evidenton faktorët relevantë në bazë të nenit 44(5) të Ligjit dhe rregullës 163(1) të Rregullores dhe, së dyti, i peshon dhe balancon të gjithë këta faktorë dhe përcakton dënimin.

(nn) Evidentimi i faktorëve relevantë

783. Faktorë relevantë për përcaktimin e dënimit janë pesha e krimit dhe pasojat e tij, kontributi personal i personit të shpallur fajtor në krim, rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese që lidhen me këta faktorë.

(oo) Balancimi i faktorëve relevantë

784. Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale për të peshuar dhe balancuar faktorë të ndryshëm për përcaktimin e dënimit.<sup>1630</sup> Këta faktorë, të cilët shtjellohen më tej më poshtë dhe përmenden në mënyrë joshteruese në nenin 44(5) të Ligjit dhe rregullën 163(1) të Rregullores, do të trajtohen në tri kategori: (i) pesha e veprës (veprave) penale dhe pasojat e saj; (ii) kontributi personal i personit të shpallur fajtor në krim (krime); dhe (iii) rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor.

---

<sup>1629</sup> Trupi Gjykses thekson se Rregullorja 1999/24 e UNMIK-ut e 12 dhjetorit 1999 e anuloi dënimin me vdekje. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se në ligjet apo kodet përkatëse të miratuara më vonë në Kosovë parashikohen dënime të njëjta ose më të rënda (*shih* nenin 118 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, 6 korrik 2003; Rregulloren nr. 2003/26 të UNMIK-ut; nenin 150 të Kodit Penal të Kosovës, 20 prill 2012, Kodin nr. 04/L082; dhe nenet 42, 144 dhe 145 të KPK-së).

<sup>1630</sup> *Shih, ndër të tjera*, nenin 44(5) të Ligjit dhe rregullën 163(1)(a), (b) dhe (3) të Rregullores.

785. Trupi Gjykues mund të shqyrtojë rrethanat rënduese dhe lehtësuese sipas cilësdo prej këtyre tri kategorive. Bazuar në rrethanat e çështjes, Trupi Gjykues ka një shkallë të konsiderueshme diskrecioni (i) për të përcaktuar çfarë përbën rrethanë lehtësuese apo rënduese, krahas atyre të përcaktuara shprehimisht në rregullën 163(1) të Rregullores, si dhe (ii) për të vendosur se sa peshë - nëse kanë - do t'u jepet atyre.

786. Gjithashtu, Trupi Gjykues duhet të shpjegojë peshën që u është dhënë këtyre rrethanave dhe provat konkrete mbi të cilat është mbështetur.<sup>1631</sup> Po kështu, personi i shpallur fajtor duhet të vihet mjaftueshëm në dijeni për faktet që janë marrë parasysh për rëndimin e dënimit.<sup>1632</sup>

i. Pesha e veprës penale dhe pasojat e saj

787. Trupi Gjykues thekson se pesha e veprës penale dhe pasojat e saj janë faktorë kyç për dhënien e dënimit. Trupi Gjykues do të shqyrtojë përmasat cilësore dhe sasiore të peshës së veprës penale në fjalë. Ai do të shqyrtojë llojin, kuadrin, si dhe rrethanat dhe pasojat e saj.

788. Pesha matet *in abstracto*, duke analizuar llojin e veprës penale në terma të përgjithshme dhe *in concreto*, duke vlerësuar rrethanat konkrete të çështjes. Jo të gjitha veprat penale që krijojnë arsye për dënim kanë domosdoshmërisht peshë të njëjtë dhe Trupi Gjykues duhet të peshojë secilën prej tyre.

---

<sup>1631</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-3122, Appeals Chamber, [Judgment on the appeals of the Prosecutor and Mr Thomas Lubanga Dyilo against the "Decision on Sentence pursuant to Article 76 of the Statute"](#), 1 December 2014, public, para. 69; *Prosecutor v. Bemba et al.*, Trial Chamber VII, ICC-01/05-01/13-2123-Corr, [Decision on Sentence pursuant to Article 76 of the Statute](#) (*Bemba et al. Sentencing*), 22 March 2017, public, para. 26.

<sup>1632</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-2276-Red, Appeals Chamber, [Public Redacted Judgment on the appeals of the Prosecutor, Mr Jean-Pierre Bemba Gombo, Mr Fidèle Babala Wandu and Mr Narcisse Arido against the decision of Trial Chamber VII entitled "Decision on Sentence pursuant to Article 76 of the Statute"](#) (*Bemba et al. Appeal Sentencing Judgment*), 8 March 2018, public, para. 116. Shih gjithashtu ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-1819-Red, Trial Chamber IX, [Public Redacted Sentence](#) (*Ongwen Sentencing*), 6 May 2021, public, para. 58. Për shembull, njoftimi i duhur mund të jepet në parashtrimet në lidhje me dënimin ([Bemba et al. Appeal Sentencing Judgment](#), para. 116).

789. Treguesit e peshës së veprës penale përfshijnë, ndër të tjera, shkallën e krimit, numrin e viktimave, cenueshmërinë e viktimave, moshën e viktimave, shkallën e vuajtjes së viktimave dhe ndikimin tek të afërmit. Faktorët që merren parasysh si elemente të peshës së krimit nuk mund merren parasysh edhe si rrethana rënduese më vete dhe anasjellas.

ii. Kontributi personal në krim

790. Në lidhje me kontributin personal në krim, Trupi Gjykses shqyrton rolin dhe pozitën e personit të shpallur fajtor, mjetet e përdorura për kryerjen e krimit dhe shkallën e synimit.<sup>1633</sup>

iii. Rrethanat individuale

791. Në lidhje me rrethanat individuale, Trupi Gjykses shqyrton rrethanat personale të personit të shpallur fajtor, siç janë mosha, gjendja shëndetësore, gjendja familjare, arsimimi, precedentët e mëhershëm penalë<sup>1634</sup> ose karakteri.

iv. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

792. Rrethanat lehtësuese duhet të lidhen drejtpërdrejt me personin e shpallur fajtor; sidoqoftë, nuk është nevoja që ato të lidhen drejtpërdrejt me krimin dhe nuk kufizohen në kuadrin e akuzës.<sup>1635</sup> Trupi Gjykses duhet të bindet për ekzistencën e rrethanave

---

<sup>1633</sup> Shih [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 952. Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Ongwen Sentencing](#), para. 139; [Bemba et al. Sentencing](#), para. 74; *Prosecutor v. Al Mahdi*, ICC-01/12-01/15-171, Trial Chamber VIII, [Judgment and Sentence](#) (*Al Mahdi Sentencing*), 27 September 2016, paras 84-85.

<sup>1634</sup> Rregulla 163(3) e Rregullores.

<sup>1635</sup> ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-2442, Trial Chamber VI, [Sentencing judgment](#) (*Ntaganda Sentencing*), 7 November 2019, para. 24 me referenca të mëtejshme.

lehtësuese në bazë të tërësisë së gjasave.<sup>1636</sup> Ekzistenca e rrethanave lehtësuese nuk e pakëson peshën e krimit, por është relevante për uljen e dënimit.<sup>1637</sup>

793. Rrethanat rënduese duhet kenë lidhje me krimin për të cilin personi është shpallur fajtor ose me vetë personin.<sup>1638</sup> Trupi Gjykes duhet të bindet për ekzistencën e rrethanave rënduese jashtë dyshimit të arsyeshëm.<sup>1639</sup> Mungesa e rrethanave lehtësuese nuk shërben si rrethanë rënduese.<sup>1640</sup> Së fundi, një element i krimit ose formë e përgjegjesisë penale nuk mund të konsiderohet në të njëjtën kohë edhe si rrethanë rënduese e po atij krimi.<sup>1641</sup>

#### 4. Përcaktimi i dënimit dhe zbritja e kohës së kaluar në paraburgim

794. Në përcaktimin dënimit të duhur, Trupi Gjykes ka kompetencë diskrecionale të konsiderueshme dhe mund të marrë parasysh praktikat e dënimit të gjykatave shtetërore dhe ndërkombëtare për krime të ngjashme.

795. Në bazë të rregullës 163(4) të Rregullores, Trupi Gjykes përcakton dënimin në lidhje me çdo akuzë të Aktakuzës së Konfirmuar, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe jep një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të personit të shpallur fajtor. Dënimi i njësuar nuk duhet të jetë më i lehtë se dënimi më i rëndë i përcaktuar për cilëndo prej akuzave. Së fundi, në bazë të rregullës 163(6) të

<sup>1636</sup> Shih [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 955 me referenca të mëtejshme.

<sup>1637</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Bemba et al. Sentencing](#), para. 24.

<sup>1638</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Bemba et al. Sentencing](#), para. 25 me referenca të mëtejshme.

<sup>1639</sup> Shih [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 955. Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Ongwen Sentencing](#), para. 53; [Bemba et al. Sentencing](#), para. 25; [Al Mahdi Sentencing](#), para. 73; ICTY, [Mucić et al. Appeal Judgement](#), para. 763; STL, *Prosecutor v. Ayyash*, STL-11-01/S/TC, Trial Chamber, [Sentencing Judgment](#) (*Ayyash Sentencing Judgment*), 11 December 2020, public, para. 181.

<sup>1640</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Al Mahdi Sentencing](#), para. 73.

<sup>1641</sup> Shih [Gucati and Haradinaj Trial Judgment](#) (Aktgjykimi *Gucati dhe Haradinaj*), para. 954. Në mënyrë të ngjashme, ICTY, *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT-08-91-T, Trial Chamber II, [Judgement](#), Vol. I (*Stanišić and Župljanin Trial Judgment*), 27 March 2013, para. 894; ICC, [Ntaganda Sentencing](#), para. 20; [Bemba et al. Sentencing](#), para. 25; [Al Mahdi Sentencing](#), para. 70; STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), public, para. 181.



Rregullores, gjatë dhënies së dënimit me burgim, Trupi Gjykses zbret kohën gjatë së cilës personi i shpallur fajtor është mbajtur në paraburgim, në rast se është mbajtur në paraburgim para ose gjatë gjykimit.

## C. KONSTATIME

### 1. Faktorë relevantë

(pp) Pesha e veprave penale dhe pasojat e tyre

i. Pesha e veprave penale

796. Trupi Gjykses thekson se ndalimi arbitrar është i rëndë, sepse i bën viktimat të cenueshme ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut. Në këtë çështje, të paktën gjashtë personave iu hoq liria nga z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s, në kompleksin e ndalimit në Zllash, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999. Askujt prej tyre nuk iu dha asnjë prej tri garancive bazë që duhet t'u jepen të gjithë personave të cilëve iu hiqet liria në një konflikt të armatosur.<sup>1642</sup> Siç rikujtohet më poshtë, të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash gjithashtu u mbajtën të ndaluar në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese dhe u keqtrajtuuan rregullisht psikologjikisht dhe fizikisht.

797. E drejta për të mos u torturuar njihet si normë e *jus cogens*.<sup>1643</sup> Krimi i torturës përfaqëson cenim të dinjitetit, sigurisë, dhe mirëqenies mendore dhe fizike të njeriut. Në këtë çështje, të paktën gjashtë individë u mbajtën të ndaluar në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese nga z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s, në kompleksin e ndalimit në Zllash, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999: ata u mbajtën në ahure të

<sup>1642</sup> *Shih* para. 495-496, 652-659. Konkretisht, të ndaluarit nuk u informuan për arsyet e heqjes së lirisë; nuk u nxorën menjëherë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonin ligjshmërinë e ndalimit të tyre.

<sup>1643</sup> *Shih, në mënyrë të ngjashme*, ICTY, *Prosecutor v. Simić*, IT-95-9/2-S, Trial Chamber II, [Sentencing Judgement](#), 17 October 2002, para. 34; *Prosecutor v. Zelenović*, IT-96-23/2-S, Trial Chamber I, [Sentencing Judgement](#), 4 April 2007, para. 36.

përshtatshme vetëm për mbajtjen e kafshëve; atyre nuk u dhanë shtretër dhe u detyruan të flinin në grazhdin e ushqimit të kafshëve ose në tokë – në pellgje uji, me jashtëqitjet e bagëtive përreth tyre, u mbajtën në errësirë; nuk iu dhanë sasi të mjaftueshme ushqimi dhe uji; nuk iu lejua të laheshin ose të ndërronin teshat; ata lejoheshin të shkonin në nevojtove shumë rrallë dhe detyroheshin t'i kryenin nevojat personale në ahur, në prani të njëri-tjetri; atyre iu refuzua ndihma mjekësore; dhe nuk lejoheshin të ndërvepronin dhe flisnin me njëri-tjetrin, duke u kërcënuar me vdekje.<sup>1644</sup> Gjithashtu, të ndaluarit keqtrajtoheshin rregullisht psikologjikisht nga z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash: ata jetonin me frikën e vazhdueshme se mund të bëheshin në çdo moment objekt i keqtrajtimit fizik; u detyruan të shihnin dhe dëgjonin keqtrajtimin fizik të të ndaluarve të tjerë; dhe nuk i lejonin të flinin.<sup>1645</sup> Gjithashtu, ata u keqtrajtuan rregullisht fizikisht nga z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s: u rrahën, u shpuan me thikë, u goditën me shkelma, me grushte dhe shuplaka çdo ditë.<sup>1646</sup> Gjatë gjithë kohës sa u mbajtën në ndalim, të ndaluarit u morën në pyetje, u akuzuan si spiunë, tradhtarë, hajdutë, gënjeshtarë ose si bashkëpunëtorë të serbëve. Gjithashtu, ata u frikësuan dhe u detyruan të shprehnin përkrahje për UÇK-në.<sup>1647</sup> Të ndaluarit u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi dhe ndaj tyre u kryen keqtrajtime fizike dhe psikologjike me synim marrjen e informatave ose deklaratave pranuese dhe/ose për t'i ndëshkuar, frikësuar dhe/ose diskriminuar ata për arsye politike.<sup>1648</sup>

798. Vrasja e paligjshme është vetiu një nga krimet më të rënda:<sup>1649</sup> vlera që mbrohet është jeta e njeriut. Për më tepër, të afërmit dhe personat në ngarkim financiar të tij lënë pas, mbeten pa një anëtar të familjes, dhe, rrjedhimisht, pa dashurinë dhe

---

<sup>1644</sup> *Shih* para. 584, 676.

<sup>1645</sup> *Shih* para. 585, 675.

<sup>1646</sup> *Shih* para. 586, 674.

<sup>1647</sup> *Shih* para. 587, 679, 682, 683.

<sup>1648</sup> *Shih* para. 587, 684. *Shih gjithashtu* 579, 583, 679.

<sup>1649</sup> *Në mënyrë të ngjashme, për shembull, ICC, [Ntaganda Sentencing](#), para. 44.*

kujdesin, pa mbështetjen, qoftë financiare, fizike, emocionale, psikologjike, morale apo të ndonjë lloji tjetër. Në këtë çështje, viktimat e vrasjes së paligjshme u vra afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, si rezultat i kombinimit të: (i) keqtrajtimit të rëndë të shkaktuar nga anëtarët e BIA-s, të cilët e mbajtën të ndaluar për gati tri javë, duke i shkaktuar dëmtim të rëndë fizik; (ii) refuzimit të ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s; dhe (iii) plagëve me armë zjarri të shkaktuara nga plumbat, në lidhje me të cilat Trupi Gjyqësor ka konstatuar se ekziston dyshim i arsyeshëm nëse ato mund t'u atribuohen anëtarëve të BIA-s, apo forcave serbe.<sup>1650</sup>

799. Trupi Gjyqësor e konsideron numrin e viktimave si pjesë të peshës së krimeve, dhe, rrjedhimisht, nuk do ta marrë parasysh si faktor rëndësues.<sup>1651</sup>

800. Trupi Gjyqësor arrin në përfundimin se aspektet e mësipërme janë relevante për vlerësimin e peshës së veprave penale.

#### ii. Pasoja të krimeve

801. Trupi Gjyqësor vëren se, si pasojë e ndalimit arbitrar dhe torturës, viktimat pësuan lëndime afatgjata, si fizike ashtu edhe mendore, ndër të cilat: lëndime në kokë, lëndime nga djegiet, thyerje të krahëve, gishtave dhe/ose dhëmbëve; dhimbje të vazhdueshme dhe të forta në të gjithë trupin; dëmtim të madh të shikimit; ndjenja të turpërta; dhe simptoma të çrregullimeve të stresit pastraumatik (makthe, fanitje të ngjarjeve traumatike dhe kujtime tronditëse të pavullnetshme).<sup>1652</sup> Ata gjithashtu përjetuan pasoja negative në marrëdhëniet personale dhe jetën familjare.<sup>1653</sup> Më tej, disa e patën dhe e kanë të vështirë të fitojnë jetesën.<sup>1654</sup>

---

<sup>1650</sup> *Shih* para. 639, 689-695. Në lidhje me këtë, Trupi Gjyqësor nuk e merr parasysh shkakun e fundit të vdekjes në përcaktimin e dënimit të duhur.

<sup>1651</sup> *Shih* Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 376.

<sup>1652</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1653</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1654</sup> *Shih* para. 550.

802. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se torturimi, dhe më pas vrasja e viktimës së vrasjes së paligjshme, patën pasoja të pakthyeshme jo vetëm mbi viktimën e drejtpërdrejtë dhe ata që ishin dëshmitarë të keqtrajtimit të tij, [REDAKTUAR].<sup>1655</sup> [REDAKTUAR],<sup>1656</sup> [REDAKTUAR],<sup>1657</sup> [REDAKTUAR],<sup>1658</sup> [REDAKTUAR].<sup>1659</sup>

803. Së fundi, Trupi Gjykses thekson se [REDAKTUAR].<sup>1660</sup>

804. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se krimet në shqyrtim shkaktuan pasoja të konsiderueshme dhe afatgjata, si fizike ashtu edhe psikologjike, te viktimat e ndaluara, dhe pasoja psikologjike tek [REDAKTUAR].

iii. Faktor rëndues: Kryerja e torturës në një mënyrë veçanërisht  
mizore<sup>1661</sup>

805. Trupi Gjykses rikujton se në disa raste rrahjet u kryen në grup<sup>1662</sup> dhe/ose zgjatën me orë të tëra<sup>1663</sup> dhe ishin aq brutale, sa që disa të ndaluar humbën vetëdijen<sup>1664</sup> ose më pas nuk ishin në gjendje të ecnin apo të qëndronin në këmbë.<sup>1665</sup>

806. Trupi Gjykses rikujton në veçanti se: pothuajse çdo ditë gjatë kohës që kaloi në ndalim, W01679 u godit me shkopinj hekuri dhe bishta sakicash, u dogj me dyllë të nxehtë qiriri dhe me një hekur të nxehtë, dhe u godit me rrymë elektrike.<sup>1666</sup> Z. Mustafa bëri sikur do ta ekzekutonte W03593-shin me armë zjarri, dhe, gjatë një rrahjeje, ai u

<sup>1655</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1656</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1657</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1658</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1659</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1660</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1661</sup> Rregulla 163(1)(b)(iv) e Rregullores. *Shih* Parashtrimin e bërë nga ZPS-ja në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të saj, para. 376-377.

<sup>1662</sup> *Shih* para. 534, 546, 570, 675.

<sup>1663</sup> *Shih* para. 546, 675.

<sup>1664</sup> *Shih* para. 531, 535, 546, 578, 586, 679, 680.

<sup>1665</sup> *Shih* para. 570-571, 680.

<sup>1666</sup> *Shih* para. 535, 539, 545.

godit me shkop bejsbolli që [REDAKTUAR]<sup>1667</sup> dhe në atë moment, ai do të kishte dashur që më mirë ta kishin vrarë,<sup>1668</sup> në një rast të dytë, teksa po e merrte në pyetje për të mësuar se çfarë dinte për identitetin e hajdutëve, z. Mustafa e rrahu W03593-shin dhe e kërcënoi se do ta vraste;<sup>1669</sup> gjatë një marrjeje në pyetje, W04669 u udhëzua nga dy anëtarë të BIA-s që të zhvishej në pjesën e sipërme të trupit e të përkulej, dhe u godit 10 deri 12 herë më një shkop gome, duke pësuar mavijosje në të gjithë shpinën.<sup>1670</sup>

807. Gjithashtu, Trupi Gjykues merr parasysh dëshminë e W01679-ës, i cili u poshtërua kur mbi të u urinua në prani të të gjithë të ndaluarve të tjerë, dhe kjo ndodhi në dy raste: W01679 dëshmoi se kur ai kërkoi ujë, dy ushtarë urinuan mbi të, e rrahën dhe i thanë, “Qe uji”.<sup>1671</sup>

808. Trupi Gjykues rikujton gjithashtu aktet e torturës, objekt i të cilave u bë viktima e vrasjes së paligjshme,<sup>1672</sup> që i shkaktuan dhimbje të zgjatura dhe agoni të papërfytyrueshme, që mund të cilësohen vetëm si të egra dhe brutale. Viktima e vrasjes së paligjshme – [REDAKTUAR] – ishin të ndaluarit që u keqtrajtuat më egërsisht.<sup>1673</sup> Viktima e vrasjes së paligjshme ishte i vetmi i ndaluar me duar të lidhura.<sup>1674</sup> Ai u rrah deri në atë pikë sa nuk ishte në gjendje të qëndronte në këmbë, u dogj me një hekur dhe u godit me thikë.<sup>1675</sup> Në një rast, viktima e vrasjes së paligjshme u rrah nga pesë apo gjashtë ushtarë të BIA-s.<sup>1676</sup> Si pasojë e keqtrajtimit të rëndë të kryer nga anëtarët e BIA-s, atij iu nxi i gjithë trupi nga mavijosjet dhe iu ënjt fytyra

---

<sup>1667</sup> *Shih* para. 546-675.

<sup>1668</sup> *Shih* para. 546.

<sup>1669</sup> *Shih* para. 547.

<sup>1670</sup> *Shih* para. 567.

<sup>1671</sup> *Shih* para. 511, 584.

<sup>1672</sup> *Shih* para. 569-576.

<sup>1673</sup> *Shih* para. 569.

<sup>1674</sup> *Shih* para. 569.

<sup>1675</sup> *Shih* para. 570.

<sup>1676</sup> *Shih* para. 570.

deri në atë pikë saqë vetëm fare pak mund t'i hapte sytë.<sup>1677</sup> Për herë të fundit viktimat e vrasjes së paligjshme u pa kur u liruan të ndaluarit e tjerë, në një gjendje në prag të vdekjes, që nuk mund të ecte e të qëndronte në këmbë.<sup>1678</sup> W01679 dëshmoi se viktimat e vrasjes së paligjshme ishte në një gjendje që vështirë mund të përshkruhej me fjalë: “trupi i tij, ato dhimbjet e tijna, ajo, atë erën që kena ndi na, atë erën e mishit”.<sup>1679</sup>

809. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se është vërtetuar rrethana rënduese sipas rregullës 163(1)(b)(iv) të Rregullores.

iv. Faktor rëndues: Viktima veçanërisht të cenueshme ose të pambrojtura<sup>1680</sup>

810. Trupi Gjykses rikujton se të ndaluarit u arrestuan befas, u dërguan dhe u mbajtën në një vend të izoluar; ata nuk e dinin se sa do të zgjaste ndalimi i tyre; dhe nuk kishin mundësi të kontaktonin ose të komunikonin me botën e jashtme, duke përfshirë edhe familjet e tyre.<sup>1681</sup> Trupi Gjykses gjithashtu thekson së disa prej të ndaluarve ishin në moshë relativisht të re në kohën kur u kryen krimet.<sup>1682</sup>

811. Për këto arsye, si rrethanë rënduese sipas rregullës 163(1)(b)(iii) të Rregullores, Trupi Gjykses konstaton faktin se viktimat në këtë çështje gjyqësore ishin veçanërisht të cenueshme dhe të pambrojtura, duke pasur parasysh statusin e tyre, izolimin dhe, në disa raste, moshën e re të tyre.

---

<sup>1677</sup> *Shih* para. 570.

<sup>1678</sup> *Shih* para. 571.

<sup>1679</sup> *Shih* para. 571.

<sup>1680</sup> *Shih* Rregulla 163(1)(b)(iv) e Rregullores. Si ZPS-ja ashtu dhe mbrojtësja e viktimave kërkuan që Trupi Gjykses ta merrte parasysh këtë faktor si rëndues (Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 374-375; Deklaratë e Mbrojtëses së Viktimave mbi Pasojat e Krimeve, para. 72).

<sup>1681</sup> *Shih* para. 428, 457.

<sup>1682</sup> [REDAKTUAR].

## v. Përfundim

812. Duke marrë parasysh llojin dhe rrethanat e krimeve, shkallën e vuajtjes së viktimave, si dhe dy rrethanat rënduese të lartpërmendura, Trupi Gjykses e vlerëson peshën e krimeve të shqyrtuara si të rëndë.

## (qq) Kontributi personal në krime

813. Trupi Gjykses rikujton se z. Mustafa, kreu drejtpërdrejt krimin e torturës dhe kreu krimet e ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme në kuadër të një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët me anëtarë të tjerë të BIA-s.<sup>1683</sup>

814. Fillimisht, Trupi Gjykses mban parasysh pozitën eprore dhe rolin qendror të të akuzuarit në sistemin e ndalimeve të paligjshme dhe torturave në kompleksin e ndalimit në Zllash, si edhe miratimin dhe mbështetjen në vijimësi prej tij të të njëjtave veprime në periudhën midis ose rreth 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999.

815. Së pari, z. Mustafa pa dhe ishte në dijeni se të ndaluarit po mbaheshin në kompleksin e ndalimit në Zllash afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, dhe u hoqi qëllimisht lirinë atyre gjatë kësaj kohe.<sup>1684</sup>

816. Së dyti, z. Mustafa, në funksionin si komandant i përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s, që kishte kontroll të plotë mbi kompleksin e ndalimit në Zllash: (i) urdhëroi vartësit e tij të BIA-s që t'i torturonin të ndaluarit, siç qe rasti i rrahjes së W01679-ës derisa humbi vetëdijen, si dhe që t'i mbanin ata në ndalim gjatë prillit 1999; (ii) nuk u dha të ndaluarve garanci bazë; (iii) u refuzoi të ndaluarve ndihmën mjekësore, me gjithë keqtrajtimin dhe lëndimet e tyre; (iv) nuk i liroi të ndaluarit, duke lejuar kështu që vartësit e tij të BIA-s t'i keqtrajtonin, deri sa ndodhi një ndryshim i jashtëzakonshëm i rrethanave – ofensiva serbe; dhe (iv) nuk i liroi dhe nuk i evakuo i viktimën e vrasjes

---

<sup>1683</sup> *Shih* para. 758-760.

<sup>1684</sup> *Shih* para. 652-659.



së paligjshme [REDAKTUAR], të cilët vazhduan të ishin në ndalim ndërkohë që z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s u larguan nga kompleksi i ndalimit në Zllash për shkak të afrimit të ofensivës serbe.<sup>1685</sup>

817. Së treti, z. Mustafa: (i) personalisht dhe qëllimisht goditi me shuplaka W01679-ën, duke e akuzuar si spiun, gënjeshtar dhe hajdut; (ii) personalisht dhe qëllimisht bëri sikur do ta ekzekutonte W03593-shin, teksa po merrej në pyetje dhe rrihej nga disa anëtarë të BIA-s, me akuzën se bashkëpunonte me serbët; dhe (iii) personalisht dhe qëllimisht rrahu W03593-shin me një shkop bejsbolli në të gjithë trupin dhe e kërcënoi se do ta vriste, teksa e merrte në pyetje për të mësuar se çfarë dinte për hajdutët.<sup>1686</sup> Duke vepruar në këtë mënyrë, z. Mustafa u dha shembull ose nxitje vartësve të tij të BIA-s që të kryenin veprime të ngjashme kundër të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash.<sup>1687</sup> Ai gjithashtu qe dëshmitar i keqtrajtimit të këtyre të ndaluarve dhe u dha urdhra vartësve të tij të BIA-s që t'i keqtrajtonin ata ose t'i kthenin në ahuret ku mbaheshin të ndaluar.<sup>1688</sup>

818. Së katërti, në lidhje me viktimën e vrasjes së paligjshme, z. Mustafa ishte i pranishëm më [REDAKTUAR] prill 1999 ose rreth [REDAKTUAR], kur [REDAKTUAR] ia dorëzoi viktimën e vrasjes së paligjshme një anëtar të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash. Z. Mustafa kishte synim keqtrajtimin vdekjeprurës që iu bë viktimës së vrasjes së paligjshme dhe që tortura të vazhdonte për rreth [REDAKTUAR] ditë, ndërkohë që i refuzoi atij ndihmën mjekësore, garancitë bazë ose lirim, që ishin në kompetencën e tij si komandant i BIA-s. Përfundimisht, z. Mustafa, në funksionin si komandant i BIA-s, vendosi të mos e lironte viktimën e vrasjes së paligjshme – çka faktikisht ishte barabar me një vendim për vrasjen e tij.<sup>1689</sup>

---

<sup>1685</sup> *Shih* para. 750, 753.

<sup>1686</sup> *Shih* para. 679, 729-733.

<sup>1687</sup> *Shih* para. 750.

<sup>1688</sup> *Shih* para. 654, 750, 753.

<sup>1689</sup> *Shih* para. 754.

819. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses e vlerëson shkallën e kontributit personal të z. Mustafa në krimet e shqyrtuara, si dhe synimin e tij, si shumë të lartë.

(rr) Rrethanat personale

820. Fillimisht, Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja nuk ka paraqitur shprehimisht asnjë argument në lidhje me zbutjen e dënimit përfundimtar të z. Mustafa.<sup>1690</sup> Megjithëse Trupi Gjykses është i mendimit se nuk ka detyrimin të kërkojë në dokumentacionin e çështjes informacione që Mbrojtja nuk e sheh të arsyeshme t'ia paraqesë, ai ka marrë parasysh rrethanat dhe faktorët e shtjelluar më poshtë.

821. Trupi Gjykses thekson se z. Mustafa është 50 vjeç,<sup>1691</sup> [REDAKTUAR]<sup>1692</sup> [REDAKTUAR].<sup>1693</sup> Trupi Gjykses gjithashtu thekson se, me sa ka dijeni, z. Mustafa nuk ka precedentë penalë të mëhershëm.<sup>1694</sup>

822. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se, gjatë deklaratave përmbyllëse, Mbrojtja konfirmoi se z. Mustafa:

ka vuajtur paraburgimin, nuk ka shkelur asnjë prej urdhrave që janë përcaktuar nga Trupi Gjykses. Kontaktet me familjen e tij kanë qenë shumë të vështira, megjithatë ai me shumë durim i ka duruar të gjitha masat që janë vendosur për të. Këto masa

---

<sup>1690</sup> Trupi Gjykses rikujton se Mbrojtjes iu dha shprehimisht mundësia për të paraqitur parashtrime në lidhje me dënimin (*Shih* [Decision Closing the Evidentiary Proceedings](#) (Vendim për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave), para. 22, 25; [Decision Setting Agenda for Closing Statements](#) (Vendim për Caktimin e Rendit të Ditës të Seancës mbi Deklaratat Përmbyllëse), para. 7-20).

<sup>1691</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, 19 nëntor 2019, f. 5, rreshti 2.

<sup>1692</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, 19 nëntor 2019, f. 5, rreshti 18; T. 14 shtator 2022, publik, f. 4799, rreshtat 14-15.

<sup>1693</sup> **Z. Mustafa:** 069404-TR-ET Part (Pjesa) 1, 19 nëntor 2019, f. 5, rreshtat 18-19. KSC-BC-2020-05, F00172, Trupi Gjykses I, *Kërkesë e Mbrojtjes për Përfundimin e Veçimit dhe Ndryshimin e Masave të Tjera të Marra ndaj Salih Mustafës*, 27 gusht 2021, konfidencial, para. 4, 13.

<sup>1694</sup> *Shih* KSC-BC-2020-05, F00050, Mbrojtësi i Specializuar, [Defence submission for the review on the detention of the Accused](#) (Parashtrim i Mbrojtjes për Rishikimin e Paraburgimit të të Akuzuarit i 20 Nëntorit 2020), 20 nëntor 2020, publik, para. 51; F00197, Mbrojtësi i Specializuar, [Defence submission for the review on the detention of the Accused](#) (Parashtrim i Mbrojtjes për Rishikimin e Paraburgimit të të Akuzuarit), 12 shtator 2021, publik, para. 27-33.

janë prezantuar prej një kohe shumë të gjatë dhe vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Megjithatë, ai nuk ka shkelur asnjë prej urdhrave të dhëna.<sup>1695</sup>

823. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se z. Mustafa bashkëpunoi me ZPS-në, sepse ai erdhi vullnetarisht në Holandë për t'u intervistuar nga ZPS-ja.<sup>1696</sup>

824. Sipas Trupit Gjykses, nga çdo person pritët që të veprojë në përputhje me ligjin ose me urdhrat e nxjerra nga gjykata, dhe, për këtë arsye, në vetvete kjo nuk përbën rrethanë lehtësuese, përveçse në raste të veçanta.<sup>1697</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykses nuk është bindur se sjellja e z. Mustafa në paraburgim dhe bashkëpunimi kanë qenë të veçantë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk i jep ndonjë vlerë lehtësuese kësaj rrethane.

825. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se gjatë deklaratave përmbyllëse, Mbrojtja vuri për herë të parë në dukje se "zotit Mustafa i vjen keq për viktimat, por ai nuk është përgjegjës as për dhimbjen dhe as për vuajtjet e tyre".<sup>1698</sup> Ndonëse sipas rregullës 163(1)(a)(ii) të Rregullores,<sup>1699</sup> kjo mund të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, Trupi Gjykses thekson se, gjatë gjithë procesit, z. Mustafa nuk ka shprehur apo shfaqur asnjëherë keqardhje për viktimat. Ai nuk pranoi të ishte i pranishëm në sallën e gjyqit gjatë deklaratës hyrëse të mbrojtëses së viktimave.<sup>1700</sup> Trupi Gjykses rikujton gjithashtu konstatimet e tij në lidhje me përpjekjet e z. Mustafa për të penguar çdo hetim dhe proces në lidhje me vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme.<sup>1701</sup>

<sup>1695</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4798, rreshti 24 deri në f. 4799, rreshti 4.

<sup>1696</sup> [Defence 20 November 2020 Detention Review Submissions](#) (Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit), 20 nëntor 2020, para. 21.

<sup>1697</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC, [Bemba et al. Sentencing](#), para. 186; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-3399, Trial Chamber III, [Decision on Sentence pursuant to Article 76 of the Statute](#), 21 June 2016, para. 81, që i referohet çështjes *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-3484-tENG-Corr, Trial Chamber II, [Decision on Sentence pursuant to article 76 of the Statute](#), (Katanga Sentencing), 23 May 2014, paras 127 to 128; ICTY, [Naletilić and Martinović Appeal Judgement](#), para. 630.

<sup>1698</sup> T. 15 shtator 2022, publik, f. 4799, rreshtat 5-6.

<sup>1699</sup> *Shih gjithashtu*, ICTY [Stanišić and Župljanin Trial Judgement](#), para. 897 dhe referencat që përmban ai.

<sup>1700</sup> T. 15 shtator 2021, publik, f. 305, rreshti 155 deri në f. 344, rreshti 15, në veçanti f. 335, rreshti 25 deri në f. 336, rreshti 1 ("Në fakt, siç ma sqaroi i akuzuari, [ai] nuk dëshiron të qëndrojë më në këtë seancë").

<sup>1701</sup> *Shih* para. 755-756.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do ta marrë parasysh këtë rrethanë për zbutjen e dënimit.

826. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është i mendimit se rrethanave personale të z. Mustafa nuk mund t'u jepet ndonjë peshë e konsiderueshme duke pasur parasysh llojin dhe peshën e krimeve të vërtetuara dhe kontributin e tij në to.

## **2. Përcaktimi i dënimit për secilën vepër penale më vete dhe i dënimit të njësuar**

827. Duke qenë se z. Mustafa është shpallur fajtor për më shumë se një vepër penale, Trupi Gjykses do të vijojë së pari me përcaktimin e dënimit për secilën vepër penale më vete, për të cilën është dhënë vendim fajësie dhe, së dyti, me përcaktimin e dënimit të njësuar për sjelljen kriminale të z. Mustafa në tërësi.

828. Pasi ka peshuar dhe balancuar të gjithë faktorët e përmendur më lart, ndër ta peshën e krimeve dhe pasojat e tyre, kontributin personal të z. Mustafa në krime, dhe rrethanat personale të z. Mustafa, si edhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese; si dhe pasi ka marrë parasysh qëllimet e lartpërmendura të dënimit, Trupi Gjykses është i mendimit se dënimi me burgim me kohëzgjatje të konsiderueshme është dënimi i duhur dhe, rrjedhimisht, e dënon z. Mustafa:

- (i) me 10 (dhjetë) vjet burgim për krimin e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1);
- (ii) me 22 (njëzet e dy) vjet burgim për krimin e luftës të torturës (Pika 3); dhe
- (iii) me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme (Pika 4).

829. Pasi ka përcaktuar këto dënime, Trupi Gjykses jep një dënim të njësuar me 26 (njëzet e gjashtë) vjet burgim për krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), torturës

(Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të z. Mustafa dhe krimet e kryera prej tij.

### 3. Koha e mbetur e burgimit

830. Sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim, Trupi Gjykses thekson se z. Mustafa u arrestua më 24 shtator 2020 dhe që nga kjo datë është mbajtur në paraburgim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses zbret nga dënimi i dhënë kohën e kaluar në paraburgim që nga 24 shtatori 2020.

## VIII. VENDIM

831. Për arsyet e lartpërmendura, bazuar në tërësinë e provave ekzistuese si dhe në parashtrimet e bëra para Trupit Gjykses në gjykim, në bazë të nenit 43 të Ligjit dhe rregullës 158 të Rregullores, Trupi Gjykses e shpall:

### z. SALIH MUSTAFA

**FAJTOR** për **Pikën 1** të Aktakuzës së Konfirmuar, **ndalim arbitrar** si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit, të kryer kundër së paku gjashtë personave, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash;

**FAJTOR** për **Pikën 3** të Aktakuzës së Konfirmuar, **torturë** si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, të kryer kundër së paku gjashtë personave, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash; dhe

**FAJTOR** për **Pikën 4** të Aktakuzës së Konfirmuar, **vrasje e paligjshme** si krim lufte, sipas neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, të kryer kundër një personi, afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash.

Trupi Gjykses e shpall z. Mustafa **TË PAFAJSHËM** për krimin e luftës të **trajtimit mizor** sipas **Pikës 2** të Aktakuzës së Konfirmuar.

Z. Mustafa dënohet me dënim të njësuar me **njëzet e gjashtë (26) vjet burgim**, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

Trupi Gjykses **urdhëron** Administratoren t'u caktojë numra prove të gjitha materialeve të shënuara më herët për evidentim, me qëllim dokumentimin e saktë të procesit, në përputhje me nenin 40(5) të Ligjit dhe rregullën 24(1) të Rregullores.

Trupi Gjykses gjithashtu **vendos** të ruajë juridiksionin në këtë çështje në lidhje me lëshimin më pas të Urdhrit për Zhdëmtim, ku do të specifikohet kompensimi i përshtatshëm për viktimat ose në lidhje me ta, në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**  
**Kryegjykatëse**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Zhilber Biti**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Roland Dekers**

E premte, 16 dhjetor 2022

Në Hagë, Holandë.

Shënim shpjegues

Në paragrafët 459 dhe 605 është shtuar fjala “[REDAKTUAR]” me poshtëshënimin përkatës pasi u fshi gabimisht gjatë përgatitjes së versionit të redaktuar publik.